

KDU 30 (05)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

STUDIME SHOQËRORE

1

2014



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

STUDIME SHOQËRORE

1

2014



PRISHTINË
2014

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS

STUDIME SHOQËRORE

1

2014

Këshilli redaktues - Editorial Board

Pajazit Nushi - Kryeredaktor / Editor-in-chief

Edi Shukriu - Sekretar, Secretary

Robert Elsie, Anëtar, Member

Arsim Bajrami, Anëtar, Member

Jusuf Bajraktari, Anëtar, Member

Anton Berishaj, Anëtar, Member

Adresa / Address:

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës
Redaksia e revistës *Studime Shoqërore*
Rr. Agim Ramadani, p.n.
10 000 Prishtinë
Republika e Kosovës
Tel. + 381 38 249 303
Fax. + 381 38 244 636
E-mail: ashak@ashak.org

Shënim:

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ka vendosur që nga viti 2014 të botojë revistë të veçantë për shkencat shoqërore, të ndarë nga revista e deritashme *Studime*. Revista e specializuar për disiplinat e shkencave shoqërore do të quhet *Studime shoqërore*.

Copyright © ASHAK

PËRMBAJTJA

PJESA HYRËSE	7
---------------------------	----------

STUDIME DHE TRAJTESA

<i>Mark Krasniqi</i>	
ROJTARËT SHQIPTARË TË KISHAVE ORTODOKSE NË KOSOVË	11
<i>Hivzi Islami</i>	
MIGRIMET E JASHTME, KONTEKSTI ETNIK DHE KRIJIMI I DIASPORAVE.....	47
<i>Zeqirja Ballata</i>	
RRUGËTIMI JETËSOR E KRIJUES I KOMPOZITORIT REXHO MULIQI.....	67
<i>Pajazit Nushi</i>	
PSIKOLOGJIA DHE INSTITUTE DHE INSTITUTE I SAJ MËSIMOR-SHKENCOR NË SHQIPTARËT	79
<i>Anton Kolë Berishaj</i>	
FLIJIMI DHE “VETËVRASJA ALTRUISTE”	103
<i>Edi Shukriu</i>	
MONUMENTET EPIGRAFIKE NGA SMIRA	121
<i>Exhlale Dobruna – Salihu</i>	
DY ZBULIME RASTI TË MONUMENTEVE SKULPTURORE NGA ANTIKITETI NË KOSOVË.....	145
<i>Ibrahim Berisha</i>	
KOMUNIKIMI I DIJES DHE TEKNOLOGJITË DIGJITALE.....	161

Zenun Halili

**LIBERALIZIMI POLITIK DHE DEMOKRATIZIMI
NË SHTETET ARABE.....** 175

Arsim Ejupi

**LUGINA E PRESHEVËS DHE KONTEKSTI
GJEOPOLITIK I PROJEKTIT LUNDRUES
“MORAVË - VARDAR”** 195

Ardian Gola

**DIKOTOMIA EPISTEMOLOGJIKE SHKENCË –
PHILOSOPHY** 207

Florent Muçaj

**POZICIONI KUSHTETUES I PRESIDENTIT KARSHI
UNITETIT TË POPULLIT - SHQYRTIME ANALITIKE ...** 221

LIGJËRATË INAGURUESE

Arsim Bajrami

**ARGUMENTIMI I GJND-së PËR PAVARËSINË
E KOSOVËS** 251

RECENSIONE DHE KRITIKA

Muhamedin Kullashi

**Pierre Péan, UNE GUERRE « JUSTE » POUR UN ETAT
MAFIEUX, Paris, Fayard, 2013, p. 450.** 273

Hivzi Islami

**Arsim Ejupi, LUGINA E PRESHEVËS. Studim
kompleks gjeohapësinor, Akademia e Shkencave dhe
e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2013, f. 350.** 291

Fehmi Agani

**Rexhep Qosja, MORFOLOGJIA E NJË FUSHATE,
Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1980, fq. 345.** 297

Lendita Juniku – Pula

KRONIKA 2013 327

PJESA HYRËSE

Udhëzime për autorët e punimeve të propozuara për botim

Për botim në revistën *Studime shoqërore* do të merren në konsideratë ndihmesat (trajtesa, studime, artikuj, recensionë, etj.) që nuk janë botuar më parë (pos në raste të veçanta) dhe që paraqesin rezultate hulumtimesh origjinale shkencore, profesionale apo të zbatuara nga ana e autorit në fushat e shkencave shoqërore, duke mos prekur të drejtat autoriale të të tjerëve. Për të gjitha punimet e paraqitura për rubrikën Artikuj – studime, Redaksia merr parasysh procedurën e vlerësimit, përkatësisht recensimit. Recensionin mbetet në Redaksi, ndërsa emrat e recensentëve nuk bëhen të njohur për autorin e punimit. Për të tjerat vendos Redaksia. Për origjinalitetin dhe cilësinë e ndihmesave përgjigjen vetë autorët.

Punimi shkencor i paraqitur duhet të përmbajë:

Emrin dhe mbiemrin e autorit, vendin ku jeton e vepron aktualisht dhe titullin e punimit. Pastaj vjen abstrakti me jo më shumë se 200 fjalë dhe në vijim, para punimit, shënohen deri në 10 fjalë çelësa termat kryesorë. Punimi ose trajtesa shkencore mund të shtrihet më së shumti deri në 10 faqe të formatit A4 të radhitura me kompjuter Microsoft Word (210x297 mm), me margjina 20 mm, në fontin Times New Roman 12 pt me radhor normal. Në fund punimi artikulli duhet të ketë një rezymë në rreth 1 faqe. Nëse punimi është në një gjuhë zyrtare të Kosovës, rezymëja duhet të jetë në një prej gjuhëve me qarkullim të gjerë (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) dhe e kundërta. Abstrakti, fjalët a termat çelësa, rezymëja dhe bibliografia duhet të jenë në Times New Roman 10 pt. Literatura e punimit jepet në fund, ndërsa fusnotat në tekstin me të cilin ndërlidhen shënohen në fund të çdo faqeje. Figurat dhe tabelat jepen në tekst. Në literaturë dhe fusnota duhet të shënohen: mbiemri dhe emri i autorit, titulli i punimit të cituar, titulli i publikimit, botuesi, vendi i botimit, viti i botimit, numri i faqes (faqeve). Kur citohet shqip shënohet f. për një f. dhe ff. për më shumë faqe (në gjuhë tjetër: p. apo pp.).

Referimet në fusnotë zakonisht shënohen si vijon:

BUDA, Aleks (2006) “Studime historike”, ASHAK, Prishtinë, ff. 604.
SHULTZ P. Duane (1969) “A history of Modern Psychology”,
Hercourt Brace College Publishers, ff. 511.

Citimi i një punimi në revistë:

ANDREA, Zhaneta (1997) Tuma e Cerujës (Rrethi i Gramshit) - Le
tumulus de Ceruje, ILIRIA 1 - 2, Tiranë, pp. 85 - 93.

Ndihmesa e propozuar duhet të jetë korrektuar gjuhësisht sipas
rregullave të drejtshkrimit të shqipes standarde ose të gjuhës në të
cilën është shkruar. Redaksisë i dorëzohet versioni elektronik. Autorët
që përdorin shenja të veçanta duhet t'i dorëzojnë edhe fontet përkatëse,
ashtu si dhe një version në letër apo PDF për identifikim të shenjave të
veçanta.

Dorëshkrimet nuk kthehen. Redaksia rezervon të drejtën për të
mos dhënë shpjegime në rast se nuk botohet punimi, artikulli, trajtesa
apo ndihmesa e paraqitur.

Redaksia

STUDIME DHE TRAJTESA

Mark KRASNIQI, Prishtinë

ROJTARËT SHQIPTARË TË KISHAVE ORTODOKSE NË KOSOVË*

KDU 271.2 (496.51)

Abstrakt

Në Kosovë janë disa kisha ortodokse mesjetare, të ndërtuara në kohën kur Bizanti ka sunduar në këto vise, të cilat më vonë i kanë usurpuar serbët, duke i konsideruar si prona të tyre. Kisha serbe ortodokse dhe pushteti serb kanë usurpuar gjithashtu edhe disa kisha katolike në Kosovë, në Mal të Zi, në Maqedoni etj., për çka ka kundërshtuar zyrtarisht edhe Papa. Në këtë punim trajtohen tri objekte të tilla sakrale në Kosovë: Kisha e Deçanit, patrikana (kisha) e Pejës dhe kisha e Deviqit në Drenicë afër fshatit Llaushë. Këto kisha gjatë sundimit të Perandorisë Osmane kanë qenë disa herë në rrezik, por shqiptarët e fshatrave afër tyre i kanë mbrojtur, duke rrezikuar edhe jetën e tyre. Madje shqiptarët kanë formuar institucion të veçantë për ruajtjen e tyre në formën e “Rojtarëve të kishave ortodokse”, duke u quajtur ose emëruar me titullin “vojvodë i kishës” përkatëse. Vojvodën e kanë zgjedhur vetë fshatarët, të cilin ia kanë paraqitur igumenit (kryemurgut) të kishës për pëlqim dhe autoritetit kompetent osman për zyrtarizim. Vojvoda ka qenë trashëgues brez pas brezi.

Fjalët çelës: Kishat (manastiret), vojvodë i kishës, toleranca tradicionale shqiptare fetare e kombëtare, respekti tradicional ndaj objekteve sakrale: kishat, xhamitë, varrezat, urat, kroyet etj.

Në Kosovë ekzistojnë disa kisha e xhami të vjetra nga epoka mesjetare, me vlerë të madhe të arkitekturës e pikturës fetare dhe me domethënie të madhe historike e përgjithësisht kulturore, kështu që, si të tilla, një numër i tyre janë nën mbrojtjen e shtetit. Mirëpo me këtë rast do të merrem me problemin e ruajtjes së tyre në të kaluarën, kur organet shtetërore angazhoheshin fare pak për to. Këtë herë subjekt i këtij punimi janë tri kisha: Patrikana e Pejës, Kisha e Deçanit dhe Kisha e Deviqit në Llaushë të Drenicës, përkatësisht rojtarët e tyre në të kaluarën, të cilët

* Punimi mbi rojtarët e kishave është botuar serbisht në “Гласник Музеја Косова и Метохије” III, Приштина, 1958. Ribotohet me disa ndryshime e shtesa.

Vlen të theksohet se si asistent i Akademisë Serbe të Shkencave, ku kam punuar 12 vjet, ketë punim ia kam ofruar Institutit Etnografik të kësaj Akademie për botim. mirëpo recensentët e Akademisë e refuzuan me motivacion se unë shkruaj mirë për rojtarët e kishave, sepse ata janë shqiptarë, sikurse edhe unë vet. Për më tepër ata theksonin se këta “vojvodë” u janë imponuar kishave për t’i plaçkitur.

quheshin dhe “vojvodë të kishës.” Kishat tjera dhe xhamitë, sa dimë, nuk kanë pasur rojtare të posaçëm të shkallës së vojvodëve. Këtë problem e kam hulumtuar në terren në kishat (manastiret) e përmendura gjatë kërkimeve etnografike dhe antropogjeografike në Kosovë, në periudhën 1952–1955. Këtu po paraqes rezultatet e kësaj pune studimore, me disa plotësime më të nevojshme.

I

Kisha e Deçanit është ndërtuar rrëzë bjeshkëve Alpet Shqiptare, në terrenin e fshatit Deçan, mu në hyrje të Grykës së Deçanit, nëpër të cilën rrjedh Lumi i Bardhë (Bistrica), i rrethuar me pyje gështenjash e pishash, mbi të cilat ngrihen majat e larta të zhveshura nga reshjet atmosferike. Manastiri (kisha) i Deçanit është ndërtuar në shekullin XIV, gjatë viteve 1327-1335. Ndërtimin e kësaj kishe e kanë financuar dinastët Nemanjiq, përkatësisht Uroshi III dhe biri i tij, Dushani. Arkitekt i kësaj vepre madhështore ka qenë kleriku katolik shqiptar nga Kotorri, patër Vito Kuqi, i cili ka qenë edhe mbikëqyrës i realizimit të punimeve sipas projektit të tij.¹ Nga dokumentet historike shihet se Dushan Nemanjiqi ka caktuar një kompani ushtarësh për të siguruar kryerjen e punimeve nga popullsia vendore, e cila ka qenë kundër ndërtimit të kësaj kishe ortodokse në vendin e kishës katolike shqiptare, që ka qenë e njohur me emrin „Kisha e Gashit” (banorët e Deçanit janë të fisit Gash, i cili shtrihet edhe në disa fshatra të tjera fqinjë).² Ky fakt tregon qartë përkatësinë etnike shqiptare të banorëve të Rrafshit të Dukagjinit. Kjo është ndërtesa më e bukur sakrale e ndërtuar në atë kohë në këto vise, me mure prej mermeri dhe me ornamentikë të pasur të jashtme e të brendshme. Prej rozete, në dyshtemenë e mermerit e deri në kupolë, kisha është e lartë 32 metra. Sundimtari Stefan Nemanjiqi është i varrosur në këtë kishë. Ai kësaj i dha shumë privilegje e prona të ndryshme dhe kështu mori edhe emrin Stefan Deçani, madje edhe kisha serbe ortodokse e shpalli shenjt po me këtë emër.³

¹ Влада Петковић, Ђорђе Бошковић, Манастир Дечани, Књ. I, Београд 1941, Српска Академија Наука, 1-18.

² Jahja Drançolli, Monumentet e kultit katolik në Kosovë, “Koha ditore” Prishtinë, 14 prill 2001.

³ Споменици културе, Београд 1951, 236; Франц Месеснел, Стари српски споменици, Споменица двадесетпетогодишњице ослобођења Јужне Србије 1912-1937, Скопје 1937, 374.

Patrikana (kisha, manastiri) e Pejës është ndërtuar dhe zgjeruar gjatë shekujve XIII e XIV⁴, në periferi të Pejës, mu në bregun e majtë të Lumit të Bardhë (Bistrica e Pejës), aty ku ky lum del nga gryka e Maleve të Rugovës. Bukuria arkitektonike e Patrikanës së Pejës as që mund të krahasohet me Kishën e Deçanit, pra, nuk ka ndonjë vlerë, por roli i saj historik në të kaluarën ka qenë i madh, si seli e patrikut (kryetarit) të Kishës ortodokse serbe.

Kisha e Deviqit, sipas traditës, është vepër e despotit Gjuragj Brankoviq, por në dokumente përmendet për herë të parë në shekullin XVI, më saktë më 1578. Ndërtesa më parë ka qenë fare modeste, e vogël, pa kupolë, por më vonë, gjatë kohës, janë bërë zgjerime, përmirësime dhe pranë saj janë ndërtuar shtesa e kthina të reja⁵, kështu që pamja e saj e tashme nuk tregon kishën origjinale. Sundimtarët nga dinastia e Nemanjiqëve kanë ndërtuar kisha e manastire edhe në vise të cilat nuk kanë qenë në shtetin e tyre, me qëllim që ta afirmojnë dinastinë e vet, sidomos në viset e pushtuara, ku “ato kanë qenë para së gjithash gurë kufiri, sesa shenjtore”⁶. Serbët në atë kohë s’kanë pasur as mundësi ekonomike, as aftësi profesionale për të ndërtuar objekte monumentale, shkruan historiani serb, profesor Pero Slijepčević. Nga kjo del se projektet dhe punimet në ndërtesa të tilla i kanë bërë të huajt, kurse dinastia e Nemanjiqëve ka qenë vetëm financuese⁷, shton ky autor.

Këto tri kisha gjenden në një regjion ku gjatë sundimit osman shpeshherë ka sunduar çrregullimi e anarkia me kryengritje të shqiptarëve kundër okupatorit aziatik.⁸ Gjatë pesë shekujsh të sundimit osman ka pasur shumë pashallarë shqiptarë, të cilët, për një kohë, nuk e njihnin pushtetin e sulltanit në Kosovë dhe në vise të tjera etnike shqiptare, por sundonin vetë të pavarur në pashallëqet e tyre. Madje edhe atëherë kur e njihnin sulltanin, kjo ka qenë vetëm një gjë formale. Pashallarë të këtyllë kanë qenë Rrotullat në Prizren, Mahmutbegollët në Pejë, Elez-pashajt në Gjakovë, Gjinollët në Prishtinë etj.⁹ Në këtë mënyrë shpeshherë shqiptarët kanë pasur konflikte e përleshje të armatosura me ushtrinë turke. Në kushte të

⁴ Po aty., 376.

⁵ Споменици културе, Ђорђе Радојчић, Јањићије Девички, Гласник Етнографског института САНУ, Књ. I, Св. 1-2, Београд 1952, 174-177.

⁶ Pero Slijepčević, Старе Српске Задужбине, “Огледи” I, Београд 1934, 92, 95, 115, 123.

⁷ Po aty.

⁸ Иван С. Јастребов, Подаци за историју српске цркве, Београд 1879, 57.

⁹ Петар Костић, Гласник Скопског научног друштва, Књ. V, Скопље. 1929, 157.

tilla vihej në rrezik siguria personale e njerëzve dhe e pasurisë së tyre. Nga ana tjetër, as fiset shqiptare në malet rreth e përqark, por edhe në rrafshin e Kosovës, nuk iu bindnin organeve të pushtetit turk, por ngjante që edhe ato kishin ngatërresa mes vete. Feudalët e vendit, bejlerë e agallarë, shpeshherë ia bënin varrin shoqishojt, të uritur për prona të reja e tituj të lartë. Në këto ngatërresa ata i shfrytëzonin çifçinjtë e tyre, fshatarët e varfër, të cilët shumë herë e paguanin me kokë apetitin e pangopur të zotërinjve të tyre feudalë. Ngjante ndonjëherë që të krijohej ndonjë mosmarrëveshje edhe në planin fetar mes individëve të krishterë e myslimanë, të nxitur nga pushteti osman, i cili në vazhdimësi punonte që ta përçajë popullin në baza fetare. Në përpjekje të tilla okupatori aziatik s'ka pasur sukses, përveç ndonjë rasti të rrallë e të parëndësishëm mes individëve, të cilët kishin ngatërresa personale mes veti. Hakmarrja, pusitë, grabitjet e vjedhjet e ndryshme e bënin këtë situatë edhe më të zymtë, shkaktonin shqetësim dhe pasiguri të përgjithshme. Kuptohet që në këtë situatë rrezikohej siguria e pronës dhe e pronarëve të saj. Edhe sot qëndrojnë në këmbë kullat e forta shqiptare gati në çdo fshat të Rrafshit të Dukagjinit, pastaj të Drenicës dhe në disa vise të tjera të Kosovës, si dokumente të gjalla që dëshmojnë për kohën e vështirë të kaluar kur këto janë ndërtuar për të mbrojtur familjen dhe pasurinë, konkretisht kafshët nga sulmet e ndryshme.

Në kushte të tilla kanë qenë në rrezik edhe kishat e manastiret, sidomos ato që ishin më të pasura. Megjithatë, kisha e Deçanit, që gjendet e vetmuar midis pyllit dhe kisha e Pejës, gjithashtu rrëzë maleve, kanë mbetur të paprekura gjatë shekujve plot trazira, në mesin e popullsisë shqiptare të besimit mysliman. Kjo ka ndodhur madje gjatë atyre periudhave kur edhe kullat shqiptare të trimave të njohur sulmoheshin nga osmanët, ose nga individë vendorë që merreshin me punë jo të mira. Këtë dukuri priftërinjtë e murgjit (klerikët) ortodoksë e shpjegojnë në mënyrën e vet. Ata thonë se këto kisha i ka ruajtur Perëndia, e cila ka bërë edhe mrekulli të ndryshme për mbrojtjen e tyre. Bile, sipas përrallave të priftërinjve të tillë, këtë rol mbrojtës e kanë luajtur edhe skulpturat e mermerit përmbi portalin e kishës së Deçanit, të cilët, në momentin kritik, qenkan “ngjallur” e vërsulur kundër sulmuesve. Mrekulli të tilla “paska bërë” edhe shenjtji Janiçije, padron qiellor i kishës së Deviçit.

Legjendat janë legjenda, ndërsa realiteti historik është diçka krejtësisht tjetër. Sikur këto kisha të kishin mbetur në mëshirën e “fuqive qiellore”, në mëshirën e Perëndisë, ato sot as themelet nuk do

t'i kishin aty ku janë. Këto monumente historike e kulturore kanë mbetur të parrënuara gjatë shekujve e të ruajtura të paprekura vetëm në saje të popullsisë bujare shqiptare të fshatrave përreth tyre dhe më gjerë.

Për hir të vërtetës duhet cekur se edhe sulltani ka dhënë disa urdhra me të cilat ndalohej çdo sulm kundër kishës së Deçanit nga kushdoqoftë. Urdhra të tilla kanë dhënë edhe pashallarët dhe autoritetet e tjera osmane. Mirëpo, nga ana tjetër, spahiu Toçi-ogllu ka dashur ta rrënojë kishën e Deçanit, me pretekst se nën themelet e saj gjendet miniera e arit. Sulltan Sylejmani (1529-1566), me një ferman të posaçëm, ka urdhëruar që kjo të mos bëhet. Sulltan Mehmeti III, më 1600, u ka dhënë urdhër begut të Dukagjinit dhe kadiut të Gjakovës (“Alltun ili”) që të bëjnë hetime dhe të marrin një vendim të drejtë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet fshatit Isniq dhe kishës së Deçanit¹⁰, sepse murgjit janë ankuar se fshatarët nuk i kryenin obligimet ndaj kësaj kishe. S'ka dyshim se këtu është fjala për popullsinë shqiptare të këtij fshati.

Në Rrafshin e Dukagjinit dhe në regjione të tjera të Kosovës, si edhe në të gjitha viset etnike shqiptare në Ballkan, shumë urdhra të pushtetarëve të lartë osmanë, madje edhe fermanët e Sulltanit, mbeteshin vetëm në letër. Shqiptarët nuk i zbatonin rregullisht as obligimet financiare ndaj okupatorit aziatik, Perandorisë Osmane; shpesh çoheshin në kryengritje të armatosur kundër pushtetit dhe ushtrisë turke, kështu që një urdhër ose ferman i sulltanit për mbrojtjen e kishave ortodokse s'ka pasur kurrfarë efekti për sigurinë e tyre. Këtë mbrojtje ato e kanë gëzuar vetëm nga popullsia shqiptare, sidomos nga fshatarësia e thjeshtë, të cilën edhe kishat shpeshherë e shfrytëzonin, siç shihet nga rasti i konfliktit me fshatin e Isniqit.

Në feudalizmin mesjetar kisha ka qenë e plotfuqishme për ta shfrytëzuar fshatarin, ose për ta mbrojtur në raste të rralla. Pushteti shtetëror ka qenë nën ndikimin e madh fetar të saj. Ky ndikim ka qenë vendimtar para shtrirjes së Perandorisë Osmane në këto vise të Evropës Juglindore. Mirëpo, më vonë, në disa regjione situata ka ndryshuar me kohë, kështu që disa kisha e manastire kanë qenë të detyruara të kërkojnë mbrojtje nga fshatrat përreth tyre, zakonisht nga familjet dhe individët e njohur që gëzonin autoritet në popull.

Në Rrafshin e Dukagjinit dhe në Drenicë, shqiptarët që e ruanin kishën populli i quante “vojvodë”, ose rojtarë të kishës. Familjen e tillë zakonisht e zgjidhte fshati, ose fisi dhe kryefamiljarin ia prezantonin

¹⁰ J. Ястребов, Подаци за историју , 37-46.

kryemurgut. Mirëpo për këtë vendim të fshatit bisedonin më parë edhe me kryemurgun (priftin kryesor). Zgjedhjen e vojvodës zakonisht e miratonin edhe autoritetet vendore osmane. Vojvoda ka pasur për detyrë që në emër të fshatit ose të bajrakut e të fisit ta mbrojë kishën në rast të rrezikut, madje duke rrezikuar edhe jetën e vet. Në kishën e Deçanit vojvoda ka pasur një dhomë të caktuar të rojës.

Roje, vojvodë e kishës së Deçanit ka qenë familja e Salih Rustës nga Deçani. Kryefamiljari Salih Rusta, në ditët kur kam biseduar me të (më 1955) ka pasur 90 vjet, por me shëndet e memorie shumë të mirë. Kishën e Pejës e ka ruajtur krejt Rugova, përkatësisht 13 fshatrat e saj, por titullin e vojvodës e ka pasur familja e Zhuj Rugovës. Familja e Behram Vojvodës nga Llausha e ka pasur këtë titull dhe e ka mbrojtur kishën në emër të bashkëfshatarëve të vet. Mbrojtja e këtyre kishave, para së gjithash, ka qenë detyrë e vojvodës së caktuar, por në raste trazirash apo kërcënimesh etj. gjithmonë kanë qenë gati të kontribuojnë në këtë drejtim edhe fshatarët e tjerë bashkë me vojvodën.

II

Në Rrafshin e Dukagjinit familja e Salih Rustës përmendet më tepër si “shtëpi vojvodë.” Edhe vetë kisha e Deçanit ka zë dhe respekt më të madh në këtë trevë se kisha e Pejës dhe e Devičit. Kisha e Deçanit ka qenë në pozitë tjetër nga patrikana e Pejës, e cila ka qenë e mbrojtur deri diku edhe nga pushtetit turk, kurse ajo e Deçanit vetëm në raste të rrezikut për të. Përveç kësaj, kisha e Deçanit ka pasur disa mosmarrëveshje pronësore me Isniqin, por megjithatë, disa kryemurgjë të saj kanë ditur të mbajnë marrëdhënie shumë të mira jo vetëm me familjen e vojvodës, por edhe me të gjithë fshatarët rreth e përqark. Me këtë rast kemi më shumë të dhëna për këtë kishë, e cila dikur ka qenë në zë për “aftësi mjekuese”, por edhe për bukurinë e saj arkitektonike. Vojvoda plak Salih Rusta i mbante mend shumë mirë ngjarjet në lidhje me mbrojtjen e kishës dhe të historikut të familjes së tij.


Nuk ishte vetëm ky dëshmitar i gjallë i kohëve të kaluara, por edhe pleqtë e tjerë, bashkëfshatarë të tij, mbanin mend dhe tregonin çdo gjë njësoj si ai. Të parët e Salih Rustës, dikur moti, kanë jetuar në Piprraj në Mal të Zi. Ata kanë qenë shqiptarë të besimit katolik, kështu që kanë rënë në konflikt me disa shtëpi malazeze. Nga ky konflikt janë shkakuar disa vrasje ndërmjet tyre. Për këtë arsye ata shpërngulen për t’iu larguar hakmarrjes dhe vendosen në Malësi, diku ndërmjet fiseve Gash e Krasniqe. Mirëpo pas një kohe edhe aty

ngatërrohen me komshi, të cilët nuk i kanë pasur në sy të mirë ardhacakët në mjedisin e tyre. Edhe këtu ata e vrasin një malësor dhe detyrohen të shpërngulen dhe të vendosen në Deçan. Për ta humbur gjurmën sa më mirë, ata ndërrojnë fis e fe, nga Piprrajt e dikurshëm bëhen Gash, si fshatarët e tjerë të Deçanit, dhe nga katolikët e mëparshëm bëhen myslimanë të rinj, siç ishin deçanasit e tjerë. Sipas traditës, kjo metamorfozë ka ngjarë para rreth 200 ose 300 vjetësh. Stërgjyshi i Salih Rustës, i cili i pari nga kjo familje është vendosur në Deçan, ka pasur emrin Kolë. Salih mban mend emrat e gjeneratave të kaluara deri te Kola. Gjenealogjia e kësaj familjeje është kjo: Salih (90 vjeç) – Rusta – Dema – Uka – Isufi – Ibra – Hyseni – Caca – Kola. Caca i ka pasur 4 djem, prej të cilëve sot (1955) ekzistojnë më se 70 familje të shpërndara në Deçan, në Carabreg (Voksh afër Deçanit) dhe në Bërzhënik, afër Pejës. Të gjitha këto familje quhen Cacaj, por ndahen në disa vëllazëri: Pepkolaj, Likaj, Lushaj dhe Iberhysaj. Familja e Salih Rustës është Iberhysaj, bashkë me 15 familje të tjera në Deçan, 5 në Baran (në Lug të Baranit), 2 në Bërzhënik e 2 në Qyshk (afër Pejës).

Sipas një tradite dikur kanë qenë rojtarë të kishës së Deçanit fshatarët e Çellopekut e të Lugut të Baranit. Duket se dikur edhe disa fshatra të tjera e kanë ruajtur këtë kishë (Loxha, Strellci etj.). Ndoshta nga këto fshatra ka pasur rojtarë të përkohshëm, të angazhuar në këtë punë në ndonjë rast rrezikut si vullnetarë, ose për ndonjë kompensim material. Kështu mund të ketë qenë rasti edhe i disa fshatrave të tjera, por ata fshatarë nuk e kanë pasur titullin e vojvodës ashtu siç ka qenë rasti me rojtarët e Çellopekut e të Lugut të Baranit.

Tregohet, sipas traditës, se murgjit (kallogjerët) e kishës së Deçanit njëherë nuk ua kanë dhënë shpërblimin e kontraktuar rojtarëve të Çellopekut, për këtë arsye ata zemërohen, e mbyllin kishën dhe i marrin kallogjerët përpara për t'ua dorëzuar organeve të pushtetit osman në Pejë. Rugës i takon një nga familja e Salih Rustës. Ai i lutë rojtarët që t'i lirojnë murgjit dhe vetë bëhet garant se ata do t'ua paguajnë hakun. Rojtarët e kanë njohur familjen e Salih Rustës, i besojnë bashkëbiseduesit dhe i lirojnë murgjit. Pas kësaj ngjarjeje, murgjit e lusin familjen e Salih Rustës që ajo të pranojë patronazhin mbi kishën e Deçanit. Me pëlqimin e fshatit dhe të fisit Gash, të partë e Salih Rustës e pranojnë këtë detyrë dhe autoritetet osmane e zyrtarizojnë këtë marrëveshje. Në këtë rast dhe në këtë mënyrë familja e Salih Rustës merr detyrën e padronit, përkatësisht të vojvodës së kësaj kishe. Kjo detyrë s'ka qenë e lehtë kur pushka i ndante fjalët.

Kisha e Deçanit shumëherë ka qenë në rrezik, por ka shpëtuar nga plaçkitja e djegia vetëm në saje të mbrojtjes së vojvodës e të fisit Gash dhe të katundeve të tjera, madje duke e paguar edhe me kokën e tyre, sepse këtë kishë ata e kishin marrë në besë. Në vitin 1878 më se 230 mijë shqiptarë janë dëbuar, vrarë e masakruar nga ushtria serbe në Sanxhakun e Nishit, në Toplicë, duke ua marrë tokat, duke ua djegur shtëpitë, xhamitë, madje, duke ua prishur edhe varrezat. Pushteti turk ka tentuar ta shfrytëzojë këtë situatë të vështirë dhe është përpjekur t'i organizojë shqiptarët që në shenjë hakmarrjes ta rrënojnë kishën e Deçanit. Pushteti turk mblodhi një numër jo të vogël njerëzish për ta kryer këtë punë, mirëpo vojvoda i atëhershëm Rustë Alija, babai i Salih Rustës, thirri fisin Gash dhe shumë fshatra të tjera, pa dallim fisi, që ta mbrojnë kishën. Ata u mblodhën shpejt në oborrin e kishës dhe u çuan fjalë njerëzve të cilët i kishte mobilizuar pushteti turk, se pa luftë askush nuk mund të hyjë brenda dyerve të oborrit të kishës. Duke parë se aty do të derdhej gjaku, ky grup njerëzish të nxitur nga turqit u shpërnda dhe kisha shpëtoi nga shkatërrimi i sigurt që i kërcënohej.¹¹



Kisha e Deçanit, vepër e arkitektit shqiptar Fra Vito Kuçi

¹¹ Sipas tregimit të vojvodës së kishës, Salih Rusta.

Se me ç'fanatizëm e kanë ruajtur fshatarët e Deçanit këtë kishë, shihet edhe nga një shembull tjetër. Me një rast, njëfarë Zekë Sylja nga Deçani kishte vrarë një kushëri të vetin – Mal Nimonin dhe vëllamin e tij, vetëm për shkak se Mala ia kishte marrë kapuçin një nxënësit të kishës.¹²

Më 28 gusht është festa e kishës, dita e Zojës së Bekuar, me ç'rast te kisha mbliidhen shumë besimtarë serbë, madje edhe nga viset e largëta nga Serbia, Maqedonia etj. Ka pasur raste kur këta pelegrinë sulmoheshin rrugës për në Deçan. Për këtë rast vojvoda i kishës shkonte në Prizren, ku mbliidheshin njerëzit nga rrethinat e tjera për të shkuar ditën e festës së kishës. Këtyre u printe dhe i mbronte vojvoda nga njerëzit e papërgjegjshëm. Mbahet mend një rast kur disa njerëz nga fshati Bardh, përkatësisht vëllezërit Col e Zhuj Sokoli dhe kushëriri i tyre, Rustem Rusta, vriten dhe dy shokët e tyre plagosen në përleshje me vojvodët që e ruanin kishën, përkatësisht njerëzit pelegrinë që kishin ardhur aty ditën e festës së saj.

Pas kësaj ngjarjeje, malësorët për hakmarrje, ia shkelin dhe ia dëmtojnë vojvodës krejt arën e mbjellë me misër dhe ia plagosin një mashkull. Në përleshje plagosen Rexhë Zenel Ibërhysaj nga Deçani dhe Sadik Zeneli e Mic Avdyli nga Bërzhniku. Vetëm me ndërmjetësime të mëdha të autoriteteve të ndryshme vendore u ndërpre kjo gjakderdhje që u bë në mbrojtjen e kishës së Deçanit.¹³



*Salih Rusta, vojvodë i Kishës
së Deçanit*

Kisha e Deçanit ka qenë në rrezik sidomos në kohën e Kryengritjes së parë në Serbi (1804). Vetëm në sajë të mbrojtjes së fshatarëve shqiptarë, në krye me familjen e vojvodës, ky monument historik edhe në ato momente kritike mbet i paprekur nga askush. Në atë kohë ka qenë igumen (kryemurg) i manastirit Haxhi Danilo (ka jetuar 112 vjet, 1708 – 1820), i cili ka pasur marrëdhënie shumë të mira me shqiptarët dhe ka ditur të shfrytëzojë

¹² Леонтије Нинковић, Братство лавре Високих Дечана, Пећ, 1923, 45-46.

¹³ Петар Костић, Црквени живот православних Срба у Призрену и његовој околини у XIX веку (са успоменама писца), Београд 1928, 42.

me mjeshtri traditën e besës shqiptare. Kjo shihet nga rasti kur plasi kryengritja në Serbi e Danilloja e dinte që turqit do ta sulmonin kishën, prandaj ai i lut shqiptarët që kishën ta ruajnë tash më mirë se kurrë më parë. Megjithatë, ai, për çdo eventualitet, shumë gjera të çmueshme nga thesari i kishës i fsheh ndër shqiptarët. Në disa raste këto i jepte si peng për një shumë të hollash, sepse në ato ditë pashai osman erdhi me ushtri nga Peja në Deçan dhe kërkonte nga Igumeni të holla për mbajtjen e ushtrisë. Në realitet ai donte ta plaçkiste manastirin, mirëpo shqiptarët e bindën pashain se kisha është e varfër, sepse igumeni para disa ditësh ka marrë të holla hua edhe nga ata për të mbetur gjallë. Kështu u largua pashai dhe kisha shpëtoi pa ndonjë të keqe. Pas një kohe igumeni shkoi në Bullgari e në Palestinë për të kërkuar ndihmë materiale për kishën, të cilën ua la në besë fshatarëve shqiptarë. Igumen Danilloja u kthye nga udhëtimi i i tij i gjatë pas një viti dhe falënderoi shqiptarët për kujdesin e tyre që e kishin ruajtur me përkushtim kishën derisa ajo ishte pa zot shtëpie.¹⁴

Gjatë Luftës së Parë Botërore, organet austriake e kanë internuar Bilall Rustemin, vëllanë më të madh të Salih Rustës, sepse si vojvodë i kishës së Deçanit, si patron i saj, ai dyshohej se është kundër pushtetit austriak në këto vise. Ndërkaq, gjatë sundimit të Jugosllavisë monarkiste, situata në Kosovë ka ndryshuar krejtësisht në dëm të shqiptarëve. Kisha ortodokse serbe në atë kohë, si gjithmonë, ka qenë në shërbim të politikës ekspansioniste antishqiptare të qeverisë së Beogradit. Sipas tregimit të Salih Rustës dhe të tjerëve, arkimandriti (kryepriifti) i kishës së Deçanit ka qenë njeri që merrej më shumë me politikë se me punët fetare. Madje në atë kohë u vra nga pusia e xhandarmërisë vojvoda i atëhershëm Bilall Rusta, ku ka pasur gisht edhe arkimandriti i kishës. Vrasja e tij ka pasur lidhje me zgjedhjet e atëhershme komunale e parlamentare. Shqiptarët përkrahnin Partinë demokratike opozitare, e cila premronte përmirësimin e gjendjes edhe për shqiptarët, kurse Partia Radikale në pushtet kishte qëndrim të kundërt. Bilall Rusta kishte autoritet në popull, prandaj si kundërshtar i partisë në pushtet, mund të ishte i dëmshëm, sepse kishte përkrahjen e elektoratit shqiptar. Arkimandriti ka qenë aktivist i flaktë në listën e partisë në pushtet, pra kundërshtar i Bilallit. Në atë kohë kisha s'ka pasur nevojë për ta ruajtur shqiptarët, prandaj vojvodët nuk gëzonin më simpatinë e saj, kështu që ata i mbante sa për sy e faqe, duke ua dhënë edhe ndonjë dekoratë ose ndonjë darkë me rastin e festave fetare.

¹⁴ Серафим Ристић, Дечански Споменици, Београд 1846, 49-52.

Mirëpo ky qëndrim i kishës serbe ortodokse u reflektua negativisht gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur situata ndryshoi në dëmin e Serbisë, e cila humbi luftën brenda një jave dhe ushtria gjermanë e italiane pushtuan Jugosllavinë, pra edhe Kosovën, e cila u bë pjesë e Shqipërisë. Në Kosovë qëndroi më gjatë ushtria italiane. Organet ushtarake italiane e morën në thumb vojvodën Salih Rrusta, sepse ai kishte dekoratën e Serbisë për meritën si vojvodë i kishës serbe. Sipas mendimit të organeve ushtarake, ai duhet të ishte i dyshimtë, sepse mund të ishte në anën e armikut të tyre. Kështu Salih Rrusta u largua nga Deçani më 1941 duke qëndruar disa muaj në bjeshkë për të mos rënë në dorë të italianëve. Salih Rrusta thoshte se kurrë nuk e kanë ruajtur e mbrojtur kishën e Deçanit për ndonjë fitim material, ose për ndonjë mirënjohje. Përkundrazi, nga kjo kanë pasur vetëm dëme të mëdha. Madje kanë humbur edhe jetën e tyre disa meshkuj të shtëpisë së tij, duke e mbrojtur këtë manastir, siç u pa edhe nga rastet që u përmendën më parë.

Kishën e Deçanit e kanë ruajtur shqiptarët, sepse në atë vend ka qenë kisha e vjetër katolike e të parëve të tyre dhe sepse tradita shqiptare respekton kishë e xhami si shtëpi të Perëndisë, si objekt sakral që meriton respekt. Përveç kësaj, ajo që është kryesore, gjeneratat e kaluara i kanë mbrojtur këto objekte në Kosovë, sepse kanë dhënë besën që do t'i ruajnë e mbrojnë në rast rrezikut. Vetë vojvoda plak, Salih Rrusta, thoshte: “E kemi ruajtur këtë hajrat (objekt i shenjtë), sepse të parët tanë kanë dhënë besën se do ta mbrojnë dhe besa shqiptare duhet të mbahet me çdo kusht.”

Fshatarët e Deçanit përsëri e morën në mbrojtje kishën, para së gjithash, vëllezërit Shaban e Mal Azemi, duke mos kërkuar as me këtë rast kurrfarë shpërblimi për këtë angazhim. Si rojtar e mbrojtës i kësaj kishe, Shabani është plagosur dy herë nga pusia e individëve që donin ta plaçkitnin ndonjë kafshë të kishës. Po për këtë arsye, vëllai i tij Mala u vra gjithashtu nga pusia më 13. IX. 1941, ndërsa pranë tij ndodhej igumeni i kishës Antonije. Shabani e mori gjakun e të vëllait qysh gjatë luftës. Mirëpo Komisioni për pajtimin e gjaqeve, atij ia dogji shtëpinë për shkeljen e sullit (vendimit) që ishte marrë në Kosovë që gjaqet duhet të pajtohen e jo të merren. Përveç kësaj Shabanin e burgosën. Pas lufte kisha e ndihmoi për të ndërtuar një shtëpi tjetër.¹⁵ Kështu, pra, edhe gjatë luftës së fundit, vetëm me këtë rast të vëllezërve Azemi, për shkak të sigurimit të kishës, u bënë dy vrasje e dy plagosje ndërmjet shqiptarëve, u dogj një shtëpi dhe u burgos një njeri.

¹⁵ Dëshmi e igumenit të Deçanit Antonije, tetor 1954.

Familja e Salih Rustës ka një dokument, një dëshmi të lëshuar nga kisha e Deçanit (Nr. 1005, më 17. IX. 1937), në të cilën, përveç tjerash shkruan:

- a) Shtëpia e Salih Rustës ka qenë gjithmonë shtëpi vojvodësh dhe e ka ruajtur kishën e Deçanit me armë në dorë, duke vënë edhe jetën në rrezik.
- b) Zgjedhjen e vojvodës e kanë vërtetuar edhe organet e pushtetit osman, valinjtë dhe vetë sulltani, e si të këtillë e kanë njohur organet e pushtetit malazias e serb. Vojvodët shpeshherë janë vrarë duke mbrojtur pasurinë e kishës nga grabitja dhe duke i mbrojtur serbët që vinin në manastir.
- c) Për këtë arsye, organet e pushtetit austriak e kanë internuar Bilall Rustën, vojvodën e atëhershëm, ndërsa familja e tij ka shpëtuar nga internimi duke ikur”.

Të gjithë ata autorë objektivë, të cilëve u ka interesuar problemi i mbrojtjes së kësaj kishe, shprehin mirënjohje ndaj vojvodëve të këtij manastiri, përkatësisht ndaj shqiptarëve të fshatrave të kësaj ane për arsye se kisha e Deçanit qëndron edhe sot në këmbë në saje të mbrojtjes që ia kanë bërë vëllazëritë e forta, fshatrat e fiset shqiptare, si edhe të sjelljeve të mira të disa kryemurgjve ndaj tyre në të kaluarën. Sikur të mos kishte qenë kjo, kisha e Deçanit do të ishte rrënuar.¹⁶ Këtë e dinë mirë vetë murgjit e manastirit. Prandaj me plot të drejtë arkimandriti i kishës së Deçanit, Leontije Ninković, shkruan: “Derisa në viset tona të tjera, turqit, të cilët sigurish kanë pasur kulturë më të lartë se shqiptarët, e pasardhësit e tyre edhe sot i konsiderojnë shqiptarët si njerëz gjysmë të egër, këta turq i kanë rrënuar shenjtoret tona dhe monumentet e tjera, ndërkaq shqiptarët i kanë ruajtur dhe kryesisht kanë ndihmuar që të ruhet monumenti ynë më i madh e më i bukur – kisha e Deçanit”.¹⁷

III

Patrikana (kisha) e Pejës gjithashtu ka shpëtuar pa u rrënuar gjatë shekujve plot trazira, në saje të padronëve nga Rugova. Ky regjion etnografik malor në Alpet Shqiptare, përmbi Pejë, ka 13 fshatra, të gjitha të fisit Kelmend. Të gjithë banorët e Rugovës dikur kanë qenë katolikë, kështu që familjet e fundi kanë kaluar në fenë muhamedane aty nga dhjetë vjetarët e fundit të sundimit turk në këto

¹⁶ Радомир Ивановић, Историјски часопис, Књ. IV, Београд 1954, 173.

¹⁷ Л. Нинковић, Братство лавре ..., 46.

visë. Mirëpo, edhe pas kësaj, rugovasi kanë vazhduar ta ruajnë kishën ortodokse të Pejës, ashtu siç e kanë ruajtur vojvodët atë të Deçanit.

Historiani i njohur serb Stojan Novaković, i cili ka qëndruar në Pejë më 1889, me atë rast ka shënuar edhe disa të dhëna për vojvodët e patrikanës së Pejës. Ai shkruan: “Shqiptarët e Rugovës e zgjedhin mes veti eprorin i cili duhet të kujdeset për sigurinë e patrikanës dhe ky ka titullin “vojvodë i kishës”. Atë ia paraqesin igumenit të manastirit dhe ai është i detyruar që ta pranojë atë që e kanë zgjedhur ata vetë.” Novaković shkruan se rugovasi e ruajnë këtë manastir vazhdimisht tash e 300 vjet. Në ditët e rrezikut gjithmonë përforcohej roja e manastirit. Kështu, gjatë luftës ndërmjet Serbisë e Perandorisë Osmane, më 1876-78, vazhdimisht kanë qenë rojë e manastirit 10 deri 15 rugova të armatosur. Një shembull që e ka shënuar ky historian serb tregon qartë se në ç’masë ka qenë patrikana nën mbrojtjen e rugovasve. Kështu, më 1889, disa serbë të pasur nga Peja, të cilët për raporte personale ishin kundër igumenit të atëhershëm Sofronije, megjithëse ky gëzonte simpati të madhe në Pejë e në rrethinën e saj, e akuzuan këtë te mitropoliti Milentije në Prizren dhe kërkuan që ky ta heqë igumenin e Pejës nga kjo pozitë, gjë që mitropoliti e bëri. Kur dëgjuan për këtë rast rugovasi shkuan menjëherë te mytesarifi i Pejës Halil-pashë Mahmutbegolli dhe kërkuan nga ai që ta marrë në mbrojtje igumen Sofroniun, përndryshe Rugova do ta mbrojë vetë ashtu siç e ka zakon, meqenëse igumeni është njeri i mirë e i ndershëm. Me këtë rast ata ia tërhoqën vërejtjen mytesarifit se 400 shtëpi të Rugovës janë gati për luftë, ashtu siç ka luftuar Deçani rreth manastirit. Pashai i thirri ata pasanikë serbë dhe i urdhëroi që menjëherë ta përmirësojnë gabimin e tyre, gjë që këtë e bënë pa folur fare. Kështu, në sajë të rugovasve, igumeni Sofronije u kthye përsëri në pozitën që e kishte më parë.¹⁸

Siç është shprehur edhe historiane Novaković, në gjysmën e dytë të shekullit XIX në Ballkan ka pasur trazira të mëdha. Në Kosovë këto kanë ngjarë sidomos për arsye të dëbimit të dhunshëm të shqiptarëve nga trojet e tyre shekullore nga Sanxhaku i Nishit (nga Toplica, Jabllanica etj., prej Prokuplës e deri në Nish) gjatë luftës serbo-turke më 1876-78, të vrasjeve masive, të djegies e plaçkitjes së shtëpive të tyre nga ushtria serbe. Historiani serb, Jovan Haxhi Vasilević shkruan se si në atë kohë Imer Agush-aga i fisit Berishë kishte mbledhur fisin e vet dhe kërkonte që, për shkak të vrasjeve dhe

¹⁸ Стојан Новаковић, Годишњица Николе Чупића, XI, Београд 1889, 292.

të dëbimit të dhunshëm të shqiptarëve nga Toplica, Jabllanica etj., të bëhet hakmarrja në serbët e Pejës. Vasileviqi, përveç tjerave, shkruan: “Kjo do të ngjante, sepse fisi Berishë është fis trim shqiptar, sikur të mos ta kundërshtonin këtë parësia e fiseve Gash e Krasniqe. Atëherë është caktuar Mehmet Zajmi, i pari i fisit më të fortë – Krasniqe, që me shqiptarët e vet të patrullojë nëpër mëhallën serbe në Pejë e në fshatrat e rrethinës për t’i mbrojtur serbët”.¹⁹

Duket se patrikana e Pejës ka pasur kushte më të volitshme sa i përket mbrojtjes së kisha e Deçanit, sepse pozita e saj gjeografike e bën të mundshme një mbrojtje më të sigurt. Kisha e Deçanit është larg fshatit më se 2 kilometra, e vetmuar midis pyllit, gjë që ka vështirësuar mbrojtjet dhe ka joshur sulmuesit. Ndërkaq, Patrikana e Pjesë është krejt afër qytetit dhe pushtetit, ku sigurimi publik është më i madh se në fshat, ndërsa në anën e kundërt të qytetit menjëherë fillon Rugova, nën patronazhin e së cilës ka qenë kjo kishë, duke qëndruar në manastir vazhdimisht një pjesëtar i familjes së vojvodës. Përveç kësaj, rugovasit janë të gjithë të një fisi dhe gjithmonë kompakt dhe të përgatitur për reagim të armatosur kundër çdo sulmi, pa marrë parasysh nga cila anë vjen ai. Kjo ka ndikuar në efikasitetin e mbrojtjes së kishës së Pejës.

Vojvodë i Patrikanës së Pejës ka qenë shtëpia e Zhuj Veselit (Zhuj Rugovës), nga vëllazëria Nikqi nga Shtupeli i Madh (Rugovë). Kjo familje është me origjinë të lashtë nga Malësia e Madhe (Shkodër). Të parët e saj janë vendosur në Rugovë para më se 300 vjetësh. Ata kanë qenë katolikë, por duket se islamizimin e kanë pranuar mjaft herët. Gjenealogjia e kësaj familje është kjo: Rama (i lindur më 1938) – Kapllani – Zhuji – Veseli – Muqa – Elezi – Rexha – Plaku, të gjithë të lindur në Rugovë. Ata i kanë kushërinjtë e tyre në Rekë të Allagës dhe në Shtupel të Madh në Rugovë, pastaj në disa fshatra të tjera në fushat e Dukagjinit. Këta kanë numër të madh të kushërinjve të tyre më të largët në Peshter (Sanxhak, rreth Tutinit, Sjenicës e Novi Pazarit), si, p.sh. në fshatin Ugëll (rreth 100 shtëpi) dhe quhen Plakiq (sipas të parit të tyre – Plaku, të cilin e përmendëm në gjenealogjinë e kësaj vëllazërie). Këta tash atje i takojnë vëllazërisë Vukli.

Nikqët i kanë kushërinjtë e tyre edhe në disa fshatra të Sanxhakut, p. sh. në Devreç, Leskovë (Vukli), ku ka edhe Shkrel, të cilët me

¹⁹ J. Хади-Васильевич, Покрет Арнаута за време српско-турских ратова 1876 и 1878, часопис "Ратник", Књ. 14, Београд 1905, 504.

shumicë jetojnë edhe në fshatin Borovshticë (rreth 60 shtëpi), në Nabo, në Megjugurë dhe në fshatra të tjera në mbarë rrafshnaltën e Peshterit. Kjo popullsi shqiptare është në fazën e fundit të procesit të asimilimit, kështu që tash rrallëkush flet gjuhën shqipe, por e dinë se janë Kelmendas dhe mbajnë disa tipare të traditës kombëtare shqiptare.

Sipas traditës, i pari i kësaj shtëpie është emëruar vojvodë i kishës ortodokse të Pejës nga vetë veziri i Shkodrës. Sipas rrëfimit të pleqve, kjo ka ngjarë kështu: rugovasit, si malësorë luftëtarë që janë, s'kanë lejuar që regjimi i okupatorit osman ta cenojë lirinë e maleve të tyre, jetën e tyre në bazë të normave të fisit dhe të zakoneve të vjetra të Kanunit të Lekë Dukagjinit. Për këtë arsye ata shpeshherë kanë luftuar kundër zaptive dhe ushtrisë turke. Njëherë veziri i Shkodrës i ka thirrur rugovasit që të merren vesh mes vete për mbrojtjen e kishës së Pejës, duke ua besuar patronatin mbi të. Me këtë rast rugovasit zgjodhën për vojvodë të kësaj kishe të parin e familjes të vojvodës së tashëm.



Patrikana e Pejës, vojvoda rugovas në mbrojtje të saj

Se sa me zell e kanë ruajtur rugovasit kishën e Pejës tregon vetë fakti që shtëpia e vojvodëve i ka humbur disa meshkuj duke e mbrojtur këtë kishë bashkë me rugovasit e tjerë. Kështu është vrarë mu në derë të manastirit Muq Elezi, nga familja e vojvodëve. Kryemurgu i atëhershëm e ka lagur dorën në gjakun e tij dhe e ka vënë shuplakën në mur pranë derës së oborrit të kishës. Kjo shenjë është ruajtur dhe është nderuar nga populli si totem disa dekada deri vonë, kur lumi i Bistricës ka vërshuar dhe ka rrënuar muret e oborrit. Djali i Muqës, Veseli, gjithashtu është vrarë pranë kësaj kishe nga njerëzit e mbrapshtë, të cilët donin të vjedhnin ndonjë kafshë të manastirit. Madje edhe djali i Veselit, Zhuji (të cilin murgjit e manastiri e quanin Sulo Vojvodi) është vrarë duke mbrojtur këtë kishë. Po këtë fat e kanë pasur edhe tre djemtë e tij: Beka, Asllani e Kapllani. Ky i fundit ka qenë i ati i vojvodës së fundit, Ramë Kapllani. Kështu, prej kësaj familje janë vrarë 6 meshkuj, pos rugovasve të tjerë, duke e mbrojtur kishën ortodokse të Pejës.

Shtëpia e vojvodëve të kishës së Pejës dikur ka qenë familje e madhe patriarkale. Në kohën e Muqës e të Veselit ajo ka pasur 53 pjesëtarë. Shumica e meshkujve të kësaj familjeje janë vrarë ose për gjak, ose duke mbrojtur kishën.



*Ramë Nikqi, vojvodë i Patrikanës së Pejës
(në Festivalin Ndërkombëtar të Folklorit
në Opati të Kroacisë, më 1951)*

Kështu, gjatë Luftës së Dytë Botërore, përkatësisht më 1941, mashkulli më i vjetër në tri familjet e ndara të vojvodëve ka qenë Ramë Kapllani njëmbëdhjetëvjeçar. Meqenëse në këtë kohë kisha kërkoi ndihmën e rugovasve, ata e kanë lënë Ramën në manastir si vojvodë dhe përfaqësues të Rugovës në atë vend. Ky, megjithëse ende fëmijë, ka qëndruar gjatë gjithë luftës i armatosur në manastir, duke u ndihmuar edhe familjeve serbe që ishin strehuar aty, të internuara nga italianët. Për këtë arsye italianët e kanë lidhur këtë djalë me litar për bli në oborr të kishës dhe kështu e kanë mbajtur dy ditë. Gjatë luftës nuk e ka

sulmuar kishën askush, sepse dihej se do të çohet e gjithë Rugova për ta mbrojtur.

Megjithatë, më 1942 disa eksponentë politikë, së bashku me italianët, përgatiteshin që në mënyrë të organizuar ta sulmojnë kishën. Porsa dëgjuan rugovast për këtë komplot, ata dërguan te prefekti i Pejës një delegacion, i cili këtij ia shpjegoi se Rugova shekuj me radhë e ka ruajtur këtë kishë dhe se do të ishte fyerje e madhe për të nëse e sulmon tash dikush e rugovast të rrinë duarkryq. Kështu, nëse ngjanë një gjë e tillë, ata të gjithë së bashku do ta mbronin siç e kanë mbrojtur gjithmonë. Pas kësaj askush nuk e merrte mbi vete përgjegjësinë për pasojat që do t'i kishte sulmi eventual kundër kishës. Mirëpo rugovast, të armatosur, qëndruan dy ditë në manastir, pastaj u kthyen në malet e veta, duke lënë aty një roje më të fortë.²⁰

Edhe vojvodët e kishës së Pejës kanë pasur dokumente të shkruara, certifikata, lëvdata e dekorata nga autoritetet e kësaj kishe, ose nga organet e atëhershme të pushtetit të Serbisë e të Malit të Zi për shërbimet e mëdha që ia kanë bërë kësaj kishe. Kështu, Vesel Muqa është dekoruar nga kral Nikolla i Malit të Zi me “Urdhrin e Danillos” të kl. I, ndërsa djali i tij, Sylja, (i quajtur nga “popët” Sulo Vojvodiq, siç e thamë më parë) është dekoruar me “Urdhrin e Sveti Savës”.²¹

IV

Kisha e Deviçit në Drenicë gjithashtu ka pasur vojvodët e vet. Mbahet mend nga pleqtë, se dikur në kohën e Perandorisë Osmane, vojvodë i kësaj kishe ka qenë Behram Vojvoda. Tani (më 1955) në fshatin Llaushë, afër Skënderajt, në këtë rreth gjenden 15 shtëpi të kësaj vëllazërie të cilat kanë mbiemrin e përbashkët Vojvodë. Të gjitha këto familje rrjedhin nga familja e vjetër e Vojvodëve të Deviçit, e cila gjatë kohës është rritur dhe është ndarë. Këto familje janë të fisit Gash.

Sipas tregimit të Avdyl Vojvodës, plak 70-vjeçar (më 1955), qysh moti e deri më 1912 kishën e Deviçit e kanë ruajtur nga një ose dy meshkuj të shtëpisë së Vojvodëve. Prej vitit 1913 deri më 1915 kisha s’ka pasur nevojë të ruhet, sepse rrethanat politike kanë qenë në favor të serbëve, kurse për shqiptarët, siç dihet, situata ka qenë tepër e

²⁰ Sipas tregimit të igumenit (kryemurgut) të Patrikanës së Pejës, Tadeja Shtërbulloviq, Pejë, shtator 1955.

²¹ “Политика”. 21. IX. 1935.

rëndë. Mirëpo kah fundi i vitit 1915 deri në fund të vitit 1918, situata ka ndryshuar në favor të shqiptarëve dhe në dëm të serbëve. Në këtë kohë kisha e Deviçit kërkonte mbrojtjen e vojvodëve dhe të Drenicës në përgjithësi. Fqinjët e kishës mbajnë mend disa emra të vojvodëve, siç kanë qenë Avdyl Vojvoda, babai i tij Halimi, gjyshi Ajeti, stërgjyshi Behrami etj. Gjatë Luftës së Dytë Botërore kisha e Deviçit nuk ka pasur vojvodë.²²

Në kishën e Deçanit, të Pejës dhe të Deviçit, vojvodët kanë pasur dhomën e posaçme në konaqet (ndërtesat) e kishës, siç u tha më parë. Mirëpo ata e ruanin manastirin ditë e natë dhe si shpërblim kisha u jepte një ndihmë të vogël, zakonisht rreth 60 grosh në muaj (1 dukat), nëse ruanin dy vetë merrnin nga 40 grosh. Këta nuk punonin asgjë në shtëpi të tyre, prandaj ky ishte kontributi ekonomik për familje.

Ka pasur raste kur edhe serbët e kanë sulmuar kishën e tyre për ta plaçkitur, siç ka qenë rasti i kishës së Deviçit. Vojvodët shqiptarë kanë intervenuar për ta mbrojtur këtë kishë edhe nga besimtarët e saj. Kështu, nga fillimi i shekullit XX, serbët e fshatit Kijevë (regjioni i Llapushës) e sulmuan kishën e Deviçit për ta plaçkitur pasurinë e saj. Shqiptarët kanë dalë për ta mbrojtur kishën nga këta serbë. Në përlëshje të armatosur janë vra 2 shqiptarë (Sejdija e Delija) dhe kushëriri i tyre Ajeti është plagosur në dorë. Më vonë Vojvodët e marrin gjakun duke vrarë disa serbë të bandës që e sulmuan kishën.

Kur shkonin murgjit “për regjistrim të besimtarëve”, këta i shoqëronin rojtarët shqiptarë të kishës, duke lënë një roje për ta ruajtur kishën. Vojvodët e Deviçit kanë qenë çifçi të kësaj kishe, e cila merrte të katërtën e prodhimeve bujqësore, por nga viti 1936 ajo merrte gjysmën e prodhimit. Rojtarët e kishës së Deçanit dhe ata të kishës së Pejës duket se s’kanë kërkuar ndonjë kompensim material, por janë kënaqur nëse kanë marrë ndonjë falënderim, mirënjohje ose dekoratë.

Kisha e Deviçit nuk mund të krahasohet, si u tha edhe më parë, nga asnjë aspekt me atë të Deçanit dhe të Pejës. Kjo është një ndërtesë e vogël pa ndonjë vlerë arkitektonike e pa ndonjë rëndësi të posaçme historike. Edhe sa i përket mbrojtjes së saj, kjo s’ka pasur atë fat si këto dy kishat e tjera. Megjithëse edhe në mbrojtjen e këtij manastiri kanë dhanë jetën disa rojtarë të tij, ka pasur mosmarrëveshje edhe ndërmjet popullsisë së rrethit në lidhje me zgjedhjen e vojvodëve, kryesisht ndërmjet fiseve Gash e Berishë. Megjithëse fshatarët e

²² Tregimi i Avdyl Vojvodës dhe i disa fshatarëve të tjerë, shtator 1955.

Drenicës e kanë ruajtur dhe e kanë mbrojtur qysh me kohë këtë kishë, ajo gjatë luftërave ballkanike, gjatë Luftës së Parë Botërore dhe sidomos gjatë sundimit të Jugosllavisë monarkiste, e ka humbur kuptimin e një objekti sakral, një shenjtoreje, sepse ka shërbyer më tepër si qendër e policisë dhe e administratës shtetërore, madje edhe si burg ku torturoheshin shqiptarët nga organet e pushtetit antishqiptar të Serbisë. Pra, kjo kishë si e tillë e ka humbur respektin e popullsisë shqiptare, e cila tradicionalisht ka respekt ndaj vendeve të kultit.

Gjatë Luftës së Parë Botërore në kishë ka qëndruar një kompani ushtarësh dhe xhandarësh austriakë, kurse në kohën e Jugosllavisë ky manastir për një kohë u shndërrua në seli të “naçallnikut” (nënprefektit) të rrethit, pastaj në stacion të xhandarmërisë dhe në burg për shqiptarët.* Edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore kishën e Deviçit e ka shfrytëzuar ushtria italiane si kazermë për një repart ushtarak. Ushtarët, sipas tregimit të fshatarëve, kanë prerë pyllin e kishës dhe kanë ndezur zjarrin midis saj për t’u ngrohur dhe për të zier ushqimin. Madje një natë e kanë lënë zjarrin ndezur dhe janë larguar. Zjarri gjatë natës është përhapur dhe është djegur kisha. Pas luftës manastirin e rindërtoi Serbia, duke i dhënë pamje të re, kështu që manastiri i vjetër nuk ekziston më në formën që e ka pasur në fillim.



Kisha e Deviçit (ndërtim i ri)



Avdyl Vojvoda nga Llausha (Drenicë)

Fshatarët e Llaushës tregojnë se më 1998-1999, gjatë gjenocidit të ushtrisë serbe ndaj popullsisë civile shqiptare të Kosovës, kisha ortodokse serbe e Deviçit afër Llaushës ishte shndërruar në burg ushtarak, ku janë torturuar civilët shqiptarë në mënyrë më të egër shtazarake. Fshatarët e Llaushës deklarorin: “Nuk po mërzhitemi për shtëpitë e djegura, por pa na prekin në shpirt britmat e njerëzve që po dëgjohen në kishën e Deviçit.....Kjo kishë ka qenë gjithmonë famkeqe për fatin e shqiptarëve të këtyre anëve.... Edhe në kohën e Rankoviçit kjo kishë është shndërruar në kasaphane për vrasjen e torturimin e shqiptarëve. Policia serbe i detyronin romët t’u binin tupanëve për të mos u dëgjuar britmat e njerëzve kur torturoheshin. Në këto aksione gjenocidi merrnin pjesë aktive edhe shumë kolonistë serbë e malazezë, uzurpatorë të trojeve shqiptare”.²³

Si duket, vojvodët e manastireve (rojtaret e kishës) janë një dukuri, një institucion i llojit të vet që paraqitet vetëm në Rrafshin e Dukagjinit dhe në Drenicë, të paktën në një formë të këtillë. Rojtarë të kishave mund të ketë pasur edhe në vise të tjera, por ata s’kanë pasur titullin vojvodë dhe mbrojtjen e organizuar më të gjerë në raste të caktuara. Në viset veriore të Shqipërisë dhe në Mal të Zi, me organizim të jetës shoqërore në baza të normave të traditës së lashtë popullore s’ka pasur nevojë të formohet institucioni i vojvodëve të kishave, sepse ato kanë gëzuar mbrojtjen e fshatit e të fisit. Fisi garantonte sigurinë personale e të pasurisë në territorin e vet, kurse objektet sakrale kanë qenë të mbrojtura edhe me Kanun dhe me respektin e posaçëm tradicional ndaj tyre. Këtë mbrojtje kisha, xhamia, varrezat dhe “hajratet” e tjera e gëzonin në territorin e caktuar edhe nëse kleriku nuk ishte i fisit të popullsisë së vendit. Në Kosovë, në përgjithësi, organizimi fisnor nuk ekziston si në vendet e përmendura më sipër, sepse fshatrat përbëhen nga pjesëtarë të fiseve të ndryshme, përveç Rugovës, ku 13 fshatrat e saj janë kelmendas. Fisi në Kosovë s’ka territor të vetin, prandaj as mbrojtja e tij nuk ka pasur efektin si në Malësi, ose në Mal të Zi. Përveç kësaj, në kohën e sundimit të Perandorisë Osmane në këto anë ka pasur turbullira dhe beteja të shpeshta kundër pushtetit turk për arsye të sanksioneve antipopullore, antishqiptare që i zbatonte ky pushtet i okupatorit aziatik. Këtë situatë e shfrytëzonin individët e papërgjegjshëm për interesa personale, përkatësisht për vjedhje e plaçkitje kryesisht të kafshëve, madje edhe nëse ato ishin pronë e institucioneve fetare.

²³ Maxhun Smajli, *Lufta dhe dilemat shqiptare*, Klinë, 2002, f. 2008.

Nga ana tjetër, patriku i Pejës ka arritur që me ryshfet dhe dhurata të shumta të marrë nga sulltani autorizime për të qeverisur të gjithë të krishterët në Kosovë, në Mal të Zi e në Maqedoni, pa marrë parasysh a janë ortodoksë apo katolikë, për të mbledhur taksa të ndryshme të kishës ortodokse. Në librin e historianit serb Jovan Radoniq ka shumë të dhëna për terrorin e kishës ortodokse serbe ndaj shqiptarëve katolikë të këtyre viseve, të cilët kanë qenë të shtrënguar me dhunë që të kalojnë në fenë ortodokse, përkatësisht në kombësinë sllave, nëse duan të shpëtojnë nga taksat shumë të rënda të imponuara nga patriku i Pejës.²⁴

Të gjitha këto fakte kanë krijuar rrethana të papërshtatshme për angazhimin e shqiptarëve që t'i mbrojnë kishat ortodokse serbe në këto vise, kur atyre u kërcënohej rreziku. Megjithatë, ky angazhim ka qenë aq i madh, sa që një rast të tillë nuk e kemi njohur në asnjë vend tjetër në Ballkan, të paktën në formën e rojtarëve-vojvodë të fesë e të kombësisë tjetër nga ajo së cilës u takonin këto kisha. Për të vërtetuar këtë anakronizëm, po përmendim edhe faktin e njohur se gjatë luftërave ballkanike, më 1913 ushtria dhe xhandarmëria malazeze kanë bërë masakrime të tmerrshme në popullin shqiptar në Rrafshin e Dukagjinit.

Ka pasur edhe raste të tjera kur shqiptarët i kanë ruajtur e mbrojtur kishat ortodokse serbe, sipas traditës brez pas brezi, shekuj me radhë. Për këtë fakt ka mjaft shembuj nga literatura, por edhe më shumë nga terreni. Këtu, sa për ilustrim, po shënojmë vetëm disa nga këta. Kështu p. sh., në Sanxhak (rrethinat e Senicës, Tutinit, Novi Pazarit etj.), sipas të dhënave të etnografit serb, profesor Petar Zh. Petroviqit, shqiptarët e atjeshëm i kanë ruajtur gjatë kohë disa kisha ortodokse serbe. Kishën e njohur mesjetare Sopoqan, pranë burimit të lumit Rashkë, e kanë ruajtur shqiptarët e vëllazërisë Noki (Ndokaj) nga fshati Tvërdosheci i Poshtëm. Familja e Ahmet Hoxhiqit (Hoxhaj) e ka ruajtur një kishë-shpellë ortodokse, përkatësisht shpellë e shndërruar dhe e pikturuar si kishë, pranë fshatit Palevë. Elez Eleskoviqi (Elezaj) dhe Avdyl Beriqi (Beraj), që të dy nga fshati Ribariq, e kanë ruajtur gjithashtu kishën-shpellë të Sh. Pjetrit në Cërna Rekë (Kollashini i Ibrit). Ky shkencëtar serb, Petar Zh. Petroviq, në shënimet e tij shton se “të gjithë këta shqiptarë i kanë ruajtur këto kisha pa kurrfarë kompensimi material”.²⁵

²⁴ Јован Радонић, Римска курија и јужнословенске земље од XVI до XIX века, Београд, 1950, 473-476, 511-512.

²⁵ Petar Zh. Petroviq, Kërkime shkencore në Sanxhak e në Rashkë më 1930.

Për popullsinë shqiptare të Sanxhakut të Novi Pazarit ka të dhëna të rëndësishme në veprën e konsullit rus, Gilferding, nga gjysma e shekullit XIX. Kjo popullsi shqiptare gjatë kohës e ka humbur gjuhën amtare shqipe dhe është asimiluar në kombësinë “boshnjake”, por ka ruajtur shumë tradita dhe karakteristika të tjera kombëtare shqiptare ²⁶, ndër të cilat edhe botëkuptimet ndaj nderit e burrërisë, që kanë ardhur në shprehje edhe me ruajtjen e kishave në këtë trevë. Asimilimi i shqiptarëve në Peshter dhe në përgjithësi në Sanxhakun e Novi Pazarit, është bërë me dhunë të pushtetit dhe kishës serbe, por edhe me martesat e tyre me boshnjake të Bosnjës.

Familja e njohur e Boletinëve në rrethin e Mitrovicës, ka ruajtur e mbrojtur kishën e Sokolicës afër Mitrovicës dhe një kishë tjetër në fshatin Vraç ²⁷. Në rrethinat e Prizrenit ka pasur disa raste të tilla. Kështu, më 1890 shqiptarët nga fshati Zoqishtë kanë plagosur një bashkatdhetar të tyre nga fshati Pagarushë, duke mbrojtur mallin e kishës e “popin” nga sulmet e tij. Me rastin e pajtimit të këtij gjaku, ata janë mbrojtur duke thënë se nuk e ndiejnë vetën fajtorë, sepse këtë e kanë bërë duke mbrojtur kishën dhe famullitarin e saj. ²⁸

Në kronikën e kishës së Sh. Markut afër fshatit Korishë në Podgurin e Prizrenit, është shënuar edhe ky konstatim: “U dogjën kthinat, u dogj libri i “ligjdhënësit”, edhe kishat do të digjeshin sikur të mos vraponin shqiptarët, të cilët e fikën zjarrin”. ²⁹

Në një punim për kultin ndaj Stevan Nemanjiqit (i quajtur edhe shënjt i Stevan Deçanski), vihet në dukje se ky kult “është i përhapur shumë edhe ndër shqiptarët në Dukagjin. Në saje të këtij kulti, kisha e Deçanit është ruajtur gjatë robërisë pesëshekullore. Sipas studiuesit Vukanoviq “Shqiptarët e Dukagjinit kanë shumë merita për këtë manastir gjatë pesë shekujsh robërie nën turq” ³⁰. Mirëpo ky autor këtu është i njëanshëm dhe duket se nuk i ka njohur mirë psikologjinë dhe traditat e shqiptarëve të këtyre anëve. Ata s’kanë çarë kokën për kultin e Stevan Deçanskit, madje as emrin s’ia kanë dëgjuar këtij dinasti mesjetar serb, të cilin kisha serbe ortodokse e ka shpallur shënjt. Madje shqiptarët e fshatrave rreth këtij manastiri janë të besimit

²⁶ Александар Ф.Гильфердинг, Путovanje по Херцеговини, Босни и Старој Србији, Сарајево, 1972.

²⁷ Të dhënat nga terreni të gjeografit Radoslav Pavloviq, më 1939.

²⁸ Петар Костић, Црквени живот..., 55

²⁹ Панта Срећковић, Синан Паша, Београд, 1865, 3-4.

³⁰ Т. Вукановић, О култу Стевана Дечанског у Метохији, “Хришћанско дело” III, 5, Скопје 1937, 381.

mysliman, siç është shumica dërmuese e shqiptarëve të Kosovës, të cilët i respektojnë vetëm pejgamberët e shënjtoret e fesë së vet e jo dinastët serbë antishqiptarë, të cilët kisha serbe ortodokse i ka bërë “shënjtër”. Për ruajtjen e mbrojtjen shekullore të kishave ortodokse në Kosovë, pra edhe për kishën e Deçanit, kanë meritë vetëm shqiptarët, e jo asnjë shënjt, asnjë fuqi tjetër, as qiellore e as tokësore.

Tradita e ruajtjes së kishave nga popullsia shqiptare është mjaft e lashtë. Kështu, nga një krisobulë (dokument) e Stefan Dushanit të shekullit XIV lëshuar manastirit Shenjtorëve Mëhill e Gabriel, afër Prizrenit, shihet se disa fshatra kanë qenë të obliguara ta ruajnë këtë kishë dhe ta përcjellin igumenin (kryemurgun) kur ai të shkojë në rrugë zyrtare.³¹ Ashtu siç kanë qenë të ngarkuara fshatrat e tjera me detyrime të ndryshme, kështu edhe ato përreth kësaj kishe kanë pasur këtë detyrë të veçantë, por s’kanë qenë vojvodë të cilët askush nuk i ka detyruar të jenë mbrojtës të kishave ortodokse, përveç morali i traditës shqiptare.

Fjala është për Kanunin e Lekë Dukagjinit, me të cilin rregullohen marrëdhëniet brenda familjes, fshatit, fisit e bajrakut. Në kohën e Stefan Dushanit mbrojtja e kishave ka qenë urdhër dhe obligim zyrtar i disa fshatrave për të ruajtur kishat në afërsi të tyre, ndërkaq ndër fiset shqiptare ky ka qenë obligim i përgjithshëm. Kanuni ia vente për detyrë çdo familjeje, çdo fshati, fisi e bajraku që të kujdesen për sigurinë e kishës, të pasurisë së saj dhe të famullitarit (klerikut). Të gjitha këto në Kanun janë përcaktuar shumë qartë.

Në Kanun thuhet: “Kisha shpatë e konop s’ka”. Kjo do të thotë se kisha s’ka me çka të mbrohet, as nuk është në moralin e saj që të mbrohet në këtë mënyrë, që të përdorë dhunën. Kanuni thotë: “Kush e dhunon kishën, dhunon famullinë. Nderën e kishës e lyp famullia”. Kanuni përcakton dënime të rënda për ata që i thyjnë këto norma të tij: “Kush e thyen kishën, asht i djegur e i pjekun e i qitun me rob e robi jashtë Bajrakut. Fajtori, - dorasi, bahet batore prej Bajrakut e shkon gjakhupës. Vllaznija, a fisi ma i afërmi i bakeqit e blenë tokën e tij, e çmimi i saj i shkon kishës së thyeme”.³² Po në këtë mënyrë Kanuni mbron famullitarin e pasurinë e tij.

Pra, as në krisobulën e Stefan Dushanit, as në Kanunin e Lekë Dukagjinit nuk përmendet institucioni “vojvodë i kishës”, i cili ka hyrë më vonë në fuqi si vendim i popullit, si mënyrë më e

³¹ Гласник Српског ученог друштва, Књ. XV, Београд 1826, 300, 305

³² Shtjefën Konstantin Gjeçovi, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shkodër 1933, 2- 6.

përshtatshme për të mbrojtur kishat. Më parë pushteti i shtetit dhe i fisit ka marrë vendim për këtë qëllim, më vonë populli shqiptar ka vendosur vetë për krijimin e institucionit të vojvodëve të kishave, të cilët i ka zgjedhur vetë dhe i ka përkrahur në rast nevojë.

Në Kosovë, megjithëse nuk ka ekzistuar një organizim fisnor më i fortë, prapë normat e Kanunit të Lekës kanë pasur ndikim të madh në marrëdhëniet reciproke në popullsi, kështu që fryma e tij edhe sot shprehet, sidomos në raste të pajtimit të gjaqeve dhe të zgjidhjes së disa ngatërresave të tjera. Kanuni ka ndikuar edhe në marrjen në mbrojtje të kishave të kësaj anë, sidomos në Dukagjin e në Drenicë.

Duke shpjeguar se pse shqiptarët e kanë ruajtur kishën e Deçanit, arkimandriti i saj, Leontije Ninković, përveç tjerash, shkruan: “Megjithëse shqiptarët nuk janë të arsimuar, ata nuk janë pa veti që nuk meritojnë të respektohen. Ata janë popull primitiv, të edukuar në frymën e traditave të tyre”.³³ Përveç kësaj, siç e kanë vërejtur edhe autorë të ndryshëm të huaj, të parët e vojvodëve të kishës sigurisht kanë marrë obligim publikisht, kanë dhënë besën se, me ndihmën e fisit, do ta ruajnë kishën. Shkelja e besës, e fjalës së nderit, për shqiptarët është turp i madh. Për këtë arsye ata i kanë ruajtur me aq zell këto kisha dhe kanë bërë vdekjen në mbrojtjen e tyre. Mandej, të jesh padron i një shënjtoreje (kisha a xhamie), do të thotë të jesh i nderuar e i respektuar në popull. Vojvodën të gjithë e kanë nderuar³⁴, prandaj disa herë ka pasur ngatërresa ndërmjet fshatrave dhe fiseve të ndryshme në Kosovë me rastin e zgjedhjes së vojvodës, sepse të gjithë dëshironin ta merrnin këtë titull. Kjo është paraqitur edhe në një tregim të një autori serb, në të cilin flitet për vojvodën e kishës së Deçanit, Bilall Rustën, ku, ndër të tjera, thuhet: “Ky është vojvodë i kishës së Deçanit, gjë që e ka trashëguar nga babai i tij me të gjitha nderimet e të gjitha brengat të lidhura me këtë detyrë. Është krenar ky për këtë. Kjo këtij ia siguron respektin në shoqëri, kështu që detyrën e rojtarit të Kralit të Shenjtë nuk do ta ndërronte as me vendin e kajmekamit të Gjakovës, jo se jo të bajraktarit në Rekë e në Malësi. Me shumë gjak ai e ka futur në gji diplomën e vojvodës. Shumë vojvodë, të partë e tij, kanë lënë kokën për t’ia siguruar familjes së vet këtë të drejtë të pacenueshme....Ai është vojvodë me ferman, dhe i duket se as igumeni nuk e do kishën e Deçanit ashtu siç e do ai

³³ Л. Нинковић, Братство лавре..., 46-47.

³⁴ И. С. Јастребов, Стара Србија и Арбанија. Споменик Српске академије наука, Споменик Књ. XLI, Београд 1904, 267, 209.

vetë”.³⁵ Megjithatë, në kohën e Jugosllavisë së kralit, siç u tha më parë, edhe vojvoda i kishës, Bilall Rusta, humbi kokën nga një pusi e xhandarëve serbë në lidhje me zgjedhjet e atëhershme parlamentare e vendore, kur ky vojvodë përkrahte partinë demokrate, që ishte në opozitë, kundër partisë radikale, e cila ishte në pushtet dhe kishte përkrahje të madhe nga igumeni i kishës së Deçanit.

Një nga arsyet e tjera që kanë ndikuar në popullsinë shqiptare të këtyre viseve për t’i mbrojtur kishat edhe në mënyrë të organizuar, ka qenë edhe bindja tradicionale se duhet të respektohen e të përkrahen vendet e kultit, vendet e shenjta, pa marrë parasysh së cilës fe i takojnë. Nën ndikimin e legjendave të ndryshme mbi fuqitë e krijesat mbinjerëzore të disa kishave e shenjtoreve e shtytur kështu nga bestytnitë e shumta, ka pasur raste që popullsia patriarkale ka kërkuar “ndihmë mjekësore” për shërimin e sëmundjeve të ndryshme në kohën kur në këto anë s’kishte as mjek, as barnatore. Popët, por edhe kleri i feve të tjera në përgjithësi kanë ditur ta shfrytëzojnë e të ngacmojnë në mënyra të ndryshme bindjen e masave të gjera popullore në këto bestytini.

Pranë manastirit të Deçanit është një burim i vogël i ujit të thartë (mineral), për të cilin shumëkush beson se ka fuqi shëruese. Megjithëse ky burim është shumë i ftohtë, disa njerëz e përdornin edhe për të shëruar reumatizmin. Përveç kësaj, në këtë kishë është arka (arkivoli) e Stefan Nemanjiqit, e ngritur në katër shtylla, nën të cilën përbiroheshin (kalonin) gratë e reja për të pasur fëmijë, me bindje se në këtë mënyrë do të plotësohet dëshira e tyre. Murgjit e rinj e përhapnin edhe këtë bestytini. Qysh në fillim e cekëm bestytninë e popave në lidhje me skulpturat e mermerit të luanëve mbi portalin e kësaj kisha, të cilët qenkan ngjallur njëherë dhe e paskan mbrojtur kishën nga sulmuesit. Të gjitha këto dikur kanë bërë efektin e vet në psikologjinë e një ambienti, të cilin kushtet historiko-shoqërore gjatë shekujve e kanë lënë prapa dhe e kanë ngarkuar me bestytini e paragjykime të ndryshme.

Besohej se edhe kisha e Deviçit ka pasur fuqi shëruese, sidomos në lidhje me sëmundjet psikike. Të sëmurët e tillë murgjit i lidhnin për një dardhe në oborrin e kishës dhe përdornin dajakun me të cilin “e shëronin” pacientin e gjorë. Edhe sot serbët e përdorin një nëmë origjinale - “Të lidhshin për dardhën e Deviçit!”, por gjithashtu edhe “Të lidhshin për dardhën e shënjtit Janiçije!”. Ky shënjt qenka padron i kësaj kisha, kurse kjo nëmë i drejtohej në raste hidhërimi ndaj njeriut i cili me sjelljet e veta të këqija meritonte këtë “shërim” të

³⁵ Григорије Божовић, Приповетке, Српска књижевна задруга, Београд 1926, 56-61.

çuditshëm.³⁶ Shqiptarët s'kanë pasur nevojë për terapinë e dardhës së shënjtit Janiçije, sepse një "terapi" të ngjashme ua jepte shpeshherë xhandarmëria kriminale serbe, madje edhe mu në kishën e Deviçit, e cila, siç e cekëm më parë, një kohë u shfrytëzua si burg famkeq për shqiptarët, ndonëse këta e kanë ruajtur shekuj me radhë.

Përveç legendave të tjera, besohej se kur ka shkuar veziri Quprili për ta rrënuar kishën e Deviçit, rrugës në fshatin Llundovik e gjithë ushtria iu ka çmendur. Vetëm në saje të lutjeve të kallogjerëve (popave), ushtria e tij u shërua, kështu që shpëtoi kjo kishë. Madje në shenjë mirënjohjeje veziri ndërtoi edhe një kishë pranë saj dhe fshatin e pagëzuan me këtë emër, që do të thotë "i çmendur". Motivi i kësaj legjende ka hyrë edhe në poezinë popullore serbe³⁷, si shumë legjenda të tjera, sidomos për Kosovën. Historianët dhe kisha serbe, në vazhdimësi, madje edhe sot, i përdorin legjendat dhe mitologjinë mesjetare si "argument shkencor historik" për ta përvetësuar Kosovën, këtë trevë shqiptare dhe shumë treva të tilla të tjera në ish-Sanxhakun e Nishit, në Toplicë, në Luginën e Preshevës etj.

Legjendat e këtij lloji në lidhje me vendet dhe objektet e kultit janë trilluar me qëllime të caktuara jo vetëm këtu në Kosovë, po kudo, me qëllim që kështu të futet frika e kështu edhe respekti ndaj tyre, që t'i ruajnë dhe t'i ndihmojnë materialisht. Legjendat e tilla kanë zgjuar edhe te vojvodët njëfarë krenarie që ata janë padronë të objekteve të shenjta, të cilat janë në gjendje të bëjnë mrekullira dhe çudira të ndryshme.

Edhe mikpritja e manastireve ka ndikuar pozitivisht në mbrojtjen e tyre nga ana e popullsisë shqiptare, e cila mikpritjen e çmon dhe e praktikon më shumë e më mirë se çdo popull tjetër në Evropë. Ndër shqiptarët kjo është traditë e lashtë e tyre, e cila edhe sot çmohet, por praktikimi i saj ka pësuar ndryshime të cilat i ka imponuar koha, kushtet e jetës bashkëkohore. Edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit thuhet se shtëpia mikpritëse duhet të nderohet. Mirëpo, manastiret ua hapnin dyert mikpritëse vetëm njerëzve të autoritetit dhe të pushtetit, nga të cilët mund të pritnin përkrahje, kurse mikpritja shqiptare i ka dyert e hapura për të ftuar e të paftuar, të njohur e të panjohur fare, pa kurrfarë dallimi fetar, kombëtar e social.³⁸

³⁶ М. Ристић, Србија у слици и речи, Београд 1927, 543-544.

³⁷ В. С. Караџић – Српске народне пјесме. Књ. VI, Београд 1899, 151-156.

³⁸ Mark Krasniqi, Mikpritja në traditën shqiptare, botim i Akademisë së Shkencave e Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2005.

Përveç kësaj disa kisha u jepnin vojvodëve ndonjë shpërblim material, dhurata, mirënjohje, dhomën, ushqimin etj., që nuk ishin kusht i domosdoshëm për angazhimin e tyre. Ana materiale s'ka luajtur atë rol në ruajtjen e kishave, në krahasim me motivet tjera të cilat i përmendëm disa herë. Eventualisht ka qenë i shpërblyer në këtë mënyrë vetëm një njeri – vojvoda i përhershëm, i cili e kalonte kohën në manastir e jo në punët obligative në shtëpinë dhe në fushën e tij. Ndërkaq, kishën e ruanin bashkëfshatarët e tij, madje edhe katundet dhe fisi në rast të nevojës, pa kurrfarë kompensimi, dhe pse, siç e thamë, mbrojtja e kishave këtyre u ka kushtuar shumë shtrenjtë.

Pra, rojtaret, përkatësisht vojvodët e kishës, kanë qenë shprehje e kushteve të veçanta që kanë mbretëruar me shekuj në Kosovë. Shprehje e traditës pozitive shqiptare, e botëkuptimeve dhe e psikologjisë së një ambientit etnik patriarkal me shumë paragjykime, bestytni e nivel të ultë kulturor të kohës, por me moral shumë të lartë, në të cilin dominojnë virtytet kryesore të traditës shqiptare, ndër të cilat zënë vendin kryesor: besa, nderi, mikpritja, burrëria, toleranca, trimëria etj. Në saje të këtyre virtyteve të larta të fshatarëve të thjeshtë shqiptarë, shpëtuan nga stuhia e shekujve këto monumente të lashta të kulturës, të artit dhe të së kaluarës historike. Këto janë njëkohësisht monumente të tolerancës fetare e kombëtare të shqiptarëve të këtyre viseve dhe në përgjithësi në trojet etnike shqiptare në këto treva të Evropës Juglindore.

*

SHTOJCË - 2013

Këtu duhet të shtohet edhe fakti se këto kisha e manastire kryesore në Kosovë, në Mal të Zi dhe në Maqedoni janë ndërtuar në kohën kur Bizanti ka sunduar edhe në këto vise, kur dhe ku serbët ende nuk kishin mbërritur. Me ardhjen e tyre, serbët i kanë uzurpuar ato, madje disa nga këto kanë qenë kisha katolike. Uzurpimin e tyre e ka kundërshtuar edhe papa i Romës, siç shihet edhe në librin e historianit serb Jovan Radoniq, të cilin e përmendëm, sidomos nga teza e doktoratës së klerikut katolik shqiptar, **Dom Gaspër Gjini**,³⁹ në të cilën, përveç tjerash, shkruan: “Papa Klementi V i ka dërguar letër

³⁹ Gaspër Gjini, Skopsko-Prizrenska Biskupija kroz stoljeća, Zagreb, 1986, 91.

kral Millutinit (Nemanjiq), duke kërkuar që t'i lirojë kishat latine (katolike) të cilat i ka okupuar ai, ose të tjerët". Papa Klimenti VI i ka shkruar më 1346 Stefan Dushanit se kishat katolike në Novobërdë, Janjevë, Prizren etj. janë nën juridiksionin e ipeshkvit të Kotorrit "të cilat i kanë okupuar mbretërit e mëparshëm dhe tash i mban të okupuara edhe ai vetë", prandaj Papa kërkon lirimin e tyre. Në dokumentet arkivore të Vatikanit të vitit 1435 shkruan se despotët serbë kanë uzurpuar shumë kisha katolike. Këtë politikë antishqiptare e kanë zbatuar edhe në Kosovë despotët e ndryshëm serbë, vasalë besnikë të okupatorit turk dhe kisha ortodokse serbe, gjithashtu vasalë të përvuajtur të sulltanit të Stambollit

Nga ana tjetër, një pjesë e madhe e shqiptarëve në pellgun e Kosovës, pjesërisht edhe në Dukagjin, kanë qenë ortodoksë, të cilët kisha serbe dhe pushteti i ka asimiluar me dhunë, përkatësisht me kohë janë sllavizuar. Kështu, angazhimi i shqiptarëve për ruajtjen e tyre mund të ketë njëfarë lidhjeje edhe me faktin se këto kanë qenë dikur kisha të të parëve të tyre të krishterë. Këtë e vërteton edhe një fakt bashkëkohor në Rugovë, ku më 2005 ka ndërtuar kishën katolike në fshatin Kuqishtë, megjithëse në trembëdhjetë katundet e Rugovës s'ka asnjë familje, asnjë njeri të fesë katolike.

Rugovasit e kanë ndërtuar këtë kishë, me iniciativën e tyre, në vendin e kishës së dikurshme, për nderë e kujtim të të parëve të tyre të cilët kanë qenë katolikë, pa cenuar aspak bindjet dhe përkatësinë e fesë së tyre të sotme myslimane. Ky është një shembull tipik dhe i vetmuar në përmasa botërore i tolerancës fetare, i ndershmërisë, i burrërisë dhe i humanizmit të këtyre malësorëve kreshnikë të Alpeve Shqiptare në rajonin e Pejës.

*

Historiani, prof. **Pero Slijepčević**, ndër të tjerat shkruan: "Është vërtetuar që nga numri i madh i kishave të vjetra serbe, vetëm në një pjesë të vogël të tyre kanë qenë krijues të vërtetë ndonjë serb i cili ka emrin e shkruar në atë kishë... Serbët s'kanë pasur kurrfarë tradite as në ndërtimtari, as në pikturim...Nemanjiqët kanë ndërtuar (financuar M. K.) manastire edhe larg kufijve të shtetit serb, për ta afirmuar dinastinë e tyre... "Ndërto monumente kulturore në Serbi dhe larg kufijve të shtetit, për t'i treguar botës kush jemi e pse po vijmë! Këtu ka qenë më i rrezikshëm Millutin Nemanjiqi. Ja, institucioni humanitar në Stamboll, ja, manastiri serb në Jerusalem. Ja, ju zotërinj grekë, edhe Novak Grebostreku (komandant, M.K.) me ushtrinë e

përgatitur, për të ndihmuar në Azinë e Vogël!... Kjo do të thotë se monumentet mbretërore shkojnë gjithnjë me ushtri. Përmendoret shpirtërore janë më tepër monumente dhe kufi të fitoreve”.⁴⁰

*



Kisha katolike shqiptare në Rugovë

Aleksandër Gilferding (1831-1872), historiani dhe diplomati i njohur rus, ndër të tjera shkruan: “Serbët e vjetër nuk kanë pasur talent dhe aftësi të mjaftueshme për të kuptuar historinë dhe paraqitjen e saj... Nën pendën e tyre gjuha është deformuar në njëfarë frazeologjie absurde të ujcavtë.. I tillë është me të vërtetë karakteri i gjithë shkrimeve të vjetra serbe. Në to s’ka fjalë të vërteta... Duhet të lexohen legjendat e Nemanjiqve, të asaj familje përplot krime, vëllai kundër vëllait, djali kundër babait dhe babai kundër të birit, për të kuptuar se sa ka mundur te serbët të ngulfatet ndenja dhe shprehja morale. Proklamohen për shënjtër të gjithë sundimtarët serbë që nga Nemanja e deri te shkatërrimi i Perandorisë Serbe (me përjashtim të car Dushanit, i cili ka vrrarë babanë e vet), pa marrë parasysh që shumë nga ata me gjakftohtësi kishin bërë shumë krime të rënda dhe që kanë

⁴⁰ Перо Слијепчевић, Старе Српске Задужбине..., 115.

qenë gjithmonë gati për ta tradhtuar fenë ortodokse për qëllime politike.

Beteja e Kosovës (më 1389) ka qenë për njerëz të arsimuar temë gjoja shkencore dhe e llogotitjes së rrejshme fetare... Tregimi, pa marrë parasysh sa e si është ruajtur me të vërtetë në popull, megjithatë gjatë shekujve patjetër ka ndryshuar dhe është deformuar... Le ta kuptojnë serbët dhe ta pranojnë para vetvetes se llogotitja dhe sahanlëpirja janë sëmundje të rënda e të rrezikshme në shoqëri”.⁴¹

Nga ana tjetër, Gilferdingu për shqiptarët shkruan: “S’ka popull më indiferent ndaj fesë se shqiptarët. Një shkrimtar gjerman, njohës i mirë i shqiptarëve, me të drejtë ka thënë për popujt të cilët janë nën pushtetin osman, që sllavi, greku e vllahu i japin përparësi fesë së tyre e jo lirisë, kurse shqiptarët lirinë e kanë mbi çdo gjë, madje edhe mbi fenë”.⁴²

Gilferdingu ka vizituar edhe kishën e Deçanit, duke shkruar më gjatë për këtë objekt sakral. Ndër të tjera ai shkruan: “Mbi derën nga jugu është një barilev në të cilin paraqitet pagëzimi i Krishtit, në të cilin shkruan me germa dhe gjuhën e vjetër sllave: “Fra Vita, vëlla i vogël, kryemjeshtër nga Kotorri, qytet i mbretërve, e ndërtoi këtë kishë për tetë vjet dhe e kreu përfundimisht në vitin 1335”.⁴³

Këtë fakt shumë të rëndësishëm e përmendin vetëm me një fjalë dy autorë serbë, kurse për kishën e Deçanit kanë shkruar me qindra studiues, letrarë, gazetarë e të tjerë, por asnjëri nga ta nuk e përmend fare arkitektin dhe ndërtuesin shqiptar Vita Kuçin.

Sipas autorit francez Zhysten Gotard, “Feja e shqiptarit është besa shqiptare. Besa është një tipar, një virtut kombëtar shqiptar”.⁴⁴

*

Akademiku **Jovan Cvijiq**, shkencëtari i njohur serb, në veprën e tij “Balkansko Poluostrvo” shkruan: “Populli serb ka arritur t’ia imponojë Kishës ortodokse serbe nacionalizmin dhe fenë serbe të Millosh Obiliqit, e cila lufton për përtëritjen e Perandorisë së car Dushanit të shekullit XIV”⁴⁵. Pra, sipas Cvijiqit, serbët s’kanë fe të

⁴¹ A. F. Gilferding, Putovanje po Hercegovini, Bosni i Staroj Srbiji, Sarajevo 1972, 241-245.

⁴² Po aty.

⁴³ Po aty., 163, 170, 241.

⁴⁴ Pal Doçi, Mirdita vatër e qëndrueshme antiosmane, Tiranë, 199, 105 dhe 107.

⁴⁵ Цвијић, Ј. Балканско полуострво и јужнословенске земље, Београд 1952.

krishterë monoteiste, por “fenë e Millosh Obiliqit, fenë pagane, e cila lufton për robërimin e popujve dhe territoreve të huaja, madje “me shpatë e me zjarr”, por edhe me kryq në ballë - si maskë. Këtë qëllim ajo e ka zbatuar gjatë shekujve ndaj shqiptarëve, duke qenë krah i djathtë i politikës ekspansioniste gjenocidiale serbe.

*

Konstantin Jireçek, historiani i njohur çek, mik i dëshmuar i politikës ekspansioniste serbe, megjithatë shkruan: “Shqiptari Progon Zguri, “heterijah i madh” bizantin, më 1295 ka rinovuar kishën e Zonjës së bekuar në Ohër”... Jireçeku shënon disa kisha katolike në Kosovë, në Prizren, në Trepçë, në Novobërdë etj., në të cilat famullitarë (priftërinj, klerikë) kanë qenë më së shumti shqiptarë të Kotorrit... Gjatë sundimit të Nemanjiqëve, latinët (katolikët M. K.) i janë ankuar (Papës M. K.) kundër serbëve të cilët po ua uzurponin kishat e manastiret.”⁴⁶ Kishën e Graçanicës e ka përtëri mbreti Millutin. Me zgjerimin e kufijve në jug janë uzurpuar shumë kisha të vjetra....Nemanjiqët kanë ndërtuar kisha edhe në Stamboll, Jerusalem etj.⁴⁷

Jireçeku shton se shqiptarët në mesjetën e hershme kanë humbur shumë tokë të tyre nga serbët, megjithatë, ata nuk ishin popull që shuhet. Nga fundi i shekullit XIII ata filluan të vendosen në drejtim të jugut në Thesali, Epir dhe në Greqi, kurse në shekullin XVII dhe në drejtim të veriut deri në Novi Pazar, Nish dhe Vranjë.... “Në pjesët e epërme të Vardarit, të Drinit të Bardhë, në Fushë të Kosovës dhe në rrethinat e Nishit, ka qenë atdheu i Dardanëve (fis ilir M. K.), të cilët përmenden 281 vjet para Krishtit”.⁴⁸ “...Shqiptarët në mesjetë kanë qenë popullsi e vjetër krishtere me kulturë të lartë qytetare, e cila është shumë më afër me grekët dhe dalmatët romanë sesa me serbët të pagëzuar më vonë”.⁴⁹

*

Dom Jak Prenku, shkruan: “Historia e Dioqezës së Shkup-Prizrenit kapë një periudhë prej mbi 16 shekuj. Krishterimi në Dardani, pra në Kosovën e sotme, është përhapur që në shek. I pas

⁴⁶ Константин Јиречек, Историја Срба, Књ. I, Београд, 1952, 10, 86, 124.

⁴⁷ По ату., 193, 264, 265.

⁴⁸ По ату.

⁴⁹ По ату.

Krishtit. Shën Jeronimi ka shkruar se Kisha katolike në Kosovë në kohën e sundimit të mbretërve serbë dhe të dominimit osman, ka përjetuar golgotë të vërtetë, shumë nga këto kisha i kanë shndërruar në kisha serbe e në xhami.

Kisha në Banjskë afër Mitrovicës, ku në vitin 1346 është varrosur e ëma shqiptare e mbretit Dushan, ishte kishë shqiptare katolike. Në Trepçë ka pasur mbi 600 besimtarë katolikë të gjithë shqiptarë (Tutti questi uomini sopra nominati sono albanesi). Për këtë shkruan arqipeshkvi i Tivarit Marin Bici (1610), pastaj Pjetër Mazreku (1623), Gjergj Bardhi (1638) etj. Kishat katolike shqiptare në Kosovë i kanë mbajtur gjallë personalitetet shqiptare duke filluar nga shenjtorët e parë Flori e Lauri, Shën Niketa, Pal Hasi, Tomë Raspasari, Pjetër Mazreku, Ndue Bytyçi, Gjon Progoni, Gjon Injaci, Martin Segoni (i doktoruar në Padovë më 1475), Gjon Nikollë Kazazi etj.⁵⁰

*

Në projektin e qeverisë së Serbisë “**Naçertanija**” të vitit 1844, për krijimin e Serbisë së Madhe është paraparë që të angazhohet edhe kleri i kishës ortodokse serbe, nën udhëheqjen e Vlladikës së Malit të Zi, të cilit, si sundimtar i këtij vendi, “i pëlqejnë punët e mëdha”.⁵¹ Kuptohet se në Serbinë e Madhe të imagjinuar do të robëroheshin shqiptarët dhe popujt e tjerë joserbë, të cilëve do t’u ndërrohej kombësia dhe feja e tyre joortodokse. I tillë ka qenë ligji edhe në Kodin e car Dushanit të shek. XIV, kush të gjendet si heretik (katolik) le t’i digjet fytyra me hekur të skuqur dhe të dëbohet.... Ai që e ka fshehur, edhe atij t’i digjet fytyra”.⁵²

*

Përtëritjen e Perandorisë së car Dushanit anembanë Ballkanit, e shohin ëndërr edhe sot, në shek. XXI, ata që duan ta krijojnë Serbinë e Madhe, si car Dushani në shek. XIV.

Një aksion të tillë të përgjakshëm ka ndërmarrë kral Nikolla i Malit të Zi më 1913 në Plavë e Guci dhe në Rrafshin e Dukagjinit, në krye me kriminelin Savo Llazareviq, përkatësisht Savë Batarja. Në këtë gjenocid kanë marrë pjesë aktive popët ortodoksë dhe kolonët serbë e malazezë. Më këtë rast në mënyrë mizore është vrarë me bajoneta edhe prifti katolik shqiptar Atë Luigj Palaj në fshatin Janosh të Gjakovës.

⁵⁰ Dom Jak Preku “Bujku”, Prishtinë, 30 qershor 1997.

⁵¹ Savo Brković, O postanku i razvoju crnogorske nacije, Titograd, 1974, 71.

⁵² Nikola Radojčić, Zakonik cara Stefana Dušana 1349 dhe 1354, Beograd, 1960, 91.

“Në këtë aksion kriminel të Malit të Zi në Plavë e Guci janë likuiduar rreth 800, kurse në Rrafshin e Dukagjinit 4000 shqiptarë”.⁵³

*

Autori serb **Mirko Gjorgjeviq**, shkruante veç tjerash: “Shumëkush nuk e vëren se në periudhën e diktaturës së Millosheviqit kisha ka qenë jo vetëm dëshmitare, por edhe pjesëmarrëse në veprimet e Millosheviqit. Kjo nuk guxon të harrohet. Në disa momente të krizës, kur dukej se Millosheviqi nuk do të kalojë, Kisha ia ka dhënë mbështetjen vendimtare, madje edhe vetë Patriku më 1995: “Kështu Kisha ortodokse serbe ka dështuar, është bërë ultranacionaliste me çka e ka tradhtuar qenien e saj”.⁵⁴

*

Millorad Tomaniqi në librin “Kisha serbe në luftë dhe lufta në të”, demaskon udhëheqësinë kishtarë të niveleve më të larta e cila e përkrah politikën serbe ekspansioniste për krijimin e Serbisë së Madhe, madje duke u pajtuar edhe me luftën për këtë “interes kombëtar”. Kleri (priftërinjtë) i kishës serbe ka porositur serbët e Bosnjës, të Kroacisë e të Kosovës që të armatosen e të luftojnë për idealin kombëtar të Millosheviqit. Ky ideal kombëtar serb është përplot argumente që dëshmojnë rolin e kësaj kishe në politikën serbomadhe dhe në luftën e fundit kundër popujve joserbë. Kisha serbe ka pasur qëllimin që kufijtë e saj të jenë gjithashtu kufij të shtetit serb, sepse kjo kishë ka pasur të drejtën e administrimit fetar edhe jashtë kufijve shtetërorë. Ky libër i Tomaniqit është përplot argumente dhe shembuj konkretë të politikës serbomadhe, siç ka qenë dhe siç është edhe sot politika ekspansioniste e Serbisë ndaj trevave shqiptare.⁵⁵

*

Publicisti serb **Nenad Briski**, shkruan: “Kongresi i lidhjes botërore të kishave të krishtera në Gjenevë, më 1994 ka vendosur përjashtimin e Kishës Ortodokse Serbe nga kjo organizatë, për arsye se ajo ka përkrahur politikën dhe gjenocidin e Serbisë ndaj disa popujve joserbë në Ballkan (boshnjak, kroat, shqiptar)”, në krye me kriminelin e njohur Slobodan Millosheviqin (kryetar i Serbisë). “Por

⁵³ Bajram Redjepagić, Pustinja, Sarajevo, 1982.

⁵⁴ Po aty.

⁵⁵ Milorad Tomanić, Srpska Crkva u ratu i rat u njoj, Beograd, 2010, 19, 96, 195, 202 i dr.

ky vendim nuk është zbatuar për arsye se një masë e tillë nuk parashihej me Statutin e kësaj organizate”.⁵⁶ Megjithëkëtë, përgjegjësia e kishës serbe mbetet e pakontestueshme në mbështetjen e gjenocidit të Millosheviqit ndaj popujve joserbë.

*

Dobrica Qosiq, ish kryetar i Jugosllavisë, akademik dhe shkrimtar i madh serb, ka shkruar diçka të ngjashëm në romanin e tij “Deobe” për karakterin e popullit serb, përkatësisht për inteligjencën serbe, kështu që kjo sentencë e tij ka hyrë edhe në enciklopedi të ndryshme të aforizmave. Qosiqi shprehimisht shkruan: “Ne gënjejmë për të mashtruar vetveten, për të pajtuar tjetërkënd, gënjejmë nga mëshira, gënjejmë se nuk frikësohemi, për të inkurajuar, për të fshehur mizërinë tonë e të huaj. Gënjejmë nga dashuria dhe njerëzia, gënjejmë për ndershmërinë. Gënjejmë për lirinë. Gënjeshtër është argumenti i atdhetarizmit tonë dhe vërtetimi i inteligjencies sonë të trashëguar. Ne gënjejmë në mënyrë krijuese, me fantazi, në mënyrë inventive.”⁵⁷

Kjo veti e mjeshtri për të gënjer e autorëve të ndryshëm serbë është e pranishme edhe sot në lidhje me trashëgiminë kulturore në Kosovë, ku me trillime e gënjeshtër të autoriteteve kishtarë e shtetërore serbe UNESCO ka regjistruar 4 kisha ortodokse në Kosovë si trashëgimi kulturore serbe, madje si vlera botërore të artit, për të “vërtetuar” kështu gjoja autoktoninë e serbëve ardhasakë në Kosovë, megjithëse këto kisha, siç dihet mirë, nuk janë serbe, por të kohës së sundimit të Bizantit kur serbë s’ka pasur në këto vise.

Në këtë mënyrë, në bazë të këtij aforizmi të akademik Qosiqit, Serbia në vazhdimësi ka zgjeruar me dhunë kufijtë e saj shtetërorë drejt jugut, duke pushtuar trojet shqiptare që nga Kongresi i Berlinit (1878) e deri me sot. Në këto territore historikisht shqiptare (Sanxhaku i Nishit - Toplica e të tjera), okupatori serb ka zhdukur të gjitha monumentet sakrale (kisha, xhamia e varreza shqiptare) - madje, “me shpatë e me zjarr”, siç thotë vetë sundimtari i atëhershëm i Serbisë, knjaz Millan Obrenoviq, më 1877, duke u lavdëruar se sanxhakun e Nishit të atëhershëm (Toplicën etj.) “deri dje krejtësisht shqiptare, sot kemi arritur që në këtë mënyrë ta bëjmë krejtësisht trevë serbe!”⁵⁸

⁵⁶ Ненад Бриски, Запрепашчујуће оправданје рата и злочина, ” Борба”, Београд, 19. VIII. 1994.

⁵⁷ Velika Epohina enciklopedija aforizama, Zagreb, 1968.

⁵⁸ Prof. Dr. Xheladin Shala, Copëtimi i Shqipërisë, “Albanica”, nr. 85, Prishtinë., 2008, f. 87.

LES VOÏVODES DES MONASTÈRES DE KOSOVA

Résumé

Il s'agit de la patriarchie de Pejë, de Deçani en Dukagjin et de Deviç dans la région de Drenica, non loin du village de Lausha. La coutume des „voïvodes des monastères" s'est maintenue ici jusqu'à nos jours. Il s'agit d'Albanais des villages voisins, qui de génération en génération protégeaient ces monastères, même dans les époques les plus difficiles de la domination turque, où plus d'une fois, les régions en question furent victimes de l'anarchie. Le voïvode était d'ordinaire élu par le „fis" (la tribu). On le présentait ensuite au chef du monastère et son élection était également approuvée par les autorités turques. La famille du voïvode devait défendre le monastère au nom de tout le village, du clan ou de la tribu. Un membre de la famille du voïvode se trouvait toujours, armé, au monastère. En cas de besoin et à son appel, tous les hommes du village ou du „fis" se rassemblaient au monastère.

Il y eut plusieurs exemples de combats sanglants où les défenseurs des monastères payèrent de leur vie. La famille du voïvode Salih Rusta de Deçani est bien connue. Elle protégeait le monastère du même nom, de même que la famille de Zhuj Veseli de Rugova la patriarchie de Pejë, et celle de Behram de Lausha le monastère de Deviç. Toutes ces familles possédaient aussi des décorations et des actes de reconnaissances écrits de la part des autorités ecclésiastiques et d'état, pour leur dévouement aux monastères en question. Les voïvodes des monastères n'étaient rattachés à ceux-ci ni par leur religion ni par leur nationalité: il s'agit d'Albanais musulmans. L'explication de cette institution doit cependant être cherchée dans le culte d'une population patriarcale pour tout temple ou objet tabou. Il s'agit aussi de la conception spécifique de l'honneur et de l'honnêteté chez les Albanais montagnards, ainsi que du rôle du Kanun Leka Dukagjin dans leur vie sociale. C'est pour un Albanais un grand outrage si quelqu'un attaque un monastère sans défense de la région. Le Kanun spécifie que l'église ne possède ni fer ni feu pour sa défense. Son honneur doit donc être protégé par le village. Il faut aussi ajouter à ce fait la croyance à la puissance surnaturelle de certains monastères. L'homme de la société patriarcale croyait donc aussi s'assurer par la protection du monastère une certaine protection de son patron. En outre le monastère donnait aussi au voïvode une certaine récompense, et les moines savaient mener habilement une politique de paix et d'amitié avec les Albanais voisins, fiers d'être les protecteurs de monastères aussi anciens que Deçani ou la patriarchie.

Grâce aux voïvodes des monastères—paysans albanais de Dukagjin et de Drenica, ces monuments historiques si importants ont été conservés jusqu'à nos jours malgré les difficultés de l'époque de la domination turque. C'est aussi un bel exemple de tolérance et de collaboration fraternelle dans une antiquité plus reculée entre les Albanais et les Serbes dans la région de Kosovë.

Literatura:

- Vlada Petković, Gjorgje Boshković, Manastir Dečani, knjiga I, Beograd, 1941.
- Franc Mesesnel, Stari srpski spomenici, "Spomenici kulture", Beograd, 1951.
- Gjorgje Radojčić, Janičije Devićki, Glasnik etnografskog instituta SANU, knj.I, Beograd, 1952.
- Pero Slijepčević, Stare srpske zadužbine, "Ogledi," I, Beograd, 1934.
- Ivan S. Jastrebov, Podaci za istoriju srpske crkve, Beograd, 1879.
- Petar Kostić, Ckveni život pravoslavnih Srba u Prizrenu i njegovoj okolini u XIX veku" Beograd, Glasnik skopskog naučnog društva, V, Skopje, 1929.
- Jahja Drançolli, Monumentet e kultit katolik në Kosovë, "Koha ditore", Prishtinë, 14 prill, 2001.
- Leontije Ninković, Bratstvo lavre Visokih Dečana, Peć, 1923.
- Radomir Ivanović, Istorijski časopis, IV, Beograd, 1954.
- Stojan Novaković, Godišnjica Nikole Čupića, XI, Beograd, 1889.
- Jovan Hadživasilević, Pokret Arnauta za vreme srpsko-turskih ratova 1876 i 1878, "Ratnik", XIV, Beograd, 1905.
- Maxhun Smajli, Lufta dhe dilemat shqiptare, Klinë, 2002.
- Jovan Radonić, Rimska kurija i južnoslovenske zemlje od XVI do XIX veka, Beograd, 1950.
- Petar Zh. Petrović, Kërkime shkencore në Rashkë më 1930 (dorëshkrim).
- Aleksandar Gilferding, Putovanje po Hercegovini, Bosni i Starj Srbiji, Sarajevo, 1972.
- Panta Srečković, Sinan Paša, Beograd, 1865.
- Tatomir Vukanović, O kultu Stevana Dečanskog u Metohiji, "Hrišćansko delo", III, Skopje, 1937.
- Shtjefën. Gjeçovi, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shkodër, 1933.
- S. Jastrebov, Stara Srbija i Albanija, Spomenik Srpske akademije i nauka, XLI, Beograd, 1904.
- Vuk St. Karadžić, Srpske narodne pjesme, VI, Beograd, 1899.
- Mark Krasniqi, Mikpritja në traditën shqiptare, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2005.
- Gaspër Gjini, Skopsko-Prizrenska biskupija kroz stoljeća, Zagreb, 1986.
- Pal Doçi, Mirdita vatër e qëndrueshme antiosmane, Tiranë. 1995.
- Jovan Cvijiq" Ballkansko poluostrvo i južnoslovenske zemle, Beograd, 1952.
- Konstantin Jireček, Istorija Srba, I, Beograd, 1952.
- Dom Jak Preku, "Bujku", Prishtinë, 30 qershor 1997.
- Savo Brković, O postanku i razvoju crnogorske nacije, Titograd, 1974.
- Nikolla Radojčić, Zakonik cara Stefana Dušana 1349 i 1354, Beograd, 1960.
- Bajram Rexhepagiq, Pustinjak, Sarajevo, 1982.
- Millorad Tomanić, Srpska crkva u ratu i rat u njoj, Beograd, 2010.
- Velika epohina enciklopedija aforizama, Beograd, 1968.
- Prof. Dr. Xheladin Shala, Coptimi i Shqipërisë etnike, revista "Albanica", nr.85, Prishtinë, 2008.
- Nenad Briski, Zaprepašçujuće opravdanje rata i zločina, "Borba", Beograd, 19. VIII.1994.

Hivzi ISLAMI, Prishtinë**MIGRIMET E JASHTME, KONTEKSTI ETNIK
DHE KRIJIMI I DIASPORAVE**

KDU 343.286

Abstrakt

Midis migrameve të jashtme dhe formimit të diasporave ekziston një lidhje shumë e ngushtë. Në formimin e diasporave, historike dhe bashkëkohore, të vogla ose të mëdha, të shumë popujve, përfshirë edhe diasporën shqiptare, ndikim të drejtpërdrejtë kanë migrimet e jashtme definitive, bashkë me migrimet e jashtme të përkohshme, të nxitura nga një varg motivesh. Ato lënë gjurmë të rëndësishme në jetën e popujve, të grupeve të ndryshme të popullsisë, të familjeve dhe të individëve. Njëra nga pasojat më të mëdha është edhe përzierja racore e popullsisë, veçanërisht në SHBA, me sjelljen me dhunë të robërve nga Afrika Perëndimore nga fundi i shekullit 17 e deri në gjysmën e shekullit 19. Në pjesën e dytë të shekullit XX në botë ndodhën ndryshime të mëdha ekonomike, sociale, politike, kulturore etj., ku u intensifikua edhe mobiliteti hapësinor dhe social i popullsisë dhe i fuqisë punëtore. Në këtë periudhë forcohen dhe intensifikohen edhe lidhjet migruese tradicionale midis vendeve evropiane dhe vendeve përtej oqeanit (SHBA, Kanada, Australi etj.) sikundër që bëhet zgjerimi demografik dhe territorial i diasporave tashmë ekzistuese dhe formimi i bërthamave të reja. Humbjet dhe dobietë ekonomike, demografike e të tjera janë të ndryshme për vendet emigruese dhe vendet imigruese. Në kuadër të migrimit ekonomik të fuqisë punëtore, të ofertës dhe të kërkesës për punë, midis vendeve të pazhvilluara dhe vendeve të zhvilluara, janë migrimet selektive si një veçori e posaçme, përkatësisht lëvizjet migruese të punëtorëve me kualifikime të larta (shkencëtarë, inxhinierë, kadro teknike, mjekë etj.), që njihen si “migrim i truve”. “Migrimet intelektuale” kanë marrë hov pas viteve të 70-ta të shekullit të kaluar dhe për vendet e pazhvilluara dhe ato në zhvillim, si eksportues kryesor i “migrimit të truve” në vendet e zhvilluara, ky tip i migrimit paraqet një humbje të madhe të kapitalit njerëzor.

Fjalët çelës: Migrimet, migrimet e jashtme, migrimet selektive, diaspora, zgjerimi i diasporave, efektet njerëzore dhe ekonomike, migrimet intelektuale.

Migrimet dhe zgjerimi i ekumenës

Nuk ka dyshim se migrimet e popullsisë kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në evolucionin e përgjithshëm demografik dhe shoqëror të njerëzimit, para së gjithash në zgjerimin e ekumenës, në ndryshimin e strukturës së popullimit dhe rrjedhimisht të hartës popullore të botës. Gjatë luftës së gjatë për ekzistencë elementare, njerëzit nga çerdhja e tyre e parë janë zgjeruar anëmbanë në Tokë, por

të gjitha njohuritë flasin për një shtrirje karakteristike oazore dhe disperzive, e diktuar nga rrethanat natyrore-gjeografike përmes pozitës gjeografike, relievit, klimës, ujit, vegjetacionit, truallit dhe botës shtazore. Këto rrethana duket se kanë qenë njëra nga determinantet kryesore në formimin e hartës populative të botës në etapën e popullimit themelor.¹ Ndërsa më vonë, nën ndikimin e fuqishëm të faktorëve shoqërorë-historikë (organizimi i shoqërisë, shkalla e finalizimit të resurseve natyrore, niveli i zhvillimit teknologjik, dija dhe arsimi, intensiteti i shfrytëzimit të territorit, këmbimi i të mirave materiale etj.) do të transformohet edhe më fuqishëm baza natyrore-gjeografike dhe me këtë do të forcohet e zgjerohet jeta e ngulitur, formimi dhe zhvillimi fizik e funksional i vendbanimeve.

Kur të vështrohet harta populative e botës sot, vërehet se pjesa dërmuese e popullsisë së planetit tonë (rreth 50%) shtrihet në zonën e mesme (20-40 shkallë të gjerësisë veriore gjeografike), në Hemisferën Veriore rreth 88%, në "Botën e Vjetër" rreth 85%, në kontaktet midis kontinentit (tokës) dhe ujit, në pjesët e jashtme të kontinenteve, rreth liqeneve, lumenjve e luginave të tyre, rreth rrugëve, rrëzë maleve, në anët e kthyer nga dielli, në rajonet e zhvilluara industriale, në qendrat e mëdha urbane etj. Rreth 80% e popullsisë së botës jeton në lartësi mbidetare nën 500 metra. Ndërsa si rrjedhojë e rrethanave të përshtatshme natyrore-gjeografike dhe e proceseve të caktuara shoqërore-historike janë krijuar territoret e koncentrimit të fuqishëm demografik.² P. sh. në një hapësirë prej rreth 12% jetojnë afër 70% e popullsisë së botës (Azia JL, që përfshin rreth 8% të sipërfaqes së botës, me më se 50% të popullsisë së botës, Evropa JP me 3% të sipërfaqes dhe 13% të popullsisë dhe pjesa verilindore e SHBA-së me 1% të territorit dhe 3% të popullsisë botërore).³

Vlerësohet se para revolucionit neolitik bujqësor (rreth 8.000 vjet para epokës sonë) numri i njerëzve ishte i vogël dhe pjesa dërmuese e ekumenës së sotme kishte dendësi shumë të rrallë të

¹M. Reinhard, A. Armengaud, J. Dupâquier, *Histoire générale de la population mondiale*, III éd., Éditions Montchrestien, Paris, 1968, pp. 9-22.

² Një gjendje të tillë e hasim qysh pas Luftës II Botërore: J. Staszevski, *Po aty*; J. Beaujeu-Garnier, *Trois milliards d'hommes. Traité de démo-géographie*, Librairie Hachette, Paris, 1965, pp. 42-88; P. Gorge, *Population et peuplement*, Presses universitaires de France, Paris, 1969; L. Buquet, *Démographie*, Masson et Cie, Droit, Sciences, Économie, Paris, 1974, pp. 147-150.

³ D. Noin, *Géographie de la population*, Masson, Paris-New York-Barcelone-Milan, 1979, pp. 74-80; M. Friganović, *Demogeografija (Stanovništvo svijeta)*, Školska knjiga, Zagreb, 1990, ff. 17-19.

popullsisë.⁴ Ndonëse nga paraqitja e paraardhësit të njeriut, të drejtuar në këmbë (*homo erectus*) kanë kaluar rreth 1.700.000 vjet dhe të *homo sapiens*it (njeriut si qenie e arsyeshme, e vetëdijshme) rreth 60.000 vjet⁵ dhe me gjithë kërkimin e autorëve dhe qarqeve të ndryshme, për evolucionin e popullsisë së botës, për shkaqet dhe pasojat e tij dhe veçanërisht për gjendjen numerike të popullsisë nuk kemi njohuri të mjaftueshme, veçanërisht për të kaluarën e largët. Në mbështetje të vlerësimeve të autorëve dhe qarqeve të ndryshme dhe më vonë dhe të shërbimeve të specializuara të Kombeve të Bashkuara flasin se nga *homo sapiens* deri në fillim të epokës sonë dhe përgjithësisht deri në fillim të kohës moderne (zbulimet e mëdha gjeografike) vërehej një lëvizje karakteristike popullore: stagnime të gjata, rënie dhe rritje e ngadalshme, me fluktuime dhe dallime të theksuara në pikëpamje territoriale si pasojë e ndikimit të një varg përcaktorëve, që kishin ndikim para së gjithash limitues.⁶ Në periudha të caktuara kohore, në disa pjesë të ekumenës së sotme ndodhte edhe shpopullimi i përkohshëm natyror⁷ si rezultat i shtimit natyror negativ (më i vogël numri i të lindurve dhe më i madh numri i të vdekurve).

Para rreth 40.000 vjetëve para epokës sonë (paleoliti i epërm), sipas vlerësimeve të përgjithshme në botë jetonin rreth 500.000 banorë, ndërsa 5.000 vjet më vonë ky numër rritet në rreth 4 milionë njerëz.⁸ Kjo gjendje numerike, me fluktuime të konsiderueshme, ku, pos rrethanave të tjera, ndikim të madh ka pasur ndërrimi i klimës, nuk ndryshon deri para 10.000-5.000 vjet para epokës sonë, kur paraqiten bashkësitë e lidhura për vendbanimet e para bujqësore (revolucion i neolitik agrar).⁹ Vlerësohet se shënohet një rritje e mirëqenies së përgjithshme, që mundëson krijimin e një baze për

⁴ Shih më gjerë: M. Reinhard, A. Armengaud, J. Dupâquier, *Histoire générale de la population mondiale*, III éd., Éditions Montchrestien, Paris, 1968, pp. 9-38 e tutje; G. Tapinos, *La démographie. Population, économie et sociétés*, Paris, 1996.

⁵ A. Varagnac, *L'homme avant l'Histoire*, Paris, 1959.

⁶ V. D. Glass - D. E. C. Eversely, *Population in history. Essays in historical Demography*, London, 1965; C. McEvedy-R. Jones, *Atlas of World Population History*, Harmondsworth, New York, Victoria, Penguin Books Ltd, 1978.

⁷ D. J. Durand, *Historical estimates of World Population: an evaluation*, Population Studies Center, University of Pennsylvania, 1974; L. Naugier, *Géographie humaine préhistorique*, Paris, 1959.

⁸ J.- N. Biraben, "Essai sur l'évolution du nombre des hommes", *Population*, No 1, Institut National d'Études Démographiques, Paris, 1979, pp. 23-24.

⁹ P. Baud-S. Bourgeat-C. Bras., *Dictionnaire de géographie*, 2^{ème} éd., Hatier, Paris, 1997, p. 300.

rritjen e popullsisë. Në këto bashkësi të para bujqësore krijohen edhe teprica të përkohshme të ushqimit (drithërat), që ruheshin si rezerva për situata të rënda ekzistenciale, çfarë ishin p. sh. vitet e thatësisë dhe, lidhur me to, dhe vitet e urisë. Bashkësitë dhe veprimtaria neolitike agrare u zgjeruan territorialisht, duke përfshirë (deri 6.000 vjet para epokës së re) Evropën Juglindore dhe gjatë pesëmijëvjeçarit edhe Mesdheun Perëndimor dhe hapësirat nëdanubiane, pastaj Afrikën Veriore gjatë fazës me lagështi, si dhe viset e Turkistanit deri në Iranin Verior, fushën e Indit dhe krahinën e Sindit. Disa të dhëna flasin se këto bashkësi në të njëjtën kohë e ndoshta edhe më herët do të gjenden edhe në Kinë, qysh 7.000 deri 6.000 vjet para epokës sonë. Intensiteti i mobilitetit (migrimi) nga jeta bredhëse bujqësore deri te jeta e ngulitur (sesile), e cila do të ketë qenë e gjatë, është varur nga tipi i ekonomisë neolitike dhe ndikimi i shumë konteksteve dhe substrateve natyrore dhe kulturore.¹⁰

Periodha, kohësisht e përvijuar midis 8.000 e 10.000 vjet para epokës sonë dhe fillimit të epokës së re¹¹ njihet edhe si "revolucion neolitik demografik", që përputhet me periudhën e zëvendësimit të ekonomisë mbledhëse e të gjuetisë dhe të mënyrës endacake të jetës me ekonominë bujqësore dhe jetën e ngulitur, ku bazën kryesore e përbënin lavërtaria dhe rritja e kafshëve shtëpiake.¹² Raportet midis popullatave nomade blegtorale dhe bujqve sesilë ashpërsohen deri në konflikte të hapura. Vitet e thatësisë dhe të urisë, duke rrezikuar jetën e bashkësive bredhëse, i intensifikojnë proceset nomadike dhe strukturat endacake i sulmojnë vendbanimet (fshatrat dhe qytetet), që dëshmojnë muret mbrojtëse në shumë vende, para së gjithash në hapësirat e Azisë së perparme.¹³ Prej këtij "revolucioni neolitik bujqësor" vlerësohet se bota shënon një përparim demografik, kur numri i popullsisë së saj rritet prej rreth 5 milion në rreth 300 milion njerëz në fillim të epokës së re, të shtrirë në një pjesë relativisht të madhe të hapësirës së sotme të banuar,¹⁴ ndërkaq, pas zbulimeve të

¹⁰ Më gjerë dhe më hollësisht shih në: E. Heršak, *Drevne seobe*, Školska knjiga, Zagreb, 2005, ff. 94-105.

¹¹ D. J. Durand, "Historical Estimates of World Population: An Evaluation", *Population and Development Review*, No 3, Neë York, 1977.

¹² G. Acsádi-J. Nemeskéri, *History of Human Life: Span and Mortality*, Akademiai Kiadó, Budapest, 1970.

¹³ E. Heršak, *Po aty*, ff. 108-109.

¹⁴ J.- N. Biraben, "Essai sur l'évolution du nombre des hommes", *Population*, No 1, Institut National d'Études Démographiques, Paris, 1979, pp. 23-24; D. J. Durand,

mëdha gjeografike, në vitin 1650 në rreth 500 milion njerëz dhe në vitin 1750 në rreth 730 milion njerëz.¹⁵ Kjo do të thotë se lëvizjen e popullsisë sa i përket anës së saj kuantitative e shquante një ngecje e gjatë, që është një nga veçoritë themelore të evolucionit demografik të botës. Autorët që janë marrë më hollësisht me evolucionin e popullsisë theksojnë se popullsia e botës në dhjetë shekujt e parë të epokës sonë, me fluktuime të dukshme, sillej prej 256 milion në vitin 14 deri në 280 milion në vitin 1000.¹⁶

Faktet shkencore flasin se në fazat e hershme të ekzistimit besohet se njerëzit jetonin të ndarë, ndërsa më vonë do të bashkohen në grupe e kolektive më të mëdha dhe më të organizuara shoqërore. Së pari ishin të grupuar në hapësirat e caktuara, që kishin pozitë të volitshme gjeografike dhe kushte të tjera të përshtatshme natyrore për zhvillimin e jetës (relievi, klima, uji, vegjetacioni, fauna etj.) të cilat do të luanin rol të madh në jetën e ngulitur dhe formimin e vendbanimeve të para. Vendbanimet si vatra të jetës dhe të veprimtarive të përgjithshme shoqërore janë ndër format e para të bashkësisë shoqërore, të krijuara gjatë fazave të gjata e të rënda të zhvillimit shoqëror-historik. Njeriu si individ dhe popullsia si bashkësi specifike njerëzish, me jetën dhe veprimtarinë e tyre, lidhen për territore të caktuara, me qëllim që me aftësitë e tyre fizike, mendore e materiale ta shfrytëzojnë dhe organizojnë jetën. Ndërsa bërthamat e jetës e të punës së përhershme të tyre në këto territore (vendbanimet) lidhen me popullsinë. Krijimi dhe zhvillimi i këtyre asociacioneve të para të njerëzve pra varet nga popullsia dhe nga numri dhe përbërja e caktuar e saj. Në anën tjetër, ndikim të konsiderueshëm në këtë drejtim kanë luajtur një varg faktorësh të bazës natyrore dhe të nivelit të zhvillimit ekonomik, shoqëror, historik dhe kulturor të njerëzimit.¹⁷

Pas revolucionit bujqësor, civilizimet e para paraqiten në Egjipt (rreth 6.000 vjet para epokës sonë), në Mesopotami (rreth 5.400 vjet), në Kinë (3.400 vjet), pastaj në Greqi (rreth 3.000 vjet p. e. së re) etj., të cilat besohet se për rrethanat e atëhershme ishin dëndur të banuara.

"The Modern Expansion of World Population", në *Proceedings of the American Philosophical Society*, Vol. III, No 3, 1967, pp. 137;.

¹⁵ A. M. Carr-Saunders, *World Population*, Oxford University Press, Fair Laun, 1936; W. W. Willcox, *Studies in American Demography*, Cornell University Press, Itaca, 1940; United Nations, *The Determinants and Consequences of Population Trends*, Vol. I, New York, 1973.

¹⁶ C. Clark, *Population Growth and Land Use*, MacMillan, New York, 1967 (tabela III. 1), p. 64.

¹⁷ M. Reinhard, A. Armengaud, J. Dupâquier, *Po aty*, pp. 9-15 e tutje.

Luginat e lumenjve (Nili, Indi, Mesopotamia, Hoangho etj.) njihen si vatra të njohura kulturore dhe popullative, ku bujqësia e ngulitur dhe punimi i tokës ishin veçori themelore të ekonomizimit dhe të mënyrës së jetesës. Këto janë edhe vatrat e zgjerimit të ekumenës në fazat e mëvonshme të zhvillimit të njerëzimit. Në kohën antike, në vatrat kulturore dhe popullative, në Kinë, në Egjipt, në Mesopotami, në Perandorinë Romake etj., edhe pse jo të plota, janë bërë disa regjistrime të kategorive të caktuara të popullsisë (ushtarët, robërit, obliguesit e tatimeve etj.),¹⁸ sikundër edhe në Evropën mesjetare dhe në Perandorinë Otomane është regjistruar popullsia, ku njësia themelore statistike ka qenë shtëpia ose oxhaku, ndërsa regjistrimet kadastrale turke (defterët) ofrojnë jo vetëm të dhëna demografike, por mundësojnë edhe rikonstruimin e gjendjes sociale dhe ekonomiko-juridike.¹⁹

Progresi i ngadalshëm demografik dhe shkaqet e tij

Nga demografia historike mësojmë se në epokën e egërsisë, ku bazë ekzistenciale e jetës ishte mbledhja e frutave të gatshme (në formën që i jepte natyra) dhe gjuetia e peshkimi, mortaliteti ishte tepër i lartë, mesatarja e jetës së të posalindurve shumë e ulët, kurse rritja demografike rezultonte të ishte tepër e kufizuar. Studiusit e procesit të transicionit të jetës nga ajo tradicionale në atë terciare theksonin se "në epokën tradicionale vdekja ishte në qendër të jetës, sikurse që ishte varri në qendër të fshatit".²⁰ Normat e lindshmërisë dhe të

¹⁸ M. Reinhard, A. Armengaud, J. Dupâquier, *Po aty*, pp. 9-38.

¹⁹ Shih defterët e Perandorisë Osmane, të deshifruara e të studiuara nga autorët boshnjakë dhe shqiptarë: H. Hadžibegić, A. Handžić, E. Kovačević, *Oblast Brankovića - opširni katastarski popis iz 1445 godine*, Sarajevo, 1972; A. Handžić, "Nekoliko vijesti o Arbanasima na Kosovu i Metohiji sredinom XV vijeka", *Simpozium për Skënderbeun*, Prishtinë, 1969, ff. 201-209; S. Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI*, Tiranë, 1984, ff. 1-721; S. Pulaha, "Nahija e Altun-ilisë dhe popullsia e saj në fund të shekullit XV", *Gjurmime albanologjike - Seria e shkencave historike*, I-1971, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1972, ff. 193-272; S. Pulaha, "Krahinat verilindore të sanxhakut të Dukagjinit - Hasi dhe popullsia e tyre në gjysmën e shekullit XVI", *Gjurmime albanologjike - Seria e shkencave historike*, II-1972, Prishtinë, 1974, ff. 185-336; M. Tërnavë, "Shqiptarët në qytetet e Kosovës në shekullin XV-XVI", *Studime historike*, 2, Tiranë, 1979, ff. 105-145; M. Tërnavë, *Studime për mesjetën*, Dukagjini, Pejë, 2000, ff. 85-278.

²⁰ J. Fourastié, "De la vie traditionnelle à la vie tertiaire", *Population*, No 3, Institut National d'Études Démographiques, Paris, 1959, p. 418.

vdekshmërisë ishin në nivel shumë të lartë, por midis tyre nuk ekzistonte dallim i madh: shpeshherë në disa pika kohore, madje edhe në periudha të gjata, mortaliteti ishte baras me natalitetin ose, në disa vite e periudha të shkurta, edhe më i lartë. Prandaj shtimi natyror ishte zero ose madje negativ, ndërsa jeta mesatare e të posalindurve sillej rreth 20 vjet, madje edhe nën këtë kufi. Vlerësohet se shkalla e lindshmërisë ishte mjaft e lartë, mirëpo numri mesatar i fëmijëve të lindur gjallë në një grua nuk ishte i madh pikërisht për shkak të jetës së shkurtër të grave, të cilat i përjetonin vetëm disa vite të periudhës së përtëritjes biologjike.²¹

Deri në revolucionin klasik industrial pothuajse nuk kishte dallime në nivelin e lindshmërisë dhe të vdekshmërisë midis vendeve sot të zhvilluara dhe vendeve sot në zhvillim, ndërsa pas kësaj kthese, veçanërisht në shekullin tonë ato do të rriten shumë. Konsiderohet se në kushtet e moszhvillimit të përgjithshëm normat e natalitetit dhe të mortalitetit silleshin deri në kufijtë e tyre fiziologjikë, midis 50 dhe 80 promilë.²² Mirëpo, sjellja riprodhuese deri në këto norma fiziologjike nuk ka mund të mbahej për një kohë të gjatë për arsye të ndryshimeve në strukturën e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë; nataliteti fiziologjik gjithnjë është dhe funksion i këtyre strukturave biologjiko-demografike.

Si faktorë kryesorë të përparimit të ngadalshëm demografik deri në kohën moderne është pra vdekshmëria e lartë si pasojë e sëmundjeve endemike dhe epidemike²³ e viteve jo të frytshme, thatësive, vërshimeve, urisë, luftërave të shpeshta etj.²⁴ Në rrethana të tilla shkalla e lindshmërisë duhej të ishte patjetër shumë e lartë. Mirëpo njohësit e rrethanave historiko-demografike theksojnë se përveç vdekshmërisë së lartë, në shkallën e latë të lindshmërisë kanë ndikuar edhe faktorët e tjerë si përcjellës iskonikë të pjesës dërmuese të njerëzimit: lufta për ekzistencë jo vetëm deri në revolucionin bujqësor, por edhe gjatë epokës "agrarë" kërkonte më tepër fëmijë si krah të punës (mbledhës të frutave, gjuetarë e peshkatarë dhe bujq e

²¹ D. Breznik, *Demografija (Analiza, metodi i modeli)*, CDI, IDN, Beograd, 1977, f. 58.

²² United Nations, *The World Population Situation in 1970*, New York, 1971, p. 6.

²³ Ndër sëmundjet epidemike të kohës paraindustriale, që merrnin jetëra të shumta të njerëzve, njiheshin murtaja, lia, kolera, tifoja, malaria, tuberkulozi, dizenteria etj. Ndër këto sëmundje, veçanërisht deri në shek. XVII, duket se murtaja bënte kërdinë më të madhe në popullatën e të gjitha moshave (M. Livi Bacci, "Définition des crises de mortalité: théorie, pratique, méthodes", *Prilozi demografskim i ekonomskim naukama*, SANU, Knj. 103, Beograd, 1994, pp. 74, 79).

²⁴ A. Armengaud, *Démographie et sociétés*, Stock, Paris, 1966, pp. 13-43.

blegtorë). Periudha e gjatë e civilizimit agraro-blegtoral, e bazuar në mënyrën ekstensive të shfrytëzimit të të mirave natyrore, kërkonte familje të tipit të zgjeruar.²⁵ Për këtë periudhë, për shkak të pasigurisë së përgjithshme ekzistenciale, në shumë mjedise gjeografike dhe bashkësi etnike e konfesionale janë krijuar edhe legjenda të ndryshme lidhur me jetën dhe vdekjen.

Gjendja e stagnimit demografik zgjat deri në periudhën e zbulimeve të mëdha gjeografike. Në Evropën mesjetare, p. sh., derisa nuk ishin sjellë kulturat e reja nga "Bota e Re" (misri dhe patatja) mortaliteti i lartë ishte në lidhje të ngushtë me urinë.²⁶ Pas këtyre zbulimeve, me gjithë ngadalësimin në ritmin demografik, si pasojë e mungesës së ushqimit (midis viteve 1600 dhe 1700 në Evropë shënohen 34 vite jo të frytshme) dhe sëmundjeve epidemike,²⁷ vërehet një rrjedhë e ndjeshme e zgjimit demografik dhe në periudhën prej vitit 1650-1750 popullsia e botës rritet për 44%, ndërsa në periudhën prej 1750-1800 shënohet një zvogëlim relativ (rritja për 25%); për një shekull e gjysmë popullsia e botës rritet vetëm përreth 80% dhe mesatarisht rreth 4,5 promilë në vit. Sipas vlerësimit të disa autorëve të njohur si studiues të zhvillimit të popullsisë në botë, popullsia e botës numerikisht ka stagnuar, duke shënuar rritje nga rreth 260 milion banorë në fillim të epokës sonë në 280 milion në përfundim të shekullit X (viti 1000).²⁸ Për 10 shekuj popullsia e botës, pra, ka stagnuar.

Migrimet e jashtme dhe krijimi i diasporave

Ndër tipet e rëndësishme të migrameve të popullsisë janë migrimet e jashtme, të njohura si migrame ndërkombëtare, që zhvillohen midis vendeve, pastaj brenda kontinenteve (intrakontinentale) dhe midis kontinenteve (interkontinentale). Migrimet e jashtme kanë një historik të gjatë dhe janë shumë më të ndërlikuara se migrimet e brendshme (brenda një shteti), më të shtrenjta, zhvillohen në distanca më të gjata hapësinore dhe bartin

²⁵ M. Rašević, "Kretanje stanovništva sveta sa osvrtom na modernu epohu", *Ekonomika misao*, nr. 3, Beograd, 1974, f. 116.

²⁶ M. Reinhard, A. Armengaud, J. Dupâquier, *Po aty*, pp. 108-173.

²⁷ J.-N., Biraben, *Les hommes et la peste*, Mouton, Paris, 1976.

²⁸ C. Clarc, *Population Growth and land Use*, MacMilan, New York, 1967, p. 64.

pasiguri dhe rreziqe të ndryshme.²⁹ Këto migrame janë intensifikuar gjatë dhjetë shekujve të fundit dhe veçanërisht pas zbulimeve të mëdha gjeografike dhe kolonizimit të "botës së re", kur migrimet e bashkësive etnike, raciale e gjuhësore morën përmasa të gjera dhe pasqyra etniko-demografike e ekumenës sonë pësoi ndryshime të mëdha, të cilat u shpejtuan me revolucionin teknik dhe zhvillimin e komunikacionit, si dhe me ndryshimet e mëdha në sferën materiale.³⁰ Përveç faktorëve ekonomikë, në lëvizjet migruese ndërkomëtare kanë ushtruar ndikim edhe determinantet joekonomike, çfarë janë shkaqet politike, persekutimet etnike, fetare, racore, pastaj motivet individuale-psikologjike, familjare etj. Ndikimin e këtyre faktorëve e gjejmë te shumë popullata në periudha të ndryshme kohore.³¹

Nga historiku i migrameve të jashtme është i njohur fakti se meqenëse zhvillohen në distanca të gjata dhe janë më të shtrenjta, atëherë mjetet e komunikacionit dhe mundësia e blerjes së biletave kanë luajtur një rol të madh, veçanërisht në migrimet përtej oqeanit, në Amerikë dhe në vendet e tjera të "botës së re". Në këtë mënyrë në fazën e parë rëndom e marrin "botën në sy" të pasurit dhe njerëzit e gatshëm për rreziqe. Në anën tjetër, informacioni mbi përparësitë, të metat dhe mënyrën e shkuarjes në botën e jashtme ka një rëndësi të madhe për fillimin dhe masovizimin e procesit.³² Popullata nga territoret dhe vendet që posedon informacione mbi mundësitë dhe përparësitë e shkuarjes në botën e jashtme krijojnë një vetëdije tjetër ndaj "botës së huaj" në raport me popullatën e viseve dhe vendeve të izoluara në pikëpamje gjeografike dhe sociale dhe mbi këtë bazë krijohet edhe tradita e migrimit.³³ Kur emigrimi shkon "from the Know to the Know" (nga e njohura në të njohurën), siç thonë irlandezët, dhe zhvillohet përmes kanaleve farefisnore, fqinjësore,

²⁹ A. Sauvy, *Théorie générale de la population, Volume II, La vie des populations*, Troisième édition entièrement refondue, Presses universitaires de France, Paris, 1966, pp. 250-266; D. J. Bogue, *International Migration, The Study of Population*, The University of Chicago Press, Chicago, 1972, pp. 1-864.

³⁰ Les migrations internationales, CICRED, *Actes du séminaire sur la recherche démographique en liaison avec les migrations internationales*, 5-11 mars, Buenos Aires (Argentina), 1974.

³¹ L. Dollot, *Les migrations humaines*, PUF, Que sais-je?, Paris, 1976, pp. 73-99.

³² P. Klinar, *Mednarodni migraciji*, Založba Obzorje, Maribor, 1976, ff. 15-31.

³³ J. Beaujeu-Garnier, *Trois milliards d'hommes. Traité de démo-géographie*, Librairie Hachette, Paris, 1965, pp. 181-198.

miqësore etj., atëherë bëhet shpejt më masiv dhe pa dyshim më i lehtë.³⁴

Midis migrameve të jashtme dhe formimit të diasporave ekziston një lidhje shumë e ngushtë. Në të vërtetë, pa këtë tip të migrameve nuk mund të ketë as formim të diasporave. Në formimin e diasporave (fjala diasporë do të thotë shprishje, shkepje, shpërndarje, shkapërderdhje), siç dihet, ndikim të drejtpërdrejtë kanë migrimet e popullsisë dhe më konkretisht migrimet e jashtme definitive, si dhe migrimet e jashtme të përkohshme, të nxitura nga një varg motivesh të braktisjes së vendlindjes. Gjatë historisë pjesëtarë të shumë popujve, të grupeve racore dhe etnike për arsye ekonomike, politike, etnike, racore, religjioze etj. janë ndarë nga trungjet e tyre të para etniko-gjeografike, duke u vendosur larg tyre, madje edhe në kontinentet e tjera.³⁵ Shprishje të mëdha të popujve ndodhën që nga koha e invadimeve të fiseve barbare, që njihen si dyndje të mëdha të popujve (gjysma e shek. IV deri në gjysmën e shek. VII) dhe lidhen me kalimin nga jeta endacake në jetën e ngulitur dhe aspiratat për përvetësimin e territoreve të pushtuara me dhunë dhe luftëra.³⁶

Procesi i formimit të diasporave lidhet ngushtë edhe me pushtimet e mbretërive të mëdha dhe zgjerimin territorial të tyre, pastaj me konfliktet midis shteteve e kombeve dhe konfesioneve të tyre, me lidhjet migruese midis vendeve evropiane dhe vendeve “të botës së re” në kohën moderne, si dhe me zgjerimin e njerëzimit përmes procesit të migrameve në përgjithësi dhe ndryshimin e hartës popullore të botës.³⁷ Pas zbulimeve të mëdha gjeografike pasojnë pushtimet dhe popullimet

³⁴ Shembulli i Irlandës flet shumë në këtë drejtim. Ky vend paraqet një fenomen në migrimet e jashtme, ku sëmundja e patates, si burim i ekzistencës së popullatës, shkaktoi uri të madhe në vitet 1846-1851 dhe lidhur me të dhe emigrimin masiv në Amerikë. Si pasojë e shpërnguljes, qysh në gjysmën e dytë të shek. 19 Irlanda kishte më shumë banorë se që ka sot dhe, së bashku me pasardhës, ka më shumë irlandezë jashtë shtetit kombëtar! Emigrimin e mundësoi edhe pozita e saj gjeografike-komunikative (anijet) dhe në fazën e parë të emigrimit prinë të pasurit, të cilët kishin mundësi të blerjes së biletavë etj. (J. Serriere, “Evolution recente de l’émigration irlandaise”, *Population*, INED, No 1, Paris, 1965, pp. 225-237).

³⁵ M. Reinhard, A. Armengaud, J. Dupâquier, *Po aty*, pp. 439-472; M. Sorre, *Les migrations des peuples (Essai sur la mobilité géographique)*, Flammarion, Paris, 1955, pp. 9-18;

³⁶ L. Dollot, *Les migrations humaines*, PUF, Paris, 1976, pp. 11-33.

³⁷ W.-H. McNeill (sous la direction de), *Human Migration – Patterns and Policies*, Londres, Indiana University Press, 1978, pp. XVIII-442; L. Dollot, *Po aty*, pp. 13-24.

e kolonizimet e tokave të reja nga evropianët në gjithë kontinentin amerikan, pastaj në Australi, Zelandë të Re, në Afrikën e Jugut dhe lidhur me to dhe ndryshimet ekonomike, sociale, kulturore, etnike, gjuhësore etj.³⁸ Emigrimet e vullnetshme të evropianëve (Irlanda, Britania e Madhe, Gjermania, Spanja, Italia, Suedia, Norvegjia, Polonia etj.) bëhen më masive në historinë e migrimeve nga fillimi i shekullit 19 deri në vitet e 30-ta të shekullit 20. Kështu në periudhën 1820-1930 midis 55 dhe 60 milion njerëz nga vendet evropiane emigrojnë në vendet e “botës së re” (SHBA, Brazili, Argjentina, Kanadaja, Australia e Zelandë e Re, si dhe Republika Jugoafrikane). Prijnë imigrantët në SHBA, ku në periudhën 1820-1950 legalisht hynë rreth 40 milion njerëz (83% nga Evropa) dhe në periudhën 1950-1990 edhe rreth 15 milion të tjerë nga gjithë bota.³⁹ Në vitin 1850 p. sh. vetëm rreth 12% e popullsisë kishte lindur në SHBA, ndërsa pjesa tjetër në Evropë (52% në Irlandë, 18% në Angli e Skoci dhe po aq në Gjermani dhe në vendet e tjera). Rreth vitit 1800 në SHBA kishte vetëm rreth 4 milion të bardhë, ndërsa në Australi në vitin 1840 kishte më pak se 200.000 evropianë dhe vetëm 2.000 të tillë në Zelandën e Re.⁴⁰

Përkundër ardhjeve të mëdha në SHBA të bashkësive popullative me përkatësi etnike, gjuhësore, ndjenja fetare dhe kulturë tjetër nga popullsia vendëse, megjithatë kazani i pamëshirshëm asimilues amerikan (Melting Pot) të gjithë imigruesit i ka bërë “me vullnet” amerikanë, duke iu nënshtruar identitetit dhe parimeve demokratike amerikane. Imigruesit kanë mund të hyjnë dhe të sillen në SHBA vetëm si individë, pa të drejta të bashkësive etnike, me të drejta kolektive. Në qendrat e mëdha urbane të SHBA-së ka të përqendruara masa milionëshe popullative, me përkatësi të ndryshme etnokulturore, çfarë është rasti me italianët, me kinezët etj. në Nju-Jork dhe në qytete tjera.

Në këtë mënyrë janë formuar diasporat historike dhe bashkëkohore, të vogla ose të mëdha, të shumë popujve, përfshirë edhe

³⁸ M. Reinhard, *Histoire de la population mondiale, 1700-1948*, Domat-Montchrestien, Paris, 1949.

³⁹ L. Bouvier-R. Gardner, “Immigration to the U. S.: The Unfinished Story”, *Population Bulletin*, 1986; P. Stalker, *Workers Without Frontiers, The Impact of Globalization on International Migration*, Lynne Rienner Publisher, 2000; I. Nejašmić, *Demogeografija (Stanovništvo u prostornim odnosima i procesima)*, Š. knjiga, Zagreb, 2005, ff.138-143.

⁴⁰ H. Jones, *Population geography*, Paul Chapman Publishing, London, 1990; I. Nejašmić, Po aty., ff. 138.

diasporën shqiptare.⁴¹ Migrimet si përcjellës permanent në evolucionin e njerëzimit dhe, lidhur me to, krijimi i diasporave, lanë gjurmë të rëndësishme në jetën e popujve, të grupeve të ndryshme të popullsisë, të familjeve dhe të individëve.⁴² Njëra nga pasojat më të mëdha është edhe përzierja racore e popullsisë, veçanërisht në SHBA, me sjelljen me dhunë të robërve nga Afrika Perëndimore nga fundi i shekullit 17 deri në gjysmën e shekullit 19. Është kjo tregtia më e madhe me njerëz: robërit shiteshin si fuqi punëtore për t'u punësuar në minierat dhe plantazhet e vendeve të “botës së re”, nga puna e të cilëve janë realizuar profite të mëdha. Vlerësohet se në periudhën 1783-1793 rreth 300.000 robër nga Afrika në Amerikë u sollën me anijet britanike (nga Liverpuli dhe Bristol).⁴³ Ndërkaq, deri në gjysmën e shekullit 19 rreth 15 milion robër u importuan nga Afrika në vendet e “botës së re”. Pasoja tjetër e deportimit të robërve është demografike: shpopullimi i Afrikës Perëndimore dhe efekti tjetër sociokulturor e politik është diskriminimi racor, si një nga problemet kryesore të brendshme të SHBA-së nga themelimi i tyre si shtet e deri në ditët tona.⁴⁴

Pas Luftës II Botërore në botë ndodhën ndryshime të mëdha ekonomike, sociale, politike, kulturore etj., natyrisht më shumë në vendet e zhvilluara, por edhe vendet e pazhvilluara dhe në vendet dhe rajonet në zhvillim. U intensifikua edhe mobiliteti hapësinor dhe social i popullsisë dhe i fuqisë punëtore, proces ky që e përshkon tërë botën bashkëkohore, me specificitete për çdo mjedis sociokulturor. Edhe pse lëvizja hapësinore e popullsisë në kërkim të punës është relativisht e vjetër, e manifestuar në një formë të caktuar dhe në shoqërinë agrare dhe veçanërisht në vendet e zhvillimit të hershëm të kapitalizmit dhe të akumulimit të kapitalit, migrimi me këtë motiv (të punës) qenësisht dallon nga çdo mobilitet i mëparshëm. Dallimet vërehen si në vëllimin dhe dinamikën, ashtu edhe në strukturën, motivet që e nxisin, drejtimet e lëvizjes dhe veçanërisht pasojat që dalin nga ky proces. Por pa marrë parasysh këto dhe dallimet e tjera, në lëvizje të tilla hapësinore-sociale faktori kryesor dhe i përbashkët paraqitet baza ekonomike.⁴⁵

⁴¹ H. Islami, “La diasporas d’un peuple méditerranéen: le cas des Albanais”, *Peuples Méditerranéens*, N0 15, Avril-Mais, Paris, 1981, pp. 73-84.

⁴² P. George, *Les migrations internationales*, PUF, Paris, 1976, pp. 1-232.

⁴³ M. Friganović, *Demogeografija (Stanovništvo svijeta)*, Školska knjiga, Zagreb, 1990, f. 162.

⁴⁴ R. Appleyard, *International migration: Challenge for the Nineties*, IOM, Genève, 1991.

⁴⁵ M. Oliveira-Roca, *Cirkulacija radne snage*, Institut za društvena istraživanja Sveučilišta u Zagrebu, Zagreb, 1987, pp. 1-377.

Në kohën më të re, përveç lëvizjes së fuqisë punëtore nga imperativi ekonomik në kuptimin më të gjerë brenda shtetit, janë paraqitur lëvizjet migruese të popullsisë dhe të fuqisë punëtore jashtë kufijve shtetërorë, të njohura si migrime të jashtme ose migrime ndërkombëtare. Përveç tensioneve të krijuara në botë e konfrontimeve në relacion perëndim – lindje ose SHBA – BRSS si pasojë e krijimit të blloqeve dhe mbi këtë bazë të “luftës së ftohtë”, brenda kontinentit të vjetër, Evropës, nisën lëvizjet migruese në drejtim të vendeve dhe territoreve të pazhvilluara në vendet dhe territoret e zhvilluara. Këto lëvizje masive migruese janë të njohura si lëvizje të lira ekonomike ose migrime të fuqisë punëtore si indikator i rëndësishëm i shkallës jo të njëjtë të zhvillimit ekonomik e shoqëror, në një anë, dhe zhvillimit demografik, në anën tjetër, midis vendeve industrialisht të zhvilluara dhe vendeve ekonomikisht të pazhvilluara. Masa të konsiderueshme të kontingjentit të punës nga tri pjesë të Evropës së pazhvilluar (Siujdhesa Pirineje: Spanja dhe Portugalia; Siujdhesa Apenine: Italia, veçanërisht pjesa jugore e saj dhe Siujdhesa Ballkanike: Greqia; ish-Jugosllavia) dhe nga Turqia iu drejtuan vendeve të Evropës Perëndimore, Qendrore dhe Veriore, industrialisht të zhvilluara, me deficit të fuqisë punëtore dhe mundësi të mëdha për punësim në ato degë dhe profesione që i refuzonte punëtori i vendit.

Nga vendet eksportuese të fuqisë punëtore merrnin pjesë kryesisht zonat ruralo-agrare, me suficit të fuqisë punëtore. Ky tip i migrimeve brenda Evropës mori hov këto pesë dekadat e fundit dhe atë jo vetëm për shkak të disproporcionit midis zhvillimit të hovshëm ekonomik dhe rritjes demografike, por edhe për arsye të tejkalimit të mosmarrëveshjeve dhe normalizimit të raporteve politike midis vendeve evropiane. Një numër jo i vogël i këtyre punëtorëve, më vonë, pas një situimi, i sjellë edhe anëtarët e familjes në vendet imigruese, si fillim i formimit të diasporave të reja. Bashkësia Ekonomike Evropiane (Franca, Italia, Gjermania Federale dhe vendet e Beneluksit) që nga formimi në vitin 1957 kishte paralajmëruar “qarkullimin e njerëzve, të shërbimeve dhe të kapitalit”, ndërsa në vitin 1970, kishte proklamuar “qarkullimin e lirë të punëtorëve” brenda gjashtëshes evropiane dhe jashtë saj.⁴⁶ Deri në vitin 1974 brenda BEE-së, përfshirë edhe Zvicrën, kishin hyrë tashmë rreth 12 milion punëtorë të huaj dhe anëtarë të familjeve të tyre.⁴⁷

⁴⁶ H. Çelik, Les travailleurs immigrés parlent, *Les Cahiers du Centre d'Etudes Socialistes*, No 94-95, Paris, 1969, p. 9 e tutje.

⁴⁷ Hommes et Migrations, Documents No 856/1974, p. 4.

Zhvillimi industrial dhe teknologjik i vendeve imigruese u diktoi kushtet e punësimit vendeve imigruese. Punëtori i huaj u detyrua ta pranojë atë vend të punës të cilin e liroi ose e refuzoi punëtori i vendit. Janë këto kryesisht vende të punës të atyre degëve ekonomike, të cilat kërkojnë mund të madh fizik, çfarë janë ndërtimtaria, metalurgjia e rëndë dhe e zezë, komunaliet, bujqësia etj. Punësimi në këto degë, së bashku me kushtet e tjera jo të përshtatshme për numrin më të madh të punëtorëve (ushqimi, banimi, puna jashtë orarit të punës etj.), është një goditje për kondicionin fizik të punëtorit dhe pasojat e emigrimit ekonomik janë të mëdha dhe afatgjate për vendet eksportuese të fuqisë punëtore. Punëtorët e huaj detyrimisht janë banorë të qyteteve dhe paralgjeve të tyre, si dhe të zonave urbane apo edhe suburbane, meqenëse vendet e punës të degëve të përmendura gjendet në këto territore, ku formohen aglomeracione të veçanta etnike, kulturore, sociale etj. Procesi i urbanizimit këtu është i pakontrolluar dhe stihik, i karakterizuar me ndërtime “të egra”. Në një mënyrë të huajt, punëtorët dhe familjet e tyre, janë futur në geto, të diskriminuar në pikëpamje sociale, kulturore, infrastrukturore etj. Në fazën e parë të ardhjeve, imigrantët e punës janë vendosur në ndërtesa të improvizuara, në baraka, në objekte të braktisura, në kazerma të vjetra etj.⁴⁸

Sa i përket strukturës sociodemografike, “proletariati” jashtë atdheut që nga fillimi i shkuarjes në vendet e huaja i përket moshës së re, biologjikisht të shëndoshë, kryesisht i gjinisë mashkullore, i kualifikuar ose i rikualifikuar në vendet e punës të shteteve imigruese. Meqenëse tregu i punës së vendeve importuese të fuqisë punëtore është më mirë i organizuar sa i përket kushteve të punës dhe fitimeve të migrantëve, në shtetet e punës vjen edhe një pjesë e fuqisë punëtore, e cila është shumë e nevojshme dhe e domosdoshme për ekonominë dhe shoqërinë e vendeve imigruese. Gjithashtu duhet vënë në pah edhe faktin se në këto lëvizje imigruese të fuqisë së huaj punëtore, në vendet importuese të këtij “proletariati”, përveç dobive të mëdha materiale e financiare, shkaktohen edhe probleme e implikime, të përcjella me ksenofobinë ndaj migrantëve të huaj. Duke ardhur nga një sistem shoqëror dhe kulturor në tjetrin, imigranti i punës bie në konflikt me shumëçka në mjedisin dhe univerzumin e ri, duke u ballafaquar me shumë të panjohura dhe probleme. Vështirësitë e para

⁴⁸ H. Çelik, Po aty, p. 46; O. Rabut, Les étrangers en France, Population, No 3, Institut National d'Études Démographiques, Paris, 1973, p. 625 e tutje; *Bilten*, br.6-7, Centar za istraživanje migracija, Zagreb, 1977; *Bilten*, br. 10, Centar za istraživanje migracija, Zagreb, 1977.

janë mosnjohja e gjuhës dhe e kulturës së vendit imigrues, tradita, strukturimi institucional i shoqërisë, normat ligjore etj. Gjithnjë ndjehet i përbuzur, inferior, i dyshimtë për gjithçka keq që ndodh aty ku ai sillet, i frikësuar se po përcillet në çdo kënd nga sigurimi e policia dhe do të burgoset, do të ndiqet nga vendi, duke mos i ditur as të drejtat e veta për t'u mbrojtur, etj.⁴⁹

Forcimi i lidhjeve tradicionale migruese dhe formimi i diasporave të reja

Në pjesën e dytë të shekullit XX forcohen dhe intensifikohen lidhjet migruese tradicionale midis vendeve evropiane dhe vendeve përtej oqeanit (SHBA, Kanada, Australi etj.) sikundër që bëhet zgjerimi demografik dhe territorial i diasporave tashmë ekzistuese dhe formimi i bërthamave të reja. Humbjet dhe dobitë ekonomike, demografike e të tjera janë të ndryshme për vendet emigruese dhe vendet imigruese. Në këtë drejtim ka dallime edhe midis migrimit të jashtëm definitiv dhe migrimit të jashtëm të përkohshëm. Në tipin e parë më shumë përfitojnë vendet imigruese (imigrantët janë të moshës së re, ekonomikisht aktive, fertile në pikëpamje të riprodhimit, punëtorë të kualifikuar, kuadro krijuese, të prirura për inovacione etj.), ndërsa në rastin e dytë përfitojnë vendet emigruese (punësimi, fitimet, kursimet etj.). Qarqet politike e të tjera që janë kundër migrantëve të huaj, veçanërisht migrantëve ilegalë kritikant e tyre i arsyetojnë me faktin se të huajt po i ngarkojnë fondet sociale dhe shërbimet publike, se kriminaliteti është më i madh te ata sesa te vendorët, se po ua zënë vendet e punës punëtorëve të vendit etj.

Vështruar nga rezoni ekonomik, “*Në literaturën ekonomike migrimi ndërkombëtar është konsideruar përgjithësisht proces pozitiv, i cili ka mundësuar zhvillimin e shumë vendeve sot të zhvilluara, veçanërisht të vendeve përtej oqeanit dhe ka hapur mundësi të reja të punësimit dhe realizimit të fitimeve më të mëdha të miliona njerëzve në botë.* Por pasojat ekonomike dhe shoqërore të migrameve të jashtme duhet vështruar dhe në lidhje me pasojat e tyre demografike, sepse çdo individ, i cili emigron nga një vend dhe imigron në vendin tjetër, bart me vete karakteristikat e tij demografike, ekonomike e të tjera dhe lidhur me të edhe rezultatin e mundshëm prodhues. Migrimet e jashtme, marrë përgjithësisht, janë më të shtrenjta se migrimet e brendshme,

⁴⁹ *Le travailleur étranger*, Paris, 1967; A. Girard, *Attitudes des Français à l'égard de l'immigration étrangère, Population*, No 5, Institut National d'Études Démographiques, Paris, 1971.

kërkojnë shpenzime më të mëdha individuale dhe shoqërore dhe transferojnë me vete investimet e mëparshme të shoqërisë dhe të familjes në edukimin, shkollimin, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale të migrantit. Këto migrime edhe për individin nënkuptojnë një rrezik të caktuar, sepse implikojnë shpenzime materiale dhe pasiguri në suksesin e punësimit dhe të standardit në mjedisin e ri”.⁵⁰

Në kuadër të migrimit ekonomik të fuqisë punëtore, të ofertës dhe të kërkesës për punë, midis vendeve të pazhvilluara dhe vendeve të zhvilluara, të intensifikuara pas Luftës II Botërore, janë migrimet selektive si një veçori e posaçme, përkatësisht lëvizjet migruese të punëtorëve me kualifikime të larta (shkencëtarë, inxhinierë, quadro teknike, mjekë etj.), që njihen si “migrim i truve” (anglisht “brain-drain”; frëngjisht “l’exode des cerveaux”),⁵¹ por që nuk kanë pasur ndikim në fuqizimin demografik të diasporave. Dhe në vend se “migrimi i truve”, përkatësisht transferi i ekspertëve, i dijes dhe i teknologjisë të shkojë në drejtimin vende të zhvilluara – vende të pazhvilluara, ky transfer po ndodh në drejtim të kundërt: nga vendet e pazhvilluara dhe ato në zhvillim “brain-drain” po bartet në vendet me shkallë të lartë të zhvillimit industrial, shkencor dhe teknologjik (SHBA, Kanada, Australi, Zelandë të Re, Evropë Perëndimore etj.), të cilat nga kjo kategori e migrantëve po nxjerrin një “ekstraprofit” joshës. Në fakt, në vendin më atraktiv për migrantët nga gjithë bota, në SHBA, pas vënies së regjimit rigoroz të imigrimit në kuadër të politikës selektive migruese nga viti 1914, ky vend ka zbatuar politikën imigruese “brain-drain”.⁵²

“Migrimi i truve”, përkatësisht “migrimet intelektuale” kanë marrë hov pas viteve të 70-ta të shekullit të kaluar dhe çështja e këtij tipi të migrimeve është trajtuar në hollësi në tubime shkencore

⁵⁰ A. Wertheimer-Baletić, *Stanovništvo i razvoj*, MATE, Zagreb, 1999, f. 323.

⁵¹ Shprehjen “brain-drain” për herë të parë e hasim në Angli. Të parët e përdorën gazetarët e këtij vendi, duke shkruar për fenomenin e shkuarjes së ekspertëve anglezë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (S. Mooney-I. Angell, “Information Technology and the Brain Drain: a Different Perspective”, in *Proceedings of the International Seminar on “Brain Drain Issues in Europe”*, Technical Report No 15, UNESCO – ROSTE, Venice, 1993.

Pas gazetarëve, në vitin 1962 shprehjen “brain-drain” e gjejmë në raportin e Royal Statistical Society, ku, për shkak të masivitetit të këtij tipi të migrimit, kjo shprehje u bë pjesë e terminologjisë shkencore (J. D. Muir, “Should the Brain Drain be encouraged?”, *International Migration*, No 7 (1-2), 1969, pp. 34-50).

⁵² J. D. Muir, *Po aty*; A. Wertheimer-Baletić, *Stanovništvo i razvoj*, MATE, Zagreb, 1999, ff. 309- 310, 324-329.

ndërkombëtare dhe në raste të tjera.⁵³ Për vendet e pazhvilluara dhe ato në zhvillim, si eksportues kryesor i “migrimit të truve” në vendet e zhvilluara, ky tip i migrimit paraqet një humbje të madhe të kapitalit njerëzor. Ndonëse sot, në botën bashkëkohore, qarkullimi i lirë i njerëzve, i mallit, i kapitalit dhe i kuadrove, në këtë rast i ekspertëve, po konsiderohet kërkesë dhe nevojë normale, megjithatë, sipas mendimit të sociologëve, “qarkullimi i lirë duhet të jetë patjetër rrugë dykahëshe, sepse vetëm atëherë mund të konsiderohet dukuri normale, ndërsa brain drain është rrugë njëkahëshe”.⁵⁴

Migrimet e popullsisë për shkaqe gjeopolitike e shtetomëdha⁵⁵ dhe migrimet e të ikurve politike për arsye ideologjike ndodhën pas Luftës I Botërore (ikjet nga Rusia komuniste) dhe pas Luftës II Botërore (ikjet nga vendet socialiste përkundër ndalimit nga regjimi i ri). Migrantët shkonin në drejtim të Evropës së zhvilluar dhe demokratike, si dhe drejt vendeve përtej oqeanit. Migrimet e këtij lloji u intensifikuan edhe pas rënies së Murit të Berlinit dhe përfundimit të “luftës së ftohtë” në fillim të viteve të 90-ta të shekullit XX, kur nga vendet ish-socialiste (Evropa Qendrore dhe Lindore, përfshirë ish-BRSS) një numër i madh i njerëzve emigroi në vendet perëndimore të Evropës dhe në SHBA e Kanada.⁵⁶ Konfliktet politike dhe luftërat në ish-Jugosllavi në vitet e 90-ta të

⁵³ *Les migrations internationales, CICRED, Actes du séminaire sur la recherche démographique en liason avec les migrations internacionales*, 5-11 mars, Buenos Aires (Argentina), Mars 1974; P. Visaria, The Determinants of “Brain Drain”, Proceedings of a Seminar Demographic Research in Relation to International Migration, Buenos Aires, March, 1974; J. Bhagwati, The Reverse Transfer of Thechnology (Brain Drain): International resource flow Accounting, Compensation, Taxation, UNCTAD, Geneva, 1978.

⁵⁴ J. Županov, “Gubitak ljudskih resursa i kulturnog kapitala zbog iseljavanja”, *Nacionalni program demografskog razvitka*, Ministarstvo razvitka i obnove, Zagreb, 1997, f. 104.

⁵⁵ Sipas Traktatit të Llozanës të vitit 1923, i mbështetur nga fuqitë e mëdha, u bë këmbimi i popullsisë greke dhe turke midis Turqisë dhe Greqisë (1,5 milion njerëz në dy drejtime), që nuk mbeti pa u përcjellë me dhunë dhe viktima në njerëz, pastaj këmbimi i bashkësive myslimane dhe hinduse në vitin 1947 midis Pakistanit dhe Indisë (rreth 17 milionë njerëz në dy drejtime), rasti i shpërnguljes së arabëve nga pjesët e Palestinës së atëhershme më 1948, kur u krijua shteti izraelit: ikën rreth 700.000 arabë për t’u zëvendësuar me afër 1 milion çifutë. Rreth 9 milion gjermanë menjëherë pas përfundimit të Luftës II Botërore, pas kapitullimit të Gjermanisë së Hitlerit, për shkak se kishin bashkëpunuar me regjimin nacist, nuk kishin rrugë tjetër pos t’i braktisnin vendet e Evropës Lindore, gjë që kaloi pa reagime në botë.

⁵⁶ UN, Economic Commission for Europe, *International Migration in Central and Eastern Europe and the Commonwealth of Independent States*, Economic Studies, no 8, Geneva, 1996.

shekullit XX, të nxitura nga hegjemonizmi serbomadhi në përpjekjet për të krijuar Serbinë e Madhe, shkaktuan tragjedi të mëdha njerëzore e materiale dhe shpërngulje të dhunshme masive të popullatave kroate, boshnjake dhe shqiptare, në një anë, dhe të serbëve jashtë Serbisë, në anën tjetër.⁵⁷

Në anën tjetër, zgjerimi i Bashkimit Evropian në fillim të shekullit XXI, kryesisht drejt lindjes (në muajin maj të vitit 2004 u bënë anëtare të BE-së Polonia, Hungaria, Çekia, Sllovakia, Sllovenia, Lituania, Letonia, Estonia, Malta dhe Qipro), përcillej nga një frikë pikërisht për shkak të imigrimit masiv të njerëzve nga vendet e lindjes në vendet e UE-së, përkatësisht të destabilizimit të tregut të punës në këto të fundit.⁵⁸ Në këtë zgjerim të UE-së vërehet dhe një paradoks, sepse Unioni në një anë hapet, por në anën tjetër mbyllet. Mbyllja ndaj disa vendeve kushtëzohet kryesisht nga domosdoshmëria që rrjedhat migruese të vihen nën kontroll. Prandaj edhe kushtet dhe kriteret për integrimin e vendeve të reja në Bashkimin Evropian, veçanërisht të vendeve të Ballkanit Perëndimor gjithnjë po ashpërsohen (në vitin 2013 u anëtarësua vetëm Kroacia, të tjerat duhet të presin!).

Hivzi ISLAMI

MIGRATIONS ABROAD, ETHNICAL ASPECT AND CREATION OF DIASPORAS

Summary

It is a known fact that the migrations of the population have played a very important role in the general demographic and social evolution of mankind, first of all in the expansion of ecumena, change of the structure of population and consequently change of the map of the populations of the world. In this regard, a crucial role was played by migrations abroad, also known as international migrations respectively migrations between countries, then within continents and between continents. These migrations have a long history and they are much more complicated than internal migrations (within a country); they are more expensive

⁵⁷ Kolonat e të përndjekurve dhe të refugjatëve kroatë për shkak të agresionit të luftës i shohim më së pari në Kroaci, nga Sllavonia Lindore dhe Vukovari me rrethinë (A.W.-Baletić, *Stanovništvo Vukovara i vukovarskog kraja*, Nakladni zavod Globus, Zagreb, 1993).

⁵⁸ A. De Tinguy, "L'élargissement à l'est de l'Union, un nouveau défi pour l'Europe réunifiée", *Hommes et migrations*, No 1230, Paris, 2001, pp. 5-19; J. Widgren, "Les politiques de la prévention de la migration illégale et du trafic de migrants", *Hommes et migrations*, No 1230, 2001, pp. 20-31.

and in long distances and consequently they are followed by different uncertainties and risks; they have been intensified in the past ten centuries, in particular, after important geographical discoveries and colonization of the “New World” when migrations of ethnic, racial and linguistic communities took further dimensions. Meanwhile, the ethnic-demographic structure of our ecumena underwent huge changes which were accelerated by technical revolution and traffic development as well as huge changes in the material sphere. In addition to economic factors, the international migration movements also were influenced by non-economic determinants, like political causes, ethnic, religious, racial persecutions, then individual psychological and family motives, etc. We can notice the impact of these factors on populations during different periods of time.

There is a close tie between migrations abroad and creation of diasporas. No diasporas could be created without this type of migrations. The migrations of population had as a direct outcome the creation of diasporas, more concretely permanent migrations abroad as well as temporary migrations which were caused by a number of motives to leave the place of birth. In this way, there have been created historical and modern diasporas, small or big ones, of many nations, including the Albanian diaspora.

The process of creation of diasporas is closely connected with occupations of large kingdoms and their territorial expansion, then with conflicts between countries and nations and their religions and migrating ties between European countries and the countries of the “New World” in modern time. Important geographical discoveries were followed by occupations, population and colonization of new lands by Europeans especially in the American continent, then in Australia, New Zealand, South Africa and as a consequence there were economic, social, cultural, ethnic, linguistic changes, too. The voluntary emigrations of Europeans (Ireland, Great Britain, Germany, Spain, Italy, Sweden, Norway, Poland, etc.) became more massive, in particular, in the history of migrations or the period from the beginning of 19th century to the 30-s in the 20th century. In big urban centres of the US there have been concentrated millions of people who had different ethnic and cultural background, like Italians, Chinese, etc. in New York and other cities.

During the second half of the 20th century, the world faced huge economic, social, political, cultural changes, which were, understandably, more present in developed countries but also in undeveloped countries and in the countries and regions which were going through a phase of development. Also, the spatial and social mobility of population and manpower with specifics for each socio-cultural environment intensified. During this period, there have been strengthened and intensified traditional migration ties between European countries and countries beyond the Ocean (USA, Canada, Australia, etc.), but there was also a demographic and territorial expansion of the existing diasporas in parallel with the creation of new nucleuses. There were different economic, demographic and other losses and benefits for countries from which came emigrants and countries which received emigrants.

As regards the migration of manpower due to economic reasons, work offer and demand, between developed and undeveloped countries which have been intensified, in particular, after the Second World War, we can mention selective migrations as a special category, respectively migration of workers with high qualifications (scientists, engineers, technical staff, doctors, etc.), which process is also known as “brain migration”. “Brain migrations” have been intensified during the last century, more concretely after the 70-s, in the undeveloped countries and countries which were going through a phase of development, known also as key exporters of “brain migration” to the developed countries. However, this type of migration presents a great loss of human capital.

Zeqirja BALLATA, Prishtinë

RRUGËTIMI JETËSOR E KRIJUES I KOMPOZITORIT REXHO MULIQI

Rexho Muliqi është murlan i Bjeshkëve të Nemuna Husein Bashiq, shkrimtar

KDU 78.071 (092)

929 (496.51) Mulliqi, Rexho

Abstrakt

Rexho Muliqi, përpos lindjes dhe fëmijërisë në Guci, një kohë të shkurtër si nxënës i Medresesë në Shkup dhe gjatë studimeve në Beograd, tërë jetën e ka kaluar në Kosovë: si nxënës në Gjimnazin shqip të Prishtinës, redaktor-producent në Radio-Prishtinë/RTV-Prishtinë si kompozitor veprash korale, solistike, përpunimesh të këngëve shqipe, veprash vokale-instrumentale, muzikore-skenike në shumicën absolute të rasteve mbi tekste poetësh shqiptarë, si dhe veprave orkestrale-simfonike dhe për teatër e film.

Në veprat e tij muzikore mbizotërojnë fuqimisht elementet melodike, ritmike e metrike, temat, përpunimet e këngëve popullore shqipe. Përgjithësisht në veprat e tij mbretëron një ambient tipik i mjediseve shqiptare. Vepra e tij muzikore është dhe mbetet e lidhur si mishi me thoin me Kosovën, ku ai e kaloi gjithë jetën e tij të bujshme dhe me plot shqetësime; ku e krijoi edhe gjithë opusin e tij muzikor që lidhet me Kosovën. Pavarësisht prapashtesës **-iq** në mbiemrin e tij, nuk është e vështirë të identifikuarit e tij prej mbiemri dhe krijuesi muzikor me rrënjë të qarta shqiptare.

Fjalët çelës: Lindja, shkollimi, pedagog, redaktor-producent në Radio-Prishtinë, kompozitor i lirë në RTV-Prishtinë, krijues muzikor kosovar.

Rexho Muliqi (Guci 1923 - Prishtinë 1982) do të ketë dalë nga një familje e vjetër dhe e njohur edhe sot gjithandej ndër vise shqiptare me mbiemrin Mula(j), i sajuar nga fjala latine mul/us (= mushku), e përvetësuar në shqipe si mul/i (= mushku), në zonën e Krajës e të Anës së Malit edhe në gjininë femërore mul/-a (= mushka), kafshë shtëpiake që kanë shërbyer për ngarkime e bartje në viset kodrinore-malore; mbiemër që është mjaft dendur i pranishëm ndër shqiptarët e Veriut: në Malësinë e Madhe dhe në atë të Dukagjinit, me kalimin e kohës dhe të shpërnguljeve edhe në shumë qytete tona. Përdorimi shpesh i mushkës/mushkut që mbaheshin për nevoja familjare ka ndikuar që ato familje t'i quajnë me këtë toponim edhe si mbiemër familjar.

Mbiemri Mula njihet në disa variante, por pa ndryshim të rrënjes së fjalës, pra Mul/aj, Mul/a, Mul/i, Mul/aku, Mul/**olli** me prapashtesë turke dhe Mul/**iq** me atë sllave -si pasojë e regjimeve jugosllave me prapavi sllavizimi të shqiptarëve. Njihet edhe në trajtë bipatronimike si Mul/osmanaj, Mul/haxhaj etj. Mbiemrin Mula e hasim në Malësinë e Madhe, përfshirë viset e Hotit-Grudës dhe Plavës-Gucisë...: Mul/a (shemb. Çun Mula, bajraktar i Hotit, shek. XIX)¹; në Malësinë e Gjakovës dhe pikërisht në Nikaj në perëndim të Tropojës: fshati Mul/aj dhe mbiemri Mul/aj; në qarkun e Shkodrës: Mul/a; në Tiranë: Mul/a, Mul/osmanaj; në Gjakovë: Mul/a; në Rugovë: Mul/haxhaj; në fshatrat Ceceli, Vilas e Manzaj të Vushtrisë, si dhe në vetë këtë qytet: Mul/aku²; në Prishtinë: Mul/a, Mulaku, Mul/haxha; në Pejë: Mul/haxhaj; në Drenicë, në qarkun e Kaçanikut e gjetiu, diku-diku, siç u tha më sipër, edhe me prapashtesën sllave: Mul/iq në Guci, Muliq në fshatin Ceceli të Vushtrisë, etj.

Fëmijëria, shkollimi, puna

Rexhoja e ka kaluar fëmijërinë si çdo moshatar në një ambient kundërtënie social-e ekonomike e politike në regjimin antipopullor të Jugosllavisë së Vjetër dhe të Re që ushtrohej sidomos ndaj shqiptarëve. Në kushte të tilla e ka nisur rrugëtimin jetësor në bankat e shkollës fillore të vendlindjes, duke treguar zell të mjaftueshëm.

Më pas, si shumë të rinj familjesh përparimtare, është dërguar dhe regjistruar në Medresenë e njohur të Shkupit, të themeluar nga mbreti Aleksandër Karagjorgjeviq për “myslimanët e Serbisë së Vjetër” (= Kosovës), Serbisë së Jugut (= Maqedonisë) dhe të Sanxhakut”, ku jetonin (dhe jetojnë) në trojet e tyre stërgjyshore pjesë të mëdha të popullit shqiptar. Në atë Medrese janë shkolluar dhe shumë nxënës të tjerë familjesh të njohura dhe arsimdashëse, si: Esad Mekuli, Hivzi Sulejmani, Idriz Ajeti, Ramadan Vraniqi, Hilmi Agani, Rifat Burgjeviqi, Vehap Shita e të tjerë. Atje ka treguar interesim për lëndët mësimore, por sidomos për lëndën e muzikës dhe luajtje në violinë, ndonëse nuk ka ngelur pas as nga lëndët tjera. Si nxënës ka marrë pjesë edhe në Demonstratat e 27 marsit 1941 të organizuar në Shkup nga nxënësit e Medresesë dhe për pasojë ka qenë i zënë dhe i dërguar në burgun e Gucisë.

¹ Shih At Gjergj Fishta, Lahuta e Malësisë, këngët XII-XIV, 197-236, Romë, 1958.

² Shih Latif Mulaku, Cecelia dhe banorët e saj, Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave filologjike 36, 2006, 103-124.

Pas lirimit Rexhoja ka ardhur në shtator të atij viti në Prishtinë dhe i ka vijuar mësimet në Gjimnazin shqiptar "Sami Frashëri", duke shprehur prirjen edhe prej muziktarit të talentuar për lëndën e muzikës, instrumentin e violinës, kitarës dhe të trumbetës, si dhe duke formuar "orkestrinë" që e udhëhiqte dhe që për të aranzhonte këngë e marshe që i luanin e i këndonin instrumentistët bashkëgjimnazistë: Gjeto Leka e Hamdi Hysniu - mandolinë, Sedat Dida dhe vetë Rexhoja – violinë bashkë me këngëtarët entuziastë si Jusuf Zherka, Hamit Thaçi, Petrit Dushi, Minir Canhasi e të tjerë. Ka qenë aktivist muzikor dhe në një nga celulatat partiake të Prishtinës, kështu që më 1943 ka shkuar në Tiranë dhe ka marrë pjesë në demonstratat e atjeshme, ku qenë plagosur e vrarë mjaft demonstrues, kurse disa të tjerë qenë dërguar në kampin famkeq të Porto Romanos.³

Gjatë qëndrimit në Tiranë ka marrë pjesë edhe në Konferencën IV të Rinisë Antifashiste në Arbanë – Petrelë dhe i ka mësuar këngët: Dalngadalë po vjen behari, Malet me blerim mbuluar; O punëtorë e punëtore, Rini, rini; Ku kam djalin, ku kam vajzën, Himni i Këshillit Nacional-Çlirimtar, "Avanti popolo" (italiane), Kuq është ku lind e perëndon (ruse, përkthyer dhe e kënduar shqip). Me t'u kthyer në Prishtinë këto këngë i ka aranzhuar për "orkestrinë" dhe këngëtarët e Gjimnazit për t'u paraqitur para prindërve dhe publikut. Më 1944 e ka kompozuar edhe të parën këngë masash *Marshi i Divizionit VI Shqiptar*, divizion i cili pat zhvilluar betejat përfundimtare kundër armikut deri në Vishegrad të Bosnjës, ku qenë vrarë e vdekur nga tifoja mjaft luftëtarë.

Me mbarimin e luftës Rexhoja shkon në Beograd, regjistrohet dhe studion në drejtimin për kompozitor (1945-'49) në Akademinë e Muzikës të Universitetit të Beogradit (klasa e prof. Marko Tajčevićit)⁴. Në këtë kohë nis veprimtaria e tij prej muziktarit profesionist. Por, për fat të keq, buzë përfundimit të studimeve e burgosin studentin gjithsesi të talentuar si informbyroist (!) dhe e dërgojnë në burgun famkeq "Goli Otok".

Pas lirimit është kthyer më 1953 në Prishtinë dhe është punësuar si redaktor muzikor në Radio-Prishtinë. Në vitet 1957-1958 ka qenë pedagog (harmoni, kontrapunkt, kompozim) në Shkollën e Mesme të

³ Nga bisedat e shpeshta të autorit të këtij punimi me kompozitorin Muliqi gjatë fillimviteve të 70-ta; shih dhe: Muzika i muzičari u NOB, Srboštampa, Beograd, 1982, 254-255.

⁴ Zeqirja Ballata, Rexho Muliqi si nxënës, student e pedagog, "Bota e re", 1 mars 1983.

Muzikës në Prizren⁵, por njëkohësisht dhe udhëheqës i Korit të SHKA "Agimi". Gjatë viteve 1959-1969 ka qenë redaktor i muzikës serioze në produksionin muzikor të Radio-Prishtinës, ndërsa gjatë viteve 1970-1982 ishte kompozitor i RTV-Prishtinës. Gjatë gjithë asaj periudhe afro 30-vjeçare kishte aktivitet të dendur e të pandërprerë prej kompozitori, duke iu qasur pothuaj të gjitha gjinive muzikore.

Krijimtaria muzikore

Në *gjininë korale*, përpos Marshit të Divizionit Shqiptar (1944), Rexho Muliqi ka kompozuar shqip dhe serbisht këngë me karakter e përmbajtje revolucionare, si: *Kënga e Republikës*, 27 Marsi 1941, *Mbajmë flamurin e lirisë*, *Demonstrata*, *Këngë për shokët...* Shumica prej këtyre kanë ngelur të panjohura ose kanë humbur partiturat e tyre! Sa i përket përdorimit jo vetëm të gjuhës shqipe e serbokroate, që i njihte, pjesërisht dhe italishtes, Rexhoja - si internacionalist që ishte - ka përfshirë, më pas në veprat e tij, këngë nga më të ndryshmet të karakterit patriotik edhe në gjuhë të tjera: ruse, italiane, etj.

Gjatë viteve të 50-ta aktiviteti i tij krijues u intensifikua në këtë gjini korale. Dy këngë të tilla janë të asaj periudhe që bëhen të njohura dhe këndohen nga ansamblet korale në Kosovë. E para është *Vendi im* mbi tekst të Kolë B. Shirokës për kor të përzier, e kompozuar më 1953 mbi vargje të rimuara që shpreheshin "për vendin e dashur/male dhe detin/çdo gja asht tuj lulzue/Fushat dhe malet, hekurudha e re" etj.⁶ Përmbajtja shprehte, pra, optimizëm të theksuar që i nevojiteshin kohës e cila, pas viteve të 80-ta, si të thuash u rrënua, meqë nuk përkonte me realitetin e përditshëm të popullatës shqiptare. Sidoqoftë, kjo këngë këndohej atëbotë nga koret tona dhe e kryente misionin që e kishte prej kënge mobilizuese. Kënga përbëhet prej dy pjesëve paksa kontrastuese me skemë formale a + b. Pjesa e parë (a) fillon në tërë korin për t'u vijëzuar zërat, pas dy masash (taktesh) melodikisht në mënyrë më të pavarur deri te fillimi i pjesës së dytë (b). Pjesa e dytë e ka rolin e refrenit. Krahasuar me pjesën e parë homofonike (a), në pjesën e dytë (b) pavarësohen linjat e zërave duke u pasuruar me imitime në intervale të ndryshme dhe duke krijuar polifoni të

⁵ Shih: Enciklopedija muzike II, Jugoslavenski leksikografski zavod "Miroslav Krleža", Zagreb, 1974, 626-627.

⁶ Zeqirja Ballata, Krijues që me opusin muzikor ia ngriti vetes përmendoren, "Fjala", 1 prill 1982.

konsiderueshme, pas së cilës arrihet dhe kulmi me përfundim solemn e optimist. Kjo këngë masive me linja të përshtatshme të zërave, harmoni klasike që sillen rreth tonaliteteve të afërta të atij bazë, me formën e qëndrueshme dhe me tematikën e njësuar masive, që bërë e popullarizuar ndër kore profesionale e amatore, pra edhe ndër dashamirë të muzikës korale. Me ndërrimet shoqërore-politike pas viteve të 90-ta të shek. XX, kësaj kënge dhe të tjerave të kësaj natyre iu zbeh mjaft roli, karakteri e përmbajtja ideore-politike. Kështu, rrethanat bënë që mos të vërehet më në repertorin e ansambleve tona korale. Dy prej atyre ansambleve: Korit Profesional dhe Korit të Pionierëve të RTP-së iu që ndaluar përdhunisht puna në fillim të vitit 1990 nga ana e udhëheqjes së dhunshme millosheviqiane.

Kënga tjetër korale ka një shtytje ngulmësisht artistike, sado me mjete melodike-ritmike e harmonike të traditës, ngërthen vlera më të larta, madje edhe në përgjithësi shquhet nga këngët e këtij kompozitori. Kjo është *Vjeshta*, po për kor të përzier, e kompozuar më 1958, kur ishte pedagog në Shkollën e Mesme të Muzikës në Prizren, të cilës edhe i që kushtuar. Teksti i saj poetik, i krijuar nga poeti Rexhep Hoxha, siç mund të kuptohet edhe nga vetë titulli simbolik ngërthen përmbajtje të ndjeshme melankolike-nostalgjike. Kompozitori që në fillim të saj ka vënë në pah këtë atmosferë me temp të ngadalshëm ("Andante", më pas "Piu mosso") duke u shërbyer me ndërrime metrike (6/8, 9/8, 12/8 etj.) dhe me dinamikë të ulët ("p"). Në pasuset e mëpastajme ndryshohet paksa tempi ("Mosso, Meno mosso"), madje edhe mjaft dukshëm ("Allegro") dhe përdoren edhe elemente kontrapunktike, imituese e kanonike me qëllim të shtjellimit më gjerësisht të materialit tematik muzikor. E gjithë kjo vjen duke u potencuar në pasusin vijues, ku bëhet dhe rikthimi në tempin fillestar ("Andante") nëpërmjet të disa modulimeve dhe të intensifikimit muzikor për të përfunduar më pas me një notë po melankolike-nostalgjike. Kjo vepër korale për nga lënda e shtruar muzikore, për nga përpunimi racional, si dhe për nga struktura e formës së bindshme konsiderohet për kohën (1958), mjedisin (Kosovë) ku është kompozuar dhe rrethanat e përgjithshme ekzistuese tejet modeste profesionale, një si margaritar në literaturën tonë korale të viteve të 50-ta⁷.

Në *gjininë solistike-instrumentale* ky kompozitor nuk ka treguar ndonjë afinitet të posaçëm. Mbase nuk i është rrekur aq kësaj gjinie edhe për faktin se në Kosovën e atëhershme, sidomos në dy dekadat e

⁷ Grup autorësh, Leksikon Jugoslavenske muzike 2, Jugoslavenski leksikografski zavod "Miroslav Krleža", Zagreb, 1984, 36-37.

para të pasluftës, kanë munguar shumë solistë instrumentalë. Arsyeja tjetër mund të jetë dhe nevoja e brendshme krijuese e tij që të shprehet, para se gjithash, përmes formave më të mëdha muzikore, siç janë ato vokale-instrumentale, koncertale-simfonike, muzikore-skenike. Dihet mirëfilli se këtyre gjinive të ndërlikuara muzikore iu qe kushtuar më pas, pothuaj gjatë gjithë veprimtarisë së mëtejshme krijuese. Sidoqoftë, dy janë vepra të tij solistike: *Legjenda për violinë e piano* dhe *Elegjia për violonçel e piano*, që të dyja të kompozuar gjatë vitit 1955. Kjo e dyta i është kushtuar poetit Esad Mekuli, i lindur në një mjedis ambientalisht tepër të afërt me atë të kompozitorit Muliqi. Ndërkaq, derisa *Legjenda...* lë përshtypjen e një kompozimi rinor me një fizionomi jo mjaft të formësuar, *Elegjia...*, përkundrazi, si për nga forma e saj e rumbullakuar (a-b-a1), si për nga tematika e zgjedhur muzikore të një ambienti tonë dhe për notat e saj të theksuara nostalgjike sikur na kujtojnë fëmijërinë dhe djalërinë e hershme të tij.

Gjinisë vokalo-instrumentale, përfshirë këtu veprat e kompozuar dhe përpunimet e shumta dhe finesë të këngëve shqipe për solist e orkestër, kor e orkestër apo solist kor e orkestër, Rexho Muliqi iu ka kushtuar kujdesin e merituar. Kësaj gjinie i është qasur me dashuri të veçantë dhe me dorë të sigurt prej profesionisti. Këngën e bukur shqipe me plot larmi metrike-ritmike e melodike, mund të thuhet se jo vetëm e ka dashur dhe njohur, por edhe e ka çmuar dhe ndier në zemër pulsën e saj. Shkrimtari dhe bashkëvendësi i tij, Husein Bashiqi, në 20-vjetorin e ndarjes së Rexhos nga jeta, e pati quajtur "*Murlan i Bjeshkëve të Nemuna*". Sepse ishte i tillë me pamjen si prej kolosi, me qëndrimin e patundur prej stoiku intelektual e internacional, me të shprehurit fjalërrallë prej malësori gucinian, me vendosmërinë për të gjelluar në një mjedis veprimtarësh që nuk i nënshtroheshin krahutave dhe të modës ditore, aq më pak mentalitetit meskin të gjysmintelektualëve prej radhëve të "fahut" muzikor. Prandaj Rexhoja është sjellur në një rreth të ngushtë miqsh intelektualë antillafazanë e antipolitikanë, që e kuptonin si krijues e intelektual dhe e dinin çfarë është arti me format e tij specifike mbi njohjen e botës dhe pasqyrimin e saj në art e që reflektohet nëpërmjet botës së brendshme të krijuesit dhe pikëpamjeve të tij.

Këtë gjini madhore ka nisur kompozitori ta kultivojë rreth viteve të 50-ta, gjini që kërkon përvojë e pjekuri profesionale, qasje serioze, që nënkupton njohje të mirë, përpos korit, edhe të solistëve, si dhe të veglave shoqëruese muzikore ansamblesh e orkestrash. Këto Rexhoja i njihte, duke marrë parasysh se pati studiuar në Beograd, ku kishte pasur mundësi të përcillte literaturën. Veprat e tij vokale-

instrumentale të kompozuara a të përpunuara mbi tekste poetike e popullore kanë qenë të pranueshme përgjithësisht, të njohura dhe artistikisht të përjetuara. Disa i ka sajuar në formë të përafërt me suitën, d.m.th. të renditura në mënyrë ciklike, të tjerat në formë ciklike, por me kontura të përafërta si të kantata për solistë, kor e orkestër dhe me tematikë aktuale e të angazhuar që shprehnin vuajtjen dhe gjakimin për drejtësi, liri shoqërore e kombëtare, tematikë kjo e cila për këtë krah të kombit tonë ishte gjithnjë tepër aktuale. E pikërisht të tillë e të ngjashme përmbajtje ngërthen kantata *Poema për ata* për recitues, soprano, tenor, kor e orkestër, sipas poemës homonime të poetit Fahredin Gunga, e realizuar që në kohën e krijimit të saj më 1959. Në të autori i ka përdorur me mjaft sukses mjetet kompozicionale-teknike të traditës. Në fund të *Poemës...* e ka huazuar dhe një fragment nga poema e njohur simfonike "*Vltava*" e kompozitorit Çek Bedzhih. Smetana (1824-1884), besuar korit e solistëve duke e përmbyllur kështu kantatën me vargjet përfundimtare *Ka me le liria... si* dhe duke e paraqitur bindshëm ambientin impresiv dhe tragjik të *Poemës* homonime të poetit F. Gunga edhe në saje të përmbajtjes sugjestive poetike⁸. Me një pjesë të përmbajtjes, mbase, mund të jetë identifikuar edhe vetë kompozitori, i cili - sado pati qëndruar brenda rrjedhave përparimtare të kohës - nuk e la regjimi "pa e shijuar" (edhe ky) burgun jugosllav. Përdorimi intenzivisht i theksuar i tekstit poetik, besuar recituesit, por dhe solistëve e korit, si dhe përdorimi me shumë simbolikë i prangave si "instrument" në kuadër të aparatit gjithorkestral shprehimisht e pikturojnë ambientin e të burgosurve politikë në Jugosllavinë e pas Luftës II Botërore.

Pos veprës *Kosova* për kor e orkestër frymorësh e vitit 1954, është edhe *Suita e vogël me motive popullore shqiptare* për soprano, kor dhe orkestër, e sajuar më 1957. Këngët janë përzgjedhur dhe renditur me mjaft kontraste. Natyrisht, kjo *Suitë...* është e një dimensionit dhe e një domethënieje dukshëm më modeste krahasuar me kantatën *Poema për ata*. *Suita* përbëhet prej gjashtë këngëve me këtë renditje: Po vijnë krushqit (dasmore, e T. Daisë, por e bërë popullore); Shuj moj bijë; Hajde Shot'-o mashalla (vallëzuese); Zare qitma fesin (beqareske); More çun, çun, çun (djaloshare). Këto e përbëjnë *Suitën e vogël* "të popullarizuar", siç e pati quajtur vetë autori. Kësaj mund t'i përshtatej njësoj mirë edhe titulli *Potpuri këngësh shqipe*. Janë dhe shumë përpunime të suksesshme, mbase më

⁸ Shih: Grup autorësh, Fjalori enciklopedik shqiptar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, 1775.

se 100 për soprano e orkestër apo soprano, kor dhe orkestër, posaçërisht të frymëzuar për këngëtarën Nexhmije Pagarusha. Ja dy prej tyre tejet të njohura: *Lulëzoi fusha, lulëzoi mali* (1959), *Nji lule që m'ka çelë tash* (1961)⁹...

Veç veprës tjetër vokalo-instrumentale me titull “*Smrt heroja*” (*Vdekja e heroit*) për soprano, tenor, kor e orkestër, kushtuar Miladin Popoviqit, Rexho Muliqi e ka kompozuar dhe atë me titull *Baresha* me vlera sublime mbi poezinë e inspiruar buklike të poetit Rifat Kukaj. Përpos përzgjedhjes së tekstit të mrekullueshëm, ka në këtë vepër të pranishëm plot elemente të bollshme melodike-ritmike e metrike të folklorit shqiptar, si dhe intervalelesh të përafërt me ato të hapësirës verilindore që kapin Kosovën, Malësinë e Madhe dhe të Plavë-Gucisë që i ka përdorur me plot frymëzim. Ka dhe shumë kërkesa për zërin solistik, gamë të gjerë vijëzash melodike dhe kërcime intervalelesh nga më të ndryshmet, si dhe shqiptimesh shpesh të rrokjeve, fjalëve që nënkuptojnë përvojë të përkryer nga këngëtarja, ashtu sikundër dhe diapazon të gjerë me intensitet interpretimi. Baresha disponon vlera burimore harmonike dhe ngjyrim orkestrale. Kjo vepër e arrirë është realizuar për herë të parë dhe me shumë sukses, natyrisht, nga sopranoja *Nexhmije Pagarusha*, bashkëpunëtorë në profesion me kompozitorin dhe bashkudhëtarë shpirtërore e tij për disa dekada. Në kantatën me titull *Jugosllavia* për solistë, kor e orkestër (1976) ka përdorur Rexhoja tekste poetësh të ndryshëm dhe ka inkorporuar në të edhe një varg melodish - këngësh revolucionare e të karakterit liridashës, përpos në gjuhën shqipe: *Qenkan mbushur malet me borë* (e kanë përdorë dhe disa kompozitorë tanë të tjerë), *Malet me blerim mbuluar* etj. edhe në gjuhë të tjera e të huaja: *Avanti popolo*¹⁰...

Në *gjinnë orkestrale-simfonike* Rexhoja mbase më së miri i ka shkrirë aftësitë e tij krijuese. Dhe kësaj gjinie të pranishme madhore muzikore ia ka kushtuar me po aq denjësi një varg veprash voluminoze, të rëndësishme në opusin e tij, por që janë me rëndësi relevante edhe për krijimtarinë tonë muzikore gjithëkombëtare. Janë këtu *Simfonia nr. 1* (1954, e pambaruar), *Fantazia për orkestër* e kryer po atë vit; dy vjet më pas është *Pastoralja dhe Vallja* për orkestër (1956), si dhe, pas dy viteve të tjera, *Akuarelet e Prizrenit* për

⁹ Shih: Zeqirja Ballata, Murlani i Bjeshkëve të Nemuna – Në njëzetvjetorin e vdekjes së kompozitorit R. Muliqi, “Koha ditore,” 2002.

¹⁰ Shih: Grup autorësh, Kosova, vështrim monografik, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2011, 561-567.

orkestër hargqesh (1958). Dhe mbi të gjitha është vepra e tij mbase më kulmore *Simfonia nr. 2 "kosovare"* (1971), e mbiquajtur nga vetë kompozitori. Në të e ka të përfshirë, brenda tematikës së përmbajtjes muzikore, edhe këngën e mirënjohur *Qenkan mbushur malet me borë* jo njëherë të përdorur në opusin e tij muzikor.

Sa i përket *gjinisë* së mirëfilltë *muzikore-skenike*, ky kompozitor i është qasur vetëm baletit, ndonëse, siç pati deklaruar me një rast, kishte dëshirë të kompozonte dhe operë. Kështu, ka kompozuar muzikën për dy balete: baletin *Nita* më 1975, sipas dramës së arbëreshit të Zarës Josip Relat¹¹. Dhe nga ky balet janë realizuar deri më tash vetëm fragmente në trajtë koncertale. Dy vjet para ndarjes nga jeta e ka kompozuar dhe baletin tjetër me titull *Legjenda mbi ngadhënjimin* (1980). Në të janë përdorur e shtjelluar, si në mjaft vepra të tjera të tij edhe këngë të ndryshme me tematikë revolucionare e patriotike shqipe të luftës kundër nazifashizmit, si ajo e përmendur më sipër *Qenkan mbushur malet me borë*, pastaj serbe, ndonjë italiane: *Avanti popolo...*, ruse: *Kuq është ku lind e ku perëndon* etj. Baleti *Legjenda mbi ngadhënjimin* është shfaqur me sukses në dhjetor të vitit 1981 nga Ansambli i Baletit të Teatrit Popullor të Kosovës – në 40-vjetorin e Revolucionit.

Kompozitori Muliqi ka kompozuar me shumë sukses edhe *për teatër, film e televizion*: për *teatër* nga autorët shqiptarë e të huaj, si Nita, Besa, Erveheja, Omeri dhe Merima, Halili e Hajria, Rrëfimi i Irkutskes, “Pelino”, Tri motrat, Dundo Maroje, Martesa; për *film*: Kapiten Lleshi, Qerim hesapesh, Uka i Bjeshkëve të Nemuna, Era dhe Lisi; si dhe për *televizion*: Kokë për kokë, Ari i Kosovës (I, II, III), Tubeliu, 117...

Kompozitori Rexho Muliqi është i përfshirë dhe në këta libra, leksikone e enciklopedi: Grup autorësh, Enciklopedija muzike 2, Jugoslavenski leksikografski zavod “Miroslav Krleža”, Zagreb, 1974, 626-627; Grup autorësh, Leksikon Jugoslavenske muzike 2, Jugoslavenski leksikografski zavod “Miroslav Krleža”, Zagreb, 1984, 36-37; Zeqirja Ballata, Gjurmëve të muzës, NGBG “Rilindja”, Redaksia e botimeve, Prishtinë, 1987, 190-200; Rafet Rudi, Sprova estetike, “Dukagjini”, Pejë, 2002, 171-177; Albana Baliu Sopa, Fjalor muzikor enciklopedik, OMSCA-1, Tiranë, 2003, 278; Grup autorësh, Kosova, vështrim monografik, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2011, 561-567; Fjalori enciklopedik shqiptar 2,

¹¹ Shih: Grup autorësh, Fjalori enciklopedik shqiptar 2, Tiranë, 2008, 1775.

Tiranë, 2008, 1775. Në të gjitha këto botime janë autorët dhe bashkëpunëtorët shqiptarë që kanë shkruar për këtë kompozitor.

Po qe se përmbledhet rrugëtimi jetësor dhe krijues i kompozitorit Rexho Muliqi, mund të konstatohet me plot gojën që punktet kryesore stacionare përgjatë gjithë jetës së tij në Kosovë dhe përreth saj, përpos Gucisë si vendlindje, kanë qenë:

- Shkupi (shkollimi në Medresenë e atjeshme);
- Prishtina (shkollimi në Gjimnazin shqiptar "S. Frashëri");
- Tirana (pjesëmarrja në Konferencën IV të Rinisë Antifashiste në Arbanë-Petrelë);
- Prishtina (vazhdimi në Gjimnazin e Prishtinës);
- Prishtina (redaktor/producent në Radio-Prishtinë);
- Prizreni (pedagog në Shkollën e Mesme të Muzikës dhe udhëheqës i Korit të SHKA-së "Agimi");
- Prishtina (redaktor i muzikës serioze në Radio-Prishtinë në vitet 1959-1969);
- Prishtina (kompozitor i RTP-së nga viti 1970 deri në ndarje nga jeta më 1982);
- Beogradi (studimet jo deri në fund, ndërprerja me dhunë dhe burgu në Goli Otok).
- Këto punkte stacionare nuk duket që të kenë qenë të rastit për të. Po kështu, në qoftë se përmbledhet rrugëtimi krijues i cili, gjithashtu, sipas të gjitha gjasave nuk do të ketë qenë rastisje, rezulton me këto fakte:
- Marshin e parë, kompozuar më 1944, e ka quajtur Marshi i Divizionit VI Shqiptar;
- Të dy këngët e njohura korale (Vendi im, Vjeshta) i ka në gjuhën shqipe dhe mbi poezi të autorëve shqiptarë;
- Të gjitha këngët që i ka përpunuar për soprano e orkestër, kor e orkestër apo për soprano, kor e orkestër, i ka në gjuhën shqipe;
- Nga dy veprat solistike për violinë, respektivisht violonçel e piano, njërën ia ka kushtuar poetit Esad Mekuli;
- Nga veprat vokale-instrumentale, kantata *Poema për ata* është e kompozuar mbi poemën e poetit Fahredin Gunga;

- Vepra tjetër vokale-instrumentale, *Suitë* e popullarizuar për soprano, kor e orkestër, është me motive këngësh shqipe;
- *Baresha* për soprano e orkestër është mbi tekst të poetit Rifat Kukaj;
- Veprat orkestrale: *Simfonia nr. 1* e pambaruar, *Fantazia* për orkestër, *Pastoralja* dhe *Vallja* për orkestër, *Suita* “Akuarelet e Prizrenit” dhe *Simfonia nr. 2* “kosovare” gjithashtu përfshijnë elemente ritmike-metrike e melodike nga folklori shqiptar, sikundër dhe melodi popullore, revolucionare, patriotike shqiptare;
- Njëri nga dy baletet, ai *Nita*, bazohet mbi veprën dramatike të poetit arbëresh Josip Relat; ndërsa në baletin tjetër *Legjenda mbi ngadhënjimin* janë përdorur këngë shqiptare, përpos atyre serbe, italiane e ruse;
- Në muzikën për teatër, përpos atyre me tema të tjera, ka shkruar dhe muzikë për veprat e autorëve shqiptarë: Nita, Besa, Erveheja, Halili dhe Hajria;
- Ka shkruar muzikë filmash me tema shqiptare: Kapiten Lleshi, Qërim hesapësh,
- Uka i Bjeshkëve të Nemuna, Era dhe Lisi;
- Edhe te muzika për TV ka përfshirë tema përmbajtjesh shqiptare: *Kokë për kokë*, *Ari i Kosovës*, *Tubeliu*, 117...

Summary

From what was mentioned above, we can undoubtedly conclude that the total opus, in the absolute majority of the musical works of Rexho Mulliqi, is strongly dominated by melodic, rhythmic, and metric elements, and themes from Albanian songs transmitting the typical atmosphere of the Albanian environment. As such, his musical artistic works remain deeply intertwined with Kosova, where, besides his childhood years, he spent all his sensational life full of distress; and where he created all his musical opus. Therefore, regardless of the suffix ‘iq’ in his surname, which was widely added to surnames of Albanians in the early and late Yugoslavia, it is absolutely not challenging to identify this composer, namely his surname, as having clear Albanian roots.

Literatura:

- Ballata, Zeqirja, Krijues që la gjurmë të thella në muzikën tonë, “Rilindja”, shkurt, 1982.
- Ballata, Zeqirja, Krijues që me opusin muzikor ia ngriti vetes përmendoren, “Fjala”, prill 1982.
- Ballata, Zeqirja, Murlan i Bjeshkëve të Nemuna – Në 20-vjetorin e vdekjes së kompozitorit R. Muliqi, “Koha ditore”, 2002.
- Ballata, Zeqirja, Fryma revolucionare në krijimtarinë e Rexho Muliqit, ”Bota e re”, maj 1982.
- Ballata, Zeqirja, Rexho Muliqi si nxënës, student dhe pedagog, “Bota e re”, mars 1983.
- Ballata, Zeqirja, Gjurmëve të muzës, OPGBG “Rilindja, Prishtinë, 1987.
- Ballata, Z. – Spahiu, S., Kulturë muzikore për kl. VII-VIII të shkollës fillore, ETMM i KSA të Kosovës, Prishtinë, 1988.
- Ballata, Zeqirja, Rrjedhave të krijimtarisë muzikore ndër shekuj, “Kosova”, Revistë historike e politike, 7/1999, 19-23.
- Ballata, Zeqirja Ecje/ngecjet dhe synimet në kulturën tonë muzikore, 2003, Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2003, 35-48.
- Berisha, Engjëll, Nismëtar i muzikës artistike në Kosovë, “Koha ditore”, 25. maj 2002.
- Enciklopedija muzike II, Jugoslavenski leksikografski zavod “Miroslav Krleža”, Zagreb, 1974, 626-627.
- Fishta, At Gjergj, Lahuta e Malësisë, Ed. Comm A. Urbinati, Via De’ Bresciani, Roma, 1958.
- Fjalori enciklopedik shqiptar 2, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, 1775.
- Këngë korale revolucionare, Shoqata e Kompozitorëve e Kosovës, Prishtinë, 1984, 5-7, 148-153.
- Kosova, vështrim monografik, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2011, 561-567.
- Mulaku, Latif, Cecelia dhe banorët e saj, “Gjurmime albanologjike”, Seria e shkencave filologjike, 36, 2006, 103-124.
- Muzika i muzičari u NOB, Srboštampa, Beograd, 1982, 254-255.

Pajazit NUSHI

PSIKOLOGJIA DHE INSTITUTEKONALIZIMI I SAJ MËSIMOR-SHKENCOR NDËR SHQIPTARËT

KDU 159.9 (=18)

Abstrakti

Në këtë trajtesë u përpunuan të dhënat, faktet dhe raportet ndërmjet tyre, që kanë të bëjnë me kalimin e mendimit psikologjik prej atij popullor në atë shkencor të tipit institucional. Psikologjia ndër shqiptarët u institucionalizuar në fillim të shekullit njëzet, kur u nda nga filozofia paraprirëse e zhvillimit të psikologjisë. Institucionalizimi i saj nënkupton krijimin e sistemit koherent lidhjesh konceptuale të rregulluara sipas parimeve shkencore për dukurit e proceset psikike, si edhe për format individuale të shumëllojshme të manifestimit të tyre. Institucionalizimi i këtillë i psikologjisë u shënuar në vitin shkollor 1913/1914, kur psikologjia mori statusin e lëndës mësimore të veçantë në Normalen e Elbasanit. Me këtë fillon zhvillimi institucional i mendimit shkencor për dukuritë proceset dhe gjendjet psikike, sepse lënda e mësimi të psikologjisë është modifikim i lëndës shkencore i përshtatur qëllimit, nevojave dhe moshës së nxënësve e studentëve. Ky vit është termini i përbashkët i institucionalizimit të psikologjisë për të gjithë shqiptarët. Tri janë shkaqet kryesore të përbashkësisë së këtij termini të institucionalizimit të psikologjisë. Shkaku i parë: në këtë vit në Normalen e Elbasanit kishte nxënës të ardhur nga të gjitha viset shqiptare, kurse kosovarët e përbënin gjysmën e tyre; shkaku i dytë: nxënësit e kryer të kësaj shkolle zhvilluan lëndën e psikologjisë në shumë vende të shqiptarëve: në Kosovë tre profesorë të pedagogjisë zhvilluan mësimin e psikologjisë në vitin 1941 – 1945 në Shkollën Normale – Liceale “Sami Frashëri” të Prishtinës, kurse pas përfundimit të Luftës II Botërore këtë lëndë e zhvilluan në Normalen e Gjakovës deri nga mbarimi vitit 1950 dy arsimtarë elbasanas; shkaku i tretë: librat e psikologjisë të botuara në Tiranë dhe në Elbasan ishin burime dijenish të para të psikologjisë për nxënësit e shkollave të mesme shqipe në viset shqiptare, ku mësohej psikologjia. Këto shkaqe kanë bërë që të argumentojmë se profesorët dhe mësuesit e kryer të Normales së Elbasanit të konsiderohen vënës të temeleve të zhvillimit institucional të kësaj lënde dhe disipline shkencore në Kosovë.

Institucionalizimi i psikologjisë ndër shqiptarët ka dy veçori themelore: u krye me vonesë prej gati një shekulli e gjysmë pas institucionalizimit zyrtar të saj dhe ky institucionalizim u bë në nivelin e didaktizmit të psikologjisë të konceptuar për nevoja arsimore, edukative dhe shkencore.

Në zhvillimin e institucionalizuar të psikologjisë në Shqipëri dhe në Kosovë ka ushtruar ndikim politika dhe ideologjia e zhvillimit të shqiptarëve në Republikën e Shqipërisë nga përfundimi i dekadës së katërt të shekullit njëzet deri me rrëzimin e sistemit monist. Derisa në Republikën e Shqipërisë psikologjia e asaj kohe zhvillohej mbi bazat e shkollës fiziologjike ruse, në Kosovë dhe në Serbi psikologjia kishte mbështetje në të arriturat në Evropën Perëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pas rrëzimit të sistemit monist në Republikën e Shqipërisë, psikologjia

u zhvillua në drejtim të të arriturave të saj kryesisht në vendet anglofile. U krijua bibliotekë psikologjike në shqipe kryesisht falë angazhimeve të shtëpive botuese të Shqipërisë.

Institucionalizimi i psikologjisë ka rëndësi të veçantë për shqiptarët: me këtë filloi zhvillimi i mendimit shkencor për shpirtin, për dukuritë e proceset psikike duke i kontribuar shpjegimit të arsyeshëm të raportit trup – shpirt, dhe në këtë mënyrë edhe shqiptarët janë inkadruar në rrjedhat e mendimit shkencor të përgjithshëm për psikikën dhe zhvillimin objektiv të saj. Mbi këtë bazë u formuan departamentet e studimeve të psikologjisë në Universitetin e Tiranës, të Prishtinës dhe të Tetovës.

Termat kryesorë: institucionalizim, psikologji filozofike, psikologji empirike, shkolla psikologjike, raporti trup – psikikë, materie – frymë, psikikë – sistem nervor.

Sistemi konceptual i psikologjisë empirike-eksperimentale dhe zhvillimi i tij

Psikologjia, siç është e njohur, ka “të kaluar të lashtë, por histori të shkurtër”. Kështu është përcaktuar zhvillimi i përgjithshëm i mendimit psikologjik dhe që nga vitet e fundit të shekullit nëntmëbëdhjetë, duke përmendur këtë perifrazë të shkurtër, por kuptimplote nga ana e studiuesve të historisë së psikologjisë, ndër të cilët dallohet psikologu amerikan Robert S. Uoduort (Robert S. Woodworth, 1869 – 1962). Vepra e njohur e këtij psikologu “Experimental Psychology” – “Psikologjia eksperimentale”, e botuar më 1939, u bë vepra më e njohur e psikologjisë pothuaj në gjithë ruzullin tokësor. Vërtet për dukuritë shpirtërore është menduar shumë herët, madje ndër shqiptarët dokumenti i parë i gjuhës shqipe “Formula e pagëzimit” e vitit 1462 fillon me theksim të shpirtit: “Në emër të shpirtit të shenjtë . . .”. Ndërkaq, psikologjia ndër shqiptarët u institucionalizua si lëndë mësimi rreth gjashtë shekuj pas vitit 1462. Nga këto të dhëna kuptojmë se historia e psikologjisë është relativisht e re; kjo fillon nga mbarimi i shekullit nëntmëbëdhjetë dhe zakonisht lidhet me vitin 1879, kur, siç përmendëm, themeluesi i psikologjisë empirike Vilhelm Vunti (Wilhelm Wundt, 1832 – 1920) ngriti në Lajpcig laboratorin e parë të psikologjisë. Nga kjo kohë psikologjia u nda nga filzofia dhe mori status të psikologjisë empirike mbi bazat e metodës eksperimentale. Pikërisht në këtë kohë mund të thuhet se psikologjia u institucionalizua në kuptimin e statusit shkencor të saj, u konceptua lënda e studimit dhe metodat e procedurat hulumtuese të gjurmimit të dukurive, të proceseve psikike dhe sjelljeve të njeriut e

zhvillimit të tyre sipas parimeve të përgjithshme shkencore. Mbi këtë bazë studimore u stabilizuan konceptet themelore të psikologjisë empirike mbi bazën e zhvillimit eksperimental të saj.

Prej kësaj kohe kanë kaluar 135 vjet dhe, kuptohet, psikologjia empirike e eksperimentale ka zhvilluar sistem konceptesh koherent e e sistematike për dukuritë, proceset psikike, për tiparet individuale dhe sjelljet e njeriut dhe zhvillimin e tyre mbi bazën e fakteve, të ndërlidhjeve ndërmjet tyre dhe mendimit induktiv, duke u larguar përfundimisht nga spekulimet filozofike dhe doktrinat religjioze për shpirtin dhe dukuritë psikike. Në këtë kuptim psikologjia empirike, e mbështetur në metodën eksperimentale, dallon nga filozofi dhe teologu gjerman Franc Brentano (Franz Brentano, 1838 – 1917), i cili me psikologji empirike ka emërtuar studimin e veprimeve të qëllimshme të njeriut nëpërmjet efekteve konkrete të tyre për të dhe për mjedisin e tij. Sistemi konceptual i psikologjisë empirike dhe eksperimentale është përgjithësim mendimesh për dukuritë e proceset psikike i mbështetur vetëm në të dhënat, faktet dhe rezultatet e përfituara nga gjurmimet e tyre eksperimentale, duke mos u bazuar paraprakisht në përgjithësim mendimesh të nivelit më të lartë, përkatësisht në teorinë e definuar më parë. Sistemi i këtillë është formuar jo vetë në bazë të përvojës, të të dhënave dhe fakteve të përfituara me anën e funksionimit të shqisave, por edhe me aktivizimin e mendjes, të mendimit dhe të proceseve të tij. Falë angazhimeve të shumë studiuesve empirikë dhe teorikë, psikologjia bashkëkohore ka arritur shkallë të lartë të zhvillimit konceptual, duke formuar sisteme konceptuale të lidhura me formimin e shkollave psikologjike.

Studiuesit e historisë së zhvillimit të psikologjisë si Edvin Boring (Edwin Boring, 1886 – 1968), Gardner Marfi (Gardner Marphy, 1895 – 1979), Gordon Olport (Gordon Allport, 1897 – 1967), Eduard L. Torndajk (Edward L. Thorndike, 1874 – 1949) etj., nga analiza e gjerë e veprave, e revistave dhe përgjithësisht e bibliografisë psikologjike i janë qasur studimit të zhvillimit të psikologjisë nga këndvështrimet e ndryshme. Kështu, Gordon Olport, psikolog amerikan, zhvillimin e psikologjisë nga shekulli njëzet e ndau sipas qasjes përmbajtësore në katër stade çiftesh studimore: 1. Studimi strukturës përball studimit të funksioneve të dukurive e proceseve psikike, 2. Studimi i elementeve përballë studimit të tërësive psikike, 3. Studimi kualitativ përballë atij kuantitativ dhe 4. Studimi eksperimental përballë studimit gjenetik – statistikor. Ky studiues është i mendimit se në fillim të shekullit njëzet ka dominuar studimi i strukturës së psikikës, i pjesëve, studimi kualitativ dhe ai eksperimental dhe më pas u zhvillua studimi i funksioneve, i tërësive, studimi kuantitativ

dhe ai statistikor. Eduard L. Torndajk, psikolog amerikan, zhvillimin e psikologjisë dhe përgjithësisht zhvillimin e mendimit psikologjik e ka përcaktuar sipas tri stadeve kryesore të zhvillimit. Këto stade janë: stadi përshkrues ose deskriptiv, stadi funksional dhe stadi shpjegues ose eksplikativ. Kjo ndarje del edhe nga stadet e përgjithshme të mendimit shkencor, ku secila disiplinë shkencore ka pasë detyrë që në fillim të përgjigjet në pyetjen: Çfarë është një dukuri, objekt? Më pas është kërkuar përgjigja në pyetjen si funksionon, si vepron një objekt në tjetrin dhe më në fund është kërkuar përgjigja në pyetjen përse ajo dukuri, objekt, etj. është i atillë. Kështu edhe psikologjia në fillim të zhvillimit të saj është marrë me identifikimin e strukturave të jetës dhe të aktivitetit psikik, më pas ka studiuar funksionin e tyre dhe më në fund është marrë me studimin e dinamikës së strukturave psikike. Rrjedhimisht me këtë, psikologjia në fillim ka qenë psikologji përshkruese ose deskriptive, më pas funksionale dhe më në fund ka marrë përmasën e psikologjisë dinamike.

Por zhvillimin e psikologjisë empirike mbi bazat e metodës eksperimentale dhe të mendimit induktiv mund ta njohim më mirë nëse i studiojmë shkollat psikologjike prej ndarjes së psikologjisë nga spekulimet filozofike e doktrinat religjioze deri në kohët më të reja. Por kjo është çështje që kërkon zbërthime paraprake të zhvillimit të psikologjisë dhe të faktorëve të këtij zhvillimi mbi të cilat mund të konceptohet prania e pikëpamjeve, e qëndrimeve dhe e përgjithësimeve të mendimit psikologjik nga shkollat e ndryshme dhe prania e tyre në zhvillimin e psikologjisë ndër shqiptarët. Madje qasja e këtillë parashtron kërkesën e identifikimit të strukturave të brendshme të psikologjisë dhe të dinamikës zhvillimore të tyre në relacion me historinë e shqiptarëve dhe periudhat e zhvillimit të saj. Për këto shkaqe na duket e rendit që në fillim të studimit të zhvillimit institucional të psikologjisë t'i qasemi këtij procesi nga këndvështrimi i zhvillimit të brendshëm të psikologjisë.

Stadet kryesore të zhvillimit të mendimit shkencor dhe stadet e zhvillimit të psikologjisë

Siç përmendëm, pas viti 1879 psikologjia filloi zhvillimin e saj të pavarur. Kjo do të thotë se zhvillimi i psikologjisë nga viti 1879 fillon rrugëtimin e zhvillimit institucional të saj. Prej asaj kohe e deri tash zhvillimi i saj, si edhe i disiplinave të tjera, ka kaluar nëpër tri stade kryesore: 1. Stadi përshkrues a deskriptiv, 2. Stadi funksional dhe 3. Stadi dinamik. Stadet e këtilla të zhvillimit të përgjithshëm, si edhe të

zhvillimit të psikologjisë, ndahen vështirë njëri nga tjetri; për to bëhet fjalë zakonisht çfarë mbisundon në stadin e caktuar. Megjithëkëtë, këto janë stade të identifikuara gjatë zhvillimit të pandërprerë të disiplinave shkencore përfshijnë, natyrisht, edhe zhvillimin e psikologjisë. A vlen kjo ndarje e ndërlidhur edhe për zhvillimin e psikologjisë pas institucionalizimit të saj ndër shqiptarët? Këtë do ta analizojmë në përmbajtjen e këtij teksti në vazhdim. Por që në fillim duhet thenë se derisa psikologjia u institucionalizua në kuptimin e pavarur të saj më 1879, psikologjia ndër shqiptarët u institucionalizua në formën didaktike njëqind e tridhjetë e katër vjet më pas. Megjithëkëtë, edhe psikologjia ndër shqiptarët trashëgoi përshkrime të dukurive, të proceseve psikike dhe të sjelljeve, madje edhe të kanonizuara, nga zhvillimi parainstitucional i saj, d.m.th. nga zhvillimi i disiplinave të mjekësisë, të biologjisë, të antropologjisë, të teologjisë, etj. Ndërkaq, pas institucionalizimit të saj, përshkrimet e dukurive, proceseve dhe sjelljeve filluan të bëheshin në mënyrë objektive, duke u mbështetur në metoda, procedura dhe teknika gjurmuese të caktuara. Analiza e përmbajtjes së teksteve të pakta të psikologjisë në gjuhën shqipe, si edhe analiza e artikujve dhe e trajtesave pak a shumë psikologjike të botuara në revista arsimore e kulturore na jep mundësi të gjurmojmë veçoritë mbisunduese të zhvillimit të psikologjisë në stadet e ndryshme të zhvillimit të saj ndër shqiptarët.

A. Xhuvani ka shkruar për kujtesën nga viti 1925¹, R. Seyfert bëri shpjegimin e mendjes dhe të kulturës së mendjes në artikullin e tij të përkthyer me titull: “Të kthymit të veprimit të shpirtit në gjân e mësueme është një faktor me rëndësi për procedimin e kulturës së mendjes”.² A. Xhuvani në veprën e tij të psikologjisë përshkroi dhe shpjegoi psikikën e proceset psikike, vetitë e personalitetit, formimin e karakterit, etj.³ M. Daiu në revistën: “Shkolla kombëtare” (nr. 23, 1939,) botoi artikullin “Ç’është psikanaliza?”; “Ç’është sugjestion?” është punim i S. Papakristos⁴. Në këto botime vështirë është të bëhet dallimi ndërmjet përshkrimit të dukurive e proceseve psikike, funksionimit dhe dinamikës së tyre. Megjithëkëtë, do të thosha se deri me botimin e veprës së psikologjisë të A. Xhuvanit ka mbisunduar përshkrimi me informacione të pakta për funksionin dhe për

¹ Revista pedagogjike, nr. 1 – 2, 3 – 4, 5 – 6, , 7 – 8, 9 – 10, Tiranë, 1925.

² Edukata e re, Tiranë, 1931, nr. 3,4.

³ A. Xhuvani, drejtor i Shkollës Normale, Fillime të pedagogjis, Pjes, e parë. Psikologji e shtime në punë t’ edukates”, 1933.

⁴ Përpyekja shqiptare nr. 14 – 15, dhe nr. 16, Tiranë, 1938.

shpjegimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, përkatësisht të shkaqeve të zvellimit të brendshëm të tyre, si nevojat, dëshirat, motivet, inetersat, etj., kurse më pas përpos përshkrimit ka dominuar funksionalizmi dhe dinamika. Funksioni dhe dinamika e strukturave psikike filluan të mbisundojnë para fillimit të Luftës II Botërore, gjatë zhvillimit të saj, sidomos pas përfundimit të saj. Kjo dallohet në librat psikologjisë të përkthyer nga rusishtja⁵. Në këtë botim, si edhe në botimet e tjera, bëhet fjalë jo vetëm për proceset psikike, për personalitetin, karakterin, etj., por edhe për zhvillimin dhe edukimin e tyre, që nënkupton qasjen funksionale dhe dinamike të proceseve psikike dhe të vetive të personalitetit. Funksioni dhe dinamika e tyre u shtua vazhdimisht gjatë dekadave të fundit të shekullit njëzet. Falë kësaj qasjeje shumë përshkrime të mëhershme parainstitucionale u korrigjuan duke lënë anash pikëpamjet dhe qëndrimet metapsikologjike, spekulative dhe religjioze. Pra, studiesit shqiptarë të psikologjisë filluan të merren edhe me gjurmimin sistematik të funksionimit të strukturave psikike, si funksionojnë strukturat psikike të njeriut. Këtë e dallojmë në angazhimin e tyre për të dhënë përgjigje në pyetjet: Si funksionojnë këto procese? Si u zhvilluan ato?, Përse janë të këtilla?, Përse ndryshojnë, etj. Zhvillimi parainstitucional i këtillë u bë mbështetës i fortë i zhvillimit institucional të saj. Relacionet e këtilla ndërmjet tyre tregojnë lidhjen ndërmjet zhvillimit parainstitucional dhe atij institucional të saj. Për këtë shkak zhvillimit të psikologjisë i qasemi nga aspekti i një procesi të pandërprerë dhe dialektik. Megjithatë, duhet thënë se me zhvillimin institucional të psikologjisë ndër shqiptarët, pavarësisht nga forma e këtij zhvillimi mbi temelin e nevojave arsimore e pedagogjike, shënon një kthesë të rëndësishme në drejtim të afrimit të shpjegimit të një çështjeje filozofike të rëndësishme atëherë edhe sot – çështjen e raportit trup – shpirt në baza të tjera nga atro metafizike dhe religjioze. Madje kjo qasje është e vlefshme për të shënuar integrimin e zhvillimit të njohurive mbi psikikën e format e saj të mjedisit kulturor, arsimor e shkencor të shqiptarëve në rrjedhat e kulturës, arsimit dhe mendimit shkencor evropian. Këtu qëndron rëndësia e institucionalizimit të psikologjisë ndër shqiptarët. Por institucionalizimi i psikologjisë në Elbasanin e Shqipërisë a do të thotë se është njëkohësisht institucionalizim i saj për të gjithë shqiptarët, kur dihet se në kohën e institucionalizimit të saj në vitin 1913 shumë shqiptarë dhe disa toka të tyre nuk ishin zyrtarisht pjesë e shtetit shqiptar?

⁵ K. N. Kornilov, Psikologjia, tekst për shkollat pedagogjike, Tiranë 1947.

Institucionalizimi i psikologjisë ndër shqiptarët dhe niveli i këtij institucionalizimi

Institucionalizimi i psikologjisë mbi bazat pedagogjike e diaktike të saj është njëkohësisht edhe institucionalizim shkencor i saj, sepse përmbajtjet mësimore e didaktike përgjithësisht, si edhe ato të psikologjisë, janë modifikim i përmbajtjeve shkencore të kryera sipas qëllimit, moshës dhe kërkesave konkrete të tyre për zhvillimin e mjedisit dhe të shoqërisë së tij në kohë të caktuar, përkatësisht për mjedisin shqiptar në fillim të dekadës së dytë të shekullit njëzet. Ç'është e vërteta, fakte të dukurive psikike dhe shpjegime të tyre kemi pasur të botuara edhe më herët në sistemin e shkencave biologjike, mjekësore dhe të disa disiplinave të grupit të shkencave shoqërore. Por sistemimin e tyre mbi themelin e rezultateve të metodave, teknikave dhe procedurave gjurmuese të posaçme për psikologji i hasim konkretisht në formë të integruar dhe me ndërlidhje koherente vetëm pas institucionalizimit të psikologjisë. Këto fakte dhe shpjegime të tyre për nevoja mësimore u sistemuan dhe u konkretizuan dy dekada pas institucionalizimit të psikologjisë si lëndë mësimore në librin e Aleksandër Xhuvanit "Fillime të pedagogjisë. Pjesë e parë. Psikologji e shtime në t'edukatës"⁶,

Mendimi shkencor përgjithësisht nuk njihet kufij. Ky parim universal vlen edhe për psikologji dhe zhvillimin e saj ndër shqiptarët. Për këtë shkak vlerësoj se institucionalizimi i psikologjisë në Normalen e Elbasanit të Shqipërisë është njëkohësisht edhe datë e përbashkët e institucionalizimit të psikologjisë për shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë, të Serbisë dhe të Malit të Zi. Institucionalizimi i kështillë ka në vete edhe dy struktura a një komponent të rëndësishme: 1. Me këtë institucionalizim u bë i mundur dallimi i dijenive shkencore nga ato joshkencore, duke përfshirë edhe eliminimin e teorisë të pasuksesshme për jetën shpirtërore nga teoritë e suksesshme për jetën psikike; 2. Janë vënë themelet e zbatimit ose aplikimit të përmbajtjeve, rregullave dhe metodave gjurmuese të psikologjisë në procesin e edukimit dhe është hapur horizonti i mundësive të zbatimit të saj në fusha të tjera të veprimtarisë.

Institucionalizimi i psikologjisë për shqiptarët në relacion kohor me fillimin e zhvillimit të psikologjisë empirike ka një përmasë kohore karakteristike: ne kemi pavarësuar psikologjinë gati një

⁶ Aleksandr Xhuvani. Fillime të pedagogjisë. Pjesë e parë. Psikologji e shtime në punë t'edukatës", Tiranë, 1933.

shekulli e gjysmë pas pavarësimit zyrtar të saj nga ana e psikologut gjerman Vilhelm Vunt (Wilhelm Wundt, 1832 – 1920). Megjithatë, psikologjia mbi temelin e mendimit shkencor te na pas viti 1913 ka shënuar ritme zhvillimi ndër më të ndryshmet herë në një drejtim e herë në drejtimin tjetër, herë më të shpeshta e herë me ritme zhvillimi më të ngadalsuara.

Por t'i kthehemi çështjes së përmendur pak më lart: Përse viti 1913 duhet konsideruar vit i institucionalizimit të psikologjisë për të gjithë shqiptraët? Tri janë argumentet kryesore ku e mbështesim këtë përfundim. I pari: në vitin shkollor 1913/1914 në Normalen e Elbasanit ka pasur nxënës nga disa vende të Kosovës. Numri i tyre, kur janë regjistruar për herë të parë me themelimin e Shkollës Normale, ka qenë shtatëdhjetë, që në krahasim me njëqind e katërdhjet nxënës sa ishin në këtë shkollë, nxënësit nga Kosova përbënin gjysmën e tyre. Nxënësit nga Kosova ishin nga Gjakova, Gjilani, Mitrovica, Peja, Vushtria, etj.⁷. Argumenti i dytë: nxënësit e kryer të Normales së Elbasanit pas 12 nëntorit 1941 deri në vitin 1950 kanë qenë mësimdhënës të parë të psikologjisë në Shkollën Normale “Sami Frashëri” në Degën e Normales dhe në Degën Liceale të këtij institucioni edukativo–arsimor, si edhe në Normalen e Gjakovës të viteve 1946/47. Elbasanasi Vasil Antoni (1901 – 1994) kishte përfunduar studimet e larta për pedagogji në Strasburg, profesor Lirak Dodbiba (1912 – 1992) kishte përfunduar studimet për pedagogji në Universitetin e Lionit më 1938, profesor Reshit Kashari (Elbasan, 1919) më parë kishte kryer Normalen e Elbasanit e më pas kishte përfunduar studimet universitare për pedagogji dhe profesor Reuf Zajmi kishte kryer studimet për pedagogji në Universitetin e Lionit. Nga këta profesorë lëndën e psikologjisë e kanë mbajtur profesor Lirak Dodbiba dhe Ymer Berisha (në kuadrin e filozofisë), kurse profesor Reshit Koshara ka mbajtur lëndën e psikologjisë të ndarë nga filozofia dhe nga pedagogjia nga viti shkollor 1943/1944 në klasën VI të Degës së Normales nga 3 orë. Këta kanë pasur për bazë tekstin e psikologjisë të Aleksandër Xhuvanit, i cili së bashku me tekstin e pedagogjisë “për një periudhë të gjatë gjallëruan në shkollat tona”⁸. Në këtë kuadër psikologjia tashmë e institucionalizuar ishte paraparë të zhvillohej në Kosovë nga viti i themelimit të Shkollës Normale “Sami Frashëri” në Prishtinë.

⁷ Elbasani – Enciklopedi, Elbasan, 2003.

⁸ Akademik Jashar Rexhepagiq – Dr. Abdulah Vokri – Mr. Abdylaziz Veseli “Shkolla Normale “Sami Frashëri” 1941 – 1945”, Prishtinë, 1997, fq.125.

Ndërkaq, psikologjia filloi të zhvillohet në formën dhe nivelin e lëndës mësimore të veçantë, e ndarë nga filozofia dhe nga pedagogjia, në vitin shkollor 1943/1944. Meqë shumë nxënës të klasave të larta të kësaj shkolle kishin ardhur nga Medreseja e Madhe Shkupit dhe nga Medreseja e Gazi Isa Beut në Shkup, këta nxënës kishin idetë e para të psikologjisë, sepse psikologjia në këto shkolla ishte e inkadruar në lëndën e filozofisë. Pra, prej kësaj kohe, përkatësisht prej viti shkollor 1943/1944 filloi zhvillimi i psikologjisë, i pavarur nga filozofia dhe pedagogjia edhe në Kosovë. Zhvillimi i këtillë ishte i lidhur me rrjedhat e zhvillimit të psikologjisë në Shqipëri. Më pas elbasanasit Dhimitër Fullani dhe Tajar Hatipi, mësues me normalen e kryer në Elbasan, kanë qenë mësimdhënës të parë shqiptarë të psikologjisë në gjuhën shqipe në Normalen e Gjakovës deri në qershor të vitit 1948 dhe, më pas Tajar Hatipi, i ngelur në Kosovë pas qershorit të vitit 1948 dhe Zekeria Rexha (1910 – 1972) profesor i diplomuar në filozofi kanë qenë mësimdhënës të lëndës së psikologjisë edhe në Normalen e Prishtinës. Autori i këtyre rreshtave ka qenë nxënës i tyre, kur ka përfunduar normalen dhe është regjistruar e ka diplomuar psikologjinë eksperimentale në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit më 1955. Argumenti i tretë: Librat e psikologjisë të botuara në Shqipëri, përkatësisht në Elbasan dhe në Tiranë (fjala është për librin e psikologjisë të A. Xhuvanit dhe të përkthimit nga rusishtja i librit të psikologjisë nga K. N. Kornilov) ishin librat e vetëm që u përdorën në gjimnazet dhe në normalet e Kosovës. Ç'është e vërteta, lënda e psikologjisë është zhvilluar në Medresenë e Mbretit Aleksandër të Shkupit, ku ka pasur ndjekës të mësimit edhe disa shqiptarë, madje edhe në Gjimnazin serb të Prizrenit dhe në atë të Mitrovicës, por jo në gjuhën shqipe dhe në kuadrin e lëndës së filozofisë, më tepër në lidhje me lëndën e logjikës. Në këtë pikëpamje si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë psikologjia u mëvetësua nga filozofia, shkencat biologjike dhe nga shkencat mjekësore. Zhvillimin e saj të pavarur e imponuan kërkesat e krijimit të profilit profesional të mësimdhënësve, përkatësisht të mësuesve. Në këtë pikëpamje ndër shqiptarët roli i pedagogjisë në zhvillimin e psikologjisë nuk është për t'u nënçmuar.

Pra, lënda e psikologjisë është zhvilluar edhe më herët, në kohën ndërmjet Luftës së Parë Botërore dhe Luftës së Dytë Botërore, gjatë sundimit të Mbretërisë së Serbisë, përkatësisht të Mbretërisë Serbe, Kroate e Sllovene. Por edhe ata pak nxënës shqiptarë që kanë pasur mundësi t'i ndjekin mësimet në këto shkolla, psikologjinë e kanë

dëgjuar në kuadrin e filozofisë, sidomos në lidhje të ngushtë me logjikën dhe në gjuhën serbe. Megjithëkëtë, psikologjia si lëndë mësimore në gjuhën shqipe, e ndarë nga psikologjia popullore dhe e mbështetur në metoda dhe procedura gjurmuese, është e lidhur drejtpërdrejt me Normalen e Elbasanit. Për këtë shkak institucionalizimi i psikologjisë si lëndë mësimore mbi baza shkencore në Normalen e Elbasanit është njëkohësisht fillim i mendimit psikologjik të organizuar në baza didaktike-shkencore për të gjithë shqiptarët.

Zhvillimi i psikologjisë në Kosovë pas përfundimit të Luftës II Botërore

Vazhda e zhvillimit të psikologjisë mbi themelet e përbashkëta në Shqipëri dhe në Kosovë ka vazhduar deri më 1948. Deri në këtë kohë, madje teksti i përkthyer nga rusishtja në shqipe i psikologut rus K. N. Kornilov i Ministrisë së Arsimit të Republikës së Shqipërisë është përdorur edhe në Kosovë. Pas qershorit të vitit 1948 ky proces i përbashkët i zhvillimit të psikologjisë institucionale u ndërpre. Kjo ngjau më 10 qershor 1948, kur PK e Jugosllavisë u largua nga Biroja Politike e Partive Komuniste dhe u vu kufiri i rreptë ndërmjet Jugosllavisë Federale, përkatësisht Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë. Në këtë gjendje, të keqën më të madhe e pësoi zhvillimi arsimor, kulturor e shkencor i shqiptarëve në Kosovë në fushën e përgjithëshme ekonomike, politike e sociale, sidomos në atë të zhvillimit të arsimit, kulturës kombëtare dhe gjuhës shqipe. Posaçërisht dua të theksoj zhvillimin e ulët të terminologjisë së shumë disiplinave shkollore e shkencore dhe nevojën që ndjenim për përkthim tekstesh shkollore me terminologji shqipe, që neve na mungonte dhe shi për këtë kishim vështirësi të madhe në shqipërimin e teksteve nga gjuhët e tjera, si edhe në ligjërimin e lëndëve shkollore për nxënës dhe më pas edhe për studentë. Kjo gjendje u reflektua edhe në zhvillimin e psikologjisë; kështu, përmbajtjes së librit të K. Kornilovit iu bënë shkurtime nga ana e një komisioni të posaçëm dhe këto shkurtime u botuan në formë dispencash ose skriptesh, ku emrat e Ivan Pavlovit, të Maksim Gorkit dhe të sovjetikëve të tjerë nuk përmendeshin. Viti 1949 shënon shkëputje të plotë dhe shumë të rëndë të zhvillimeve arsimore, kulturore e shkencore ndërmjet shqiptarëve të Shqipërisë dhe shqiptarëve të Kosovës. Kjo shkëputje u reflektua edhe në zhvillimin e mendimit psikologjik dhe të psikologjisë përgjithësisht. Prej këtij viti filloi zhvillimi i psikologjisë në klasët e paralelet shqipe të shkollave të

përbashkëta serbo-shqiptare të Kosovës, ku në disa vende lënda e psikologjisë shtjellohej nga profesorët në gjuhën serbe. Prej kësaj kohe fillon një etapë e re e zhvillimit të psikologjisë në Kosovë duke mos pasur kurrfarë kontaktesh zyrtare me rrjedhat zhvillimore arsimore e shkencore të Shqipërisë.

Në Kosovë prej vitit 1948 deri në vitin 1974 lënda e psikologjisë në shkolla normale, në gjimnaze dhe në disa shkolla profesionale, siç ishte shkolla e mesme mjekësore, e arteve, etj. u zhvillua sipas planit dhe programit të Republikës së Serbisë. Nevojat mësimore për të mësuarit e psikologjisë mbuloheshin me tekste të përkthyer nga serbokrotishtja në shqipe. Të këtilla ishin këta libra shkollorë të psikologjisë: *Psikologjia pedagogjike* nga Dr. Borislav Stevanoviq, e përkthyer dhe e botuar në shqipe më 1957, *Psikologjia fëmijërore* e autori Fridrih Troj më 1958, *Psikologjia* e autorit Dr. Tomislav Tomekoviq, që u botua më 1965, *Psikologjia e personalitetit* e Dr. Nikola Rot-it më 1965, *Psikologjia e përgjithshme për shkollat normale dhe akademitë pedagogjike* nga autori Dr. Nikola Rot, që u botua më 1968 (u ribotua shtatë herë deri në vitin 1982), në vitin 1976 u botua përkthimi i librit *Psikologjia fëmijërore* e Dr. Vera Smilaniq – Çolanoq e Dr. Ivan Toliçiqit, nga kroatishtja më 1971 u përkthi libri *Psikologjia* për klasën III gjimnaz e autorit Dr. Mladen Zvonareviq, etj. Përmbajtja e këtyre teksteve kishte mbështetje më të madhe në literaturën psikologjike të vendeve perëndimore. Institucionalizimin e psikologjisë në nivel të nevojave mësimore e përcolli edhe vepra burimore në shqipe “*Bazat psikologjike të kultures së të folurit të të nxënësve të shkollës fillore*” e autori Pajazit Nushi, që u botua më 1964. Unë e kolegët psikologë shqiptarë, që zhvillonim lëndën e psikologjisë, këtë e zhvillonim sipas formimit tonë nga profesorët universitarë që krenoheshin se janë formuar në Francë, në Universitetin e Sorbonës të Anri Pjeronit, të Pol Gijomit, etj. dhe në Angli, te psikometristi Terston, Pirson, etj. ose në Gjermani te pasardhësit e Vuntit, të Ebinghausit, të Frojdit, etj.

Në vitin 1974 Kosova mori të gjitha kompetencat në zhvillim të arsimit, të kulturës, të shkencës dhe të mjeteve të informimit. Por tendenca tashmë e formuar e zhvillimit të lëndës së psikologjisë sipas teksteve dhe përmbajtjeve psikologjike të viteve të mëparshme vazhdoi pavarësisht nga zhvillimi i kontakteve tona me kolegët e Tiranës së pas viteve të tetëdhjeta.

Psikologjia ndër shqiptarët në gjysmën e dytë të shekullit njëzet

Zhvillimi i psikologjisë ndër shqiptarët mori hov nga mbarimi i dekadave të gjysmës së dytë të shekullit njëzet, sidomos nga fillimi i viteve të shekullit njëzet e një. Në këtë segment kohor dallohen dy faza: 1. Zhvillimi prej rreth viteve `50-ta deri në vitin 1990 dhe 2. Zhvillimi prej vitit 1990 deri në vitin 2010. Për fazën e parë (1950 – 1990) zhvillimi i psikologjisë rrugëtoi në dy “korse”: në atë të Shqipërisë dhe në atë të Kosovës. Gjatë këtyre dyzet vjetëve pothuajse nuk është shënuar ndonjë formë bshkëpunimi ndërmjet bartësve të zhvillimit të psikologjisë në Shqipëri dhe në Kosovë; secili ka ndjekë rrugën e vet zhvillimore të “trasuar” nga sistemi politik e ideologjik i vendit të tyre. Por në një pikë zhvillimi bashkoheshim: Në dy vendet u botuan kryesisht libra shkollorë të psikologjisë. Në Shqipëri hartuesit e këtyre librave ishin vendës, kurse në Kosovë dominonin përkthimet e teksteve nga serbokroatishtja të autorëve nga Beogradi, Zagrebi e Ljubljana. Në Kosovë u botuan dhjetra libra të përkthyer për nevojat e shkollave të mesme, kurse në Shqipëri u botuan disa dhjetra për nevojat e shkollave të mesme dhe për nevojat universitare, të cilat gjuhësisht qëndronin në nivel shumë më të lartë se përkthimet e librave të psikologjisë në Kosovë prej serbokroatishtes në gjuhën shqipe.

Analiza përmbajtësore e këtyre botimeve tregon për disa ngjashmëri, por më shumë për dallime në qasje studimore të psikologjisë ndërmjet studiuesve shqiptarë të psikologjisë në Shqipëri dhe në Kosovë. Elementet thelbore të proceseve dhe gjendjeve psikike nuk mund të ndryshonin, madje edhe synimi i të mësuarit të psikologjisë për formim materilist dialektik për natyrën e shoqërinë ishte i përbashkët. Por dallimet ishin të mëdha. Këto dallime do të na bëhen të qarta po qe se përqendrohemi vetëm në qasje studimore të dukurive e procese psikike dhe shfaqjeve objektive të tyre. Kështu, bie fjala, lehtë konstatohen dallime dhe në konceptet kryesore të psikologjisë, siç është rasti kur analizojmë përkufizimin e lëndës së psikologjisë në tekstet e psikologjisë të shkollave të mesme dhe universitare. *Ne në Kosovë e përkufizonim lëndën e psikologjisë si disiplinë shkencore që merret me studimin e jetës psikike të njerëzve dhe të kafshëve. Jetën psikike e përbëjnë proceset dhe gjendjet psikike. Proceset psikike të njerëzit mund të jenë procese intelektuale, siç janë perceptimi, të mësuarit, kujtesa dhe të menduarit, mund të jenë procese emocionale, siç janë ndjenjat dhe proceset konative ose të vullnetshme siç janë proceset motivuese dhe veprimet e vullnetshme. Me gjendje psikike kuptojmë tiparet relativisht të qëndrueshme të*

individit, siç janë shprehuritë, aftësitë, temperamentit, nevojat, interesimet dhe tiparet e tjera të personalitetit”⁹. Në tekstet e psikologjisë të botuara në Tiranë të asaj kohe lexohet përkufizimi i lëndës së psikologjisë, sipas të cilit “Psikologjia është shkenca, që merret me studimin e psikikës dhe formës së saj më të lartë, vetëdijes njerëzore. Ajo studion brendin dhe rregullaritetet e veprimtarisë psikike të njeriut, ligjet e lindjes dhe rrjedhës së proceseve psikike të personalitetit si edhe karakteristikat psikologjike të llojeve të ndryshme të veprimtarisë që kryejnë njerëzit”¹⁰.

Në përgjithësi përmbajtjet e teksteve të lartpërmendura esencialisht dallojnë pak njëra nga tjetra. Nuk ka vend dyshimi se lënda e psikologjisë merret me studimin e fakteve psikike dhe me përgjithësimin e dijenive individuale në rregulla, parime, ligje dhe teori, që përbëjnë esencën e programeve shkollore të të gjitha niveleve dhe tipave shkollore. Zhvillimi i jetës psikike, i formave të saj nga nivelet më të ulëta deri në ato më të larta të vetëdijësimit është përmasa përmbajtësore e rëndësishme e programeve shkollore të psikologjisë. Qëllimi i formimit të pikëpamjeve dhe qëndrimeve materialiste dhe dialektike për veprimtarinë psikike përçohet nëpër gjithë përmbajtjet e programeve shkollore, madje ky qëllim ishte karakteristik për të gjitha vendet e zhvillimit të marrëdhënieve socialiste, pavarësisht nga forma e organizimit të marrëdhënieve shoqërore në Shqipëri dhe në Federatën Jugosllave, duke përfshirë edhe Reapublikën e Serbisë dhe Krahinën Autonome të Kosovës, etj. Megjithatë, disa dallime janë të qëndrueshme. Ndër to dallohen: jeta psikike është e vetëdijshme dhe ka disa forma të pavetëdijshme të saj. Tërësia e jetës psikike të njeriut që mësohej atëherë ishte e sajuar prej veprimeve të vetëdijshme dhe atyre të pavetëdijshme, por përmasa a dimensionit i vetëdijshmërisë dhe i pavetëdijshmërisë mësohej në shkollat e Kosovës dhe më gjerë, kurse në Shqipëri përmasa e pavetëdijshmërisë nuk është e pranishme në tekstet shkollore. Metodot gjurmuese të dukurive, të proceseve psikike dhe të formave të aktivitetit psikik që përpunoheshin në shkollat e Kosovës ishin të natyrës cilësore a kualitative (vetëvëzhgimi, vëzhgimi dhe gjurmimi eksperimental) dhe të natyrës sasiore a kuantitative (tekstet dhe procedurat statistikore). Në tekstet shkollore të psikologjisë në Shqipëri përpunoheshin kryesisht metodat kualitative, ndërsa nuk ka përpunime në tekstet shkollore të testeve dhe të teknikave e procedurave statistikore. Jeta psikike, aktiviteti psikik dhe format e këtij aktiviteti mbështeteshin në sistemin konceptual të

⁹ Dr. Nikolla Rot, Opšta psihologija, Beograd, 1967, fq. 3.

¹⁰ Universiteti Shtetëror i Tiranës – Fakulteti Histori – Filologji, “Psikologjia”, tekst për shkollat e larta, Tiranë 1965, fq. 3.

shkollës fiziologjike të Bashkimit Sovjetik të autorëve Ivan M. Seçenovit dhe të Ivan P. Pavlovit. Në kuadrin e këtij koncepti në këto tekste është përpunuar hollësisht veprimtaria e lartë nervore. Ndërkaq, në Kosovë dhe më gjerë ky sistem përmendej në caqe të kufizuara, madje as nuk përfshihej në rendin e shkollave psikologjike, siç janë shkolla e strukturalizmit, funksionalizmit, geshtaltizmit, psikanalizës, humanizmit dhe shkolla kognitive.

Derisa qëllimi i përgjithshëm i arsimit dhe edukimit, duke përfshirë edhe studimin e psikologjisë ishte përcaktuar në tekstet e Tiranës formimi i botëkuptimit materialist-dialektik për dukuritë psikike, në tekstet e përkthyer nga serbishtja dhe më pas edhe në tekstet burimore të psikologëve shqiptarë, qëllimi i psikologjisë ishte njohja dhe kuptimi i realitetit psikik, ku këkohej të jepnim përgjigje në tri pyetje kryesore: **Çfarë** (është kujtesa), **si** funksionon (procesi i të mbajturit në mend, i rinjohjes dhe i riprodhimit) dhe **përse** është i këtillë? Ndërkaq, ndër shkollat psikologjike dhe sistemet konceptuale të tyre në tekstet e psikologjisë së Tiranës në ato vite nuk bëhej fjalë për sistemet konceptuale psikologjike të shkollës së funksionalizmit, geshtaltizmit, psikanalizës, e bihejviorizmit, etj. Në vitet e përmendura psikologjia në tekstet e Tiranës ishte e bazuar, siç përmendëm, kryesisht në shkollën fiziologjike ruse të Ivan Mihajllloviq Seçenovit e të Ivan Petroviq Pavlovit, kurse në sistemin konceptual të teksteve shkollore të të gjitha niveleve dhe të të gjitha tipave në ish-Jugosllavi, duke përfshirë edhe Kosovën, sistemi konceptual i shkollës fiziologjike ruse të Ivan Mihajllloviq Seçenovit, Ivan Pavlovit e bashkëpunëtorëve të tyre dhe koncepti madhor veprimtaria e lartë nervore ishte njëri nga sistemet psikologjike, por jo edhe sistem kryesor; ky sistem përmendej si shkollë fiziologjike e rëndësishme për zhvillim të psikologjisë, ndërkaq refleksologjia përmendej rrëshqitazi si pararendëse e bihejviorizmit. Dallimet të mëdha vërehen, siç pamë, në metodat e studimit të proceseve psikike, në studimin e metodave, të teknikave dhe të procedurave hulumtuese. Ne në Kosovë, si edhe në gjithë Jugosllavinë, mësonim shumë për testet dhe analizën kuantitative të rezultateve që arrinim pas matjeve psikometrike sidomos të aftësive të një numri të madh ose të vogël subjektesh. Në tekstet e psikologjisë që botoheshin në Shqipëri nuk bëhej fjalë për teste. Këto janë disa nga ndryshimet përmbajtësore dhe metodologjike që mund të konstatohen edhe sot, kur gjurmohet edhe sipërfaqësisht zhvillimi i tekstologjisë së psikologjisë në gjuhën shqipe. Varësisht nga qëllimi arsimor dhe shkencor i lëndës së psikologjisë trajtoheshin

edhe çështjet fundamentale të personalitetit, të strukturës dhe zhvillimit të tij, ku vend të posaçëm në psikologjinë e personalitetit të ish-Jugosllavisë së asaj kohe zinin teoritë e personalitetit, sidomos ato të bazuara në rezultatet e analizës faktoriale.

Këto ndryshime në sistemet konceptuale psikologjike ndërmjet shqiptarëve të Shqipërisë dhe shqiptarëve të Kosovës nuk duhet kuptuar si kundërvënie e sistemit konceptual të psikologjisë që mësohej në shkollat e Kosovës ndaj atij që mësohej në shkollat e Shqipërisë. Autorit të këtyre rreshtave nuk i është i njohur ndonjë artikull e trajtesë psikologjike e filozofike ku është kritikuar sistemi konceptual i psikologjisë së Shqipërisë së viteve 1950 – 2000. Ky dallim ishte produkt i sistemeve politike dhe ideologjike të dy vendeve, produkt i dallimeve të sistemeve politike dhe ideologjike ndërmjet Shqipërisë së atyre viteve dhe Jugosllavisë po të së njëjtës kohë. Pikërisht këtu konstatojmë ndikimin e sistemeve politike dhe ideologjike në zhvillimin e mendimit shkencor përgjithësisht, duke përfshirë edhe zhvillimin e mendimit shkencor psikologjik sidomos kur bëhej fjalë për raportin trup – materie dhe psikikë – shpirt, që ka qenë dhe ngeli raport kryesor në zhvillimin e përgjithshëm të mendimit filozofik dhe psikologjik.

Faza e dytë e zhvillimit të psikologjisë ndër shqiptarët nga viti 1990 i përket periudhës zhvillimore të përgjithshme pas rrënimit të sistemit monist. Kjo fazë në tekstologjinë e psikologjisë fillon me përkthimin dhe botimin e librit “Psikologjia – Një hyrje koncize” e Terry P. Pettyjohnit më 1996. Me botim e kësaj vepre u bë një kthesë e madhe në studimet e psikologjisë. Përmbajtja e këtij teksti kryesisht i konceptuar mbi bazën bihejvioriste ndryshoi rrënjësisht qasjen e studimeve dhe të interpretimeve të sjelljeve dhe të proceseve psikologjike. Ky tekst, me botimin e tij në Pejë, filloi të përhapet dhe të përdoret edhe në shkollat e Kosovës. U botuan tekste shkollore të psikologjisë të përkthyer tashmë jo nga rusishtja dhe serbokroatishtja, por nga anglishtja në Tiranë, në Prishtinë, në Tetovë, etj. U përkthyen vepra të psikologëve klasikë, sidomos ato të Zigmund Frojdit, Alfred Adlerit, të Karl Jungut, të Erik Fromit, etj. Përkthimi i këtyre veprave i atribuohet më tepër interesimit të studiuesve nga Shqipëria sesa atyre nga Kosova e viset e tjera. Shqiptarët e interesuar të të gjitha viseve i marrin me kohë këto tekste dhe vepra. Në Kosovë nuk kemi pasur përkthime veprash kapitale të klasikëve të psikologjisë. Por ne që këto vepra i kemi lexuar dhe përpunuar në gjuhët e tjera, na duken më të kuptueshme se këto të përkthyer në gjuhën shqipe. Më duket se vlerësimi ynë, së paku ai imi, është real kur kam parasysh se kompleti i

veprave të Zigmund Frojdit është përkthyer në serbokroatishte nën përkujdesjen e redaktorit, psikanalistit gjerman me origjinë hebraike Hygo Klajn nga Beogradi, kurse këto në shqipe u përkthyen nga nëntë veta, kryesisht gjuhëtarë, dhe shumë prej tyre nën redaktimin e Rexhep Hidës. Gjej të rrugës edhe me këtë rast të kërkoj që në përkthimin e veprave psikologjike të konsultohen domosdoshmërisht edhe psikologët, por kjo është çështje tjetër.

Vlen të theksohet se kërkesat e mjedisit kosovar, sidomos pas përfundimit të luftës në Kosovë dhe përjetimet e rënda me ankth dhe me stres parashtruan kërkesën e kuadrove profesionale për psikologji klinike, si edhe për nevoja profesionale të tjera. Në Universitetin e Prishtinës në vitin shkollor 2001/2002 u hap dega e psikologjisë në kuadrin e Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Më vonë u hap dega e psikologjisë edhe në disa kolegje dhe qendra universitare private në Prishtinë. Në këtë pikëpamje mund të thuhet se pas rreth njëqind vjetëve është ngritur në nivel më të lartë dhe është stabilizuar institucioni i studimeve të psikologjisë në Tiranë, në Prishtinë dhe në Tetovë.


Shkollat psikologjike dhe depërtimi i sistemit konceptual të tyre në gjuhën shqipe

Psikologjia në procesin e pandërprerë zhvillues të saj ka kaluar nëpër disa shkolla a sisteme konceptuale, që përbëjnë historinë e psikologjisë. Ky është proces i përgjithshëm i zhvillimit të mendimit shkencor, sepse këtë e dallojmë edhe në zhvillimin e disa disiplinave të tjera të zhvillimit shkencor të tyre. Kështu, në zhvillimin e filozofisë dallojmë shkolla filozofike, si Shkolla e Aleksandrisë, Shkolla e Athinës, Shkolla e Frankfurtit, etj.; në histori të sociologjisë dallojmë shkolla sociologjike, si Shkolla e Komteit, Shkolla Sociologjike Franceze, Shkolla Virtuale, etj.; në histori të pedagogjisë janë identifikuar shkolla pedagogjike, si Shkolla e Herbartit, e Pestalocit, e Komenskit, etj. Situatë e ngjashme shfaqet edhe në zhvillimin e mendimit psikologjik; edhe këtu dallojmë shkolla psikologjike dhe sisteme konceptuale të ndryshme. Shpesh këto shkolla marrin emërtime të tjera, ndër të cilat dallohet edhe emërtimi sisteme konceptuale. Siç përmendëm, këto dy terma shpesh marrin përmbajtje ekvivalente, përkatësisht nuk bëhen dallime ndërmjet domethënies së termit shkollë psikologjike dhe sistem psikologjik. Megjithëkëtë, mendoj se këto dy terma kanë domethënie jo plotësisht të njëjta. Shkolla psikologjike ka domethënie e studiuesve që kanë

arritur të konceptojnë ide, gjykime e lidhje të tyre në sisteme të veçanta, ku theksi vëhet në këto personalitete dhe në biografitë profesionale të tyre, kurse me termin sisteme konceptuale psikologjike konsideroj se duhet kuptuar idetë, gjykimet, përfundimet dhe teoritë psikologjike dhe pikërisht sistemet psikologjike duhet vënë theksin në idetë dhe karakteristikat e tyre, që përbëjnë një sistem koherent e të përgjithshëm të mendimeve esencila për jetën dhe aktivitetin psikik.

Në zhvillimin e psikologjisë studiuesit e historisë së psikologjisë Edving Boring, Gordon Marfi, Robert Uoduort, etj., kanë identifikuar këto shkolla me sisteme konceptuale psikologjike, që sipas kriterit kronologjik të zhvillimit renditen sipas këtij rendi: shkolla e sistemi konceptual të strukturalizmit, të funksionalizmit, të bihejviorizmit, të geshtaltizmit, të psikanalizës, të psikologjisë humaniste dhe shkolla e sistemi konceptual të psikologjisë kognitive. Këtë e dallojmë në diagramin e mëposhtëm:

SHKOLLAT PSIKOLOGJIKE



Në këtë paraqitje të sistemeve psikologjike shkollat psikologjike janë të lidhura me emrin e themeluesit dhe të përfaqësuesve kryesorë të tyre. Karakteristikat kryesore të sistemeve konceptuale të këtyre shkollave janë: Zhvillimi i psikologjisë empirike – introspektive i Vilhelm Vuntit (Wilhelm Wundt (1832 – 1920) ka filluar me zbërthimin e përbërësve të jetës dhe të aktivitetit psikik dhe me identifikimin e atyre përbërësve, që nuk kanë mundësi të zbërthehen më tutje. Përbërësit e këtyre janë tre: ndijimet, përfytyrimet dhe gjendjet emocionale. Koncepti themelues i shkollës funksionalsite të Uliem Xhejmsit (William James, 1842 – 1910) i ka trajtuar proceset psikike si funksione, që përherë janë të drejtuara drejt një qëllimi duke ia përcaktuar detyrën e psikologjisë gjurmimin e rolit të këtyre proceseve në realizimin e detyrave jetësore. Sistemi konceptual i Shkollës bihejvioriste të Xhon Uotsonit (John Watson, 1878 – 1958) ka të bëjë me studimin e sjelljeve, duke shpjeguar dallimet individuale të sjelljeve dhe njësinë psikologjike më të vogël të reagimeve prej të cilave formohen sjelljet e ndërlukuara të organizmit në bazë të të mësuarit dhe ndikimit që ushtrojnë në organizëm faktorët e jashtëm. Bihejviorizmi ka zhvilluar sistemin konceptual të vetin në bazë të formulës S – R (stimulus – reagim). Psikologjia geshtaltiste ose psikologjia e organizimit të tërësive konsiderohet se është kundërreagim i hapur ndaj psikologjisë strukturaliste dhe bihejviorizmit. Kjo psikologji me studiuesit e saj Maks Verthajmer (Max Wertheimer, 1880 – 1943), Wolfgang Këler (Wolfgang Kohler, 1887 – 1967) dhe Kurt Levinin (Kurt Lewin, 1890 – 1947) ka synuar gjurmimin e tërësive psikike, sidomos të perceptimeve, sepse tërësia është kualitet (gestalt) indivual, që nuk përbëhet prej elementeve përbërëse të saj. Psikanaliza është shkolla e koncepteve të Zigmund Frojdit (Sigmund Freud, 1856 – 1939). Sipas tij baza themelore e të kuptuarit të sjelljeve të njeriut është zhvillimi psikoseksual, libido, shtytësit dhe aparati psikik i përbërë nga pavetëdija, paravetëdija dhe vetëdija (pikëpamja e parë), përkatësisht nga idi, egoja dhe superegoja (pikëpamja topike e dytë). Psikologjia humaniste është sistem konceptual i psikologut amerikan Abraham Maslout (Abraham Maslow, 1908 – 1970). Sipas tij dhe teorisë së personalitetit e bazuar në hierarkinë e motiveve, psikologjia ka për detyrë krijimin e kushteve për zhvillimin e potencialeve psikike të njeriut, duke synuar arritjen në nivelin e vetaktualizimit. Shkolla kognitive ka sistem konceptual të përmledhur nga psikologu amerikan Ulrik Neiser (Ulric Neisser, 1928), i cili në veprën e tij “Cognitive psychology” (“Psikologjia kognitive”) ka theksuar qasjen e rëndësishme të kuptimit dhe të

shpjegimit të proceseve mendore për aktivitetin e gjithëmbarshtëm psikik të njeriut.

Këto sisteme konceptuale dhe shkollat e tyre kanë depërtuar në shqipe nga dekada e gjashtë e shekullit njëzet në Kosovë dhe nga viti 1990 kanë filluar shtrirjen e tyre në Shqipëri. Sot përbëjnë strukturën e qasjeve studimore edhe nga ana e studiusve shqiptarë, duke i konsideruar pjesë të zhvillimit të psikologjisë dhe të mendimit psikologjik të përgjithshëm.

Secila nga këto shkolla të psikologjisë ka zbatuar metoda të posaçme gjurmuese. Psikologjia strukturaliste ka përcaktuar përbërësit psikik (ndijimet, përfytyrimet dhe emocionet, si edhe përshkrimin e cilësisë a kualitetit, të intensitetit dhe të kohëzgjatjes së elementeve të përmendura të pandashme, duke zbatuar metodën e vetëvëzhgimit ose të introspeksionit. Funksionalizmi ka zbatuar metodën e vetëvëzhgimit, të eksperimentit dhe të vëzhgimit sistematik. Me anë të kombinimit të këtyre metodave ka ardhur në përfundim se vetëdija dhe dukuritë e vetëdijes janë përcjellëse të aktivitetit sensorik e motorik të drejtuar në përshtatjen e organizmit të njeriut mjedisit fizik e shoqëror të tij. Psikanaliza ka gjurmuar shkaqet a motivet e sjelljeve dhe të çrregullimeve të tyre, duke zbatuar metodën e asociacioneve të lira dhe interpretimin e ëndrrave. Bihejviorizmi i është kundërvënë strukturalizmit me metodën e vëzhgimit objektiv, të matjes së reagimeve dhe të sjelljeve; ka mohuar metodën e vetëvëzhgimit dhe rezultatet e arritura me zbatimin e saj, duke mohuar njëkohësisht edhe konceptet mentaliste, kurse përmbajtjen e termave e ka zëvendësuar me përmbajtje të termave të psikologjisë objektive. Psikologjia humaniste konsiderohet fuqia e tretë (së bashku me psikanalizën dhe behejviorizmin) e psikologjisë. Për këtë fuqi, përkatësisht shkollë, gjurmimi i idealeve të njeriut, i synimeve dhe i vlerave të tij arrihet duke zbatuar metodën e vetëvëzhgimit, të vëzhgimit sistematik dhe kombinimin e tyre me qëllim të njohjes së synimeve njerëzore dhe krijimin e kushteve për zhvillimin maksimal të tyre. Psikologjia kognitive zbaton metodën gjurmuese të eksperimentit dhe atë të ndërlidhjes a korrelacionit me qëllim të njohjes së strukturave njohëse të realitetit me funksionet e tyre.

Biblioteka shqipe e veprave psikologjike

Njëqind vjet pas institucionalizmit të psikologjisë është formuar në gjuhën shqipe bibliotekë e pasur e veprave të psikologjisë në

kuptimin e botimit të numrit relativisht të madh të veprave të psikologjisë në gjuhën shqipe përbrenda një kohe relativisht të shkurtër, si edhe të disa disiplinave të lidhura ngusht me psikologjinë (filozofi, fiziologji, sociologji, etnologji, etj.). Këtu është fjala për libra dhe për një numër të konsiderueshëm veprash psikologjike burimore dhe të përkthyer që janë botuar në gjuhën shqipe. Autori i kësaj trajtese është orvatur t'i sistmojë botimet e librave shkollorë të psikologjisë dhe të veprave psikologjike kudo që ato të jenë botuar. Gjithsesi, në mos të gjitha, shumë nga këto vepra të përkthyer dhe veprat burimore përbëjnë pjesën më të madhe, dhe më të rëndësishme të bibliotekës personale të disa studiuesve shqiptarë të psikologjisë. Por kjo është më pak e rëndësishme; shumë më i rëndësishëm është fakti se në gjuhën shqipe është krijuar bibliotekë e vlefshme e veprave psikologjike të mirëfillta, kurnjëherë më e pasur se sot. Ndërkaq, kujdes më i madh i është kushtuar përkthimit të veprave të psikanalizës, të psikologjisë humaniste dhe asaj kognitive, kurse për sistemin konceptual të shkollës strukturaliste, geshtaltiste dhe funksionaliste në gjuhën shqipe ka pak botime.

Kontributin më të madh në këtë fushë e kanë dhënë botuesit nga Shqipëria, ku interesimi për të siguruar burime origjinale dhe të përkthyer është më i madh se në viset e tjera shqipfolëse. Natyrisht, kjo tregon njëkohësisht interesimin e madh për studime të psikologjisë. Në fushën e përkthimit të veprave të psikologjisë Kosova e dekadave të fundit ka dhënë shumë pak kontribut. Pavarësisht nga ndryshimet e vendeve në sigurimin e veprave të psikologjisë, fondi i këtyre veprave u rrit me një ritëm të shpejtë në dy dekadat e fundit. Studiuesit e historisë së psikologjisë ndër shqiptarët mund t'i hyjnë studimit tekstologjik të këtyre veprave për të nxjerrë në shesh dhe për të përcaktuar qartë rrugën e zhvillimit të mendimit psikologjik shqiptar, duke analizuar përmbajtjen e këtyre veprave për të dhënë përgjigje në pyetjen ku përputhet dhe ku dallon historia e zhvillimit të psikologjisë ndër shqiptarët nga skema e përgjithshme e historianit të njohur të psikologjisë Edvin Boringut (Edwin Boring, 1886 – 1968).

Ky, siç është e njohur, zhvillimin historik të psikologjisë e ka ndarë në tri etapa: 1. Etapa e parë është etapa filozofike, që ky studiues e ka përcaktuar prej Rene Dekartit (Rene Decartes, 1596 – 1650) deri te Gustav Feheneri (Gustav Fechner, 1803 – 1887), përkatësisht prej vitit 1650 deri në vitin 1860; 2. Etapa e dytë është etapa e zhvillimit institucional të psikologjisë nga Vilhelm Vunti (Wilhelm Wundt, 1832 – 1920) deri te Viljem MekDugali (William

McDougall, 1871 – 1938), gjegjësisht prej vitit 1850 - deri në vitin 1923 dhe 3. Etapa e tretë është ajo e identifikimit të faktorëve specifikë, që shtrihet prej gjurmimeve të Eduard Tolmanit (Edward Tolman, 1886 – 1959) e deri në vitet e tridhjeta të shekullit njëzet.

Nga vështrimi i thjeshtë i kësaj kohe shtrirëse dallojmë ritme të ngadalshme të zhvillimit të psikologjisë ndër shqiptarët me dendësi studimore të rralla, por të shtuara shumë nga mbarimi i dekadës së fundit të shekullit njëzet deri në mbarim të dekadës së parë të shekullit njëzet e një. Ku shfaqen ndryshime të tjera ndërmjet zhvillimit të psikologjisë së shqiptarëve prej kësaj skeme të përgjithshme dhe përse shfaqet ky ndryshim? A mund të identifikohen stadet e veçanta të zhvillimit të historisë së psikologjisë ndër shqiptarët apo ndoshta këto janë stade të gërshetuara të zhvillimit të psikologjisë dhe të mendimit psikologjik shqiptar, etj. Studime të këtilla, siç përmendëm, janë kryer nga të tjerët. Studiuesit e mirëfilltë të historisë së zhvillimit të mendimit psikologjik ndër shqiptarët duhet t'i hyjnë këtij studimi me vlerë të përgjithshme për zhvillimin e mendimit shkencor ndër shqiptarët. Më në fund, historia e medimit psikologjik shqiptar duhet të jetë pjesë e programit të institucioneve studimore të psikologjisë për të gjithë shqipfolësit, që studiojnë psikologjinë dhe për disa disiplina të veçanta të grupit të shkencave sociale, sidomos për sociologji dhe etnologji.

PSYCHOLOGY AND ITS EDUCATIONAL-SCIENTIFIC INSTITUTIONALIZATION AMONG THE ALBANIANS

Summary

The distant past of psychology and its brief history was reflected upon the development of psychology among the Albanians and its institutionalization. The psychological thought among the Albanians has passed through periods similar to those of the development of the scientific thought in general. Two are the main periods of the development of this type of thought: the pre-scientific period (mythical thought and folk psychology) and the scientific period. The scientific period, which was preceded by philosophical psychology, was characterized in particular by the beginning of the institutional development of psychology in 1879.

The institutionalization of psychology among the Albanians took place by systemizing psychological knowledge in a separate subject. The implementation of this process, which was supposed to start with the opening of the “Shkolla Normale” (Teachers’ Training College) in 1909, began with the introduction of the subject of psychology in the curriculum of the teachers’ training college in Elbasan and its introduction in the school year 1913-14.

The institutionalization of psychology in the same year also marked the institutionalization of psychology for the Albanians of Albania, Kosova, Macedonia and Montenegro. This is best shown by participation of numerous Albanian students from all over the Albanian lands in the study of psychology (half of them were from Kosova), the development of institutional psychology in Kosova by the professors who had previously completed their studies in Teachers' Training College in Elbasan, and psychological books published in Tirana and in Elbasan for the teaching of psychology to Albanian pupils and students in Kosova and elsewhere. This trend continued until the end of the first part of the 20th century.

In the second half of the 20th century, the course of the development of psychology took different paths in the Republic of Albania and in Kosova: in Albania psychology developed under the influence of the Russian school of physiology focusing in particular on the higher nervous activity. On the other hand, in the Albanian schools, which worked by the curriculum of the Republic of Serbia, psychology developed by focusing on its achievements in the states of Western Europe and anglophone states, yet, trying to give a place of merit to the conceptual system of reflexology, especially conditioned reflexes and the explanation of certain forms of learning based on the mechanism of conditioned reflexes.

Such a division continued to the last decade of the 20th century, respectively to the nineties of the last century. Since then, the distribution of psychological works and authors increased continuously (in general, according to personal interests), in particular after the establishment of the Department of Psychology at the Faculty of Social Sciences of the University of Tirana, at the Faculty of Philosophy of the University of Prishtina, and the Faculty of Philosophy of the University of Tetova. The institutionalization of psychology among the Albanians has two different levels: didactical, which lasted between 1913 and 1990, and the study level on the basis of quantitative research methods and procedures, which began after 1990 and stabilized itself at the end of the first decade of the 21st century.

Literatura:

- Gardner Murphy, "Historical Introduction to Modern Psychology", London, 1957.
 Robert S. Woodworth, "Contemporary Schools of Psychology", Methuen & CO LTD, 11 New Lane London EC 4, 1965.
 Žarko Korač, "Škole i sistemi u psihologiji", Beograd, 2008.
 Prof. Alfred Uçi, "Filozofia e T. A. Kavalitit", Voskopoja, Akademia e Re, Tiranë, 2004.
 Le Bon, "Psikologjia e edukatës", Tiranë, 1932.
 Aleksandër Xhuvani, "Fillime të pedagogjis". Pjesë e parë. Psikologji e shtime në punë të edukatës", Elbasan, 1933.
 Nuri Abdiu "Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar (deri më 1039)", Tiranë, 2003.
 Nuri Abdiu, "Bibliografi e punimeve psikologjike e për psikologjinë të botuara në vendin tone para dhe pas luftës", Shkodër, 1986.
 Duane P. Schultz University of South Florida, "A History of Modern Psychology" Harcourt Brace College Publishers, 1969.
 M. G. Jaroševski, "Psihologija u XX stoljeću", "Svjetlost" OOUR Zavod za udžbenike i nastavna sredstva – Sarajevo, 1981.

- Ndriçim Kulla, “Antologji e mendimit shqiptar 1870 – 1945”, Shtëpia botuese “Plejad”, Tiranë, 2003.
- Hajrullah Koliqi, “Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar”, Shtëpia botuese “Libri Shkollor”, Prishtinë, 2002.
- Prof. Dr. Islam Krasniqi, “Bibliografi e punimeve pedagogjike të botuara në gjuhën shqipe në periodikun pedagogjik (1945 – 1978)”, Prishtinë, 2007.
- “Elbasani Enciklopedi”, Elbasan 2003.
- Dr. Qazim Lleshi, “Normalja e Gjakovës”, Gjakovë, 1987.
- Maurice Reuchlin, “Historia e psikologjisë”, Shtëpia botuese “Kuvendi”, Lezhë 1999.
- Edmon Rrapi, “Histori e mendimit psikologjik” (autorë, koncepte, vepra), Shtëpia botuese “Pegi”, Tiranë, 2004.
- Akademik Jashar Rexhepagiq – Dr. Abdullah Vokri – Mr. Abdylaziz Veseli, “Shkolla Normale “Sami Frashëri”, Zhvillimi , karakteri dhe rëndësia e saj 1941 – 1944 (Dokumente të zgjedhura dhe kujtime), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës” Prishtinë, 1997.
- Hamdi V. Thaçi, Gjumnazi “Sami Frashëri” Prishtinë 1941 – 1944 I, Prishtinë, 2011.
- Prof. Dr. Pajazit Nushi, “Psikologji e përgjithshme”, Shtëpia botuese “Libri Shkollor”, Prishtinë, 2002.

Anton KOLË BERISHAJ, Prishtinë

FLIJIMI DHE “VETËVRASJA ALTRUISTE”

KDU 179.7

340.62

Abstrakt

Punimi “Flijimi dhe vetëvrasja altruiste” i qaset një analize socioantropologjike të ritualit të lashtë të (vetë)flijimit. Si dukuri e veçantë me karakter planetar, (vetë)flijimi lidhet me ritualet pagane të shoqërive të lashta, mirëpo me modifikime të dukshme ruhet gjer në botën moderne. Retrospektiva historike e kësaj dukurie zbulon forma të cilat oscilojnë që nga flijimi i vrazhdë i qenieve njerëzore (sidomos grave dhe fëmijëve) e deri në zëvendësimin e tyre me gjallesa që “derdhen gjak”.

(Vetë)flijimi përshkohet edhe me doza të theksuara realigjioze, si nevojë e zbutjes së mënisë së zotave, për shprehjen e admirimit ndaj të parëve – (gjurmë tipike animiste) etj. Këto rituale krijojnë simbiozë të jetës reale me elemente të theksuara mistike. Trashëgimia kulturore shqiptare ka ruajtur mite dhe legjenda që dëshmojnë lashtësinë e jetës dhe formave specifike të organizimit ta saj.

Kalaja e Shkodrës, si legjendë që lidhet me kështjellën, përveç elementeve sociokulturore, religjioze dhe mitike, në disa varianta të ruajtura shpreh formën më të vrazhdë të flijimit të gruas. Flijimi i Rozafës si ritual lidhet me besën si vlerë, që paradoksalisht nuk shpërblehet, por ndëshkohet.

(Vetë)flijimi, shikuar me dioptrinë e teorisë sociologjike dyrkemiane, del të jetë epitete i “vetëvrasjes altruiste”, e veçanta e së cilës lidhet me shkallën e integritetit të individit me grupin shoqëror.

Fjalët çelës: Flijimi, shoqëria, tradita, miti, legjenda, religjioni, kultura, grupi shoqëror, familja, gruaja, burri, vetëvrasja altruiste, integriteti.

Ndër nocionet që gjatë historisë i ka prekur civilizimet gjithandej botës, në rrethana të ndryshme shoqërore, ekonomike dhe politike, që nga format më të lashta të organizimit të jetës e gjer në kohën moderne është (vetë)flijimi. Ky ritual me kohë është shndërruar në normë sociomorale, kulturore dhe religjioze. Karakteri global i *flijimit*¹ provohet edhe me

¹ Nocionet “*flijim*” dhe “*sakrificë*”, jo vetëm në përdorimin e përditshëm, në gjuhën shqipe e zënë vendin e njëri-tjetrit. Pra, ato në shumë raste përdoren si sinonime, siç është rasti edhe me “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”, Prishtinë (1981:488), *flijimi* definohet si: “Ai që *flijohet*, *fli*, *sakrificë*. Bëj flijime. Kërkoj flijime. Jap jetën për një çështje të madhe, për inetrësia e larta të atdhutit e të popullit, bëj fli veten, bie dëshmor, bëhem theror. U flijua për lirinë e atdheut etj. Ose: bëj fli një njeri a një bagëti për nder të një hyjnie (sipas besimeve të kota). Flijonin skllëvërit (fëmijët)... E lë apo e japë diçka shumë të shtrenjtë për qëllime e

faktin se pothuajse të gjithë popujt e kanë konceptualizuar dhe standardizuar – madje edhe gjuhësisht, duke i dhënë edhe premisa hyjnore: sakrifikimi latin. **sacrificium**; ital. **sacrificio**; frëngj. **sacrifice**). Ky term është pothuajse identik me **offering** (ang.) ose atë latin **offerre** dhe me atë gjerman **Opfer**; më vonë ka derivuar jo nga **offerre**, por nga **operari** (Old High German **opfâron**; Middle High German **opperu**, **opparôn**, që kanë domethënie "për të bërë zealously, për t'i shërbyer Zotit, për t'i ofruar sakrificë atij.²

Me sakrifikim apo flijim në kuptimin fillestar e të plotë të fjalës nënkuptohet ofrim i një dhurate Hyjnisë, si shprehje e jashtme e respektit tonë me qëllim të arritjes së afrimit me atë. Për të qenë më preciz, *ofrimi* si veprim nuk bëhet vetvetiu flijim gjersa nuk kryhet këmbimi i vërtetë me dhuratën reale, të dukshme (p.sh.: vrasja/therja, derdhja e gjakut etj.). Ashtu si kuptimi dhe rëndësia e viktimës që nuk mund të përcaktohet me metoda apriori, çdo teori e shfrytëzuar për këtë qëllim duhet të bazohet dhe matet me përmbajtjen e ritualit të popujve paganë, e në veçanti të religjioneve të shpallura, sidomos të hebraizmit dhe krishterimit, e më pakë budizmit, islamit dhe protestantizmit.

*Vedizmi*³ në Indinë e lashtë është shprehur në masën që asnjëherë, në asnjë vend nuk është shfaqur. Flijimi religjioz lidhet me hyjnitë Agni dhe Soma. Një proverb indus thotë: "Flijimi është këthiza e botës". Religjioni i lashtë indian, në esencë ishte religjion i flijimit, ndërsa religjioni i lashtë persian mund të përshkruhet si religjion i observimit. Këtu dominon lufta ndërmjet të mirës dhe të keqes, Ormuzit dhe Djallit që përfundon me fitore eshatologjike të Zotit të mirë. Me këtë, religjioni i hershëm 'parseist' mund të konsiderohet si religjion 'monoteist'⁴ Flijimi i kalit në kulturën persiane, i njohur me emrin

ideale të larta, sakrifikoj. Flijoj jetën (veten). Flijoi rininë e tij. Flijoi çdo gjë). Shih: "Fjalori i gjuhës së sotme shqipe", Prishtinë (1981: 488). **SAKRIFICË** – heqje dorë me dëshirë nga të mirat vetjake, nga diçka e nevojshme a e shtrenjtë për të arritur një qëllim ose në të mirë të dikujt; **flijim**, vetëmohim etj. (Fjalori i gjuhës së sotme shqipe", Prishtinë (1981:1729).

² cf. Kluge "Etymologisches Wörterbuch der deutschen Sprache", Strassburg, 1899, p. 288.

⁴ Religjioni "VEDA" (Vedism) – faza më e vjetër e religjionit indus – sidomos ajo që është ekspozua në Rig-vedë dhe në të cilën zotat janë të ndarë në katër klasë. Lutjet flijuese 'vediane' nuk shprehin asnjë frymë nënshtrimi. Madje edhe shprehja "falemnderit" është e panjohur në gjuhën vede. Zotat plotësisht zbrasin në nivelin e shërbëtorëve të thjeshtë të njerëzimit, ndërsa 'a high-riests' ose brahmanët u nënshtrohen ritualeve të komplikuara dhe gradualisht arrijnë dinjitetin hyjnor. Ceremoniali flijues me duartë e njeriut zhvillohej gjër detajet ekstreme që shpërthente me pushtet të pazezistueshëm mbi zotat. (Shih: www.newadvent.org > [Catholic Encyclopedia](#)).

(**açvamedha**), është kryer me urdhrin e mbretit në prezencën e tërë popullit dhe ky ritual ka kërkuar përgatitje disavjeçare. Ideja mbi këtë flijim për t'i dërguar Zotit dritë duket se vjen si ndërrim me flijimin e njerëzve, që fillimisht ishte zakoni i rëndomtë.⁵

Të dhënat të cilat i publikon lidhur me dukurinë e besimit të vjetër të grekët Fustel De Coulanges, pohon se në Greqinë antike “kemi hasur në një religjion që si objekt i kishte paraardhësit, ndërsa simbol kryesor e kishte vatrën; ajo edhe e ka krijuar familjen dhe i ka pru ligjet e para. Mirëpo kjo racë në të gjitha degët e saj e kishte edhe një religjion, religjionin ku personazhe kryesore janë Zeusi, Hera, Atena, Junona, religjioni i Olimpikut helen dhe Kapitolit romak. Këto dy religjione, e para i ka gjetur zotat e vet në shpirtin e njeriut, ndërsa tjetra në natyrën fizike.”⁶

Flijimi si akt religjioz lidhet me besimet më të vjetra të këtyre popujve, pavarësisht nga karakteri politeist i religjionit, dhe ka funksionin e mëshirimit të zotave dhe të të parëve, për të evituar mëninë e tyre, gjegjësisht për të merituar përkrahjen. Lutja, flijimi dhe ofrimi i të mirave materiale ishin komponentat kryesore që dominojnë në përpjekjet e vdektarëve të zakonshëm për të siguruar afrimin me zotat⁷. “Nuk ka ekzistuar asnjë vëllazëri e cila nuk e kishte të flijuarin e vet” dhe Zotin e vet mbrojtës. Akti religjioz në këtë ishte i një natyre me atë në familje. Kjo përbëhej kryesisht nga një shujtë e përbashkët, ushqimi ishte i përgatitur mbi një flijëtoare (tryezë, A.B.) dhe ishte, pra, i shenjtë, e hanin duke u lutur; hyjnia ishte prezente dhe merrte pjesën e vet të ushqimit dhe pijes”.⁸ Zakoni i lashtë i ekspozimit të ushqimeve në varreza (ushqime që derdhin gjak dhe ato që nuk kanë gjak), për mëshirimin e Zotit të nëntokës, Hadit, ritual ky që ka mbijetuar në disa klutura gjer më sot, është shoqëruar edhe me gosti të mëdha dhe të shtrenjta, të njohura si “*theoxenia*”, ngjashëm më

⁵ (Cituar sipas: f. Hardy, "Die vedisch-brahmanische Periode der Religion des alten Indiens", Münster, 1892, p. 150).

⁶ Kulanzh De Fustel (Fustel De Coulanges (1998:145), Antička država (Le Cite Antique), Platon, Beograd.

⁷ Të krishterët besojnë në fuqinë e flijimit si akt me vlerë çudibërëse nëse Zoti e ka flijua djalë të vetëm; Myslimanët këtë e kryejnë me shkuarje në Haxh. Secili zot shtëpie – në Mekë apo në shtëpi, e flijon një dele (ose ndonjë krijesë tjetër si kompensim i kësaj) – për respekt ndaj fesë së Abrahamit dhe secili fëmijë është i njohtuar se ekziston, sepse ashtu ishte vullneti i Zotit (Cituar sipas: In Relative Values: Reconfiguring Kinship Studies, editet by Sarah Franklin and Susan Mc Kinnon, Durham. Duke University Press, (2001:448).

⁸ Kulanzh De Fustel (Fustel De Coulanges (1998:141,142).

“*leotisterninë*” te romakët. Si rregull ka qenë djegia e të mirave të ekspozuara në altar, e njohur me termin “holocaust”⁹. Më vonë do t’i referohemi formës më të vrazhdë të flijimit të fëmijëve që ka mbijetuar në saje të shkrimeve të ruajtura mbi Agamemnonin, i cili e flijon bijën e vet, Ifigjeninë, në veprën e njohur “Elektra” të Euripidit.

Te romakët e lashtë flijimi praktikohet nga përafërisht të njëjtat motive si te popujt tjerë: të meritohet përkrahja dhe mëshirimi i perëndive, të evitohen fatkeqësitë dhe fati ters. Hebrejtë¹⁰ kanë ruajtur në sistemin e tyre të flijimit rite dhe ide që janë ruajtur nga religjioni pagan. Ky fakt paraqet një befasi se si është e mundur që religjioni i reformuar nuk i ka hudhur ritualet dhe normat etike të religjioneve të lashta, por i ka adaptuar në një formë të lartë¹¹.

Religjioni kinez – një kompleks i adhurimit të natyrës dhe paraardhësve, është i pandashëm me konstituimin e shtetit. *Sinismi*, si religjion më i vjetër, ishte një monoteizëm i përkryer. Mirëpo ne më së miri e njohim këtë sistem të flijimit kinez në formën që e ka dhënë reformatori i madh Konfuqi (gjashtë shekuj para Krishtit), sistem ky që është ruajtur pothuajse i pandryshuar edhe pas gadi dy mijë vjetëve. Siç është “i biri i Qiellit dhe prijës shtetëror i fesë, cari kinez ishte po ashtu edhe klerik i lartë, i cili i vetmi ka mund t’i ofrojë flinë qiellit. “I biri i Diellit” e bënte flijimin për vazalët e zotave, tokës dhe drithit.”¹²

⁹ Shih: www.newadvent.org > [Catholic Encyclopedia](#)

¹⁰ Abrahami është patriarku i parë kulturor dhe emri i tij ka kuptimin e “babait ekzaltues” edhe si Abraham e edhe si “baba i shumë popujve”. Ai është konsideruar baba i tri feve të shpallura monoteiste: judaizmit, krishterimit dhe islamit. Edhe përkundër shfaqjeve të qarta të shpallura Mojsiut, Jezusit dhe Muhamedit, të tri këto tradita fetare e lidhin origjinën me Abrahamin dhe kjo është arsyeja pse ata thirren në “religjionet abrahamike”. Ekzistojnë shumë epizoda të tregimeve mbi Abrahamin, mirëpo rrëfimi i cili është themel dhe atë e bën “baba” të fesë është ai që paraqitet në “Krijimi 22”. Këtu rrëfëhet se ai ishte i vullnetit të flijojë djalin e vet, sepse Zoti e këkoi këtë nga ai. Pra, ai bëhet baba i fesë jo për të mbrojtur djalin e vet, por për shkak të gatishmërisë së tij që ta sakrifikojë atë, meqë Zoti e kërkonte nga ai. “Merre djalin tënd të vetëm të cilin e don dhe shko në krahinën Mori dhe atje vendose në zjarr në njërin nga kodrat të cilat unë t’i tregoj” (Krijimi 22: 02), cituar sipas: “In Relative Values: Reconfiguring Kinship Studies, editet by Sarah Franklin and Susan mc Kinnon, Durham. Duke University Press, (2001:447).

¹¹ Lidhur me këtë, shih: (cf. [Deuteronomy 12:31](#); [18:10](#)). Abraham's trial (Gen. xxii 1 sqq.) ended with the prohibition of the slaying of Isaac, [God](#) ordering instead the sacrifice of the ram caught in the briars. Among the [Children of Israel](#) human sacrifice meant the profanation of Jahëeh's name ([Leviticus 20:1](#) sqq., etc.).

¹² Shih: www.newadvent.org > [Catholic Encyclopedia](#)

Te egjiptasit, mëshirimi i Zotit dhe lartësimi i tij është bërë rregullisht në bankete dhe argëtime, me ushqim, pije dhe tryeza të mbushura përplot, si simbolikë e flijimit. Në vendosjen e gurthemelit të objekteve të reja fetare janë ofruar viktimë njerëzish, sistem ky që u ndërpre vetëm në kohën e Ramassides; gjurmët e këtij zakoni të neveritshëm kanë mbijetuar në ceremonitë e mëvonshme, mirëpo tani si kujtim përmes një portreti të skalitur të burrit të lidhur me zinxhirë dhe me thikë në fyt. Për nderë të Zotit të tyre Ammon-RA, pushtetarët e mbretërisë së re kanë ruajtur traditën duke organizuar aq shumë bankete të shtrenjta sa që shteti ka qenë para bankrotit¹³.

Sistemi fenikas i flijimit i kishte disa pika të përbashkëta me sistemin izraelit. "Tryeza e flijimit nga Marseja" njësoj si "sofra e Kartagës" kishte origjinë fenikase (qe, viça, kaprolla, drenusha – të buta dhe të egra). Mirëpo në këtë sistem hetohen edhe gjurmët e ritit të stërlashtë të flijimit të fëmijëve si përpjekje për të mëshiruar Zotin e tmerrshëm, zakon ky po ashtu mizor kundër të cilit është angazhuar dhe ka luftuar Bibla. Kulti i farefisnisë buron nga idetë e errëta të hyjnive që anojnë kah pikëllimi, vrazhdësia dhe mizoria. Duhet përmendur adhurimin e Baaland Astartës, Phallismit dhe flijimin e virgjërisë, flijimin e të rriturve dhe fëmijëve, që romakët e civilizuar kot janë përpjekur t'i ndalojnë.¹⁴

Pushtetarët "profetë" të mëvonshëm kanë ngritur zërin kundër këtyre zakoneve morbide të flijimit të fëmijëve në emër të Molohit. Në ruajtjen e këtij zakoni të lashtë s'do mend se patën ndikim ambientet fqinje pagane që kishin pushtuar mendjen e mbretërve Achaza dhe Josiasa në atë masë sa që edhe në ultësirën famkeqe të Hinomesë, afër Jerusalemit, mijëra fëmijë të pafajshëm janë flijuar në emër të Molohit¹⁵. Janë të njohura edhe tregimet jashtëbiblike të cilat

¹³ Ibid.

¹⁴ Ibid.

¹⁵ Moloh - Moloch, also rendered as Molech, Molekh, Molok, Molek, Molock, Moloc, Melech, Milcom, or Molcom (representing Semitic מלך *m-l-k*, a Semitic rrënjë d.m.th. "mbret") është emri i një Zoti të lashtë Ammonit. Moloch ka qenë i adhuruar nga kanaanacët, fenikasit dhe kultura të afërta në Afrikën Veriore dhe në Levantu. I adhuruar si Zot nga fenikasit dhe kanaanaci Moloch ishte besim me një lloj zakoni morbid të flijimit të fëmijëve nga ana e prindërve. Personazhet Moloch në librin "Deuteronomy" (Deuteronomy (Ancient Christian Commentary on Scripture: Old Testament, Volume III) të Levitskit si formë e idolonënshtimit (Levitski 18:21). Moloch është shfrytëzuar figurativisht në letërsinë angleze të John Miltonit Paradise Lost (1667) dhe Allen Ginsbergut në "Howl" (1955), që kanë të bëjnë me personin apo sendin që kërkojnë viktimitë të shtrenjtë. (From Wikipedia, the free encyclopedia).

të keqen shoqërore, sidomos vrasjen e sundimtarit përpiqen ta interpretojnë si akt vëllavrasës që ka ndodhur në zëna fillën historike të një populli. Në këtë mënyrë, fillimi i historisë së Romës, ku Romuli e vret vëllain e vet Remin dhe si vëllavrasës qendron në fillimin e historisë së përgjakshme të mbretërve romakë, e cila është përplotë atentate dhe vrasje ka domethënien e vet. Me fjalë të tjera, historia e fitimtarit më së shpeshti është histori e vrasësit dhe kjo është arsyeja pse është aq mizore dhe e përgjakshme. Rrëfyesit biblikë mbi Kainin dhe Abelin dhe ky tregim romak kanë të përbashkët vetëm motivin, ndërsa dallimi esencial qendron në faktin se këtu historia e vrasësit (Kainit, A.B.), nuk rrëfëhet si histori e fitimtarit dhe nuk paraqet ideal. Përkundrazi, Kaini është paraqitur si viktimë e të keqes së vet dhe ky nuk ka zgjidhje për rastin e vet.”¹⁶

Megjithatë, flijimi u ndryshua duke u zëvendësuar qeniet njerëzore më kafshë të ndryshme, mirëpo ajo që mbeti konstante në këto rituale është derdhja e gjakut. Flijimi (zakonisht i ndonjë kafshe) pas aktit të pajtimit të palëve në konflikt në praninë e ndërmjetësve është ruajtur te shumica e shoqërive patriarkale. Në traditën tonë kjo njihet si *e kemi hangër bukën*, që simbolizon përforcimin dhe vënien pikë në fund të një procesi. Derdhja e gjakut (flijimi) i ndonjë kafshe (sërish si derdhje gjaku), edhe sot praktikohet me rastin e vënies së gurthemelit të shtëpisë familjare të banimit.

Në këtë kontekst, historia e lashtë shqiptare që përçohet nëpërmjet rrëfimeve të miteve dhe legendave, siç është ajo e **Kalasë së Shkodrës (Rozafës)**, për shkak të marrëdhënieve me fqinjët të cilat nuk kanë qenë në vazhdimësi destruktive, por ka pasur edhe kontakte sociokulturore simbiotike, mund të mos veçohet me origjinalitetin e saj historik, mirëpo në esencë përmban shumë elementet mitike të flijimit, që përkohet me veçoritë e traditës shqiptare. “Në periudhën e ndërtimit të kështjellës treva banohej nga fisi ilir i Labeatëve, lundrimtarë e tregtarë të zotë. Në këtë kohë qyteti merr një zhvillim ekonomik, gjë që dëshmohej nga prerja e monedhës në qytet që në vitin 230 p.e.r. Kështjella ka një histori të gjatë luftarake dhe një gojëdhënë popullore e baladë të lidhur me qytetin e Shkodrës. E ndërtuar gjatë Mbretërisë Ilire, përfaqësohet nga një legjendë që tregon mbajtjen e një premtimi, premtimit të besës legjendare. Rozafa, nusja e më të voglit ndër tre vëllezërit (baca Gjergj) u muros e gjallë

¹⁶ Glas Koncila 4 (1753) | 27.1.2008. Vjeronauk za odrasle, Ivan Dugandžić
UPOZNAJMO BIBLIJU, Kain i Abel: prvo bratoubojstvo.

në themelet e kalasë pas këshillës së një plakut, siç tregon legjenda, - si një sakrificë për të ndalur përgjithnjë syrin e keq që shkatërronte muret për çdo natë“.¹⁷

Rrëfimi fillon me përshkrime të zakonshme për legjendat, ku gërshetohen elementet mistike me jetën reale. Mjegulla në këtë rast simbolizon mëninë e zotave si paralajmërim që kërcënon jetën nëse nuk kryhet flijimi si i vetmi akt që ka fuqinë e zbutjes së tij. “...I ra mjegulla Bunës dhe e mbuloi të tanë. Tri ditë e tri net kjo mjegull mbeti aty...”¹⁸ Mesazhi që bartet nga “plaku” (lexo: shenjti) si lajmëtar i zotave të mënirë (të inatosur), e jo ndonjë orakull kalimtar, pasi që vetë legjenda i jep atij veçori mistike kur e përshkruan krijesë me aftësi të vegjimit (“...tha kështu plakut e shkoi: njitash u pa, njitash s’u pa”¹⁹, del të jetë në shërbim të lidhjes së zotave të plotfuqishëm që e shtrijnë pushtetin mbi jetën dhe fatin e njerëzve vdektarë të zakonshëm, në këtë rast vëllezërve “ustallarë”.²⁰ Funksionalizimi i kësaj lidhjeje - zotave të mënirë dhe “ustallarëve” të cilët marrin përsipër kryerjen e aktit të filijimit – është një kombinim ideal për të justifikuar flijimin si vlerë të dëshmuar shoqërore, por edhe parakusht për krijimin e një shoqërie funksionale dhe të qëndrueshme. Barleti më 1504 në “Rrethimi i Shkodrës”, “... nuk i përmend situatat dhe nuk e përmend flijimin, ndoshta pse ai është monoteist. Për këtë çështje shprehet më hollësisht në një studim Vili Kamsi.”²¹

Mirëpo, unë seriozisht nuk e shoh lidhjen ndërmjet monoteizmit dhe heshtjes së aktit të stërlashtë të flijimit, sado brutal që duhet të ketë qenë, pasi që flijimi si ritual qarkullon gjithandej botës dhe është ruajtur dhe përcjellur brez pas brezi. M. Barleti mbase edhe si klerik do ta kishte rrëfyer këtë legjendë në variantin e saj origjinal pa ndonjë hezitim sikur ta kishte dëgjuar në atë formë sidomos kur dihet se periudha e Mesjetës është e stërmëshur me storiet më mizore mbi

¹⁷ <http://www.gjuhashqipe.com/albanologji/albanologjiqytete.aspx?id=301>, Kalaja e Rozafës.

¹⁸ Ibid.

¹⁹ Ibid.

²⁰ Puna'mbârë, o trë vllazën. T'mbârë paç, o plak' i mirë. Po ku e shéh ti t'mbârën t'onë? Ditën punojmë, natën ná shëmbët. A dín me ná diftue ndôj fjalë t'mirë: shka t'bâjmë qi t'i mbâjmë muret n'kâmbë? - Unë di,- u thot' plakut,- po druej me iua thânë se â' m'kat. - At' m'kat hidhe mbi kryetin t'onë, se na duem ta qindrojmë më kâmbë nji'kyt k'shtjellë. (Shih: http://sq.wikipedia.org/wiki/Kalaja_e_Shkodr%C3%ABs).

²¹ Ibid.

viktimat e fushatës së *inkuizicionit* (ndjekjes së shtringave) pikërisht nga qarqet e Selisë së Shenjtë, klerik i së cilës ishte edhe vetë Barleti²².

Rozafa në këtë legendë nuk shfaqet si viktimë e akuzës, por si “objekt” flijimi me më pak vlerë dhe më pak e dhimbshme se çdonjëri nga vëllezërit ‘ustallarë’. Megjithatë, nëse ka ndodhur fshehja e qëllimtë e murosjes së një nëne që ka një foshnje në gji (akt padyshim tepër brutal), në emër të besimeve bestypte që kanë dominuar edhe te populli të cilit i përkiste, kjo duhet të ketë ndodhur nga përpjekja e Barletit për të ndalur vazhden e këtij procesi në kontekstin e rrethanave që për nga niveli i zhvillimit sociokulturor, moral dhe ekonomik nuk ishte shikëputur shumë nga tradita e kohës së murosjes së Rozafës.

Pavarësisht se legjenda në rastin konkret ia “vë në gojë” plakut përzgjedhjen e viktimës (njërës nga gratë), patrilinearizmi si premisë bazike e organizimit shoqëror manifestohet si impuls inercioni që duhet ta ketë dominuar dilemën e zgjedhjes së viktimës për aktin e flijimit. Viktimë duhet të jetë jo kushdoqoftë, por njëra nga gratë?! Mbetet enigmë pse jo njëri nga vëllezërit nëse në kontekstin patriarkal të jetës, vlера e burrit ishte më e lartë? Sidoqoftë, nëse “fshehja” e mizorisë së flijimit (si murosje e gruas së gjallë) në versionin e legjendës së regjistruar nga Barleti është e qëllimtë, ai padyshim e synon “zhveshjen” e legjendës nga petku mistik. Këtë madje e bën në atë masë sa që del përtej interpretimeve bestypte dhe paragjyqimeve të zakonshme zakonore të asaj kohe ndaj gruas si qenie e degraduar, që matej me gjysmën e vlerës së burrit. Ai, pra, e fuqizon gruan, ia jep rolin e qenies kreative, të dobishme dhe të denjë të krijojë vlера, qytete dhe qytetërime, sidomos kur shkruan: “Na patën rënë në dorë disa shkrime... Ishin shkruar aty në gjuhën popullore se njëfarë Roza me motrën e vet, të quajtur Fa, qenë themeluesit e parë të Shkodrës e prandaj fortësa e saj quhet Rozafa.”²³

Në anën tjetër, përkundër interpretimit të apologjetit kishtar çfarë ishte Barleti, popullit i “hyn në punë” mesazhi i ‘plakut’, lajmëtarit të kohës, sepse shfaqet si refleksion i simbiozës së reales dhe bestyptes – me çka i jep legjendës jo vetëm që i jep karakter religjioz, por edhe e legjitimon dhunën ndaj gruas në nivelin e

²² **Inkuizicioni** (lat. *inquisitio* – gjurmim, hetim) është emërtim i një vargu original të institucioneve kishtarë që nga shek.12 e gjer në kohën e luftimeve të Napoleonit në Evropën Perëndimore. Janë themeluar me qëllim të luftimit të herezisë, mirëpo më vonë destinimi i tyre është zgjeruar duke përfshirë këtu edhe fushatën e ndjekjes së shtringave. (<http://hr.wikipedia.org/wiki/Inkvizicija>).

²³ Ibid

zhvillimit shoqëror ku dominon logjika patriarkale e subordinimit sitematik të saj nga burri. Në anën tjetër, mesazhi i tij është në shërbim të forcimit të bindjes se veprat e mëdha kërkojnë sakrifica, qofshin ato edhe aq mizore, siç është murosja e gruas së gjallë në murin e kalasë.

Besa: Ciladoqoftë nga gratë e ustallarëve që u sjell bukën (në legjendë flijohet gruaja e më të sinqertit dhe më besnikut, element ky që bie ndesh me normat sociokulturore, morale dhe religjioze të traditës), në këtë legjendë merr rolin e viktimës. Mirëpo ky ishte çmimi i besës si vlerë, pesha e rëndë e saj: burri flijon gruan, ndërsa gruaja pa kundërshtim i nënshtrohet kodit moral të vullnetit të burrit. Ajo bie fli për të ruajtur integritetin moral të burrit të saj, i cili i vetmi e mbajti besën. Ky moment në rolin e Rozafës mbase reflekton me një “shkëndijë” të aktivizmit individual. Shikuar retrospektivën e funksionimit familjar dhe shoqëror, legjenda nuk paraqet ndonjë origjinalitet, mirëpo megjithatë shfaq simbolikën e gruas si gurthemel i “ngrehinës” me vlerë jetike shoqërore.

Ajo, pra, nuk shfrytëzohet as si eksponat i pavlerë kanunor, as si subjekt i denjë për respektim, por si “objekt” me vlerë që posedon forcën e shfuqizimit të mallkimit dhe ruajtjes së “fytyrës” së burrit. Mirëpo as flijimi nuk mjafton që Rozafa të mos “zhveshet” plotësisht nga ato komponente që e bëjnë personalitetin e saj të veçantë, me integritet dhe dinjitet. Ajo thjesht është një qenie që vritet e nuk vetëvritet, së cilës përveç emrit (për të cilin Barleti madje shkruan se është kompozitë e dy emrave: Roza dhe Fa) nuk mbetet asnjë trashëgimi që vlen të mbahet mend. Rozafa në instancën e fundit del të jetë viktimë e burrit të saj, ndërsa besnikëria e tij e “verbër” si vlerë e synuar më tepër lë shije të naivitetit.

“Flijimi si veprim del të jetë këtu shumë i ndjeshëm, pasi që prodhon efekt të dyfishtë: njërin mbi objektin për të cilin bëhet dhe mbi të cilin synohet ndikimi dhe tjetri mbi personin juridik i cili e dëshiron dhe provokon këtë efekt. Nganjëherë vlera e flijimit kushtëzohet me këtë efekt të dyfishtë. Kur një zot shtëpie sakrifikon për të vënë gurthemelin e shtëpisë së tij, kërkohet që jo vetëm shtëpia të jetë në gjendje të strehojë familjen e tij, por edhe familja të jetë në gjendje të hyjë në atë.”²⁴

²⁴ “Essai sur la nature et la fonction du sacrifice.” (Ese mbi natyrën dhe funksionin e sakrificës), **Henri Hubert dhe Marcel Mauss**, *Année sociologique*, tome II, 1899, page 47. http://www.uqac.quebec.ca/zone30/Classiques_des_sciences_sociales/index.html

Kjo qenie e brishtë e quajtur grua pajtohet me fatin që ia përcaktojnë burrat e familjes. Hesht dhe vdes pa asnjë kundërshtim pikërisht në mënyrën që shoqëria e ka edukuar dhe që pret nga ajo. E dëgjueshme, e butë, e prirur të nënshtrohet, edhe Rozafa është prototip i gruas që bindjen dhe nënshttrimin e konsideron virtyt e jo ves. “Mbi të njëjtat baza e ka përgatitur edhe Alison Lurie përmbledhjen e vet »Clever Gretchen and Other Forgotten Folktales«, Heinemann, London, 1980. Qasjen e vet e ka arsyetuar me faktin se në zgjedhjet e gjertanishme (të cilat kryesisht i përbënin meshkujt e shk. XIX), heroinat janë kryesisht pasive, të mira, të pafuqishme dhe të mërzitshme, gjë që pritej nga vajzat e atyre kohërave. Mirëpo mijëra tregime popullore e kundërshtojnë atë botëkuptim, ato i ka rrëfyer A. Lurie, e cila me këtë ka dëshiruar t’u kthejë zërin e mirë te fëmijët dhe prindërit e sotëm me shpresë se ndonjëra nga ato heroina të treguara një ditë do të bëhen njësoj të famëshme siç janë sot Hirushja dhe Borbardha.”²⁵

Legjenda e shfaq tërë vrazhdësinë e normave shoqërore ndaj gruas viktimë, duke i mohuar asaj (Rozafës) madje edhe të drejtën për të kundërshtuar apo për t’u bindur. Frika e natyrshme njerëzore nga vdekja dominohet nga kujdesi dhe dhembja për foshnjen që e kishte në gj, kështu që as vdekja nuk duket heroike (meqë ky nuk është funksioni i saj), por del të jetë krejt e natyrshme.

Gjiri jasht – këkesë groteske e saj sipas legjendës, e simbolizon jetën, mirëpo edhe këtu elementi patrilinearist e dominon madje edhe vdekjen, duke e skalitur foshnjen që e ushqen në gj me gjini të përcaktuar si djalë. Kërkesat e vetme të Rozafës sipas legjendës lidhen me jetën, me pasardhësit, që në mënyrë të tërthortë tingëllojnë si kushte të flijimit. “Uji gëlqeror që kalon ndër muret e kalasë lidhet në fantazinë e folklorit me qumështin e gjirit të Rozafës, kërkesa e së cilës si akord për të pranuar sakrificën ishte lënia e anës së djathtë të trupit »sýnin e djathtë qi t`shoh birin t`em, krahun e djathtë qi ta mbâj, gjinin e djathtë qi ta ushqej, kâmben e djathtë qi me përkûnd djepin« që të kujdesej për të birin e sapolindur.”²⁶

Flijimi si akt moral sociokulturor është shfrytëzuar si element i përdorshëm për ndërtimin e strukturave të legjendave, ciklit të kreshnikëve dhe epikës shqiptare përgjithësisht (Rozafa, nëna dhe motra e Mujit dhe e Halilit, motra e Gjergj Elez Alisë, Nora e

²⁵ LYDIA SLEVICKY (1984:72), Narodna umjetnost 21 (1984), rasprave i osvrti, Zagreb.

²⁶ <http://www.gjuhashqipe.com/albanologji/albanologjiqytete.aspx?id=301>, Kalaja e Rozafës.

Kelmendit etj.). Mirëpo e përbashkëta e këtyre grave është se u mungon doza e nevojshme karizmatike, impulsi personal për veprime autonome, të ndërgjegjshme se nuk munden të veprojnë jashtë dinjitetit të kërkuar patriarkal. Përveç Norës së Kelmendit së cilës autori ia “injekton” një dozë paksa më të fortë të vetakcionit, gratë tjera kryesisht u nënshtrohen presioneve të normave të kontrollit joformal të kohës, të zakoneve rigjide dhe sjelljeve të imponuara nga mileu kulturor i shoqërisë segmentare. Ato janë në shërbim të grupit shoqëror për të kryer veprime të cilat priten nga ato, sepse siç pohuam më lartë, modeli patriarkal i edukimit të tyre bazohet në përvujtni, dëgjueshmëri, besnikëri, butësi dhe prirje për nënshttrim.

Trashëgimia epike shqiptare ruan mite, legjenda dhe tregime nga më të ndryshmet të cilat me shekuj kanë mbijetuar duke u kënduar dhe lartësuar si shembuj të flijimit të femrës për familjarët. Kënga e Gjergj Elez Alisë është ndër shembujt margaritarë të sakrificës së motrës për vëllain e lënduar. Gjergj Elez Alia me nëntë plagë në trup mbijetoi në saje të përkushtimit të motrës që t’ia shërojë plagët dhe ta ndihmojë vëllain. Në një moment vëllai dyshon në disponimin e motrës dhe në mënyrë të tërthortë e akuzon atë se është lodhur duke i shërbyer atij dhe dëshiron të martohet. Motra reflekton me një sinqeritet dhe siguri, duke i thënë vëllait: *“Hifsha gjallë nën dhe në më shkon mendja me u martua...”*. Mirëpo, shembulli i motrës së Gjergj Elez Alisë, të cilës as nuk i dihet emri, është vetëm njëra ndër kategoritë e “virgjineve të betuara”.

Një trajtim i këtillë i gruas si krijesë që i përshtatet flijimi për të tjerët dhe që pritet nga ajo që këtë rol ta luajë në pajtim me normat e shoqërisë, nuk është specifikë vetëm e ambientit shqiptar në të kaluarën. Përpjekjet sado të vogla qofshin që gruaja të dalë nga korniza stereotipe dhe të menjanojë pritshmërinë shoqërore, duke manifestuar sjellje të cilat nuk përkojnë me normat zakonore përcillej me reagime nga më të ndryshmet: “Në Evropë ka shumë gra të cilat merren me punë burrash dhe të cilat për këtë arsye përtojnë të hyjnë në martesë. Gratë e këtilla lirisht mund të quhen – *gjini e tretë*, që do të thotë se këto gra nuk janë as burra, as gra. Pamja e tyre fizike dhe struktura mentale nuk përkojnë me burra, ndërsa obligimet dhe puna që kryejnë nuk përkojnë me gra.”²⁷ Në këtë mënyrë, në fund të shekullit XIX, në **Revue des deux mondes** shkroi **V. Fereri i famshëm**, duke u ankuar për konfuzionet e përgjithshme gjinore të

²⁷Predrag Šarčević, VIRDŽINA – ŽENA KOJE NEMA, Treći program, Bgd.

cilat, sipas mendimit të tij, me sjellje të “padenja” e kanë shkaktuar pjesëtarët subverzive të lëvizjes së atëhershme për emancipimin e grave në qendrat urbane të Evropës Perëndimore.

Për shkak të gjithë kësaj, neveria e Fererit ndaj identitetit të paqartë dhe të dykuptimshëm të shifrazhetkinjave dhe punëtoreve industriale nga fillimi i këtij citati, në shikim të parë duket plotësisht i kuptueshëm dhe i arsyeshëm. Ato nuk kanë përkuar me kornizën konceptuale, morale dhe normalisht as politike të botës së tij dhe ai ka reaguar në të vetmën mënyrë logjike, në atë mënyrë që i ka akuzuar për anomalitet! Ajo që atij i ka mungar e që ne e kemi është njohuria mbi rëndësinë e dallimit analitik të **gjinisë** (seksit) si shprehje e biologjisë dhe natyrës dhe **rolit gjinor** (gender) si prodhim i kulturës dhe edukatës.²⁸

Në këtë mënyrë historia krijon një laryshi tablosh skenike ku nuk mungon as gruaja shqiptare, mirëpo në të kaluarën ajo nuk i merr rolet, por i ndahen, e ato janë kryesisht dytësore, në shërbim të kryeheronjve, në sfond të jetës si shërbyese e përvujtur dhe besnike e prindërve, vëllezërve, burrit apo të bijëve. Përndryshe, më së shpeshti gruan e hasim në vorbullin e intrigave dhe shkaseve për situata që e sfidojnë machizmin, trimërinë dhe burrërinë si vlera kulmore të rezervuara për mashkullin. Pra, gruan herë e hasim në rolin e ndonjë heroine që sakrifikon për të tjerët, herë si eksponat të përcëmuar të traditës që mund të gjendet dhe “tregtohet” kurdo, ose si mekanizëm i ripërtëritjes biologjike pa personalitet... Depersonalizimi i gruas përvijohet si element i fuqizimit të burrit përkrah saj, pavarësisht në çfarë relacioni janë ndërmjet veti: e bija e shndërruar në virgjinë të betuar, gruaja e vëllait të vogël apo motra e Gjergje Elez Alisë, Mujit e Halilit etj.

Edhe legjenda mbi Kalanë e Shkodrës e ruan frymën mitike të aktit të flijimit të gruas, në këtë rast të Rozafës, në formën që e hasim edhe te popujt tjerë të lashtë (Ifigenia në Elektra)²⁹. Kjo lehtësi e

²⁸. Ibid

²⁹ **Elektra** është tragjedi greke të cilën e ka shkruar Euripidi. Kjo vepër u krijua rreth vitit 410. para Krishtit. Nuk është vërtetuar se cili e shkroi më parë Elektrën: Euripidi apo Sofokliu. Vite më parë se ndodhi ngjarja e tragjedisë, para luftës së Trojës, prijësi ushtarak Agamemnoni e flijoi bijën e vet Ifigeninë pr t'a mëshirua perëndeshën Artemida në mënyrë që të lëshojë erën dhe anijet greke të lundrojnë në Trojë. Gruaja e tij, Klitemnestra nuk ia fali kurrë këtë akt dhe së bashku me dashnorin e saj Egistin, e vranë Agamemnonin pas kthimit nga lufta. Ngjarja e tragjedisë e përcjell të bijën e Klitemnestrës, Elektrën dhe vëllain e saj Orestin, të cilët i hakmirren nënës dhe njerkut. Pas Euripidit, motivin e Ifigenisë e kanë përpunuar shumë nga autorët e njohur, si psh: Jean Racine, Goethe, dhe në kohën e sotme Ismail Kadare.

padurueshme e vrasjes së saj i siguron përjetësinë, por vetëm si viktimë mbi të cilën ushtrohet dhunë e jo si heroinë që vetëflijohet për të tjerët.

Në këtë legjendë jo, mirëpo epika jonë është e stërngarkuar me heroizma ku edhe burrat janë në role të atyre që sakrifikojnë jetën për të mirën e përbashkët shoqërore, madje shumë më shpesh se gratë. Mirëpo për ndryshim nga ato, burrat nuk i *flijojnë*, por *flijohen*. Akti i vetëflijimit e ruan personalitetin, dinjitetin dhe sensin e tyre për jetë sociale. Vetëflijimi e implikon komponentën e vetëdijes së lartë morale, për ndryshim nga akti i flijimit nga të tjerët ku gruas përveç personalitetit i mohohet edhe e drejta për aktivizëm shoqëror, solidaritet dhe gatishmëri që të dëshmojnë vlerën e vet brenda grupit shoqëror. *Vetëflijimi* është akti më i lartë individual në shoqërinë segmentare – komponentë qenësore e vetëdijes kolektive, ndërsa *flijimi* është dhunë, degradim dhe mohim i personalitetit.

Andaj, storia e legjendës duke rrëfyer për vrasjen e një qenieje njerëzore të pafajshme - gruas, rrëfen edhe për vrasjen e së drejtës për deklarinimin e vullnetit të lirë të saj, mohimin e të drejtës në përzgjedhjen e vlerave, shprehjen e individualitetit, personalitetit, integritetit moral dhe fizik, trajtimit si qenie me sens për dhe kundrejt kërkesave shoqërore. Kjo flet për rigjyditetin e normave të cilat e ngulfasin hapësirën e gruas që të dëshmohet si e dobishme dhe të çojë jetë të dinjitetshme. Privimi nga e drejta e vetëflijimit del të jetë më mizor edhe se vetë akti i flijimit të saj.

Analiza e nocionit “**(vetë)flijim**”, pavarësisht nga karakteri planetar i tij, i shikuar nga prizmi teorik apo praktik, si rezultat i aktivizmit personal apo si i nxitur nga presioni i normave sociokulturore, religjioze dhe morale, si epitete të heroizmit apo i flijimit nga të tjerët, si reagim vetanak ndaj sfidave apo për të plotësuar pritjet e të tjerëve, siç pamë, ndodh në kohëra dhe hapësira gjithandej botës dhe në instancën e fundit del të jetë i dhunshëm. Edhe Mic Sokoli që “mbuloi” grykën e topit me gjoks, edhe motra e Gjergj Elez Alisë që flijoi rininë duke shëruar për nëntë vjet plagët vëllait, njëjtë si cilado vajzë ‘pa emër’ që hyri në celibat për të ‘ndrequr gabimin e Zotit që nuk i fali vëlla’, ose Rozafa që e murosën të gjallë duke e privuar nga e drejta për të bërë zgjedhjen e fatit të vet..., flijohen nga të tjerët. (Vetë)flijimi, pra, nuk është flijim, por shprehur me gjuhën e E. Durkheim-it, është “**vetëvrasje altruiste**”, ndërsa flijimi nga të tjerët është thjesht vrasje. Durkheim-i në veprën e tij “*Vetëvrasja*” konkludon se me rënien e solidaritetit mekanik për shkak të ndarjes së

punës dhe industrializimit, rriten forcat të cilat e shkaktojnë anominë dhe egoizmin, me çka njësoj goditen të gjitha klasat.

Edhe pse vetëvrasja është akt individual, shembullin ekstrem të përzgjedhjes vetanake dhe të shprehjes personale e të kontrollit mbi fatin e vetvetes Durkheim-i i konstaton shkaqet sociale dhe me themelin e disbalansit të integritit social dhe regulacionit moral e nxjerr tipologjinë e vetëvrasjes. *Vetëvrasja egoiste* është pasojë e individualizmit dhe mungesës së integritit social, i cili mbetet pa përkrahje sociale, pasi që shoqëria religjioze, pjesë e së cilës është ai, e ka humbur kohezionin e vet (1979:185). Pra, shikuar nga ky prizëm, karakteri i vetëvrasjes varet nga shkalla e integritit të grupeve shoqërore të cilave ai u përket (1979:230).

Përkundër vetëvrasjes egoiste, **vetëvrasja altruiste** ndodh si rezultat i integritit të plotë, kur individët për shkak të lidhjes së fuqishme me grupin e humbin perceptcionin e individualitetit të vet dhe flijojnë për interesa të grupit. Pika kryesore referuese e sjelljes së individit është e vendosur jashtë ‘vetes’ së tij, pra në grup, pjesë e së cilës është ai. (1979:242:243)³⁰.

Andaj motivin për (vetë)flijim duhet kërkuar në shkallën e integritit të individit dhe mekanizmat homogjenizues, siç janë: ndjenja e përkatësisë dhe lidhjet me grupin, normat sociokulturore, morale, religjioze, kontrolli joformal etj. Nga këto varet edhe pritshmëria e të “tjerëve”, por edhe gatishmëria e individit për të pranuar flijimin. Qasja ndaj (vetë)vrasjes përgjithësisht del të jetë specifike etnokulturore e ambinetit të caktuar. Për japononezët të bësh vetëvrasje është njësoj si për amerikanët të bësh krim. Ata përjetojnë të njëjtën “kënaqësi” në aktin e vetëshkatërrimit sikur amerikanët kur i shkatërrojnë të tjerët. Vetëvrasja i kënaq disa kërkesa të cilat nuk mund të gjenden në aktet tjera.³¹

Qoftë rigjiditeti i normave, qoftë pesha e përgjegjësisë morale që buron nga pritjet e grupit, qoftë modeli specifik i edukatës, qoftë sistemi i vlerave - ose të gjitha së bashku - flijimin e privojnë nga

³⁰ Durkheim Emile, Suicide – a study in Sociology, This edition published in the Taylor & Francis e-Library, 2005:174-175. Originali: *Le Suicide: Étude de sociologie* first published 1897, Paris; Cituar sipas: (<http://marul.ffst.hr/dokumenti/izdavastvo/predavanja/Sanja.Stanic.Klasicna.drustvena.misao.u.teoriji.potrosnje.pdf>).

³¹ Robertson Jennifer (1999:1), Dying to tell: Sexuality and Suicide in imperial Japan, *Sings*, Autumn, 25,1. Research Library. (Benedikt 1946, 1974, Wolf, 1990, xxxi).

komponenta e individualizmit. Vetëm grupi “ka personalitet”, ndërsa individi shfaqet në variantin e element të tij. Ndryshimi ndërmjet të *flijuarëve* ndodh vetëm pas vetë aktit, nëse bëhet fjalë për heronj të cilët duhet glorifikuar, apo për të dëgjueshmit dhe të prirurit për t’u nënshtruar, të cilët duhet ankuar. Të parët kryejnë “vetëvrasje altruiste”, ndërsa të dytët i vrasin në emër të ‘altruizmit’. E përbashkëta e tyre është se vdesin në emër të flijimit për grupin.

Flijimi është imponim shoqëror për qëllime të ndryshme shoqërore (qoftë si vrasje altruiste “dyrkemiane”, qoftë si vrasje e grave dhe e fëmijëve për të zbrapsur mallkimin ose për të zbutur mëninë e zotave) në kultura dhe kohëra të ndryshme. Si të shpjegohet ndryshe fakti se ‘shërbëtori nuk ka pasur mundësi ta mbijetojë zotërinë e vet, ose gruaja burrin e vet? Edhe shërbëtorët janë varrosur me “zotërinë” (princin, mbretin), edhe gruaja ka hyrë në zjarr të digjet me trupin e burrit të vet të vdekur.³² Mos ka dikush iluzion se këtë e bënë me vullnetin e tyre nga pikëllimi për ata që vdiqën? Jo, ata e bënë nën presionin e normave të grupit shoqëror në të cilin ishin (mbi)integruar dhe të cilit i takonin.

Summary

The purpose of the article is to highlight a historic, sociocultural, and religious context of the blurred act of one's sacrifice as a ritual, norm and as a collective (group) action toward an individual, or of the individuals upon themselves. Myths and legends have survived the time as tales, artistic pieces or as stories, which sometimes hide or exaggerate the weight of sacrifice, but never deny its ancient connection for reincarnation of the gods or mitigation of their anger.

The Albanian history hasn't stalled in preservation of mythical and mystical heritage of sacrifice. The castle of Shkodra, known as Rozafa, is the most tangible legend between Albanian reality and the blurred mystical world, through images of ordinary people who carry the weight of sins that life brings where survival is threatened – not only from destructive neighborhood but also from chronic hunger. The special part of the legends which may not distinguish with originality, is the woman as an “object” of sacrifice. The image of a woman in the background of important events, the men, brothers or even to the mythologized patriarchal fathers, is at their service, but is constantly deprived from actions that encourage her to prove personality, integrity and dignified actions. She falls a victim to group norms – either as a sister, wife, daughter, or mother...while increasingly being denied activism, will and desire of actions on her personal name.

Personality is suffocated by rigid norms of patrilineal society where heroism and glory are saved for a man. Either the rigidity of norms, or the responsibility of a moral weight that stems from group trends, or the specific educational model, or the

³² Ibid, fq.177-179.

system of values- or all of the above- sacrifice is deprived from components of individualism. Stated in a Durkheimian language, only the group has “personality”, while an individual is displayed in a variant and element. The difference between sacrifices happens only after the act is preformed, if it is about the heros that should be glorified, or for the humble and the waiting to subject, who should complain, such as the case of Rozafa. The first commits “ altruist suicide” while the second kills in the name of “altruism”. The common thing between them is that they both die in the name of sacrifice for the group.

Literatura dhe burimet tjera:

- Cvjeticanin V, Supek R. (2003.), Emile Durkheim i francuska sociološka škola (str. 186-324), Zagreb, Naklada Ljevak.
- De'nis-Gojanovic, M. (1999.), Samoubojstva u Republici Hrvatskoj (analiza mortalitetnih podataka), Vladavina prava, 3.
- Durkheim Emile, Suicide – a study in Sociology, This edition published in the Taylor & Francis e-Library, 2005. Originali: *Le Suicide: Étude de sociologie* first published 1897.
- Essai sur la nature et la fonction du sacrifice. » (Ese mbi natyrën dhe funksionin e sakrificës), Henri Hubert dhe Marcel Mauss, *Année sociologique*, tome II, 1899.
- Freud, S. (1961.), Beyond the pleasure principle, New York, Liveright Publishing Corporation.
- Glas Koncila 4 (1753) | 27.1.2008. Vjeronauk za odrasle, Ivan Dugandžić UPOZNAJMO BIBLIJU, Kain i Abel: prvo bratoubojstvo.
- Haralambos, M., Holborn, M. (2002.), Sociologija: teme i perspektive, Zagreb, Golden marketing.
- Hudolin, V. (1984.), Psihijatrija, Zagreb, Stvarnost.
- In Relative Values:Reconfiguring Kinship Studies, editet by SarahFranklin and Susan Mc Kinnon, Durham. Duke University Press, (2001).
- Jung, C. G. (1973.), Čovjek i njegovi simboli, Zagreb, Mladost.
- Kluge "Etymologisches Wörterbuch der deutschen Sprache", Strassburg, 1899.
- Kozarić-Kovačić, D., Grubišić-Ilić, M., Grubišić, F., Kovacic, Z. (2002.), Epidemiological indicators of suicides in the Republic of Croatia, Društvena istraživanja.
- Kulanzh De Fistel (Fustel De Coulanges (1998), Anticka drzava (Le Cite Antique), Plato, Beograd.
- Slavicky Lydia (1984), Narodna umjetnost 21, (1984), rasprave i osvrti, Zagreb.
- Modly, D. (1994.), Objašnjenje trileme: ubojstvo, samoubojstvo, nesretni slučaj, Zagreb, MUP.
- Nikić, M. (1995.), Samoubojstvo: psihodinamika, prevencija i moralno vrednovanje. Predrag Šarčević, VIRDŽINA – ŽENA KOJE NEMA, Treći program, Bgd.
- Robertson Jennifer (1999), Dying ti tell: Sexuality and Suicide in imperial Japan, *Sings*, Autumn, 25,1. Research Library.

Web faqe:

[www./sq.wikipedia.org/wiki/Kalaja_e_Shkodr%C3%ABs\)](http://sq.wikipedia.org/wiki/Kalaja_e_Shkodr%C3%ABs)

www.gjuhashqipe.com/albanologji/albanologjiqytete.aspx?id=301, Kalaja e Rozafës

[www.http://www.gjuhashqipe.com/albanologji/albanologjiqytete.aspx?id=301](http://www.gjuhashqipe.com/albanologji/albanologjiqytete.aspx?id=301),
Kalaja e Rozafës

[www.http:Wikipedia, the free/Eenciclopedia\).](http://www.wikipedia.org)

www.uqac.quebec.ca/zone30/Classiques_des_sciences_sociales/index.html

[www://hr.wikipedia.org/wiki/Inkvizicija\).](http://hr.wikipedia.org/wiki/Inkvizicija)

[www://shkoder-shkodra.blogspot.com/2006/06/kalaja-e-shkodres-kalaja-rozafat.html](http://shkoder-shkodra.blogspot.com/2006/06/kalaja-e-shkodres-kalaja-rozafat.html)

Edi SHUKRIU, Prishtinë

MONUMENTET EPIGRAFIKE NGA SMIRA

KDU 904 (496.51)

Abstrakt

Në Smirë të Vitisë janë zbuluar monunente epigrafiqe, të cilat janë shfrytëzuar si material ndërtimor të xhamisë së vjetër të Smirës dhe që u gjetën pas rrënimit të saj. Dalja në dritë e tyre mundësoi edhe rinjohjen dhe evidencimin e lokaliteteve të reja arkeologjike të periudhës antike dhe mesjetare.

Monumentet epigrafiqe të Smirës zënë vend të posaçëm në epigrafinë dardane dhe më gjerë për nga përmbajtja e teksteve, onomastikës, simboleve të paraqitura dhe arkitekturës. Në mesin e tyre interes të veçantë paraqesin monumenti epigrafik përkushtuar Hyjneshës Dardane dhe monumenti përkushtuar Jupiterit *tonë* (IOMN) nga përfaqësuesit e tribës Quirinius nga Roma. Ara përkushtuar Hyjneshës Dardane është monument i parë i tillë i zbuluar në Kosovë, është monument i parë i punuar në të katër faqet, është i vetmi monument në pjesën qendrore të Europës Juglindore dhe në veri të saj ku paraqitet labirinthi dhe është i vetmi që përmban kompozicion të simboleve të kombinuara. I gjithë kompozicioni me labirinthin rrethor të qarkut të mbyllur paraqet ciklin e jetës dhe përfytyrimin dardan të universit të përjetshëm, duke dëshmuar kështu edhe zhvillimin filozofik-religjioz dardan dhe prezencën e mohuar të kosmogonisë e kosmologjisë dardane.

Fjalët çelësa: Hyjneshë Dardane, Smira, Iupiter noster, labirinthi.

MONUMENTET EPIGRAFIKE NGA SMIRA

Në Smirë të Vitisë janë zbuluar monunente epigrafiqe, të cilat për nga përmbajtja e tekstit, onomastikës, simboleve të paraqitura dhe arkitekturës zënë vend të posaçëm në epigrafinë dardane dhe më gjerë.¹ Në mesin e tyre interes të posaçëm paraqesin monumenti i përkushtuar e Hyjneshës Dardane (me dy labirinte) dhe monumenti përkushtuar Jupiterit *tanë* (IOMN). Monumentet epigrafiqe janë përdorur si material ndërtimor të xhamisë së vjetër të Smirës dhe u gjetën pas rrënimit të saj. Dalja në dritë e tyre, të përdorura si spolie dhe të marra nga hapësira përreth mundësoi edhe rinjohjen dhe

¹ Monumentet epigrafiqe u evidencuan në janar të vitit 1988 dhe sot, me përkrahjen e smirasëve, gjenden në Koleksionin Arkeologjik të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës.

evidencimin e lokaliteteve të reja arkeologjike të periudhës antike dhe mesjetare.

1. Monumenti përkushtuar Hyjneshës Dardane

Monumenti votiv i përkushtuar Hyjneshës Dardane është monumenti më i vlefshëm epigrafik i zbuluar deri më sot në Kosovë (Fig. 1- 4). Vlera e monumentit qëndron në teonominë prezente (përkushtimi një hyjneshe dardane) dhe në paraqitjet simbolike unike të trajtuara në reliev. Me arkitekturën katërfaqësore për t'u parë nga katër anë, monumenti po ashtu paraqet një raritet.²



Fig. 1. Monument i përkushtuar Hyjneshës Dardane (Smirë)

Monumenti është punuar mbi kuadrant mermeri të bardhë, të përshkuar me ngjyrë të përhimtë (78 x 36 x 37 cm). Skalitja është e bërë në të katër faqet e monumentit, me dy fusha të mbishkrimit dhe dy fusha simbolike-ornamentale (34,5 x 22,5 cm). Fushat e mbishkrimeve dhe të simboleve janë vendosur në korniza të theksuara (a, b, c, d). Kapiteli dhe bazamenti i monumentit janë dëmtuar gati tërësisht. Në pjesën e poshtme të kapitelit duken gjurmët e gjetheve të lerthit, ndërsa nën to një brez me vija relievore. Kapiteli kishte në pjesën e epërme edhe elemente të tjera, të cilat nuk mund të definohen për shkak të dëmtimeve.

Dy faqet ballore kanë të skalitura dy tekste identike, njëri i ruajtur plotësisht, ndërsa tjetri i dëmtuar nga gjysma e rreshtit 4 (Fig. 1-4). Tekstet e monumentit:

² Shukriu, E. (1989), ff. 15-21.

a.

D E A E
D A R D
A R T O R V S
H E R A C L I

5

T V S S P E C
L E G I I I F L
V S L M
G E N T A N O T B A S S O

b.

D E A E
D A R D
A R T O R V
H E R A

5

T V

Leximi i teksteve:

a. Deae / Dard(anicae) / Artorius / Heracli / tus spec(ulator) / leg(ionis) IIII Fl(aviae) / v(otum) s(olvit) l(ibens) m(erito) / Gentiano et Basso

b. Deae / Dard(anicae) / Artorius / Heracli / tu[s spec(ulator) / leg(ionis) IIII Fl(aviae) / v(otum) s(olvit) l(ibens) m(erito) / Gentiano et Basso]



Fig. 2. Tekstet në monumentin përkushtuar Hyjneshës Dardane

Tekstet janë skalitur në kornizat e theksuara të fushës së mbishkrimit dhe përkushtimi hyjnisë (rreshti 1-2) dhe formula e përkushtimit (rreshti 7) janë skalitur pak më larg se nisma e tekstit. Shkronjat kanë module më të mëdha deri në rreshtin 7, pos shkronjës së zvogëluar **I** në rreshtat 3-4, shkronjës **S** në rreshtin 3 dhe shkronjës **O** në rreshtin 8. Në tekstin e parë (a) shkronja **I** e rreshtit 3, si e zvogëluar është vendosur pas shkronjës **V**, ndërsa në tekstin e dytë (b) shkronja **I** është vendosur në brendi të shkronjës **V**. Emrat e konsujve janë skalitur me madhësi të përgjysmuar nga shkronjat e tjera (rreshti 8). Të gjitha shkronjat kanë skalitje të thellë dhe të rregullt. Teksti përmban serifë të theksuar horizontal dhe trekëndësh.

Formula e përkushtimit *Deae Dard(anicae* dhe me tekst të plotë është i pari i këtij lloji i zbuluar në Kosovë. Më parë njiheshin vetëm dy monumente nga kolonia romake Romula-Malva e Rumunisë.³ Pas luftës në Kosovë janë gjetur dhe dy të tjera në Gllamnik të Podujevës (Vendenisi antik).⁴ Këtë hyjneshe e paraqet dhe shtatorja nga Mediana te Nishi (Serbi),⁵ monumentet votive nga Baja e Kurshumlisë⁶ dhe Kamenica (Serbi), dorëza e paterës nga Branetiçi i Ulët,⁷ por, sipas mendimit tim, me të lidhet dhe busti i njohur si *Busti i Gruas nga Vërboci*, monedha me figurë hyjneshe dhe mbishkrim DARDANICI, monumenti votiv në kishën e Lipjanit (Kosovë)⁸ dhe mbase edhe shtatorja e gruas nga Suhareka - Theranda.

Dedikanti i monumentit është Artorius Heraclitus, vëzhgues (*speculator*) i legjionit IV të Flavëve.⁹ Artorius është nomen joperandorak gentil, i përhapur në Itali, në Afrikë, në Galinë Jugore e në Dalmaci.¹⁰ Ky nomen, i pidentifikuar në pjesën qendrore të Europës Juglindore, duket për herë të parë në monumentin votiv të Smirës. Kognomeni Heraclitus ka proveniencë helene dhe si i tillë është identifikuar edhe në arën përkushtuar Asklepit, Telesforit dhe

³ Tudor D. - Vlădescu C. (1977), ff. 183 – 189.

⁴ Për monumentin e parë shih: E. Dobruna - Salihu (2012), ff. 217-224. Për foton e monumentit të dytë shih: Dobruna - Salihu, E. (2005), Tab. 163, Fig. 304 - N. 355 (51).

⁵ Jovanović, A. (1980) ff. 53-59.

⁶ Mirdita, Z. (1981), ff. 252, nr. 239.

⁷ Popović, I. (2007), f. 35.

⁸ Mirdita, Z. (1981), 254, nr. 250.

⁹ Këtë titull, që bën pjesë në *res militaris* e mban edhe dedikanti i arës nga Graçanica e shek. II dhe ai i arës nga Batusha. Shih: Mirdita Z. (1981), 248 nr.217; 252 nr. 241.

¹⁰ Alföldy, G. (1969), f. 62.

Higisë, të gjetur në Prizren.¹¹ Mbështetur në emrat e konsujve të Romës, Gentiano dhe Basso (rreshti 8), monumenti është ngritur në vitin 211.¹²

Në dy faqet anësore të monumentit gjenden paraqitjet relievore, njëra me labyrinth rrethor të qarkut të mbyllur (c) dhe tjetra me labyrinth katërkëndsh (ç). Simbolet janë vendosur në korniza të theksuara, ngjashëm me ato të fushave të mbishkrimit.



Fig. 3. Labyrinthi rrethor i qarkut të mbyllur (c)



Fig. 4. Labyrinthi katërkëndsh (ç)

Faqja me labyrinth rrethor (c) përbëhet nga një kompozicion me paraqitjen e diellit-universit dhe hardhisë së rrushit e lerthit, degët e të cilave ndërlidhen me një nyje profilaktike (Fig. 3). Pjesën qendrore e zë paraqitja e diellit-universit, e përbërë nga një rreth i mbyllur, në brendinë e së cilës ka rrathë të ndërlidhur, të cilët formojnë gjashtë kryqe të thyera (svastika). Në qendër gjendet gjysmësfera e theksuar, e ndarë me tri gjysmëharqe. Në pjesën e epërme të faqes gjendet hardhia (kalaveshi i rrushit, në anën e djathtë, dhe gjethi i hardhisë, në anën e majtë). Përmes rripit gjysmëharkor dega e hardhisë lidhet me pjesën e poshtme të fushës kompozicionale, ku gjenden degët e lerthit me dy gjethë. Degët harkore të lerthit lidhen njëra me tjetrën me një nyjë të theksuar, që parandalon hyrjen në qarkun e mbyllur rrethor. Faqja me labyrinthin rrethor është punuar me mjeshtri dhe paraqet një kompozicion unik e të panjohur deri më sot.

¹¹ Šašel, J. Et A (1986), f. 261.

¹² Shukriu, E. (2004), ff.9-32; E. Shukriu (2001), ff.17-37; E. Shukriu (1991), ff. 33-39.

Faqja me labyrinth katërkëndsh (ç) është po ashtu simbol i pidentifikuar në pjesën qendrore të Europës Juglindore (Fig. 4). Ky lloj i labyrintheve duket si simbol apo si element dekorues në Knosos,¹³ Egjipt, Samos dhe Itali,¹⁴ si dhe në urnat e hershme etruce në trajtë të shtëpive.¹⁵ Labyrinthi është vendosur në portat e qyteteve të fortifikuara dhe në maketat e shtëpive të vjetra helene, ndërsa sipas Virgjilit, ishte i skalitur në dyert e Shpellës së Sibilës në Kumë.¹⁶

Arkitektura kuadrante e përpunuar në katër faqe është deri më sot rast unik në Kosovë dhe tregon se monumenti është vendosur diku në qendër për t'u vështruar nga të katër anët. Analogji më të afërta, me përpunim të katër faqeve, gjenden tek monumentet nga rrethi i Prijepoljes të Malit të Zi, siç janë arat nga Kolovrati, të cilat i përkasin rrethit kulturor ilir dhe në të cilat, si në Dardani, dominojnë si elemente simbolike dhe dekoruese hardhia e rrushit dhe gjethet e lërthit.¹⁷ Përpunime në tri faqe të monumenteve gjenden në territorin e Norikut, ku gjenden paraqitjet antropomorfe të perëndive.¹⁸ E tillë është ara përkushtuar Minervës nga Celeia, ajo e Jupiterit nga Petovia, e Mitrës, e Silvanit, ndërsa ato me paraqitje simbolike duken më rrallë.¹⁹

2. Monumenti përkushtuar Iupiter Noster (IOMN)

Nga monumenti përkushtuar Iupiter Optimo Maximo Noster është ruajtur pjesa e epërme, kapiteli dhe katër rreshtat e parë të mbishkrimit (Fig. 5).²⁰ Monumenti është skalitur në trajtë kuadranti në mermer të bardhë, të përshkuar me ngjyrë të kuqërremtë (46 x 48 x 65 cm). Kapiteli ka trajtë katrori të theksuar dhe një kupolë, në mesin e së cilës gjendet vrima e vogël e libacionit, me diametër prej 7 cm. Teksti i monumentit:

¹³ Kanlif, B. (1964), f. 273.

¹⁴ Enciklopedija likovne umjetnosti (1964), f. 273.

¹⁵ Kanlif, B. (1964), f. 11.

¹⁶ Chevalier, J. - Gheerbrant, A. (1983), f. 655.

¹⁷ Zotović, M. (1975), ff. 179-183, fot.1, 2 etj.

¹⁸ Zotović, M. (1975), ff. 179-183.

¹⁹ Hoffiller, V. - Saria, S. (1938), 22, 125, 146, 111.

²⁰ Ara u gjet në shtëpinë e Mustafë Durmishit, për dallim nga monumentet e tjera që u gjetën në rrënojat e xhamisë së vjetër.

I O M N

T_{FL} Q V IRINVSTSTAT_L L CRES

NTILLAE

Leximi i tekstit:

I(ovi) O(ptimo) M(aximo) N(oster) / T(itius) Fl(avius) Quirinus
/ T(riba) statio L(abut?) Cres[ce]ntillae [...]

Formula e përkushtimit: IOMN gjendet në kapitel. Teksti vijues është skalitur në gjithë sipërfaqen ballore të monumentit, pa korniza të fushës së mbishkrimit, në gjerësi prej 40 cm dhe në lartësi të ruajtur prej 33 cm. Teksti ka një hederë trekëndëshe, midis shkronjave *L* dhe *C* (rreshti 3), ndërsa nuk është i sigurt ekzistimi i hederës midis shkronjave *L* dhe *A* (rreshti 4). Në rreshtin 3 ekziston ligatura e shkronjave *T*, *I* dhe *O*.

Formula e dedikimit IOMN duket si jo e zakonshme, duke e rritur kështu dhe vlerën e monumentit. Prenomen *Titius* është gentilic joperandorak, i përhapur në provincat romake,²¹ ndërsa nomeni *Flavius* është emër perandorak, po ashtu mjaft i përhapur.²² Nomeni *Crescentilla* dëshmohet po ashtu për herë të parë në Kosovë, por si kognomen është prezent në territorin dardan²³ dhe, ndonëse i rrallë dhe i veçantë, është i përhapur edhe në vende të tjera.²⁴ Monumenti datohet në kapërcyell të shekujve II-III.

Vlera e monumentit rritet edhe me prezencën e *triba Quirinus* me prejardhje nga Roma, e cila si e tillë nuk është paraqitur deri më tash në monumentet epigrafike të Kosovës antike. Paraqitja e saj dhe e nocionit *noster*, që nuk duket tek monumentet e tjera përkushtuar Jupiterit, është dëshmi se dedikantët nuk ishin vendës dhe se me këtë formulë ia kanë dedikuar Jupiterit të tyre dhe jo atij vendës si *interpretation romana*.

²¹ Alföldy, G. (1969), f. 127.

²² I njëjti, f. 38, 205.

²³ Mirdita, Z. (1981), 220.

²⁴ Alföldy, G. (1969), 182.



Fig. 5. Monumenti me përkushtim IOMN



Fig. 6. Monumenti me përkushtim IOM

3. Monumenti përkushutar Jupiterit (IOM)

Monumenti votiv (ara) përkushtuar Jupiterit, i ruajtur mirë, është skalitur në mermer të bardhë, të përfshirë me degëzime të kuqërremta të xehes së hekurit (105 x 48 x 40 cm; Fig. 6). Bazamenti nuk është dekoruar, por në kapitel gjendet ornamenti relievor, definimin e të cilit e pamundësojnë dëmtimet. Fusha e mbishkrimit (57 x 39 cm) nuk ka korniza dhe është e dëmtuar vetëm në mesin e rreshtit 6. Teksti i monumentit:

	I	O	M
	P	R	O
	S	A	V
	D	O	M
	N	N	A
	V	G	G
5	I	M	P
	P	A	S
	S	E	P
	V	I	L
	P	O	S
	A	L	B
	I	N	O
	E	T	
	A	E	M
	I	L	I
	A	N	O
10	C	O	S

Leximi i tekstit:

I(ovi) O(ptimo) M(aximo) / prosalu[e] / dominor(um) / nn(ostrum) avg(ustorum) / impp(eratorum duorum)²⁵ Ascl[e] / pia[de]s Sep(timius) / vil(icus) posuit / Albino et Aemiliano / co(n)s(ulibus)

Formula e përkushtimit zë gjithë gjerësinë e fushës së mbishkrimit dhe shkronjat e saj kanë lartësi prej 5,5 - 6 cm. Nga rreshti 2 - 4 shkronjat kanë lartësi prej 5 cm, ndërsa nga rreshti 5 prej 4 cm. Teksti ka shkurtesa të krijuara me *suspension* (rreshti 4 dhe 5), me kontraksion (rreshti 10) dhe ka vetëm një hederë (rreshti 4). Serifet e theksuara janë horizontale apo në trajtë trekëndëshi.

Nomen *Asclepiades* paraqitet për herë të parë si nomen në arën e Smirës. Deri më tash ky është njohur vetëm si cognomen grek,²⁶ i dëshmuar rrallë, si në tri raste në Salone²⁷ dhe në monumentin e Graçanicës (shek. III).²⁸ Kognomen *Septimius* duket si nomen dhe kognomen perandorak gjatë sundimit të Septim Severit dhe është mjaft i përhapur në Itali, Afrikë, Norik dhe, ndonëse më pak, në Dalmaci.²⁹ Ky gentilic perandorak duket më pak në Mezinë e Epërme, ndërsa si kognomen paraqitet vetëm në arën e Smirës. Termi *vilicus*, pos në këtë monument, është dëshmuar në monumentin nga Timacus Minus, Llapasella dhe Ulpiana.³⁰ Ara datohet në vitin 206, sipas palës konsulare Albino dhe Aemiliano.

4. Pllaka mbivarrore e C. Valerius Valens

Monumenti mbivarror (stella) i ngritur C.Valerius Valensit³¹ është mjaft i ruajtur (Fig. 7). Ky është skalitur mbi një pllakë mermeri të bardhë, të përshkuar me kokërza të gjelbërta, me trajtë katërkëndëshi (108 x 87 x 12 cm). Në faqen ballore gjendet fusha e mbishkrimit, ndërsa në të prapmen rozeta-yll me gjashtë rema, e përshkuar në brendi me vija harkore (Fot. 8). Stella është e dëmtuar veçanërisht në pjesën e majtë dhe në të poshtmen, ndërsa gjatë rrënimimit të xhamisë është ndarë në tri pjesë. Fusha e mbishkrimit, e ruajtur në tërësi, është e thelluar dhe e rrethuar me kornizë relievore, pa zbukurime.

²⁵ Është fjala për dy perandorë, Septim Severin dhe Antoninin.

²⁶ Alföldy, G. (1969), 157.

²⁷ Šašel, A.et J. (1986), f. 242 nr. 2309.

²⁸ Mirdita, Z. (1981), 85.

²⁹ I njëjti, ff. 478-479.

³⁰ I njëjti, f. 24.

³¹ Shukriu, E. (1991), ff. 33-38.

Teksti i monumentit:

C VAL VALENS VIXITAN
 NIS XXVII H S E
 C VAL VIATOR FRATRI
 PIINTI S S I M OATQVE
 5 C ON SER VANTIS SIMO
 B M P
 ET SIBI SI BOSVO
 ETIVLIAEMARCELLINAE
 M ATRICARISSIME E
 10 LERIAE FLAVIAE CO
 NAIAE VIVIS FECIT

 T A V T A

Leximi i tekstit:

C(aius) Val(erius) Valens vixit an / nis XXVII h(ic) s(itus) e(st)
 / C(aius) Val(erius) Viator fratri / piintissimo atque / conservantissimo
 / b(ene) m(erenti) p(osuit) / et sibi suo / et Iuliae Marcellinae / matri
 carissime eItI / Leriae Flaviae Co /naiae vivis fecit / tauta

Modulet e shkronjave të skalitura kanë lartësi prej 4 cm, ndërsa gjerësia e tyre ndryshon. Ligatura dhe shkurtesa nuk ka, por ka serife të shumta, si vija horizontale dhe vertikale. Pika është e vetmja hederë dhe kjo është vendosur ose gabimisht (rreshti 4), ose nuk është vënë fare kur është dashur (rreshti 1, 9).



Fig. 7. Stella e C. Valerius Valens



Fig. 8. Rozeta në stellën e C. Valerius Valens

Stella është ngritur në fund të shekullit I ose në fillim të shekullit II. Përcaktimin e tillë kohor e mundësojnë parametrat vijues: mungesa e ligaturave, veçori e monumenteve të shek. I dhe fillimit të shek. II; prezenca e pikave si shenja të ndarjes (hedera), veçori e monumenteve të shek. I-II,³² mungesa e formulës DM, që nuk duket para shek. II; prezenca e formulës HSE, e cila nuk është dokumentuar para shek. II dhe prezenca e formulës BMP, e përdorur në punëtoritë e Mezisë së Epërme që në fillim të shek. II.

Onomastika e monumentit përmban rregullat e tria nomina latine, duke dëshmuar kështu përkatësinë latine të bartësve të saj. Në monument përmenden Caius Valerius Valens i ndjerë, Caius Valerius Viator (vëllai që ngrii monumentin), Iulia Marcellina (nëna) dhe Valeria Flavia Conaia. Prenomeni Caius (rreshti 1 dhe 3) është latin dhe si prenamen duket për herë të parë në Dardani, ku më parë është dëshmuar vetëm si kognomen dhe të cilin e mbajnë personat me gentilic Iulius.³³ Praenomen Leria (rreshti 10) nuk është dëshmuar deri më tash në Dardani. Ky gjendet si gentilic, por nuk është shumë i përhapur.³⁴ Si nomen joperandorak ndeshet në trajta të ndryshme në Itali, ndërsa në monumentin nga Salona e gjejmë në trajtën Lereia.³⁵

Nomen Valerius (rreshti 1 dhe 3) është gentilic joperandorak. Ky si kognomen, me bartës prejardhesh të ndryshme, duket në Italinë veriore, Gali, Panoni e Daki.³⁶ Nomen Iulia (rreshti 8) është gentilic perandorak, mjaft i përhapur në shek. II, por ishte në përdorim prej kohës së Cezarit e deri në shek. V.³⁷ Ky nomen duket shumë shpesh në territorin e Shkupit, ku ishin të vendosur milites deducti, me prejardhje të huaj, ndërsa në Kosovë është dëshmuar në monumentin e Prizrenit dhe atë të Dërsnikut.³⁸ Nomen Flavia (rreshti 10) është po ashtu emër i përhapur, sidomos në provinca danubiane dhe në Afrikë.³⁹ Si nomen perandorak është i shpeshtë në monumentet e shek. II të Mezisë së Epër, tek individët me prejardhje latine.

³² Petrović, P. (1975), 83, 96, 102.

³³ Mirdita, Z. (1981), ff. 39-40.

³⁴ Schulze, W. (1904), 273.

³⁵ I njëjti, 93.

³⁶ Alföldy G. (1969), 131, 321.

³⁷ I njëjti, 31-32.

³⁸ Mirdita Z. (1981), 40-41.

³⁹ Schulze, W. (1904), 38, 205.

Kognomen Valens (rreshti 1) ka përhapje të gjerë⁴⁰ dhe duket shpesh edhe në Mezinë e Epërme dhe në Maqedoni.⁴¹ Po ashtu është i përhapur edhe kognomeni Viator (rreshti 3),⁴² që e mban dedikanti. Pasi që C. Valerius Valens paraqitet si beneficiar konsular i legjionit IV të flavëve në arën e Mitrovicës të shek. II, duket se është fjala për të njëjtin person, i cili vdiq në moshën 27-vjeçare.

Kognomeni Marcellina (rreshti 8) është mjaft i përhapur.⁴³ Ky del si deminutiv i emrit latin Marcella (Marcellus) dhe konsiderohet si nomen i venetëve.⁴⁴ Kognomeni Conaia (rreshti 10-11) është i padëshmuar. Si gentilic joperandorak në trajtën Conia duket shpesh në territoret kelte.⁴⁵ Kur kihet parasysht se monumenti iu ngrit dhe nënës (Iuliae Marcellinae), e cila paraqitet me *duo nomina*, atëherë dhe Leriae Flaviae mund të interpretohet si gruaja e tij, që del si çështje që duhet shqyrtuar më tej.

Nocioni tauta (rreshti 12) me origjinë jolatine del si një paraqitje e pazakontë, andaj dhe krijon vështirësi për t'u zbërthyer. Ndonëse në artikujt e mëhershëm kam shkruar se mund të paraqet një aklamacion, por edhe sot është e vështirë që pa analogji të sillen konkluzione të mjaftueshme. Nga analogjitë e pakta të gjetura është mbishkrimi latin i sarkofagut të ngritur vajzës 3-vjeçare Secundilla, i cili përfundon me formulën bilinguistike dhe me alfabet grek: Αρωματί - ταῦτα.⁴⁶

5. Pllaka mbivarrore e dekurionit të municipiumit te Smira

Pllaka mbivarrfore (stella), e ngritur nga një dekurion, është ruajtur në tërësinë arkitektonike (70 x 2,23 cm), por e ka mjaft të dëmtuar fushën e mbishkrimit (66 x 32 cm). Edikula ka trajtë gjysmëharkore (66 x 32 cm). Kjo dhe fusha e mbishkrimit janë vendosur në korniza të relievuara. Në edikulë është paraqitur simboli i diellit me rreze të zgjatura, ndërsa anët e fushës së mbishkrimit janë të përshkuara me hardhi të rrushit, që del nga ena dyvegjake e vendosur në fund të stellës, ikonografi kjo tipike për trojet dardane. Teksti i monumentit:

⁴⁰ Alföldy, G. (1969), 318-319.

⁴¹ Šašel, A. et J (1986), 497.

⁴² Të njëjtët, 52; Alföldy, G. (1969), 326; Mirdita, Z (1981), 116.

⁴³ Alföldy, G. (1969), 224; Šašel, A. et S (1986), 218.

⁴⁴ Alföldy, G. (1969), 236-237.

⁴⁵ Schulze, W. (1904), 77.

⁴⁶ Mullen, A. (2013) Southern Gaul and Mediterranean – Multilingualism and Multiple identities in the Iron Age and Roman Period, Cambridge Classical Studies, Cambridge, 206 (IGF 57).

D M
SO EM
VI
NNI XXX
5 EST
VS
DECM TA
REX NIPO

Leximi i tekstit:

D(iis) M(anibus) / So[...] IA Iem(iliano) / vi[xit] / [a]nni[s] XXX
/ [hic situs] est / [...]us / dec(urio) m(unicipii) [...]ta / rex nipo[te]

Sipas hapësirës në tekstin e dëmtuar duket se i ndjeri kishte tria nomina. Praenomen SO... mund të lexohet si So(llius) apo So(da), të cilat nuk duken shpesh në trojet dardane. Sollius është gentilic joperandorak,⁴⁷ ndërsa Soda duket si kognomen latin i dëshmuar në monumentin e shek. II në lokalitetin Çuçer.⁴⁸ Kognomeni Aemillianus është një kognomen mjaft i shpeshtë joperandorak.⁴⁹ Stella datohet në shek. II apo në fillim të shek. III.

Përfundime nga analiza e monumenteve epigrafike të Smirës

Monumentet epigrafike të zbuluara në Smirë, me shumësinë e tyre dhe me të dhënat që ofrojnë, sjellin një varg elementesh të reja dhe të rëndësishme për arkitekturën e monumenteve epigrafike të Dardanisë, teogoninë, onomastikën, zhvillimin filozofik-religjioz, çështjet e prejardhjes dhe identitetit, si dhe për prezencën e municipiumit në afërsi me banorë vendës dhe të huaj.

Në mesin e monumenteve epigrafike ai i përkushtuar Hyjneshës Dardane ka rëndësi të veçantë, pasi që është monument i parë i tillë i zbuluar në Kosovë me përkushtim kësaj hyjneshe; është monument i parë i punuar në të katër faqet; është i vetmi monument në pjesën qendrore të Europës Juglindore dhe në veri të saj ku paraqitet labyrinthi dhe është i vetmi që përmban kompozicion të simboleve të kombinuara, që në kuptimin sublim paraqesin ciklin e jetës dhe përfytyrimin dardan të universit të përjetshëm.

⁴⁷ G. Alföldy (1969), 121.

⁴⁸ Z. Mirdita ((1981), 135, 223 nr.61. Cognomen Sodali duke tek libertinët, shih I.Kajanto, The latin cognomina, CHL XXXVI, Helsinki-Helsingfors 1965, 306.

⁴⁹ G. Alföldy ((1969)), 55.

Vendosja e dy labyrintheve në arën Hyjneshës Dardane, në veçanti e labyrinthit rrethor të qarkut të mbyllur, shpreh njohuritë e kohës me kuptim të thellë filozofik-religjioz. Përfundimi nxirret kur kihet parasysh se vetëm më të urtit që i përballojnë sprovat e iniciacionit arrijnë në qendër të labyrinthit, ku gjenden ndriçimi i të njohurit sublim, fuqia dhe përjetësia.⁵⁰ Pasi që labyrinthi (pallat i sëpatës dyteheshe) i paraqitur përmes sëpatës dyteheshe (labrys) është simbol i Zeusit rrufehedhës dhe simbolizon Diellin, simbolet e paraqitura në faqet anësore të kësaj are përputhen në simbolizmin e tyre, duke dhënë paraqitjen autoktone të diellit - universit (labyrinthi rrethor) dhe paraqitjen jovendëse të labyrinthit (labyrinthi katërkëndësh). Ky gërshetim i simboleve vendëse dhe jovendëse është rezultat i prejardhjes helene të dedikantit (mbase dhe jo), i cili shërbeu si ushtar - vëzhgues në Dardani.

Labyrinthi rrethor paraqet një shkallë më të lartë të besimit dhe të njohurive, që rrjedh nga zhvillimi i kultit solar. Kulti është dëshmuar te dardanët mjaft shumë në objektet e epokës së hekurit dhe në arkitekturën e trajtat e tumave dhe sidomos me vendosjen e dy simboleve të rrugës diellore në varret e tumës në Shirokë të Suharekës.⁵¹ Kontinuiteti i kultit solar është dëshmuar nga burimet e shkruara te peonet fqinj edhe në shekullin II.⁵²

Paraqitja e diellit duket edhe në arat përkushtuar Jupiterit dhe, më rrallë, Cererës, por te këto simboli i diellit është tejet i thjeshtë. Simboli i diellit në arën e Smirës është kompleks dhe deri më sot unik, kur kemi parasysh edhe kombinimin me svastikat, hardhinë, lerthin e nyjen profilaktike. I gjithë kompozicioni, bashkë me rrathët që krijojnë gjashtë (6) svastika, pos simbolit të diellit dhe rrugëtimit diellor, paraqet ciklin e përhershëm të jetës dhe përfytyrimin dardan të universit. Paraqitja e tillë paralajmëron dhe kierarkinë e krijuar të religjionit dardan, si dhe zhvillimin e kosmogonisë dhe kosmologjisë dardane. Edhe sfera në qendër të kompozicionit, e ndarë në tri pjesë, paraqet tërësinë qiell-tokë, përkatësisht relacionet tokë - qiell - nëndhe. Simbolet e tjera, që duken në faqen c, hardhia dhe lerthi, e përforcojnë këtë relacion, ndërsa nyja që lidh dy degët e lerthit, të lidhura dhe me degët e hardhisë, del si mbrojtëse e hyrjes. Ndonëse paraqitja e nyjes profilaktike është e shpeshtë dhe në vete bart traditat totemike dhe kultet bujqësore të epokës së neolitit, më vonë u konsiderua si vetë nyje

⁵⁰ Mircea, E. (1964), f. 312.

⁵¹ Shukriu, E. (1990), ff. 103-112; Këto objekte prej bronzi janë konsideruar si pulla: Djurić, N. (1965), ff. 537-539.

⁵² Stipčević, A. (1981), ff. 17, 33, f.n. 2.

e jetës apo një labyrinth përmes të cilit duhet kaluar për të arritur deri te qendra (zgjidhja dhe çlirimi).⁵³ Në këtë drejtim shihet dhe nyja në arën e Smirës, pra si një hyrje imagjinative në jetë e në misteret e saj.

Lerthi e hardhia e rrushit, veçmas apo të dyja bashkë, që dalin nga një enë, janë elemente karakteristike të monumenteve mbivarrore (sepulkrale) të Dardanisë të periudhës romake dhe këto janë simbole të trashëguara nga periudha parahistorike. Lerthi duket si ornament dhe në enët dardane të punuara në çark të shek. V-IV p.K., ndërsa dëshmi për paraqitjen e hardhisë te dardanët para periudhës romake nuk ka, por kjo nuk e mohon prezencën e saj edhe me parë.

Sipas dëshmive të derisotme dedikanti Artorius Heraclitus ishte me prejardhje greke dhe fakti se ai e ngriti monumentin përkushtuar Hyjneshës Dardane flet për rolin dhe rëndësinë e kësaj hyjneshe, ndërsa kompozicioni i tërësishëm i simbolit të diellit-universit, hardhisë dhe lerthit flet për shumësinë e funksioneve të Hyjneshës Dardane, të përvetësuar në ecejaket kohore⁵⁴ dhe kryesinë e saj të panteonit dardan. Kufizimi i funksionit të Hyjneshës Dardane vetëm në suazat e plleshmërisë do të thotë thjeshtëzim dhe zbehje e funksioneve të saj.

Ndonëse dielli konsiderohet edhe si mbarsës,⁵⁵ kjo hyjneshë nuk duket më vetëm hyjneshë e plleshmërisë, e territorit apo vetëm si psihopomp mortal dhe hierofont iniciacistik (dy funksione të mëvonshme të diellit), por sipas arës së Smirës ajo zë vendin e hyut më të rëndësishëm të panteonit dardan, duke u bërë hyjneshë e ringjalljes së përgjithshme dhe e përjetshmërisë. Elemente krahasuese mund të gjenden dhe te hyjneshat kelte Nehalennia dhe Epona, për të cilat M. Green konstanton se përfshinin shumë aspekte të jetës: lindjen, zhvillimin, plleshmërinë, rigjenerimin, mbrojtjen nga demonët e deri te fati i njerëzimit pas vdekjes.⁵⁶

Labyrinti rrethor me qarkun e mbyllur paraqet një shkallë më të lartë të besimit dhe të njohurive dardane, përkatësisht të një shkalle të lartë filozofike-religjioze, që rrjedh nga zhvillimi i mëtejshëm i kultit solar dhe vrojtimit e analizat e qiellvrojtuesve - priftërinjëve dardanë. Analiza e këtij labyrinti sjell si përfundim se koncepti i trinisë kishte zënë rrënjët në kohën e ngritjes së monumentit, pasi që çdo element përmbajtësor i kompozicionit ndahet në tri pjesë: 1) a. hardhia e

⁵³ Chevalier, J. - Gheerbrant, A. (1983), ff. 99-100.

⁵⁴ Shukriu, E. (2010a), ff. 571-575; E. Shukriu (2010b), ff. 160-164.

⁵⁵ Chevalier, J. - Gheerbrant, A. (1983), f. 655.

⁵⁶ Green, M. (1989), f. 9.

rrushit, b. labyrinthi rrethor, c. dega e lerthit; 2) tre kryqe të thyera me rrema në të majtë (lindja); 3) tre kryqe të thyera me rrema në të djathtë; (vdekja); 4) ndarja në tri pjesë e sferës qendrore. Natyrisht, kjo është çështje për studime të mëtejme.

Çështje për studime të mëtejme është edhe formula tauta e shkruar në tekstin e pllakës mbivarrëse të C. Valerius Valens (Monumenti 4. Fig. 8). Tauta trajtohet si fjalë greke (ταῦτα)⁵⁷ dhe është përdorur në Greqinë antike me kuptime të ndryshme. Platoni (*Etika*) e përdor këtë nocion në kuptimin se ideja është identike me *diç tjetër* (tauton) dhe se në të njëjtën kohë është e ndryshme nga *gjërat e tjera* (thateron). Nëse *tauton* kuptohet si *diç tjetër*, formula tauta do ta kishte kuptimin qendër / ide / perëndi. Kjo formulë shtron dhe çështjen e prejardhjes së familjes së Caius Valerius Viator apo të përfaqësive të tyre me gjuhën / kulturën greke, siç e shtron dhe nevojën për studime shumëdimensionale dhe më të thelluara që ofrojnë monumentet epigrafike të Kosovës dhe të Dardanisë.

Në aspektin onomastik monumentet përmbajnë onomastikë dhe formula të shumta në të cilat paraqitet për herë të parë përmëri pronor noster (monumenti 2), prenomenet Caius dhe Leria (monumenti 4)⁵⁸, nomenet Artorius (monumenti 1), Asclepiades (monumenti 3) dhe Crescentilla (monumenti 2), kognomeni Conaia (monumenti 4), triba e njohur romake Quirinus (monumenti 2) dhe formula tauta (monumenti 4).

Tabela onomastike

	monumenti	Prenomen	Nomen	Kognomen	Aklamacion	përmëri pronor / tribë
1	DEAE DARD		Artorius	Heraclitus		
2	IOMN		Crescentilla			noster triba Quirinus
3	IOM		Asclepiades	Septimius		
4	DM Stellë e Valensit	Caius Leria	Valerius Flavia	Valens Marcellina Conaia /?/	Tauta	
5	DM Stellë e dekur. Aemiliano	So(llius) ? So(da)		Aemilianus		

⁵⁷ Greek Word Study Tool

<http://www.perseus.tufts.edu/hopper/morph?l=tau%3Dta&la=greek> dt. 1.1.2014.

⁵⁸ Në Dardani është dëshmuar vetëm si kognomen.

Sipas dy monumenteve të Smirës dëshmohej prezenca e një vendbanimi më të madh në afërsi (monumentet 2, 5). Monumenti 5 paralajmëron ekzistimin e municipiumit, siç shihet nga porositësi i stellës që ishte dekurion (*decurio*) dhe të nocionit *municipii*. Nga emri i qytetit janë ruajtur vetëm dy shkronjat e fundit: ...ta. Hapësira e dëmtuar e emrit lë mundësi të prezencës së katër shkronjave të tjera paraprake dhe njohjen e mundshme të emrit të plotë të municipiumit.

Ndihmesë për mundësinë e zbërthimit të emrit të qytetit ofron monumenti 2,⁵⁹ në të cilin është shënuar emri i vendbanimit që nis me shkronjën L (*statio L.*). Përderisa në burimet e mëhershme nuk gjendet asnjë qytet që nis me shkronjën L, vetëm në listën e Prokopit të qyteteve të Dardanisë të shek. VI gjenden tri qytete që nisin me të: Labutza, Liste dhe Lasbaros.⁶⁰ Kur kihet parasysh se emri i municipiumit në monumentin 5 përfundon me shkronjat ...ta dhe se në hapësirën e dëmtuar të emrit ka vend për katër shkronja, duket e arsyeshme që emri i këtij qyteti, i cili sipas monumentit 2 (Fig. 5) nis me shkronjën L, që shihet si Labutza e Prokopit, apo si Labuta, siç duket të jetë shënuar në monument.

Përfundimi mbi prezencën e qytetit nuk mund të qëndrojë pa dëshmitë arkeologjike të kohës relevante, si *conditio sine qua non* për ta mbështetur qëndrimin se qyteti e kishte emrin Labuta. Në këtë drejtim duhet theksuar nevojën për përmbajtjen e relevancës arkeologjike, siç janë: 1) dëshmitë për ekzistimin e një vendbanimi të madh, 2) prezenca e objekteve të shek. II-III dhe 3) prezenca e objekteve të shekujve V-VI. Duket se këto kërkesa i plotëson lokaliteti arkeologjik që mban toponimin *Gradina* dhe që gjendet në hyrje të fshatit Gushicë, afër Smirës.

Pas rekognoscimit arkeologjik (1989) u dëshmua se *Gradina* e Gushicës është një vendbanimin i madh dhe i pasur i shek. II-III, me objekte të shumta të periudhës romake (themele të godinave, tegulla, qeramikë e vegla të punës). Të dhënat e tjera flasin edhe për prezencën e jetës intensive gjatë shek. V-VI (tjegullat e periudhës së hershme bizantine dhe fragmentet e enëve).

Në mbështetje të mendimit të vazhdimit të jetës edhe në shek. VI flet dhe mikrotoponimi *Kisha e Rimit*,⁶¹ e cila gjendet në qendër të Gushicës dhe ku janë të dukshme gjurmët e themeleve të një kishe të hershme. Këtyre duhet shtuar mikrotoponimet e ruajtura në Smirë dhe

⁵⁹ Ara u gjet në shtëpinë e Mustafë Durmishit, për dallim nga monumentet e tjera që u gjetën në rrënojat e xhamisë së vjetër.

⁶⁰ Proc. Caes., De aedificis IV, 4.

⁶¹ Janë të shumta lokalitetet arkeologjike në Kosovë për të cilat banorët thonë se i takojnë kohës së rimit.

objektet në to, siç janë *Ledenci te Kisha, Kisha, Qeremidana* etj.. Kështu, objektet e antikës së vonë dhe të mesjetës rreth Gushicës dhe Smirës e provojnë vazhdimësinë e jetës intensive edhe në shek. VI në këtë hapësirë. Në këtë drejtim edhe Gradina e Gushicës, vendbanim i gjerë i antikës dardane, mund të identifikohet me qytetin Labuta - Labutza.



Fig. 9. Edikulë e monumentit epigrafik



Fig. 10. Fragment i kornizës së stelës



Fig. 11. Kapitel i stilit jonik (mermeri)




Fig. 12. Kapitël (mermer)



Fig. 13. Shtyllëza (mermer)

Edi SHUKRIU, Prishtina

EPIGRAPHIC MONUMENTS FROM SMIRA (KOSOVA)

Summary

At the village of Smira (Municipality of Vitia, Kosova) there were discovered epigraphic monuments in 1988 being used as spolia at the old mosque. The monuments present a great interest by the content of their texts, onomastics, symbols and architecture. Among them, the distinguished ones are the monument dedicated to Dardanian Goddess (Mon. 1. Fig 1-4) and the monument dedicated to *our* Jupiter (Mon. 2: IOMN) built by the representative of Quirinius tribe from Rome (Mon. 2, Fig. 5).

1. Deae Dardanae Monument

The monument is built in quadrant white marble overwhelmed with gray colour (78 x 36 x 37 cm). Engraving is done on monument's four sides (two inscription fields and two symbolic fields). Inscriptions and symbols fields are placed in emphasized frames (34,5 x 22,5 cm). The capitël and the base are almost completely damaged. In the bottom of the capitël stay the traces of ivy leaves, while beneath them a track of relief lines. The other elements of the capitël's upper part are missing. Two front sides hold engraved two identical texts, one of them is damaged from half of the line 4 (Fig. 1 - 4). Dedication (lines 1-2) and the dedication formula (line 7) are engraved a little farther than the text beginning. Letters have large modules up to line 7, except the reduced letter **I** (lines 3, 4), the letter **S** (line 3) and the letter **O** (line 8). In the first text (a) reduced letters **I** decided after the letter **V** (line 3), while in the second text (b) the letter **I** is placed inside the letter **V** (line 3). The names of the consuls are sculpted in half sizes (line 8). The text contains emphasized horizontal and triangle serifs.

The dedication formula *Deae Dard(anicae)*, which holds the full text is the first one discovered in Kosova. Previously only two monuments from Romula-Malva (Romania) were known. Two others have been found in Gllamnik of Podujeva (ancient Vendenis) after the war in Kosova. This goddess is presented at the statue from Mediana (Serbia), monuments from Kurshumlia Spy and Kamenica (Serbia) and in the handle of patera from the Low Branetic. Related to her is the bust known as *Bust of Woman from Vërboc*, a coin with Goddess figure and inscription DARDANICI, the votive monument in the Lipjan church (Kosova) and maybe even a statue of a woman from Suva Reka / Theranda (Kosova).

The monument was dedicated by Artorius Heraclitus, speculator of the Legion IV Flavia. Artorius is a non-imperial nomen, which appears in Kosova for the first time. Cognomen Heraclitus has a Greek provenience and it was identified at a monument dedicated to Asclepios, Hygeia and Telesphoros (Prizren, Kosova). Due to the consul names Gentiano and Basso (line 8) the monument dates in the year 211. In the two lateral sides of the monument two relieve labyrinths are placed, a close circle (c) and a quadrant (d). The circle labyrinth consists of composition of the sun-universe and vine grape and ivy, the branches of which are linked by a prophylactic knot (Photo 3). The sun-universe occupies the central part and it consists by a closed circle, inside of which are linked lines which form different spaces and six swastikas. In the center stays emphasized a semi sphere divided by three arches. In the upper part of the side the vine grape is placed, respectively grape on the right and the leaf of the vine grape on the left. The vine branch is connected to the bottom of the field with the ivy branches holding two leaves. Ivy branches are related to each other through a knot, the Quadrant labyrinth's side (d) is also an unidentified symbol in the central part of Eastern Europe (Fig. 4).

2. Jupiter Noster Monument (IOMN)

The monument dedicated to Jupiter Optimo Maximo Noster is stored at the upper part, the capitel and the first four lines of the inscription (Fig. 5). The monument is sculpted in quadrant shape white marble, overwhelmed with reddish tint. (46 x 48 x 65 cm). The square form capitel has highlighted, dome in which center stays a small libation hole (diam. 7 cm). The dedication formula IOMN is engraved on the front side of capitel and the following text at all the frontal surface of the monument without field frames of inscription.(40 cm x 33 cm). The text has one triangle hedera, between letters **L** and **C** (line 3), while the existence of hedera between letters **L** and **A** (line 4) is not sure, It also has one ligature of letters **T**, **I** and **O** (line 3). Praenomen *Titius* is non imperial gentilicium and it is spread in all Roman provinces as well as nomen *Flavius*, which is imperial nomen. Nomen *Crescentilla* was proved for the first time in Kosova, but as cognomen is present in the Dardanian territory and, although rare and special, it is widespread in other countries. The monument dates at the turns of the II - III centuries.

The presence of the Quirinus tribe originating from Rome increases the value of the monument. Its appearance and of the notion *noster* is evidence that dedicants were not indigenous and that by a used formula they dedicated the monument to their Jupiter and not to the domestic one as *interpretatio romana*.

3. Monument dedicated to Jupiter (IOM)

The monument dedicated to Jupiter is sculpted in white marble with reddish ramification from iron ore (105 x 48 x 40 cm. Fig. 6) and is well saved. While the foundation has not decorated the relieve, the ornament stays on capitel, but its definition is impossible. The inscription field (57 x 39 cm) has not frames and it is damaged from the middle of line 6. The dedication formula takes the whole width of the inscription field with the letters height 5.5 - 6 cm. In lines 2-4 letters have their height of 5 cm, while from line 5 of 4 cm. The text has abbreviations created with suspension (line 4, 5), with contraction (line 10) and it has only one hederia (line 4). Serifs are horizontal and triangular. Nomen Asclepiades appears for the first time as nomen. Cognomen Septimius appeared as imperial nomen and cognomen during the rule of Septimius Severus. This gentilicium appears less in Upper Moesia, while as cognomen it is present only in Smira's ara. According to the consuls Albino and Aemiliano, It dates in the year 206

4. Sepulclar monument of C. Valerius Valens

The sepulclar monument built to C. Valerius Valens is almost wholly saved (Fig. 7). It is built on a white marble rectangle slab with green grains (108 x 87 x 12 cm). On its front is the inscription field, while on the back side was engraved rosette-star (Fig. 8). Stella is damaged on the left side and below. The inscription field is deepened and placed in an undecorated relieved frame. The modules of engraved letters have their height of 4 cm, while their width varies. It has not ligature and shortcuts, but there are numerous horizontal and vertical line serifs. The point is the only hederia set incorrectly (line 4), or not set at all when it was needed (lines 1, 9). Dated at the end of 1st century or in the beginning of the II century. Onomastics contain tria nomina, indicating Latin affiliation of the carriers.

At the monument Caius Valerius Valens is mentioned, then Caius Valerius Viator (his brother who raised the monument), Iulia Marcellina (mother) and Valeria Flavia Conaia. Praenomen Caius (lines 1, 3) is Latin and it appeared for the first time in Dardania as well as the praenomen Leria (line 10). Nomen *Valerius* (lines 1, 3) is nonimperial gentilicium and appears often as cognomen. Nomen Iulia (line 8) is imperial gentilicium and often appears in ancient Scupi and present Prizren and Dërsnik (Kosova). Nomen Flavia (line 10) is imperial nomen which often appears with the monuments of the 2nd century in Upper Moesia, linked with individuals having Latin origin. Cognomens Valens (line 1) and Viator (line 3) are widespread in Moesia Superior and Macedonia. Cognomen Marcellina (line 8) is widespread, but there is no evidence on the cognomen Conaia (lines 10-11). As the monument was raised to mother appearing by *duo nomina*, Flaviae Leriae can be interpreted as his wife and maybe Conaia should be seen as a mistake in writing. Notion tauta (line 12) with non-Latin origin in the Latin text appears unusual and can be seen as a centre / idea / God.

5. Sepulclar Monument of the Decurion of Municipium near Smira

Sepulclar monument raised of the decurion Aemilianus is well preserved in its architectural integrity (70 x 2.23 cm), but its field inscription is very much damaged (66 x 32 cm). It has semi arc aedicule (66 x 32 cm) which together with the field inscription is placed in the relieved frame. The sun symbol stays in aedicule, while the

inscription field frames are overwhelmed with grape vine that comes from a two-handed pot placed at the end of the monument.

It seems that the deceased had tria nomina. Praenomen SO... can be read as So(lius) or So (da), infrequent in Dardanian territories, while non imperial cognomen Aemillianus is frequent. The monument dates in the 2nd century or the beginning of the 3rd century.

*

Epigraphic monuments of Smira bring new and important elements concerning the architecture of the Dardanian epigraphic monuments, their theogony, onomastics, philosophical-religious development, origin and identity issues as well as on the presence of a municipium. Among them, the monument dedicated to the Dardanian Goddess has a special significance as it contains the combined composition of symbols presenting thus the cycle of life and image of eternal universe. It also proves the Dardanian philosophical-religious development and the denied presence of cosmogony and cosmology.

The presence of close circular labyrinth expresses the deep philosophical-religious Dardanian knowledge of the times. A conclusion is issued considering that only the wise who overcomes trials of initiation reach labyrinth center, where the sublime knowledge of lighting, power and eternity are placed. As labyrinth symbolizes the sun and it is also the symbol of Zeus, both labyrinths overlap in their symbolism, one with Dardanian origin (Fig. 3) and non-domestic origin (Fig. 4). An analysis of this monument leads to the conclusion that the Dardanian Goddess was a goddess of the general resurrection and eternity.

The issue of further studies presents formula *tauta* of the monument 4 (Fig. 8), which is the Greek word (ταῦτα) and it was used in ancient Greece with different meanings. Plato used this term in his *Ethics* in the sense that the idea was identical with something else (*tauton*) and that at the same time was different from other things (*thateron*). If *tauton* were understood as something else, formula *tauta* would have the meaning of center/ idea/ god. This formula raises also the issue of the origin of C. Valerius Viator's family or their links with Greek language/ culture.

In terms of onomastics, the monuments contain multiple names and formulas (see: Tabela onomastike) as praenomens *Caius* and *Leria* (Mon. 4), nomens *Artorius* (Mon. 1), *Asclepiades* (Mon. 3) and *Crescentilla* (Mon. 2), cognomen *Conaia* (Mon. 4), Roman triba *Quirinus* (Mon. 2), the possessive pronoun *noster* (Mon. 2) and formula *tauta* (Mon. 4).

According to two monuments, the presence of larger dwellings is proved (Mon, 2, 5). Monument 5 warns the existence of municipium, from whose name only the last two letters are stored and there is a space for four other preliminary letters. Further name's recognition provides monument 2, where the residence name begins with letter L (*L. statio*). According to Procopius list, three dwellings begin with letter L: Labutza, Liste and Lasbaros. Taking into consideration this, then that the name at the monument 5 ends with letters *ta...* and that at the damaged space there is room for four letters the name of the dwelling can be seen as Labuta (Labutza). The existence of the large settlement is testified at *Gradina* site at Gushica (archaeological recognition of 1989), which can be identified as Labuta. Other data speak about the life during the early Byzantine period, as *Kisha e Rimit* (Church of Romans) in Gushica and sites in Smira: *Ledenci te Kisha*, *Kisha* (Church), *Qeremidana*, etc.

Literatura:

- Alföldy, G. (1969) "Die personennamen in der römische Provinz Dalmatia", Carl Winter universitat, Heidelberg.
- Chevalier, J. - Gheerbrant, A. (1983) "Riječnik simbola", Nakladni zavod Hrvatske, Zagreb.
- "Enciklopedija likovne umjetnosti" 3 (1964) Leksikografski zavod FNRJ, Zagreb.
- Djurić-Slavković, N. (1968) Ilirski tumuli kod S. Reke, Glasnik Muzeja Kosova i Metohije IX, Priština
- Dobruna - Salihu, E. (2012) Votivna ara *deae dardanicae* i beneficijarna postaja iz Vendenisa, Vjesnik arheološkog muzeja u Zagrebu 3. s., XLV.
- Jovanović, A. (1980) Prilog proučavanju skulptura sa Medijane, Niški zbornik 9.
- Hoffiller, V. - Saria, S. (1938) "Antike inschriften aus Jugoslavien", Zagreb.
- Kanlif, B. (1964) Rimsko carstvo, Narodi i civilizacije, Beograd.
- Green, M. (1989) "Simbol and Image in Celtic Religious Art", Routledge, London and New York,
- Mircea, E. (1964) "Traite d'histoire des religions", Payot, Paris.
- Mirdita, Z. (1981) "Antroponomia e Dardanisë në kohën romake", Rilindja, Prishtinë.
- Mullen, A. (2013) Southern Gaul and Mediterranean - Multilingualism and Multiple Identities in the Iron Age and Roman Period, Cambridge Classical Studies, Cambridge, 206 (IGF 57).
- Petrović, P. (1975) "Paleografija rimskih natpisa u Gornjoj Meziji", Arheološki institut, Beograd.
- Popović, I. (2007) Dea Dardanica iz Mediane i srodni spomenici iz balkanskih provincija carstva, Niš i Vizantija, Simpozium 6, Niš.
- Schulze, W. (1904) "Zur geschichte lateinischer Eigennamen", Berlin.
- Stipčević, A. (1981) "Kultni simboli kod ilira", Centar za Balkanološka ispitivanja, knj.10, Sarajevo.
- Shukriu, E. (2004) Dea Dardane - Ikonografia e monumenteve, simbolet dhe funksionet, Instituti i Historisë, Kosova 26, Prishtinë,
- Shukriu, E. (2010a) Two Labyrinths and Dardanian, Greek and Roman Relations, Cinquième colloque sur l'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'antiquité, Université Pierre Mendès France, Grenoble 2008, Volume II, CRHIPA- De Boccard, Paris.
- Shukriu, E. (2010b) Two labyrinths and two identical texts on the Dardanian goddess, ARKOS /Scienca e reastauro/ 19, Cosenza.
- Shukriu, E. (2001) Dea e Dardanisë dhe monumentet e tjera epigrafike nga Smira, Buletin i Fakultetit Filozofik XXVI, Prishtinë.
- Shukriu, E. (1991) Stella nga Smira dhe "Gradina" e Gushicës, Gjurmime Albanologjike 20 - Seria e Shkencave Historike, Instituti Albanologjik, Prishtinë.
- Shukriu, E. (1990) Kulti i diellit të dardanët, Studimi etnografik i ndryshimeve bashkëkohore në kulturën e popullit shqiptar, Instituti Albanologjik, Prishtinë.
- Šašel, A. et J. 1986 Inscriptiones latinae quae in Iugoslavia inter annos MCMII et MCMXL repertae et editae sunt, Situla 25, Ljubljana.
- Zotović, M. (1975) Antički spomenici i predmeti sa lokaliteta Kolovrata kod Prijepolja, Raška baština 1, Kraljevo.

Exhlale DOBRUNA - SALIHU, Instituti Albanologjik, Prishtinë

DY ZBULIME RASTI TË MONUMENTEVE SKULPTURORE NGA ANTIKITETI NË KOSOVË

KDU 903 (496.51)

Abstrakt

Në këtë punim trajtohen dy monumente të punuara në gurë në të dy gjinitë – relief dhe skulpturë – nga koha romake të zbuluara në Kosovë kohëve të fundit rastësisht në dy lokalitete të ndryshme.

Njëri, i gjetur në Kaçanik, i takon një monumenti mbivarror të tipit stelë nga shekulli II, të punuar në gur lokal dhe të ruajtur mjaft mirë. Në fushën relievore të kësaj steleje është skalitur figura e kalorësit në kompozimin e të ashtquajturit “kalorësi trakas”, që ka të bëjë me të ndjerin e heroizuar, i cili në pjesën qendrore dardane paraqet rastin e tretë të pranisë së tij në monumente të këtij karakteri.

Monumenti tjetër, i gjetur në Mushtisht te Suhareka, ka të bëjë me një shtatore në skulpturë të plotë, punuar në mermer nga shekujt II-III, së cilës i mungon koka dhe disa pjesë të gjymtyrëve. Pjesa tjetër është e ruajtur mirë me veshje të përbërë nga tunika dhe toga e madhe, e cila e precizon si shtatore të tipit *togatus*, që shënon rastin e parë në të gjithë Dardaninë.

Rëndësia e këtyre dy monumeteve qëndron në faktin se i pari në këtë pjesë dardane rrit numrin e monumenteve mbivarrorë të këtij kalorësi në tri, duke dëshmuar edhe një herë kultin e heroit - kalorësit, kurse shtatorja e këtij tipi, me praninë e saj për herë të parë, ofron të dhëna të reja në fushë të antikitetit në mbarë Dardaninë.

Fjalët çelës: Dardania, Kosova, stela, figura e kalorësit, shtatorja, tipi *togatus*.

* * *

Në vazhden e gjetjeve arkeologjike të rastit në Kosovë, materiali i lëvizshëm gjithnjë zë një vend me rëndësi. Kësaj radhe fjala është për dy monumente të antikitetit të punuara në gurë – njëra në gur lokal dhe tjetra në mermer – në të dy gjinitë: relief dhe skulpturë të plotë të gjetura në dy lokalitete të ndryshme, duke na befusuar për të mirë me të dhëna të vlefshme.

Stela me figurën e kalorësit nga Kaçaniku (fig. 1).

Monumenti mbivarror i tipit stelë u gjet me rastin e hapjes së rrugës “Dushkaja” mbi shkollën “Skënderbeu” gjatë vitëve 2009-2010 dhe tani ruhet në Shtëpinë e Kulturës.¹ Është i punuar në një gur vendor me shtresa bardh-okër dhe rremba dyngjyrësh, kuq e hiri. Pos disa dëmtimeve në kornizat anësore, është i ruajtur i tëri me përmasa: gjatësi 180 cm., gjerësi 71 cm, trashësi 22-28 cm. Kjo stelë përbëhet nga komponentet standarde të stelave të Dardanisë: fusha relievore me akroterë (këtu të thjeshtë), fusha mbishkrimore dhe xokoli, si dhe thundra e ruajtur për përforsim në bazament. Kurse i mungon zbulurimi i kornizës me motivin karakteristik të stelave të kësaj treve, të përbërë nga hardhia dhe gjethet e urthit që del nga vazoja në xokol², e i cili gjendet edhe në dy stelat e gjetura më herët mu në Kaçanik³. Meqenëse nuk është skalitur edhe mbishkrimi, atëherë duket se kemi të bëjmë ose me një



Fig. 1

¹ Gjatë kërkimeve arkeologjike në muajin prill të vitit 2013 në Kaçanik, nga personeli i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit (të cilin e falënderoj për ndihmën e ofruar) u njohtova se në Shtëpinë e Kulturës gjendet një monument i zbuluar rastësisht, i cili kishte mbetur i padeshifruar si për nga trajta, ashtu edhe për nga paraqitja në relief. Në lokalitetin Soponicë, në afërsi të Kaçanikut, gjendet edhe një sarkofag i gurit, po nga koha romake, i cili i përket tipit me kapak çati me akroterë, por pa kurrfarë zbulurimi.

² PAPAZOGLU, F. (1969) ff.156-158; DOBRUNA-SALIHU, E. (1987) ff. 194-198; E NJËJTA (2003-2005) ff. 126-139; E NJËJTA (2013): 594-596, figg. 1-5, 11, 12, 16.

³ VULIĆ, N. (1931) f. 78, n. 182; MIRDITA, Z. (1981) f. 249, n. 222, f. 253, n. 248; Interpretimi i relievit: DOBRUNA-SALIHU, E. (2003-2005) ff. 696-697, n. 114, T. 58, fig. 106, f. 755, n. 203, T. 99, fig. 181 fusha relievore është e dekoruar me motivin e rozetës së gjeometrizuar.

monument që e priste blerësin⁴, ose fjala është për një monument të pakryer⁵. Për mundësinë e supozimit të dytë flet edhe gjendja e motivit të skalitur në fushën relievore me mbarim harkor të përmasave 48 x 50 cm, që është trajta mbizotëruese në Dardani dhe gati e vetmja në trevën e Kosovës⁶. Ky motiv, në të cilin qëndron edhe rëndësia e këtij monumenti, paraqet figurën e një kalorësi të punuar në një reliev mjaft të sheshtë gati vetëm me kontura. Nga ai duket qartë koka pa detaje dhe trupi po ashtu pa detaje të veshjës, pos një detajimi të mundshëm të klamidës së zakonëshme që valvitet mbi shpinë. Nga gjymtyrët janë skalitur duart, nga të cilat me të majtën mban kalin për freri, ndërsa të djathtën e ka të ngritur në shenjë përshëndetjeje, të njohur si *benedictio Latina* (bekimi latin). Pozicioni i kalit, me këmbën e djathtë të ngritur nuk mund të dallohet qartë se a ishte në ecje apo në vrapim. Ndonjë figurë tjetër që e shoqëron nuk mund të dallohet. Shikuar në tërësi duket një punim mjaft sipërfaqësor.

Ky kalorës ikonografikisht i përgjigjet të ashtuquajturit “kalorësi trakas”⁷, i cili në kohën romake kryesisht haset në provincat ballkanike si në monumentet mbivarrore, ashtu edhe në ato votive, të cilat janë edhe më të shumta. Sidomos shumë shpesh e hasim në territorin trakas – në Traki dhe Mezi të Poshtme që nga shekulli I p. Kr.⁸, për ç’arsye e ka marrë edhe emrin, si dhe në provincën e Maqedonisë, ku më të shumta janë monumentet mbivarrore, ndërsa pllakat votive vijnë nga treva e Pellagonisë⁹. Njëherit edhe në Azi të

⁴ Khr. DOBRUNA-SALIHU, E. (2003-2005) ff. 598-599, n. 9, T. 4, fig. 4, n. 64, T. 31, fig. 57; n. 100, T. 50, fig. 92, n. 177, T. 85, fig. 162, n. 233, T. 111, fig. 207, n. 273, T. 124, fig. 234 (nga e gjithë Dardania); E NJËJTA (2007): ff. 328-329, n. 8, T. 2, fig. 8 (nga fshati Zhur).

⁵ DOBRUNA-SALIHU, E. (2003-2005): n. 74, T. 35, fig. 66 (nga rrethina e Shkupit), n. 231, T. 110, fig. 205 (nga Prizreni).

⁶ MÓCSY, A. (1970) ff. 79-80, fig. 24, (nga *Ulpiana*), ff. 95-97, fig. 32, (nga *Naissus*-i), ff. 118-120, fig. 37 (nga *Timacum minus*-i); DOBRUNA-SALIHU, E. (1987) tipi I, ff. 195-197, figg. 1-5, (nga Kosova); E NJËJTA (2003-2005) tipi III, ff. 88-98, 679-748, TT. 42-90 (nga e tërë Dardania).

⁷ Të parët e kanë emëruar studiuesit: DUMONT, A. (1869) f. 218 dhe KAZAROW, G. I. (1918) sht. 1132 e tutje.

⁸ KAZAROW, G. I (1938): pason; FIRATLI, N. – ROBERT, L. (1964): f. 26, T. 45, fig. 185, T. 46, fig. 184, T. 54, fig. 206; BORDENACHE, G. (1965): ff. 264-265, figg. 10-12, f. 269, figg. 17-18, f. 276, fig. 26; ALEXANDRESCU-VIANU, M. (1985) ff. 65-67, figg. 2/1, 4/1, 6/5, 7/4. GOCEVA, Z. – OPPERMAN, M. (1981-1984).

⁹ RÜCH, A. (1969) f. 151, fig. 78, f. 157, fig. 82, f. 187, fig. 94; ALEXANDRESCU-VIANU, M. (1975) f. 182 e tutje, figg. 1/4, 4/1, 3, 8/4; CERMANOVIĆ-KUZMANOVIĆ, A (1982) ff. 27-53, nn. 36-72. TT. 21-39, figg. 36- 69 me literaturën tjetër.

Vogël, ku figura e këtij kalorësi në stela fillon të paraqitet që nga koha helenistike (shekujt III dhe II p. Kr.),¹⁰ kurse në provincat e Dakisë¹¹ dhe të pjesës veriore të Mezisë së Epërme të shumta janë vetëm pllakat votive.¹²

Në trevën dardane, pos pjesës jugore, territorit të Skupit, ku stelat mbivarrore me këtë motiv janë diç më të shumta – në të cilat është i pranishëm me të dy grupet e paraqitjes: me shoqërues dhe vetëm¹³ – në pjesën qendrore (sot Kosova dhe pjesa veriperëndimore kufitare e Shqipërisë), është i pranishëm vetëm edhe në dy stela: Uglarte Prishtina (fig. 2)¹⁴ dhe Margegaj te Tropoja (fig. 3)¹⁵, ku kjo e fundit paraqet monumentin mbivarror deri më tash të gjetur në pikën më perëndimore të Dardanisë. Në të dyja rastet – ku në të parin gjendet në xokol, kurse në të dytin po ashtu në fushën relievore të formës së njëjtë – është paraqitur vetëm, pa elementet e zakonshme përcjellëse, që e hasim edhe në të gjitha paraqitjet e këtij kalorësi në cipusët kubikë me mbarim piramidal nga pjesa lindore dhe juglindore e provincës së Dalmacisë: rrjedha e mesme e lumit Drin (*Drinus*, *Drina*), territoret e Malvesiatit (*Malvesiatium*, Skelani) Kapedunit (*Capedunum*, Uzhica) dhe të Municipit S... (*Municipium S...*, Komini te Plevla)¹⁶, të cilat paraqesin monumentet e pakta të kësaj province me figurën e këtij kalorësi. Është karakteristike se në pjesën qendrore edhe në monumentet votive haset shumë pak, vetëm në dy pllaka nga Ulpiana (fig. 4, 5)¹⁷, kurse më i shumtë është po ashtu në pjesën

¹⁰ PFHUL, E. – MÖBIUS, H. (1979): TT. 191 e tutje; RANTZ, B (1983) f. 200 e tutje.

¹¹ BUDAY, A. (1926) ff. 1-19; HAMPARTUMAIN, N. (1979) me literaturën e cituar.

¹² CERMANOVIĆ-KUZMANOVIĆ, A (1963) ff. 31-33, nn. 2-3, 6-9, f. 41, n. 69; E NJËJTA (1982) ff. 3-11, nn. 1-14, TT. 1-7, figg. 1-13 me literaturën e cituar.

¹³ DRAGOJEVIĆ-JOSIFOVSKA, B. (1982) f. 99, n. 81, f. 103, n. 88, ff. 178-179, n. 326; DOBRUNA-SALIHU, E. (2003-2005) f. 643, n. 26, T. 13, fig. 22, ff. 670-672, nn. 72, 73, 74, TT. 34-35, figg. 64-66, f. 751, n. 195, T. 93, fig. 175.

¹⁴ VULIĆ, N. (1931) 195, n. 520; DOBRUNA-SALIHU, E. (2003-2005) f. 711, n. 134, T. 68, fig. 126 me literaturën e mëhershme.

¹⁵ JUBANI, B. (1974): 205a, T. 1; interpretimi i figurës dhe transkriptimi i mbishkrimit: DOBRUNA-SALIHU, E. (2003-2005) f. 710, n. 133, T. 68, fig. 125.

¹⁶ ZOTOVIĆ, R. (1995) ff. 72-73, 125-129, nn. 129, 130, 133, 135, 143, 147, 152, 153, 155, 156, figg. 129a, 130, 135, 155a me literaturën e mëhershme

¹⁷ CERMANOVIĆ-KUZMANOVIĆ, A. (1982) ff. 19-20, nn. 26-27, T. 14, figg. 26-27; DOBRUNA-SALIHU, E. (2003-2005) f. 813, nn. 319-320, T. 150, fig. 277.

jugore (në territorin e Skupit)¹⁸ dhe veriore dardane (në territorin e Naissus-it dhe në *Timcum minus*, Ravne)¹⁹, ku në të gjitha rastet është paraqitur me shoqërues.



Fig. 2



Fig. 3



Fig. 4



Fig. 5

¹⁸ CERMANOVIĆ-KUZMANOVIĆ, A. (1982) f. 18, n. 25, T. 13, fig. 25, ff. 21-23, nn. 29, 32, T. 18, fig. 32, f. 26, n. 35; DOBRUNA-SALIHU, E. (2003-2005) ff. 810-812, nn. 315-318, TT.148-149, figg. 273-276.

¹⁹ CERMANOVIĆ-KUZMANOVIĆ, A. (1982) ff. 12-15, nn. 15, 16, 18-21, T. 10, figg. 19-20, T. 11, fig. 21; DOBRUNA-SALIHU, E. (2003-2005) ff. 814-816, nn. 321-326, T. 150, figg. 277-278.

Te ky kalorës, i cili i takon grupit të perëndive kalorëse,²⁰ esenciale është domethënia e tij religjioze. Shikuar nga ky aspekt ai paraqet heroin (*heros-in*), ku në monumentet votive ka të bëjë me të parin apo të parët e hyjnizuar, për ç'arsye edhe në shumë relieve mban vetëm emrin *Heros*, ndërsa në monumentet mbivarrore, ku po ashtu hasim edhe në përkushtimin *heros (heroi)* paraqet të ndjerin e heroizuar, duke u identifikuar me vetë të ndjerin të cilit i përkushtohet monumenti dhe i cili në të vërtetë barazohet me këtë perëndi²¹ apo me heroin e familjes²². Prandaj kemi të bëjmë me kultin e të parëve, të heroit, që haset në tërë Ballkanin, me të cilin lidhet shumë ngushtë ky perëndi kalorës i përhapur në këtë trevë²³.

Për rolin e madh që ka luajtur kulti i perëndisë kalorëse në mesin e popullsisë ilire dhe, lidhur me të i heroit kalorës në të njëjtën formë në të cilën paraqitet edhe “kalorësi trakas”, i cili ka qenë i pranishëm në territorin ilir, është me rëndësi të ceket se dëshmi na ofrojnë tri monumente votive me një vlerë të veçantë. Te njëri kemi të bëjmë me pllakën relievoe mu nga treva e Dardanisë, të gjetur në Bulesovc te Vranja, me paraqitje të këtij kalorësi në gjueti (fig. 6)²⁴. Në



Fig. 6

bazë të mbishkrimit, përfundi kësaj paraqitjeje figurative, përkatësisht heroit-kalorës të hyjnizuar, të cilin në mënyrë të drejtë e ka deshifruar studiuesi kroat M. Suiq: *Deo Tatoni pa(trio)...*, duke theksuar “se, nëse ky *Tato, deus patrius* ilir është vetë kalorësi i heroizuar – i hyjnizuar i paraqitur në relief, përkatësisht nëse ekziston lidhja organike ndërmjet komponentës figurative dhe asaj epigrafike, atëherë figura e heroizuar në kompozimin e “kalorësit trakas”, përbri rasteve të tjera, paraqet edhe një

²⁰ WILL, E. (1955) ff. 55-154 – ff. 55-89 kalorësi trakas, ff. 89-103 kalorësit danibianë.

²¹ GARAŠANIN, M. – D. (1967) f. 186.

²² VULIĆ, N. (1941-48) f. 285; GARAŠANIN, M. (1976) ff. 280, 281. Për mendimin se në monumentet mivarrore paraqet të ndjerin e heroizuar janë shumica e autorëve që nga studiuesi KAZAROW, G. I. (1918) sht. 1145.

²³ BENOIT, F. (1954) pason, sidomos f. 63.

²⁴ BOŠKOVIĆ, Dj. (1956-57) ff. 159-162 me foto; PETROVIĆ, P. (1979) ff. 126-127, n. 119; CERMANOVIĆ-KUZMANOVIĆ, A. (1982): f. 18, n. 25, T. 13, fig. 25; DOBRUNA-SALIHU, E. (2003-2005) f. 812, n. 318, T. 149, fig. 276.

perëndi që është e lidhur ngushtë me kultin e të parëve në trevën e ilirëve të Ballkanit dhe sidomos në trevën e ngushtë ku është gjetur monumenti, e cila kishte veti profilaktike dhe apotropeike, ashtu siç kishin *dii patrii* në Romë²⁵. Te dy monumentet tjera kemi të bëjmë me dy mbishkrime nga kompleksi i tempullit të Eskulapit në qytetin Lambez (*Lambaesis*, në priferi të fshatit Tazoult në Algjeri) të provincës së Numidisë në Afrikën Veriore, të cilat ia ka përkushtuar një ushtar, më vonë konsull, me prejardhje nga Risini (*Risinium*, Risni), në provincën e Dalmacisë, kalorësit Medaur (*Medaurus*), Larit – perëndisë-mbrojtëse të këtij qyteti dhe të parëve (*patrium numen*), ku në njërin epigram edhe veten e quan *Medaurius*²⁶. Për identifikimin e tij janë dhënë mendime të ndryshme,²⁷ mirëpo karakterin e tij më afër e ka precizuar arkeologu M. Garashanin, duke konstatuar se fjala është për të parin e përbashkët, heroin e banorëve të qytetit, kulti i të cilit mund të vihet në lidhje me formimin e vetë qytetit. Prandaj edhe në rastin e Medaurit dhe të Tatonit kemi të bëjmë me heroin e bashkësisë së gjerë²⁸. Bazuar në këtë, thekson ky studiues, mund të konkludojmë se tek ilirët në kuptim të gjerë ekzistonte një perëndi i të parëve, përkatësisht prindparë i paramenduar dhe i paraqitur si kalorës, që ikonografikisht ishte shumë i ngjashëm me “kalorësin trakas”, sigurisht edhe në përmbajtje, por që ka mbajtur emra të ndryshëm, si *Tato* dhe *Medaurus*²⁹. Në të mirë të kësaj flasin edhe monumentet mbivarrore nga pjesa lindore dhe juglindore e provincës së Dalmacisë, ku në mënyrë mjaft të theksuar është dokumentuar antroponimia ilire, siç është rasti edhe me ekzemplarin tonë nga Uglari, në të cilin përmendet emri *Nanea*, që është vendës dhe i lidhur vetëm për Dardani³⁰. Prandinë e këtyre monumenteve me paraqitjen e tillë të figurës së kalorësit në këto treva, sikundër edhe në atë të Pellagonisë dhe të rrjedhës së mesme të Vardarit (përfundon ky studiues), nuk mund ta lidhim assesi me treva të banuara nga popullsia trakase, me ç’rast vërtetohet ekzistimi i kultit të heroit kalorës të përhapur jashtë trevës trakase edhe në ato treva të Ballkanit të cilat ishin ilire”.³¹

²⁵ SUIĆ, M. (1961) ff. 93-96 me foto.

²⁶ CIL 3, 258; 8, 2851.

²⁷ MARIĆ, A. (1933) ff. 10-13 me literaturën e cituar.

²⁸ GARAŠANIN, M. (1976) ff. 273- 275, 281.

²⁹ GARAŠANIN, M. – D. (1967) f.187. Shumë e ngjashme me ikonografinë e Medaurit është edhe figura e kalorësit në dy pllaka të shekullit III p. Kr. nga Apolonia në trevën e Ilirisë së Jugut, i cili paraqet një perëndi që adhurohej nga banorët e këtij qyteti, khr. CEKA, H. – ANAMALI, S. (1959) ff. 93-94, shën. 28, fig. 23.

³⁰ PAPAŽOGLU, F. (1969) ff. 179, 187 (tabela).

³¹ GARAŠANIN, M. (1976) ff. 277-278.

Se në territorin e gjerë ilir që herët ka qenë i pranishëm ky kult kemi dëshmi që nga koha parahistorike. Fjala është për paraqitjen e kalorësve të vetmuar lakuriq në të ashtuquajturat “urnat japode”, që duhet lidhur gjithsesi me të ndjerin e heroizuar³². Sipas arkeologut A. Stipčević të njëjtën domethënie duhet të kenë pasur edhe figurinat e kalorësve lakuriqë nga Nezakci (*Nesactium*, Visaçe) në trevën e Histrisë dhe të Novo Mestos së sotme (Slloveni)³³. Prania e këtij kulti që nga koha pararomake dokumentohet edhe me figurat e kalorësve në katër pllakat metalike nga Selca e Poshtme te Pogradeci (*Pelion-i ant?*) në Shqipëri dhe te Gostili te liqeni i Shkodrës në Mal të Zi³⁴. Prandaj, shihet qartë se në trevat e banuara me ilirë që nga koha parahistorike ka ekzistuar kulti i heroit - kalorësit, përkatësisht i të ndjerit të heroizuar, i cili ka qenë mjaft i pranishëm³⁵.

Shtatorja e tipit “Togatus” nga Mushtishti (fig. 7 a, b).

Shtatorja, punuar në skulpturë të plotë, u gjet rreth datës 5. IX. 2012. në dalje të fshatit Mushtisht, në drejtim të Dellocit, në vendin e quajtur Simjane, gjatë hapjes së kanalit të ujësjellësit me eskavator nga M. Hajdari, në thellësi rreth 1.50 m.³⁶ Për një kohë qëndroi në oborrin e shtëpisë së tij, prej nga u bart në Muzeun e Kosovës. Asaj i mungon koka me pjesën më të madhe të qafës, pëllëmba e dorës së majtë dhe pjesa e këmbëve mbi nyell së bashku me veshjen e po ashtu është e dëmtuar pëllëmba e dorës së djathtë. Kurse pjesa tjetër, pos disa gërvishtjeve të vogla, është e ruajtur mirë.

E skalitur në mermer të bardhë të mbuluar me patinë me ngjyrë okër, kjo shtatore me lartësi 120 cm paraqet një person që qëndron në këmbë në pozicion kontraposto me peshën e trupit që rëndon mbi këmbën e majtë, ndërsa e djathta është e përkulur lehtë në gju. Të dy duart janë të lakuara në bërryl: me të djathtën, të vendosur përmbi brez në drejtim të krahavorit, shtrëngon disa palë të veshjes, kurse me të majtën, të shtrirë përpara, mbante një gjë.

³² SERGEJEVSKI, D. (1950) T. 3, fig. 1.

³³ STIPČEVIĆ, A. (1984) f. 219.

³⁴ Khr. GARAŠANIN, M. (1976) f. 279.

³⁵ Khr. STIPČEVIĆ, A. (1984):ff. 216 e tutje, ku autori e dëshmon edhe me shembuj tjerë.

³⁶ Për gjetjen e këtij monumenti njoftimi u bë përmes mediave elektronike nga z. D. Zekolli, menagjer komunal i Trashëgimisë Kulturore të Suharekës, të cilit i jam falenderuese.

Elementi më karakteristik i kësaj shtatoreje është veshja e përbërë nga tunika dhe toga. Tunika (këmisha), me mëngë të shkurta dhe prerje ovale rreth qafës, duket vetëm në kraharonin e anës së djathtë dhe krahun e kësaj ane deri te bërryli. Ajo në xhoks është detajuar me palë të rralla mjaft plastike të pjerrëta dhe vertikale, kurse në mëngë me palë të holla dhe të sheshta. Ndërkaq, toga e madhe romake (pelerina nga materiali i leshtë) e mbështjell tërë trupin, pos kësaj pjese të këmishës. Ajo pasi mbulon shpinën, kalon nga ija e dhjathtë duke formuar përfundi belit një brez masiv (*umbo*). Një kind i saj lëshohet poshtë deri në gju dhe, duke formuar një hark me pala të gjera mjaft plastike (*sinus*), ngjitet në drejtim të supit të majtë, ku mbulohet nga një kind tjetër, i cili, si një rrip me pala paralelele varet poshtë dhe, pasi përkulet në formë harku, përfundon brenda në brez, për të dalë poshtë në mes këmbëve. Kindi i tretë, i cili mbulon tërë krahun e majtë zbret duke formuar një hark tjetër paralel me të parin, me pala të ngjashme, në drejtim të këmbëve. Prapa dhe anash është trajtuar mjaft thjesht gati në një masë, që tregon se shtatorja është punuar për t'u shikuar vetëm përpara (*en face*), prandaj ka qenë e mbështetur për muri apo e vendosur në nische.



Fig. 7a



Fig. 7b

Nga mënyra e mbajtjes dhe draperisë së pasur duket qartë se kemi të bëjmë me togën karakteristike luksoze, e cila fillon të mbahet gjatë fundit të Republikës dhe fillimit të Perandorisë³⁷. Në kohën e hershme perandorake haset te perandorët e dinastisë Jul-Klaude dhe Flave, ndërsa te personat e zakonshëm deri në shekullin IV. Mirëpo edhe pse shtatoret e këtij tipi, të cilat janë të shumta në treven itallike, hasen në të gjithë Perandorinë, megjithatë ndërmjet provincave ka dallime të mëdha për nga prania e tyre³⁸. Nga provincat e largëta perëndimore një numër i mirë vjen nga Hispania,³⁹ nërsa nga provincat e Ballkanit të shumta janë në Daki⁴⁰. Ndërkaq, nga trevat fqinje janë mjaft të rralla. Katër shtatore magistratësh, karakteristike e të cilëve ishte *toga praetexta*⁴¹, vijnë nga dy provinca; dy sosh të shekullit II janë nga pjesa veriore e Mezisë së Epërme, të gjetura në Singidun (*Singidunum*, Beogradi)⁴² dhe Viminac (*Viminacium*, Kostolci)⁴³, ndërsa dy të tjera janë nga pjesa perëndimore e provincës së Maqedonisë, njëra e fundit të sundimit të dinastisë Antonine është gjetur në Apolloni⁴⁴ dhe tjetra nga shekujt III-IV, e cila është e karakterit funerar, në Dyrrah⁴⁵. Kurse një shtatore perandorake e shekullit I vjen nga provinca e Dalmacisë, e gjetur në Naronë (*Narona*, Vid te Metkoviqi)⁴⁶.

Mënyra e punimit të gjithmbarshëm të kësaj shtatoreje, ku sidomos shprehet trajtimi i veshjes me pala lineare paralele dhe të ashpra, tregon qartë se ka dalur nga dora e një skulptori që vepronte në një punëtori vendore, i cili, edhe pse i përmbahej modelimit sa më adekuat të saj, ishte jo shumë i shkathët në paraqitjen e draperisë.

Megjithëse identiteti i kësaj shtatoreje është i vështirë, duke u nisur nga fakti se shtatoret e tipit “togatus” rregullisht paraqesin persona me rëndësi, ku zakonisht vendoseshin në vende publike, atëherë me siguri edhe kjo shtatore duhet të paraqesë një person të tillë – ndoshta ngjashëm me ekzemplarët e mëhershëm, duhet të jetë fjala

³⁷ BEAULIEU, M. (1951) f. 60.

³⁸ GOETTE, H. R. (1990) pason.

³⁹ BASARRATE NOGALES, T. (2011) ff. 653-660, figg. 3 a, b, 4 c, d. Shtatoret e perandorëve.

⁴⁰ Observim. Shtatoret e magistratëve.

⁴¹ BEAULIEU, M. (1951) ff. 60, 61, fig. 83.

⁴² SREJOVIĆ, D. – CERMANOVIĆ-KUZMANOVIĆ, A. (1987) f. 160, n. 70.

⁴³ TOMOVIĆ, M. (1996) ff. 216-217, fig. 1.

⁴⁴ PRENDI, F. – CEKA, H. (1964) ff. 40-42, n. 12, TT. 12, 13.

⁴⁵ TOČI, V. (1962) 120-122, fig. 62.

⁴⁶ MARIN, E. (2003) f. 17, fig. 27.

për një magjistrat – mirëpo karakteri tematik i saj nuk mund të përcaktohet. Njëherit, sa i takon datimit të saj edhe pse mungesa e kokës e vështirëson atë, bazuar në stilin e punimit, duhet të jetë punuar aty rreth gjysmës së dytë të shekullit II dhe fillimit të shekullit III.

Me këto veçori, kjo shtatore është e një rëndësie të veçantë, meqë është e para dhe e vetmja e paraqitur me togë jo vetëm në Kosovë, por në të gjithë Dardaninë. Së bashku me dy shtatore të tjera të gjetura në dy lokalitete: Gjakovë⁴⁷ dhe në Ravne (*Timacum minus*) në pjesën veriore dardane⁴⁸, por me tipa tjerë të veshjës – te njëra duke i përngjarë himationit helen, ndërsa te tjetra sagumit romak dhe klamidës helene, të njohur edhe si klamidë dardane (*chlamydem Dardanicam*)⁴⁹, që është e zakonshme te bust-portretet e stelave mbivarrorë – përbëjnë shtatore të vetme të meshkujve të punuar në skulpturë të plotë në tërë trevën dardane.

Kjo shtatore, e cila në trevën e Suharekës paraqet rastin e dytë të shtatoreve punuar në skulpturë të plotë, ku tjetra paraqet një shtatore femre me veshje vendase, ilire⁵⁰, është edhe një udhërrëfyes i mirë për hulumtime të ardhshme arkeologjike, më parë këtu ku u gjet ajo. Aq më shumë, kur në këtë vend së pari u has në themele të mureve të punuara me gurë dhe llaq gëlqeror në thellësi rreth 60 cm., kurse pas zbulimit të shtatores u gjetën edhe fragmente të tullave me trashësi 4-5 cm. Duke qenë se areali i Suharekës është i njohur me material të pasur arkeologjik dhe me këso zbulimesh të antikitetit,⁵¹ atëherë do të ishte më se e nevojshme që të bëhen hulumtime sa më parë, të cilat do të qitnin në dritë të dhënat e kahershme për lokalizimin e një qendre antike të karakterit *civitas peregrinorum* mu në mes të fshatrave Mushtisht, Popovlan dhe Sopi.⁵²

* * *

Në fund mund të konstatojmë se rëndësia e këtyre monumenteve – që të dyja të dala nga punëtoritë vendëse – qëndron në faktin se secila me tematikën e saj na ofron të dhëna të vlefshme. Stela me figurën e kalorësit – e cila, bazuar në dy gjetjet e mëhershme në Uglar

⁴⁷ DOBRUNA-SALIHU, E. (2003-2005) f. 802, n. 300, T. 141, fig. 259.

⁴⁸ VULIĆ, N. (1941-48) f. 91, n. 196.

⁴⁹ Khr. GJERGJI, A. (1969) f. 157, shën. 34.

⁵⁰ DOBRUNA-SALIHU, E. (2007a) ff. 291-292, fig. 8.

⁵¹ DOBRUNA-SALIHU, E. (2007) ff. 321-322, fig. 2, ff. 324-327, figg. 4, 7, ff. 337-341, figg. 18, 23-26, fig. 344-345, fig. 33, 35.

⁵² ČERŠKOV, E. (1969) f. 41.

dhe Tropojë, duhet t'i takojë kohës së njëjtë, aty rreth shekullit II – duke e rritur numrin e monumenteve mbivarrorre me paraqitje të tillë të figurës së kalorësit në pjesën qendrore dardane në tri sosh përforcon të dhënat mbi praninë e kultit të heroit kalorës, përkatësisht të ndjerit të heroizuar edhe në këtë pjesë të Dardanisë, ashtu si në pjesët tjera të saj dhe të tërë territorit ilir. Shtatorja me tipin e saj *togatus* jo vetëm që e pasuroi fondin e monumenteve të antikitetit në Kosovë dhe në mbarë Dardaninë, por edhe dëshmoi praninë e monumeteve të tilla që me veçoritë etnografike hasen për herë të parë, duke e përbërë deri më sot një unikat në këtë trevë.

Exhlale DOBRUNA-SALIHU, Prishtinë

ZWEI ZUFÄLLIGE ENTDECKUNGEN SKULPTURALER MONUMENTE DER ANTIKE IN KOSOVO

Zusammenfassung

Im Zuge der zufälligen archäologischen Befunde im Kosovo findet das bewegliche Material einen wichtigen Platz. Dieses Mal geht es um zwei Denkmäler der Antike in zwei Gattungen, die von lokalen Handwerkern in Stein erarbeitet wurden: Relief und vollständige Skulptur, an zwei verschiedenen Orten gefunden, die zur römischen Zeit den Gebieten von zwei Verwaltungseinheiten gehörten.

Stele mit der Figur eines Ritters aus Kaçanik (Abb. 1) - wurde in den Jahren 2009-2010 gefunden und befindet sich jetzt im Haus der Kultur. Sie wurde am einheimischen Stein erarbeitet und ist gut erhalten. Auf dem bogenförmigen Reliefveld ist die Ritterfigur in der Komposition des sogenannten „Trakischen Ritters“ gemeißelt – was mit dem verehrten Verstorbenen bzw. mit dem vergötterten Ritter zu tun hat. Diese Stele ist das dritte Grabmal mit dieser Figur (Abb. 2, 3) im Zentraldardanien, das auch in den Votivdenkmälern selten gefunden wird, in zwei Fällen (Abb. 4, 5). Häufiger taucht sie in den Denkmälern des südlichen Teils (das Territorium von Scupi) und in Norddardanien (Timacum minus), wo die Platte aus Bulesovci bei Vranje eine Besonderheit im Bezug auf den Inhalt der Inschrift darstellt (Abb. 6).

Die Statue des Typus *togatus* von Mushtisht (Abb. 7 a, b) - wurde Ende 2012 gefunden und befindet sich jetzt im Museum des Kosovo. Erarbeitet als vollständige Skulptur in Marmor, heute fehlen der Kopf, die linke Handfläche und Beinteile über den Knoten. Seine Einzigartigkeit besteht an der Bekleidung bestehend aus einer Tunika und einer großen römischen Toga mit zwei charakteristischen Details - Massenband (*umbo*) unterhalb der Taille und unterhalb des Knies fallende Kindi, das einen Bogen bildet (*sinus*) – das stellt den ersten Fall in ganz Dardanien dar. Um der ersten Hälfte des 2. Jahrhunderts und dem Anfang des 3. Jahrhunderts gearbeitet, stellt es zweifellos eine wichtige Person dar.

Die Bedeutung dieser beiden Denkmälern liegt an der Tatsache, dass uns beide mit ihrer Thematik wertvolle Daten liefern. Die Stella mit der Ritterfigur – die basierend auf zwei frühere Befunde Uglar und Tropoja der gleichen Zeit gehören sollte, um den 2. Jahrhundert – beweist durch die Erhöhung der Zahl von Grabmälern mit solcher Ritterfigur in Zentraldardanien auf drei noch einmal den Kult um den Ritterheld bzw. des vergötterten Toten in diesem Teil Dardaniens. Die Statue des Typus *togatus* hat nicht nur den Fonds von Statuen im Kosovo und ganz Dardanien bereichert, sondern auch zum ersten Mal mit ihrer Präsenz neue Erkenntnisse über die Antike im ganzen Gebiet geliefert.

Literatura

- ALEXANDRESCU-VIANU, Maria (1975) Les stèles funéraires de la Macédoine romaine, Dacia n. s. 19, Revue d' archéologie et d'histoire ancienne, București, 183-200.
- ALEXANDRESCU-VIANU, Maria (1985) Les stèles funéraires de la Mésie Inférieure, Dacia 29, București, 57-73.
- BASARRATE NOGALES, Trinidad (2011) Plástica romana Emerietense en el contexto de Hispania: Modelos y difusión, XI coloquio International de arte Romano provincial (Meridë, 18-23 maj 2009), "Roma y las provincias: modelo y diffusion II", (ed.) T. Nogales – I. Rodá, Merida, 653-670.
- BEAULIEU, Michèle (1951) "Le costume antique et medieval", Presses Universitaires de France, Paris.
- BENOIT, Fernand (1954) "L'heroisation équestre", Annales de la Faculté des Lettres, Aix en Provence.
- BORDENACHE, Gabriela (1965) Temi e motivi della plastica funeraria di età Romana nella Moesia Inferior, Dacia n. s. 9, Revue d' archéologie et d'histoire ancienne, București, 253-281.
- BOŠKOVIĆ, Djurdje (1958) Prilog proučavanju "tračkog konjanika, Starinar 7-8, Organ Arheološkog Instituta SANU, Beograd, 1956-57, 159-163.
- BUDAY, Arpad (1926) Das problem des sog. thrakischen Reiters, Dolgozatok 2, Travaux de l'Institut archéologie de l'Univerzite a Szeged, Seghedin 1-19.
- CERMANOVIĆ-KUZMANOVIĆ, Aleksandrina (1963): Die Denkmäler der thrakischen Heros in Jugoslawien und das Problem des thrakischen Reitergottes, Archaeologia Iugoslavica 4, Societas Archaeologia Iugoslaviae, Beograd, 31-59.
- CERMANOVIĆ-KUZMANOVIĆ, Aleksandrina (1982) "Monumenta intra fines Jugoslaviae Reperta", Corpus cultus equitus Thraci 5, E.J. Brill, Leiden.
- Corpus Inscriptionum Latinarum 3, 258; 8, 2851, Berlin.
- ČERŠKOV, Emil (1969) "Rimljani na Kosovu i Metohiji", Arheološko društvo Jugoslavije, Beograd.
- DOBRUNA-SALIHU, Exhlale (1987): Nadgrobne stele s područja Kosova. Arhitektonika i plastika, Arheološki vestnik 38, Inštitut za arheologiju SAZU, Ljubljana, 193-205.
- DOBRUNA-SALIHU, Exhlale (2003-2005) "Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake. Sepulkrale dhe e kultit 1-2", Instituti Albanologjik, Prishtinë.
- DOBRUNA-SALIHU, Exhlale (2007) Zbulimet e rastit të monumenteve të gurit nga koha romake në trevën e Kosovës. Kontribut i përnjohjes së terrenit në Kosovë,

- Gjurmime Albanologjike - Seria e Shkencave Historike 36, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2006, 319-354.
- DOBRUNA-SALIHU, E. (2007a) Darstellungen der Frauentracht auf Grabdenkmälern in Dardanien, Acten des IX Internationalen Kolloquiums über Probleme des Provinzialrömischen Kunstschaftens (Innsbruck, 25.-28. Mai 2005), (ed.) E. Walde, G. Grabherr, B. Kainrath), "Ikarus 2", Innsbruck, 287-294.
- DOBRUNA-SALIHU, Exhlale (2013) Dekorativno-simbolični motivi vegetabilnih i animalnih obilježja na stelama s područja Dardanijske. Podrijetlo i pravci širenja, "Sepulkralna skulptura zapadnog Ilirika i susjednih oblasti u doba Rimskog Carstva", Zbornik radova s međunarodnog simpozija (Split, 27.- 30. rujna 2009), Split, Književni krug, 593-618.
- DRAGOJEVIĆ-JOSIFOVSKA, Borka (1982) "Inscriptions de la Mésie Supérieure VI. Scupi et la region de Kumanovo", (ed.) F. Papazoglou, Centre d'études épigraphiques et numismatiques de la Faculté de Philosophie de l'Université de Beograd.
- DUMONT, Albert (1876) "Inscriptions et monuments figurés de la Thrace", Impr. nationale, Paris.
- FIRATLI, Nezih – ROBERT, Luis (1964): "Les stèles funéraires de Byzance gréco-romaine", A. Maisonneuve, Paris.
- GARAŠANIN, Milutin (1976) O problemu starobalkanskog konjanika, Godišnjak Centra za balkanološka ispitivanja ANUBiH 13/11, Sarajevo, 273-282.
- GARAŠANIN, Milutin – GARAŠANIN, Draga (1967) "Istorija Crne Gore 1", Titograd.
- GOCEVA, Zlatozara – OPPERMANN, Manfred (1981-84) "Monumenta inter Danubium et Haemum reperta", Corpus cultus equitus Thraci 2(1)-2(2), E.J. Brill, Leiden.
- GOETTE, Hans Rupprecht (1990), "Studien zu römischen Togadarstellungen", Philipp von Zabern, Mainz am Rhein.
- GJERGJI, Andromaqi (1969) Elemente të përbashkëta të veshjes së viseve të ndryshme ilire dhe vazhdimësia e tyre në veshjet tona popullore, "Ilirët dhe gjeneza e Shqiptarëve", Sesion shkencor (Tiranë, 3-4 mars 1969), Tiranë, 153-173.
- HAMPARTUMAIN, Nubar (1979) "Moesia Inferior und Dacia", Corpus cultus equitus Thraci 4, E.J. Brill, Leiden.
- JUBANI, Bep (1974) Rrethi Tropojës, Buletini Arkeologjik 4, Instituti i Historisë – Sektori i Arkeologjisë, Tiranë, 199-205.
- KAZAROW, Gawril I. (1918) Heros (Thrakischer Reiter), A. Pauly – G. Wissowa, Realencyclopädie der classischen Altertums-wissenschaft, Suppl. 3, Stuttgart, 1132-1148.
- KAZAROW, Gawril I. (1938) "Die Denkmäler des thrakischen Reitergottes in Bulgarien", Dissertationes Pannonicae 1-2/14, 1935-1938, Budapest.
- MARIĆ, Rastislav (1933) "Antički kultovi u našoj zemlji", Privrednik, Beograd.
- MARIN, Emilio (2003) Naronitaski Augusteum i arheološka istraživanja u Naroni 1988-2001, "Arheološka istraživanja u Naroni i dolini Neretve", Znanstveni skup (Metković, 6.-9. listopada 2001), (ed.) E. Marin, Hrvatsko arheološko društvo, Zagreb-Metković-Split, 11-50.
- MIRDITA, Zef (1981) "Antroponimia e Dardanisë në kohën romake", Rilindja, Prishtinë.

- MÓCSY, András (1970) "Gesellschaft und Romanisation in der römischen Provinz Moesia Superior", Akadémiai Kiadó, Budapest.
- PAPAZOGLU, Fanula (1969) "Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba", Djela Centra za balkanološka ispitivanja 30/1, Sarajevo.
- PETROVIĆ, Petar (1979) "Inscriptions de la Mésie Supérieure IV. Naissus-Remisiana-Horreum Margi", (ed.) F. Papazoglou, Centre d'études épigraphiques et numismatiques de la Faculté de Philosophie de l'Université de Beograd.
- PFUHL, Ernst – MÖBIUS, Hans (1977) "Die östgriechischen Grabreliefs 1", Philipp von Zabern, Mainz am Rhein.
- PRENDI, Franjo – CEKA, Hasan (1964) Skulptura të Apollonisë, Studime historike 2, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 25-85.
- RANTZ, B (1983) Le cavalier thrace - Theme iconographique, Pulpudeva 4 (Plovdiv, 3-17. octobre 1980), Sofia, 200-219.
- RÜSCH, Alfred (1969) Das Kaiserzeitliche Porträt in Makedonien, Jahrbuch des Deutschen Archäologischen Instituts 84, Berlin, 58-196.
- SERGEJEVSKI, Dimitrije (1950) Japodske urne, Glasnik Zemljskog muzeja u Sarajevu, n. s. 4-5, 1949-50, 45-94.
- SREJOVIĆ, Dragoslav – CERMANOVIĆ-KUZMANOVIĆ, Aleksandrina, (1987) "Rimska skulptura u Srbiji", Katalog izložbe, Beograd.
- STIPČEVIĆ, Aleksandar (1984): Kult heroiziranog pokojnika u ilirskoj religiji, "Duhovna kultura Ilira", Simpozijum (Herceg Novi, 4.-6. novembra 1982), Posebna izdanja Centra za balkanološka ispitivanja 67/11, Sarajevo, 215-221.
- SUIĆ, Mate (1961) Tato ilirski Deus Patrius, Starinar 11, Beograd 1960, 93-97.
- TOČI, Vangjel (1962) Mbishkrime e relieve nga nekropoli i Dyrrahit, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës – Seria shkencat shoqërore 2 (16), Tiranë, 70-136.
- TOMOVIĆ, Miodrag (1996) Neobjavljene mermerne skulpture iz Narodnog muzeja u Beogradu, Zbornik narodnog muzeja 16-1, Beograd, 217-223.
- VULIĆ, Nikola (1931) "Antički spomenici naše zemlje", Spomenik Srpske kraljevske akademije 71 (55), Beograd.
- VULIĆ, Nikola (1941-1948) "Antički spomenici naše zemlje", Spomenik akademije nauka i umetnosti 98 (77) Beograd.
- WILL, Ernest (1955) "Le relief cultuel greco-romain. Contribution à l'histoire de l'art de l'Empire romain", E. de Boccard, Paris.
- ZOTOVIĆ, Radmila (1995) "Rimski nadgrobni spomenici istočnog dela provincije Dalmacije", Kadinjača, Užice.

Ibrahim BERISHA, Prishtinë

KOMUNIKIMI I DIJES DHE TEKNOLOGJITË DIGJITALE

KDU 303 .093.7

Abstrakt

007

Kultura identifikohet me komunikimin, ndërsa komunikimi ndërkulturor me qytetërimin. Zhvillimi i teknologjive informative është duke krijuar mundësi të gjera komunikimi dituror dhe ndërkulturor. Andaj, shoqëria e sotme, krahas shoqërive globale, duke shfrytëzuar teknikat e reja komunikuese merr edhe epitetin e “shoqërisë informative”, shoqërisë së dijes”. Një nga vlerat më kreative të këtij komunikimi postklasik, pra digjital, është libri, i cili në trendin e zhvillimit teknologjik hap hapësira dhe fusha të mëdha të këmbimit dhe të zhvillimit të dijes. Libri tradicional, konvencional po ia lë vendin librit elektronik, ndërsa në këtë proces po ngecin institucionet diturore të Kosovës. Bartja e dijeve është bërë e lehtë dhe më pak e kushtueshme dhe kjo është sprovë e ndryshimit mbasi nga ky ndryshimi teknologjik përfitues janë krijuesit dhe konsumuesit e dijes si vlerë universale.

Fjalët çelës: Komunikim ndërkulturor, libër, e-books, bibliotekë, dije, liri njerëzore, stereotipe, e drejtë e autorit.

Zgjerimi i komunikimeve është në një proces intensiv, prandaj edhe sot e kësaj dite njeriu është bërë jo vetëm subjekt, por edhe objekt i kësaj teknologjie që zhvillohet me një dinamikë të jashtëzakonshme, jo rrallë duke e ndihmuar dhe lehtësuar komunikimin, por edhe duke e rrezikuar përveç formës dhe përmbajtjes edhe vetë të qenit e tij social, human dhe solidar. Për të treguar këtë ndryshim të plotë në komunikimet ndërmjet njerëzve është i rëndësishëm theksimi i faktit të pranuar gjerësisht që teknologjia informuese sot është një kulturë njerëzore, është agjens themelor i hulumtimeve dhe identitetit dituror dhe akademik, me të drejtë krahasuar sikur që ishte bujqësia apo vreshtaria në Mesjetë dhe industria e lehtë në parakapitalizëm apo industria e rëndë në kapitalizmin liberal. Tashmë njeriu detyrohet të njohë dhe zotërojë teknologji komunikuese për të mundur të jetë një faktor aktiv në tregun e dijes dhe të punës. Nuk është puna më nëse do apo jo dikush të mësojë teknologjinë informative komunikuese, por një detyrë e tillë është vetë prova për të mbijetuar dinjitetshëm dhe për të qenë korrespondues me proceset diturore dhe sociale në tërësi.

Po kështu, teknologjia dhe dimensionin e komunikimeve arsimore ka vënë në dilemë sociologët e komunikimeve, nëse ajo ndikon edhe

në ridimensionimin e lirisë humane. Teknologjia është më e fuqishme se dëshira për liri shoqërore, përderisa zhvillimi teknologjik ngushton sferën e lirisë sonë dhe çdo përparim teknologjik që synohet dhe dëshirohet e ndihmon pikërisht këtë kufizim, mendon Teodor Kazinski. Mendimi i Kazinskit mbi dëshirën e njeriut, e cila në shoqërinë moderne shumëherë mund të jetë më e fuqishme për të pasur teknologji se sa liri, tërheq mbas edhe dilema dhe probleme mbi perspektivën jo vetëm të komunikimeve, por edhe të socialitetit.¹

Është i arsyeshëm vlerësimi që bëhet nga sociologët dhe informatologët, se komunikimi megjithëse është i ndikuar, nuk identifikohet plotësisht me teknologjinë. Do pasur parasysh se komunikimi nuk është vetëm mjeti-pajisja, që shërben për të vënë marrëdhënie më të mira apo më të këqija ndërmjet njerëzve. Mjeti mund të mos shfrytëzohet, ndërsa komunikimi është atje ku jemi ne, një këmbim yni me botën. Me gjithë këtë dinamikë dramatike, zhvillimi tekniko-teknologjik nuk e ka zhvendosur njeriun si faktor themelor të komunikimeve, prandaj dimensionin social në komunikime vazhdon të mbetet primar, edhe pse ai teknologjik është i papërgjashtëshëm. Kjo e mpreh pyetjen së cilës sot nuk mund t'i jepet përgjigje dhe që do kohë për të marrë përgjigjen e plotë: Se njeriu dhe teknologjia supermoderne e komunikimeve në të ardhmen a do të jenë partnerë apo në konflikt të hapur për të zotëruar tregun e dijes?

Dilemat janë shtuar nga presioni për të shfrytëzuar kohën duke përdorur mediat, veçmas televizionin dhe internetin. Doris Graber gjykon se sot një maturant i shkollës së mesme kalon më shumë kohë para televizorit se sa në shkollë. Në veçanti kjo ka të bëjë me fëmijët në institucionin parashkollor dhe në shkollën fillore². Pse njerëzit janë të drejtuar kaq shumë kah komunikimi. Pse ata janë të lidhur shumëfish me internetin dhe televizionin?

Inteligjencia artificiale, term i përdorur për herë të parë nga Xhon Mekartni më 1965, megjithëse nuk e zhvendos njeriun plotësisht, ajo e shmang nga froni i të vetmit inteligjent. Përmes kompjuterit, edhe në fushën e komunikimeve do të mund të procesohen të dhëna në mënyrë të njëjtë me atë të trurit të njeriut, duke pasur mundësinë që ato përmbajtje të përpunohen, zgjerohen dhe seleksionohen³ në mënyrë të

¹ Berisha, Ibrahim (2007), Mediat, agjensët e komunikimeve, PEN/AAB, Prishtinë, f. 11.

² Graber, Doris A (2002), Mass Media & American Politics”, COPRESS, Washington, D.C., p. 3.

³ Shih. John Hall (2003), Representation; Cultural Representations and Signifying Practice, London.

pavarur dhe për nevoja krejt të ndryshme, duke përfshirë edhe sistemet komplekse diturore dhe kulturore.

Bashkësitë sociale krijojnë marrëdhënie aktive ndërkulturore. Kultura është komunikim, por edhe “ këmbimin – dhënie e marrje e domethëniesve ndërmjet anëtarëve të një shoqërie dhe grupeve. Në epiqendër të këtij këmbimi dhe zhvillimi ndërkulturore mbizotëron dija, dhe në këtë kuadër libri që po merr vlera dhe kompetenca ende më universale me procesin e shpejt të digjitalizimit. Duket si një vizion magjik, por i vërtetë mendimi i Borhesit, kur dhjetëra vjet përpara daljes së internetit theksonte se të gjithë njerëzit shkruajnë një të vetmin libër të madh të quajtur literaturë. Literatura ka potencialin dhe vlerën më të mundshme të këmbimit elit dhe aq më shumë masiv në saje të ndihmës së medias, prandaj sot vija ndarëse ndërmjet sistemeve diturore elite dhe masive është pak e theksueshme. Maskultura zotëron edhe komunikimet shkollore. Në këtë kontekst mendimi i Borhesit është paraprijës edhe i synimit të Fondacionit Sloan⁴, i cili planifikon të “digjitalizojë dijen e gjithë botës”.

Revolucioni “digjitalizim”, ndërsa u jep përgjigje shumë pikëpyetjeve, ringreh po kaq shumë pikëpyetje të tjera, që presin të marrin përgjigje me kohën që vjen. Raporti kultura, arti, libri, biblioteka, botuesi, libraria, hulumtimi dhe këmbimi diturore në tërësi, në njërën anë, dhe kompjuteri, interneti, teknologjia komunikuese, në tjetrën, e mban aktive dilemën e së ardhmes kulturore dhe antropologjike të dijes dhe të literaturës si sistemet me të fuqishme dhe më ndikuese në zhvillimin dhe emancipimin qytetëruar të njerëzimit.

Dija enciklopedike kërkonte hapësira të mëdha dhe të sigurt komunikimi, kundrejt se tash është e bartshme shpejt dhe pakufizueshëm përmes teknologjive dhe aparateve të vogla komunikuese. Një bibliotekë e tërë veprash konstruktohet në një aparat, për t’u transferuar nga një pikë në pikën tjetër të rruzullit tokësor me një komandë teknologjike.

⁴ Alfred P. Sloan Foundation është një organizatë filantropike, joprofitabile, me seli në SHBA, e formuar në vitin 1934 nga Alfred P. Sloan. Fondacioni Sloan si qëllim ka sigurimin e granteve për të përkrahur hulumtimet dhe kërkimet që kanë të bëjnë me shkencën, teknologjinë dhe performancat ekonomike, si dhe të përmirësimit të kualitetit të jetës amerikane. Më 31 dhjetor të vitit 2011 Fondacioni Sloan llogaritej të kishte asete me vlerë totale prej 1.65 miliard dollarësh. Ka gjashtë subjekte ku shpërndahen grantet: Hulumtimi bazik, edukimi shkencor, kuptimi publik i shkencës, performanca ekonomike dhe kualiteti i jetës, problemet e zgjedhura nacionale, iniciativat qytetare.

Ndryshimi që është duke ndodhur në këtë marrëdhënie nuk do të thotë të jetë apriori krizë dhe reduktim kulturor në përgjithësi, në njërën anë, dhe i dijes, në anën tjetër, gjithë kjo në favor të teknologjizmit dhe aventurës, megjithëse e ardhmja e këtij raporti nuk është e thjeshtë dhe as lehtë e parashikueshme.

Në këtë rast bëhet fjalë për sisteme të mëdha kulturore komunikuese, të cilat në vete bartin pluralitet dhe kontradikta. Secili sistem kulturor, shprehet Meri Daglas, herë pas here është i detyruar të ballafaqohet me kontradikta, të cilat vetë procesi i krijon dhe i menaxhon. Konfliktet, fjala vjen, janë njohur shumëkund ndërmjet përkrahësve të liberaldemokracisë kulturore (multikulturalizmit) dhe “kujdesit për statusin kulturor etnik të bashkësisë (monokulturalizmit). Prandaj në procesin e këmbimit ndërdituror dhe ndërkulturor duhet pasur parasysh edhe mosmarrëveshjet, të cilat janë të natyrshme të përcillen me praktika dhe përvoja të reduktuara, që pasohen nga modelet tradicionale apo autoritare kulturore.

Për të treguar efektin e këtij reduktimi komunikues kulturor, negativ dhe injorues, do sjellë në vëmendje “interkomunikimin kulturor” dhe dituror ndërmjet Shqipërisë komuniste dhe Kosovës së okupuar në ish-Jugosllavinë Socialiste në vitet 1945-1990. Kufizimi i këmbimit kulturor po edhe përmbajtjet e këtij komunikimi, për arsye sistemesh autoritare, kanë prodhuar ideologji më shumë se sa dije. Më tepër autoritarizëm të dijes se sa dije të autoritetshme.

Kultura në Kosovë është interpretuar me diskurse stereotipe, tematizime në kontekstin e diskutimeve, ngjashëm me përvojat e vendeve postkoloniale. Sociologjikisht dhe antropologjikisht kjo kulturë bazohej në theksimin e dallimeve ideologjike dhe nacionale, duke potencuar “fascinimin me vetveten dhe me frikën nga të tjerët”. Kultura kështu kishte elemente fiksioni dhe të objektit-kult (mu sikur e veçon Bhabha) dhe funksionon mbi skenarin e fetishit. Stereotipi kulturor në Kosovë mund të përkufizohet si fetishizim i formave reprezentuese kulturore duke pasur bazë diskursin e estetizimit dhe identifikimit ideologjik, i krijuar nga mbyllja, pamundësia për të komunikuar hapur.

Stereotipet si konstrukte, si në rastin komunikues ndërshtetëror, mund të jenë fikse, afagjate, po është po kaq e pritshme që ndryshimi i tyre i ngadaltë të përcillet me rezistencë dhe kundërshtime. Një rezistencë e tillë është më e theksuar te brezat e mesëm dhe të vjetër, të cilët nuk e kanë me dëshirë ndryshimin e modeleve dhe teknologjive komunikuese, duke përfshirë edhe komunikimin dhe metodologjinë e hulumtimit dhe të editimit akademik.

Në dijen shqiptare burimi kryesor i stereotipeve ishte letërsia, si më e konsumuara dhe më lehtë e këmbëyer e arteve. Letërsia, si model dhe agjens kognitiv, diktohej nga programet dhe përmbajtjet e konstruktive ideologjike, të cilat orientonin dhe sistemonin shumë kufizime dhe orientime skematizuese që nga shkolla fillore edhe deri te përcaktimi i temave të doktoratës. Të kujtohen vetëm bërthamat për planprogramet arsimore (tekste, posaçërisht histori dhe gjuhë shqipe) në vitet e 80-ta, apo ndalesat e tjera ideologjike dhe veprimet nga pozita etnocentrike serbe për arsim të kufizuar letërsie, imponim shkrimtarësh e kulturë serbe e sllave gjithnjë që nga vitet '20 - '90 të shek XX.

Ky fenomen kulturor tashti kërkon dekonstruimin e stereotipeve. Shqyrtimi dhe tematizimi kritik mund të ndihmojë për të ndërtuar modelin dinamik të komunikimit ndërkulturor, po edhe dituror në përgjithësi jo vetëm brenda shqiptarëve, por edhe në raport me kulturat tjera më pak frekuentuese.

Edhe kultura në Shqipëri kohë të gjatë është interpretuar përmes diskursit dominues ideologjik komunist, po kështu ngjashëm me përvojat e vendeve të Evropës Lindore. Kulturalisht kjo praktikë mbështetej në theksimin e ngjashmërive dhe të dallimeve, posaçërisht të ngjashmërive dhe dallimeve ideologjike dhe jo atyre estetike. Stereotipi kulturor në Shqipëri ka të kombinuar diskursin e identifikimit ideologjik dhe emocional-nacional njëkohësisht. Kultura kështu, përmes dy formateve të mëdha të stereotipeve, ishte shprehje e “dëshirave, interesave, frikës dhe ideologjisë”. Komunikimi i ngurtësuar, i ngërçit, i izolimit vetëm sa i ka forcuar stereotipet komunikuese, të cilat jetojnë ende gjerësisht në kulturën dhe kanë efektet e tyre negative edhe në komunikimet akademike.

Libri sot, për shembull, që është një strukturë dominante e komunikimit, në periudhën e medializimit individual dhe kolektiv ende nuk është vënë në faqet e teknologjisë-industrisë mediale. Kjo teknologji komunikuese ofron mundësi të ndryshme informacioni. Ky model libri elektronik bën të mos presë lexuesi që ai të dalë i tërë nga një shtëpi botuese për ta pasur mundësinë që ta lexojë. Libri jep oferta të shumta komunikimi dhe për të pasur një hapësirë më të gjerë rreth kësaj mundësie duhet përmendur format e ndryshme të qasjes, që i qasen lexuesit sot pikërisht përmes teknologjive komunikuese: Botimi i pjesshëm përpara se të dalë një vepër, botimi i pjesshëm mbas daljes së veprës, përkthimi, përpunimi për nevoja të tjera, si për radio, televizion, film, teatër-mikrokopie, pllaka, shirita manjetofoni-botime xhepi, botime të lira, reprinti, botime shkollore, huazimi i librit për

interesa komerciale dhe jokomerciale, antologjitë dhe botimet speciale, fotokopje, multimedia-interneti⁵. Janë këto shumë nga format që mundësohen nga teknologjitë moderne të komunikimit përmes të cilave libri mbërrin i pjeshëm apo i plotë, në formën e autoriale apo i përpunuar tek auditori i gjerë mediatik. Kjo gjerësi e shtrirjes teknologjike kishte frikësuar sociologët dhe kulturologët⁶ të shohin me shumë pesimizëm të ardhmen e burimit më të madh të dijes - librit. Madje mundësinë e përfundimit të librit nga presioni i proceseve të reja teknike-teknologjike e kishin paraqitur edhe disa nga teorikët më të njohur të komunikimeve në shek. XX, ndër të cilët edhe Marshall Mekluhan. Mu duke pasur parasysh gjithë potencialin që ofron kjo teknologji për librin dhe shtypin në tërësi, ai në vitet '60 të shekullit të kaluar prognozonte se „fundi i librit do të mbërrinte në vitin 1980“.⁷ Fatbardhësisht, kjo prognozë e tij nuk u realizua. Mbas vdekjes së Mekluhanit më 1980 edhe një qendër që ishte në Toronto për kulturë dhe teknologji me emrin e tij u shua, duke simbolizuar edhe shuarjen e prognozës sa të pazakonshme, po aq edhe të pakëndshme. Ndërkohë hulumtimet më të reja tregojnë se "Në përgjithësi ende e-books nuk po pranohen më shumë se sa librat e shtypura. Kështu, te ky grup intelektualësh, media, teknologjia komunikuese përgjithësisht, megjithëse vlerësohet si faktorë civilizues dhe kulturor, nuk i jepet statusi dituror tradicional që e kishte libri. Teknologjia komunikuese vlerësohet nga komunikologët të jetë teknologji e civilizimit, kurse kundërshtarët ngrenë zërin se është teknologji e dehumanizimit. Ndërsa më parë civilizimi njerëzor identifikohet shumë me librin, me shtrirjen e tij, me biblioteka dhe librari, civilizimi i sotëm nuk identifikohet gjithaq më me librin dhe informacionin klasik të shtypur, por me atë elektronik. Shkrimi është vetëm një segment i vogël i civilizimit, ndërsa komunikimi, format e shumta, audio dhe vizuele, janë totaliteti i civilizimit të sotëm botëror, pa mënjnauar shkrimin.

Ndryshimi, me gjithë këtë pasaktësi të Mekluhanit, është duke ndodhur, madje duke shkuar në një koncept të përafërt me teorinë e tij "globale". Tani vetëm në një CD të thjeshtë mund të përgatiten rreth 500 libra mesatar. Në dhjetë CD do të gjendet një bibliotekë solide. Tradicionalistët do të përgjigjen: bibliotekat nacionale u ngritën bashkë me krijimin e kombit, me industrializimin, kanë edhe referenca simbolike. Po, në fakt, edhe njeriu ka nevojë edhe për simbolika të

⁵ Unzeld, Zigfrid (1990), Autor i njegov izdavač, Jedinstvo, Prishtinë, f. 25.

⁶ McLuhan, Marshall (2004), Instrumentat e komunikimit, IK, Tiranë f.104-107.

⁷ Po aty f. 15.

tilla. Fjala vjen, letra e dikurshme postare kishte qëllimin e bartjes së ideve, emocioneve dhe shprehte seriozitet; letra e sotme mediale ka qëllim komunikimin dhe argëtimin, të shumtën, jo seriozitetin në thelb të vet. Media nuk prejjudikon kërkesën për kontrollim të sjelljes, libri është shumë më konservator dhe më tradicional. Të mos harrohet, media kultivon dhe ndërton qëndrime kolektive, veçmas kur nuk ekziston një rrjet policentrik, duke e kthyer kështu mesazhin themelor në ideologji ekstreme, nacionaliste, raciste etj.. Rreth librit të caktuar bëhet zhurmë, pa pasur mundësi reaksioni, por media nxit dhe krijon vetë zhurmë, e modelon vëllimin, përmbajtjen dhe gjerësinë e saj.

Libri elektronik sikur edhe ai i shtypit po sjell ndryshimin edhe të këmbimit të informacionit akademik. Për librin elektronik fillon të flitet për herë të parë më 1971, kur Michael Hart, student i Universitetit Illinois fillon të shpërndajë në rrjetin universitar libra të digjitalizuar. Kishte një shtrirje të kufizuar, në një rrjet lokal. E vërteta, libri i paraqitur në formë elektronike për rrjetin global është i një moshe të re dhe komunikologët kanë vërejtur se kjo ndodhi më 1987, kur u botua libri i parë kompjuterik i Majkëll Xhojsit "Mbrëmja". Brenda një çerek shekulli libri elektronik ka vërshuar web faqet, portalet, bibliotekat, libraritë, arkivat elektronike. Duket një garë e pafundme për të zënë pozitë të fuqishme nga sistemet e mëdha mediale dhe komunikuese në tregun e librit dhe të botimeve elektronike. Librat bestseller kanë filluar të ofrohen gjerësisht nga botuesit edhe në formë elektronike.⁸

Një hulumtim i bërë më 2008 nga Panairi i Librit në Frankfurt, anketë e realizuar me 840 ekspertë të fushës së librit, nxjerr përfundimin se në vitin 2018 shitja e librave të digjitalizuar, përkatësisht E-book, do të jetë më e madhe se sa shitja e librave të shtypur. Konservatorët edhe në këtë hulumtim, 27 për qind e tyre, nuk pajtohen se ndonjëherë shitja digjitale e librit do ta mund shitjen konvencionale, pra të librit të shtypur. Po çfarë paraqet nocioni E-book⁹ në kohët e sotme.

⁸ Yoffie, David B. (1997), *Competing in the age of digjitale convergence*, Harvard Business School Press, Boston pp. 1-37.

⁹ Nocioni E-Book (nga anglishtja "libër elektronik") është përkufizim identik me termin - Terminus, një përkufizim ky për librin e shtypur në letër, dhënë nga UNESCO: Libri është botim joperiodik me të paktën 49 faqe, duke përjashtuar faqet e kopertinës, botuar në një vend dhe duke ia paraqitur ato publikut. UNESCO (1965): *Recommendation concerning the International Standardization of Statistics Relating to Book Production and Periodicals* vom 19.11.1964. In:

Për të plotësuar informacionin lidhur me E-book do t'i referohemi edhe Shröder-t. Ai gjykon se E-Books janë "përmbajtje tekstesh të përhershme, të regjistruara ose të ruajtura në mënyrë elektronike, deponimi i të cilëve perceptohet vetëm vizuelisht nga marrësi"¹⁰.

Puna fillestare për një projekt të madh digjitalizues nis me Projektet Gutenberg¹¹ Google Books dhe Open Content Alliance synojnë të bëjnë digjitalizimin e miliona titujve të librit dhe të dorëshkrimeve, duke sfiduar kështu bibliotekën si një objekt dhe institucion konvencional libri dhe dorëshkrimi. Amazon në SHBA tashmë ka pushtuar tregun me librat elektronikë dhe të pajisjes përkatëse të leximit Kindle. Që nga fundi i vitit 2010 shitësit e platformave on-line kanë shitur më shumë libra digjitale se libra të shtypur. Në kompaninë gjermane "Kindle-Shop" mund të blihen mbi 750.000 E-Books, duke përfshirë këtu më shumë se 35.000 tituj gjermanë. *Capital Economic Journal* ka parashikuar se numri vjetor i kopjeve të shitura prej dy milionëve (referuar viti 2010) do të rritet në mbi 33 milion në vitin 2014.

Në këtë hapësirë ndërkulturore, globale më mirë thënë të zhvillimit dhe këmbimit të dijes, përmes librit elektronik janë përfshirë sisteme të mëdha korporative dhe partnere si: Smithsonian Institution, Hewlett-Packard, Yahoo dhe Microsoft's MSN. Për masën e shtrirjes së librit elektronik e dëshmojnë edhe hulumtimet e bëra. Një anketë e grupit "PE" më 2009 tregon: "37% e të gjithë librave të rinj janë në dispozicion si e-book. Pionierët janë botuesit e librave në fushën e shkencës dhe arsimit, ku 51% e botimeve të reja janë në format e-book"¹² Autorët zbulojnë mundësitë e tyre në tregun e librit elektronik. Platforma të veçanta sigurojnë mundësinë në një audiencë të madhe në një kohë shumë të shkurtër, gjë që ka qenë gjithmonë shumë e vështirë për librin e shtypur. Portali "grin.de" boton prej vitin 1998 tezat bachelor, master dhe doktoratura.¹³ Interkomunikimi është dinamizuar edhe përmes bartjes më të lehtë të dijeve dhe vlerave

Records of the General Conference. Thirteenth Session. Resolutions. Paris: United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization, S. 144.

¹⁰ Shih Schröder, Andreas (2006): e-Books und Bücher. Empirische Untersuchung zum Leseverhalten. Überarbeitete Version von 2006. Saarbrücken: (2006), 12 Ebd. Kapitel 2.1.1.

¹¹ Në vitin 1971 ka nisur në gjuhën angleze "Projekti Gutenberg".

¹² Shih Börsenblatt (2009): E-Books: Umsatzzeerge mit Wachstums-potenzial. Umfrage des Arbeitskreises Elektronisches Publizieren online. (Frankfurt am Main ,deutschland): 14.10.2009. URL: <http://www.boersenblatt.net/>

¹³ Shih. Janello, Christoph (2010): Wertschöpfung im digitalisierten, p. 65.

kulturore në tërësi në formën e shërbimeve të shpejta, madje “duke përfshirë stafin e specializuar për të zgjedhur, strukturuar, interpretuar, shpërndarë etj. arkitekturën, përmbajtjen, teknologjitë, përdoruesit vijojnë të ripërcaktohen nëpërmjet konferencave, seminareve shkencore ose shkrimeve të studiuesve”.¹⁴

Një nga çështjet që del problematike është rregullimi i të drejtës së autorit për veprat, të cilat janë tituj të rrallë dhe pronë e bibliotekave. Po i referohemi modelit amerikan lidhur me këtë pasuri kulturore nacionale. E drejta e autorit sipas ligjit amerikan mbi të drejtat e autorit është se veprat artistike tashmë janë edhe pronë publike.

"Mirëpo kjo nuk është gjithmonë kështu. Ndonëse bibliotekat po digjitalizohen, dokumentat digjitale mbeten të padisponueshme, pasi autorët apo trashëgimtarët e tyre kanë të drejtat mbi veprat dhe nuk duan që ato të shpërndahen në mënyrë digjitale."¹⁵

Tashmë ka disa procese gjyqësore ndaj sistemeve të mëdha digjitalizuese, që drejtojnë gishtin nga ato për shkelje të të drejtës së autorit. Open Library, në një projekt joprogfitabil do të bëjë digjitalizimin e 18000 librave në Universitetin e Kalifornisë, por që më parë nuk ka siguruar të drejtën e autorit. Kështu, trendi sifidues i teknologjisë moderne komunikuese ka përpara një prag etik që duhet zgjidhur me mirëkuptim të palëve, bibliotekave, botuesve, autorëve dhe sistemeve të mëdha digjitalizuese.

Edhe në gjuhën shqipe ka filluar procesi i digjitalizimit nga institucionet dhe fondacionet, por ende pa arritur të hyjë fuqishëm në tregun e dijes globale. Vetë shtrirja dhe cilësia e shfrytëzimit të komunikimeve në internet është e diskutueshme, mbasi hulumtimet e bëra në Kosovë dëshmojnë për prirjet më të mëdha të shfrytëzuesve në biseda dhe këmbime joditurore, joakademike. Madje *Internet Usage in the European* e vë Kosovën në një shkallë të ulët të shfrytëzimit të internetit. Statistikat e publikuara nga IUE flasin se në vitin 2012 në Kosovë e shfrytëzojnë internetin 377 mijë veta ose 20,5 për qind e popullsisë. Kjo duket një përqindje joreale, mbasi hulumtimet e bëra nga institucione tjera e vënë Kosovën me përqindje të lartë shfrytëzimi.¹⁶ Mbas vitit 1999 Kosova parvjet ka pasur shtim të qasjes

¹⁴ Domi, Etleva, Bioletra, BKUK, Prishtinë.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Internet World States,. Shoqata e Kosovës për Informacionin dhe Teknologjinë e Komunikimit (STIKK) vë në dukje se depërtimi i internetit është 72.1%, që do të thotë gati dy të tretat e popullsisë kanë akses në rrjetin global të kompjuterëve, Southeast European Times në Prishtinë -- 16/05/12,(setimes.com)

në internetit. Sipas ART-së, penetrimi i shërbimeve të internetit për vitin 2009 ka qenë mbi 121 lidhje apo 7.05 për qind për kokë banori.¹⁷ Në anën tjetër, penetrimi i shërbimeve të internetit për shtëpi ka qenë 35 për qind në vitin 2009, ndërsa në periudhën gusht 2008 penetrimi i këtyre shërbimeve ka qenë rreth 21.6 për qind. Për një shtrirje solide të rrjetit të internetit në Kosovë dëshmon edhe e dhëna e PTK-së. Posta dhe Telekom i Kosovës (PTK) dhe kompania telekomunikuese IPKO tani kanë mbi 400 mijë lidhje të internetit në vend dhe përdorimi i tij është rritur për 6 për qind krahasuar me një vit më parë.¹⁸ Në Kosovë në vitin 2013 ishin mbi 850 mijë përdorues të internetit, që paraqesin rreth 45 për qind të popullsisë. Shtrirja e internetit na bën ta kuptojmë potencialin e përcimit të mesazhit on-line.¹⁹

Shqipëria me 1.471.400 shfrytëzues të internetit, me një pjesëmarrje prej 49 për qind është ndër vendet e fundit në Evropë. Numri i përdoruesve nuk flet për cilësinë dhe përmbajtjet e konsumuara, mbasi institucionet kryesore të dijes, shkencës dhe artit ende janë të vonuara në procesin e digjitalizimit. Kështu, ASHAK-u ende nuk e ka të digjitalizuar fondin e botimeve të veta, ndërkohë që Biblioteka Kombëtare e Kosovës ka filluar si fazë e parë, me formatizimin e informacioneve elektronike të fondit. Në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë njëri ndër projektet e para ishte digjitalizimi i informacionit të skedarit manual të vlerave të rralla (dorëshkrime dhe antikuarë), duke mundësuar kështu kërkimin edhe në distancë të katalogëve të digjituara; E-ALBANICA, që përfaqëson Bibliotekën Digjitale Albanologjike me përmbajtje të veprave të rralla të Bibliotekës Kombëtare (dorëshkrime, antikuarë, harta dhe periodikë të shekujve XV-XIX në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera). E-books shqip pritet të jetë në tregun me ofertë ndërkulturore me digjitalizimin e sistemeve komunikuese në institucionet arsimore, shkencore dhe kulturore.

Jashtë këtij tregu vlerësimi për cilësinë e studimeve dhe të mësimdhënies do të jetë i ulët. Rangimi i agjencisë Ranking²⁰ lidhur me cilësinë e universiteteve në vitin 2013 e vendos Universitetin e Prishtinës në numrin rendor 4416, ndërsa një vit më parë është radhitur i 3387-ti për nga cilësia. Madje ende më poshtë e radhitë

¹⁷ www.art-ks.org/

¹⁸ www.telegrafi.com/ekonomi/kosova-lidere-ne-perdorimin-e-internetit-ne-ballkan-3.02.2010

¹⁹ Po aty, 25.03.2013.

²⁰ Ranking Web of World Universities (Web renditja e universiteteve botërore). Kjo është iniciativë e matjeve kibernetike dhe e hulumtimit të Qendrës së Shkencave Humane e Sociale (CCHS), si pjesë e Këshillit Kombëtar të Kërkimit (CSIC). Është trupa më e madhe publike e kërkimit në Spanjë.

Universitetin e Tiranës, në numrin rendor 8012. Për të pasur parasysh se sa e ulët është vlerësuar cilësia akademike, do marrë shembull universitetet në rajon. Universiteti i Beogradit është i radhitur në vendin 729, ndërsa ai i Lubjanës në vendin 241.

Modernizimi i shërbimeve akademike dhe i kulturës përmes teknologjive të reja është mundësia më e mirë e komunikimit edhe brenda shqiptarëve e edhe me botën. Sot ka fare pak informata për kulturën shqiptare dhe shtrirja e këtyre informatave në sisteme teknologjike rajonale dhe globale krijon shanse të vlerësimit më të drejtë nga bota përmes vlerave kulturore. Digjitalizimi i pasurisë diturore dhe vlerave kulturore nëpërmjet një projekti afatgjatë, duke pasur si synim edhe tregun kulturor dhe industrinë kulturore, e thyen mbylljen që duket si një pengesë ende aktive për të qenë pjesë aktive e tregut të dijes dhe të punës.

Konsumuesit e vlerave kulturore dhe diturore shqiptare sot nuk gjenden vetëm në hapësirat etnike shqiptare, po shumë më gjerë. Në botë jetojnë dhe punojnë shumë shqiptarë, andaj do të ishte e nevojshme ofrimi i këtyre vlerave nëpërmjet digjitalizimit edhe për këtë grup të madh, një pjesë e të cilëve janë të lidhur drejtpërdrejt me studimet dhe procesin akademik. Krijimi i platformave digjitale, të cilat do të shërbenin si plato, efektizon ofertën për të gjitha informacionet dhe thesarin e shkapërderdhur dituror dhe kulturor.

Në portale do të mund të sistemoheshin të dhënat nga fusha të ndryshme të dijes dhe kulturës. Portalet do të ofronin mundësinë që shfrytëzuesit të kenë edhe linqe e forume apo t'i përcjellin debatet e hapura për temat me rëndësi për dijen dhe kulturën tonë. Këto portale mund të kenë linqe ku do të shpreheshin mendimet e dijetarëve, studiuesve dhe të interesuarve të tjerë, po ku edhe ekspertët do të merrnin pjesë duke sajuar materiale të ndryshme lidhur me vlerat e kulturës sonë.

Deri më tani janë shfrytëzuar fare pak fondet nga BE-ja, të cilat përmes projekteve do të ndihmonin për të qenë edhe studentët, profesorët dhe institucionet akademike pjesë e tregut konkurrues ndërkombëtar. Po kështu institucionet shqiptare, duke pasur parasysh gjuhën që përdoret në Kosovë, në Shqipëri, në Maqedoni etj., do të mund të krijonin platformë të përbashkët inauguruese-promovuese në fushën e studimeve dhe promovimeve të rezultateve shkencore. Ndër projektet e munguara është edhe mosrealizimi i databazës në gjuhë të huaja, posaçërisht në gjuhën angleze, e cila do të plasonte informacionet themelore për veprat dhe autoritet shkencore, institucionet dhe po kështu edhe do t'i promovonte rezultatet në fusha

të ndryshme, duke hapur mundësi për realizimin e projekteve të përbashkëta edhe me institucione të ngjashme kudo në botë.

Thjesht, hapësira kibernetike është tani fushëbetejë e informatave, e vlerave dhe e promovimit të risive akademike. Dilema: Çfarë do të ndodhë me dijen, format e ofrimit të saj, klasike-tradicionale me librin e shtypur, ndikuar nga shtrirja e shpejtë e digjitalizimit? A mund të shmanget letra me shkronjat e mrekullueshme dhe ato shkronja të gjenden vetëm në ekranet e kompjuterëve? A do të kemi në një të ardhme të afërt në shtëpi, në një hapësirë fare të vogël, bibliotekë me qindra mijë libra, pjesën e madhe të të cilëve kurrë nuk do të mbërrijmë t'i shfletojmë? Të gjitha këto janë të pritura të ndodhin. Po njëherësh edhe lufta e lexuesit tradicional në letër, me një format prestigji dhe përkushtimi kultural e antropologjik do të provojë të shënojë fitoren e radhës, si një fitore e një qytetërimi historik që sfidon të ardhmen. Tradicionalja nuk do të zhduket, por modernja do të dominojë. Libri i shtypur gjithsesi do të jetojë, por ai i digjitalizuar-elektronik pritet të sundojë në hapësirën kulturore globale.

Kompleksiviteti i temës, fjalës dhe shkrimit në këtë kontekst, i raportit të librit edhe në gjuhën shqipe me median, sa kalon koha bëhet edhe më shumë kompleks. Problemi metodologjik nuk mund të shmanget, se referenca e medias i dedikohet edhe librit e dhe bibliotekës nga teoricienë të shumtë, sociologë, komunikologë dhe letrarë. Pavarësisht problemeve, kulturat nacionale në kuadër të arkivave, bibliotekave, librarive, qendrave studimore etj., nuk do të mund të mbeten gjatë jashtë qasjes së informatës dhe dijes në një shkallë globale.

Miliarda njerëz jetojnë vetëm duke konsumuar përmbajtje diturore përmes teknologjive digjitale, ky është një fakt i madh, po miliarda njerëz konsumojnë njëkohësisht edhe librin e edhe përmbajtjet mediale. Gjenden fare pak, që në jetën e tyre udhëtojnë vetëm me librin, pa mediat apo pa të dyja bashkë. Biblioteka dhe libri konsiderohen vlera tradicionale-konservatore, kulturore dhe civilizuese, po njëherësh shumë moderne edhe në ditët e sotme. Media e ka një kuptim civilizues dhe kulturor, por jo edhe aq tradicional-konservator. Teknologjia komunikuese diturore vlerësohet nga komunikologët të jetë teknologji e civilizimit, kurse kundërshtarët ngrenë zërin se është teknologji e dehumanizimit. Ndërsa më parë civilizimi njerëzor identifikohet shumë me librin, me shtrirjen e tij, me biblioteka dhe librari, civilizimi i sotëm nuk identifikohet gjithaq më me librin, por me median, komunikimin. Shkrimi është vetëm një segment i vogël i civilizimit, ndërsa komunikimi është totaliteti i civilizimit të sotëm.

Summary

The models of knowledge communication have gone through changes in Kosova as well, though with a considerably slower pace compared to the more developed societies. The extension of the communication technologies, which is close to the average standard of the South-eastern Europe, does not provide a high quality of communications. The time spent in the media technology, internet, and especially news portals and social networks, does not suffice to have proper research and communication of knowledge compared to the time spent in informal conversations and communications. One of the reasons for this should be sought in the verbal and not literal model of communication, which prevails in the tradition of the Albanian society.

Digitalization of knowledge and robust systems of digitalization of books and information for the Kosova society is still scarce, with the exception of academic institutions. The academic institutions have managed to digitalize a symbolic amount of their publications; however, they have not yet succeeded in becoming part of the global market of knowledge. One of the problems in the process of being part of the digitalized system of books and scientific research is linked to the ethical dilemma, namely, related mainly to the copyright issue.

Many rare books and manuscripts are being kept at the National Library of Kosova, the institution with the largest collection of publications and manuscripts, but the digital transmission of these values requires establishing the norm of knowledge communication. The national culture values arranged in archives, libraries, bookshops, study centres, and so on, require proper access to information and know-how at the global level, but also a long-term national strategy.

Literatura:

- Agar, Michael (2002), *Language shock*, New York.
- Baylon, Christian & Mignot, Xavier (2004), *Komunikimi, LogosA, Shkup*.
- Berisha, Ibrahim (2007), *Media, agjensët e komunikimeve*, AAB, Prishtinë.
- Berisha, Ibrahim (2007), *Media dhe tranzicioni*, AAB, Prishtinë.
- Boef, M. Le (1991), *Imagination, Inspiration, Innovation*, MVG.
- Day, Luis Alvin (1999), *Ethics in Media Communications and Controversis*, e—book, fefth edition, <http://www.amazon.com/>
- Doris A. Graber (2002), *Mass Media & American Politics*, COPRESS, Washington, D.C.
- Gocinni, Govani (2001), *Istorijs novinarstva*, Clio, Beograd.
- Deuze, Mark (2001), *Educating, New Journalists: challenges to the curriculum*, Journalism Educator.
- Hall, Stuart (2003), *Representation; Cultural Representations and Signifying Practice*, London.
- Heng J., Hula R. (1999), *The Color of School Reform*, PU, New Jersey.
- Jakubowicz, Karol (2001), *Media in Transition*, London, Routledge.

McLuhan, Marshall (2004), Instrumentat e komunikimit, IK, Tiranë.

Karlsrajter, Ana, (2003), Mediat në shoqëritë shumëgjuhësore, OSBE, Vjenë.

Stagliano, Riccardo (2004), Të merresh me informacion në kohën e internetit, ISHM, Tiranë.

Yoffie, David B. (1997), Competing in the age of digjital convergence, Boston.

Doc. Ligji nr. 04/L-065, Prishtinë, Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Web.faqe:

www.boersenblatt.net

www.art-ks.org

www.telegrafi.com

www.coe.int

www.aipce.net

<http://www.amazon.com>

Zenun HALILI

LIBERALIZIMI POLITIK DHE DEMOKRATIZIMI NË SHTETET ARABE

KDU 327 (53)

Abstrakt

Shtetet arabe kanë një shumëllojshmëri të sistemeve politike, secili duke pasqyruar të kaluarën e vet historike, përvojën koloniale, gjendjen ekonomike e sociale, dallimet religjioze dhe presionet e popullsisë për ndryshime. Në rajonin e Lindjes së Mesme, regjimet e personalizuar autoritare kanë bashkëjetuar me regjimet marksiste, me monarkitë dhe me regjimet demokratike. Shpjegimet sociokulturore të performancës politike dhe të demokratizimit, të cilat sugjerojnë se traditat kulturore dhe një sërë faktorësh të tjerë shoqërorë formësojnë zhvillimin politik dhe modernizimin e një shoqërie, më shumë se kudo tjetër, kanë kuptim në vendet e botës arabe.

Kultura politike në shumicën e shteteve arabe e dominuar nga komponentë të caktuar ku hyjnë kulti i personalitetit, demagogjia, manipulimi dhe mosbesimi është në kundërshtim të plotë me parimet bazë të sistemeve demokratike. Pasojë e kësaj gjendjeje është kriza e thellë në sistemet qëverisëse të shteteve arabe, e cila manifestohet me mungesën e plotë të llogaridhënies së klasës politike në pushtet. Kjo ka bërë që arti i kompromisit politik, pa të cilin nuk mund të paramendohet funksionimi i një sistemi demokratik, të neglizhohet në terësi dhe që metodat e detyrimit dhe të represionit të luajnë rol esencial në mbajtjen e pushtetit.

Fjalët çelës: demokratizimi, liberalizimi, sistemet e qeverisjes, autoritarizmi, neglizhenca politike, mungesa e kompromisit politik, modernizimi, industrializimi, urbanizimi, sekularizimi.

Hyrje

Vendet arabe kanë hyrë në shekullin XXI me probleme të shumta të shkaktuara nga paqartësitë politike, nga pabarazia ekonomike, nga trazirat sociale dhe nga jokoherenca psikologjike. Kohëve të fundit pak rajone të botës kanë qenë dëshmitare të trazirave dhe ndryshimeve të shpejta siç kanë qenë vendet e Botës Arabe.¹ Edhe tradita e tyre historike ka qenë pothuajse e njëjtë. Para Luftës së Parë Botërore

¹ Ne i definojmë si vende të botës arabe këto shtete: Algjerinë, Arabinë Saudite, Bahreinin, Egjiptin, Emiratet e Bashkuara Arabe, Irakun, Jemenin, Jordaninë, Kuvajtin, Libinë, Libanin, Marokun, Katarin, Omanin, Sirinë, Tunizinë dhe Territorët e Palestinës.

shumica e tyre stagnuan dhe u gërmitën nën sundimin e turqve otomanë. Pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane, ato i panë vizionet e pavarësisë dhe rastin për t'i flakur gjurmët e dominimit të huaj.

Aso kohe filloi edhe paraqitja e lëvizjeve nacionaliste, të cilat me veprimet e tyre energjike i nxitën qeveritë. Në shumë raste ato e fituan kontrollin e qeverive në kundërshtim me autoritetet fetare në vendet e tyre. Pastaj ato vazhduan me përpjekjet për të nisur programet e modernizimit, duke ndërtuar autostrada, hekurudha dhe shkolla, duke subvencionuar industrinë, duke sponzoruar programe të ndryshme shkollore në fushën e bujqësisë dhe në reformën e tokës. Por problemet me të cilat u ndeshën ato, si injorimi, korrupsioni, interesat vetjake dhe ndërhyrjet e huaja shpeshherë ishin shumë të vështira për t'u tejkaluar.

Çështjet e pazgjidhura të identitetit, të autenticitetit dhe të legjitimitetit vazhdojnë t'i konfrontojnë popujt e atyre vendeve. Derisa demokratizimi po lëshon rrënjë në pjesën më të madhe të botës, shumica e burrshtetasve të vendeve arabe ende po i rezistojnë reformimit të sistemeve të tyre politike, duke e mbajtur pushtetin nëpërmjet metodave të detyrimit, kooptimit dhe të represionit. Edhe sot e kësaj dite analfabetizmi, sëmundjet e ndryshme dhe shkalla e lartë e vdekshmërisë vazhdojnë të jenë të pranishme në përmasa të mëdha në shumicën e vendeve të atij regjioni.

Ndryshimet politike dhe modernizimi

Në botën e sotme të transformimeve të shpejta dhe të modernizimit, shtetet arabe përballen me probleme të shumta politike dhe me një situatë të paqartë ekonomike e sociale. Problemi kryesor qëndron në rivalitetin ndërmjet forcave reformuese dhe një pjese tradicionale e cila insiston në ruajtjen e së kaluarës. Çka është modernizimi? Modernizimi është një proces shumëdimensional i cili kërkon ndryshime në të gjitha fushat e mendimit njerëzor.

Aspektet kryesore të modernizimit janë: Industrializimi, urbanizimi, sekularizimi, demokratizimi, edukimi etj. Në nivelin psikologjik, modernizimi përfshin ndryshimet fundamentale në vlera, në sjellje dhe në pritjet e njeriut.² Përpos tjerash, modernizimi është një proces me anë të të cilit njerëzit e një vendi apo regjioni

² Samuel P. Huntington: Political order in Changing Societies, Yale University Press, 1968, f. 32.

përmirësojnë kushtet e jetës duke marrë në duartë e veta fatin e tyre dhe të ambientit ku ata jetojnë. Në epokën e modernizimit është e rëndësishme ngritja profesionale dhe punësimi të bëhet në bazë të meritës.

Popujt çdo ditë përballen me zhvillimet e shpejta teknologjike në fushat e industrisë, ekonomisë dhe politikës. Si proces modernizimi çdoherë ka ekzistuar në shoqëri dhe si i tillë është i pandalshëm, por shpeshherë ai paraqet problem për t'u adaptuar në shoqëri të ndryshme. Kjo ndoshta më së shumti vlen për vendet e botës arabe të cilat nga pikëpamja kulturore ndryshojnë dukshëm nga demokracitë perëndimore. Si rezultat i këtij dallimi kulturor, te vendet arabe modernizimi politik shpesh shihet edhe si vesternizim, adoptim i kulturës perëndimore.³

Elitat politike shpeshherë e promovojnë procesin e modernizimit brenda shteteve të tyre me qëllim që të rrisin fuqinë dhe autoritetin politik. Për të bërë këtë, liderët politikë orvaten të përmirësojnë gjendjen në sfera të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me mirëqenien e shoqërisë, si përparimet në shëndetësi, në shkollim etj. Pasi të ketë filluar modernizimi, ai shndërrohet në një proces të pandalshëm dhe shpeshherë lidershipi politik që e ka iniciuar nuk mund ta kontrollojë atë. Si i tillë procesi i modernizimit transformohet në një proces problematik, sepse në disa raste është me i shpejtë se zhvillimi politik. Kjo zbrazëti ndërmjet modernizimit dhe zhvillimit politik ngadalë shndërrohet në faktor destabiliteti për këto shoqëri.

Një numër i konsiderueshëm autorësh e kanë definuar modernizimin politik në mënyra të ndryshme. Por shumica e këtyre autorëve fokusohen më tepër në karakteristikat dalluese ndërmjet politikave moderne dhe politikave tradicionale. Sipas Huntingtonit, aspektet kryesore të modernizimit politik mund të përmbliken në tri grupe:

E para, modernizimi politik përfshin racionalizimin për autoritetin, zëvendësimin e një numri të madh autoritetesh tradicionale, religjioze, familjare dhe etnike me një autoritet të vetëm politik dhe sekular. Me anë të këtij ndryshimi nënkuptohet se qeveria është produkt i njeriut e jo produkt i natyrës apo i krijuesit dhe se shoqëria e organizuar mirë duhet të ketë një burim human nëpërmjet të të cilit determinohet autoriteti final. E dyta, modernizimi politik

³ Samuel P. Huntington: The Clash of Civilization and Remaking of World Order. Published in Great Britain, by The Free Press, 2002, f.73.

përfshin dallimet ndërmjet funksioneve të reja politike dhe zhvillimin e strukturave speciale për ushtrimin e këtyre funksioneve. E treta, modernizimi politik përfshin rritjen e pjesëmarrjes politike nga ana e grupeve të ndryshme sociale brenda shoqërisë.

Pjesëmarrja e gjerë politike mund të ndikoj në rritjen e kontrollit të qytetarëve nga shteti, ashtu siç ndodhë në shtetet totalitare, ose mund të ndikojë në rritjen e kontrollit të shtetit nga ana e qytetarëve, ashtu siç ndodh në shumicën e shteteve demokratike të botës

Në shtetet arabe dhe në tërë regionin e Lindjes së Mesme, procesi i modernizimit është më i avancuar se zhvillimi politik dhe demokratizimi. Elitat e atjeshme politike, duke sponsoruar zhvillimet në fushën e edukimit kanë krijuar në mënyrë indirekte një klasë të mesme profesionale nga e cila vjen kërkesa për reforma të sistemit politik. Por duhet theksuar se edhe përkundër kësaj, në disa vende të botës arabe ende ekzistojnë sisteme politike të paprekshme të cilat nuk i dëshirojnë ndryshimet.⁴

Kërkesa kryesore e zhvillimit politik në një shoqëri demokratike është kërkesa për pjesëmarrje politike, e cila do të thotë që qytetarët të kenë një zë më efektiv në procesin e vendimmarrjes politike. Në përgjithësi, kur flasin për zhvillimin politik dhe demokratizimin studiuesit politikë argumentojnë se participimi nënkupton politikën zgjedhore që rezulton me ndërtimin e institucioneve të qeverisjes, siç janë legjislaturat, qeveritë etj. Mirëpo përvoja dhe realiteti në vendet arabe ka një ndryshim në këtë pikë. Në ato vende zgjedhjet nuk janë evidencë reale e zhvillimit politik. Shpeshherë dalja në votime atje është vetëm një çështje kozmetike, që u shërben më tepër elitave dhe nuk paraqet orvatje të sinqertë për ndërtimin e demokracisë. Sipas fjalëve të një vëzhguesi, politikën e atjeshme zgjedhore mund të prodhojnë “demokraci joliberal”,⁵ sepse në ato vende mund të ekzistojë praktika demokratike, por ka një mungesë të plotë të kontrollit të pushtetit.

Në shtetet arabe si Egjipti, Jordania dhe Kuvajti zgjedhjet kanë dështuar në ndërtimin e sistemeve demokratike dhe në promovimin e participimit politik. Në Algjeri, kur zgjedhjet nuk dhanë rezultatet e dëshiruara nga klasa politike, ato u anuluan dhe ky akt çoi deri në

⁴ Vicky Randall and Robin Theobald: *Political Change and Underdevelopment*, Duke University Press, 1998, f. 40.

⁵ Fareed Zakaria: *The Rise of Illiberal Democracy*, 76 *Foreign Affairs* (November-December, 1997), f. 22-43.

luftën e përgjakshme civile. Në anën tjetër, në vendet ku ekzistojnë regjime të monarkive tradicionale dhe teknokracive të dhunshme as që mund të flitet për zgjedhjet, madje as për ato kozmetike. Në shtetet si Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe thjesht nuk ka politika konkurruese.

Në mesin e shteteve arabe Egjipti konsiderohej lider i zhvillimit politik, por në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar edhe atje u forcua pushteti autoritar. Qeveria e presidentit Mubarak ishte shndërruar në një qeveri autokratike, që sakrifikonte të drejtat njerëzore për të mbajtur pushtetin. Regjimet represive në Irak (gjatë sundimit të Sadam Hysenit), në Siri dhe në Libi (gjatë regjimit të Gadafit) ishin rekorde sa i përket fushës së zhvillimit politik. Liderët politikë, si Sadami e Gadafi (para rrëzimit të tyre) e mbanin gjithë pushtetin në duartë e tyre.

Një çështje shumë e rëndësishme në politikën e pushtetit dhe të ndryshimeve në vendet arabe është edhe çështja e lidershipit politik. Edhe pse shtetet arabe brenda tyre kanë grupe dhe klasa të ndryshme shoqërore të ndërlidhura me njëra-tjetrën, gjithmonë ekziston një grup i individëve që ka fuqi dhe ndikim më të madh politik sesa të tjerët. Liderët politikë të Lindjes së Mesme ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga vendi në vend. Ai regjion njihet si kështjella e fundit e monarkive absolute në botë.

Në shtetet e zhvilluara industriale, lidershipi politik e përfiton legjitimitetin për të udhëhequr në bazë të zhvillimit ekonomik të vendit dhe të stabilitetit politik, kurse liderët politikë të vendeve arabe dallojnë në këtë drejtim. Liderët e atjeshëm politikë shquhen për paraqitje me përmbajtje ideologjike të cilat përcjellin imazhe nacionaliste dhe religjioze.⁶ E gjithë kjo bëhet me qëllim që klasa politike që e udhëheq popullin t'i forcojë pozitat e veta dhe në një mënyrë apo tjetrën të legjitimojë qëndrimin e tyre në pushtet. Mund të thuhet lirisht se ai lloj prezantimi, ku paraqiten elemente ideologjike, nacionaliste religjioze nuk shfaq dëshirën dhe përpjekjet e klasës politike për të përmirësuar kushtet e jetës së qytetarëve.

Duke qenë të tilla, prezantimet ideologjike në një shoqëri transformohen në faktorë destabiliteti. Për shembull, popullata kurde që jeton në Irak, Iran, Siri dhe Turqi është viktimë e vazhdueshme e fushatave të tilla. Por duhet theksuar se edhe liderët e disa vendeve

⁶ Michael C. Hudson, Arab Politics: The search for Legitimacy (New Haven: Yale University Press, 1977, f. 20.

arabe përballen me probleme të shumta në përpjekjet për të fituar legjitimitetin e udhëheqjes së tyre mbi grupe të ndryshme etnike. Këto probleme janë më të theksuara në shtetet si: Siria, Libani, Bahreini dhe Iraku (gjatë qeverisjes së Sadam Hysenit), shtete këto në të cilat minoriteti religjioz e kontrollon qeverinë. Me anë të ideologjisë bathiste qeveritë e Sirisë dhe të Irakut (para luftës së fundit) legjitimonin pushtetin e tyre, ku në qendër të organizimit kishin vendosur nacionalizmin arab, që promovonte bashkimin e popujve arabë.⁷

Trashëgimia politike

Sistemi trashëgimor është ai sistem në të cilin një strukturë administrative e identifikuar zhvillohet dhe zgjerohet në një shoqëri apo perandori të caktuar. Detyrat e qeverisë bëhen më të specializuara dhe me komplekse. Si rezultat, raporti “qeverisës - të qeverisur” tenton të filtrohet nga një rrjet i tërë burokratësh. Pra, burokratët janë ata që bëjnë transmetimin e direktivave të qeverisësve te të qeverisurit. Në shumicën e shoqërive islamike modelet trashëguese të lidërshpit janë dominante. Në botën islamike, ku religjioni dhe politika janë dy fenomene të pandara, shahët, sulltanët dhe sheikët tentojnë të qeverisin në mënyrë patriarkale dhe trashëgimore. Qeveria është personale. Dy burokracitë, ato civile dhe ushtarake, janë pak a shumë struktura të zgjeruara nga lideri.

Në sistemin trashëgimor të lidërshpit të vendeve arabe, lideri është burim ekskluziv i të gjitha ideve dhe strategjive të rëndësishme. Politikat dhe programet burojnë nga ai. Idetë dhe sugjerimet e reja, për të cilat mendohet se do të jenë të suksesshme, duhet patjetër t’i dorëzohen liderit në mënyrë që ai t’i paraqes ato si të vetat. Historikisht peizazhi politik i vendeve arabe është i stërm bushur me individë, kundërshtarë të liderëve, që tentuan të paraqiten si kreatorë të ideve dhe politikave të ndryshme. Këta, natyrisht, dështuan në këtë drejtim, sepse idetë dhe politikat efektive ishin të monopolizuara nga ana e liderëve. Shtete arabe janë qeverisur nga sistemet trashëgimore autoritare gjatë tërë historisë së tyre. Islamizmi e ndihmoi sistemin trashëgimor të qeverisjes edhe përmes idealeve e edhe përmes realitetit.

⁷ Amatzia Baram, “ Territorial Nationalism in the Arab World “ Middle East Studies 26 (October 1990), f.425-448.

Në tërë kornizën filozofike që evoluoi me islamizmin janë të theksuara raportet e zanafillës: “krijues i krijuar”. Islamizmi kërkon nga të gjithë besimtarët që të pranojnë Zotin si krijues të gjithëfuqishëm. Muhamedi është prototip i liderit, ai përfaqëson pasivitetin e përkryer para Zotit dhe aktivitetin e përsosur para njeriut. Ndërlidhja e religjionit me politikën nënkupton që liderët e ndryshëm politikë e kanë pasur mundësinë që ta prezantojnë veten si të lidhur drejtpërdrejt me Zotin.

Duke e konsideruar profetin Muhamed emisar special të Zotit, shumica e liderëve politikë të botës islame janë munduar që të tregojnë se paraardhësit e familjeve të tyre kanë lidhje të ngushtë me Muhamedin.⁸ Kjo ndodh për arsye se aristokratë dhe liderë të natyrshëm në civilizimin islamik konsiderohen vetëm ata individë të bashkësisë që kanë lidhje me profetin Muhamed. Sistemi trashëgimor i qeverisjes është në veçanti i preferuar nga sekti fetar shiit.

Mungesa e institucioneve të mirëfillta vetëqeverisëse

Në vendet e botës arabe shteti është gjithçka, çdo gjë është e monopolizuar rreth shtetit, ndërsa shoqëria në përgjithësi nuk është aq e rëndësishme. Një numër i shteteve arabe nuk kanë legjislatura shtetërore. Liderët politikë që kanë qenë të interesuar për modernizimin e vendeve të tyre nuk kanë shprehur interes për zgjerimin e pjesëmarrjes politike, sepse shoqëritë të cilat ata donin t'i modernizojnë dominoheshin nga elemente tradicionale, të cilëve po t'u lejohej pjesëmarrja në procesin politik do të ktheheshin në kundërshtarë të procesit të modernizimit. Për t'i dominuar forcat e tilla tradicionale dhe për t'u mbrojtur nga kërcënimet e shteteve të jashtme pushtetarët e vendeve arabe promovuan zhvillimin e shpejt burokratik e ushtarak të shteteve të tyre.

Një faktor tjetër që ka ndikuar në mospraninë e institucioneve të vetëqeverisjes në shtetet arabe ka qenë edhe prania e forcave kolonialiste në regjionin e Lindjes së Mesme, të cilat pengonin zgjerimin e vetëdijes politike të popujve të okupuar. Për të penguar zhvillimet politike të rajonit, forcat britanike dhe franceze kanë ndërhyrë në disa shtete arabe, si në Jordani, Irak, Siri dhe Liban. Përpjekja e tyre e fundit ishte ajo e vitit 1956, kur forcat izraelite të

⁸ W. Montgomery Watt. Muhammad: Prophet and Statesman (London: Oxford University Press, 1961), f. 15.

ndihmuara drejtpërdrejt nga Britania dhe Franca u orvatën për rrëzimin e qeverisë shumë të popullarizuar të Naserit në Egjipt.

Edhe pas largimit të fuqive imperialiste nga rajoni vazhdoi tradita e invazionit ushtarak, por tash nga dy superfuqitë ushtarake të kohës: Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Shtetet e Bashkuara të Amerikës vetëm gjatë administratës së Reganit kanë intervenuar në Liban, Siri, Iran dhe Libi, kurse intervenimi më i njohur nga Bashkimi Sovjetik ishte ai i vitit 1979 në Afganistan. Në vitin 1986 sovjetikët së bashku me forcat e Gjermanisë Lindore dhe të Kubës dolën në përkrahje të regjimit prosovjetik të Jemenit.

Duhet theksuar se ushtritë janë institucionet e brendshme më të rëndësishme në shtetet arabe dhe në tërë rajonin e Lindjes së Mesme. Edhe përkundër eksperimenteve periodike me liberalizimin ekonomik e politik, shtetet e atjeshme, veçanërisht shtetet arabe të Lindjes së Mesme, ende vazhdojnë të jetojnë si shtete jodemokratike.⁹ Për t'i mbajtur pozitat e tyre politike liderët e atjeshëm politikë veprojnë me gjuhën e forcës, kurse për t'u mbrojtur nga kundërshtimet e mundshme të kundërshtarëve të tyre politikë ata mbështeten te forcat ushtarake.

Për këtë arsye mund të themi lirisht se organizatat ushtarake janë institucione shumë të rëndësishme, të cilat nuk mund të shpërfillen nga ana e udhëheqësve autoritarë. Atje ushtritë janë përdorur disa herë për ndërrimin e pushtetit. Në shumicën e shteteve tradicionale të Lindjes së Mesme kontrolli mbi ushtrinë bëhet përmes anëtarëve të familjes, të fisit ose nëpërmjet mercenarëve. Në Arabinë Saudite Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Aviacionit janë nën kontrollin e plotë të familjes mbretërore. Atje asnjë ministri që ka të bëjë me sigurinë kombëtare nuk është jashtë kontrollit të djemve të Ibn Saudit, themeluesit të Arabisë Saudite.¹⁰

Përpos ushtrisë, në vendet arabe një rol mjaft të rëndësishëm e luajnë edhe burokratët. Burokratët jo vetëm që merren me administrimin e ligjeve, por në mungesë të institucioneve ligjvënëse ata luajnë edhe funksionin ligjbërës. Rëndësia e lidhjeve familjare te shtetet arabe i shtynë burokratët t'u japin përparësi anëtarëve të

⁹ Nora Bensahel and Daniel L. Bayman: *The Future Security Environment in the Middle East: Conflict, Stability and Political Change*. Publisher: Rand Publication, Santa Monica, CA.2003, f. 129.

¹⁰ Ghassan Salameh, "Political Power and Saudi State", *Merip Reports* 9 (October 1980) f. 9-10.

familjeve dhe të fisit, pa marrë parasysh përgatitjen e tyre profesionale.

Në Sudan, për shembull, sektori burokratik është dominues dhe shumë i fuqishëm. Edhe në Arabinë Saudite sektori i burokracisë vazhdon të mbetet besnik i autoritetit mbretëror. Shërbimi civil i Jordanisë është rritur 300 për qind brenda periudhës pesëmbëdhjetëvjeçare. 1970-1975.¹¹ Burokracia libaneze, e cila së bashku me ushtrinë nga politika e atjeshme ishin konsideruar si forca kryesore të cilat do të shërbenin për zhvillimin e vendit, pati dështuar në atë drejtim. Burokracia e atjeshme për më tepër se një dekadë e kishte mbajtur premtimin se do të shndërrohej në një organizatë profesionale, por më vonë ajo e ndryshoi kahjen për t'iu kthyer rolit të saj në shërbim të elitave.

Në shumicën e shteteve arabe, institucionet ligjvënëse, parlamentet, si dhe sektori privat i ekonomisë kanë ngelur prapa hijes së demokracisë. Në rajonin e Lindjes së Mesme burokracia vazhdon të mbetet fusha më e preferuar për karrierat e shumë të rinjve të edukuar. Kjo traditë kishte filluar me Ataturkun në Turqi.¹² Edhe Naseri i Egjiptit ishte ithtar i sistemit burokratik. Në shumicën e shteteve arabe, burokracitë të cilat funksionojnë me bekimin e elitave udhëheqëse bëhen pengesa kryesore e demokracisë dhe e pjesëmarrjes politike.

Te shumica e vendeve arabe qeveritarët e atjeshëm nuk i lejojnë organet legjislativë që të bëhen organe përfaqësuese me karakter ligjvënës, por në traditën islamike dhe fisnore të vendeve arabe ekziston një respekt për konsultimet, për komunikimet ndërmjet anëtarëve të familjes dhe të fisit. Kjo traditë shërben edhe si arsye për themelimin e asambleve konsultative.¹³ Në Lindjen e Mesme ekzistojnë tri lloje të legjislativave:

1. Legjislativat pa funksion ligjvënës. Këto legjislativa funksionojnë me bekimin e monarkut dhe kanë karakter konsultativ. Shumica e anëtarëve të tyre janë të emëruar nga

¹¹ Jamil E. Jreisat, *Bureaucracy and Development in Jordan*, "Journal of Asian and African Studies" 24 (1989) f. 99.

¹² Metin Heper, "Political Modernization as Reflected in Bureaucratic Change: The Turkish Bureaucracy and a Historical Bureaucratic Empire Tradition", "International Journal of Middle East Studies" 7 (October 1976) f. 510.

¹³ Abdo Baklini, Gulian Denoeux, and Robert Springborg: *Legislative Politics in the Arab World: The Resurgence of Democratic Institutions*. Publisher: Lynne Rienner, Boulder, CO. Publication Year: 1999. f. 47.

- monarku. Të tilla gjenden në Oman, Katar, Arabinë Saudite dhe në Emiratet e Bashkuara Arabe;
2. Legjislaturat që kanë pjesëmarrje të kufizuar në sistemin e bërjes së ligjeve. Këto legjislatura gëzojnë të drejtën për të kritikuar në mënyrë të hapur shtetin dhe politikën shtetërore. Ato themelohen nëpërmjet zgjedhjeve të manipuluar dhe që karakterizohen me një opozitë formale. Të tilla legjislatura mund të gjenden në Algjeri, Egjipt, Iran, Kuvajt, Siri, Jordani, Liban, Marok, Tunizi, Jemen dhe në Irakun e sotëm;
 3. Legjislaturat me funksion të mirëfilltë legjislativ. Ato themelohen me anë të zgjedhjeve të lira me pjesëmarrjen e disa partive politike. Legjislatura të tilla aktualisht gjenden në Turqi dhe në Izrael.

Siç shihet nga kjo që u tha më lart, në shtetet arabe qëllimi i themelimit të organeve ligjvënëse nuk është afirmimi i vlerave të vërteta të demokratike dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrjen politike. Në vendet arabe partitë politike dhe legjislaturat e stili perëndimor deri më tani nuk kanë pasur sukses që t'i realizojnë objektivat e tyre për demokratizimin e shoqërisë.

Pse qeveritë autoritare qenë aq të zakonshme në botën arabe?

Për vite të tëra historianë dhe shkencëtarë politikë spekulojnë mbi origjinën kulturore ose sociale të autoritarizmit në botën arabe. Disa nga ta mendojnë se arsyeja kryesore është islami, duke argumentuar se ai nuk është në përputhje me demokracinë apo të drejtat e njeriut. Të tjerët vënë në dukje strukturën e familjes, duke argumentuar se një shtet i dominuar nga një figurë e vetme (mashkulli) favorizohet nga familjet tipike arabe.¹⁴ Sot vetëm disa historianë dhe shkencëtarë socialë i marrin seriozisht këto shpjegime.

Disa autorë mendojnë se nuk ka arsye të supozohet se islami është më pak ose më shumë në përputhje me demokracinë dhe të drejtat e njeriut se krishterimi apo judaizmi. Për të argumentuar këtë ata sjellin shembulljt e Indonezisë, shtetit me numër më të madh të popullatës myslimane dhe të Turqisë, të dyja shtete demokratike, ndonëse me të meta. Edhe pse nuk ka një shpjegim të vetëm për

¹⁴ James L. Gelvin: *The Arab Uprisings: What Everyone Needs to Know?* Oxford University Press, New York. Publication Year: 2012.f.7.

përhapjen e qeverive autoritare në botën arabe, historianë dhe shkencëtarë politikë kanë ofruar dy shpjegime të pjesshme me të cilat pajtohen shumë ekspertë. E para ka të bëjë me kontrollin e shtetit mbi burimet arabe dhe e dyta me politikën e jashtme amerikane.

Shumica shteteve arabe të Gjirit Persik janë monarki dhe si të tilla ato vazhdojnë të përdorin pasuritë e tyre të mëdha për të ruajtur pushtetin e tyre dhe për të ndërtuar forca të mëdha ushtarake me anë të së cilave e shkatërrojnë ose e korrutojnë opozitën e mundshme politike në vendet e tyre. Tetë shtetet e Gjirit Persik: Arabia Saudite, Bahreini, Iraku, Irani, Omani, Emiratet e Bashkuara Arabe, Katari dhe Kuvajti përbëjnë një rajon mjaft të pasur nga i cili sigurohet rreth 60% e naftës botërore.¹⁵ Rezervat e mëdha të naftës u kanë mundësuar familjeve mbretërore që me pasuritë e shtetit t'i plotësojnë kërkesat e popullit. Kuvajti paraqet një shembull të tillë. Familja mbretërore e Kuvajtit u kishte ndihmuar ekonomikisht të gjithë atyre banorëve që kishin nevojë. Pas luftës me Irakun familja mbretërore u kishte ndarë tokë falas dhe u kishte dhënë kredi të mëdha të gjithë atyre që patën nevojë për ndërtimin e shtëpive të reja. Pas luftës shteti kishte ngritur pagat për 25% dhe kishte paguar faturat e rrymës dhe të ujit për të gjithë banorët. Sjelljet e këtilla të shtetit me qytetarët e tij edhe nëse nuk kanë pasur rëndësi të madhe ekonomike, meqë shumica e qytetarëve janë të pasur, ka ndikuar pozitivisht në rritjen e besimit te pushtetmbajtësit.

Arsyeja e dytë që ka mundësuar ruajtjen e regjimeve tradicionale ka të bëjë edhe me lidhësin politik. Liderët e ndryshëm vazhdimisht mbajnë kontakte formale me të gjitha shpresat e popullit. Për shembull, në Arabinë Saudite familja mbretërore është ajo e cila e cakton monarkun, por çdo person i gjinisë mashkullore mund të takohet me monarkun për të biseduar me të lidhur me problemet apo për ndonjë propozim që ka për ta bërë. Qëllimi i këtyre bisedave, që zakonisht bëhen ditën e martë, është që të mbahet i kënaqur populli.¹⁶ Familja mbretërore gjithashtu ndihmon xhamitë dhe institucionet tjera fetare. Por duhet theksuar se përveç këtyre të mirave, ata nuk gëzojnë ndonjë liri të vërtetë. Arabia Saudite nuk është shtet demokratik, atje mungon liria e shtypit dhe e shprehjes.

Edhe shtetet tjera arabe të cilat nuk janë shumë të pasura me naftë, siç janë Egjipti dhe Siria, kanë përdorur metoda të ndryshme për të ruajtur

¹⁵ Zenun Halili: *Lindja e Mesme - Historia dhe politika*. Botoi Instituti Kosovar Për Media dhe Politika, Prishtinë, 2010, f. 148.

¹⁶ Ibid, f. 149.

lojalitetin e popujve të tyre për qeveritë. Një prej metodave të përdorura nga këto shtete është edhe ndihma e dhënë qytetarëve në formë të rentës. “Shteti i rentës“ është ai në të cilin qeveria nuk mbledhë të ardhura nga qytetarët e saj për mes taksave.¹⁷ Në vend që të mblidhnin taksa prej tyre, qeveritë e këtyre vendeve i shpërndanin burime te qytetarët e vet. Shpjegimi i dytë i pjesshëm për përhapjen e sundimit autoritar në botën arabe është politika e jashtme amerikane. Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk kanë qenë shumë të angazhuara në rajonin e Lindjes së Mesme deri në periudhën menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore.

Angazhimi amerikan në atë rajon përkoi me fillimin e Luftës së Ftohtë, e cila ka përcaktuar qëllimet amerikane atje. Gjatë viteve të Luftës së Ftohtë, Shtetet e Bashkuara kanë qenë të angazhuara për të arritur gjashtë qëllime kryesore në rajon: për të parandaluar zgjerimin e ndikimit sovjetik; për të siguruar qasjen përëndimore për naftën; për të siguruar zgjedhjen paqësore të konflikteve; për të ruajtur një ekuilibër rajonal të pushteteve; për të promovuar shtete të qëndrueshme përëndimore në rajon; për të ruajtur ekzistencën dhe sovranitetin e Izraelit; për të mbrojtur linjat detare, linjat e komunikimit dhe linja tjera të ngjashme që lidhin Shtetet e Bashkuara me Evropën dhe Azinë.¹⁸ Regjimet autoritare ishin të dobishme për arritjen e të gjitha këtyre qëllimeve. Hartuesit e politikave amerikane besonin se vetëm regjimet e forta autoritare mund të sjellin një zhvillim të shpejt ekonomik të nevojshëm për të parandaluar popullsinë e vendeve të tyre drejt komunizmit.

Sipas tyre, vetëm regjimet e fuqishme autoritare si ai i Egjiptit mund të nënshkruanin traktate paqeje me Izraelin përballë kundërshtimit popullor ndaj këtyre traktateve. Amerikanët besonin se vetëm regjimet e forta autoritare e kanë mundësinë për të mbajtur një bilanc rajonal të pushtetit, i cili do të mund të siguronte furnizim të pandërprerë të naftës për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe për aleatët e saj. Mbështetja amerikane për regjimet autoritare ka qenë në formë direkte dhe indirekte. Shtetet e Bashkuara në mënyrë direkte dhe indirekte kanë mbështetur oficerët ushtarakë të cilët e morën pushtetin me anë të ndërhyrjeve ushtarake në disa vende arabe gjatë viteve 1940 – 1960. Autokratët si Mubaraku i Egjiptit dhe Ali Abdullah Saleh i Jemenit kanë qenë aleatë të amerikanëve në rajon.

¹⁷ John Waterbury: *The Soft State and the Open Door: Egypt's Experience with Economic Liberalization, 1974-1984*, *Comparative Politics* (October 1985), f. 68.

¹⁸ James L. Gelvin: *The Arab Uprisings: What Everyone Needs to Know?* Oxford University Press, New York. Publication Year: 2012, f. 9.

Mbështetja direkte e Shteteteve të Bashkuara të Amerikës nuk ka munguar edhe për familjet mbretërore, për sheikët dhe emirët e vendeve arabe anekënd regjionit të Lindjes së Mesme

Përpjekjet për demokratizim

Shtetet si Egjipti, Siria, Iraku, Libani, Sudani dhe vendet tjera arabe kanë bërë përpjekje për adaptimin e demokracisë liberale në vitet e para të pavarësisë së tyre, por shumica e këtyre eksperimenteve të hershme me demokracinë kanë dështuar që në fillim. Megjithatë, në Liban demokracia zgjati deri në shpërthimin e Luftës Civile në vitin 1975, kurse në Sudan tri intervale të qeverisjes demokratike u ndërprejnë me anë të ndërhyrjes ushtarake. Por, pavarësisht nga këto rezultate të përziera, shumë vlera demokratike, të tilla si përgjegjësia e liderëve në procesin e vendimmarrjes, e kanë ruajtur statusin e tyre të mëparshëm.

Këto vlera kanë rrënjë të thella kulturore në botën arabe si dhe rezonancë të fuqishme bashkëkohore. Regjimet e ngjyrave të ndryshme ideologjike janë ndjerë të detyruara për të përdorur një fjalor demokratik. Në Egjipt një nga gjashtë pikat e programit të Gamal Abdel Naserit mbështetej në krijimin e jetës “së shëndetshme” demokratike, ideologjia bathiste pohonte demokracinë si qëllim, kurse emri zyrtar i Jemenit të Jugut, një shtet autoritar marksist-leninist, ishte Republika Demokratike Popullore e Jemenit. Por hapa serioz drejt demokracisë në një numër të dukshëm të vendeve arabe nuk janë vërejtur deri në vitet 1980.

Këto përpjekje u ndërmorën pas shkatërrimit të Murit të Berlinit dhe pas rënies së bllokut komunist. Pas goditjes aq të fuqishme të autoritarizmit dhe uljes së mbështetjes ushtarake sovjetike, edhe regjimet më despotike në botën arabe, si Siria dhe Iraku, u detyruan që të miratojnë disa masa kozmetike për të maskuar sundimin e tyre me zbulime demokratike.¹⁹ Disa vite pasi kishte filluar kjo valë e re e demokratizimit, vetëm Jordania dhe Jemeni e vazhduan rrugën e demokratizimit, kurse Egjipti dhe Tunizia e ndryshuan kursin e tyre demokratik.

Në fillim të viteve 1990, dy monarkitë tradicionale të pasura me naftë - Bahreini dhe Omani, u ndien të obliguara që të emëronin

¹⁹ Najib Ghadbian: *Democratization and the Islamist Challenge in the Arab World*. Westview Press, Boulder, Colorado - 1997, f. 3.

”këshilla konsultuese”, kurse Arabia Saudite inauguroi këshillin konsultativ gjashtëdhjetanëtarësh. Në Algjeri eksperimenti demokratik u ndërpre me anë të një ndërhyrjeje ushtarake në vitin 1992.

Studimet e fundit kanë treguar skepticizëm në lidhje me demokratizimin e vendeve arabe në dritën e një trendi tjetër, në rritjen e lëvizjeve islamike (i quajtur nganjëherë si “Fundamentalizmi islamik”²⁰ Ngritja e grupeve dhe e lëvizjeve islamike ka përkruar me shtytjen drejt demokracisë, posaçërisht në ato shtete që kanë lejuar mbajtjen e zgjedhjeve të lira, siç janë Algjeria dhe Jordania. Grupet islamike po ashtu kanë krijuar lëvizje opozitare në shtetet që kanë refuzuar hapjen, si p.sh. Siria. Ishte pikërisht rritja e islamikëve ajo që tronditi elitat në pushtet dhe që i shtyri ata të mendojnë nëse duhej vazhduar me rrugën demokratike e cila po e rrezikonte mbijetesën e tyre.

Pranvera Arabe

Pranvera Arabe është një term për valën revolucionare të demonstratave dhe protestave (të dhunshme dhe jo të dhunshme), të trazirave dhe luftërave civile në vendet arabe që filluan më 18 dhjetor të vitit 2010. Deri më tani sundimtarët janë detyruar të largohen nga pushteti në Tunizi, dy herë në Egjipt (Mubaraku dhe Morsi), në Libi dhe në Jemen. Kryengritjet civile kanë shpërthyer në Bahrein dhe në Siri; protesta të mëdha shpërthyen në Algjeri, Irak, Jordani, Kuvajt, Marok dhe Sudan, kurse protesta më të vogla kanë ndodhur në Oman, në Arabinë Saudite dhe në territoret nën autoritetin palestinez.

Pranvera Arabe e vitit 2011 është parë si një prej momenteve të mëdha historike të transformimit politik. Krahasset janë bërë me revolucionet evropiane të vitit 1848 dhe me tranzicionet demokratike të pas Luftës së Ftohtë në Evropën Lindore, ndërsa disa të tjerë e kanë trajtuar atë si një valë të katërt të demokratizimit.²¹ Këto analogji kanë kuptim duke pasur parasysh pushtetin shumëvjeçar të diktatorëve që ishin indiferentë ndaj ndryshimeve politike në një rajon të njohur për autoritarizëm të vazhdueshëm.

²⁰ Ibid, f.4.

²¹ Hashemi Nader: The Arab Spring Two Years On: Reflections on Dignity, Democracy, and Devotion. Journal title: Ethics & International Affairs. Volume: 27. Issue: 2. Summer 2013, f. 207.

Popujt arabë kanë pësuar shumë shtypje të natyrës koloniale në të kaluarën. Në botën arabe nuk qeveris shoqëria përmes përfaqësuesve të saj të zgjedhur në mënyrë demokratike, por qeverisin klanet, fiset e familjet e njohura. Presidentët në vendet arabe sillen sikur të ishin monarkë absolut, të cilët qëndrojnë në pushtet duke përdorur forcën, korrupsionin, shantazhin dhe turpin. Bashar al Assad ka zëvendësuar babain e tij Hafez al Assad, Seif al Islam ishte projektuar si zëvendës natyror i Gadafit, Mubaraku gjithashtu kishte menduar të dizajnonte zëvendësues djalin e tij.²² Të gjitha këto plane tipike despotike dhe aspak demokratike u prishën nga ngjarjet e Pranverës Arabe.

Pranvera Arabe është një refuzim kundrejt autoritarizmit, korrupsionit, vjedhjes së të mirave të vendit, nepotizmit dhe favorizimit. Ishte një protestë për të vendosur një higjienë morale në një shoqëri që ka qenë shfrytëzuar dhe poshtëruar për dekada me radhë. Për këtë arsye nuk është një revolucion ideologjik. Nuk ka një lider, nuk ka një parti që organizon dhe që i çon përpara revoltat. Miliona persona kanë zbritur nëpër rrugë. Një revolucion i një lloji të ri: spontan e i paparashikuar. Është një faqe historie e shkruar ditë për ditë, pa një planifikim, pa ndërmjetësim, pa truke.²³ Kryengritjet e tanishme në shtetet arabe e kanë origjinën nga një dështim i dy fishtë, - njëri politik dhe tjetri ekonomik.

Politikisht dështimi për të zhvilluar një sistem të hapët e plural kishte lënë shumë pakë mundësi për pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën shoqërore dhe politike dhe për përfaqësimin e tyre në qeveri. Kurse ekonomikisht qeveritë e vendeve arabe kishin dështuar për të krijuar rritje përfshirëse, të drejtë dhe të barabartë. Për një kohë të gjatë regjimet autoritare të vendeve arabe janë mbështetur në institucionet politike dhe ekonomike për ta ruajtur status quon, duke krijuar raporte të paqëndrueshme mes lirive ekonomike e politike sidomos për të rinjtë. Ka pasur rritje ekonomike, por ajo nuk ishte shumë e shpërndarë, kishte rishpërndarje, por kishte edhe rritje të korrupsionit.²⁴ Dhe në fund reformat e ngadalta nuk arritën të pengonin prishjen e kontratës shoqërore të popullatës arabe me shtetet e tyre.

²² Alban Daci: Pranvera Arabe një histori e shkruar çdo ditë, botuar më 10 nëntor 2011 në blogun, albandaci.blogspot.com.

²³ Ibid.

²⁴ Magdi Amin and the others: *After the Spring: Economic Transitions in the Arab World*. Publisher: Oxford University Press. New York, 2012, f. 17.

A është Pranvera Arabe një manifestim i zemërimit publik kundër status quos?

Nuk ka asnjë dyshim se ky fenomen, që shumë vëzhgues i referohen si “Pranvera Arabe”, është një manifestim spontan i zemërimit publik në botën arabe. Ajo çfarë ishte e zakonshme në shumicën e vendeve arabe ishte se rendi i vjetër i lidhur me plot autoritarizëm, represion politik, brutalitet policor, nepotizëm, keqmenaxhim ekonomik, papunësi dhe varfëri nuk ishin më të qëndrueshme dhe ngjarjet si në Tunizi shkaktuan një sërë revoltash edhe në vende të tjera. Ashtu si të gjitha përmbysjet e mëdha sociale, kryengritja arabe ishte më e gjatë sa i përket realizimit dhe e lindur nga shumë shkaqe të ndërthurura njëra me tjetrën.²⁵ Megjithatë, ky manifestim mori forma të ndryshme për shkak të përvojave të ndryshme në vende të ndryshme. Për më tepër, aktorët shoqërorë dhe politikë që kanë luajtur role në këto përvoja gjithashtu kanë karakteristika të ndryshme nga njëri vend në tjetrin. Deri tani sunduesit kanë ndryshuar në disa vend arabe, por rruga e çdo vendi e udhëhequr pas ndryshimit të udhëheqjes ka qenë e ndryshme për shkak të karakteristikave të tyre të veçanta.

A ka pasur sukses Pranvera Arabe?

Në fillim të vitit 2011 egjiptianët festonin kur Mubaraku u përmbys nga një kryengritje popullore pas 30 vjetësh në pushtet. Në Lindjen e Mesme dhe në Afrikën e Veriut diktatorët u përmbysën dhe atmosfera pro demokracisë ishte euforike. Lëvizja u quajt shpejt Pranvera Arabe, por koha tregoi se ajo ishte një shpresë fallse për të ardhmen.²⁶ Afërsisht tri vite pas revolucioneve në botën arabe, asnjë vend i vetëm nuk është ende në rrugën e qartë për t’u bërë një demokraci e qëndrueshme dhe paqësore.

Vendet që kishin më shumë shpresë si Tunizia, Libia dhe Jemeni po vuajnë. Një eksperiment kaotik me demokracinë në Egjipt, vendi me më shumë banorë në rajon, e dërgoi një president të zgjedhur pas hekurave. Siria është e zhytur në një luftë të përgjakshme civile. Tani ka

²⁵ Levent Bashturk, Analizë e botuar në portalin “Mendimi Press”, më 8 shtator 2012.

²⁶ Zëri i Amerikës: Intervistë e James Phillips, analist i Lindjes së Mesme në Fondacionin Heritage. Realizuar më 25 Gusht, 2013.

edhe të tillë që po mendojnë se Pranvera Arabe është e mallkuar.²⁷ Lindja e Mesme, argumentojnë ata, nuk është gati për ndryshim. Një arsye është se ajo nuk ka institucione demokratike, kështu që fuqia e njerëzve do të kalbet në anarki ose do të provokojë një rikthim të diktatura.

Arsyeja tjetër është se forca më gjithëpërfshirëse e rajonit është islami dhe siç e kemi cekur edhe me pare, ka autorë që besojnë se islami nuk është në gjendje të bashkëjetojë me demokracinë. Kritikët dalin me konkluzionin se Lindja e Mesme do të ishte më mirë sikur Pranvera Arabe të mos ndodhte kurrë. Por mendoj se këto pikëpamje janë të parakohshme dhe në rastin më të keq të gabuara. Tranzicionet drejt demokracisë janë shpesh të dhunshme dhe të gjata. Është e vërtetë se pasojat më të këqija të Pranverës Arabe ishin në Libi fillimisht dhe tashmë në Siri, që janë tepër të tmerrshme. Megjithatë besohet se shumica e arabëve nuk dëshirojnë të kthehen pas.

Shumë arabë laikë dhe miqtë e tyre në Perëndim tani argumentojnë se për shkak se islamistët kanë tendencën të shohin sundimin e tyre si të dhënë nga Zoti, nuk do të pranojnë kurrë një demokraci të vërtetë e cila nënkupton kufizime, përfshirë gjykata të pavarura, shtypin e lirë dhe fuqi të shpërndara përmes një kushtetute pluraliste që duhet t'i mbrojë minoritetet.²⁸ Por edhe kjo mendoj se është e gabuar. Jashtë botës arabe, islamistët në Malajzi dhe Indonezi kanë demonstruar se mund t'i mësojnë rregullat e demokracisë. Edhe protestat e tanishme në Turqi kundër kryeministrit autokratik Erdogan, të zgjedhur në frymën demokratike, kanë më shumë të përbashkëta me Brazilin sesa me Pranverën Arabe. Turqia, me të gjithë të metat e saj, është më demokratike sot sesa ishte në kohën kur sundonte ushtria.

Përfundim

Siç kemi thënë edhe më parë, në vendet arabe të Lindjes se Mesme modernizimi si fenomen shoqëror është më i avancuar se zhvillimi politik. Gjendja ekonomike në disa vende arabe është stabile me tendencë të përmirësimit të mëtejshëm. Padyshim një problem serioz me të cilin përballen shtetet arabe është liberalizimi i proceseve politike, me theks të veçantë pjesëmarrja e qytetarëve në jetën politike. Elitat politike e kontrollojnë në mënyrë absolute pushtetin

²⁷ The Economist: Pranvera Arabe, A dështoi revolucionin? Botuar në "Gazeta Shqip", më 19 Korrik, 2013.

²⁸ Ibid

shtetëror, përderisa qytetarët, në rastin më të mirë, mund të marrin pjesë vetëm në proceset konsultative.

Dialogu ndërmjet pushtetmbajtësve dhe qytetarëve është në fazën embrionale të tij. Që ky dialog të ketë fillim të mbarë dhe të kurorëzohet me sukses, lidhshipi politik do të duhej të ketë vizion më të qartë për të ardhmen dhe të heqë dorë nga mënyra autoritare e qeverisjes. Në anën tjetër, kësaj duhet t'i paraprijnë ndryshime të mëdha në ekonomitë e shteteve arabe. Ato ende gjenden në dilemë të madhe, të cilës ende nuk i janë përgjigjur në mënyrë të kënaqshme. Gjendja e tashme ekonomike në ato vende kërkon pashmangshmërisht reforma të thella ekonomike, përfshirë këtu privatizimin, eliminimin gradual të proteksionizmit në ekonomi, si dhe krijimin e kushteve më të përshtatshme për investime.

Që këto dilema të zgjidhen më me lehtësi është e nevojshme që elitat politike më në fund të kuptojnë se interesi i përgjithshëm kombëtar është më i rëndësishëm se interesat personale të individëve apo grupeve të caktuara politike. Pa perceptimin e këtij argumenti domethënës shtetet arabe do të mbesin edhe më tej atje ku kan qenë, - bastion i fundit i regjimeve autokratike në botë.

Summary

In the Arab countries of the Middle East, modernization as a social phenomenon is more advanced than political development. The economic situation in some Arab countries is stable with a tendency of further improving. But, obviously a serious problem facing the Arab countries is the liberalization of the political process, with special emphasis on the participation of citizens in political life. Political elites are in absolute control of state power, while citizens, at best, can only participate in the consultation processes.

The dialogue between political elites and citizens is in its embryonic stage. But, for this dialogue to have a good start and to be crowned with success, political leaderships must have a clear vision for their future and give up the authoritarian way of governing. On the other hand, this should proceed with major changes in the economies of the Arab countries. They are in a great dilemma, which has not still been answered satisfactorily. The current economic situation in those countries inevitably requires deep economic reforms, including privatization, gradual elimination of protectionism in the economy, and the creation of appropriate conditions for investment.

For these dilemmas to be resolved more easily, it is necessary for political elites to finally understand that the overall national interest is more important than personal interests of certain individuals or political groups. Without perception of this significant argument, the Arab states will still remain what they are, the last bastion of autocratic regimes in the world.

Literatura:

- The Middle East Today. Contributors, Don Peretz - author. Publisher: Praeger. Place of Publication: Westport, CT. Publication Year: 1994.
- Christopher Catherwood, A Brief History of the Middle East. Published in London, by Constable & Robinson Ltd. Year of Publication 2006.
- Samuel P. Huntington, Political Order in Changing Societies, Yale University Press, 1968.
- Almond, Powell, Strom, Dalton, Comparative Politics Today, Seventh Edition. Publisher: Longman. Publication Year 2003.
- Samuel P. Huntington, The Clash of Civilization and Remaking of World Order. Published in Great Britain, by The Free Press, 2002.
- Vicky Randall and Robin Theobald, Political Change and Underdevelopment, Duke University Press, 1998.
- Michael C. Hudson, Arab Politics, The search for Legitimacy (New Haven: Yale University Press, 1977.
- W. Montgomery Watt. Muhammad, Prophet and Statesman (London: Oxford University Press, 1961.
- Fareed Zakaria, The Rise of Illiberal Democracy, 76 Foreign Affairs (November-December, 1997.
- Metin Heper, "Political Modernization as Reflected in Bureaucratic Change: The Turkish Bureaucracy and a Historical Bureaucratic Empire Tradition", "International Journal of Middle East Studies" 7 (October 1976)
- Ghassan Salameh, "Political Power and Saudi State", Merip Reports 9 (October 1980)
- Abdo Baklini, Gulian Denoeux, and Robert Springborg: Legislative Politics in the Arab World: The Resurgence of Democratic Institutions. Publisher: Lynne Rienner, Boulder, CO. Publication Year: 1999.
- James L. Gelvin: The Arab Uprisings: What Everyone Needs to Know? Oxford University Press, New York. Publication Year: 2012.
- Zenun Halili, Lindja e Mesme - Historia dhe politika. Botoi Instituti Kosovar Për Media dhe Politika, Prishtinë, 2010.
- John Waterbury, The Soft State and the Open Door: Egypt's Experience with Economic Liberalization, 1974-1984, Comparative Politics (October 1985).
- Najib Ghadbian, Democratization and the Islamist Challenge in the Arab World. Westview Press, Boulder, Colorado - 1997.
- Hashemi Nader, The Arab Spring Two Years On: Reflections on Dignity, Democracy, and Devotion. Journal title: Ethics & International Affairs. Volume: 27. Issue: 2. Summer 2013.
- Magdi Amin and the others, After the Spring: Economic Transitions in the Arab World. Publisher: Oxford University Press. New York, 2012.
- Fouad Ajami, "The End of Pan-Arabism," Foreign Affairs 57 (Winter 1978-1979).
- Mehran Kamrava, Democracy in the Balance, Culture and Society in the Middle East. Publisher: Catham House Publishers. New York, 1998.

Arsim EJUPI, Prishtinë

LUGINA E PRESHEVËS DHE KONTEKSTI GJEOPOLITIK I PROJEKTIT LUNDRUES “MORAVË - VARDAR”

KDU 911.3 (497.11-13)

Abstrakt

Ambiciet e vazhdueshme të Serbisë për zgjerim territorial janë përmbushur përmes pushtimit dhe nënshtrimit të popujve dhe vendeve të tjera të Ballkanit. Dalja e drejtpërdrejtë në det ka qenë synim i përhershëm i saj. Pozitën gjeografike kontinentale serbët e kanë parë si pengesë për zhvillimin dhe realizimin e synimeve të tyre ekspansioniste. Serbia përmes luftërave ose përfshirjes në krijesat gjeopolitike artificiale si Mbretëria SKS apo ajo e Jugosllavisë pas vitit 1929, RSFJ-ja, pastaj dhe Unioni Serbi-Mali i Zi, disa herë ka arritur të zgjerohet territorialisht dhe të dalë në det. Por megjithëse pjesë e ish-Jugosllavisë, me një vijë të gjatë bregdetare, Serbia asnjëherë nuk ka arritur ta valorizojë ekonomikisht dhe politikisht atë, pasi daljen e drejtpërdrejtë në det e kanë pasur republikat e tjera: Kroacia, Mali i Zi, Bosnje-Hercegovina dhe Sllovenia. Në këto kushte Serbia ka synuar t'i realizojë lidhjet e saj me detin përmes zhvillimit të infrastrukturës, si hekurudha Beograd - Tivar e përfunduar në vitin 1975. Një projekt gjigant infrastrukturor, që nuk u realizua deri sot, është Kanali lundrues “Moravë - Vardar”. Lugina e Preshevës, me ujëndarësin e saj të ulët, shtrihet ndërmjet këtyre dy luginave, prandaj nëpër të ishte parashikuar të ndërtohej një sektor i kanalit, që do t'i mundësonte Serbisë daljen në detin Egje.

Fjalët çelës: Kanali lundrues, Lugina e Preshevës, Serbia, gjeopolitike, dalja në det, pozita.

Pozita gjeografike, kufijtë, madhësia dhe emri

Lugina e Preshevës (pa Medvegjën) shtrihet prej 42° 14' e 35" deri 42° 39' e 56" të gjerësisë gjeografike veriore dhe prej 21° 31' e 34" deri 21° 58' e 08" të gjatësisë gjeografike lindore. Ajo ndodhet në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik. Kufirin perëndimor të saj e përbën Mali i Karadakut të Preshevës në jug dhe Malësia e Bujanocit në veri, kurse në lindje Mali i Rujanit dhe i Kozjakut. Kufiri verior i fushës së Bujanocit, që është dhe kufiri verior i LP-së, kalon nëpër lartësitë Cërkvishtë, në sektorin e Banjës së Bujanocit.¹ Ujëndarësi i

¹ M. Kostić, *Vranjsko-Bujanovačka Kotlina, Vranjski glasnik*, br. XIV, Vranje, 1976, f. 185.

ulët i Preshevës (460 m) në jug ndanë Luginën e Preshevës nga fusha e Kumanovës.

Lugina e Preshevës, si njësi e veçantë natyrore i takon Anamoravës jugore, e cila fillon në jug të Bujanocit, ku Morava e Binçit bashkohet me Moravicën e Preshevës dhe formon Moravën jugore.² Ajo ka pozitë gjeografike të përshtatshme, pasi shtrihet përgjatë luginave qendrore të Gadishullit Ballkanik. Nëpër territorin e saj kalon Korridori X, Beograd – Nish – Shkup - Selanik, që përbën arterien kryesore komunikative të Gadishullit Ballkanik, e cila e lidhë Evropën Qendrore me atë Jugore etj. Autostrada E-75, që kalon nëpër këtë korridor dhe i lidhë detet e ftohta me ato të nxehta, është përfshirë në T.E.M. (Trans European Motorways).³ Paralel me rrugën automobilistike shtrihet edhe vija hekurudhore. Një tjetër korridor natyror të rëndësishëm paraqet Gryka e Konçulit në Moravën e Binçit, përmes së cilës rajoni komunikon me Anamoravën në Kosovë, ndërsa gjithë Kosova ka qasje të drejtpërdrejtë në Korridorin X.⁴ Qafa malore e Livadhit të Shehut dhe ajo e Muçibabës lehtësojnë komunikimin e këtij rajoni me pjesën jugore të fushës së Moravës së Binçit.

Komuna e Medvegjës përfshinë pjesën e epërme të pellgut të lumit Jabllanica. Masivi malor i Gollakut e ndanë atë nga rrafshi i Kosovës, në lindje shtrihet deri në kontaktin me Luginën e Moravës Jugore, ndërsa në verilindje zbrit në fushën e gjerë të Leskocit. Në perëndim dhe jug, në një gjatësi rreth 40 km, kufizohet me komunën e Prishtinës, Podujevës dhe Kamenicës, ndërsa në veriperëndim me komunën e Kurshumlisë në Serbi. Në lindje kufizohet me komunën e Lebanës, kurse në veri me Bojnükun dhe Prokuplën. Medvegja ndodhet ndërmjet 42° 40' 10" dhe 43° 0' e 02" të gjerësisë gjeografike veriore, si dhe 21° 23' e 22" dhe 21° 42' e 09" të gjerësisë gjeografike lindore. Medvegja komunikon me rrafshin e Kosovës në lindje dhe fushën e Leskocit në perëndim përmes qafave malore, përkatësisht luginës së lumit Jabllanica.

Komuna e Medvegjës, me gjithë pozitën disi periferike ndaj bërthamës së trungut gjeoetnik shqiptar, është pjesë integrale e tij. Sipas autorëve serbë, Medvegja ndodhet në të ashtuquajturin kufi etnografik,⁵ sepse në veri shtrihen teritore të populluara kryesisht nga

² J. Marković, *Geografske oblasti SFRJ*, Univerzitet u Beogradu, Beograd, 1966, f. 294.

³ Projekat: *Izrada lokalno ekonomike strategije razvoja opštine Preševo*, Institut za razvoj malih i srednjih preduzeća, Beograd-Preševo, 2005-2006, f. 71.

⁴ I. Ramadani, "Kosova Lindore", *Buletini i FSHMN-ës*, Prishtinë 1998.

⁵ M. Vasović. *Gornja Jablanica – geografska svojstva*, Beograd, 1998, f. 11.

serbët, ndërsa në jug shumica janë shqiptarët autoktonë dhe të tjerët serbë e të ardhur. Konteksti i sotëm etnodemografik i komunës së Medvegjës është rrjedhojë e tkurrjes së vazhdueshme të trungut gjeoetnik shqiptar, si rezultat i dëbimit të shqiptarëve dhe e vendosjes në tokat e tyre të kolonëve serbë sidomos pas vitit 1878.

Të gjitha faktet e lartpërmendura kanë bërë që pozita gjeografike e Luginës së Preshevës të ketë vlera të shumta gjeografike, komunikatave dhe gjeostrategjike. Ajo përfshinë një sipërfaqe prej 1249 km² në të cilën jetojnë mbi 110.000 banorë rezidentë. Në të janë zhvilluar tri qendra urbane: Presheva, Bujanoci dhe Medvegja.



Harta 1. Pozita gjeografike e Luginës së Preshevës

Emërtimi Luginë e Preshevës është relativisht i ri dhe është futur në përdorim këto vitet e fundit. Ky nocion është i kontestueshëm nga qarqet politike e shkencore serbe. Në studimet e pakta shkencore për këtë trevë, të bëra nga serbët, askund nuk përmendet nocioni Luginë e Preshevës. M. Kostiq përmend emërtimet Lugina e Moravicës dhe Fusha e Bujanocit⁶. Me Luginë të Moravicës ka emërtuar hapësirën prej ujëndarësit të ulët të Preshevës e deri te lokaliteti Levosovë. Sipas këtij autori Lugina e Moravicës paraqet tërësi të posaçme, kurse fusha e Bujanocit është pjesë përbërëse e Luginës së Vranjës dhe Bujanocit. Sipas J. Trifunoskit viset përgjatë rrjedhjes së epërme të lumit të Tabanocit dhe të Moravicës së Preshevës janë pjesë përbërëse të të ashtuquajturës Luginë e Kumanovës dhe e Preshevës, si dhe ujëndarës i ulët ndërmjet rrjedhave të Moravës dhe Vardarit.

Vetë termi “luginë” nga aspekti gjeomorfologjik është mjaft i kontestueshëm pasi që viset përreth Preshevës janë tektonikisht të paradisponuara në mungesë të rrjedhjeve të mëdha ujore. Mirëpo elementet e sferës social-ekonomike, si popullsia me shumicë shqiptare, veçoritë demografike, prapambeturia në zhvillimin ekonomik, e kaluara historike dhe perceptimi mbi përkatësinë e njëjtë janë ato elemente të cilat i japin kësaj hapësire atributet e një tërësie ose rajoni gjeografik i cili është pranuar në literaturë si Luginë e Preshevës. Duhet përmendur që emërtimi Luginë e Preshevës fillon më intensivisht të përdoret në periudhën e shpërthimit të konfliktit të armatosur në Kosovë, në radhë të parë nga qarqet politike, diplomatike e mediatike amerikane, evropiane e më pastaj edhe nga ato shqiptare. Emërtimi *Lugina e Preshevës* sot është përqafuar përgjithësisht si emërtim nga shqiptarët dhe të huajt në kuptimin e një entiteti të veçantë etnik dhe politik.

Kanali lundrues “Moravë - Vardar” dhe përpjekjet e Serbisë për dalje në detin Egje

Ideja për ndërtimin e kanalit Moravë - Vardar daton nga fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX. Kësaj ideje i paraprinë interesimi i shtuar për zhvillimin e komunikacionit në lumin Morava. Francezët ishin ndër të parët që u interesuan për realizimin e kësaj ideje. Për këtë qëllim ishte krijuar kompania e përbashkët franko-serbe (French-Serbian Shipping Company), e cila në bashkëpunim me kompaninë

⁶ M. Kostić, *Preševska kotlina – društveno-geografska studija*, Vranjski Glasnik, br.V, Vranje, 1969, f.93.

tjetër franceze “Principale compagnie de bateaux à vapeur” ka zhvilluar aktivitetet për organizimin e trafikut lumor në Moravë. Francezët kërkuar nga princi serb Milan Obrenović që t’u lejohej shfrytëzimi i trafikut lumor në Moravë për 30 vjet. Por këtu ndërhyr Rusia, e cila ishte e interesuar për prezencën e saj më të fuqishme në Ballkan. Megjithatë, në vitin 1860 francezët e fituan të drejtën e shfrytëzimit të lumit Morava për komunikacion lumor. Por marrëveshja u prish dhe ndërtimi i rrugës lundruese nuk filloi pasi u zbulua se kompania franceze nuk ofronte siguri të mjaftueshme për investime dhe se merrej me biznese të dyshimta.

Ideja rishfaqet në vitin 1879 nga inxhinieri serb Ante Aleksić në librin me titull “Morava, gjendja e tanishme dhe mundësitë lundruese”,⁷ madje ajo zhvillohet më tej pasi propozohet mundësia e lidhjes së Danubit me detin Egje. Projekti iu prezantua gjermanëve, anglezëve dhe, nëpërmjet tyre, amerikanëve, të cilët shprehën interesim për realizimin e tij. Më 1907, një kompani amerikane nga Nju-Xhersi skicon projektin paraprak për rrugën lundruese “Moravë - Vardar”, të quajtur “Linja e gravitetit ekonomik evropian në raport me Kanalin e Suezit” (“The line of European economic gravitation in relation to Suez Canal”).

Zhvillimet e reja gjeopolitike në Ballkan, shkatërrimet nga luftërat dhe nevoja për rimëkëmbjen ekonomike penguan realizimin e këtij projekti të shtrenjtë dhe shuan përkohësisht shpresat për mbështetje politike dhe financiare për ndërmarrjen e kësaj nisme.


Shpresat ringjallen në vitin 1961 kur “Projektantski Zavod rečnog saobraćaja” nga Beogradi përpilon projektin paraprak për ndërtimin e rrugës lundruese Danub - Selanik, ndërsa në vitin 1973 u prezantua shtojca e projektit dhe Raporti i Ekspertëve të Kombeve të Bashkuara për rrugën lundruese Moravë - Vardar.

Problemet e brendshme në Jugosllavinë e Titos, që manifestohen me kërkesat legjitime të shqiptarëve në Kosovë për avancimin e të drejtave dhe statusit të barabartë me popujt e tjerë shtetformues, ritja e nacionalizmit serb, synimet për dominimin politik brenda ish-Federatës, inferioriteti politik dhe ekonomik i disa republikave etj., janë shenjat e para të shthurjes së kësaj krijese shtetërore artificiale, që mbështetej në idetë social-utopiste të vëllazërim-bashkimit. Rezultati është shpërbërja e RFSJ-së në fillim të viteve 1990.

⁷ D. Jovanovski, *Morava-Vardar (Axios) navigation route*, Danubius, Journal of regional cooperation, 2011; <http://danube-cooperation.com/danubius/28/11/2011>. f.3.

Të gjitha republikave iu rikthye subjektiviteti ndërkombëtar, ndërsa Serbia bëhet sërish shtet kontinental. Në qarqet politike, ekonomike dhe akademike ringjallet edhe një herë ideja e ndërtimit të rrugës lundruese nëpër Moravë dhe Vardar deri në detin Egje.

Sipas të dhënave të publikuara të projekteve paraprake, kjo rrugë lundruese do të ishte një sistem i komplikuar kaskadash dhe kanalesh, që do të kishin për qëllim eliminimin e dallimeve hipsometrike prej 491,6 m. Ishte parashikuar ndërtimi i 65 kaskadave nga qyteti i Smederevës (Serbi) deri në portin e Selanikut. Rruga lundruese do të ndahej në pesë sektorë, nga të cilët më problematik del ai i ujëndarësit të Luginës së Preshevës midis Preshevës dhe Kumanovës.



Harta 2. Lugina e Preshevës në projektin e rrugës lundruese “Moravë - Vardar”

Sipas D. Perishiqit,⁸ në situatën e sotme gjeopolitike dhe ekonomike të marrëdhënieve në rajonin e Ballkanit, ndërtimi i rrugës lundruese është pothuajse i pamundur. Ajo që mund të bëhet tani është që gjatë ndërtimit të planifikuar të sistemeve infrastrukturore të rezervohet hapësira për ndërtimin e tij në të ardhmen. Ndërtimi i kanalit lundrues nëpër Luginën e Preshevës është parashikuar edhe me Planin Hapësinor të Serbisë⁹. Studimet e deritanishme nuk kanë mundësuar zgjidhje përfundimtare, por vetëm rezervimin e hapësirës për rrugë lundruese. Plani ka për qëllim sigurimin e kushteve hapësinore minimale për lundrim nëpër Moravë pas vitit 2020.

Kostoja e lartë e realizimit të këtij projekti gjigant infrastrukturor, rrethanat e sotme dhe perspektiva e zhvillimeve gjeopolitike etj., do të jenë pengesë për ndërtimin e tij edhe për një kohë të gjatë.

Projekti lundrues “Moravë - Vardar” dhe vazhdimësia e mendësisë hegjemoniste serbe për dominim në Gadishullin Ballkanik

Pasi kanë kaluar njëqind vjet nga paraqitja e idesë për hapjen e kanalit lundrues Danub – Moravë - Vardar, kjo ide shfaqet sërish nga Partia Përparimtare Serbe e cila doli fituese në zgjedhjet e fundit në Serbi. Aktualizimi i idesë megalomane për hapjen e kanalit pikërisht nga kjo parti nuk është diçka e papritur, duke ditur të kaluarën politike të njerëzve udhëheqës të kësaj partie. Tomisllav Nikoliqi dhe Aleksandër Vuçiqi ishin të dytët, përkatësisht të tretët në hierarkinë politike të Partisë Radikale Serbe të Vojisllav Sheshelit, parti e cila me përcaktime programore, por edhe me veprime konkrete kishte një orientim tepër armiqësor ndaj shqiptarëve dhe ndaj popujve tjerë joserbë në ish-Jugosllavi. Vojisllav Shesheli, në bazë të dëshmimeve të shumta të siguruara, është dërguar në Tribunalin e Hagës, ku po përballlet me një proces gjyqësor dhe me akuza për gjenocid e spastrime etnike në Kroaci dhe Bosnje e Hercegovinë. Arrestimi dhe dërgimi i Sheshelit në Hagë e lë partinë e tij pa lider dhe nxitë përçarjet brenda Partisë Radikale të cilat përfundojnë me fraksionimin e saj. Është pikërisht njeriu i dytë i partisë Tomisllav Nikoliqi, një militant partiak, me formim mesatar intelektual e profesional, por me ndikim të madh brenda anëtarësisë së partisë, i cili vendosi të shkëputet nga Partia Radikale Serbe dhe të formojë një subjekt të ri politik - Partinë Përparimtare Serbe (Srpska Napredna Stranka).

⁸, *Srpska žila kucavica*, NIN, nr. 2712, 19.XII.2002, Beograd.

⁹ Po aty.

Tomisllav Nikoliqi e Aleksandër Vuçiqi, duke parë konjunkturën aktuale politike në regjion dhe Evropë, si dhe etjen e madhe për të fituar pushtetin, provojnë së paku deklartivisht të shkëputen nga e kaluara politike, duke proklamuar proevropianizmin dhe përqafimin e vlerave demokratike përrëndimore. Mirëpo këtë transformin kozmetik dhe orientim kinse properëndimor e demaskojnë disa nga pikat kyçe të programit të tyre partiak në fushatën e fundit zgjedhore në të cilën ata dolën fitues. Njëra ndër to është edhe ideja për ndërtimin e kanalit lundrues “Moravë - Vardar”, e cila ide ka një histori të gjatë prej më se një shekulli. Edhe pse elaborimi i idesë fokusohet në benefitet ekonomike e mjedisore që do t’i sillte shtetit të Serbisë, objektivi kryesor është faktorizimi i Serbisë si fuqi ballkanike me aspirata hegjemoniste ndaj shteteve dhe popujve tjerë. Prandaj kjo ide duhet parë si vazhdimësi e mendësisë së vjetër hegjemoniste të pjesës dërmuese të korpusit politik, intelektual, akademik i cili vazhdon ta ngulfatë prosperitetin shoqëror në Serbinë e mileniumit të ri.

Sipas proklamuesve të idesë, me hapjen e kanalit “Moravë - Vardar” Serbia do të zgjidhte njëkohësisht dy probleme të mëdha mjedisore: thatësitat dhe vërshimet. Hapja e kanalit dhe ngritja e argjinaturave do të mbronte 70.000 deri 80.000 ha të tokës më cilësore bujqësore. Ndërsa, në anën tjetër, do të mundësohej ujitja e po aq hektarëve gjatë periudhës së thatë. Prodhimtaria bujqësore do të trefishohej dhe dobittë do të ishin edhe në sferën e prodhimit të energjisë, meqë do të punonin 5 deri 7 hidrocentrale me fuqi të instaluar ndërmjet 300 deri 400 mgw energji elektrike. Në aspektin gjeokomunikativ, rruga lundruese nga Evropa Veriore deri në Detin Egje do të ishte më e shkurt për 1200 kilometra. Këto janë disa nga argumentet “pro” ndërtimit të kanalit të dhëna nga grupi i ekspertëve të Ministrisë së Planifikimit Hapësinor të Serbisë në krye me vetë ministrin Milan Baçeviq (i lindur në Kosovë), ish-profesorin në Departamentin e Gjeografisë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore në Universitetin e Prishtinës gjatë viteve të 80-ta. Megjithatë, gjatë argumentimit asnjehërë nuk mbetën pa u përmendur mundësitë e valorizimit gjeopolitik e gjeostrategjik të pozitës natyrore të Serbisë në kontekstin e Gadishullit Ballkanik, por edhe më gjerë. Kështu, në një prononcim për gazetën serbe “Politika” të datës 27.1.2013, tradicionalisht të afërt me pushtetin, ministri Baçeviq thotë: “Përmes realizimit të këtij projekti Serbia do të bëhej një faktor i rëndësishëm në të gjitha lidhjet komunikative në relacionet ndërmjet jugut të Evropës dhe në pjesën e mesme dhe përrëndimore të kontinentit. Me këtë sistem

lundrues i tërë shteti do të lidhej me sistemin Rajna – Majna - Danub, që është më i rëndësishmi në Evropë, por edhe me sistemet lundruese të Ronës e Senës në Francë, si dhe Odrës e Visllës në Poloni e Çeki”. Me ndërtimin e këtij kanali, gjithnjë sipas M. Baçeviqit, do të ndryshohej pozita gjeopolitike dhe statusi ndërkombëtar i Serbisë.¹⁰ Baçeviq nuk ngurron të shfaq haptas aspiratat hegjemoniste, kur thotë se Serbia, nëse ndërtohet kanali mund të bëhet një superfuqi evropiane, me çka ajo do të shpaguante pozitën shumë të volitshme gjeopolitike.¹¹

Në qarqet politike, intelektuale dhe analitike në Serbi, të tillë që janë të afërt me pushtetin dhe e kundërta, shfaqen mendimet pro dhe kundër idesë për ndërtimin e kanalit lundrues. Kështu, Zhivadin Joviçiq, profesor në Fakultetin e Gjeografisë të Universitetit të Beogradit, për portalin e gazetës së njohur serbe “Danas” arsyeton idenë për ndërtimin e kanalit, duke e vlerësuar atë si vazhdimësi të ideve vizionare të gjeografit serb Jovan Cvijiq (1865-1927), i cili në fillim të shekullit XX elaboroi idenë mbi mundësinë e lidhjes së Moravës me Vardarin dhe daljen e Serbisë në portin e Selanikut. Jovan Cvijiqi ishte një shkencëtar në shërbim të politikës dhe ishte një ndër ideatorët dhe eksponentët më të mëdhenj të aspiratave hegjemoniste serbe në Gadishullin Ballkanik, i cili idenë për ndërtimin e kanalit e shpjegon në artikullin e tij të botuar me titull: “*Dalja e Serbisë në detin Adriatik*” (“Izlazak Srbije na Jadransko more”).¹² Profesi Joviçiq në artikullin e tij “*Kanal Dunav - Solun nije fantazija*”,¹³ të shkruar për gazetën “Danas”, argumentet “pro” ndërtimit të kanalit provon t’i shpjegojë në kontekstin aktual gjeopolitik në Evropë në përgjithësi e sidomos në Gadishullin Ballkanik dhe aspiratat e Serbisë për integrim në Bashkësinë Evropiane. Sipas tij, realizimi i kësaj ideje do të kishte rëndësi shumë të madhe për proceset integruuese të Unionit, për shkak të problemeve dhe hamendjeve të shumta, siç janë kriza ekonomike botërore, raportet ndërmjet shteteve anëtare më të zhvilluara dhe atyre më pak të zhvilluara brenda BE-së, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me pranimin e shteteve të reja anëtare, e sidomos përcaktimin e datës për fillimin e bisedimeve të Serbisë për aderim në Bashkësinë Evropiane.¹⁴ Në këtë kontekst profesori Joviçiq e sheh ndërtimin e

¹⁰ <http://www.politika.rs/rubrike/Tema-nedelje/Plovni-put-od-Beograda-do-Soluna/Brodom-izmedju-sna-i-jave.lt.html>

¹¹ <http://bif.rs/2013/10/pocinju-zvanicni-razgovori-o-izgradnji-kanala-dunav-morava-vardar>

¹² J. Cvijić, “Izlazak Srbije na Jadransko more”, *Glasnik srpskog geografskog društva*, God.1, br. 2, Beograd, 1912, ff. 192-205.

¹³ http://www.danas.rs/danasrs/dijalog/kanal_dunav__solun_nije_fantazija

¹⁴ Po aty.

kanalit si argument të fuqijëshëm, i cili do t'i mundësonte Serbisë një rrugëtim më të shpejtë drejt anëtarësimit të plotë në BE, dhe përsëri shpjegimin e mbështet në pozitën e volitshme gjeostrategjike dhe territorin-korridor me karakter ndërkontinental që ka Serbia, me çka ajo në mënyrë më energjike do t'i prezantohej Evropës dhe botës.

Brenda qarqeve intelektuale, politike dhe analitike në Serbi hasen edhe qasje mjaft pragmatike e realiste kur bëhet fjalë për idenë e ndërtimit të Kanalit Moravë - Vardar. Mahmud Bushatlija, këshilltar për investime dhe analist ekonomik, në prononcimin e tij për gazetën serbe "Politika" të datës 27.1.2013, me të drejtë konstaton që ideja për ndërtimin e kanalit është e tejkaluar dhe se në konjunkturën aktuale gjeopolitike dhe ekonomike është një projekt i pareaizueshëm. Sipas tij, kjo ide ka qenë grandioze për rrethanat gjeopolitike të fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, atëherë edhe kur është promovuar për herë të parë. Austrohungarezët e kanë përkrahur këtë ide për të penguar dominimin turk për hyrjen në Detin e Zi dhe dominimin rus përmes Gadishullit të Krimesë.¹⁵ Gjithashtu, edhe në aspektin teknologjik kjo ide është e tjekealuar, meqë kanali lundruer nuk do të kishte kapacitet t'i pranojë anijet bashkëkohore lumore-detare dhe ngarkesat e mëdha.

Përpos rrethanave tjera gjeopolitike që dallojnë nga ato të fillimit të shekullit XX, ndërtimi i kanalit lundruer nuk është rentabil as në aspektin ekonomik. Edhe pse projekti është ende në fazën preliminare dhe pa studim të detajizuar të fizibilitetit ekonomik, social e mjedisor, analistët ekonomikë parashohin që ndërtimi i kanalit do të kushtonte prej 15 deri 20 miliard dollarë. Shumë njohës të rrethanave ekonomike në Serbi tërheqin vërejtjen që ndërtimi i kanalit do ta bënte Serbinë pa nevojë një "robërëshë të borxheve" (dužnicko ropstvo) me pasoja ekonomike afatgjata. Miladin Kovačevići, bashkëpunëtor në revistën "Analizat makroekonomike", tërheq vërejtjen se Serbia nuk guxon të fillojë këso lloj projektesh të shtrenjta, sepse për shkak të stërngarkimit me borxhe mund të përfetojë skenarin grek. Një tjetër njohës i mirë i rrethanave ekonomike në Serbi, profesori Lubodrag Saviq, parashih një tjetër rrezik që mund të sjellë ndërtimi i këtij kanali. Ekziston mundësia që kanali Moravë - Vardar të përfetojë fatin historik të hekurudhës Beograd - Tivar, me të cilën gjatë ekzistimit të ish-RSFJ-së Serbia ka realizuar kontaktin me detin (1975). Kur ishte ndërtuar kjo hekurudhë pretendohet se përmes saj do të zhvillohej

¹⁵ <http://www.politika.rs/rubrike/Tema-nedelje/Plovni-put-od-Beograda-do-Soluna/Kanalom-nema-ko-da-plovi.lt.html>

transporti nga Hungaria, Rumania, Çekia dhe gjysma e Evropës. Shkatërrimi i Jugosllavisë ka bërë që porti i Tivarit sot të jetë i zbrazët, hekurudha të mos shfrytëzohet, ndërkaq, duke marrë parasysh terrenin e vështirë nëpër të cilin kalon ajo, dukshëm më e lartë është kostoja për mirëmbajtje se sa përfitimet.

Në rastin e projektit lundrues Moravë - Vardar situata është e ngjashme, bile edhe më delikate, meqe duhet një marrëveshje paraprake ndërshtetërore ndërmjet Serbisë, Maqedonisë dhe Greqisë nëpër të cilat shtete do të realizohej ky system lundrues. Në kohën kur BE-ja, Greqia dhe Maqedonia janë në krizë, vështirë se mund të paramendohet një marrëveshje tripalëshe ose edhe katërpalëshe (me Bashkësinë Evropiane) për financimin e përbashkët të këtij projekti.

Përfundim

Serbia me pozitë natyrore kontinentale shumë herët ka shprehur ambiciet për t'u zgjeruar territorialisht dhe për të dalë në det. Të gjitha luftërat e zhvilluara në Gadishullin Ballkanik gjatë dy shekujve të kaluar kanë qenë të frymëzuara nga aspiratat hegjemoniste dhe ekspansioniste serbe për pushtim teritosh, dalje në det dhe nënshtrim të popujve joserbë. Këto luftëra janë përcjellë me spastrime etnike e gjenocid, ndërsa më së shumti e ka pësuar populli shqiptar, i cili për shkak të karakteristikave gjeostrategjike të truallit gjeoetnik ka qenë në shënjestër të këtyre pushtimeve. Përveç se me luftëra, qëllimet e veta hegjemoniste dhe ekspansioniste Serbia ka provuar t'i realizojë edhe përmes projekteve gjigante infrastrukturore si hekurudha Beograd - Tivar dhe së fundi ideja e re (e vjetër) e hapjes së kanalit lundrues Danub – Moravë – Vardar - Porti i Selanikut. Edhe kjo projekt-ide, sikurse shumica e projekteve të tjera parashihet të kalojë nëpër një pjesë të natyrshme të trungut gjeoetnik shqiptar, siç është Lugina e Preshevës. Edhe pse në rrethanat aktuale gjeopolitike dhe ekonomike në të cilat ndodhet Gadishulli Ballkanik dhe e gjithë Evropa, një projekt i tillë është i vështirë për t'u realizuar, aktualizimi i kësaj ideje nga qarqet politike, ekonomike dhe shkencore, siç është rasti me promovimin e T. Nikoliqit, kryetar i Partisë Përparimtare Serbe (fraksion i Partisë Radikale Serbe), që fitoi zgjedhjet e fundit presidenciale dhe parlamentare në Serbi, me qëndrime të shprehura antishqiptare tregon, nga njëra anë, vazhdimësinë e ambicieve të Serbisë për dalje në det dhe, nga ana tjetër, rëndësinë strategjike të Luginës së Preshevës si segment kyç i kësaj projekt-rruge lundruese.

Arsim EJUPI, Prishtinë

PRESHEVA VALLEY AND GEOPOLITICS OF FLOATING CHANNEL “MORAVA – VARDAR”

Summary

Serbia's continuous ambitions for territorial expansion have been realized through conquest and subjugation of peoples and territories from different Balkan countries. These activities were always led by the permanent goal, to reach the sea. Serbs have seen the continental geographical position as the main obstacle for development and implementation of expansionist goals. Through involvement in wars or geopolitical artificial creatures like the Yugoslav Kingdom, the former Yugoslavia, Union of Serbia and Montenegro, Serbia has repeatedly managed to expand territorially and to reach the sea. But, although as a part of the former Yugoslavia, with a long coastline, Serbia never managed to evaluate it economically and politically, because it has never reached directly the sea. In these conditions, Serbia has tried to achieve its connections with the sea through infrastructure development, as Belgrade-Bar railway. Another giant infrastructure project that was never realized is floating channel "Morava-Vardar". Presheva Valley, with its low watershed, lies between these two valleys, so it was planned to build a canal sector through which Serbia would be able to reach the Aegean Sea.

Key words: Floating channel, Presheva Valley, Serbia, geopolitical, sea, position.

Literatura:

- MIHAJLO KOSTIĆ, *Vranjsko-Bujanovačka Kotlina*, Vranjski Glasnik br. XIV, Vranje, 1976.
- JOVAN MARKOVIĆ, *Geografske Oblasti SFRJ*, Univerzitet u Beogradu, Beograd, 1966.
- Projekat: *Izrada lokalno ekonomike strategije razvoja opštine Preševo*, Institut za razvoj malih i srednjihpreduzeća, Beograd-Preševo, 2005-2006.
- IBRAHIM RAMADANI, *Kosova Lindore*, Buletini i FSHMN-ës, Prishtinë, 1998.
- MILORAD VASOVIĆ, *Gornja Jablanica-Geografska svojstva*, Beograd, 1998.
- MIHAJLO KOSTIĆ, *Preševska kotlina – društveno geografska studija*, Vranjski Glasnik br.V, Vranje, 1969.
- DOBRIVOJE JOVANOVSKE, *Morava-Vardar (Axios) navigation route*, Danubius, Journal of regional cooperation, 2011.
- NIN *Srpska žila kucavica*, nr. 2712. 19.XII.2002. Beograd, 2002.
- JOVAN CVIJIC, “Izlazak Srbije na Jadransko more”, *Glasnik srpskog geografskog društva*, God.1, br. 2, Beograd, 1912.
- <http://www.politika.rs/rubrike/Tema-nedelje/Plovni-put-od-Beograda-do-Soluna/Brodom- izmedju-sna-i-jave.lt.html>
- <http://bif.rs/2013/10/pocinju-zvanicni-razgovori-o-izgradnji-kanala-dunav-morava-vardar>
- http://www.danas.rs/danasrs/dijalog/kanal_dunav_solun_nije_fantazija
- <http://www.politika.rs/rubrike/Tema-nedelje/Plovni-put-od-Beograda-do-Soluna/Kanalom-nema-ko- da-plovi.lt.html>

Ardian GOLA, Prishtinë

DIKOTOMIA EPISTEMOLOGJIKE SHKENCË - PHILOSOPHY

KDU 1:2

Abstrakt

Punimi nuk zhvillon ndonjë argument sistematik dhe nuk trajton përmtësisht evoluimin e trajtave njohëse që njeriu i ka zhvilluar përgjatë historisë. Ai paraqet në mënyrë skematike evoluimin e këtyre trajtave dhe mëton të shkoqisë disa nga aspektet problemore të tyre. Miti, legjenda, religjioni ishin ndër trajtat e para “njohëse” të njeriut përmes të cilave ai njihte mjedisin rrethues duke ndërtuar njëkohësisht raport të pandashëm me natyrën. Me paraqitjen e filozofisë në Greqinë antike, mendja shfronësoi trajtat iracionale të njohjes së botës. Më pas ajo filloi të shkëputet nga spekulimi dhe metafizika për t’u orientuar drejt empirizmit dhe pozitivizmit. Me lindjen e shkencës u relativizua roli njohës i filozofisë, duke ndodhur kështu shfronësimi tjetër epistemologjik. Me gjithë rivalitetin ndërmjet tyre, filozofia dhe shkenca vazhdojnë rrugëtimin e mbështetur në mendjen, “arroganca totalitare” e së cilës zhveshi nga autoriteti mitin dhe religjionin. Ky rrugëtim njohës jo vetëm që lë pa përgjigje, por edhe i shton kompleksitetin sfidës së vjetër filozofike: nëse këto trajta të shumëllojshme dijesh zhvillohen përmes një linje evolucioni të njëtrajtshëm progresiv duke na zbuluar shkallëshkallshmërisht njohjen gjithnjë e më të saktë për botën, apo janë vetëm trajta dijesh kulturalisht të kushtëzuara, të cilat përballë një bote të paarrtshme epistemologjiksht kanë për funksion vetëm që të mundësojnë akomodimin mjedisor të njeriut?

Fjalët kyçe: mit, religjion, filozofi, shkencë, njohje, simbolizim, subjektivitet, objektivitet, esencë, aparençë.

Hyrje

Njëmendësia objektive në mënyrë të vazhdueshme ka provokuar shpirtin njerëzor. Nevoja psikologjike dhe shpirtërore e njeriut që të kuptimësojë të pakuptueshmen, të njohë të panjohshmen, të shpjegojë të pashpjegueshmen, të interpretojë të painterpretueshmen etj. e ka shtyrë atë që të simbolizojë përfytyrimet e tij për mjedisin në mënyrat nga më të ndryshmet. Ky “Animal Symbolicum”, siç parapëlqente Cassirer ta quante njeriun,¹ asnjëherë nuk ka rreshtur së simbolizuari

¹ Megjithëse elementin e racionalitetit e konsideronte tipar të qenësishëm të veprimtarisë njerëzore, përkufizimi “Animal Rationale” për Cassirer-in nuk gjithëpërfshinte tërë trajtat e jetës kulturore në tërë pasurinë dhe variacionet e saj. Për këtë arsye edhe e propozoi përkufizimin “Animal Symbolicum”. Për të

mitologjikisht, e më pas edhe konceptualisht dhe shkencërisht. Shtytja për këto “simbolizime të shumëtrajtshme” ka marrë forma të ndryshme të manifestimit duke filluar me mitologjinë, religjionin, artin, filozofinë, shkencën etj. Këto simbolizime të orientuara mitologjikisht, ritualisht, estetikisht, konceptualisht dhe eksperimentalisht kanë pësuar metamorfoza të shumanshme në procesin e komplikuar evolutiv të shpjegimit të botës, ashtu sikurse edhe të pozicionit kozmologjik të njeriut.

Nocionin *epistemologji* nuk e kam përdorur prerazi në kuptimin e teorisë së njohjes, siç kuptohet tradicionalisht në filozofi. Kuptimin e këtij nocioni, siç e kam përdorur edhe në titull, e kam shtrirë në tërë domenin e aftësisë *simbolizuese* të njeriut që me anë të simboleve të ndërtojë diskurse dhe të prodhojë sisteme të dijes përmes të cilave ai e *njeh* botën. Në këtë kuptim edhe miti përfshihet si sistem i veçantë simbolik, i cili edhe për shkak të ndikimit në zhvillimet e hershme të filozofisë, e madje edhe shkencës, mund të rehabilitohet përbrenda vetë fushës së epistemologjisë.

Para se të trajtojmë dikotominë epistemologjike shkencë – metafizikë, në fillim shkurtimisht do të analizojmë ndërlidhjen dhe varësinë ndërmjet mitit dhe filozofisë dhe mënyrës se si i pari ka vazhduar me praninë e heshtur në refleksionet e të dytes. Punimi nuk zhvillon ndonjë argument sistematik dhe nuk trajton përimtësisht evoluimin e trajtave njohëse që njeriu i ka zhvilluar përgjatë historisë. Ai paraqet në mënyrë skematike evoluimin e këtyre trajtave dhe mëton të shkoqisë disa nga aspektet problemore të tyre, si ndërthurjen e mitit me filozofinë antike, raportin e kësaj të fundit me teologjinë mesjetare, raportin e komplikuar të filozofisë me shkencën, karakterin larpurlartist të së parës dhe atë utilitarist të së dytës, raportin e subjektivitetit me objektivitetin, etj.

Nga amalgama mit – filozofi deri te teologjizimi mesjetar i metafizikës greke

Simbolizimet mitologjike për burim kishin “frikën” nga e panjohura, kurse ato konceptuale kishin për burim “habinë” filozofike. Simbolizimet konceptuale ishin refleksione të pastra mendore pa

“Sistemi simbolik” përmbyll “Çarkun funksional” të përbërë nga “Sistemi receptor” dhe “Sistemi efektor” Më gjerësisht shih: Cassirer, “*An Essay on Man. An Introduction to a Philosophy of Human Culture*”; fq. 42 – 44.

qëllime utilitare në përshkrimin e njëmendësisë, gjë që nuk ishte karakteristikë e qasjeve mitologjike dhe shkencore. Ndërkohë që për të parat, karakteri utilitar i simbolizimit konsistonte në “mbajtjen nën fre” të forcave të mbinatyrshe (miti dhe religjioni), për të dytat, karakteri utilitar manifestohet në tendencat e intensifikuarra posesive të njeriut modern (shkenca e shfrytëzuar nga teknologjia). Zhvendosja e shkallëshkallshme e qasjes mitike ndaj objektivitetit nga skena e interpretimeve të pranueshme shoqërisht, kulturalisht dhe ideologjikisht pasoi me përforcimin e qasjes së pastër racionale ndaj njëmendësisë, duke marrë primatin e interpretimit të paanshëm “shkencor” të shkarkuar nga ngarkesat e ndryshme mitologjike (e më vonë edhe nga “reliktet e shterpësisë” së abstraksionit larpurlartist).

Megjithatë, shkëputja e racionalitetit prej autoritetit mitologjik ishte një proces tejet i komplikuar evolutiv. Kështu, në vendlindjen dhe origjinën e mendimit filozofik, në antikitetin grek, refleksioni fillestar filozofik kishte ngjyrimë dhe ngarkesa mitologjike, përfshirë këtu si filozofinë parasokratike, ashtu edhe atë passokratike. Megjithëse në trajta poetike, Homeri dhe Hesiodi paraqesin një fillesë të re të pavarësismit mendor prej autoritetit mitologjik², duke i bërë perënditë objekt të kritikës racionale. Gërshetimi i të menduarit me referime mitologjike dhe racionale ekzemplifikohet, para se gjithash, me lajmëtarët e parë të filozofisë greke – *shtatë të urtit*,³ të cilët më shumë i takonin botës patriarkale dhe traditës popullore të saj se sa qytetit dhe kulturës qytetare të Greqisë së Vjetër.⁴ Mendimi kozmologjik i filozofit parasokratik Anaksimandrit është po ashtu i mbërthyer përbrenda paradigmës mitologjike të kohës. E tërë qenia që zanafillon prej praelementit të pafundmë dhe të padiferencuar të *Apeironit* i nënshtrohet *Dicë*-së, perëndeshës së drejtësisë.⁵ Gjithashtu

² STUMPF, Samuel Enoch (2000), *Filozofia – historia dhe problemet*, Toena, Tiranë, f. 4.

³ “Shtatë të urtit” ishte epiteti i dhënë nga tradita greke shtatë njerëzve të ditur të Greqisë, të cilët ishin filozofë, burrështetas dhe ligjvënës dhe të cilët shqueshin me diturinë dhe mençurinë e tyre. Këta ishin: *Solon of Athens* - "Nothing in excess"; *Chilon of Sparta* - "Know thyself"; *Thales of Miletus* - "To bring surety brings ruin"; *Bias of Priene* - "Too many workers spoil the work"; *Cleobulus of Lindos* - "Moderation is the chief good"; *Pittacus of Mitylene* - "Know thine opportunity"; *Periander of Corinth* - "Forethought in all things". Cituar sipas: <http://www.mlahanas.de/Greeks/LX/SevenSagesOfGreece.html>

⁴ Mbase kjo mund të jetë edhe arsyeja pse këta nuk figurojnë në fillimin e historisë së filozofisë greke.

⁵ “Nga ai burim që lindin sendet, po atje kthehen kur shkatërrohen sipas domosdoshmërisë, sepse ato vuajnë dënimin dhe riparojnë njëri-tjetrin për

edhe në kozmologjinë heraklitiane gjejmë referenca mitologjike. Në njërën prej fragmenteve të përzgjedhura të tij, Herakliti shprehej: “Dielli nuk e tejkalon masën e tij. Po qe se e bën, Erinijet [Erinyes – Furiet], përkrahëset e drejtësisë do ta marrin vesh”.⁶ Madje edhe në korpusin filozofik të Platonit, i njohur si një ndër racionalistët dhe idealistët më të përkorë të historisë së filozofisë perëndimore, hasim në referime mitologjike. Në momente të caktuara të zhvillimit të mendimit të tij filozofik del në pah, siç do të shprehej Hegeli në veprën e tij për Platonin, “përfaqësimi i thjeshtë dhe në vend të procesit konceptual kemi mitet, lëvizjet përfytyruese të formuara vetë, ose rrëfimet e nxjerra nga përfaqësimi shqisor”.⁷ Russell bënte kategorizimin e dy tendencave të mendësisë greke: njëra ishte pasionante, religjioze, mistike, e tjetërbotshë, tjetra gazmore, empirike, racionaliste, e interesuar për njohjen e fakteve të ndryshme.⁸ Tendencës së fundit, gjithnjë sipas Russelit, i takonin sa Herodoti, aq edhe filozofët e hershëm jonianë e deri-diku edhe Aristoteli. Megjithatë, shkëlqimi poetik i stolisjeve mitologjike të mendimit racional është dukshëm më i vogël te Aristoteli, dominimi i dukshëm i racionalitetit në mendimin e të cilit i mundëson që t’i jep kuptim dhe t’i sistematizojë në mënyrë tejet kritike të gjitha idetë e paraardhësve të tij.

Ndonëse i spastruar nga devijimet mitike, refleksioni i pastër mendor vazhdon të mbetet në shërbim dhe funksion të vetvetes, si një “larpurlartizëm” i pastër reflektiv pa ndikime në njëmendësinë objektive. Në trajtën e spekulacionit të pastër filozofik, kjo qasje “shkencore” ndaj objektivitetit, ndonëse ende në fazën embrionale, fillon që gradualisht të ridimensionohet nën ndikimin e filozofisë empiriciste. Një periudhë jo e vogël historike e ndërpret atë që filozofët antikë e filluan. Thyerjen e parë “larpurlartizmi” filozofik e përjetoi me Mesjetën, filozofët reprezentativë të së cilës kishin preokupim kryesor arsyetimin religjioz, përkatësisht argumentimin e besimit përmes arsyes. Duke e ndërthurur elementin fetar-dogmatik në arsyetimet filozofike, filozofët mesjetarë shfrytëzonin traditën e pasur filozofike të antikitetit grek për arsyetimin e të vërtetave

padrejtësitë e tyre sipas rregullit të kohës”; Stumpf, *Filozofia, Historia dhe problemet* f. 7.

⁶ <http://library.flawlesslogic.com/heracl.htm> (qasur me 13 shkurt 2012)

⁷ HEGEL, G. W. F. (2004) *Platoni*, Dritan, Tiranë, f. 74.

⁸ RUSSELL, Bertrand (2004) *Një histori e filozofisë perëndimore*, Vëll. I., Milosau, Tiranë, f. 43.

fetare. “Viktimë” kryesore e këtij diskursi teologjik ishte Aristoteli, filozofia e të cilit u teologjizua, përkatësisht u krishterizua. Edhe Heidegger, duke përpunuar mendimin për karakterin teologjik të ontologjisë në njërën prej leksioneve të tij, e pohon transformimin teologjik kishtar të metafizikës greke.⁹ Në skolastikën mesjetare, mendimi i pastër racional iu nënshtrua dhe u vu në funksion të vërtetave religjioze, gjegjësisht dogmave të kohës. Megjithëse filozofia u bë shërbëtore e teologjisë, “skolastikët përpunuan një gjuhë filozofike, konceptet e së cilës janë në mënyrë të shkëlqyer të sakta dhe të thella”, e madje “në krahasim me këtë gjuhë, mjetet shprehëse të shumë filozofëve modernë duken të trasha dhe të thjeshtëzuara”.¹⁰

Ripozicionimi epistemologjik i filozofisë përgjatë fuqizimit të shkencës

Riorientimi shkencor, fillimisht filozofik, si kriter të së vërtetës vendosi verifikimin rigorozisht empirik me mbështetje ekskluzive në fakticitetin empirik. Në këtë mënyrë hudhen themelet e para të shkencave ekzakte. Kështu, rrugëtimet epistemologjike të filozofisë dhe shkencës pavarësohen, paralelizohen por edhe komplementarizohen me gjithë rivalitetin e nëndheshëm të tyre si dhe arrogancën e ndërsjelltë me pretendime superioriteti që shoqëronin këtë rrugëtim. Në fillesat e pavarësimit të shkencës ndaj filozofisë, shkenca paraqitet jo vetëm me pretendime universaliste po edhe me ambicie të superioritetit epistemologjik në raport me filozofinë. Karakteri universal disiplinuar i saj, premiset dhe metodologjia vireshin në diskutim vetëm nga skepticizmi filozofik. Shkenca, siç shprehej Roger Scruton duke interpretuar kontekstin shkencor-filozofik që provokoi paraqitjen e filozofisë kritike të Kantit, paraqitej si një tablo unanimiteti dhe objektiviteti me të cilën nuk mund të hahej asnjë sistem metafizik.¹¹ Sipas Scrutonit, ky fakt i rrezikoi filozofisë edhe kontributin e saj për fondin e njohjes njerëzore në të ardhmen, duke e vënë në mëdyshje madje edhe vetë mundësinë e metafizikës si të tillë.¹² Kjo mëdyshje u rëndua dukshëm sidomos me skepticizmin radikal të Hume-it,¹³ kundërefekti i të cilit ndërlidhej me kthesën e madhe të rrugëtimit

⁹ HEIDEGGER, Martin (2003) *Leksione dhe konferenca*, Plejad, Tiranë, f. 63.

¹⁰ HERSH, Zhanë *Habia filozofike*, Dituria, Tiranë, f. 73.

¹¹ SCRUTON, Roger (2000) *Histori e shkurtër e filozofisë moderne*, Besa, Tiranë, f. 148.

¹² *Ibid.*, f. 149.

¹³ *Ibid.*, f. 149.

historik të metafizikës, gjegjësisht me zgjimin e Kantit nga “përgjumja dogmatike”.

Duke e diferencuar prej trajtave të tjera njohëse, Bertrand Russell filozofinë e pozicionon në mes teologjisë dhe shkencës. “Si teologjia, ajo përbëhet prej meditimesh për probleme që dituria e njeriut deri më sot i ka konsideruar të pavërtetuara; por si shkencë ajo i bën apel arsyes njerëzore më shumë se autoritetit, qoftë ky i lidhur me traditën apo me manifestimin e Zotit. E tërë dituria e saktë i takon shkencës; e gjithë dogma që kapërcen diturinë e saktë i përket teologjisë. Por mes teologjisë dhe shkencës është një Tokë e Askujt, e hapur për sulme nga të dy krahët; kjo Tokë e Askujt është filozofia”.¹⁴ Në të njëjtën linjë të diferencimit epistemologjik, Heideggeri i atribuon rrugë esencialisht të ndryshme gnoseologjike vrojtimit shkencor prej refleksionit filozofik.¹⁵ Madje ai shkon edhe më tutje, duke i atribuar shkencës edhe fusha krejtësisht tjera të studimit. “Fushat livruese të shkencave janë krejtësisht të ndryshme” – shprehet Heidegger në leksionin inaugurues në Universitetin e Freiburg-ut të mbajtur në vitin 1929.¹⁶ Ai mohon çdo mundësi të vlerësimit të fuqisë njohëse të filozofisë nga perspektiva shkencore. “Filozofia”, thotë Heidegger, “kurrë nuk mund të matet në bazë të standardit të idesë së shkencës” për të radikalizuar përfundimisht mendimin e tij me konstatimin se “kurrfarë mase e rigorozitetit shkencor s’ia del dot mbanë seriozitetit të metafizikës”.¹⁷ Në *Tractatus Logico – Philosophicus*, Wittgenstein është munduar që të zgjidhë këtë nyje gordiane, duke spikatur fillimisht mohimin kategorik të çfarëdo ndërlidhjeje substanciale ndërmjet filozofisë dhe shkencave natyrore, e më pas ndarjes epistemologjike të roleve të tyre. Në propozicionin 4.111 të kësaj vepre, Wittgenstein shprehet qartë: “filozofia nuk është një prej shkencave natyrore”.¹⁸ Sipas tij, “shkenca duhet studiuar faktet, kurse filozofisë i takon të sqarojë kuptimin e termave me anën e pastrimit të gjuhës sonë dhe zhdukjes së enigmave gjuhësore. Tërësia e propozicioneve të vërteta (pra, fakteve – A.G.) është gjithësia e shkencës natyrore (ose korpusi i përgjithshëm i shkencave natyrore)... [ndërsa]... Qëllimi i filozofisë është sqarimi logjik i

¹⁴ RUSSELL, Bertrand (2004) *Një histori e filozofisë perëndimore*, Vëll. I., Milosau, Tiranë, f. 3.

¹⁵ HEIDEGGER, Martin (2003) *Leksione dhe konferenca*, Plejad, Tiranë, f. 72.

¹⁶ *Ibid.*, f. 72.

¹⁷ *Ibid.*, f. 92.

¹⁸ WITTGENSTEIN, Ludwig (2000) *Tractatus Logico – Philosophicus*, Instituti i Filozofisë – Sociologjisë, Prishtinë, f. 55.

mendimeve. Filozofia nuk është doktrinë, por veprimtari. Një vepër filozofike qenësisht përbëhet prej shtjellimeve. Filozofia nuk rezulton në “propozicione filozofike”, por në të sqaruarit e propozicioneve. Filozofia duhet t’i bëjë të qarta dhe t’i përkufizojë saktë mendimet, që, përndryshe, janë pothuajse të turbullta dhe të vagëlluara”.¹⁹

Progresi i pandalshëm shkencor ndikoi në ripozicionimin (post)modern të filozofisë, gjë që imponoi pashmangshëm kontestimin radikal dhe rivlerësimin e plotë të epistemave të kohës. Filozofia vazhdoi spekulimet me ide dhe koncepte të karakterit abstrakt si dhe me shtrimin e problemeve duke shpërfillur nga fokusi i saj zgjidhjen; nga ana tjetër, përmes operimit me nocione ekzakte dhe duke u mbështetur në konstatime empirikisht dhe eksperimentalisht të verifikueshme, pra në induksion, shkenca nuk ndalej së korruri suksese marramendëse në fushën e njohjes, përkatësisht dijes njerëzore. Kështu, me të arriturat e saj, vlefshmëria e të cilave fundamentohet në fakte eksperimentalisht të verifikuara, shkenca ka kontribuar në zgjimin e filozofisë nga letargjia, duke i ndihmuar kështu në tejkalimin e rubikonit rreth të cilit sillej si në rreth vicioz. Këtë borxh filozofia ia ka kthyer shkencës duke i marrë zbulimet e saj nën optikën e ‘racionalizmit kritik’ (Karl Popperi) dhe duke ia tërhequr vërejtjen pjesëtarëve dhe ithtarëve të saj për ‘euforinë fatkeqe’ (Herbert Marcuse) që mund të sjellë “fetishizimi” i saj.

A priorizmi sintetik si tejkalim i vështirësive epistemologjike të metafizikës

Ishte klasiku i shquar i filozofisë idealiste gjermane, Imanuel Kanti ai i cili u mundua t’i jep fund problemit të dikotomisë epistemologjike metafizikë - shkencë. Kanti përpiquej që t’i lehtësonte mendjes përcaktimin në mënyrë të plotë dhe të sigurt vëllimin dhe kufijtë e përdorimit të saj jashtëpërvojësor²⁰. Përgjatë tërë kursit të tij filozofik të *kritikës së mendjes* ai u përpoq të argumentonte mundësinë e ekzistimit të metafizikës si shkencë.²¹ Ai nuk mjaftohej me ekzistimin e metafizikës vetëm si *metaphysica natyralis*, ngase kjo nuk ofron kurrfarë sigurie epistemologjike për subjektin. Avancimi i statusit epistemologjik të metafizikës prej *metaphysica natyralis* në *shkencë* ka mbetur peng i mosdallimit të *grykimeve analitike* dhe

¹⁹ *Ibid.*, f. 55.

²⁰ KANT, Immanuel (2002) *Kritika e mendjes së kulluar*, Libri shkollor, Prishtinë, f. 40.

²¹ *Ibid.*, f. 40.

sintetike. “Se a do të mbetet apo do të falimentojë metafizika, varet nga zgjidhja e kësaj detyre” – shprehet kategorikisht Kanti.²² Duke iu referuar shkencave ekzakte si modele të sakta epistemologjike, refleksionin e tij filozofik Kanti e përqendroi në *a priorizimin* e njohjeve tona, gjegjësisht në gjetjen e këtyre *gjykimeve sintetike a priori*, si trajtë e vetme e arritjes së sigurisë epistemologjike. Sipas Kantit njohja shkencore është *a posteriori*; ajo lind nga përvoja konkrete dhe bazohet në të. Prandaj shkenca nuk merret me të vërtetat e domosdoshme, por me çështjet e faktit konkret. Megjithatë ajo mbështet në disa aksioma dhe parime universale, të cilat, për shkak se e vërteta e tyre mendohet se është në pikënisje të çdo hulumtimi empirik, nuk mund të provohen vetë në mënyrë empirike. Prandaj këto aksioma janë *a priori*, dhe ndërsa disa syresh janë analitike, disa të tjera janë sintetike, duke thënë diçka thelbësore për botën empirike.²³

Duke e interpretuar *a priorizmin* kantian në polemikë me Konrad Lorenz-in, Popper riformuloi konceptualisht dhe e zhvilloi përmbajtjesisht teorinë *a prioristike* të Kantit. Për dallim nga Kanti, i cili njohjen *a priori* e konsideronte “të domosdoshme në kuptimin apodiktik”, Popper këtë njohje e vlerësonte si “të domosdoshme në kuptimin hipotetik”.²⁴ Me gjithë karakterin hipotetik që Popper i mvesh *a priorizmit* të tij, ai vazhdon ta quajë veten *a priorist* radikal pikërisht për shkak të ndërfutjes së elementit gjenetik në teorinë e tij. “Ajo që mendoj unë”, thotë Popper, “është se, gjithçka që njohim është gjenetikisht *a priori*. *A posteriori* është vetëm seleksionimi i asaj që kemi shpikur *a priori*”.²⁵ Ai vazhdon tutje: “Në kundërshtim të plotë me të gjithë epistemologët që nga John Locke dhe për dallim edhe me Kantin dëshiroj të parashtoj tezën e mëposhtme: e gjithë njohja është në përmbajtjen e saj *a priori*, d.m.th. gjenetikisht *a priori*. E gjithë njohja është hipotetike, e hamendësuar: është hipoteza jonë. *A posteriori* janë vetëm eliminimet e hipotezave: ndeshja e hipotezave me realitetin. Pikërisht këtu dhe vetëm këtu qëndron elementi empirik në njohjen tonë”.²⁶

Duke i gjetur gjykimet sintetike *a priori* në matematikë, gjeometri dhe fizikë, Kanti ishte i mendimit se ato janë të pranishme në cilësinë e propozicioneve edhe në metafizikë.²⁷ Sipas Kantit, metafizika “nuk

²² *Ibid.*, f. 39.

²³ SCRUTON, Roger (2000) *Histori e shkurtër e filozofisë moderne*, Besa, Tiranë, f. 149.

²⁴ POPPER, Karl (2002) *E gjithë jeta është zgjidhje problemesh*, Shkodër, f. 86.

²⁵ *Ibid.*, f. 85.

²⁶ *Ibid.*, f. 87.

²⁷ KANT, *vep. cit.*, f. 38.

është e interesuar që vetëm t'i zbërthejë konceptet, të cilat ne vetvetes ia formojmë a priori për gjësendet; ne duam që njohjet t'i zgjerojmë a priori, për ç'arsye duhet t'i përdorim edhe parimet e tilla, të clat konceptit të dhënë i shtojmë diçka që nuk gjendet në të dhe, kështu, me anë të gjykimeve sintetike a priori të shkojmë aq larg *jashtë tij* sa që as vetë përvoja nuk mund të na shoqërojë deri atje”.²⁸ Me këtë hipotezë ai mendonte se kishte identifikuar pikëtakimin dhe njëkohësisht pikëthyerjen e filozofisë (metafizikës) dhe të shkencës. E para konsiderohej si refleksion që konfiguronte trajtat a prioristike të njohjes, ndërsa e dyta si formësim që ndërfitë relacionin sintetik përbrenda tyre, përkatësisht ndërmjet subjektit dhe predikatit. Ky trajtësim sintetik i gjykimeve a priori buron nga shkenca aq sa edhe nga filozofia.

Metafizika e subjektivitetit si trajtë e re e sigurisë epistemologjike

Kanti e zhvilloi përpikërisht nismën descartiane për rikonstruktimin e metafizikës tradicionale të raportit të subjektit me objektin, gjegjësisht konstruktimin e metafizikës së re të subjektivitetit²⁹. Me këtë metafizikë Kanti ndërton, siç shprehet Popper, “teorinë ‘aktiviste’ të dijes” si përmbysje të teorisë ‘pasiviste’ të dijes”.³⁰ Ndërsa, sipas Heidegger, hedhjen e themelit të subjektivitetit [...] e mundëson dhe e siguron reduktimi transcendent në subjektivitetin absolut³¹. Përkundër mendimit tradicional kontemplativ, i cili drejtohet kah objektiviteti duke e reduktuar të vërtetën në përputhjen e njohjes me objektin, Kanti nisat nga mendimi subjektiv – produktiv, përkatësisht nga uniteti transcendent i vetëdijes për veten, i cili vendoset në qendër të universit dhe i cili e ka forcën krijuese dhe ligjdhënëse në konstituimin e të vërtetës për botën.³² Kështu, epistemologjikisht subjekti nuk modelohet më sipas objektivitetit, por

²⁸ *Ibid.*, f. 38.

²⁹ S’ka dyshim se nisma e dekonstruktimit të metafizikës objektive i takonte Descartes-it, i cili bëri kthesën epokale me parashtrimin e *ego cogito*. Ai ishte themelues i njëmendtë i filozofisë moderne dhe mendimet e tij shërbyen si pikënisje për shumë variante të mëvonshme subjektiviste dhe idealiste. Më gjerësisht shih: Mavriqi, *Poesis e Praxis, Zhvillimi i nocionit të punës prej Aristotelit deri te Hegeli*, ff. 131-141.

³⁰ MILLER, David, *Popper, Vepra të zgjedhura*, Shtëpia e librit dhe Afërdita, Tiranë, ff. 357-358.

³¹ HEIDEGGER, *vep. cit.*, f.243.

³² MAVRIQI, Ramush (2005) *Poesis e Praxis, Zhvillimi i nocionit të punës prej Aristotelit deri te Hegeli*, Dukagjini, Pejë, f. 131.

përkundrazi, objektiviteti modelohet sipas subjektivitetit. Po të shprehemi me gjuhën e spekulacionit të thellë metafizik të Hegelit, nga objektivizimi i subjektivitetit kalohet në subjektivizimin e objektivitetit. Sigurisht se te Kanti nuk bëhet fjalë për subjektivizim ontologjik, por subjektivizim epistemologjik të objektivitetit. Prandaj edhe *realiteti noumenal*, si objektivitet jashtësubjektiv asnjëherë i arritshëm me siguri të plotë epistemologjike, konfigurohet dhe modelohet si *realitet fenomenal* në saje të strukturës a prioristike epistemologjike të etabluar të subjektivitetit. Pikërisht në këtë strukturë a prioristike, përmes të cilit mundësohet rindërtimi sintetik i materialit të dhënë objektivisht dhe të pranuar sensualisht nga subjekti njohës, përqendrohet e tërë fuqia krijuese, ligjvënëse, rregulluese, sintetizuese, transformuese etj. e subjektit.

Ndërkohë që Kanti, pra, reflektonte rreth identifikimit të kushteve të domosdoshme dhe universale a priori të subjektit, kushte të cilat janë të rrënjësura në atë që, sipas Descartit, është e vetmja gjë që njerëzve i është shpërndarë në mënyrën më të barabartë – pra arsyen, ishte Fichte ai i cili këtë fuqi subjektive, funksioni dhe roli i së cilës ishte thelbësisht gnoseologjik, e hipostazoi ontologjikisht duke i dhënë forcë krijuese subjektit tjetërfarë nga ajo që i dha Kanti. Funksioni krijues i mendjes, siç është rikonstruktimi subjektiv *fenomenal* i botës *noumenale*, te Kanti ishin nusprodukte të funksionit teorik – njohes së mendjes. Duke interpretuar riorientimin filozofik të mendimit postkantian nga Fichte, Russell shpjegon: “[Fichte] e çoi subjektivizmin deri në një pikë që duket thajse është i përfshirë në një lloj çmendurie. Ai thotë se Uni është i vetmi realitet i fundmë dhe se ajo ekziston vetëm ngaqë e pozicionon veten; Jouni, që ka një realitet të nënshtruar, gjithashtu ekziston vetëm nga që Uni e pozicionon atë”.³³

Pra, subjekti i Kantit ishte tjetër prej Unit Krijues të Fichtes, Idesë Objektive të Schellingut dhe Frymës Absolute të Hegelit. Me transformimin hipostazues të fuqisë njohëse të subjektit hipostazohej edhe vetë subjekti. Prandaj Fichte nuk fliste për një subjekt konkret njohës, siç ishte rasti me filozofinë kritike të Kantit, por për një subjekt transindividual, që tejkalonte subjektet konkrete. Të njëjtën dilemë, veçse në vija të tjera krahasimi, e parashtron edhe Roger Scruton: “Kur Kanti flet për aftësinë e subjektit njerëzor, flet gjithmonë për përvojën ‘tonë’, arsyetimin ‘tonë’, konceptet ‘tona’, vullnetin ‘tonë’, etj., duke e lënë të hapur çështjen kyçe nëse kjo

³³ RUSSELL, Bertrand (2004) *Një histori e filozofisë perëndimore*, Vëll. III., Milosau, Tiranë, f. 292.

“tonë” duhet marrë në kuptimin e përgjithshëm ose jo. A nënkuptohen me të të gjitha qeniet njerëzore të konceptuara objektivist? Apo duhet interpretuar në kuptimin e veçantë të idealizmit që e ka fjalën për subjektin abstrakt, “Uni”-n që merret me ndërtimin subjektiv të një ‘bote’? Kjo dykuptimësi është me rëndësi vendimtare, sepse në varësi të interpretimeve të saj duket se shkojmë ose drejt një metafizike objektive, ose drejt një epistemologjie tepër solipsistike”.³⁴

Duke tërhequr vërejtjen se tranzicioni ndërmjet metafizikës dhe shkencës nuk është i prerë qartë dhe se ajo që ka qenë një ide metafizike dhe mund të bëhet një teori shkencore e testueshme nesër, në veprën e tij *The Logic of Scientific Discovery* Popperi ofron një mori shembujsh, si: atomizmi, ideja e “parimit” të vetëm fizik ose elementi i fundmë (prej të cilit derivohen të tjerët), teoria korpuskulare e dritës, teoria fluide e elektricitetit etj.³⁵ Sipas Popperit, të gjitha këto ide dhe koncepte metafizike kanë ndihmuar, madje edhe në trajtën e tyre të hershme, në ndërtimin e një rendi në pamjen e njeriut për botën dhe në disa raste madje edhe kanë mundësuar parashikime të suksesshme.³⁶

A mund të themi se ndërkohë që filozofia rreket ta kapë esencën unike dhe të pandryshueshme të shpërfaqjeve të panumërta të saj, shkenca tenton t’i studiojë pikërisht këto të fundit? Pra, a mundet esenca t’i përkasë filozofisë, ndërsa aparencia shkencës për shkak se e para është shumë e lartë t’i nënshtrohet verifikimeve empirike, ndërsa e dyta tepër e ulët për refleksionet spekulative. A paraqet kjo ndonjë superioritet të sofistikuar epistemologjik të filozofisë përkundraill shkencës?

Një vlerësim i tillë hipotetik vështirë se do t’i bënte ballë sfidës nihiliste niçeanë të shpërbërjes epistemologjike të njëmendësisë. “Bota e vërtetë” – tashmë atë e kemi hequr qafe”, thotë Nietzsche duke ironizuar dihotominë gnoseologjike të realitetit, për të vazhduar me pyetjen provokative “por cila botë ka mbetur?”. Ai vazhdon me sarkazmë duke u përgjigjur me pyetje tjetër “ndoshta bota e dukjes?” për t’i dhënë goditjen përfundimtare me përgjigje mjaft nihiliste: “Sigurisht që jo! Bashkë me botën e vërtetë ne kemi hedhur tutje edhe botën e dukjes!”³⁷ Kjo ngase, nëse shprehemi me gjuhën e Schellingut, “e padukshmja e mban të dukshmen”. Në të njëjtën kohë, ai mëtonte se

³⁴ SCRUTON vep. cit., f. 170.

³⁵ POPPER, Karl (2005) *The Logic of Scientific Discovery*, Taylor & Francis e-Library, London & New York ff. 277-278.

³⁶ *Ibid.*, f.278.

³⁷ NIETZSCHE, Friedrich (2002) *Perëndimi i idhujve*, Bargjini, Tiranë, f. 26.

shkencat natyrore vazhdimisht shkojnë drejt abstraktes – drejt spirtualitetit. Përmes gjuhës së ndryshimit permanent dhe logosit, Herakliti përpiquej të argumentonte se natyra e vërtetë e sendeve pëlqen ta fshehë veten. Sipas tij harmonia e padukshme është më e fortë se harmonia e dukshme dhe se në dukje sendet janë të kundërta, por në të vërtetë ato janë të njëjta.³⁸ Aristoteli, për të cilin dija ndahej në dijen e vërtetuar dhe dijen intuitive, e kuptonte këtë të fundit si kapje të formës së padukshme të thelbit ose të natyrës esenciale të një sendi. Me të njëjtën gjuhë edhe Karl Popper theksonte se “në fakt ne nuk njohim asgjë nëpërmjet shikimit, sepse e vërteta është e fshehur thellë”.³⁹

Shpërfillja nihiliste nietzscheane pashmangshëm do të na çonte drejt pyetjes: A thua vallë identifikimi ose njëjtësimi i esencës me aparcencën dhe aparcencës me esencën çon drejt pajtimit komplementarizues të dy perspektivave diametralisht të kundërta epistemologjike? A do t’i ndihmonte dhe a do ta komplementarizonte në këtë drejtim qasjen parciale të shkencës qasja integraliste dhe unitariste e filozofisë ndaj qenies si të tillë? Mbetet të shihet se deri në çfarë përmasash shkenca mund të ruajë unitetin e saj integral përballë kompleksitetit të pareduktueshëm të realitetit dhe të mos humbasë në turbullirat e njohjeve të “pakuptimta” (ndonëse logjikisht dhe shkencërisht të “sakta” dhe utilitarisht funksionale) si rezultat i parcializimit dhe fragmentarizimit të pashmangshëm dhe të pafundmë epistemologjik të tërësisë së njëmendësisë. E sa për mitin dhe religjionin është vështirë të mendohet ndonjë rivendosje e sigurt e autoritetit të tyre epistemologjik në një kohë kur “arroganca totalitare e mendjes” (Derrida) i ka dëbuar ato nga froni epistemologjik për të legjitimuar totalitarisht epistemat e *racios* dhe *shkencës*.⁴⁰

Përfundim

I tërë ky rrugëtim i shpirtit njerëzor drejt njohjes, i paraqitur në mënyrë skematike në këtë punim, duke vënë theksin më shumë te raporti i filozofisë dhe shkencës, jo vetëm që e lë pa përgjigje, por edhe i shton kompleksitetin sfidës së vjetër filozofike: nëse këto trajta të shumëllojshme dijesh zhvillohen përmes një linje evolucioni të

³⁸ HERAKLITI (1986) *Mbi natyrën*, Rilindja, Prishtinë, f. 26.

³⁹ MILLER, vep. cit., f. 30.

⁴⁰ Për shkak të kufizimit të hapësirës, këtu nuk kemi vazhduar tutje për të problematizuar kritikën postmoderne ndaj arsyes, përkatësisht autoritetit të saj si dhe vetë-legjitimitimit dhe arsyetimit epistemologjik që ajo i ben vetes.

njëtrajtshëm progresiv duke na zbuluar shkallshkallshmërisht njohjen gjithnjë e më të saktë për botën, apo janë vetëm trajta dijeshe kulturalisht të kushtëzuara, të cilat përballë një bote të *paarritshme* epistemologjikisht kanë për funksion vetëm që të mundësojnë akomodimin mjedisor të njeriut? Debati vazhdon, por nëse është *e para*, atëherë filozofia e ka të hapur terrenin për të ndërmarrë rolin e një metateorie për të integruar në një tërësi epistemologjikisht sintetike dhe koherente të gjitha dijet fragmentare të disiplinave të shpërndara shkencore. S'ka dyshim që ky unitet i pretenduar metashkencor, më shumë se një sfidë mund të jetë ëndërr e optimizmit iluminist të tipit durkhemian. Nëse është *e dyta*, atëherë dallimi ndërmjet këtyre trajtave të ndryshme të dijes është i natyrës epistemike (në kuptimin e Foucault-it) pa ndonjë epërsi cilësore ndërmjet vete duke mbetur kështu në nivel të simbolizmit reprezentativ të një bote të *paarritshme* epistemologjikisht ose asaj që Kanti e quante *sendi në vetvete* (noumen). Në këtë kuptim dijet që dalin nga këto epistema do të ishin vetëm botëkuptime kulturalisht të kushtëzuara, që për funksion kanë akomodimin tonë sa më efektiv në botë, por që në kuptimin e njohjes do të na tradhtonin për të na lënë përherë në agnosticizëm.

Ardian GOLA, Prishtina

EPISTEMOLOGICAL DICHOTOMY SCIENCE – PHILOSOPHY

Summary

This paper does not develop any systematic argument and does not treat in details the evolution of the forms of knowing that humans have developed during the course of history. It uses a rather schematic approach to introduce the evolution of these forms aiming at analyzing some of their problematic aspects.

Myth, legend and religion are primordial forms of knowing, through which humans were able to know their environment while building a unitary relation with nature. After the emergence of Greek philosophy, the irrational forms of knowing were dethroned by reason. The latter gradually started to detach itself from speculation and metaphysics and to move toward empiricism and positivism. With the birth of science, the role of philosophy in knowing the world was relativized. This made the second epistemological dethroning possible. Regardless of their rivalry, philosophy and science continue their journey based on reason alone, whose “totalitarian arrogance” in effect removed the authority from myth and religion.

The long human's spirit ‘venture of knowing’ not only failed to give a concrete answer to the old philosophical challenge but, moreover, it increased its complexity. Therefore, the challenge remains: whether these diverse forms of knowing are developed through continual accumulation of knowledge and unilinear

progressive evolution disclosing gradually the more exact knowledge about the world, or these forms are merely culturally conditioned forms of knowledge - which by facing the epistemologically unachievable world - all they can do is make the environmental accommodation of human possible?

The debate continues. Nevertheless, if it is the *former*, then philosophy has its door open to undertake the role of a metatheory in order to integrate all the fragmented knowledge of dispersed scientific discipline in an epistemologically synthetic and coherent entirety. There is no doubt that this aspired metascientific unity, more than a challenge, can be just an illusion of Enlightenment optimism of the Durkheimian optimism. However, if it is the *latter*, then the difference between these various forms of knowledge is epistemic one (in Foucauldian term) without any superiority to each other, remaining at the level of representative symbolism of an epistemologically unachievable world or what Kant labelled a *thing-in-itself* (noumenon). Hence, knowledge that emerges from these epistemes would be only culturally conditioned world-views, whose function at the practical level remains in making effective the environmental adaptation of human, while, at the level of knowing, it would betray us by leaving us in permanent agnosticism.

Literatura:

- Cassirer, Ernest. *An Essay on Man. An Introduction to a Philosophy of Human Culture*. New Haven: Yale University Press, 1944.
- Hegel, G. W. F. *Platoni*, Tiranë, Dritan, 2004.
- Heidegger, Martin, *Leksione dhe konferenca*, Tiranë, Plejad, 2003.
- Herakliti, *Mbi natyrën*, Prishtinë, Rilindja, 1986.
- Hersh, Zhanë, *Habia filozofike*, Tiranë, Dituria.
- Kant, Immanuel, *Kritika e mendjes së kulluar*, Prishtinë, Libri shkollor, 2002.
- Mavriqi, Ramush, *Poiesis e Praxis, Zhvillimi i nocionit të punës prej Aristotelit deri te Hegeli*, Pejë, Dukagjini, 2005.
- Miller, David, *Popper, Vepra të zgjedhura*, Tiranë, Shtëpia e librit dhe Afërdita.
- Nietzsche, Friedrich, *Perëndimi i idhujve*, Tiranë, Bargjini, 2002.
- Popper, Karl, *E gjithë jeta është zgjidhje problemesh*, Shkodër.
- . *The Logic of Scientific Discovery*, London & New York, Taylor & Francis e-Library, 2005.
- Russell, Bertrand. *Një histori e filozofisë perëndimore*, Vol. I. 3 vols, Tiranë, Milosau, 2004.
- . *Një histori e filozofisë perëndimore*. Vol. III. 3 vols. Tiranë, Milosau, 2004.
- Scruton, Roger, *Histori e shkurtër e filozofisë moderne*, Tiranë: Besa, 2000.
- Stumpf, Samuel Enoch, *Filozofia – historia dhe problemet*, Tiranë, Toena, 2000.
- Wittgenstein, Ludwig, *Tractatus Logico – Philosophicus*, Prishtinë, Instituti i Filozofisë - Sociologjisë, 2000.

Burimet elektronike

<http://library.flawlesslogic.com/heracl.htm> (qasur më 30 janar 2014).

<http://www.mlahanas.de/Greeks/LX/SevenSagesOfGreece.html> (qasur më 31 janar 2014).

Florent MUÇAJ

POZICIONI KUSHTETUES I PRESIDENTIT KARSHI UNITETIT TË POPULLIT - SHQYRTIME ANALITIKE

KDU 328.131

342.4

Abstrakt

Punimi me titull *“Pozicioni kushtetues i presidentit karshi unitetit të popullit”* është bërë me shkrim standard (times new roman). Një faqe është hyrje, ndërsa i gjithë teksti i punimit është i ndarë në disa tituj dhe në fund ka përfundimin në një faqe e gjysmë.

Në hyrje të punimit autori trajton qëllimet dhe arsyet e studimit të atributit të unitetit të popullit, sidomos transmetimin e tij në parimin e ndarjes së pushteteve.

Përmes këtij artikulli autori synon që të arrijë dy qëllime kryesore: së pari të sfidojë në aspekt teorik parimin e uniteti të popullit si atributi kryesor dhe më i rëndësishëm i presidentit dhe së dyti të vë në pah situatat praktike me të cilat përballët presidenti në rrugën e tendencave për të transmetuar unitetin e popullit dhe kombit në përgjithësi.

Punimi është i strukturuar në këtë mënyrë: Në hyrje janë shqyrtuar aspektet teorike dhe kushtetuese të unitetit të popullit, elementet praktike të këtij atributi, analiza e rastit të Republikës së Kosovës dhe ndikimi i këtij atributi kushtetues në ndryshimet kushtetuese në Republikën e Kosovës.

Në fund të punimit autori ka paraqitur ide për temën, duke spikatur dhe duke analizuar mjaft mirë elementin e unitetit të popullit dhe duke dhënë përfundime konkrete sa i përket rolit të këtij atributi sidomos në funksionin kushtetues të presidentit.

Fjalët çelës: President, kushtetutë, unitet i popullit, legjitimitet, lidhshmëri, neutralitet.

Vështrime hyrëse

Në secilën prej kushtetutave, por edhe në brendi të funksionimit të një shteti, presidenti na paraqitet si një ndër shtyllat kryesore në raportin ndërmjet ndarjes së pushteteve. Në të gjitha kushtetutat e vendeve demokratike, atributi që e bën presidentin të reflektojë në raportin e pushteteve në një sistem juridik dhe kushtetues është përfaqësimi i popullit, respektivisht të qenit i të gjithë qytetarëve.

Punimi në fjalë mëton të ngre paralelizma, duke vështruar aspektet e rregullimit kushtetues të pozicionit të presidentit në përfaqësim të unitetit të popullit dhe kombit në përgjithësi. Punimi synon t'i prekë segmentet kryesore dhe elementet e këtyre segmenteve

përmes të cilave vërehet dhe transmetohen, por edhe shfaqen pengesa në realizimin e parimit të unitetit të popullit dhe kombit.

Qëllimi i këtij punimi është vënia në pah e elementeve kushtetuese që presidentin e bëjnë të reflektojë si përfaqësues i unitetit të popullit, konkretisht përfaqësues i secilit qytetar. Ky qëllim do të arrihet përmes krahasimit të rregullimit kushtetues të disa vendeve, duke tërhequr paralelizma me Republikën e Kosovës dhe me situatën që është krijuar në Republikën e Kosovës sidomos pas vendimit politik për të pasur një president të zgjedhur nga populli dhe analizimit të disa situatave praktike.

Në mes tjerash, punimi përmban elemente krahasuese të rregullimit kushtetues të institucionit të presidentit, gjë që na jep të kuptojmë që burimi kryesor kushtetues në këtë kontekst do të jenë kushtetutat e vendeve përkatëse përmes të cilave do të tentohet të bëhet nxjerrja e këtyre elementeve teorike.

Metodat që do ta dominojnë punën gjatë këtij trajtimi janë: Metoda krahasuese, analitike, dogmatike dhe ajo filozofike. Natyrisht, metoda e cila do të dominojë është ajo krahasuese, për faktin që i gjithë punimi do të dominohet në tërheqjen e paraleleve që prekin dimensione të ndryshme, duke krahasuar me theks të veçantë rolin që ka presidenti në ndarjen dhe balancimin e pushteteve, efektet të cilat i arrin për përfaqësimin adekuat të unitetit të popullit.

Përveç kësaj në mesin e tërheqjes së paralelëve, me theks të veçantë do të analizohet edhe gjendja që pritet të krijohet në Republikën e Kosovës pas hyrjes në fuqi të amendamenteve kushtetuese për zgjedhjen e presidentit, por edhe gjendja në Republikën e Shqipërisë, e cila shpeshherë ka cenuar atributin kryesor të presidentit, pra përfaqësimin e unitetit të popullit.

1. Reflektimi i parimit të unitetit të popullit nga monarku te presidenti

Autorët e përkufizojnë presidentin si shef i shtetit, i cili mund të vijë në pushtet në dy mënyra: e para përmes parlamentit, dhe de dyta përmes votës së lirë të qytetarëve¹. Në fakt po të shikohet transformimi i institucioneve dhe historiku i formësimit të ndarjes së pushteteve, presidenti na del të jetë njëri ndër organet në mesin e organeve shtetërore më të hershme. Do të thoshim si është e mundur kjo? Të gjithë autorët që kanë shkruar për historikun e zhvillimit të

¹ Kurtesh Salii, E DREJTA KUSHTETUESE, libri I, Prishtine, 1998, fq. 219-220.

kushtetutave dhe mbi të gjitha transformimin e pushtetit shtetëror, pajtohen që vetë figura e sotme e presidentit e ka prejardhjen nga mbreti². Në fakt në analizën e të dhënave historike në këtë drejtim me të vërtetë na dal që i ashtuquajti shefi i shtetit, pra presidenti është transformim i monarkut, siç e thotë edhe profesori i të drejtës kushtetuese A. Bajrami.

Që nga karta e madhe e lirive e vitit 1215 në fakt filloi edhe kufizimi i pushtetit të mbretit dhe njëherit, përveç kësaj, edhe transformimi i vetë mbretit dhe "zbutja" e tij në kuptimin e mënyrës së qeverisjes. Kufizimi i pushtetit të mbretit më pas mundësoi edhe krijimin e organeve paralele me mbretin, ndërsa krijimi i organeve paralele, siç ishin parlamenti dhe qeveria, mundësuan ndarjen e pushteteve, ku më pas u paraqit edhe reflektimi i rolit të presidentit në ndarjen e tyre, por edhe në përfaqësimin e unitetit të popullit. Siç mund të vërehet, kufizimi i monarkut, krijimi i institucioneve të tjera paralele dhe krijimi i vijës ndarëse të pushteteve mundësoi vënien në pah edhe të atributit të unitetit të popullit, i cili rëndom i takonte presidentit. Në këtë kontekst rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe paraqitja e kushtetutave, të cilat edhe juridikisht e kanë përfaqësuar këtë element. Paraqitja e kushtetutave të para të shkruara që nga shekulli XV, s'ka dilemë që i ka dhënë një kahje tjetër ndarjes së pushteteve, e në këtë kontekst edhe theksimit të rolit të presidentit dhe mbi të gjitha unitetit të popullit dhe kombit. Është i pamohueshëm fakti që uniteti i popullit, si atribut që sot e gëzojnë presidentët, nuk ka mund të transmetohet në kohën kur kanë ekzistuar monarkitë absolute, sepse rëndom mbreti edhe pse ka qenë një dhe i vetmi, nuk ka pasur mundësi të reflektojë përfaqësimin e unitetit të popullit, andaj mund të pajtohem që paralelisht me kufizimin e pushtetit të mbretit është ndarë nga pushtetet tjera edhe figura e presidentit, por krahas këtyre ka lindur edhe atributi i përfaqësimit të unitetit të popullit dhe kombit.

Diferencimi dhe krijimi i figurës së presidentit dhe në tërësi ndarja e pushtetit ka ardhur si rrjedhojë e pakënaqësisë së popullit me qeverisjen e mbretit, apo më mirë të themi me mënyrën e qeverisjes së tij në përgjithësi. Në të kundërtën edhe sot ka sisteme absolute, të qeverisura përmes sistemit të trashëgimisë, ato janë të rralla, por është interesante që edhe populli është i kënaqur me to. Rast tipik në ditët e sotme, ku populli qeveriset nga sundimtari absolut është sulltanati i Burneit, një vend në Azi, i cili është një monarki me tipare absolute dhe

² Njëri ndër ta Osman Ismaili, në librin e tij FILLET E SË DREJTËS, kapitulli për shefin e shtetit.

sundimtari trashëgohet e nuk zgjedhet! Ajo që vlen për t'u përmendur në këtë vend është dashuria e popullit për sulltanin e tyre, të cilit i besojnë shumë.³ Është interesant që në këtë vend tipik për mënyrën e qeverisjes, pavarësisht një sistemi absolut, ku qeverisja nuk buron nga zgjedhjet e lira dhe demokratike, monarku arrin të reflektojë unitetin e popullit dhe në këtë mënyrë arrin të mbajë besimin dhe të paktën kjo reflektohet me zhvillimin ekonomik që ka vendi dhe besimin e qytetarëve që kanë në monarkun e Burneit. Është e çuditshme se si një monarki absolute ka mbijetuar kaq gjatë, madje këtë çudi e theksojnë edhe shumë ekspertë të shkencave juridike e politike dhe sikur pajtohen që ky sistem mund të funksionojë edhe më tutje si i tillë përderisa nuk janë krijuar probleme deri tani⁴. Në përgjithësi mund të konkludojmë që atributi i unitetit të popullit është shumë i rëndësishëm për funksionimin e pushteteve dhe jo rastësisht i është besuar një subjekti shtetëror i cili rëndom duhet të reflektojë besim dhe të transmetojë faktin që është unik dhe vendimet e tij janë të paanshme. Në përgjithësi gjatë zhvillimit historik dhe modernizimit të figurës së monarkut dhe transformimit të tij në një institucion modern, ajo që është vërejtur më së shumti si karakteristikë që e ka veçuar presidentin nga pushtetet e tjera ka qenë pikërisht “uniteti i popullit”. Së këndejmi, ky atribut tashmë kushtetues e ka shndërruar presidentin në një shtyllë të pushtetit shtetëror, i cili qëndron ndërmjet tre pushteteve të ndara, me të vetmin qëllim që të mundësojë funksionimin, balancimin dhe ruajtjen e kredibilitetit e funksionimit kushtetues të pushteteve në përgjithësi dhe garantimit të funksionimit të tyre demokratik.

1.1 Përfaqësimi i unitetit të popullit dhe kombit, atribut kryesor i presidentit sipas rregullimeve kushtetuese

Të gjitha kushtetutat më të avancuara të vendeve demokratike e kanë legjitimuar si atributin kryesor të presidentit përfaqësimin e unitetit të popullit dhe të kombit. Së këndejmi, Kushtetuta e Bullgarisë në nenin 92.1. thekson “Ai (presidenti) përfaqëson unitetin e kombit”⁵. Në këtë kontekst në Kushtetutën e Francës theksohet: “Ai (presidenti) është garant i pavarësisë kombëtare dhe i tërësisë së territorit, si dhe garantues i zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare”⁶. Siç mund të

³ Dokumentari “Monarkitë e Azisë”, shfaqur më 29.12.2012, Explorer Histori.

⁴ Po aty.

⁵ Kushtetuta e Bullgarisë, neni 92.1.

⁶ Kushtetuta e Francës, neni 5.

shihet, Kushtetuta e Francës çështjen e përfaqësimit të unitetit të popullit e rregullon në mënyrë pak më indirekte, duke mos qenë shprehimisht i saktësuar që presidenti është përfaqësues i unitetit të popullit, por një gjë të tillë e lë të nënkuptohet me faktin që presidenti thuhet se është garantues i pavarësisë kombëtare dhe i tërësisë territoriale.

Kushtetuta e Republikës së Greqisë është edhe më e tërhequr sa i përket këtij aspekti, së andejmi ajo në raport me këtë atribut të presidentit paraqitet më shumë indirekte, duke theksuar që “presidenti është rregullator i regjimit politik”⁷, marrë në një dimension tjetër, të qenit rregullator i regjimit politik, njëherit do të thotë të jesh edhe faktor balancues dhe garantues që pushtetet do të funksionojnë në suaza të konturave të kushtetutës. Edhe në rastin e Kushtetutës së Republikës së Greqisë vërehet transmetimi i këtij atributi përmes kësaj dispozite kushtetuese. Është interesant mënyra se si e rregullon Ligji Themelor i Gjermanisë çështjen e unitetit të popullit si atribut kushtetues i presidentit, sepse nuk ka dispozitë kushtetuese në këtë ligj që i referohet decidivisht unitetit të popullit si atribut i presidentit, një gjë e tillë në Ligjin Themelor të Republikës Federale Gjermane mund ta nxjerrim vetëm në kuptim të dispozitave të tjera që rregullojnë çështje të tjera dhe jo direkt unitetin e popullit. Në tekstin e betimit të presidentit gjerman, ndër të tjera thuhet: “Betohem se tërë fuqitë e mia do t’ia kushtoj të mirës së popullit gjerman”, ku nga kjo pjesë e tekstit megjithatë reflekton atributi i unitetit të presidentit, megjithëse kjo është e natyrshme dhe është pjesë edhe e shumicës së kushtetutave si pjesë e tekstit të betimit⁸. Në nenin 59.1. në Ligjin Themelor Gjerman po ashtu thuhet që presidenti përfaqëson vendin në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke aluduar kështu në përfaqësimin e unitetit të popullit në përgjithësi.⁹

Kushtetuta e Hungarisë është e qartë sa i përket atributit të presidentit si përfaqësues i unitetit të popullit. Aty thuhet: “Kryetari i shtetit të Hungarisë është president i Republikës i cili përfaqëson unitetin e kombit dhe garanton funksionimin demokratik të aparatit shtetëror”.¹⁰ Kushtetuta e Italisë këtë atribut e ka vendosur te kompetencat e presidentit si të parën me radhë. “Presidenti i Republikës është kryetar i shtetit dhe përfaqëson unitetin kombëtar”.¹¹ Rast tjetër nga këto që i përmendëm më lart është shembulli i

⁷ Kushtetuta e Republikës së Greqisë, neni 30.1.

⁸ Ligji Themelor i Republikës Federale Gjermane e viti 1949, neni 56.

⁹ Po aty, neni 59.1.

¹⁰ Kushtetuta e Hungarisë, neni 29.1.

¹¹ Kushtetuta e Italisë, 1948, neni 87.

Kanadasë e cila ka ruajtur traditën; si pasojë e kësaj në Kanada mbreti është ai që ka ingerencën kushtetuese të përfaqësimit të unitetit të popullit. Një gjë e tillë pasqyrohet edhe në Kushtetutën e Mbretërisë së Holandës, ku mbreti mbi të gjitha reflekton unitetin e popullit dhe kombit dhe njëherit ai është bartës i pushtetit ekzekutiv, sikurse në Holandë dhe Kanada një gjë e tillë ndodh edhe në Belgjikë, Norvegji dhe Suedi. Për dallim nga të ashtuquajturat mbretëri kushtetuese, në shumicën prej të cilave nënkuptohet që mbreti është ai që reflekton unitetin e popullit, por pa ingerencë decrive kushtetuese, kushtetuta e Spanjës ka paraparë që “mbreti është kryetari i shtetit, simbol i unitetit dhe i qëndrueshmërisë së tij”¹².

Kushtetuta e Rumanisë po ashtu është shumë e qartë sa i përket përfaqësimit të unitetit të popullit nga ana e presidentit, madje e njëjta e vendos këtë segment në kuadër të çështjeve të para për presidentin. Aty theksohet: “Presidenti i Rumanisë përfaqëson shtetin rumun dhe është garant i pavarësisë kombëtare, i unitetit dhe i tërësisë territoriale të vendit”¹³. Së këndejmi, siç shihet, garantimi i unitetit të popullit në Kushtetutën e Rumanisë shoqërohet edhe me elementin e garantimit të tërësisë territoriale si element i rëndësishëm që lidhet me unitetin e popullit dhe kombit¹⁴.

Kushtetuta e Republikës Austriake po ashtu nuk është decrive kur është çështja e unitetit si atribut që ushtron presidenti federal. Vetëm neni 65 i Kushtetutës së Republikës Austriake përfshin në vija të trasha kompetencat e presidentit federal, duke mos e përmendur decidivisht çështjen e unitetit të popullit si atribut që i takon presidentit. Edhe kushtetuta e Republikës së Kroacisë është e qartë në kontekstin e shfaqjes së unitetit si atribut që e ushtron presidenti, së këndejmi ajo parasheh se “Presidenti i Republikës së Kroacisë është kryetar i shtetit i cili kujdeset për ekzistencën e republikës dhe siguron unitetin e Republikës së Kroacisë dhe veprimtarinë e rregullt të pushtetit shtetëror”.¹⁵ Kushtetua e Republikës së Maqedonisë nuk qëndron në të njëjtën linjë me Kushtetutën e Republikës së Kroacisë, sepse e njëjta nuk është fikse rreth provizionit kushtetues të presidentit për të cilin po flasim. E vetmja gjë që e thotë në këtë kontekst Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë është neni 79, ku theksohet: “Presidenti përfaqëson Republikën”, që nënkupton vetëm një element

¹² Kushtetuta e Mbretërisë së Spanjës, neni 56 (Kurora).

¹³ Kushtetuta e Rumanisë, neni 80.1.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Kushtetuta e Republikës së Kroacisë, neni 94.

të unitetit të popullit dhe kombit. Edhe Kushtetuta e Republikës së Sllovenisë është pak a shumë në të njëjtën vijë me atë të Republikës së Maqedonisë, ku në nenin 102 të kësaj kushtetute thuhet se “presidenti i Republikës së Sllovenisë përfaqëson vendin brenda dhe jashtë...”.¹⁶

Edhe Kushtetuta e Federatës Ruse ka paraparë dispozitë fikse sa i përket rolit të presidentit në kontekstin e garantimit të unitetit të popullit. “Presidenti i Federatës Ruse është garant i kushtetutës së Federatës Ruse si dhe i lirive dhe të drejtave të qytetarit. Sipas procedurës së Kushtetutës së Federatës Ruse ai merr masa për mbrojtjen e sovranitetit të Federatës Ruse, po ashtu garanton funksionimin e harmonizuar të organeve të pushtetit shtetëror”,¹⁷ thuhet aty. Së fundmi, Kushtetuta e Republikës së Turqisë e pasqyron unitetin e popullit në nenin 40 të kushtetutës, si vijon: “Presidenti i Republikës është kryetar i shtetit e në këtë cilësi ai përfaqëson Republikën e Turqisë dhe unitetin e kombit turk, i cili është roje e zbatimit të kushtetutës dhe funksionimit të rregullt dhe të harmonishëm të organeve të shtetit”.¹⁸

Në tërësi elementi i përfaqësimit të unitetit të popullit dhe kombit përbën një garanci më shumë kushtetuese, por në disa vende edhe ligjore. Marrë në përgjithësi, ky element i rëndësishëm që mbase e identifikon nder edhe vetë pozicionin kushtetues të shëfit të shtetit kur është çështja e ndarjes së pushteteve dhe reflektimi i tij në këtë ndarje. Shikuar edhe në aspektin praktik, pikërisht ky atribut i presidentit del të jetë kyç edhe për balancimin e pushteteve të ndara në një sistem të caktuar kushtetues. Sikundër edhe vendeve që i përmendëm më lart, edhe në Republikën e Kosovës dhe në atë të Shqipërisë është vënë në pah si garancion kushtetues përfaqësimi i unitetit të popullit nga ana e presidentit. Kushtetuta e Republikës së Kosovës vendos përfaqësimin e unitetit të popullit si njërën ndër atributet kryesore kushtetuese të presidentit. Kësisoj, në nenin 83 theksohet: “Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës”, karshi kësaj edhe kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e rregullon një gjë të tillë në nenin 86.1. Shpeshherë në praktikë ndodh që pavarësisht ingerencave dhe garancive kushtetuese, pushtetit dhe fushëveprimtarisë së presidentit për të reflektuar unitetin e popullit, një gjë e tillë është e pamundur të bëhet për shkak të arsyeve të ndryshme! Mund të ketë disa arsye që

¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Sllovenisë, neni 102.

¹⁷ Kushtetuta e Federatës Ruse, neni 80.2.

¹⁸ Kushtetuta e Republikës së Turqisë, neni 40.

presidentin e pengojnë që të kryejë në tërësi funksionin e tij kushtetues. Të paktën kjo mund të thuhet për vendet që kanë kaluar nëpër tranzicion të thellë dhe që nuk kanë pasur një traditë të mirëfilltë të funksionimit të institucioneve demokratike. Një ndër faktorët thelbësorë që mund të çojnë në sfida praktike dhe pengesa për të ushtruar parimin e unitetit të popullit janë:

- Mënyra e zgjedhjes së presidentit,
- Raporti i presidentit me ekzekutivin, me theks të veçantë me kryeministrin,
- Raporti i presidentit me parlamentin,
- Kompetencat e qarta të presidentit.

Para se të analizohet pozicioni i presidentit në raport me ekzekutivin dhe parlamentin, duke përfshirë këtu edhe mënyrën e zgjedhjes dhe qartësinë e kompetencave të tij si aspekte të rëndësishme, mund të provojmë që të japim një definicion për elementet faktike që mund ta qartësojnë mënyrën e ushtrimit të unitetit të popullit nga ana e kryetarit të një shteti.

1.2. Cilat mund të jenë elementet me anë të të cilave presidenti reflekton unitetin e popullit ose kombit?

Më lart identifikuam disa kushtetuta më kryesore të vendeve demokratike, të cilat në mënyrë shprehimore sanksionojnë përfaqësimin e unitetit të popullit nga ana e presidentit, në drejtim të kësaj tani lind pyetja: Cilat janë në fakt aspektet praktike përmes të cilave zbatohet një dispozitë kushtetuese që sanksionon përfaqësimin e unitetit të popullit nga ana e presidentit, apo më mirë thënë, cili mund të ishte aspekti praktik i elementeve që e përbëjnë zbatimin e kësaj garancie kushtetuese? Nisur nga fjala “unitet”, e cila është strumbullari i kësaj që nënkupton një tërësi apo një shumicë, në këtë rast “unitet i popullit” reflekton me atë që përfaqëson vullnetin e pastër të popullit. Po provojmë të identifikojmë disa elemente që do të reflektonin aspektet praktike të atributit “uniteti i popullit”. Të shohim cilat mund të jenë këto. Ato mund të përbëhen prej shtatë elementeve, si:

- Përfaqësimi i vullnetit të popullit apo i shumicës së tij-legjitimiteti,
- Neutraliteti i vendimeve dhe i veprimeve të presidentit,
- Menaxhimi i krizave dhe lidershipi,

- Unifikimi i politikave shtetërore,
- Balancimi i pushteteve dhe garantimi i funksionimit normal të tyre,
- Të qenit figurë jashtë politike e presidentit,
- Transparenca dhe puna e hapur e presidentit¹⁹.

1.2.1. Analizë e elementeve përmes të cilave presidenti mund të reflektojë unitetin

1.2.1.1. Legjitimiteti (Vullneti i popullit ose i të zgjedhurve të tij)

Ky është një element i rëndësishëm që shpërfaqet si faktor thelbësor i transmetimit të unitetit të popullit. Vullneti i popullit është mbi të gjitha dhe njëherit ai i jep presidentit fuqinë për të reflektuar se me të vërtetë përfaqëson unitetin e popullit dhe të kombit. Legjitimiteti i fortë do të thotë edhe hapësirë për veprim të presidentit, si dhe garanci për veprim dhe mundësi për të reflektuar unitet kushtetues. Në këtë kontekst ndryshe do të shihej një president i cili në zgjedhje ka fituar ngusht në raport me kundërkandidatin, p.sh., ka fituar vetëm 51% të votave dhe ndryshe do të shihej në raport me legjitimitetin nëse ka fituar më shumë vota në raport me kundërkandidatin. Një gjë e tillë mund të paraqitet edhe te presidentët që zgjedhen nga parlamenti. Me një legjitimitet tjetër shihet presidenti i cili është zgjedhur nga parlamenti dhe që ka pasur përkrahjen e shumicës së forcave politike në parlament dhe me një legjitimitet krejtësisht tjetër mund të ketë presidenti i cili është zgjedhur në parlament, por që nuk ka reflektuar në përgjithësi përkrahje të shumicës së mazhorancës. Sot hasim në shumë situata të tilla në praktikë, kur një president në zgjedhje fiton ngusht ndaj kandidatit të tij, ose kur në parlament nuk e merr shumicën dhe përkrahjen e shumicës. Më së shumti këto ndodhin në vendet që gjenden në një fazë më kritike të tranzicionit politik në përgjithësi. Rast tipik që mund të jetë objekt i analizës është Republika e Shqipërisë dhe ajo e Kosovës.

Ish-presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Bamir Topi në vitin 2007 ishte zgjedhur president i Republikës së Shqipërisë vetëm në raundin e fundit, madje Republika e Shqipërisë në këtë rast ishte buzë zgjedhjeve të parakohshme, për faktin që faktori politik nuk kishte

¹⁹ Disa nga këto elemente në një formë tjetër i identifikon edhe profesori Arsim Bajrami në punimin e tij “Ndryshimet kushtetuese në Republikën e Kosovës”, botuar në revistën CONSTITUTIO, nr. 1, fq. 19.

marrëveshje për figurën e presidentit, ndërsa në anën tjetër mazhoranca insistonte që presidenti i Republikës duhet të ishte kandidati i tyre, duke mos e marrë madje as mundin që të takoheshin me akterët opozitarë, e një gjë e tillë pastaj pati ngritur tensione të mëdha sidomos gjatë seancave plenare të zgjedhjes së presidentit, të cilat madje zgjasnin edhe deri në orët e hershme të mëngjesit, duke e shndërruar garën në një maratonë të vërtetë. Vështirësitë për të marrë legjitimitetin nga ana e z.Topi e vështirësonte edhe mundësinë e tij për të reflektuar të ashtuquajturin “unitet i popullit”, marrë parasysh përkrahjen që kishte në parlament. Ai u zgjodh president në raundin e fundit, me disa vota të opozitës, duke vërtetuar kështu rrugën e vështirë të marrjes së legjitimitetit e cila vinte në pikëpyetje të madhe shumë gjëra që lidheshin me legjitimitetin dhe kështu me unitetin e popullit. Se sa e vështirë kishte qenë marrja e legjitimitetit, një gjë të tillë e vërtetonin edhe fjalët e kryeministrit të atëhershëm z.Berisha, i cili pak para shpalljes së rezultateve tha: *“Mendoj që do ta kemi presidentin e Republikës”* dhe kjo po ashtu tregonte që presidenti ishte i mazhorancës dhe do ta kishte vështirë të reflektonte unitetin e popullit. Ndër të tjera se sa afër kishin qenë zgjedhjet e parakohshme dhe kriza kushtetuese, e vërtetonin po aq fjalët e z.Berisha, kur u shpreh: *“Ajo që ka rëndësi të veçantë është se sot votoi parandalimi i zgjedhjeve të parakohshme, votoi vendosja në institucionin e parë të vendit të një politikani, votoi Kushtetuta me procedurat e saj”*. Kryeministri garanoi opozitën se “ky zhvillim i sotëm hap perspektiva të reja bashkëpunimi në të gjitha fushat për të realizuar së bashku objektivat e përbashkëta, integrimin e vendit në NATO, BE, shtetin ligjor, investimet e huaja në Shqipëri”, etj. “Kurrë ndonjëherë ky vend nuk ka qenë më në interes të sipërmarrjes botërore sa ç’është sot”, “motorët e rritjes së shpejtë ekonomike janë ndezur plotësisht dhe së shpejti do të ndodhë shkëputja ekonomike e këtij vendi”²⁰. Nga ky fragment shihet se sa e rëndësishme ishte shmangja e zgjedhjes së parakohshme, meqenëse kryeministri e kishte konsideruar si sukses. Gjithsesi kjo lidhet me vështirësinë e marrjes së legjitimitetit, si element që reflekton unitetin e popullit, prandaj edhe skepticizmi që z.Topi do të përfaqësonte unitetin e popullit ishte i madh, kjo krejt për faktin që në parlament kishte vetëm përkrahjen e mazhorancës, duke mos ardhur kështu si vullnet konsensual. Megjithatë, përkundër kësaj, edhe pse z. Topi ishte pjesë e mazhorancës, apo më mirë thënë pjesë e

²⁰ http://storico.radiovaticana.va/alb/storico/2007_07/145842_bamir_topi_zgjidhet_president_i_ri_i_republikes_se_shqiperise.html.

partisë kryesore mazhoritare gjatë ushtrimit të detyrës si president maksimalisht kontribuoi në ushtrimin e unitetit të popullit, duke kundërshtuar shpeshherë edhe linjat e partisë së tij e cila i kishte ndihmuar të bëhet president.

Është interesante se përkundër faktit, por edhe presioneve, Presidenti Topi tregoi të kundërtën e asaj që ishte pritur realisht, sepse ajo që ishte pritur nënkuptonte konsultimin e tij me kryeministrin e vendit, marrjen e vendimeve në konsultim me të dhe mbajtjen në njëfarë forme të një bilanci me politikat e partisë demokratike, parti nga vinte vetë presidenti. Sikundër roli i tij ishte tejet i madh dhe ai parapëlqeu që të bënte rolin e një presidenti si përfaqësues i të gjithë qytetarëve dhe jo një “marionetë” e mazhorancës dhe politikave të kryeministrit. Madje shumëherë Presidenti Topi për të dëshmuar dhe forcuar faktin se është përfaqësues i denjë i qytetarëve, bëri thirrje për uljen e tensioneve politike në Republikën Shqipërisë dhe për unitetin ndërmjet pozitës dhe opozitës në bërjen e politikave dhe në qeverisjen e vendit për një të ardhme më të mirë.²¹

Rast tjetër që në Republikën e Shqipërisë lidhet me legjitimitetin, si një element i transmetimit të unitetit të popullit, është rasti i ish Presidentit Alfred Moisiu, i cili ishte dëshmuar përfaqësues me të vërtetë i denjë i unitetit të popullit, duke qenë kështu pjesë e një marrëveshjeje historike për një president konsensual që do të përfaqësonte njëmend unitetin e popullit. Z.Moisiu, përveçse u dëshmuar si një president konsensual, transmetoi me të vërtetë legjitimitet, duke u zgjedhur president me një përkrahje të gjerë të parlamentit. Kësisoj, fakti që kishte një legjitimitet të theksuar i ndihmoi atij që edhe gjatë ushtrimit të detyrës të jetë në funksion të unitetit të popullit. Edhe vetë ai pas dhënies së betimit më 24 qershor 2002 kishte deklaruar se “*do të qëndrojë mbi interesat politike, sepse aspirojmë për paqe në Ballkan dhe anëtarësim të Shqipërisë në NATO*”.²² Nga ky pasues mund të shihet edhe vetë qasja, në këtë kontekst e z.Moisiu për vullnetin që të përfaqësojë unitetin e popullit, të cilin edhe vetë e çmonte si një atribut mjaft të rëndësishëm të një presidenti, meqë “Presidenti i vendit është një figurë e rëndësishme për kudo, pasi ai ka disa obligime tepër të mëdha në raport me institucionet e tjera të shtetit. Kështu, si te ne, ashtu edhe sipas

²¹ <http://www.albpress.org/2011/07/25/topi-takon-moisiun-dhe-meidanin-te-ulete-tensioni-politik-po-demtohet-demokracia-dhe-institucionet/>.

²² http://setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/infoBios/setimes/resource_centre/bio-archive/moisiu_alfred.

kushtetutës së Republikës së Kosovës, Presidenti përfaqëson unitetin e popullit. Sipas kushtetutës tuaj²³ kjo përcaktohet në nenin 4, pika 3 si dhe në nenin 83; ndërsa sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, pika 1. Pra rrjedhimisht çdo rast që cenon unitetin e popullit përbën “kazus” për interesimin ose ndërhyrjen e Presidentit për të sqaruar situatën si dhe për të kërkuar marrjen e masave për rregullimin e gjendjes²⁴. Edhe vetë profesorët, studiuesit dhe njohësit e mirë të të drejtës kushtetuese e pranojnë hapur rolin që ka pasur presidenti Moisiu në përfaqësimin dhe reflektimin në unitetin e popullit gjatë kohës sa ka ushtruar këtë detyrë.²⁵ Është me të vërtetë e vështirë të paramendohet të ushtrosh dhe reflektosh unitetin e vërtetë të popullit në një ambient politik të papërshtatshëm, në mes forcash politike divergjente, presionet që i ishin bërë presidentit Moisiu, madje ai i kishte pohuar edhe vetë²⁶. Madje kulmi i ambientit të keq që njëherit shpeshherë i kishte bërë të pamundur z. Moisiu reflektimin dhe përfaqësimin e unitetit të popullit ishte ndërrimi i qeverisjes në Shqipëri dhe ardhjes në krye të mazhorancës të partisë demokratike, madje kjo kishte eskaluar kur kryetarja e kuvendit që vinte nga radhët e partisë demokratike i kërkoj “falje publike” popullit që partia demokratike e kishte përkrahur z. Moisiu si president²⁷, sigurisht për faktin që ai nuk pranonte që të bëhej pjesë e “bashkëqeverisjes” me mazhorancën e re.

Në këtë kontekst, legjitimiteti, që transmetohet përmes mënyrës së zgjedhjes është shumë i rëndësishëm për të pasur një president që përfaqëson unitetin e popullit. Njëjtë sikurse Republika e Shqipërisë, edhe ajo e Kosovës ka pasur probleme me figurën e Presidentit. Sidomos janë shfaqur probleme në procedurën e zgjedhjes së tij, apo më mirë thënë nuk ka pasur vullnet të qartë, aspekt ky që e ka bërë të vështirë edhe reflektimin e unitetit të popullit.

Vështirësitë e zgjedhjes së Presidentit në Republikën e Kosovës u vërejtën që në zgjedhjet e para. Po ashtu edhe në zgjedhjet e dyta

²³ Fjala është për Kushtetutën e Republikës së Kosovës, 2008.

²⁴ Alfred Moisiu, “Kompetencat e Presidentit në fushën e sigurisë”, marrë nga fjalimi i z. Moisiu në konferencën rajonale “Roli i Presidentit në përcaktimin e modelit të qeverisjes në Republikë - përvojat rajonale”, botuar në revistën Constitutio, fq. 49.

²⁵ Një gjë të tillë e ka pranuar dhe e ka argumentuar edhe prof. Aurela Anastasi në ligjëratën e mbajtur në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, më 14 nëntor 2012.

²⁶ Alfred Moisiu “Midis Nanos dhe Berishës”, Kujtime, vëllimi III, Toena, 2009.

²⁷ Luan Omari, “Ndarja e Pushteteve dhe pavarësia e institucioneve kushtetuese”, fq. 76.

parlamentare, si dhe këto të fundit, kur gjithçka është përfunduar me një marrëveshje politike si pasojë e mungesës së vullnetit për të zgjedhur një president konsensual i cili do të përfaqësonte vlerat dhe unitetin e popullit. Mungesa e gatishmërisë për të bërë një gjë të tillë shpeshherë në Republikën e Kosovës ka vënë në pikëpyetje refleksionin dhe kryerjen e funksionit të plotë kushtetues nga ana e Presidentit. Sikundër ka shumë rëndësi mënyra se si zgjedhet Presidenti, qoftë nga populli apo nga parlamenti, sa është ai i pranueshëm dhe i përkrahur qoftë nga ana e popullit apo e deputetëve si të zgjedhur të tij, të gjitha këto çështje janë relevante kur është fjala e reflektimit të unitetit të popullit, ku legjitimiteti i fortë i Presidentit njëherësh do t'i mundësonte dhe hapte rrugë reflektimit maksimal për përfaqësimin e unitetit të popullit nga presidenti.

1.2.1.2. Elementet e tjera

Neutraliteti i vendimeve dhe i veprimeve të presidentit është një element shumë i rëndësishëm përmes të cilit presidenti mund të reflektojë dhe të përmbushë në mënyrën sa më të mirë unitetin e popullit. Një president neutral nënkupton një president balancues, një president i cili peshon vendimet e tij dhe në çfarëdo forme bën baraspeshën ndërmjet pushteteve. Presidenti nuk mund të reflektojë unitetin e popullit në qoftë se vendimet e tij janë në një vijë me ekzekutivin apo mazhorancën e cila e ka qeverinë. Për të reflektuar neutralitet presidenti duhet të dëshmojë që vendimet e tij janë në të mirë të popullit, mbi të gjitha të balancuara dhe kredibile duke mos lënë kështu asnjë fije dyshimi në lidhje me efektin e vendimeve të tij.

Siç e thotë edhe vetë profesor Luan Omari, shpeshherë sulmet politike ndaj presidentit Moisiu në Shqipëri janë bërë për shkak të vendimeve të tij, në këtë rast kthimin në shumicën e rasteve, pra kthimin e ligjeve. Vendimet e shumta të z. Moisiu për kthimin e ligjeve, duke pretenduar që janë kundërkushtetuese, i kishte vërtetuar edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë²⁸. Kësisoji ishte vepruar edhe ndaj presidentit Topi, i cili për t'iu ikur dhe për t'u distancuar nga politikat e përditshme të sigurisë kishte "guxuar" që të kthente madje ligjet, por edhe të merrte vendime të tjera të guximshme, të cilat disa prej tyre edhe ishin penguar nga ana e mazhorancës, madje edhe ishin rrezuar në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë.

²⁸ Luan Omari, "Vepra e cituar", fq. 78.

Neutraliteti i Presidentit reflektohet sidomos në rastet kur ai distancohet nga ngjarjet e politikës së përditshme, por edhe kur vendimet e tij janë të peshuara mirë. Neutralitetin në figurën e presidentit mund ta shfaqë më së miri të qenit e presidentit jashtë partisë politike, së këndejmi presidenti duke shfaqur neutralitet në ushtrimin e kompetencave të tij, tregon dhe shfaq njëherit edhe përfaqësim të unitetit të popullit.

Në Republikën e Kosovës ka ngjallur shumë reagime vonimi i emërimit të Sylejman Selimi si komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës, sepse për një gjë të tillë duhet të koordinoheshin presidenti dhe kryeministri, ndërsaq presidenti i Republikës së Kosovës z. Sejdu, si autoritet përfundimtar për emërimin e tij e pati vonuar dekretimin e Selimit si komandant, e diçka e ngjashme kishte ndodhur edhe në rastin emërimit të drejtorit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës. Po ashtu edhe rasti i refuzimit dhe mosdekretimit të listave të kandidatëve për gjyqtarë nga ana e ushtruesit të detyrës së Presidentit nga Jakup Krasniqi, ishte parë si vendim i guximshëm dhe mbi të gjitha vendim që kishte reflektuar në një masë apo tjetër unitetin e popullit. Të qenit neutral i presidentit në vendimet e tij e bën atë që të nxjerr në masë të madhe në pah faktin që është përfaqësues i uniteti të popullit, elementit mbase më të rëndësishëm që e bën presidentin të jetë i dallueshëm nga shtyllat e tjera të pushtetit.

Menaxhimi i krizave dhe lidershipi është një ndër elementet po ashtu të rëndësishme i cili tregon maturinë e presidentit, njëherit reflekton pashmangshëm edhe unitetin e popullit. Lidershipi i presidentit është njëra ndër karakteristikat e presidentit, e cila i ndihmon që të shfaq tek qytetarët sensin për përfaqësim të unitetit të popullit. Se sa është i rëndësishëm lidhershhipi si veçori tek personaliteti i presidentit, mund ta tregojë edhe raporti që ai ka sidomos me kryeministrin dhe qeverinë. Është interesante se mazhorancat parlamentare, që e udhëheqin edhe qeverinë, kanë një tendencë të heshtin rolin e presidentit dhe aktivitetin e tij në jetën politike. Nëse i analizojmë vetëm disa vende, sidomos këto të Evropës Juglindore, në përgjithësi nga ana e partive politike të vendeve përkatëse është vërejtur tendencë për të bërë një marginalizim të presidentit; kjo është vërejtur vetëm duke parë rolin e presidentit në jetën politike. Sigurisht, në shumicën e rasteve, “dyluftimi” kushtetues ndërmjet një presidenti dhe mazhorance parlamentare, gati që ka qenë i pamundur, sepse si i tillë ka paralizuar sistemin kushtetues. Një gjë e tillë është vërejtur qartazi në Republikën e Shqipërisë, atë të Kosovës, Maqedonisë, Serbisë e cila madje një kohë pati bllokuar çështjen e

presidentit derisa i bëri ndryshimet e duhura kushtetuese. Një tendencë e tillë shihet edhe në Slloveni. Diçka më të avancuar sidomos në kontekstin e përfaqësimit të unitetit të popullit e kemi parë në institucionin e presidentit në Republikën e Kroacisë. Një president me karakteristika të theksuara lidërshipi për të reflektuar unitetin e popullit duhet të dëshmojë edhe si menaxher i mirë i krizave institucionale, e një menaxhim i tillë, duke forcuar besimin tek qytetarët do të transmetojë gjithsesi edhe përfaqësimin e unitetit të popullit. Rasti më i mirë në këtë drejtim është ai i Italisë. Në bazë të statistikave të autorëve të ndryshëm, në 50 vitet e fundit në Itali për shkak të krizave të shpeshta janë ndërruar mbi 50 qeveri, kjo ka bërë që qytetarët italianë të shtojnë gjithnjë e më shumë besimin te presidenti i tyre, meqë e shihnin të tillë si një lloj “shpëtimtari” dhe institucioni i cili mbulonte dhe menaxhonte mjaft mirë vakuumin institucional, që krijohet sidomos me rrëzimin e shpeshtë të qeverisë.²⁹

Unifikimi i politikave shtetërore ndoshta përbën elementin më të vështirë të transmetueshëm te një president, sidomos tek presidentët të cilët zgjedhën nga parlamenti, marrë parasysh mënyrën e zgjedhjes. S’ka dilemë që roli i presidentit në unifikimin e politikave shtetërore është vendimtar, e kjo transmetohet sidomos përmes kompetencës së zakonshme të “përfaqësimit të vendit brenda dhe jashtë” nga presidenti. E thamë më parë që unifikimi i politikave si i tillë është vështirë i transmetueshëm, mbase për faktin që mund të paraqiten rrallë situata kur edhe kërkohet roli i presidentit, që përmes unifikimit të politikave të reflektojë realizimin e përfaqësimit të unitetit të popullit. Lidhur me këtë element, Republika e Kosovës, përkatësisht Presidentja Jahjaga, edhe pse e komentuar shumë për shkak të mënyrës së zgjedhjes, në disa aspekte ka shfaqur elementin e veprimit për unifikim të politikave shtetërore! Së këndejmi, krijimi i këshillit kombëtar kundër korrupsionit çmohet si një veprim i unifikuar i politikave ekzekutive në luftimin e korrupsionit në Republikën e Kosovës. E njëjta formulë u zgjodh edhe në rastin e krijimit të këshillit kombëtar për integritet evropian. Edhe pse shikuar në aspektin e ngushtë, krijimet e institucioneve të tilla mund të dalin edhe jashtë fushëveprimit dhe karakterit të kompetencave të Presidentit në Republikën Kosovës, por analizuar në relacion me unitetin e popullit një gjë e tillë është e qëndrueshme.

²⁹ Mbi strukturën kushtetuese dhe veprimtarinë institucionale të Republikës së Italisë dhe Republikës së Shqipërisë, Teki Ali Kurti, Tiranë 2003, fq. 68.

Unifikimi i politikave është i lidhur ngushtë edhe me elementin tjetër, pra **balancimin dhe ruajtjen e balancit të pushteteve nga ana e presidentit**. Presidenti, për të reflektuar unitetin e popullit, duhet të garantojë funksionimin kushtetues të institucioneve dhe njëherit të bëjë balancimin e pushteteve, duke mos i lënë që ato të devijojnë nga misioni i tyre kushtetues. Duke qenë garantues i funksionimit të pushteteve, presidenti reflekton edhe unitetin e popullit. Si mund të luajë presidenti rolin e balancimit ndërmjet pushteteve dhe njëkohësisht të garantojë funksionin e tyre kushtetues? Shembull, rasti i përdorimit të vetos së presidentit gjithnjë ka vënë në pah përveç refleksionit për përfaqësim të unitetit të popullit edhe atë të garantimit për funksionimin kushtetues të institucioneve, por edhe të balancimit të pushteteve. Kthimi i ligjeve nga ana e presidentit tregon tendencën për të garantuar funksionimin kushtetues të parlamentit në këtë rast.³⁰ Rasti tjetër që presidentit i mundëson që të realizojë një element të tillë është emërimi i zyrtarëve të lartë shtetërorë, një gjë e tillë reflekton sidomos raportin ndërmjet ekzekutivit dhe presidentit, refuzimi i zyrtarëve të lartë me një arsye nga ana e presidentit, p. sh. i ambasadorëve, nënkupton garanci për funksionimin kushtetues të institucioneve se sa është kjo e realizueshme në praktikë mbetet çështje e diskutueshme. Së andejmi, mund të marrim shembull edhe dekretimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ose edhe zyrtarëve të lartë të bartësve të institucioneve të sigurisë, ku mund të reflektohet një element i tillë që reflekton pastaj edhe elementin e unitetit të popullit.

Të qenit figurë jashtë partive politike e presidentit është padyshim një ndër elementet ndoshta më vështirë të realizueshme, si në rastet kur presidenti zgjedhet nga populli, ashtu edhe në rastet kur ai zgjedhet nga ana e parlamentit. Të qenit jashtë partive politike e presidentit do të thotë thjesht një president konsensual, një president i cili më parë nuk ka qenë apo nuk ka ushtruar funksione politike, por mbi të gjitha është person i respektuar tek qytetarët e një vendi. Është vështirë të paramendohet një president që nuk ka origjinën nga një parti politike, marrë parasysh raportin e forcave politike në një vend, por në anën tjetër të bërit realitet i këtij elementi do të ishte një kartë shumë e fuqishme në dorën e presidentit, që në vazhdimësi do të reflektonte unitetin e popullit. Një gjë e tillë ishte provuar në Shqipëri me ish-presidentin Moisiu, kur u bë kompromisi, meqë ai erdhi i tëri si figurë jashtë politike. Në fakt konsensualiteti për të zgjedhur një

³⁰ E drejta e vetos së presidentit është një e drejtë universale, e paraparë në shumicën e kushtetutave të vendeve demokratike.

president që praktikisht nuk ka qenë shumë aktiv në jetën politike, por që ka ndërtuar reputacion mbi bazën e të arriturave të caktuara është mbi të gjitha problemi më i madh, pasi që në çfarëdo forme partitë politike tentojnë që kandidati i tyre i caktuar të jetë edhe president, gjë që figurën e presidentit shpesh e shndërron më tepër në një president partiak sesa një përfaqësues i unitetit të popullit.

Edhe transparenca e punës së presidentit përbën një element shumë të rëndësishëm, kjo puna transparente e tij, i ndihmon qytetarët që të qartësohen dhe të binden për qasjen e presidentit ndaj tyre, transparenca sigurisht që reflekton një nuancë të përfaqësimit të unitetit të popullit, për faktin se puna e hapur e tij gatishmëri që funksioni kushtetues i presidentit, në një formë apo tjetër të jetë në diskonim të qytetarëve të vendit.

Nisur nga këto elemente të identifikuara si elemente që në një formë apo tjetër identifikojnë transmetimin e elementit të unitetit të popullit, në kontekst praktik në botë na paraqiten edhe raste të cilat dalin edhe jashtë koncepteve teorike të shtjellimit qoftë të unitetit të popullit apo edhe të elementëve të tjera që e karakterizojnë figurën e presidentit. Një rast i tillë, do të thoja i rrallë në praktikë, është rasti i presidentit të Uruguait Joze Mujica, një president i cili për të shfaqur modestinë dhe njëherit karshi kësaj vlerat e vërteta të një prijësi popullor, përkundër që është i pari i vendit, bën një jetë mjaft modeste, duke jetuar në fermën e tij në një fshat të vendit, i zhveshur komplet nga privilegjet e pushtetit. Një njeri modest, një i burgosur politik për 14 vite, z.Mujica për të transmetuar dashurinë dhe përkushtimin ndaj qytetarëve të tij, një pjesë të rrogës, madje edhe rezidencën e tij në kryeqytet e ka liruar për njerëzit e varfër. Ajo që ia vlen për t'u përmendur është fakti që edhe opozita e Uruguait e pranojnë se në kohën e z.Mujicës janë përmirësuar edhe rritja ekonomike, arsimi dhe shëndetësia. S'ka dyshim që kjo praktikë, në aspektin e ndërlidhjes me elementet teorike, që i mundësoi presidentit për ta kryer siç është më së miri funksionin kushtetues, në rastin e Presidentit të Uruguait është dukur krejt ndryshe, ndoshta për faktin që praktika e tij e papresedan është e pakrahasueshme me elementet teorike që i kemi shqyrtuar.³¹ Më parë presidenti i Uruguait për të dëshmuar se përfaqëson unitetin e popullit kishte përdorur veton ndaj ligjit për abortin, e cila kishte ngjallur reagime të shumta sidomos nga liderët dhe kundërshtarët opozitarë³².

³¹ <http://www.bbc.co.uk/news/world-latin-america-20334136>.

³² <http://www.laht.com/article.asp?CategoryId=12394&ArticleId=320478>.

2. Rasti i Republikës së Kosovës - presidenti dhe uniteti i popullit

Republika e Kosovës si një vend që ka kaluar nëpër një fazë të vështirë të tranzicionit, e cila ka qenë karakteristike sidomos për rrugën e shtetkrijimit dhe shtetndërtimit, sigurisht se ka pasur reflektim edhe tek institucioni i presidentit. Institucioni i presidentit në Kosovës, në kuptimin e fuqisë kushtetuese, deri pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ka lënë shumë për të dëshiruar pasi që ai ka qenë nën margjinat e PSSP-së.³³ Edhe pse qysh në procesin e hartimit të Kornizës Kushtetuese, institucioni i presidentit kishte ngjallur debate për shkak të rëndësisë së tij. Debatet kryesisht janë zhvilluar në orientimet e segmentit që ka të bëjë me mënyrën e zgjedhjes nga parlamenti ose drejtpërdrejt nga populli.³⁴ Pavarësisht debateve, Kosova kishte mbetur në stadin e një presidenti të zgjedhur nga parlamenti i cili kishte sjellë problemeve në vazhdimësi, e këto probleme paraqitnin probleme të tjera shumë më mëdha që i pamundësonin presidentit të shfaqte unitetin e popullit.

Nisur nga viti 2001, atëherë kur Kosova krijoi institucionet e saj, në vazhdimësi janë transmetuar probleme që kanë vështirësuar funksionimin, por edhe zgjedhjen e presidentit. Marrë në përgjithësi, problemet e shfaqura kanë treguar që posti i presidentit është shndërruar në një post ordiner politik dhe pjesë e pazareve, madje ndonjëherë edhe në nivelin e ndarjes së ndonjë posti ministror politik. Që në vitin 2001, kriza e krijuar ndërmjet LDK-së dhe PDK-së ishte e lidhur me figurën e presidentit! LDK-ja madje lëshoi vetë pe dhe e zhblllokoj krizën, pasi që vërejtj që presidentit historik i Kosovës z. Rugova po i rrezikohej posti. Pavarësisht kësaj, të njëjtat probleme u shfaqën edhe në vitin 2005, të cilat probleme dëmtuan në masë të madhe elementin e popullit te presidenti për shkak që figura e tij në vazhdimësi bëhej pjesë e koalicioneve. Edhe pse PDK atëbotë kishte ofruar zgjidhje, duke propozuar që të gjendet një president konsensual dhe një figurë jashtë politike për të mundësuar që sa më mirë të përfaqësohet uniteti i popullit, megjithatë fituesit e zgjedhjeve vepruan sipas formulës së vjetër, duke e bërë prapë presidentin pjesë e marrëveshjeve për koalicion, pa e ndarë çështjen, sërish lideri i partisë fituese u konfirmua president. Vdekja e z.Rugova kishte futur sërish Kosovën në testim për të matur unitetin e klasës politike për figurën e presidentit. Sërish kishte probleme, kur z.

³³ Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, autoritet përfundimtar për zbatimin e Kornizës Kushtetuese.

³⁴ Intervistë me Prof. Dr. Arsim Bajramin, datë 18.1.2013.

Sejdu me vështirësi u zgjodh President, si zëvendësues i z.Rugova, por jo me konsensus dhe pa kundërshtime. Pavarësisht kësaj, është shumë evident fakti që nëse e shohim çështjen në kontekstin e unitetit të popullit gjatë administrimit ndërkombëtar, ka qenë vështirë që të vihet në pah uniteti i popullit të Presidentit në kuptimin e ushtrimit të funksioneve kushtetuese për faktin se pengesë reale ishte PSSP-ja dhe roli i saj në sistemin kushtetues të Kosovës gjatë asaj kohe, edhe pse në pozitën e Presidentit gjatë kësaj periudhe kishte qenë personi që në fakt ishte simbol i këtij pozicioni në Kosovë. Miratimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ndërroi plotësisht kompozicionin e Presidentit, në kuptimin e rolit dhe fuqisë kushtetuese, edhe pse përsëri ishte shprehur elementi partiak dhe jokonsensual në rastin e zgjedhjes. Në postin e Presidentit u rizgjedh prapë z.Sejdu, i cili mori në raundin e tretë 68 vota.

Dilemën që e kemi shtruar më lart sa i përket çështjes, se sa mundet një president i cili ka ardhur si pasojë e një koalicioni politik, ku më parë është bërë i ditur emri i kryeministrit, të ushtrojë unitetin e popullit. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në brendi të saj sillte shumë mundësi dhe instrumente kushtetuese me të cilat presidenti do të mund të garantonte unitetin e popullit dhe të mundësonte funksionimin kushtetues të institucioneve³⁵.

Nëse e tërheqim çështjen në një vijë tjetër, lind pyetja se sa ka mundur Presidenti i Republikës së Kosovës që të reflektojë unitetin e popullit? Është vërejtur që duke filluar nga z. Sejdiu, Pacolli, e më pak Presidentja Jahjaga, kanë pasur vështirësi serioze në përfaqësimin e plotë të parimit të unitetit të popullit, marrë parasysh mënyrën dhe rrugën politike se si kanë ardhur në postin e presidentit, kryesisht mbi bazën e “partitizimit” të postit të presidentit.³⁶

Presidenti Sejdiu, si njeri që kishte përjetuar përpjekjet për të reflektuar unitetin e popullit, e që në shumë raste kishte arritur falë karizmës dhe elegancës së tij gjatë ushtrimit të detyrës! Megjithatë, edhe ai kishte hasur në pengesa dhe dilema dhe krejt këto vështirësi lidheshin me rrethanat politike, ambientin politik dhe pamundësitë që të gjitha funksionet kushtetuese të presidentit të ushtroheshin ashtu siç ishte më së miri. E themi këtë për faktin se një analizë e nenit 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës na çon në përfundimin e ndarjes së pushtetit ekzekutiv ndërmjet kryeministrit dhe të presidentit, meqë ka

³⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 84, transmeton fuqinë kushtetuese të Presidentit përmes kompetencave të tij.

³⁶ Opinion, “Partitizmi i Presidentit”, botuar në Koha Ditore, 20 shkurt 2011.

shumë kompetenca që ndahen ndërmjet tyre, ndërsa për t'u ushtruar me efektivitet kërkojnë bashkëpunimin e kryeministrit dhe presidentit. Në Republikën e Kosovës u tregua jo shumë funksionale zgjedhja e udhëheqjes së pozitës së kryeministrit nga dy partitë më të mëdha, e aq më shumë i ashtuquajti "partitizëm i presidentit", i cili i kishte pamundësuar Presidentit Sejdiu shpeshherë ushtrimin e funksioneve reale kushtetuese. Kjo kishte rezultuar pastaj edhe me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila kishte cilësuar se z. Sejdiu kishte bërë shkelje të rëndë të kushtetutës, duke plotësuar kushtin për shkarkim si një lloj sanksioni kushtetues. Ish-presidenti Sejdiu, vështirësitë që i shihte te ky kompozicion dhe format e presidentit, sidomos kur ishte çështja e reflektimit të unitetit të popullit, e kishte shfaqur edhe në një konferencë studimore për praktikën rajonale të presidentit, me theks të veçantë Republika e Kosovës, duke treguar edhe përvojat e tij si ish-president. Lidhur me këtë ai shprehet kështu:

"Pavarësisht nga kjo, pjesa e debatit që u zhvillua, mendoj se megjithatë do të gjen pika të përputhshme dhe këto rrjedhin më së drejtpërdrejt për pjesët që bien ndesh deri tani në jetën kushtetuese të Kosovës, përkatësisht për tre-katër sosh e që janë nga fushat më të rëndësishme e që si të tilla edhe janë atakuar, apo janë pjesë e projektit për ndryshime.

Do të përpiqem të prezantoj paralelisht edhe përshtypjet e mia si ish president i vendit, por edhe për periudhën e mëvonshme, pasi nuk jam në këtë detyrë, kur kam theksuar se nuk mund të bëhet ndryshimi kushtetues vetëm për mënyrën e zgjedhjes së presidentit të vendit. Në këtë kuadër profesor Bajramit³⁷ i kujtohet mirë në një nga debatet që i kemi pasur në një organizëm tjetër, kam shtruar nevojën e hulumtimit të mirë në përputhje të asaj se çka duhet të shkojë si pjesë e pakos së përbashkët me vetë ndryshimin e zgjedhjes që të dalë, pra me idenë e përputhshme, një president nga vota e qytetarëve dhe çka implikon kjo në disa fusha të drejtpërdrejta dhe ato që lidhen posaçërisht me pushtetet e caktuara dhe në veçanti me ato që kanë të bëjnë me Qeverinë e Kosovës, përkatësisht me kryeministrin e vendit.

Këto i kam thënë nga një arsye e vetme sepse jam njeri që e kam përjetuar, flas, edhe me tjerë që e kanë përcjellë këtë pjesë, nganjëherë edhe të paqartësive, që kanë dalë nga Kushtetuta e Kosovës dhe

³⁷ Është fjala për Prof. Dr. Arsim Bajramin, në këtë kohë kryetar i komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, por edhe anëtar i komisionit shtetëror që ka shkruar kushtetutën e vitit 2008.

nganjëherë të them edhe nga faktorë të tretë, edhe jashtë kësaj pjese, nga ambiciet që të keqpërdoret një normë e caktuar kushtetuese e cila nuk ka qenë shumë mirë e precizuar apo e definuar dhe ka lënë hapësirën e keqinterpretimeve apo keqshfrytëzimit, them më drejtpërdrejt”³⁸

Nga sekuencat e shkëputura nga fjalimi i tij shihen qartë lidhjet që i bënte z.Sejdiu jo vetëm me formën e zgjedhjes së presidentit, por sidomos segmentet që lidheshin me ndarjen e kompetencave ndërmjet presidentit dhe kryeministrit, të cilat ai vetë i kishte provuar në praktikë. Shihet qartë për problemet që kanë sjell dispozitat e nenit 84, sidomos kur bëhet fjalë për pushtetin që ndahej ndërmjet kryeministrit dhe presidentit. Madje fjala “faktorë të tretë” na lë të nënkuptojmë situatat dhe ambientin politik i cili kishte pamundësuar një gjë të tillë. Apo kur përmendet edhe fjalia “...nga ambiciet që të keqpërdoret një normë e caktuar kushtetuese e cila nuk ka qenë shumë mirë e precizuar..”, tregohet qartë për mëdyshjet dhe pengesat, e njëherit edhe pamundësitë për një ushtrim efektiv të kompetencave kushtetuese, sidomos ato që linin hapësirë për t’u interpretuar në mënyra të ndryshme. Madje në të njëjtin fjalim z.Sejdiu pohon për një pozicion shumë më të mirë të presidentit me kornizën kushtetuese³⁹, paralele kjo e tërhequr që na jep të kuptojmë rëndësinë e një presidenti, i cili nuk është pjesë e mazhorancës dhe qëndron më larg politikës në vendimmarrje. Fatkeqësisht, formula që ende është në fuqi imponon që të kemi një president, i cili është peng i mazhorancës, e cila pastaj ndikon dhe kushtimisht reflekton edhe në funksionin kryesor të presidentit, pra unitetin e popullit. Pamundësia dhe rrethanat pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese quan Republikën e Kosovës në përpjekjet për të gjetur zgjidhje më të mira kushtetuese të cilat do t’i mundësonin presidentit që në mënyrë sa më të efektshme të kryejë funksionin e tij kushtetues.

2.1 Uniteti i popullit si faktor që çoi Republikën e Kosovës drejt zgjedhjeve të reja kushtetuese

I ashtuquajtur “partitizëm” i presidentit u dëshmuar shumë president në Kosovë, i transmetuar dy herë tek presidenti Rugova dhe Sejdiu, të cilët kishin vështirësi të zgjedheshin, si pasojë e mungesës së konsensusit, i cili konsensus ka paraqitur shpeshherë pengesa në

³⁸ Shkëputur nga fjalimi i ish-presidentit Sejdiu në konferencën rajonale “Roli i presidentit në përcaktimin e qeverisjes në Republikë - mësimet dhe përvojat rajonale”, 28.2.2012.

³⁹ Po aty.

kontestin e unitetit të popullit. Situata e krijuar me figurën e presidentit në Republikën e Kosovës eskaloj pas vendimit të datës 28.9.2010, nr. ref. AGJ 43/10, Lënda nr. kl 47/10, kur Gjykata Kushtetuese provoi shkeljen e rëndë kushtetuese të Presidentit Sejdiu, lë shumë për të dëshiruar mënyra se si u bë kjo, por sigurisht që për një moment të gjithë e kuptuam rëndësinë e presidentit dhe reflektimin e unitetit të popullit dhe figurën e presidentit për qytetarët, pasi që një gjë e tillë prodhoi krizë. Mbajtja e zgjedhjeve të reja dhe procedurat për krijimin e institucioneve demokratike në Republikën e Kosovës përsëri spikatën anomalitë e vjetra që kishte Kosova për figurën e presidentit, duke qenë se nuk gjendej konsensus ndërmjet partive për një figurë që do të përfaqësonte unitetin e popullit. Siç ndodhte më parë, edhe kësaj radhe u dasht të dihet emri i kryeministrit, të bëhej koalicioni qeverisës, në mënyrë që të përcaktohet edhe figura për president. Kjo solli kulmin në seancën e Kuvendit të datës 21 shkurt 2011, ku kandidati i dominuar për president u shoqërua me bojkot të seancës së përfaqësuesve të popullit, në mungesë të konsensusit për një gjë të tillë. Kjo përpos që vinte në pikëpyetje legjitimitetin, sigurisht që vinte në pikëpyetje të madhe edhe parimin e unitetit të popullit, të cilin do të mund ta ushtronte një president pa legjitimitet, duke qenë se seanca u bojkotua nga shumica e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Edhe pse kjo sfidë u tejkalua nga ngutia e madhe për t'u bërë një gjë e tillë, procedura e zgjedhjes së presidentit në atë seancë u shoqërua me shkelje kushtetuese, të cilat definitivisht e futën Republikën e Kosovës në një udhëkryq dhe sollën në situatë që të mendohej mirë për pozicionin kushtetues dhe mënyrën e zgjedhjes së tij, e cila ashtu siç ishte aktualisht, impononte konsensus politik, që në Kosovë gjithnjë kishte munguar. Shkeljet kushtetuese që ndodhën në seancën përkatëse u vërtetuan edhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. ko 29/11, i datës 30.3.2011, përmes të cilit u kontestua zgjedhja e Presidentit Pacolli.

Pavarësisht kësaj, në kontekstin e asaj që po e analizojmë çështjen, pra kontekstin e shikimit kah legjitimiteti i presidentit gjatë kohës edhe pse të shkurtër të qëndrimit të z.Pacolli si President i Republikës së Kosovës,⁴⁰ kishte ndërmarrë disa veprime, që në një formë apo tjetër bartnin në vete një theks transmetimi të unitetit të popullit, duke parë për nga elementi i transparencës dhe gatishmërisë së tij për punë.

⁴⁰ Përfshin kohën nga data e zgjedhjes, 22 shkurt 2011, deri në datën e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, 30.3.2011.

Vendimi i gjykatës kushtetuese për procedurat kundërkushtetuese të zgjedhjes së presidentit vuri përsëri në sprovë faktorin politik për t'u bashkuar drejt konsensusit për një figurë të re për president të vendit, i cili do të përfaqësonte sa më mirë që të jetë e mundur unitetin e popullit. Megjithëse një gjë e tillë u arrit, ky konsensus pati një çmim, sepse u arrit me kushtin që Republika e Kosovës t'i hynte ndryshimeve të Kushtetutës, që do të mundësonin zgjedhjen e presidentit drejtpërdrejt nga qytetarët, si formë e cila do të largonte mundësitë për të manipuluar me institucionin e presidentit, si formë që do të forconte legjitimitetin e presidentit dhe njëherit do të rriste edhe mundësitë për një përfaqësim dinjitoz të unitetit të popullit, që kishte munguar në Kosovë.⁴¹

Kjo mbase ishte zgjidhja më e mirë për të mos e komplikuar situatën dhe njëherit për t'i dhënë mundësi që figura e presidentit t'i shfaqë vlerat që meriton, duke i hapur edhe rrugën e funksionalitetit të tij kushtetues. Ashtu siç ishte paraparë në marrëveshje, kompletimi i reformës kushtetuese më pas do ta çonte Republikën e Kosovës në zgjedhje të reja presidenciale, në mënyrë që populli të provojë legjitimitetin dhe mbi të gjitha unitetin që mund të ofronte një president popullor! Një gjë e tillë edhe e kishte ofruar reforma kushtetuese, e cila kishte dhënë një platformë moderne të zgjedhjes së presidentit nga populli, duke marrë për bazë praktikën më të mira kushtetuese. Pavarësisht kësaj, çështja e presidentit në Republikë mori një kahje tjetër, një kahje të një rruge të komplikuar sa politike, aq edhe juridike. Ani pse reforma kushtetuese u kompletua me kohë mbi bazën e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës konform nenit 144 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilës Gjykata Kushtetuese ka juridiksion për vlerësimin paraprak të amendamenteve, për përputhshmërinë e tyre me liritë dhe të drejtat e qytetarit, ose konkretisht me kapitullin II të vetë Kushtetutës.

Mbase mund të duket një këndvështrim jo adekuat ndërlidhja e mendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe reformë kushtetuese me çështjen bosht të temës, pra legjitimitetin e popullit si atribut të fuqishëm të presidentit, por s'ka dilemë që kjo ndërlidhje ekziston, meqenëse gjithçka lidhet me legjitimitetin si një element shumë i rëndësishëm që mundëson një president të reflektojë unitetin e popullit. E thamë edhe më lart, një marrëveshje për të tejkaluar krizën

⁴¹ Pika 1 dhe 2 e marrëveshjes politike ndërmjet tre liderëve, z.Thaqi, z.Pacolli dhe z.Mustafa, e lidhur me 6 prill 2011.

politike, “prodhoi” një president konsensual, por edhe një kusht, e ky kusht ishte kompletimi i platformës kushtetuese dhe ligjore për të çuar përpara realizimin e qëllimit për një president të pranueshëm dhe funksional. Nga garantuesit e marrëveshjes, presidenti ishte i përkohshëm, ndërsa interpretimi i Gjykatës Kushtetuese për amendamentet në fjalë sikur e komplikoj situatën, pasi Gjykata Kushtetuese disa amendamente i shpalli si të tilla që cenonjë liritë dhe të drejtat e qytetarit, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Pa dashur të lëshohemi në kualitetin e interpretimit të aktgjykimit në fjalë, sepse kjo i takon një dimensionit krejt tjetër. Pa dyshim, ajo që na bën të ndërlidhim çështjen bosht të temës me vendimin e Gjykatës Kushtetuese është mënyra e interpretimit të amendamentit 10, e cila vuri në pikëpyetje legjitimitetin e presidentes aktuale znj. Jahjaga, e cila kishte dalë nga marrëveshja e lartpërmendur e liderëve. Kësisoj, duke u vënë në pikëpyetje legjitimiteti, vihej në pikëpyetje edhe parimi i unitetit të popullit dhe mënyra e transmetimit të tij. Amendamenti 10 i pakos së amendamenteve të komisionit kushtetues, në frymën e marrëveshjes, kishte paraparë mbajtjen e zgjedhjeve të reja pas kalimit të periudhës 6-mujore, Gjykata Kushtetuese këtë amendament e kishte cilësuar si të tillë që cenonte liritë dhe të drejtat e njeriut, duke qenë se me vendimin e zgjedhjes së kuvendit të Republikës së Kosovës, mandati i Presidentes Jahjaga ishte 5-vjeçar. Ky interpretim e kishte komplikuar shumë situatën, duke ngjallur debate si për mënyrën e interpretimit të amendamenteve ashtu edhe për legjitimitetin e Presidentes, sepse interpretimi i Gjykatës Kushtetuese nxirrte nga funksioni marrëveshjen politike, ani pse zgjedhja e Presidentes kishte qenë e përkohshme⁴².

Tanimë nga një presidente e cila ishte konsensuale dhe përfaqësonte unitetin e popullit, ky interpretim kundër frymës së marrëveshje që solli konsensualitetin, çoi në një kontestim të legjitimitetit dhe vuri në pikëpyetje mundësinë për të reflektuar unitetin e popullit dhe rolin e tij në balancimin e pushteteve. Mospërkrahja, në shenjë kontestimi të legjitimitetit të Presidentes Jahjaga, u dëshmuar në seancën e 12 dhjetorit 2012, kur ajo mbajti fjalimin vjetor, ndërsa deputetët e LDK-se si partia më e madhe opozitare, njëherit garantues të marrëveshjes, e lëshuan sallën në shenjë proteste, duke kontestuar legjitimitetin e saj.

⁴² Interpretimi i, rastet Ko 29/12 dhe Ko 48/12, 20.7.2012, Agj. 284/12.

T'i kthehemi tani çështjes së debatit profesional, cilësisë së interpretimit të amendamentit 10 nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në mesin e shumë kritikëve, analiza që kishte ngjallur debatin më profesional në këtë kontekst ishte një analizë e z. Andrea Lorenzo Capussela, publikuar më 20.9.2012 me titull "Mandati i presidentit mund të shkurtohet", mbase disa sekuenca të analizës së tij në kontekst gjeneral ia vlen të bëhen po aq pjesë e kontekstit të asaj që po e shqyrtojmë. Madje që në hyrje z.Cpussela citon: "Mendimi i Gjykatës është i gabuar, shpjegimi pse e ndihmon debatin dhe mund të ndryshojë formën e demokracisë në Kosovë e cila qartazi ka nevojë për përmirësim"⁴³. Madje në këtë kontekst, Capussela të gjitha argumentet e dhëna nga ana e Gjykatës Kushtetuese në interpretim të mandatit të presidentes i quan të rrëshqitshme, të përsëritura, false dhe që nuk kanë të bëjnë fare me liritë dhe të drejtat e njeriut. Madje në njërën prej pikave të aktgjykimit, kur Gjykata Kushtetuese cilëson se "presidentes do t'i shkelej e drejta për mbrojtje juridike nëse do t'i merrej mandati, pasi ajo nuk mund të ankohet për këtë çështje në Gjykatë", por në këtë argument, siç e quan Capussela të rrëshqitshëm, ai thotë se për të eksituar e drejta për mbrojtje ligjore duhet të ekzistojë edhe një e drejtë tjetër e cila duhet të mbrohet. Si përfundim, ai thotë me ironi për këtë të drejtë që mund të pretendojë gjykata kushtetuese se është shkelur, është njësoj sikur "të shkosh të ankohesh në Gjykatë që Rita Ora refuzon të martohet me mua, por që në fakt unë nuk kam të drejtë pasi që kjo e drejtë e imja asnjëherë s'ka eksituar", andaj nuk mund ta kërkojë ta mbrosh një të drejtë kur s'ka çfarë të mbrohet⁴⁴.

Tanimë reforma kushtetuese për presidentin e cila është në pritje të miratimit, ka mbetur shpresa e vetme për të forcuar rolin e presidentit në kryerjen e funksionit kushtetues dhe transmetimin e unitetit të popullit, vetëm jetësimi i kësaj reforme mund të kthejë dinjitetin e "venitur" të figurës së presidentit, e cila në Republikën e Kosovës ka paraqitur problem të vazhdueshëm.

3. Përfundim

Nga ajo që kemi trajtuar deri më tani mund të vijmë në këto përfundime:

⁴³ Andrea Lorenzo Capussela, "Presidentit mund t'i shkurtohet mandati", botoi KOHA DITORE, 20.9.2012.

⁴⁴ Po aty.

1. Uniteti i popullit është një element shumë i rëndësishëm që përmes transmetimit të tij i mundësohet presidentit kryerja e funksionit real kushtetues dhe njëherit ky element e identifikon në tërësi figurën e presidentit;
2. Uniteti i popullit është më lehtë i transmetueshëm te presidentët që zgjedhen nga populli se sa tek ata që zgjedhen nga parlamenti;
3. Në vendet që e zgjedhin presidentin nga parlamenti vërehet një tendencë e përgjithshme e partive politike, sidomos e mazhorancës, për të marginalizuar figurën e presidentit dhe kjo tendencë pastaj e dëmton parimin e unitetit të popullit;
4. Mënyra e zgjedhjes së presidentit është përcaktuesi kryesor i cili ndihmon që presidenti sa më lehtë të transmetojë unitetin e popullit, sepse mënyra e zgjedhjes transmeton edhe legjitimitetin;
5. Vendet në tranzicion kanë pasur vazhdimisht probleme me figurën e presidentit, konform transmetimit të unitetit të popullit, për shkak të mungesës së kulturës politike, papjekurisë dhe mosunifikimit të qëndrimeve;
6. Uniteti i popullit duket në perspektivën e funksionimit, madje duket shumë më i pranueshëm në kuadër të një monarkie kushtetuese sesa në një demokraci jokonsensuale;
7. Në Republikën e Kosovës problemet me figurën e presidentit dhe reflektimin e unitetit të popullit janë më shumë transmetim i logjikës së qeverisjes së vendeve të Evropës Juglindore;
8. Institucioni i presidentit për të arritur maksimumin në reflektimin e unitetit të popullit duhet të ketë një pavarësi më të madhe kushtetuese karshi pushteteve të tjera, madje si i tillë duhet të jetë i ndarë sa i përket fushëveprimtarisë;
9. Qeveria, pavarësisht rrethanave, duhet të mundësojë ambient kushtetues, ligjor dhe faktik që presidenti të reflektojë unitetin e popullit. Në këtë kontekst roli i qeverisë si bartëse e pushtetit ekzekutiv është shumë i rëndësishëm;
10. Ndërrimi i platformës kushtetuese që ka të bëjë me presidentin do t'i shërbente Republikës së Kosovës, por edhe asaj të Shqipërisë për t'ia kthyer dinjitetin figurës së presidentit në kuptimin e realizimit të përfaqësimit të unitetit të popullit.

THE CONSTITUTIONAL POSITION OF THE PRESIDENT TOWARDS THE UNITY OF THE PEOPLE - ANALYTICAL REVIEWS

Summary

The paper entitled "*The Constitutional Position of the President against the unity of the people - Analytical Reviews*", aims to treat the main factor, and perhaps the key attribute of the president, the unity of the people.

It is well known that the president as one of the key institutions, should be apolitical and reflect, above all, on all the people and worthily represent all the citizens or people.

A problematic fact of this paper is decoding itself and finding attribute meaning to people's unity and its transmission in practice, since there are practically continuously displayed difficulties in transmission and reflection of the president as the representative of the unity of the people.

Many constitutions have foreseen the way of electing the president by the parliament, but many theorists and analysts as well raise the issue on how an elected president by the parliament and by the people, can implement the constitutional obligation to be a representative of the unity of the people .

Also almost all constitutions have foreseen a provision as "the president is the representative of the unity of the people and the nation," so here is exactly the shaft issue of thesis topic. Hence the paper also aims to shed light on the practical approach, to the implementation of the constitution, towards unity representation of the people and the nation, including the manner through which these elements can be transmitted.

Therefore, the paper highlights some scientific arguments on how the president can and should represent the unity of the people. With particular emphasis, the paper is also focused on practical challenges, analyzing the case of Kosova, Albania and other cases as well, on how presidents of aforementioned countries have transmitted representation for the unity of the people and nation.

Literatura:

Afred Moisiu, "Midis Nanos dhe Berishës", Kujtime, vëllimi III, "Toena", 2009.

Arsim Bajrami, punimi "Ndryshimet kushtetuese në Republikën e Kosovës", botuar në revistën CONSTITUTIO nr 1.

Kurtesh Salju, E DREJTA KUSHTETUESE, libri I, Prishtine, 1998.

Osman Ismaili, FILLET E SË DREJTËS, Prishtinë, 2011.

Luan Omari, "Ndarja e pushteteve dhe pavarësia e institucioneve kushtetuese".

Teki Ali Kurti, "Mbi strukturën kushtetuese dhe veprimtarinë institucionale të Republikës së Italisë dhe Republikës së Shqipërisë", Tiranë, 2003.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Kushtetuta e Francës.

Kushtetuta e Republikës së Greqisë.

Ligji Themelor i Republikës Federale Gjermane.

Kushtetuta e Hungarisë.

Kushtetuta e Italisë, 1948.

Kushtetuta e Mbretërisë së Spanjës.

Kushtetuta e Rumanisë.

Kushtetuta e Republikës së Kroacisë.

Kushtetuta e Republikës së Sllovenisë.

Kushtetuta e Federatës Ruse.

Kushtetuta e Republikës së Turqisë.

Kushtetuta e Bullgarisë.

Marrëveshja politike ndërmjet tre liderëve, z.Thaqi, z.Pacolli dhe z.Mustafa, e lidhur më 6 prill 2011.

Rasti Ko 29/12 dhe Ko 48/12, 20.7.2012, Agj. 284/12.

Alfred Moisiu, “Kompetencat e presidentit në fushën e sigurisë”, marrë nga fjalimi i z.Moisiu në konferencën rajonale “Roli i presidentit në përcaktimin e modelit të qeverisjes në Republikë - Përvojat rajonale”, botuar në revistën Constitutio.

Dokumentar “Monarkitë e Azisë”, shfaqur më 29.12.2012, Explorer Histori.

Intervistë me Prof. Dr.Arsim Bajramin, datë 18.1.2013.

Andrea Lorenzo Capussela, “Presidentit mund t’i shkurtohet mandate”, botoi KOHA DITORE, 20.9.2012.

Opinion, “Partitizmi i presidentit”, botuar në Koha ditore, 20 shkurt 2011.

Fjalimi i ish-presidentit Sejdiu në konferencën rajonale “Roli i presidentit në përcaktimin e qeverisjes në republikë - mësimet dhe përvojat rajonale”, 28.2.2012.

<http://storico.radiovaticana.va/alb/storico/2007>

[07/145842 bamir topi zgjidhet president i ri i republikes se shqiperise.html](http://storico.radiovaticana.va/alb/storico/2007/07/145842_bamir_topi_zgjidhet_president_i_ri_i_republikes_se_shqiperise.html).

<http://www.albpress.org/2011/07/25/topi-takon-moisiun-dhe-meidanin-te-ulete-tensionit-politik-po-demtohet-demokracia-dhe-institucionet/>.

http://setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/infoBios/setimes/resource_centre/bio-archive/moisiu_alfred.

<http://www.bbc.co.uk/news/world-latin-america-20334136>.

<http://www.laht.com/article.asp?CategoryId=12394&ArticleId=320478>

LIGJËRATË INAGURUESE

Arsim BAJRAMI

ARGUMENTIMI I GJND-së PËR PAVARËSINË E KOSOVËS

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dhe Juridiksioni i saj

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) është organi kryesor gjyqësor i Kombeve të Bashkuara. Është themeluar në vitin 1945 me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe ka filluar punën në prill të vitit 1946¹. Selia e Gjykatës gjendet në Pallatin e Paqes në Hagë të Holandës. Nga gjashtë organet kryesore të Kombeve të Bashkuara është Gjykata e cila është e vetmja që nuk gjendet në Nju-Jork të SHBA-së. Roli i Gjykatës është të vendosë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare për kontestet ligjore që dorëzohen në gjykatë nga shtetet dhe të japë mendime këshilluese për çështje ligjore që referohen nga organet e autorizuara të Kombeve të Bashkuara dhe agjencitë e specializuara. Gjykata përbëhet nga 15 gjykatës të cilët zgjedhen me mandat nëntëvjeçar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe Këshilli i Sigurimit. Gjykata ndihmohet nga Regjistri i saj që është organ administrativ. Gjuhët zyrtare të gjykatës janë gjuha angleze dhe ajo frënge.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë vepron si gjykatë botërore. Gjykata ka juridiksion të dyfishtë: ajo vendos në pajtim me të drejtën ndërkombëtare për konteste të natyrës ligjore që dorëzohen nga shtetet (juridiksioni në çështje të diskutueshme) dhe jep mendime këshilluese për çështje ligjore sipas kërkesës së organeve të Kombeve të Bashkuara apo agjencive të specializuara që janë të autorizuara për të bërë një kërkesë të tillë (juridiksioni këshillues).

¹ Gjykata e Përhershme Ndërkombëtare e Drejtësisë 1922-1946. Themelimi i Gjykatës së Përhershme Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJPND) paraardhësja e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ishte bërë me Konventën e Lidhjes së Kombeve. Ajo mbajti mbledhjen inauguruese në vitin 1922 dhe u shpërbë në vitin 1946. Puna e GJPND, gjykata e parë e përhershme ndërkombëtare me juridiksion të përgjithshëm, bëri të mundshëm qartësimin e një numri të aspekteve të së drejtës ndërkombëtare dhe kontribuoi në zhvillimin e saj. Ndërmjet viteve 1922-1946 GJPND u mor me 29 raste të kontesteve ndërmjet shteteve dhe dha 27 mendime këshilluese.

Kërkesa drejtuar Kombeve të Bashkuara

Më 26 mars 2008 Qveria e Serbisë paraqiti planin e saj që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë të vendosë për deklarimin e Kosovës për shkëputje. Serbia kërkoi të merrte mendimin nëse Deklarata kishte shkelur të drejtën ndërkombëtare. Gjithashtu, ishte ndërmarrë një nismë që kërkonte ndihmën ndërkombëtare nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, kur ajo u mbledh sërish në Nju-Jork në shtator të vitit 2008. Më 15 gusht 2008, Ministri i Jashtëm i Serbisë Vuk Jeremiq zyrtarisht dorëzoi kërkesën në Kombet e Bashkuara duke kërkuar mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Rezoluta ishte formuluar si vijon:

Duke ditur qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara,

Duke pasur parasysh funksionet dhe pushtetin e saj nga Karta e Kombeve të Bashkuara,

Duke kujtuar se më 17 shkurt 2008 Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë shpallën pavarësinë nga Serbia,

Të vetëdijshëm se ky akt është pranuar nga anëtarët e Kombeve të Bashkuara me reagime të ndryshme për sa i përket pajtueshmërisë së saj me rendin juridik ndërkombëtar,

Vendos në pajtim me nenin 96 të Kartës së Kombeve të Bashkuara për të kërkuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, në pajtim me nenin 65 të Statutit të Gjykatës për të dhënë një mendim këshillues në çështjen e mëposhtme:

“A është shpallja e pavarësisë së njëanshme nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare?

Më 30 shtator 2008 nisma serbe u hodh në votim të parë dhe u përkrah nga 120 shtete anëtare. Asambleja e Përgjithshme e miratoi këtë propozim si Rezoluta 63/3 në votimin e dytë me 77 vota në favor të kërkesës, 6 kundër dhe 74 abstenime.

Sigurimi i dokumenteve nga Kombet e Bashkuara

Më 9 tetor 2008, Sekretariati i Kombeve të Bashkuara informoi GJND-në se kishte filluar përgatitjet e një dosjeje që përmbante të gjitha dokumentet relevante për çështjen ligjore para Gjykatës, duke përfaqësuar trupin e së drejtës ndërkombëtare në këtë çështje.

Përveç vërejtjeve hyrëse, dosja përmbante një kopje të Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit, raporte të Këshillit të Sigurimit, raporte zyrtare për veprimtarinë e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), raporte për forcën e sigurisë të KFOR-it të udhëhequr nga NATO-ja, rregullore dhe marrëveshje ndërkombëtare të bëra nga UNMIK-u, raporte mbi aktivitetet e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse dhe për Procesin e Statusit të Kosovës. Gjithashtu ishin përfshirë instrumente të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare-universale apo regjionale siç janë kopje të Kartës së KB-së, të Aktit Final të Helsinkit, si dhe marrëveshje të ndryshme për të drejtat civile e njerëzore dhe dokumente të tjera ligjore nga Ballkani (p.sh. vendimet e Komisionit të Badinterit).

Procedimet gjyqësore

Më 21 prill 2009 GJND njoftoi se 35 shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara kishin deponuar deklaratat me shkrim brenda afatit kohor të caktuar nga gjykata (17 prill 2009) për çështjen e ligshmërisë së shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës. Edhe Kosova deponoi deklaratën e saj me shkrim. Shtetet që deponuan deklaratat e tyre me shkrim ishin Çekia, Franca, Qiproja, Republika Popullore e Kinës, Zvicra, Rumania, Shqipëria, Austria, Egjipti, Gjermania, Sllovakia, Rusia, Finlanda, Polonia, Luksemburgu, Libia, Mbretëria e Bashkuar, ShBA, Serbia, Spanja, Irani, Estonia, Norvegjia, Holanda, Sllovenia, Lituania, Japonia, Brazili, Irlanda, Danimarka, Argjentina, Azerbajxhani, Maldivet, Sierra Leone dhe Bolivia. Në këtë proces Kina dorëzoi për herë të parë zyrtarisht opinionin e saj në një rast para GJND-së. Shtetet që kishin deponuar deklaratat me shkrim u lejuan që të dorëzonin komente të shkruara në deklaratat e tjera deri më 17 korrik 2009. Venezuela u lejua që të dorëzonte dokumentet e saj edhe pas kalimit të afatit. Deklaratat me shkrim më të gjata ishin bërë nga Argjentina, Spanja, Rusia, Qiproja, SHBA-ja dhe Mbretëria e Bashkuar, ndërkaq Libia kishte dorëzuar deklaratën më të shkurtër. Qiproja solli një listë me regjionet e Evropës që mund të priten të pasojnë kërkesën dhe të bëjnë veprime të ngjashme të shkëputjes. Rusia dhe Sllovenia argumentuan nëse Kosova përbënte një rast unik. GJND ftoi po ashtu edhe Sekretarin e Përgjithshëm të KB-së Ban Ki-Moon për të dërguar deklaratën e tij. Dokumenti i tij përmbante tri pjesë, e para përkujton procesin që solli deri te rasti i GJND-së, e dyta shpjegon vendosjen e misionit të KB-së

në Kosovë dhe citon dy data relevante: Marsin e vitit 1998 si fillim të angazhimit të KB-së në Kosovë dhe shkurtin e vitit 2008 e cila përmendet si datë përmbyllëse, koha kur u shpall pavarësia e Kosovës. Në pjesën e tretë të deklaratës së tij, Ban Ki-Moon shkruan për dispozitat e së drejtës ndërkombëtare që lidhen me rastin pa e qartësuar pozicionin e tij në favor apo kundër pavarësisë. Katërmbëdhjetë shtete që kishin deponuar deklaratimet e tyre me shkrim dorëzuan edhe komentet për deklaratimet e tjera me shkrim. Këto shtete janë (sipas radhës së dorëzimit): Franca, Norvegjia, Qiproja, Serbia, Argjentina, Gjermania, Holanda, Shqipëria, Sllovenia, Zvicra, Bolivia, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Spanja. Edhe Kosova dorëzoi kontributin e saj me shkrim që përmbante komentet në lidhje me deklaratimet e shkruara.

Dëgjimet publike dhe argumentet ligjore të palëve

Dëgjimet publike u hapën më 1 dhjetor 2009. Gjatë këtyre dëgjimeve u paraqitën deklarata dhe komente me gojë nga disa shtete anëtare të KB (pa marrë parasysh se a kishin deponuar deklaratimet apo komentet e tyre me shkrim), si dhe nga përfaqësuesit e Kosovës (nën titullin “Autorët e shpalljes së njëanshme të pavarësisë”).

Kosovës dhe Serbisë iu ishin dhënë tri orë për të paraqitur rastin e tyre me 1 dhjetor 2009. Ndërkaq, 27 shteteve të tjera iu ishin dhënë nga 45 minuta kohë dhe paraqitja e tyre u bë sipas rendit alfabetik në gjuhën frënge. Procedimi zgjati deri më 11 dhjetor 2009.

Argumentet serbe:

- Shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës shkel bazat e së drejtës ndërkombëtare. Është një sfidë për autoritetin e Kombeve të Bashkuara dhe një sfidë për rendin juridik ndërkombëtar të bazuar në parimet e sovranitetit dhe integritetit territorial. Deklarata e Pavarësisë paraqet një përpjekje për ta hequr administrimin e KB-së në Kosovë, për të anuluar sovranitetin e Serbisë në Kosovë dhe të imponojë pavarësinë si zgjidhje të njëanshme për Kosovën;
- Kosova ka qenë “djepi historik i Serbisë dhe përbën një nga shtyllat kryesore të identitetit të saj”;

- Shpallja e pavarësisë u bë nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës dhe ishte në kundërshtim me Rezolutën 1244 të Kombeve të Bashkuara, e cila garanton integritetin territorial të RFJ-së (tani Serbisë);
- Të gjitha propozimet e Serbisë që ofronin autonomi të gjerë për shqiptarët etnikë janë refuzuar;
- Serbëve dhe joshqiptarëve të tjerë në Kosovë po u kërcënohen të drejtat themelore njerëzore dhe po bëhet trysni mbi ta që të largohen nga regjioni. Të gjitha qytetet e mëdha në Kosovë, me përjashtim të Kosovska Mitrovicës, janë pastruar etnikisht. Kishat dhe manastiret serbe në Kosovë janë "të vetmet monumente kulturore në Evropë që garantojnë nga forcat e armatosura, sepse ato ballafaqohen me kërcënim real për shkatërrim";
- Do të ishte precedent i rrezikshëm nëse vendet e tjera me administratën e KB konkluduan se ardhja e forcave paqeruajtëse paraqitte hapin e parë për shkëputjen e regjionit².

Argumentet e Kosovës:

- Pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme. Kjo nuk do të ndryshojë jo vetëm për Kosovën, por edhe për hir të paqes dhe sigurisë së rajonit;
- Pas shkeljes së të drejtave njerëzore të shqiptarëve të Kosovës, Serbia humbi të gjitha të drejtat mbi këtë vend;
- Vullneti i Popullit të Kosovës për ta shprehur lirisht vullnetin e vet politik shkon shumë vjet prapa dhe ishte i qartë për të gjithë pjesëmarrësit në Konferencën e Rambujesë. "Ka qenë e qartë menjëherë pas konfliktit të vitit 1999, kur Rezoluta 1244 e KB e cila i referohej qartë marrëveshjes së Rambujesë. Ishte e qartë gjatë periudhës së administrimit të UNMIK-ut dhe është diskutuar dhe marrë plotësisht në konsideratë gjatë negociatave për statusin final";

² Dushan Bataković, Ambasador i Serbisë në Francë <http://www.icj-cij.org/docket/index.php?p1=3&p2=4&k=21&case=141&code=kos&p3=1>.

- Negociatat për statusin final të Kosovës kishin për qëllim të bindnin Serbinë për ta njohur pavarësinë e Kosovës;
- Serbia nuk ka qenë kurrë e sigurtë në ofertat e saj për autonomi ndaj Kosovës. Ndërmjet bisedimeve për statusin, Serbia miratoi kushtetutën ku konfirmonte Kosovën si pjesë të Serbisë dhe në këtë mënyrë u tregoi qartë shqiptarëve se nuk ishte e interesuar për gjetjen e zgjidhjes dhe tregoi se çfarë mendonte ajo me ofertën e saj për autonomi. Në këtë mënyrë Serbia tregoi se Kosova është vetëm një copë toke³.

Argumentet e Shqipërisë:

1. Nuk ka asnjë rregull në të drejtën ndërkombëtare që ndalon shkëputjen;

- Do të ishte shkelje e rëndë e së drejtës ndërkombëtare nëse ndërhyrja nga shtetet e treta, qoftë me dhunë apo në formë tjetër, do të ishte vendimtare për shpalljen e pavarësisë. Mirëpo në rastin e Kosovës nuk ndodhi ashtu⁴.

Pas përfundimit të dëgjimeve publike, gjykatësit Abdul Koroma, Mohamed Bennouna dhe Antonio Augusto Cancado Trindade iu dhanë të gjitha palëve kohë deri më 22 dhjetor 2009 për t'iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me pretendimet se e drejta ndërkombëtare nuk e ndalon shkëputjen, duke marrë parasysh premtimet nga pjesëmarrësit e zgjedhjeve parlamentare në Kosovë të vitit 2007 për të shpallur pavarësinë dhe dispozitat e marrëveshjes së Rambujesë të vitit 1999⁵.

Argumentet ligjore

Argumentet ligjore kundër shpalljes së njëanshme të pavarësisë të paraqitura nga vende të ndryshme përqëndrohen në mbrojtjen e integritetit territorial të RFJ-së në dokumente të ndryshme ndërkombëtare duke përfshirë këtu Kartën e KB-së dhe në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-së.

³ Skënder Hyseni, Ministër i Jashtëm i Republikës së Kosovës. <http://www.icj-cij.org/docket/index.php?p1=3&p2=4&k=21&case=141&code=kos&p3=1>.

⁴ Gazmend Barbullushi, Ambasador i Shqipërisë në Holandë, <http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15618>.

⁵ <http://www.icj-cij.org/docket/index.php?p1=3&p2=4&k=21&case=141&code=kos&p3=1>.

Argumentet e paraqitura në përgjithësi nuk janë argumente kundër së drejtës morale të shqiptarëve të Kosovës për vetëvendosje, por përqëndrohen në ligjshmërinë apo thënë ndryshe veprimin e njëanshëm të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes. Pasi që Rezoluta 1244 e KS të KB-së ia dha tërë autoritetin PSSP-së, argumenti është se Institucionet e Përkohshme nuk kishin autoritet të shpallnin pavarësinë.

Argumentet e paraqitura në përkrahje të shpalljes së njëanshme të pavarësisë mbulojnë pesë aspekte kryesore. I pari është prezumimi në të drejtën ndërkombëtare se të drejtat civile dhe njerëzore, duke përfshirë edhe ato të pakicave, duhet të mbrohen, me qëllim të demonstrimit se këto të drejta ishin abuzuar nga regjimi i Millosheviqit. I dyti është theksi i vënë në shtojcat e dokumenteve si Rezoluta 1244 e KS të KB-së për një proces politik për të përcaktuar statusin final, me qëllim të demonstrimit se një proces i tillë është përfunduar me sukses me Procesin e Statusit të Kosovës. I treti është se referencat për integritetin territorial të Serbisë janë vetëm në gjuhën preambulare e jo edhe në gjuhën operative. Pra, dokumenti hesht për sa i përket asaj se çfarë forme merr statusi final i Kosovës. I katërti është se principi i integritetit territorial i kufizon vetëm shtetet e tjera e jo akterët vendorë. I pesti është se e drejta për vetëvendosje, për të cilin GJND-ja gjeti se ishte *jus cogens* në rastin e Timorit Lindor, është e drejtë e të gjithë popujve, jo vetëm e atyre në kontekstin kolonial.

Një argument tjetër thelbësor është ai i qëndrueshmërisë në kushtetutën e fundit legjitime të Jugosllavisë, Kosova kishte të njëjtën të drejtë ligjore për vetëvendosje që ishte bazë për pavarësimin e pesë nga gjashtë republikat jugosllave: Kroacia, Sllovenia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Bosnja e Hercegovina. Pra, në një seri të amendamenteve kushtetuese nga viti 1963 deri më 1974, Jugosllavia i kishte ngritur dy krahinat autonome, Kosovën dhe Vojvodinën, në një status të njëjtë ligjor si edhe republikat, me administratën e tyre, kuvendin dhe gjyqësorin, si dhe me pjesëmarrje të barabartë në të gjithë trupat federale të Jugosllavisë. Ato kishin të njëjtën fuqi të vetos në Parlamentin Federal dhe ishin njësoj përgjegjëse për implementim, zbatim dhe amendamentim të kushtetutës jugosllave, si dhe ratifikimin e marrëveshjeve dhe formulimin e politikës së jashtme jugosllave. Gjatë viteve 1980, administrata e Millosheviqit shpërndaui dhe ndaloi së funksionuari institucionet e Kosovës dhe në mënyrë të njëanshme ndryshoi kushtetutën duke i hequr autonominë. Ky argument u ngrit nga Kroacia në procesin e GJND-së.

Implikimet për të drejtën ndërkombëtare

Deklarata e Pavarësisë nxiti një debat ndërkombëtar nëse ky rast kishte krijuar një presedan ndërkombëtar që do të mund të aplikohet në lëvizjet tjera separatiste apo në ndonjë rast special. Njohja e pavarësisë së Kosovës nga 72 shtete anëtare të KB nga 192, sipas shumë burimeve, i ka përshpejtuar lëvizjet tjera separatiste. Muaj më pas, Rusia njohu Abkhazinë dhe Osetinë Jugore duke cituar pavarësinë e Kosovës, të cilën vetë s'e kishte njohur si presedan. Kjo po ashtu çoi në ngritjen e tensioneve në Bosnjë e Hercegovinë, ku Republika Sërpska përdori veton e saj për njohjen e Kosovës me arsyetim se ajo do të shkëputet pastaj për t'iu bashkuar Serbisë si kompensim për humbjen e saj. Po ashtu ky rast mund të ketë pasojë edhe në marrëdhëniet ndërmjet Tajvanit dhe Republikës Popullore të Kinës.

Dhënia e mendimit

Më 22 korrik 2010 gjykata vendosi që shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare⁶. Kryetari i GJND-së, gjykatësi Hisashi Owada, tha se e drejta ndërkombëtare nuk përmbante “asnjë ndalesë për shpalljen e pavarësisë”. Gjykata po ashtu tha se përderisa shpallja e pavarësisë nuk ka qenë e paligjshme, çështja e njohjeve ishte politike⁷.

Gjykata theksoi se Deklarata e Pavarësisë nuk ishte bërë nga Kuvendi i Kosovës, Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, apo ndonjë trup tjetër publik, nuk kishte zbatuar procedurën legjislative dhe nuk ishte publikuar si duhet. Fjalët *Kuvendi i Kosovës* në variantet e gjuhës angleze dhe frënge ishin bërë për shkak të përkthimit jo të drejtë dhe nuk ishin të pranishme në tekstin origjinal në gjuhën shqipe, kështu që autorët që e kishin quajtur veten “përfaqësuesit e popullit të Kosovës” nuk ishin të limituar nga Korniza Kushtetuese e krijuar nga Kombet e Bashkuara, që kishte rezervuar çështjet ndërkombëtare të Kosovës vetëm në kompetencë të përfaqësuesit të KB-së⁸.

Mendimi këshillues i gjykatës u pa si vendim që kishte krijuar presedan të mundshëm që do të kishte implikime të mëdha për lëvizjet separatiste në botë, si dhe për bisedimet e Serbisë për anëtarësimin në

⁶<http://www.icj-cij.org/docket/index.php?p1=3&p2=4&k=21&case=141&code=kos&p3=1>.

⁷ Po aty.

⁸ Po aty.

BE. Gjithashtu u pa edhe si mundësi që do të çonte në njohjen e pavarësisë së Kosovës nga më shumë vende⁹.

Paragrafi përfundimtar i mendimit këshillues (paragrafi 123), i cili është pjesë operative e vendimit (dispozitiv) përmban tri regjistrimet e votimit: ai shpallte se Gjykata në mënyrë unanime kishte gjetur se kishte juridiksion t'i përgjigjej kërkesës së Asamblesë së Përgjithshme për një mendim këshillues duke qenë se për rastin në fjalë Gjykata e pranonte se ajo kishte të drejtë të vendoste për atë kërkesë. Gjykata vendosi me nëntë vota për dhe pesë kundër për të pranuar kërkesën për dhënien e mendimit këshillues¹⁰.

Reagimet për verdiktin (vendimin) erdhën nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe akterë joshitetërorë. Kosova e përshëndeti këtë vendim dhe tha se tani mund të vazhdonte me më shumë njohje dhe anëtarësim të mundshëm në BE dhe në KB. Reagimet e Serbisë për vendimin ishin negative, ndërkaq politikanët u takuan në një seancë urgjente për t'i diskutuar hapat e mëtejshëm të Serbisë për të ruajtur "integritetin territorial" duke u betuar se nuk do ta njihnin kurrë Kosovën si shtet të pavarur, përkundër thirrjes kosovare për një gjë të tillë. Shtetet e BE-së që kishin njohur Kosovën e përshëndetën vendimin dhe bënë thirrje për dialog ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ata gjithashtu bënë thirrje edhe për shtetet e tjera që ta njohin Kosovën. Të gjitha, pesë shtetet e BE-së që nuk e kishin njohur Kosovën deklaruan se vendimi ishte një shikim i ngushtë bazuar vetëm në tekstin e deklaratës dhe se nuk do ta ndërronin pozicionin e tyre. Shtetet e tjera thanë se nuk do të ndryshonte gjë. Të gjithë trupat supranacionalë e përkrahën verdiktin (vendimin) së paku në disa pjesë, ndërkaq akterët joshitetërorë përshëndetën precedentin që ky opinion kishte krijuar. Opinioni i shumicës iu nënshtua kritikave ligjore nga disa komentatorë dhe nga gjykatësit e pakënaqur¹¹.

Reagimet më të forta erdhën nga Karabaku dhe Bosnja. E para e përgëzoi opinionin si precedent të krijuar dhe dha indikacione për mundësinë që të kërkonte një mendim të njëjtë nga GJND-ja për konfliktin e Nagornji Karabakut, përderisa e dyta ishte e ndarë ndërmjet politikanëve nga Republika Sërpska në njërën anë, që thoshin se në një të ardhme do të mund të shpallnin ligjërisht pavarësinë, dhe nga politikanët nga Federata e Bosnjë Hercegovinës

⁹ Po aty.

¹⁰ Po aty.

¹¹ Po aty.

nga ana tjetër, që thoshin se opinioni nuk do të duhej të rrezikonte statusin e vendit të tyre. Ndër reagimet e tjera ishin edhe ato të Rusisë që e kundërshtonin verdiktin, përderisa Abkazia dhe Osetia Jugore e përshëndetën.

Argumente kushtetuese-juridike për pavarësinë e Kosovës Aneksimi i dhunshëm i Kosovës

Periodha pas miratimit të Rezolutës së Bujanit karakterizohet me presione të vazhdueshme politike, e që kishte për qëllim krijimin e rrethanave politike në të cilat kjo Rezolutë do të diskualifikohej dhe do të krijoheshin kushtet për aneksimin e dhunshëm të Kosovës në kuadër të Jugosllavisë. Në këtë kontekst, në periudhën prej 8 shkurtit e deri në gjysmën e majit 1945 në Kosovë, me urdhrin e komandantit suprem (Tito)¹² vendoset administrimi ushtarak si organ i pushtetit ushtarak-shtetëror. Ndonëse me vendosjen e gjendjes së administrimit (sundimit) ushtarak nuk u rrëzua plotësisht pushteti popullor, puna e organeve të pushtetit popullor dukshëm qe zbehur, meqë ai iu nënshtrua detyrave që parashtrroi pushteti ushtarak.

Çështja e statusit të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit nga kreu politik i PKJ-së filloi të shtrohet në fund të vitit 1944 dhe në gjysmën e parë të vitit 1945. Biseda e parë, në udhëheqjen partiake, për fatin e mëtejshëm të Kosovës, sa dihet, është mbajtur në Komitetin Qendror të PKJ-së gjatë shkurtit të vitit 1945. Në këto biseda, ku merrte pjesë kreu politik i PKJ-së, ishin të kristalizuara tri mundësi të zgjidhjes së çështjes së Kosovës:

- Që Kosova t'i bashkohet Shqipërisë;
- Që Kosova të inkuadrohet në Serbinë Federale;
- Që Kosova të ndahet ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi (të cilit do t'i bashkëngjitej Rrafshi i Dukagjinit).

Nga këto tri alternativa dominoi ajo e komunistëve serb, që Kosova t'i bashkohet Serbisë Federale në kuadër të Jugosllavisë Federale.

Duke u mbështetur në këto qëndrime të reja politike, të cilat ishin në kundërshtim me qëndrimin e mëparshëm të PKJ-së lidhur me Kosovën (dhe premtimet që u ishin dhënë shqiptarëve për

¹² Me gjerësisht, Stipe Mesiq, "Si u shkatërrua Jugosllavia", Prishtinë, 2011.

vetëvendosje), filluan përgatitjet për aneksimin e dhunshëm të Kosovës.

Kosova u aneksua nga Serbia nga rrethanat e administrimit ushtarak më 10 korrik 1945, në Kuvendin e Prizrenit (i ashtuquajtur plebishit i Prizrenit), i cili u organizua nga forcat politike serbe. Në këtë Kuvend u miratua “Rezoluta për bashkimin e Kosovës dhe Metohisë me Serbinë Federale”. Në këtë rezolutë supozohet se përmes delegatëve, Këshillit Krahinor të Kosovës e të Dukagjinit “shprehej vullneti për t’iu bashkëngjitur Serbisë”. Ky konstatim nuk është i saktë, ngase nuk i përgjigjet realitetit historik. Vullnetin e vet burimor përfaqësuesit e popullit shqiptar e shprehën në Konferencën e Bujanit, por u bë një falsifikim ordinar i përcaktimit politik të popullit shqiptar dhe u bë aneksimi i dhunshëm i Kosovës me Serbinë federale.

Edhe pse formalisht Kosova u aneksua nga ana e Serbisë më 10 korrik 1945, burimet historike flasin se marrëveshjet për aneksimin e Kosovës u kryen më herët, në kuadër të KQ të PKJ-së, KQS-së dhe KK të PKJ-së. Këtë e vërteton edhe fakti se një vendim të këtillë para Kuvendit kontestues të Prizrenit e shprehën përfaqësuesit nga Kosova (Dushan Mugosha dhe Mehmet Hoxha) në Mbledhjen e Këshillit Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Serbisë (7-9 prill 1945) të mbajtur në Beograd, ku këta dy deklarohen për bashkimin e Kosovës me Serbinë.

Në aspektin konstitucional është me rëndësi të theksohet fakti se edhe pse vendimi kontestues mbi bashkimin e Kosovës me Serbinë federale u mor pa vullnetin e shqiptarëve (sepse ata që vendosën nuk kishin mandat për një deklaram të këtillë), ai mbështetej mbi supozimin se edhe atëherë është realizuar parimi i vetëvendosjes.

Në anën tjetër, në vendimin e përmendur “Kosova i bashkohet Serbisë federale në kuadër të Jugosllavisë”. Edhe ky formulim ka rëndësi, ngase i jep të drejtë Kosovës që të dërgojë në aktet e veta burimore kushtetuese këtë vendim pas procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë.

Për shkak të aktualitetit politik, me qëllim të argumentimit të së drejtës së vetëvendosjes së popullit shqiptar pas zhbërjes së ish-RSFJ-së, do të analizojmë shkurtimisht këto dy aspekte të këtij vendimi kontestues.

Formulimi që u bë në rezolutë që Kosova t’i bashkohet Serbisë “*me dëshirën e popullatës së saj*”, ndonëse nuk i përgjigjet realitetit,

në fakt ngërthen në vete faktin, qoftë edhe në mënyrë të tërthortë, se çështja e Kosovës qysh atëherë trajtohej si çështje e vetëvendosjes së popullatës së saj. Në Kuvendin e Prizrenit jo rastësisht u la “plotësisht në heshtje” Rezoluta e Bujanit, e cila kishte “krejtësisht një kontekst tjetër gjeopolitik”. Në Rrafshin konstitucional-juridik mund të nxirret përfundimi se në Kuvendin e Prizrenit në fakt nuk u bë shfuqizimi i Rezolutës së Bujanit, por siç thekson me të drejtë akademik Gazmend Zajmi, “u bë dërgimi i saj nëpërmjet një zgjidhje tjetër të mëvonshme për fatin shtetëror politik të Kosovës”. Po këtë fat të dërgimit, sipas akademik Gazmend Zajmit, “e pësoi edhe Rezoluta e nxjerrë më 1945 për bashkimin e Kosovës me Serbinë nëpërmjet Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut 1990, nxjerrë nga Kuvendi i Kosovës mbi pavarësinë dhe barazinë e Kosovës në ish-Federatën - konfederatën e ish-Jugosllavisë”¹³.

Vendimi sipas të cilit Kosova i bashkohet Serbisë Federale në kuadër të Jugosllavisë federative është me rëndësi, sepse ndonëse nuk përkon me vullnetin burimor të popullit shqiptar, i jep të drejtë atij që pas shpërbërjes së RSFJ-së të riformulojë dhe përcaktojë sërish statusin e vet konstitucional. Ky argument është mjaft i rëndësishëm dhe i shërben Kosovës për t’u rikthyer në gjendjen para vendosjes për asocim me Serbinë në vitin 1945. Duke u bazuar në këtë, Kosova ka të drejtë që të thirret në parimin juridik “*Restitutio in integrum*”. Ky parim nënkupton të drejtën e Kosovës që sërish të deklarohet për statusin e vet konstitucional, gjë që edhe e bëri në vitin 1990 dhe 1991, kur nëpërmjet organeve të veta legjitime (Kuvendit) dhe me deklaram gjithëpopullor politik (referendum) nxori dhe miratoi aktet burimore kushtetuese dhe politike me të cilat lindi Republika e Kosovës shtet sovran dhe i pavarur.

Konstituimi formal juridik i statusit autonom të Kosovës në kuadrin e ish-Federatës së Jugosllavisë u bë me këto akte:

- Vendimin e Kuvendit Krahinor të Kosovës e Metohisë (i shprehur në formë të rezolutës) me të cilin bëhet aneksimi i dhunshëm i Kosovës me Serbinë federale në kuadrin e ish-Jugosllavisë;
- Vendimin e mbledhjes së Tretë të KAÇKJ-së me të cilin është miratuar Vendimi kontestues i Kuvendit Krahinor;

¹³ Akademik Gazmend Zajmi, “Rrjedhat e konfliktësisë shqiptaro-serbe në rrafshin kushtetues të ish-Federatës Multinacionale të Jugosllavisë”, Vjetari 1996, Prishtinë, 1996.

- Ligjin e Kryesisë së Kuvendit Popullor të Serbisë për themelimin dhe organizimin e KAKM-së;
- Kushtetutën e RFPJ-së të vitit 1946.¹⁴

Nga kjo që u theksua më lart mund të nxjerrim këto përfundime:

- Kosova historikisht ka qenë një territor kompakt, i banuar nga populli shqiptar si popull autokton dhe si një nga popujt më të vjetër të Ballkanit;
- Në sajë të politikës joparimore të Fuqive të Mëdha, trojet etnike shqiptare gjatë gjithë historisë kanë qenë objekt i copëtimeve territoriale dhe i pushtimeve të huaja;
- Çështja e Kosovës nuk mund të paraqet vetëm një anë të çështjes shqiptare, por paraqet një çështje unike që mund të zgjidhet vetëm me bashkimin kombëtar dhe me krijimin e një shteti shqiptar në kufijtë e tij historikë dhe natyrorë;
- Kosova u aneksua në mënyrë të dhunshme nga ana e Serbisë, në kushtet e gjendjes së administrimit ushtarak në Kosovë;
- Shpërbërja e ish-RSFJ-së krijoi një gjendje të re gjeopolitike, e cila Kosovës i jep të drejtën e shkëputjes nga ish-Jugosllavia, dhe që duke shpallur pavarësinë të vetëpërcaktohet që të jetojë me ligjet e veta dhe të ketë institucione dhe organizim të pavarur politik.

Pavarësia e Kosovës ishte në pajtim me të drejtën ndërkombëtare dhe me rendin e ri ndërkombëtar

Pavarësia e Kosovës dhe e drejta e saj për vetëvendosje ishte në pajtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare dhe me proceset e krijimit të rendit të ri ndërkombëtar. E drejta e vetëvendosjes paraqet shtyllë të demokracisë dhe të lirisë së individit dhe të popujve. E drejta e vetëvendosjes si e drejtë universale është përcaktuar në nenin 1 të Kartës së OKB-së, ku përcaktohet misioni i saj që të zhvillojë relacione miqësore midis kombeve, bazuar në respektimin e parimeve të të drejtave të barabarta dhe të vetëvendosjes së popujve dhe të

¹⁴ Dr. Kurtsh Salju, "Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të KSAK në Jugosllavinë Socialiste", Prishtinë, 1984, fq.31.

ndërmarrë masa të tjera adekuate për ta forcuar paqen universale. Koncepti modern i vetëvendosjes është i përcaktuar në mënyrë të qëndrueshme në praktikën antikolonialiste të Kombeve të Bashkuara. Karta e Kombeve të Bashkuara shpall synimet themelore të sistemit të përfshirjes së promovimit e zhvillimit përparimtar të banorëve të territoreve në kujdestari drejt vetëvendosjes ose pavarësisë, e cila do të jetë e përshtatshme për rrethanat e veçanta në të cilat ndodhet secili territor me njerëzit e tij dhe dëshirat e shprehura lirisht të njerëzve që kanë të bëjnë me to¹⁵.

Parimi i vetëvendosjes u afirmua edhe me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për dhënien e pavarësisë vendeve dhe popujve të kolonizuar të aprovuar në vitin 1960. Në nenin 2 të kësaj Deklarate përcaktohet se të gjithë popujt kanë të drejtën për vetëvendosje; mbi këtë të drejtë ata lirisht përcaktojnë statusin e tyre politik dhe lirisht realizojnë zhvillimin e vet ekonomik, social e kulturor. Afirmimin dhe njohjen tjetër ndërkombëtare e drejta e vetëvendosjes e ka gjetur edhe në dy konventat tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut: Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Kulturore e Sociale të miratuara në vitin 1966.

Në nenin 1 të këtyre konventave përcaktohen këto elemente të së drejtës së vetëvendosjes:

- Të gjithë popujt e kanë të drejtën për vetëvendosje, mbi këtë të drejtë ata lirisht përcaktojnë statusin e tyre politik dhe lirisht e realizojnë zhvillimin e vet ekonomik, social dhe kulturor;
- Për mirëqenien e tyre popujt lirisht mund të disponojnë pasuritë dhe burimet natyrore, pa paragjykim për ndonjë obligim që del nga bashkëpunimi ekonomik ndërkombëtar, bazuar në parimin e përfitimit të ndërsjellë dhe të drejtën ndërkombëtare;
- Shtetet nënshkruese të Konventës, përfshirë edhe ata që kanë përgjegjësi për administrimin e trojeve që nuk vetëqeverisen, do të promovojnë të drejtën për vetëvendosje dhe do të respektojnë atë të drejtë në përputhje me pikat e OKB-së.

¹⁵ Karta e Kombeve të Bashkuara, neni 76, paragrafi.b.

Afirmimi i mëtëjshëm i së drejtës së vetëvendosjes është bërë në Deklaratën e parimeve të së Drejtës Ndërkombëtare lidhur me marrëdhëniet miqësore midis shteteve të miratuar më 1970. Në këtë Deklaratë është ritheksuar obligimi i çdo shteti që të respektojë të drejtën për vetëvendosje në përputhje me dispozitat e Kartës së OKB-së. Rëndësia e kësaj preambule shihet nga preambula e saj ku thuhet 'të bindur se parimi i të drejtave të barabarta dhe i vetëvendosjes së popujve përmban një kontribut të rëndësishëm për të drejtën bashkëkohore ndërkombëtare, aplikimi i efektshëm i tij ka rëndësi kruciale në promovimin e marrëdhënieve miqësore midis shteteve të bazuara në parimin e barazisë sovrane.

Mbështetur në aktet e lartpërmendura ndërkombëtare, e drejta e vetëvendosjes u është njohur shumë popujve të shtypur (edhe jashtë kontesteve të shkolonizimit), si në rastin e Bangladeshit, të Biafrës, të Eritresë, të Kuebekut, të Tajvanit, të Somalisë, të Timorit Lindor, të Palestinës, të Polisarios etj. Në historinë më të re politike shumë shtete të Evropës Juglindore zbatuan të drejtën e tyre për vetëvendosje. Në këtë kuadër populli gjerman e realizojë të drejtën e tij për vetëvendosje me 1990, kur populli i Gjermanisë Lindore dhe i asaj Perëndimore vendosi të ribashkohet duke rrëzuar Murin e Berlinit. Në të njëjtën kohë deklarimet e tyre për pavarësi u shprehën edhe nga ish-republikat e Bashkimit Sovjetik gjatë viteve 1989 dhe 1991. Ishin të parat Republikat Baltike të cilat e realizuan vetëvendosjen duke restauruar pavarësinë e tyre. Një proces të njëjtë kaloi edhe ish-Çekosllovakia nga e cila në mënyrë paqësore dolën dy shtete të pavarura: Çekia dhe Sllovakia.

Së fundi, pas shpërbërjes së ish-Federatës Jugosllave, gjashtë njësitë federale të saj zbatuan pavarësinë e tyre përmes vetëvendosjes dhe luftërave për pavarësi.

Duke u nisur nga baza legale ndërkombëtare, Kosova paraqet rast tipik të vetëvendosjes. Vetëvendosja është një e drejtë legjitime e Kosovës dhe ka mbështetje në qenien sociopolitike të Kosovës. Kosova është aneksuar dhunshëm nga Serbia që nga viti 1918, Gjatë Luftës së Dytë Botërore; shqiptaret e Kosovës i janë bashkangjitur luftës antifashiste vetëm me premtimin e çlirimit kombëtar dhe realizimit të së drejtës për vetëvendosje. Ata artikuluan vullnetin e tyre burimor përmes Rezolutës së Bujanit, e cila ia garantonte Kosovës të drejtën e vetëvendosjes, përfshirë këtu edhe të drejtën e bashkimit me shtetin amë - Shqipërinë. Mirëpo ky vullnet burimor u shtyp dhe më 1945, Kosova i aneksohet Serbisë brenda Jugosllavisë

Federale. Pas shpërbërjes së Federatës Jugosllave, edhe Kosova sikur edhe njësitë tjera federale deklaroi vullnetin e saj për pavarësi nëpërmjet referendumit të vitit 1991¹⁶. Ky përcaktim doli nga e drejta për vetëvendosjen e popullit të Kosovës në rrethanat e zhbërjes së ish-Jugosllavisë. Vullnetin dhe përcaktimin e tij të fuqishëm për pavarësi dhe vetëvendosje populli shqiptar e konfirmojë edhe përmes luftës çlirimtare të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, dhe mijëra viktimave, të cilat ranë për idealin e pavarësisë dhe lirisë së Kosovës

Duke u nisur nga ajo që u theksua më lart, rrjedh se pavarësia e Kosovës ka bazën e saj juridike-politike në të drejtën ndërkombëtare dhe paraqet një rast tipik të vetëvendosjes së popujve.

Pavarësia e Kosovës ishte një e drejtë legjitime e popullit të Kosovës

Kosova paraqet një rast tipik të vetëvendosjes. Kosova i plotësonte të gjitha kushtet për vetëvendosje. Ajo i plotësonte të gjitha kushtet ndërkombëtare për të funksionuar si shtet i mëvetësishëm. Të gjitha kushtet e përcaktuara me të drejtën ndërkombëtare janë tipike për Kosovën. Kosova i plotëson të gjitha kushtet sa i përket territorit, popullsisë dhe të poseduarit e qeverisë efektive.

Sa i përket kriterit territorial, Kosova i ka plotësuar kushtet e përcaktuara për të qenë shtet i mëvetësishëm. Kosova historikisht shquhet me një territor kompakt gjeografik në të cilin me shekuj jeton populli shqiptar si popull autokton dhe si një nga popujt më të vjetër të Ballkanit. Territori si kusht për njohjen ndërkombëtare të Kosovës është më së paku kontestues. Kosova ka pasur historikisht një mëvetësi territoriale (Dardania, Vilajeti i Kosovës, KSA e Kosovës, Republika e Kosovës) dhe ka ruajtur kontinuitetin e një hapësire të përcaktuar gjeografike dhe të definuar administrativo-juridike me identitetet dhe subjektivitet të veçantë politik-territorial dhe me kufijtë e garantuar e të mbrojtur në planin juridik-kushtetues. Sipërfaqja në të cilën shtrihet sot territori i Kosovës është dukshëm më e gjerë se sipërfaqja e shumë shteteve të tjera që janë të njohura ndërkombëtarisht. Njohja e pavarësisë së Kosovës nuk e kundërshton frymën e Aktit Final të Helsinkut dhe nuk paraqet ndryshim të kufijve në Evropë. Pas shpërbërjes së Federatës Jugosllave, kufijtë interfederal dhe

¹⁶ Arsim Bajrami, "Kosova-political, international law and constitutional argumentes", koautor me Dr. E. Stavilecin dhe Mr. B. Rekën, Prishtinë, 1996.

administrativ të Kosovës shndërrohen në kufij administrativë shtetërorë. Në aspektin juridik kufijtë e Kosovës kanë qenë të garantuar me Kushtetutën Federative dhe me Kushtetutën e Kosovës të vitit 1974. Neni 5 i Kushtetutës Federative shprehimisht përcaktonte se territori dhe kufitë e Kosovës nuk mund të ndryshohen pa pëlqimin e saj. Së fundi, edhe vetë Rezoluta 1244 dhe Korniza Kushtetuese njohin kompaktësinë territoriale dhe pacenueshmërinë e kufijve të Kosovës. Realiteti etnik në Kosovë vërteton se territori i saj si historikisht, ashtu edhe aktualisht ka qenë i banuar nga shqiptarët si popull me shumicë absolute. Burimet historike dhe etnologjike tregojnë se shqiptaret janë popull autokton në Kosovë, shumë më të hershëm se serbet, të cilët përmes masave administrative kanë kolonizuar Kosovën. Popullata shqiptare në trojet e ish-Jugosllavisë dhe territori i saj etnik gjatë gjithë historisë ka jetuar dhe funksionuar si një bashkësi etnike me pjesën tjetër të shqiptarëve në Ballkan. Populli shqiptar i Kosovës është pjesë e trungut të përbashkët shqiptar, i cili në sajë të pushtimeve historike është ndarë në kufij artificialë në shumë shtete të Ballkanit. Aktualisht Kosova, krahasuar me shtetet tjera që dolën nga ish-Jugosllavia, paraqet një tërësi homogjene etnike. Banorët e Kosovës janë shqiptarët etnikë mbi 90%, ndërsa 10 janë presëtarë të minoriteteve të ndryshme. Megjithë tendencat e spastrimit etnik dhe të kolonizimit serb, me të cilin u ballafaqua Kosova, ajo arriti të ruajë identitetin e shumicës absolute shqiptare. Kjo u vërtetua edhe në ngjarjet e fundit kur pas dështimit të politikës së spastrimit etnik, populli i Kosovës në mënyrë impulsive u kthye në trojet e tij etnike dhe konfirmoi lidhmerinë e tij autoktone me Kosovën.

Pavarësia e Kosovës paraqitte një realitet faktik, pas shpalljes së saj dita-ditës po shtohet numri i njohjes nga shtetet e ndryshme.

Rezyme

Pavarësia e Kosovës, si vullnet politik i popullsisë shumicë në Kosovë, paraqitte një domosdoshmëri të kohës. Bashkësia ndërkombëtare, por edhe shtetet tjera në rajon duhej të kuptonin se opcioni i pavarësisë së Kosovës nuk është ndonjë zgjidhje ekstreme dhe program nacionalist. Pavarësia e Kosovës është një zgjidhje e drejtpeshuar e kohës, që e zgjidh drejt krizën në Kosovë dhe do t'i jepte fund konfliktit shekullor shqiptaro-serb dhe ngatërresave midis këtyre dy popujve. Në kuptimin e së drejtës së ligjshme për bashkim kombëtar, pavarësia e Kosovës paraqitte një kompromis drejt zgjidhjes së plotë të çështjes shqiptare më Ballkan. Kjo zgjidhje do reflektonte edhe një stabilitet afatgjatë në rajon. Pavarësia e Kosovës nuk dëmtonte interesat e asnjë shteti në rajon dhe nuk rrezikonte shtetet fqinje. Akademik Gazmend Zajmi thotë se pavarësia krijon balance ndërkombëtare, të cilat

do të siguronin sigurinë reciproke në rajon¹⁷. Kjo zgjidhje e stabilizonte Maqedoninë, e cila aktualisht sfidohet me konfliktet ndëretnike ndërmjet maqedonëve dhe shqiptarëve. Nuk janë të sakta zërat se njohja e pavarësisë do të destabilizonte Maqedoninë dhe do të nxiste tendencat separatiste në këtë republikë. Përkundrazi, njohja e shtetit të Kosovës do e ulte tensionin ndëretnik në këtë republikë dhe do të krijonte një frymë mirëbesimi dhe bashkëpunimi rajonal.¹⁸

Sa i përket Shqipërisë, pavarësia e Kosovës nuk do të nënkuptonte bashkimin e saj me Shqipërinë. Aktualisht kjo paraqet një zgjidhje reale, me një pozicion real të Kosovës në rajon. Ky pozicion neutral është një bazë e mirë e integriteteve kombëtare dhe rajonale dhe do të hapte rrugën e integriteteve të gjera në nivel të Evropës.

Duke njohur pavarësinë e Kosovës, bashkësia ndërkombëtare po e njoh një të drejtë legjitime të një populli autokton, i cili nuk kërkoi asgjë më tepër se popujt e tjerë të Evropës Lindore, të cilët, në sajë të proceseve demokratike pas rrëzimit të Murit të Berlinit dhe mbarimit të Luftës së Ftohtë, filluan demokratizimin e tyre dhe procesin e integritetit në familjen e gjerë të popujve evropianë.

Njohja e pavarësisë së Kosovës paraqet një proces logjik të procesit të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë¹⁹ dhe krijimit të shteteve të reja mbi gërmadhat e kësaj creature artificiale shtetërore. Pas njohjes së pavarësisë së njësive të tjera federale, me njohjen e pavarësisë së Kosovës në Ballkan duhet të përcaktohen raporte të reja të cilat krijojnë një klimë të mirëbesimit dhe fqinjësisë ndëretnike.

Literatura:

- Arsim Bajrami, “Kosova-political, international laë and constitutional argumentes”, koautor me Dr. E. Stavilecin dhe Mr. B. Reken, Prishtinë, 1996.
- Arsim Bajrami, “Mëvetësia e Kosovës në sferën normative në periudhën 1974-1994”, disertacion i doktoratës, Prishtinë, 1995.
- Arsim Bajrami, “Aspektet kushtetuese dhe politike të mëvetësisë së Kosovës”, Prishtinë 1996.
- Arsim Bajrami, “Neka aktuelna pitanja u vezi sa postupkom revizije Ustava SFRJ i Ustava SRS”, Naša zakonitost, nr.5/88. Zagreb, 1988.
- Arsim Bajrami dhe Mr.sc.Florent Muçaj, “Aspektet e ndryshimeve kushtetuese me theks të veçantë në Republikën e Kosovës”, botoi “Biznesi” - revistë shkencore e Kolegjit Universitar Biznesi, fq. 31-59, Prishtinë 2011.
- “Cambridge International Dictionary of English”, Cambridge University Press, 1995.
- Aurela Anastasi, “Historia e të Drejtës Kushtetuese në Shqipëri 1912-1939”, Tiranë, 2007.

¹⁷ Më gjerësisht: Akademik Gazmend Zajmi, “Dimensionis of the Questions of Kosova in the Balcanes, Prishtinë, 1994.

¹⁸ Akademik Esat Stavileci, “Çështja shqiptare në udhëkryqin e zgjidhjeve paqësore”, Prishtinë, 1995.

¹⁹ Më gjerësisht: Denis MacShane, “Why Kosovo Still Matters”, 2011.

- Denis MacShane "Why Kosovo Still Matters", 2011.
- Esat Stavileci, "Çështja shqiptare në udhëkryqin e zgjidhjeve paqësore", Prishtinë, 1995.
- Esat Stavileci, "Fjalor shpjegues i termave administrative", Botime të veçanta, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë 2010.
- Esat Stavileci, "Çështja shqiptare në udhëkryqin e zgjidhjeve paqësore", Prishtinë 1995.
- Esat Stavileci "Një këndvështrim për Pakon e Ahtisaarit", Prishtinë 2007.
- "Fjalori Konkiz i Oxfordit për Politikë", Edicioni dytë, Oxford University Press 2003.
- Gazmend Zajmi, "Çështja e Kosovës në kuadër të çështjes shqiptare si sfidë e madhe dhe madhore e kohës dhe ndaj kohës", Prishtinë, Revista "E drejta" 1/96.
- Gazmend Zajmi, "Rrjedhat e konfliktësisë shqiptaro-serbe në rrafshin kushtetues të ish-Federatës multinacionale të Jugosllavisë", Vjetari 1996, Prishtinë, 1996.
- Gazmend Zajmi, "Dimensionis of the Questions of Kosova in the Balcanes, Prishtinë, 1994.
- Greg Campbell, "The road to Kosovo", 2000.
- Gabriel Partos, "Kosova - mënyra të reja për të ndalur një konflikt të vjetër", botuar në librin Lufta kundër luftës, Tiranë, 2001.
- "KOSOVA- një vështrim monografik", Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Prishtinë 2011.
- Kurtesh Salii, "Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të KSAK në Jugosllavinë Socialiste", Prishtinë, 1984.
- Luan Omari, "Kushtetuta e Republikës së Kosovës, një vështrim krahasues", Tiranë 2009.
- Luan Omari dhe Dr. Aurela Anastasi "E drejta kushtetuese", Tiranë 2010.
- Marc Weller, "Shtetësia e kontestuar", KOHA, Prishtinë, mars 2009.
- Noel Molcolm, "Të drejtat e Kosovës", botuar në librin Lufta kundër luftës, Tiranë, 2001.
- Noel Molcolm, "Kosovo-a Short History", Macmillan, London 1998.
- Parker, Andrew N., "Decentralization The Way Forward for Rural Development", June 1995. World Bank Policy Research Working Paper. Washington, DC..
- Post-Conflict Constitution ,Drafters' Handbook ,Prepared by The Public International Law & Policy Group Paul R. Williams, Executive Director Elizabeth Hahn, Post-Conflict Constitution Project Director Cassandra Tillinghast, Senior Research Associate Emily Nugent, Senior Research Associate January 2007.
- Qerim Qerimi, "Karakterit dhe brimet e të dejtës nërkombëtare për të dejtat e neriut", Revista "E dejtat", nr. 2/2010.
- Sistemi kshtetues dhe sfidat e Tij"- Konferencë shkencore kombëtare, boton Universiteti i Tiranës, 2011.
- Stipe Mesiq , "Si u shkatërrua Jugosllavia", Prishtinë 2011.

Shukri Rrahimi, “Vilajeti i Kosovës”, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK, Prishtinë, 1989.

Visar Morina, The Newly Established Constitutional Court in Post-Status Kosovo: Selected Institutional and Procedural Concerns, *Review of Central and East European Law*, Volume 35, Number 2, 2010.

Xhezair Zaganjori, Aurela Anastasi, Eralda Qani, “Sistemi i së drejtës në kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, Tiranë 2011.

Arsim BAJARMI, Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës, 2011.

James CRAWFORD, The Creation of states in international law, 2006.

Marc WELLER, *Contested Statehood: Kosovo’s Struggle for Independence* (2009).

Kosova në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, 2010- www.mfa-ks.net

Bujar DESKU, interpretimi i deklaratës së pavarësisë së Kosovës nga GjND-ja, 2013.

Deklarata e Pavarësisë së Kosovës.

Opinioni juridik i GjND-së.

Rezoluta 1244.

Pakoja e Ahtisaarit.

Kushtetuta e Kosovës.

RECENSIONE DHE KRITIKA

Muhamedin KULLASHI, Pariz

LA DOXA DE PÉAN SUR LE KOSOVO

Pierre Péan, **UNE GUERRE « JUSTE » POUR UN ETAT MAFIEUX**, Paris, Fayard, 2013, p. 450.

Pierre Péan présente son livre comme une enquête sur la guerre au Kosovo et sur l'Etat qui en ait issu. Les premiers chapitres sont consacrés à la critique de l'intervention militaire de l'OTAN, en 1999, contre l'armée serbe. Les arguments invoqués en faveur de l'intervention par les responsables politiques des grandes puissances (notamment des Etats Unis, de la France, de la Grande Bretagne et de l'Allemagne) mais également des intellectuels et des médias - « prévenir une catastrophe humanitaire », « préserver la stabilité dans une région-clé de l'Europe », « stopper les crimes massifs contre les civils » - Péan les balaye d'un revers de main : « tout ou presque était faux dans leur présentation des faits » (p. 22), dans le chapitre « Tout ça pour ça ! ». Après avoir présentée cette intervention comme illégale, illégitime et injuste, il nous apprend à l'appui d'une citation d'un hebdomadaire italien qu'« après les bombardements de 1999 les Nations unies ont confié le Kosovo tout entier à la mafia » (27). Ainsi, tout au début du livre on trouve l'explication du titre. Il tient à souligner qu'il n'est jamais allé au Kosovo (p. 42), et nous devrions ajouter qu'on ne se souvient pas qu'il ait écrit quoique ce soit sur les Balkans. Ce qui ne l'a pas empêché d'écrire un livre de 450 pages sur le Kosovo et sur les débats politiques et intellectuels, en Europe et ailleurs, sur les tenants et les aboutissants des conflits dans les Balkans.

Relancer les débats

Ayant qualifiée l'opération de 1999 d'une vingtaine de pays occidentaux alliés comme « agression d'un Etat souverain (la République de Serbie) » (p. 32), Péan la situe dans un contexte plus large comme événement qui « marque la fin d'une séquence qui a débuté en 1990, avec la guerre en Croatie ». Une raison supplémentaire du caractère illégal et illégitime de cette intervention réside, pour lui, dans le fait que « les Serbes ont été à deux reprises du

bon côté : contre les Allemands, aux côtés des Français, pendant la Première guerre mondiale... et puis contre les nazis, pendant la Seconde guerre mondiale ...sauvant de nombreux juifs ». Plus loin, il reproche à diverses reprises aux grandes puissances « d'avoir monté de vastes campagnes de désinformation pour transformer les Serbes en nazi et les Croates –ex collaborateurs des nazis, eux en démocrates ».

Les deux éléments de cet argument ont été *répétés à satiété*, depuis 1999, notamment par les idéologues du régime serbe et ses sympathisants. Cette approche qui présente les Croates globalement comme des collaborateurs des nazis, et les Serbes comme antifascistes, est pour le moins unilatérale. Il suffirait de feuilleter *l'Encyclopédie militaire* de la Yougoslavie publié à Belgrade, et y voir, par exemple, un fait de taille : la moitié des 24 divisions des partisans antifascistes, durant la Seconde guerre mondiale (12) étaient celles de la Croatie. Et ce n'est pas par hasard que Tito, d'abord dirigeant du mouvement ouvrier croate, devient le chef de la résistance antifasciste des yougoslaves. Mais, d'autre part, concernant les Serbes, faudrait-il vraiment occulter le fait que l'Etat serbe de Nedić a participé à la déportation et l'extermination de la quasi-totalité des Juifs en Serbie, autour de 15 mille. Ainsi, la Serbie était proclamée par les nazi, en 1941, comme le premier Etat en Europe « nettoyé » des Juifs (*Judenfrei*).

Cependant, il faut ajouter que les positions politiques des dirigeants occidentaux, des intellectuels et des médias envers les guerres des années 90 en Yougoslavie, n'étaient pas fondées sur les mérites des ancêtres dans les guerres précédentes.

Pierre Péan accable, à la longueur de son livre, la « doxa dominante » des politiques, des intellectuels, des journalistes et des écrivains aux Etats Unis comme en Europe, d'avoir orchestré « des cycles de campagnes médiatiques » afin de « diaboliser les Serbes et leur chef de l'Etat » (p. 34). Le régime de Milosević, son idéologie et surtout l'ampleur des pratiques militaires et policières du nettoyage ethnique des institutions et des territoires (sacro-saints), les crimes massifs sur les populations civiles ont suscités en effets des critiques et des protestations dans de nombreux pays. Etait-ce vraiment une « diabolisation » ? On a l'impression que Péan veut se lancer, d'ailleurs avec un retard considérable, dans une bataille médiatique sur les conflits en ex-Yougoslavie, de laquelle il était (le grand) absent.

A l'appui d'une citation du *Monde Diplomatique* du 1999, il nous fait savoir que la reconnaissance des indépendances de la Slovénie, de la Croatie, et la Bosnie-Herzégovine, a été « la plus grande erreur collective de l'Occident » (p .45), que les conflits n'étaient rien d'autre que « la confrontation des trois nationalismes également exacerbé et meurtriers » (p. 46). Ce schéma égalise mécaniquement les responsabilités pour les guerres et les crimes, en escamotant des faits indéniables. Ainsi, les tensions politiques dans ces républiques s'étaient transformées en guerre à partir d'agressions militaires : les troupes serbes, après avoir « purifiée » l'Armée yougoslave de Tito de ses soldats et officiers non-serbes, avaient attaqué d'abord la Slovénie (1991), ensuite la Croatie et la Bosnie, en 1992, et finalement le Kosovo en 1998 et 1999 : quatre guerres d'agressions successives, durant 8 ans. Ces guerres d'agressions étaient des réponses à des *référendums* dans lesquels la majorité de la population s'était déclarée pour l'indépendance. Les gouvernements occidentaux, après maintes analyses, ont préféré reconnaître cette volonté de la majorité tout en condamnant les agressions militaires. Les contempteurs des indépendances n'avaient pas remarqué qu'à peu près en même temps on a assisté à la *décomposition de trois fédérations* communiste : de l'U.R.S.S, de la Tchécoslovaquie et de la Yougoslavie. Apparemment, les structures politiques et idéologiques qui reliaient les composantes de ces fédérations étaient épuisées. La Russie s'était accommodée, dans la majorité des cas, avec les indépendances des républiques qui l'avaient demandé. Le divorce de la Tchécoslovaquie s'est réalisé, également, sans violence. Mais, le régime serbe, aveuglé par sa puissance militaire, voulait imposer son hégémonie, par la force, aux autres peuples de la Yougoslavie.

A la différence de la « doxa dominante », Péan, dans sa volonté de dé-diaboliser le régime de Milosević, développe sa *doxa*, dont un élément important est le déni de sa volonté du nettoyage ethnique du Kosovo.

Ainsi, dans les pages 61-62, il veut nous faire croire, à l'appui d'une citation, que « les Serbes ne témoignent encore d'aucune volonté de vider de ses habitants albanais une quelconque région du Kosovo ou de procéder au « nettoyage ethnique » de la province ». Mais, comme la cohérence n'est pas toujours son point fort, il oublie ce qu'il nous a dit précédemment, en citant une résolution du Conseil de sécurité de 1998, donc une année avant les frappes aérienne de l'OTAN, où il est dit que « les unités de sécurités serbes et l'armée

yougoslave, qui ont causé de nombreuses victimes civiles et ... le déplacement de 230.000 personnes qui ont dû abandonner les foyers ». Cette Résolution demande explicitement « le retour sans entraves des réfugiés et des personnes déplacées » (p.63).

Il faut y ajouter les rapports de la FIDH et des *Médecins sans frontières* et *Médecins du monde*. Selon ceux-ci, dans cette période plus de 400 villages du Kosovo ont été bombardé par les troupes serbes et fortement endommagés ». La dissymétrie des rapports de force entre, d'un côté l'armée et la police serbe et de l'autre l'UÇK, était énorme. Les rangs de l'UÇK étaient constitués justement par les jeunes de ces villages attaqués, d'abord de ceux de Drenica (attaquée, en printemps 1998, et ensuite de ceux à Dukagjin (Métochie). Ainsi, après plus de dix ans de résistance politique et pacifique au Kosovo, c'est la résistance armée qui naît dans ces régions, en réponse à la terreur du régime serbe. Péan transforme ces résistants en criminels et mafieux. A la différence de Péan, de nombreux journalistes européens ou américains, mais aussi serbes (p. ex. Lazar Stojanović ou Stojan Cerović), qui se sont rendus sur place durant la guerre au Kosovo, voyaient les soldats de l'UCK comme des combattants de la liberté.

D'ailleurs, la caractéristique dominante des guerres menées par les troupes serbes en Croatie, en Bosnie et au Kosovo est la même : les civils ne sont pas la conséquence des conflits armés entre « les belligérants », mais bel bien la cible principale du « nettoyage ethnique » des territoires. Les enquêtes de nombreux organismes internationaux, et des journalistes qui ont travaillé sur le terrain en témoignent.

Ce que les responsables politiques des grandes puissances demandent à Milosević, par plusieurs délégations envoyées à Belgrade durant 1998, c'est de cesser l'offensive de ses troupes au Kosovo. Milosević leur répond par l'intensification des attaques, qui faisaient augmenter les chiffres des victimes civiles, mais d'autre part renflouait les rangs de l'UÇK, par les jeunes issus justement de ces régions attaqués.

A la différence de Péan, qui n'en croit pas un mot aux arguments des responsables politiques d'une vingtaines de pays qui ont participé à l'intervention contre les troupes serbes, un nombre important des journalistes serbes, mais également des représentants de certains partis politiques (DS, SPO etc.) et des intellectuels et associations serbes, accusent Milosević de mener une politique

intransigeante et suicidaire contre « la communauté internationale » pour se maintenir au pouvoir.

Péan s'emploie, comme un vrai romancier, à la restitution de l'atmosphère des négociations à Rambouillet et à Kleber, début 1999, « dans les coulisses de la politique française ». Toutes ces pages ne nous apprennent rien de nouveau, de ce qu'on avait eu l'occasion de lire, dans de nombreux articles, sur les négociations à Rambouillet et à Kleber. Par ailleurs, Péan n'est pas le seul à croire que la partie serbe dans ses négociations aurait offert une bonne solution, « des propositions qui allaient très loin » pour le Kosovo, en proposant une « autonomie de gouvernement » qui garantiraient « le caractère multi-ethnique de la province à l'intérieur de la Serbie », et les nombreux droits et les libertés pour les Albanais (91-92). Notre journaliste indépendant, qui veut nous faire *découvrir la vérité* sur les causes de la guerre du Kosovo, mais aussi l'aveuglement des dirigeants occidentaux et de la majorité des intellectuels et des médias européens et américains, épouse tranquillement les arguments du régime de . Il faut une forte dose de cynisme pour prendre pour de l'argent comptant ces promesses du régime de , en faisant abstraction de son idéologie et surtout de ses pratiques politiques, policières et militaires au Kosovo, depuis qu'il est venu au pouvoir, en 1987. Après les cycles de terreur policières , produisant des milliers de prisonniers politiques, c'est le nettoyage ethnique des institutions du Kosovo : fin 80 et début 91 ,la grande majorité des Albanais (des dizaines de milliers) seront expulsés, par la force, de toutes les institutions du Kosovo : des institutions politiques, des écoles et de l'université, des hôpitaux et des crèches, des entreprises économiques, des journaux et des chaînes télévisées, mais également des clubs du sports.

M.Péan, comme un certain nombre de journalistes, dans les années 90, croit que la meilleure façon d'éviter la « diabolisation » du régime de Milosević, à la différence de la « doxa dominante » dans les pays occidentaux, serait d'adopter les arguments de ce même régime : à titre d'exemple en niant le *nettoyage ethnique* des institutions au Kosovo. Malgré les faits sur le terrain, restitués par les organismes internationaux des droits de l'homme. Ainsi, par exemple le *Bureau international du travail* dans son rapport de 1991 (« Licenciements et nettoyage ethniques au Kosovo »), constate, après des enquêtes sur le terrain, l'ampleur et le caractère de cette opération. Précédemment, *La Fédération Internationale d'Helsinki*, dans un de ses rapports, souligne qu'entre 1981 et 1988, l'Etat serbe a condamné 22.000

albanais à des peines de prison allant de 2 à 20 ans le prison pour le délit d'opinion, assez souvent pour la revendication du statut de République pour le Kosovo.

Des journalistes perspicaces belgradois avaient constatés que les prisons de Serbie, par le traitement qu'elles avaient réservé aux jeunes albanais, la plupart des étudiants, allaient servir *d'école* pour la résistance aussi bien politique que celle armée. Effectivement, les dirigeants de l'UCK, seront souvent les prisonniers politiques, soutenu et orienté par Adem Demaçi, écrivain, qui avait passé 30 ans dans geôles de serbes, pour des revendications politiques. Il aura en 1999 le prix Sakharov du Parlement européen.

A la différence de Péan, des journalistes, de divers pays (y compris ceux de la Serbie, comme Lazar Stojanović et Stojan Cerović) qui ont travaillé sur le terrain durant la guerre, percevaient, en effet, les soldats de l'UCK comme des combattants de la liberté.

Le mouvement de résistance politique et pacifique des années 80 et 90, était qualifié souvent par les idéologues du régime de Milosević et sa police comme « terroriste », « criminel et mafieux ». Après le nettoyage ethnique *des institutions*, les réseaux de solidarité, du « système parallèle » dans l'enseignement, la santé, les médias, le sport, se voyaient attribuer l'étiquette de « mafieux ». Le nettoyage ethnique des institutions au Kosovo, et les arrestations massives et condamnation pour le délit d'opinion avait choqué l'opinion européenne, car cela se passait au moment même de la chute du Mur du Berlin et de la libération des prisonniers politiques dans toute l'Europe de l'Est. Le régime serbe va radicaliser son action en enchainant, à partir de printemps 1998, par le nettoyage ethnique du *territoire* du Kosovo. Rappelons qu'à la différence de la doxa de P.Péan, à Belgrade, des associations et des intellectuels serbes (S.Popović, N. Kandić, S. Biserko, V. Pešić, D. Stojanović etc.) critiquent la *politique d'apartheid* instituée par le régime de et d'autre part exigent « dénazification de la Serbie », ayant en vue autant des éléments de l'idéologie du régime mais que les pratiques politiques et militaires, notamment le « nettoyage ethnique » des territoires et les dispositifs qui les accompagnent.

A la différence de M.Péan, qui s'emploie, à travers tout son livre au déni, ou à la réduction et la justification (au non de l'intégrité du territoire) des crimes de masse du régime serbe, certains parmi les plus hauts dirigeants de la Serbie les ont reconnus. Rappelons deux arrêts récents (2012 et 2013) de la TPIY. Six hauts dirigeants de l'Etat, de

l'Armée et de la police serbe (M.Milutinović, le Premier Ministre, le Vice-Président N. Šainović, le chef de l'Etat-major de l'Armée serbe le général D. Ojdanić, l'adjoint du Ministre de l'intérieur serbe (MUP) et le chef de la sécurité le général V. Djordjević, le général N. Pavković et le chef de la police pour le Kosovo, S. Lukić) étaient accusés par le TPIY « d'avoir participé à une entreprise criminelle commune en 1999, qui avait pour but de modifier la composition ethnique du Kosovo afin de garantir le contrôle permanent des Serbes sur la province. »

Selon l'acte d'accusation, cet objectif devait être réalisé « par une campagne généralisée de terreur et de violence à l'encontre de la population albanaise de souche, au cours de laquelle des civils albanais ont été expulsés, tués, transférés de force et persécutés. » D'après l'acte d'accusation, ils ont « dirigé, encouragé ou soutenu des opérations menées par la police serbe, au cours desquelles des centaines de personnes ont été tuées et qui ont entraîné le départ forcé d'environ 800 000 civils albanais du Kosovo. »

Les cinq parmi les accusés furent condamnés, en 2011 et 2012, à de lourdes peines de prison. Le Chef de l'Etat-major, Ojdanić et le général Djordjević ont reconnu tous les chefs d'accusations qui les concernaient. Plus particulièrement, Vlastimir Đorđević, responsable des unités de police serbes et des effectifs qui opéraient au Kosovo en 1999, a précisé notamment sa responsabilité d'avoir organisé et dirigé le transfert, par des camions frigorifiques, des corps des civils et des soldats de l'UÇK tués, depuis le Kosovo vers la Serbie, et réentrées dans les sites spéciaux. L'adjoint du procureur du TPIY, Grejem Bluit, cité par *Vreme* de Belgrade, affirmait que le "caractère planifié de la destruction des traces des crimes correspond au caractère planifié et organisé du crime".

M. Péan critique sévèrement les dirigeants occidentaux d'avoir permis, par une guerre « illégale et illégitime », mais aussi « injuste », de 'détacher' une partie du territoire de la Serbie et de le livrer à la « mafia » albanaise, malgré l'attachement passionnel des Serbes pour le Kosovo. Les pays alliés auraient « choisi de ne pas voir l'attachement viscéral des Serbes au « berceau serbe du Kosovo ». (p.33). Notre journaliste, qui se targue fréquemment dans ce livre, de l'objectivité et du souci de vérité et de justice, oublie de prendre en compte l'attachement de la majorité de la population du Kosovo, des Albanais, pour le pays. Comment ce fait-il que, malgré le fait que la Serbie ait établi depuis 1913 la domination militaire et policière sur le

Kosovo, la majorité de la population, malgré les cycles de terreurs, soit resté au Kosovo? D'ailleurs, Péan nous avait rappelé le fait que des dizaines de milliers de Serbes avaient quitté le Kosovo dans les années 70, à la suite d'un changement constitutionnel, qui avait offert au Kosovo une large l'autonomie (p. 59).

En fait, les gouvernements occidentaux et la majorité des opinions publiques de leurs pays, dans les débats sur le statut du Kosovo, depuis au moins 1999, ont surtout pris en compte, au lieu d'un supposé « attachement viscéral », la volonté politique de la majorité de la population du Kosovo. Ainsi, en janvier 2006, les représentants des pays du Groupe de contacts (la France, La Grande Bretagne, l'Allemagne, les Etats Unis et la Russie) avaient rendu publique un communiqué dans lequel ils soulignent le fait que « la solution de la question du statut du Kosovo aura pour base *la volonté politique de la majorité de la population* ».

Les critiques des crimes des troupes serbes au Kosovo, notamment en 1999, en France et dans d'autres pays, pour Péan ne sont qu'une « propagande exagérément mensongère » (p. 166).

Jacques Chirac, par contre, comme un homme d'Etat responsable, dans le second tome de ses *Mémoires*, (*Le temps présidentiel*, Paris, 2011) explique : « Dans l'immédiat et malgré les réticences de l'administration américaine, peu désireuse de se réengager sur ce terrain, seule une action de l'OTAN peut mettre un terme à la nouvelle entreprise d'épuration ethnique lancée par contre le Kosovo, trois ans à peine après la fin du conflit bosniaque ». Chirac souligne également que la résistance armée des Kosovars depuis 1996, après une période pacifique se transforme en « guerre d'indépendance... ».(p. 236)

La décision de l'intervention a été prise, en effet, après de longues et minutieuses analyses de la situation complexe, et après de nombreuses concertations entre les dirigeants des pays alliées, réunis par une volonté de s'opposer aux pires crimes commis en Europe après la Seconde guerre mondiale.

Le renversement des responsabilités

Même si, à différentes reprises, M. Péan développe la thèse selon laquelle l'intervention militaire contre les troupes serbes était non seulement illégale mais aussi injuste, il lui arrive cependant de

citer des rapports des organismes internationaux qui confirment les crimes de masse. Ainsi, il cite le rapport de l'OSCE, selon lequel « les tueries sommaires comme étaient phénomène généralisé dans tout le Kosovo », et l'expulsion « par la violence » des 860.000 Albanais de la province » (p. 190-91). Reconnaisant parfois ce qu'il est difficile de nier, il va cependant *déplacer* la responsabilité vers la « Force alliée ». L'objectif des dirigeants occidentaux de mettre fin à l'épuration ethnique serbe est réduit par M. Péan à des déclarations « purement et simplement mensongères ». (p. 192). Après avoir nié, malgré les faits sur le terrain, (attestés par de nombreux organismes internationaux), la visé de l'Etat serbe d'effectuer un nettoyage ethnique au Kosovo, Péan rejette la responsabilité pour les crimes massifs des troupes serbes et pour l'expulsion violente de 860.000 des Albanais du Kosovo du régime serbe vers les pays Alliés. M. Péan a l'art du renversement des responsabilités : il en avait offert un autre exemple dans son livre sur le Rwanda (*Noires fureurs, blancs menteurs*, Mille et une nuits, 2005). Dans ce livre il avait trouvé la cause du génocide sur 800.000 Tutsis dans l'attentat contre le président Habyarimana. A la différence de la thèse de P. Péan, la Commission du procureur Trévidić, avait démontré, récemment, à la suite d'une enquête d'experts sur le terrain, que les responsables de l'attentat n'étaient pas du côté de l'armée des Tutsi.

Egalement, dans la description des conflits entre les troupes serbes et l'UÇK, P. Péan régulièrement accuse les soldats de l'UÇK de provoquer les soldats serbes, qui se voient du coup dans la nécessité de se défendre ou de protéger « l'intégrité territoriale de la Serbie ».

Les affirmations fréquentes de M. Péan selon lesquelles les Serbes du Kosovo seront, depuis 1999, les oubliés de la communauté internationale ne tiennent pas debout. Il suffit de consulter les rapports de nombreux organismes internationaux sur place (MINUK, UNDP), ceux des associations internationales des droits de l'homme, ainsi que les discours publics, notamment, des responsables internationaux, transmis par les médias, pour voir qu'à partir de juin 1999, le souci de sécurité de la minorité serbe, devient graduellement une préoccupation majeure. Les responsables politiques de l'ONU ou de l'UE, vont définir l'attitude envers la minorité serbe comme *critère* essentiel dans la valorisation des nouvelles institutions kosovares. Les serbes du Kosovo, malgré l'insécurité, avait accès aux médias du Kosovo, en langue serbe, de la Serbie et aux média internationaux, depuis 1999.

Ils exprimaient leurs opinions par leurs représentants aux conseils municipaux mais également au Parlement du Kosovo. Par ailleurs, l'affirmation de Péan qu'il est allée au Kosovo pour donner la parole aux victimes serbes, ignorée par la communauté internationale est d'autant plus prétentieuse. Par un séjour de quelques heures à Gracanica où, par ailleurs, existe, depuis plusieurs années le *Média Centar*, qui organise des débats politiques entre hommes politiques et journalistes Serbes et Albanais, mais aussi internationaux. Divers organismes internationaux, mais aussi les médias et les intellectuels, y compris ceux du Kosovo, ont dénoncé et critiqué les exactions contre les Serbes, après la guerre. L'amélioration de la situation de sécurité des Serbes après la guerre, a été perceptible. De cette évolution fait exception l'irruption de la violence des extrémistes albanais les 17, 18 et 19 mars 2004. Rappelons que parmi les 18 victimes, 11 parmi eux étaient des Albanais. Des centaines de maisons de Serbes furent brûlées. Ces maisons ont été reconstruites, à la suite, par les autorités du Kosovo, à partir de l'été 2004. P. Péan dans son style d'objectivité et de souci de vérité affirme « qu'en mars 2004, le Kosovo a été littéralement nettoyé de ses minorités ethniques »³⁷⁹. En fait, au Kosovo vit aujourd'hui une communauté de 150.000 Serbes. Mais également, des Roms, des Bosniaques, des Monténégrins, des Turques, qui font 10% de la population du Kosovo. L'Union européenne et les autorités du Kosovo, ont fait un travail de long haleine, depuis 1999, d'intégration graduelle des Serbes dans les nouvelles institutions du Kosovo, depuis les municipalités jusqu'au Parlement et le gouvernement.

L'approche de Péan envers la question du Kosovo se manifeste également par le refus de communiquer avec les représentants des institutions du Kosovo, avec ceux de la société civile, les journalistes ou les représentants des organismes internationaux au Kosovo. Mais également avec les hommes politiques, les intellectuels et les journalistes serbes qui ont une attitude critique envers le régime de Milosević, son idéologie et ses pratiques.

Afin de rendre plus convaincante sa critique radicale des gouvernements occidentaux, des intellectuels et des journalistes qui ont soutenu l'intervention militaire contre le régime serbe et également l'indépendance du Kosovo, P. Péan construit l'image d'un pays qui serait en enfer sur la terre, un espace habité exclusivement par des criminels et des mafieux, un *produit monstrueux* qui bénéficie de la complicité de « quelque soixante mille militaires, policiers,

administrateurs et jugent internationaux» (336-362). M. Péan tend ce produit monstrueux devant les yeux des occidentaux afin qu'ils prennent conscience des erreurs historiques qu'ils ont fait par l'intervention contre la Serbie et par le soutien au Kosovo indépendant. Cette construction a été opérée dans ce livre par certains procédés classiques de la propagande : notamment celui qui construit un grand mensonge à partir de certains éléments vrais. Cependant, la généralisation et l'extrapolation de ces éléments sur l'ensemble de la société et de l'Etat rend la construction de Péan, non seulement outrancière mais essentiellement fausse. Ainsi, le crime organisé et les réseaux mafieux existent au Kosovo. Mais les organismes internationaux qui s'occupent de ces réseaux ne laissent pas entendre que ces réseaux sont l'essence même de la société et de l'Etat du Kosovo. Dans leurs rapports, ces institutions spécialisées dans l'analyse des phénomènes mafieux, signalent la puissance et l'enchevêtrement des réseaux mafieux non seulement entre les pays des Balkans et de l'Europe de l'Est mais également avec d'autres régions du monde.

Dans ce livre de 450 pages de P. Péan on ne peut trouver une seule phrase qui pourrait suggérer que la société et l'Etat du Kosovo puissent développer des activités qui ne seraient pas mafieuses et criminelles. La fausseté des affirmations de Péan provient de cette volonté *d'essentialiser le mal* dans l'Etat du Kosovo, en se privant de l'effort de le comprendre dans ses contrastes et contradictions, dans son évolution et changements, donc dans sa complexité. Les journalistes ou les experts de divers organismes internationaux qui se sont rendu au Kosovo et qui se sont donné la peine de comprendre, sans parti pris politiques et sans préjugés, ses réalités, on trouve une présentation radicalement différente de celle de P. Péan.

Ainsi dans les rapports annuels de la Commission européenne sur les pays des Balkans occidentaux (y compris le Kosovo), qui aspirent à intégrer l'Union européenne. Ces rapports minutieux, faits à la suite de nombreuses enquêtes sur le terrain, par une communication régulière et systématique avec les institutions de ces Etats, mais également par divers acteurs de la société civile. Parallèlement avec les carences et les défauts, ils soulignent les progrès fait dans divers domaines, y compris dans le domaine de la lutte contre la corruption et le crime organisé.

Selon les rapports de la Commissions européenne sur le Kosovo, les réformes dans l'administration publique, dans le système judiciaire

et la police ont permis une efficacité plus importante dans leur fonctionnement. Les institutions du Kosovo ont fait des efforts considérables à affronter les problèmes de la corruption et du crime organisé. Dans ce travail elles ont bénéficiée du soutien de la Mission civile de l'Union européenne, l'EULEX. Ainsi, plusieurs enquêtes judiciaires, arrestations et procès à l'encontre des personnes soupçonnées de corruption, de crimes organisé ou de crimes de guerre, ont eu lieu ou sont en cours. Il faut la peine de signaler que les poursuites judiciaires et les procès à l'encontre des personnes soupçonnées de crimes organisé et crimes de guerre ont augmenté notamment depuis la proclamation de l'indépendance, 2008 : devant les tribunaux sont traduit des responsables de tout les échelons de l'administration de l'Etat, depuis les maires des communes jusqu'au Ministres, de différents ressorts.

Dans ces rapport a été constaté une participation plus large des minorités, et surtout celle serbe, aux dernières élections locales de 2009 et aussi celles législatives de décembre 2010, ayant pour effet une présence plus importante des représentants des minorités aux conseils municipaux, au Parlement national et dans le gouvernement. Ainsi, dans le gouvernement actuel il y a trois ministres serbes et un vice-premier ministre. L'usage de la langue serbe, comme deuxième langue officielle du Kosovo, dans toutes les institutions, les documents ainsi que dans les médias, parallèlement avec l'usage officiel de la langue turque et rom dans plusieurs municipalités, ont contribué à créer un meilleur climat dans les relations interethniques. Ces faits têtus des réalités du Kosovo, depuis la proclamation de l'indépendance, et la reconnaissance par une centaine de pays, de tous les continents, ne peuvent pas disparaître, même si on fait un livre de 450 pages pour les nier.

D'autre part, le Groupe de pilotage, constitué par 23 pays de l'Union européenne, la Turquie et les Etats-Unis, a pris la décision début septembre 2012 de mettre un terme à la supervision de l'indépendance du Kosovo. Cette décision a été prise à la suite des appréciations du travail fait, par les institutions du Kosovo depuis 2008, et notamment après avoir établi que le Kosovo avait mis l'essentiel des dispositions du plan Ahtissaari en œuvre et constaté que le cadre constitutionnel et juridique nécessaire était en place.

Dans ces rapports sont mis en lumière également, n'en déplaise à Péan, des dimensions très importantes des activités de la société et de l'Etat du Kosovo, y compris sur le plan régional et international, la

création des liens et des projets économiques et culturels avec une centaine de pays, dont certains ne l'ont pas encore formellement reconnu.

Manipuler l'horreur

La pièce maitresse de la preuve du caractère mafieux et criminel de l'Etat du Kosovo pour Péan (comme pour Dick Marty) réside dans un crime **supposé** : le prélèvement des organes sur des prisonniers serbes, effectué par les soldats de l'UÇK, durant la guerre de 1998-1999, au Nord de l'Albanie.

P. Péan tend ici d'asseoir la véracité de son opinion sur « le trafic d'organes pratiqué par l'UÇK », par la répétition fréquente de l'affirmation, selon laquelle les organisations internationales n'ont mené aucune enquête sur ce trafic d'organes. Pourtant *c'est faux*, car le TPIY, la MINUK (la Mission de l'ONU au Kosovo) et Eulex avaient mené des enquêtes aussi bien sur les détentions et les meurtres que sur les allégations sur « le trafic d'organes ». Ces organismes ont également mis en place, avec la police et les tribunaux du Kosovo, plusieurs procès depuis 1999, sur les meurtres ou les enlèvements des Serbes ou des Albanais, au Kosovo ou devant le TPIY. Un certain nombre de procès sur ces questions sont en cours.

Après la publication du rapport de M. Marty, ces organisations ont rappelé avoir mené des enquêtes qui n'ont pas abouti faute de preuves. Carla Del Ponte, Procureur de la TPIY, dans son livre *La traque, les criminels de guerre et moi* (2008) admet qu'elle n'avait pas le début d'une preuve pour poursuivre l'enquête.

Ce qui est intéressant c'est que le Chef de l'Agence militaire de sécurité de la Serbie (BIA), Svetko Kovač, a déclaré lors d'une conférence de presse à Belgrade, le 28 décembre 2010, selon le quotidien belgradois *Blic*, que son Agence a travaillé depuis 1999 à la collecte des informations sur le trafic d'organes : « mais ce que nous avons trouvé ne suffisait pas pour une étape ultérieure. » M. Kovač a souligné également qu'il n'a pas de dossier classique sur M. Hashim Thaçi.

M. Vukčević, de sa part, avait déclaré à Belgrade, après la publication du rapport de Dick Marty, que celui-ci contient une grande partie de son propre rapport. Cependant, M. Marty reconnaît que l'équipe de ce Procureur, « qui a déployé des efforts considérables,

n'a pas non plus abouti à des résultats très concrets. » (p. 10) Plus tard, M. Marty va avouer qu'il n'a pas de témoins, mais des sources, qui pourraient devenir des témoins, sous conditions de sécurité. Cependant, plusieurs procès au Kosovo, depuis 1999, sur le crime organisé ou les crimes de guerre, malgré les difficultés avec les conditions de sécurité de témoins (seulement au Kosovo ?), ont été menés à l'appui également des témoins dont certains ont témoigné aussi devant les médias. En même temps, il lui est arrivé de reconnaître qu'il n'a pas de preuves juridiques mais des éléments qui pourraient confirmer son appréciation politique que les autorités de divers pays et ceux de la Minuk étaient au courant du crime supposé.

Il vaudrait la peine d'avoir en vue ici le constat du Chef de l'Agence militaire de sécurité de la Serbie (BIA) sur l'absence de preuves sur le trafic d'organes, malgré son enquête menée depuis 1999. M. Péan accuse les organisations internationales au Kosovo d'avoir été au courant de ce « crime » et d'avoir tout fait tout pour que l'affaire ne vienne au grand jour. Pourrait-on faire, alors, le même reproche à la puissante BIA, sachant que ses services, selon les déclarations publiques de leurs responsables, ont continué leurs activités de terrain au Kosovo, après 1999 ? Comment se fait-il que ces services n'ont pas trouvé de témoins crédibles *parmi les dizaines de milliers de Serbes qui ont quitté le Kosovo vers la Serbie*, avec leur armée, après la guerre ? Ces questions ont été posées par certains journalistes serbes qui avaient le souci de l'objectivité.

Pour prouver la vérité du prélèvement d'organes sur les prisonniers serbes par les soldats de l'UCK, durant la guerre, P. Péan cite différents rapports et articles, et notamment celui de Dick Marty. Cependant, tout de suite après la publication du rapport de Marty, ce sont justement des médecins de renommée qui ont clairement contesté la possibilité du prélèvement d'organes dans ce contexte. Ainsi, le chef de l'Institut de Médecine légale et de la Criminologie de Skopje (Macédoine), M. Aleksej Duma, dans son entretien pour le quotidien *Utrinski vesnik*, le 25 décembre, souligne l'absence de conditions techniques et médicales en Albanie pour ce type d'opération. D'autres ont rappelé que la première greffe (légale) de rein en Albanie a eu lieu dans une clinique de Tirana en 2008.

De la même façon, prof. dr Goran Kronja, durant 30 ans chef de l'équipe pour la transplantation des organes dans la VMA, la prestigieuse Académie militaire-médicale à Belgrade, à deux reprises s'est adressé à l'opinion de la Serbie concernant ce crime supposé.

Dans le journal belgradois on-line « Svedok », le 31 janvier 2011, dans un entretien mené par Sredoje Simic, M.Kronja explique pourquoi cette opération n'était pas possible au Kosovo ou en Albanie: « Parce que la procédure du prélèvement des organes est extrêmement sophistiquée et compliquée [...]. Car, pour le prélèvement des organes on a besoin, entre autres, des conditions de stérilité, un bon soutien de laboratoires, et des dilutions très chères. Jusqu'à tout récemment chez nous, qui sommes mieux munis et équipés matériellement et par la logistique que le Kosovo, seulement l'Académie militaire et médicale avait le laboratoire pour fabriquer ces dilutions. » Dans la longue description des conditions requises pour le prélèvement d'organes, dr Kronja souligne plus particulièrement « le très haut niveau professionnel des équipes des chirurgiens vasculaires, des chirurgiens spécialistes pour des organes concrets, ainsi que d'autres experts. » Ce type d'opération n'aurait pu se faire, selon dr Kronja, qu'ailleurs, dans un Etat qui aurait les conditions logistiques et les équipes professionnelles de haut niveau. Et dans ce cas, il s'agirait effectivement « d'un crime monstrueux ». Mais, si le crime n'a pas eu lieu, ajoute-il « dans ce cas le raisonnement dans ce sens est aussi monstrueux. Le cerveau qui raisonne de cette manière, seulement sur la base des indices non-vérifiés, incertains et arbitraires et également monstrueux. »

La mission de l'UE EULEX a constitué, il y a deux ans déjà, une unité spéciale qui enquête sur le crime supposé du prélèvement d'organes, dirigé par le procureur Clint Williamson. D'autre part, il faut rappeler le fait que depuis la publication du rapport de M. Marty, ce sont les autorités de Kosovo et celles de l'Albanie qui ont demandé officiellement une nouvelle enquête judiciaire internationale.

Péan accuse les instances internationales (MINUK, TPIY) d'avoir étouffé ou détruites « les preuves importantes » (329-330) sur « le trafic d'organes organisé par l'UÇK »

Malgré le fait que les trois enquêtes de la MINUK, de TPY et de l'EULEX n'ont pas trouvé aucune preuve sur le prélèvement des organes par les soldats de l'UÇK, malgré le fait que Marty, trois ans après avoir rendu public son rapport, n'a pas apporté aucune preuve en faveur de ses allégations et refuse toute coopération avec l'équipe de l'EULEX, et malgré le fait que la quatrième enquête par l'équipe spéciale de l'EULEX, n'a pas confirmé ce crime supposé, Péan croit dur comme fer à la véracité de ce crime. Péan nous cite l'indignation du journaliste serbe Budimir Ničić de la réaction de Kouchner,

Ministre des Affaires Etrangères de la France, lors de sa visite au Kosovo début mars 2010, à la suite de la question qu'il lui pose « Un grand nombre de familles serbes vous accusent d'avoir participé à du trafic avec les organes des Serbes kidnappés ? »³³¹⁻². Péan n'exprime la moindre réserve envers l'affirmation contenue dans cette question. Péan, dans ses commentaires des entretiens déjà publiés, depuis quelques années, s'emploie à nous convaincre de la véracité de ce crime supposé, même s'il n'apporte pas la moindre bribe d'élément fiable. Par contre, il critique tous ceux qui expriment des doutes sur les allégations de D. Marty. Ainsi, il s'attaque à un article dans le *Monde* du 31 décembre 2010 qui a osé parler « des faiblesses du rapport sur le trafic d'organes », une « controverse » destinée, selon lui, à occulter la gravité du crime.(p.430)

Citant amplement le rapport de Marty dans 28 pages de son livre, Péan, souligne la certitude de Marty du lien entre le crime supposé des soldats de l'UÇK durant la guerre et le cas de la clinique *Médecus* en 2008. Ces pratiques criminelles, qui ont des ramifications internationales, ont été découvertes par la police du Kosovo, et celle de l'Eulex, en 2008. Début mai 2013, le verdict est tombé. Reconnus coupables de crime organisé et de trafic d'êtres humains, deux médecins ont écopé des peines de 8 et 7 ans de prison. Les trois autres médecins, tous anesthésistes, ont été condamnés à des peines de 3 à 1 an d'emprisonnement. Ce procès de plusieurs années s'est déroulé, cependant, en l'absence des deux principaux protagonistes de cette affaire. Le médecin turc Yucuf Ercin Sonmez et l'israélien Moshe Harel, qui jouait le rôle d'intermédiaire entre donneurs et receveurs et était de ce fait considéré comme le cerveau du réseau

L'arbitraire de la méthode de « l'enquête » de Péan, à l'appui du rapport de D. Marty, se voit ici par l'extrapolation entre ces deux situations, par une *construction artificielle* de la *continuité* des activités d'une décennie, qui n'est pas corroborée jusqu'à aujourd'hui par aucune preuve.

Mais le Procureur de l'Eulex, Jonathan Rathel, selon *Independent* du 12 mai, était formel : « Durant mon enquête de 5 ans je n'ai pas trouvé aucun lien entre ce cas et les allégations sur les prélèvements d'organes durant la guerre. »

M. Péan évite « les faiblesses » des interrogations et des doutes, car il a des certitudes inébranlables, étayées par le recyclage de nombreuses citations d'articles, déjà connus depuis 1999, et qui devraient les confirmer : l'illégalité et l'illégitimité de l'intervention

au Kosovo, la création par les services occidentaux de l'organisation « criminelle et mafieuse » de l'UÇK, le « parrainage » de l'indépendance du Kosovo.

Dans l'*Epilogue*, (p .429-458) M. Péan revient à la charge contre les pays occidentaux par l'usage d'un « témoignage » du procureur serbe Vekaric, qui, par ailleurs, ouvre le livre : c'est un geste qui en dit long sur sa démarche. Un des derniers chapitres du livre a pour titre « Dernière plongée dans l'horreur... » (p. 439). Ces « plongées dans l'horreur » devraient *tétaniser* ses lecteurs, en refoulant les doutes sur les explications politiques des problèmes du Kosovo que Péan nous offre dans ce livre. Et cependant, ce « témoignage » n'a acquis aucune crédibilité, même pas en Serbie, plus d'un an et demi après sa publication. Ainsi, le *Fond pour le droit humanitaire* de Belgrade, organisme chevronné dans l'enquête et la dénonciation des crimes de guerre, depuis 20 ans déjà, critique la démarche du Procureur de la Serbie, dans un communiqué publié par le quotidien *Danas* de Belgrade (11 septembre). La présidente du Fond, Nataša Kandić, a réagi, après la publication de la vidéo par une chaîne de télévision de Belgrade qui met en scène un « témoin » qui aurait participé au prélèvement des organes des prisonniers serbes au Nord de l'Albanie : « Je crois que le Procureur pour les crimes de guerre de la Serbie lance cette histoire pour des raisons politiques mais en même temps il provoque de l'inquiétude dans les familles des victimes. Cette histoire n'est pas convaincante [...] pourquoi ce témoin si important, s'il existe, ne se trouve pas sous la protection de l'équipe de l'EULEX qui mène l'enquête sur cette affaire ? » ; elle a ajouté : « si le Procureur de la République serait une institution sérieuse, il aurait travaillé ensemble avec l'équipe de l'EULEX dirigé par le procureur Clint Williamson. » Kandić s'interroge plus loin : « qui pourrait croire que si l'UÇK aurait décidé de faire une action si criminelle, aurait engagé des soldats simples pour couper par une baïonnette des cœurs, afin de les vendre ensuite ? ». Le « témoin » dans cette vidéo affirme, en effet, qu'il n'a jamais vu de sa vie les outils « nécessaires pour pratiquer une opération chirurgicale ». Selon ce témoignage, il aurait fait une formation de *deux semaines* pour faire l'opération du prélèvement d'organes (?!). Ni l'équipe de l'EULEX n'a donné aucune crédibilité à ce récit.

Cette production de témoignage devant les caméras ressemble à une autre, de 1998, qui met en scène deux « soldats de l'UÇK » qui « avouent » devant les caméras de la police serbe « avoir participé à

jeter plusieurs civiles serbes à Klečka (au Kosovo), dans une fosse de chaux brulante à 1000 degré ». Le régime serbe et une partie des médias belgradois avaient qualifié ce crime supposé de « l'Auschwitz pour les Serbes ». C'est le Directeur de l'Académie militaire et médicale de Belgrade (VMA), M. Zoran Stanković qui avait qualifié le récit et les données présentées dans cette vidéo comme une supercherie compromettante pour la Serbie.

C'est l'*abjection* d'un crime *supposé* qui devrait, pour Péan, éclairer « la vraie nature » d'un mouvement de libération et d'un Etat (p. 442), et d'autre part *refouler* le poids des crimes *avérées* de l'Armée et de la police serbe au Kosovo.

Ce livre de Péan n'apporte pas une enquête sérieuse sur le Kosovo. Par des citations nombreuses et abondantes des articles publiés en France depuis 1999, il *recycle* une interprétation des événements qui stigmatise les gouvernements, les intellectuels et les médias de plusieurs pays occidentaux de s'être opposé au pire régime que la Serbie ait connu dans son histoire et d'avoir soutenu la libération d'un peuple. A l'ignorance des Balkans, aux commentaires superficiels M. Péan allie l'arrogance des certitudes inébranlables et irréfléchies.

Arsim Ejupi, LUGINA E PRESHEVËS. Studim kompleks gjeohapësinor, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2013, f. 350.

Lugina e Preshevës, siç e quajten amerikanët në vitin 2001, që u përqaftua si emërtim nga shqiptarët dhe të huajtë në kuptimin e një entiteti të veçantë etnik dhe politik, ose Kosova Lindore apo tri komunat në jug të Serbisë (Presheva, Bujanoci dhe Medvegja), shtrihet në rreth 1.250 km katrorë. Shqiptarët këtu jetojnë në një numër relativisht të madh dhe kanë një shtrirje territorialisht kompakte, por me një shpërndarje, meqë komuna e Medvegjës lidhet me rajonin e Gallapit në Kosovë. Komuna e Preshevës sot hyn në radhën e komunave më homogjene kombëtare, sepse mbi 95% të popullsisë së gjithmbarshme janë shqiptarë, ndërsa në komunën e Bujanocit shqiptarët përbëjnë rreth 65% të popullsisë; të tjerët janë serbë dhe romë. Ndërkaq, në komunën e Medvegjës, për shkak të shpërnguljeve, së pari të qeta, pastaj intensive, numri i shqiptarëve gjithnjë po zvogëlohet dhe ata sot përbëjnë një përqindje të vogël, gati simbolike; në numër absolut atje sot kanë mbetur të jetojnë vetëm afër 500 veta nga rreth 6.000 sa kishte sipas regjistrimit të vitit 1981.

Si popullatë rezidenciale në këtë territor para dy-tri dekadave jetonin rreth 100.000 shqiptarë, të shtrirë në 67 fshatra dhe në tri qendra urbane. Jo vetëm në komunën e Medvegjës, por edhe në dy komunat e tjera, në Preshevë e Bujanoc, këto dy dhjetëvjetëshat e fundit komponenti numerik dhe reprodutiv-biologjik i shqiptarëve gjithnjë po tëhollohet përmes shpërnguljes, ndërsa shkaqet kryesore janë presionet policore-ushtarake, politike dhe ekonomike. Indikatorët më të qartë për këtë tendencë të regresit demografik janë rënia e shkallës së lindshmërisë dhe zvogëlimi i vazhdueshëm i numrit të paraleleve dhe të nxënësve në klasën e parë të shkollës fillore në të gjitha vendbanimet e Luginës së Preshevës. Lugina është 7-8 herë më e pazhvilluar se mesatarja e Serbisë dhe popullata shqiptare kryesisht jeton nga bujqësia dhe nga remitancat që i sjellin bashkatdhetarët që punojnë në botën e jashtme.

Për shkak të pozitës gjeopolitike dhe gjeostrategjike dhe arterieve të rëndësishme gjeokomunikative (hekurudha ekziston që nga viti 1874 dhe autostrada që nga viti 1962 si vija ndërkombëtare), Lugina e Preshevës u bë pjesë e apetiteve dhe interesave të të mëdhenjve, perandorive të ndryshme, por në radhë të parë e interesave të Serbisë nga pjesa e dytë e shekullit XIX e këndeje. I kujtojmë idetë e

kahmotshme të Serbisë për daljen në det, ëndrrën dhe kërkesën e J. Cvijiqit, ithtarit kryesor të daljes në detin Adriatik dhe në detin Egje, duke imituar I. Garashaninin, por edhe interesimin e kompanive të huaja, para së gjithash të atyre franceze nga fillimi i viteve të 60-ta të shek. XIX për mundësinë e zhvillimit të komunikacionit lumor në luginën e Moravës.

Pretendimi megaloman i Serbisë që dy luginat, e Moravës dhe e Vardarit, të bëheshin të lundrueshme përmes një sistemi të komplikuar dhe shumë të shtrenjtë të lundrimit, duke kaluar madje edhe pengesën jo të vogël relieve, kërrusjen midis Preshevës dhe Kumanovës (460 m lartësi mbidetare), nuk ka dyshim se ishte dhe mbeti një absurd! Cvijiqi kishte përpunuar edhe idenë për daljen e Serbisë në detin Adriatik përmes ndërtimit të një hekurudhe, e cila duhej të kalonte nëpër luginën e Drinit. Këto apetite të Serbisë i përmendi tash së fundi edhe presidenti aktual i Serbisë, Nikoliq. Kjo aspiratë e Serbisë, historike dhe aktuale, e vështirëson shumë zgjidhjen e çështjes së Luginës së Preshevës në kontekstin e kërkesës së shqiptarëve për shkëmbim terriroresh dhe bashkim me Kosovën. Disa zëra të herëpashershëm të zyrtarëve serbë, përfshirë kryeministrin aktual Daçiq, për këmbim terriroresh (Lugina t'i jepet Kosovës, ndërsa Veriu i Kosovës t'i bashkëngjitet Serbisë) janë vetëm një lojë politike cinike. Por edhe nëse ka diçka të vërtetë, këtë kërkesë duhet kuptuar si këmbim të disa fshatrave të Karadakut në komunën e Preshevës dhe të Bujanocit, gati të shpopulluara, me veriun e Kosovës, por jo edhe të territorit ku kalojnë arteriet kryesore – hekurudha dhe autostrada, që është shumë i pasur me resurse natyrore. Në këtë pikë ka edhe zëra të disa politikanëve e deputetëve shqiptarë të Kosovës, të cilët për interesa individuale apo klanore, drejpërdrejt ose tërthortë, mendojnë si politikanët serbë! Një fakt tjetër, që ia shton rëndësinë Luginës dhe i rritë edhe më shumë interesat e të tjerëve rreth saj, veçanërisht të Serbisë, është se mes për mes Luginës së Preshevës tash kalon edhe korridori X i autostradës ndërkombëtare Beograd – Shkup – Selanik, si arterie kryesore në Ballkan, që lidh Evropën Qendrore me atë Jugore.

Siç na është e njohur, ndarjet e territorit etnodemografik të shqiptarëve deri në ditët tona kanë qenë të imponuara e të dhunshme dhe të shoqëruara me tragjedi të mëdha në rrafshin kombëtar, politik, ekonomik, social, familjar etj. Hapësirat shqiptare të tri komunave: Medvegjë, Bujanoc e Preshevë bëjnë pjesë në tërësitë e mëdha etnogeografike ku përfshihen edhe rajonet e Gallapit dhe të

Karadakut, e bashkë me to të tërë Kosovës të lidhura pashkëputshëm me Luginën e Komanovës-Shkupit dhe zonën e Karadakut, që sot ndodhet në Maqedoni. Jo rastësisht Lugina e Preshevës dhe shqiptarët e atjeshëm në kohën e Perandorisë Osmane, deri në vitin 1912 ishin pjesë përbërëse dhe e pashkëputshme e Vilajetit të Kosovës, ndërsa pas vitit 1919 në Mbretërinë SKS bënë pjesë në Banovinën e Vardarit. Pas Luftës II Botërore ky territor sërish në pikëpamje administrative-politike mbeti jashtë Kosovës dhe hapësirës së pakëputur etnike. Megjithatë, shqiptarët e këtij rajoni ishin dhe mbetën në shumë rrafsh pjesë përbërëse e një tërësie me popullatën shqiptare të Kosovës dhe të Maqedonisë, duke marrë pjesë aktive në të gjitha rrjedhat dhe lëvizjet kombëtare e çlirimtare të atëhershme e të mëvonshme, përfshirë dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit XX dhe fillimin e shekullit XXI, kur e ndihmuan materialisht dhe me luftëtarë Lëvizjen për liri e pavarësi dhe UÇK-në (1998-1999), luftën çlirimtare të shqiptarëve në Maqedoni (2001) dhe të vetë UÇPMB-së në Luginën e Preshevës (2000).

Lugina e Preshevës shumë pak është studiuar. Ajo është hulumtuar kryesisht në kuadër të regjioneve më të mëdha, si të Anamoravës, Pçinjës, Kumanovës etj. dhe kryesisht vetëm nga autorët serbë. Studimet janë të mangëta edhe për faktin se ajo asnjëherë nuk është trajtuar në mënyrë të gjithanshme e komplekse, por janë bërë vetëm hulumtime të pjesërishtme si në rrafshin fiziko-gjeografik, ashtu edhe në aspektin socioekonomik dhe demografik. Mungonin studimet nga ana e autorëve shqiptarë. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës që moti ishte e interesuar për ta nxjerrë në dritë një botim të plotë shkencor për Luginën, por nuk e kishte autorin. U gjet një studiues i ri, serioz dhe perspektiv në shkencë, autori i studimit që po e përurojmë sot, dr. Arsim Ejupi, i lindur dhe i lidhur me Luginën, i cili punon në Universitetin e Prishtinës, por jeton atje. Ai e bëri diplomën, masterin e shkencave dhe disertacionin e doktoratës për problemet konkrete të këtij territori. Deri tash ka botuar disa studime dhe artikuj në Kosovë, në rajon dhe më gjerë për Luginën e Preshevës dhe për çështjet e ndryshme teorike në rrafshin e shkencave gjeoetnike dhe gjeohapësinore, që tregojnë origjinalitetin dhe citohen dhe në nivel jashtëkombëtar.

Autori në analizën e tij shkencore vë në pah se problemi i Luginës së Preshevës dhe i shqiptarëve të atjeshëm ekziston gjatë kohë. Territori ishte si çështje “e ngrirë”, si zonë krize, me tensione latente, por në pika të caktuara kohore dhe me tensione të hapura

politike, etnike, konfesionale etj. Duhej vetëm një shkëndijë që të eksplodojë dhe kjo ndodhi para disa muajve me një lapidar; kontesti rreth tij në një shkallë e ndërkombëtarizoi Luginën, por në dimensionet kyçe çështja nuk u çua deri në fund. Çështja nuk gjeti mbështetje të duhur as politike, as diplomatike e as financiare nga autoritetet e Kosovës dhe të Shqipërisë.

Në takimet e Vjenës 2005-2007, ku u vunë suazat bazë për zhvillimet e mëvonshme, kërkesat e popullatës shumicë të hapësirave përkatëse në Kosovë as që u shtruan nga ana e liderëve shqiptarë të Kosovës, e aq më pak ato të shqiptarëve të Luginës së Preshevës! Në asnjë rast nuk u përmend as emri i Luginës së Preshevës, as i shqiptarëve që jetojnë atje! Edhe sot kjo Luginë vazhdon të mos trajtohet si çështje ndërkombëtare, madje as e barabartë me Veriun e Kosovës. Faktori ndërkombëtar, në saje të heshtjes së shqiptarëve dhe të realitetit në terren, Luginën e Preshevës e trajton si “çështje të brendshme të Serbisë” dhe nën juridiksionin e saj, ndërsa veriun e Kosovës nuk e konsideron si “çështje të brendshme të Kosovës” dhe të rendit kushtetues të saj! Institucionet qendrore të Kosovës nuk e kontrollojnë pjesën veriore të saj, ndërsa institucionet e Serbisë funksionojnë efektivisht atje në Luginën e Preshevës!

Edhe në takimet e Brukselit midis kryeministrave të Kosovës dhe Serbisë në gjysmën e parë të vitit 2013, me ndërmjetësimin e baroneshës C. Ashton, Lugina e Preshevës mbeti jashtë çdo bisedimi dhe reciprociteti me Serbinë. Në bisedimet në Vjenë dhe në Bruksel pashmangshëm duhej të shtrohej çështja e shqiptarëve të kësaj Lugine, nëse jo për zgjidhjen e problemeve të tyre, bile për ta shfrytëzuar si argument për t’i relativizuar dhe amortizuar kërkesat e autoriteteve të Beogradit për privilegjet e serbëve në Kosovë, përfshirë krijimin e Asociacionit apo Bashkësisë së Komunave Serbe, me kompetenca që si duket shpiejnë drejt invalidizimit të tërësisë territoriale të Kosovës dhe lëndimit të rëndë të funksionimit të shtetësisë së saj! “Asociacioni i Komunave do të funksionojë nën dy ombrella ligjore”, të Kosovës dhe të Serbisë, bëjnë të ditur instancat relevante ndërkombëtare!

Nga argumentimi në studimin e dr. Arsim Ejupit del se më të sakrifikuarit janë bërë shqiptarët e Luginës: pa lidhje komunikimi madje as në rrafshin kulturor me Kosovën. Janë pamundësuar rrethanat që t’i realizojnë të drejtat e tyre njerëzore e kombëtare, shoqërore, politike-shtetformuese dhe ekonomike brenda Serbisë. Nuk mund t’i zgjidhin as problemet elementare jetësore, sepse, përveç tjerash, kufijtë janë bërë pengesë: duke qenë nën juridiksionin e

Serbisë, kufijtë e kontrolluar me Maqedoninë, me Bullgarinë (përmes Serbisë) dhe me Kosovën po e pengojnë seriozisht funksionimin e jetës ekonomike. Ka mbetur pa u kthyer një numër i madh i shqiptarëve në shtëpitë e tyre pas konfliktit të armatosur në vitin 2000; vendbanimet e komunës së Medvegjës dhe të pjesës së Karadakut të Preshevës dhe Bujanocit gati janë braktisur nga shqiptarët, duke i lënë pronat e tyre të paluajtshme. Në anën tjetër, presioni ushtarako-policor është rritur: pas ndjekjes së forcave ushtarake serbe nga Kosova, koncentrimi i tyre është bërë pikërisht në territorin e Luginës së Preshevës, kryesisht në rripin kufitar me Kosovën.

Por të gjitha këto dhe çështje të tjera do të duhej të shtroheshin në Vjenë dhe më vonë në Bruksel nga autoritetet kosovare. Për avancimin e pozitës së gjithmbarshme të shqiptarëve të Luginës së Preshevës produktive janë vetëm angazhimet konkrete, të prekshme, të Kosovës, të Shqipërisë dhe të faktorit ndërkombëtar, por në nivelet e tyre relevante vendimmarrëse. Një hap i tillë politik ndoshta do të duhej të konsiderohej debati në Kuvendin e Kosovës për Luginën, i inicuar më tepër për përfitime politike të grupeve të caktuara. Por edhe ai përfundoi vetëm më një rezolutë, e cila shpresojmë të mos jetë e vdekur që në fillim dhe të mos e ketë fatin e rezolutave të tjera të nxjerra në këtë Kuvend. Nga ana tjetër, edhe faktori politik shqiptar i Luginës së Preshevës është jounik dhe plotësisht konfuz sa i përket kërkesave dhe zgjidhjes së çështjes së shqiptarëve të atjeshëm. Në luftë për pushtet, pa pasur as potencial votues, shqiptarët atje janë copëtuar në disa grupacione e parti politike, duke lënë anash interesin e territorit, të kauzës kombëtare dhe të popullatës së atjeshme. Me një sjellje joracionale dhe jopragmatike ndaj këtyre çështjeve, ata sot gjenden në pozita krejtësisht të pakuptimta, ku varësisht nga rrethanat, pikat kohore konjunkturale, një grup deklarohet për bashkim me Shqipërinë, tjetri për bashkim me Kosovën, grupi i tretë ia dorëzon tinëzisht pushtetin lokal partisë së Daçiqit, grupi i katërt mbetet i hutuar etj. Në këto sjellje të pakuptueshme e të dëmshme të faktorit vendor shqiptar, mjerisht kanë gisht edhe disa liderë politikë të Kosovës!

Publikimi ka 350 faqe, me shumë tabela, harta e grafikona dhe ilustrime të tjera. Kështu voluminoz, studimi përfshinë disa pjesë problemore, të cilat janë reciprokisht të lidhura dhe përbëjnë një tërësi unike. Pas një parathënie dhe shqyrtimeve hyrëse dhe paraqitjes së çështjes së hulumtimit, qëllimit dhe qasjeve metodologjike të hulumtimit, si dhe prezantimit të problemit, tema është ndërtuar në nëntë pjesë, secila me

shumë kaptina e nënkaptina. Në fund pasojnë konkluzionet, një rezymë në gjuhën angleze, literatura, burimet dhe indeksi i emrave.

Studimi i dr. Arsim Ejupit, me një përmbajtje komplekse gjeohapësinore e gjepolitike dhe qasje teoriko-metodologjike dhe empirike hartohet për herë të parë dhe si botim vjen në kohën më të duhur, kur vëmendja ndaj çështjes së Luginës po rritet në të gjitha nivelet e zhvillimeve politike shqiptare dhe evropiane. Në aspektin teorik shquhet për trajtimin e koncepteve të reja, për zbatimin e parimeve dhe metodave bashkëkohore të diferencimit territorial, të rajonizimit gjeografik, aplikimit të metodave të reja për zhvillimin e planifikuar dhe shfrytëzimin racional të hapësirës, pastaj për rëndësinë gjeopolitike dhe gjeostrategjike të territorit-korridor dhe për implikimet gjeopolitike në nivel vendor, rajonal dhe ndërkombëtar. Përveç rolit shkencor, botimi ka edhe një rëndësi praktike, sepse shqyrtimi i problematikës komplekse mbi bazën e argumenteve shkencore i ofron faktorit politik shqiptar, vendor dhe më gjerë, autoriteteve të Kosovës dhe të Shqipërisë, që të kërkojnë dhe të insistojnë në të drejtën e Luginës së Preshevës për subjektivitet politik në vehte. Në anën tjetër, studimi me rezultatet që ofron shërben si bazë solide për planifikimin hapësinor, rajonal dhe shoqëror dhe për përpilimin e strategjive dhe politikave zhvillimore ekonomike e më gjerë.

Në sajë të punës intensive disavjeçare shkencore-hulumtuese të autorit pa dyshim se në këtë publikim janë arritur rezultate origjinale, shkencërisht të qëndrueshme, që gjithsesi do të hapin perspektiva për brezat e rinj studiuesish për të ndërmarrë në të ardhmen hulumtime edhe më të gjera. Për nga rezultatet e arritura dhe qasja metodologjike e problematikës së studiuar, ky botim i përket studimeve të tipit bashkëkohor në gjeoshkenca dhe më gjerë dhe si i tillë do të kontribuojë edhe në zgjerimin e dijeve në gjithë fushat e gjeoshkencave dhe disiplinave të afërta të saj. Si studim kompleks gjeohapësinor, me karakter shumëdisiplinar, me të dhënat dhe faktet që sjell dhe konkluzionet shkencore që përmban, ai pa dyshim do të shërbejë si burim informacioni dhe reference për jetën dhe problemet në tërë kompleksitetin e tyre dhe, sot dhe nesër në Luginën e Preshevës. Për të gjithë ata që interesohen për këtë territor dhe për atë popullatë, çfarë janë studiuesit, bota akademike, qeverisja komunale, faktori politik dhe institucionet shoqërore, planerët, organizatat e ndryshme joqeveritare, investitorët, vizitorët etj., ky botim është alfa dhe omega, pra i mirëseardhur dhe i mirëpritur për bibliotekat e çdo familjeje shqiptare dhe për secilin hulumtues e lexues shqiptar të kësaj krahine dhe më gjerë.

Hivzi Islami

Rexhep Qosja, **MORFOLOGJIA E NJË FUSHATE**, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1980, fq. 345.

TESTIMONIUM PAPUPERTATIS I R. QOSJES*

Në njërin nga sesionet që organizonte Instituti Albanologjik para pak vitesh, fjalën e vet të hyrjes R. Qosja e përfundonte duke cituar një autor, me një frazë që atij i dukej se do të bënte efekt dhe do të tingëllonte si jokonvenciale (jodogmatike, mendon ai): “Po historia?, zotërinj, do të gënjejë si gjithmonë!” “Me konsiderata të këtilla ndaj historisë, u ngut t’i dorëzojë asaj (këtë radhë shkencës historike të letërsisë) edhe një dokument, MORFOLOGJINË, e cila, si thotë vetë, është “patologji e një mentaliteti”, pasojat e të cilit është duke i vuajtur akoma.

Pamfleti u botua dhe u shit shpejt dhe u lexua “me ëndje”, si e parashihte autori. As që mund të ishte ndryshe veçanërisht kur dihet se që në parathënie paralajmërohej përshkrimi i një meçi a ndeshjeje shumëvjeçare, madje të një proporcioni të paparë: një me pesë! Parajalmërimi tjetër, që në parathënie, se autori e kishte shkruar librin zgërdhishëm, do të thotë “me buzë në gaz”, shtonte doemos kureshtjen dhe interesimin.

Proporcionet në arenë ndryshonin. Kundërshtarët herë ishin pesë, herë bëheshin pesë a gjashtë, herë dilnin shumë më tepër. Por, kjo s’mund të ndryshonte gjë në thelb. Ata do të humbnin. Populli e thotë dhe R.Q. e di dhe e citon: “siç do të thoshte populli, disa ulokë e të sëmure një të shëndoshë e bëjnë urë”! Por populli e thotë dhe e thotë kot! Sepse këtu nuk ngjet ashtu. Ose nuk ishte i shëndoshë, i shëndoshi ynë, ose për ndonjë arsye tjetër, por nuk ngjau si thotë populli. Përkundrazi, kundërshtarët ishin të dështuar që më parë, kurse numri i tyre, sa më i madh të ishte, vetëm do ta shtonte famën e Të Vetmit! Ky, madje, ka aq fuqi sa as nuk shikon vetëm t’i godasë kundërshtarët, por duke qitur shqelma në të katër anët, dëshmon se mund të terrorizojë këdo dhe të gjithë menjëherë.

* Ky vështrim (në përkthim “Turpi i varfërisë”), është botuar në gazetën e përditshme “Rilindja” të Prishtinës, në dy vazhdime, më 24 maj 1980 dhe më 7 qershor 1980. Ne e marrim pa asnjë ndryshim nga vëllimi 8 i veprave (*Intervista, reagime*) të Fehmi Aganit, publikim i shtëpisë botuese “Dukagjini”, Pejë, 2002, fq. 331-374.

Kundërshtarët vërtet janë të vegjël, të dobët, “pa kulturë letrare, artistike, teorike, metodologjike, e të mos flasim për kulturën e tyre estetike dhe filozofike”! (Ndokush mund të mendojë se është më mirë “të mos flasim” se sa në këtë mënyrë kontradiktore e të pakuptim!). Kundërshtarët janë diletantë, antitalentë ose, të shumtën, gjysmëtalentë. Ata “përziejnë ide, kritere, koncepte, shije” në veprat e tyre “të paqena”, “duke mos e njohur kurrë dhe kurrkund idenë e totalitetit”! (fq. 316). Edhe kur shkruajnë kritika, kritika e tyre është “ekzemplar tipik i kritikës dogmatike analfabetike”. Kritikës së tyre “i mungon dinjiteti elementar i kritikës letrare: ajo është kritikë e poetikë, sepse është kritikë e paestetikë”! Kjo kritikë “në të vërtetë” nuk është kritikë. Ajo është “ose hermeneutikë diskreditimi, ose hermeneutikë reklame”! (fq. 316). Të gJORËT, d.m.th. kundërshtarët e imagjinuar, të kredhur në provincializëm nuk do t’i njohin kurrë “idetë universale, jetike dhe vizionet e gjera, planetare”! (fq.317).

Vogëlsia e kundërshtarëve të supozuar e komprometon nevojën e një lufte të madhe kundër tyre, e bën të pakuptimtë të shkruhet për ta një libër i tërë, madje nga R.Q. Por, jo, imagjinatës së sëmurë i nevojiten pikërisht kundërshtarë të këtillë, objekte të manipulimit, për të krijuar dhe për të forcuar kontrastin me madhështinë e Të Vetmit. Vogëlsia si kontrast i madhështisë, “varfëria provinciale” si kontrast i “ideve universale”, i “vizioneve të gjera, planetare” të R. Qosjes.

Vërtet mund të thuhet, madje me të drejtë, se madhështia që e ndien kaq shumë nevojën për kontrastin, që e mbështet thuaja ekzistencën e vet në këtë kontrast të projektuar, duket si të mos kishte bazë në veten e saj. Por, pamfleti as nuk është shkruar për ata që fort të mendojnë. Ndryshe, si mund të ishte aq konfuz e kontradiktor, sa njëra faqe nuk e di ç’thotë faqja që i paraprin!

Qëllimi i autorit të pamfletit është kompleks. Në qoftë se **Iluzionet**, që do të priten si “bombë intelektuale”(!), nuk arritën të mbërthejnë për një kohë të gjatë vëmendjen e opinionit për R.Q., në qoftë se **Anatomia** me pretendimin absurd që të jetë shprehje e vetëdijes së kulturës sonë për “domosdonë e vetëdijes së vet, të kritikës dhe të teorisë”, kaloi pa zgjuar fort interesim dhe pa lënë fare gjurmë; në qoftë se, më në fund, në këto kohë orientimesh dhe interesimesh të diversifikuara dhe të afrimeve të vlerave dhe të krijuesve të ndryshëm ekziston droja të bjerë në harresë fare R.Q., atëherë pamfleti i titulluar **Morfologjia**, qoftë edhe në mënyrë skandaloze, duhet të tërheqë vëmendjen kah R.Q. dhe të konfirmojë prezencën qendrore të tij në jetën tonë kulturore!

Qëllimi i autorit është që, njëkohësisht, të zhdukë (pikërisht: të zhdukë!) kundërshtarët e supozuar, ata që nuk pajtohen, mendojnë ndryshe ose kanë qëndrim negativ ndaj vlerës së aspekteve të ndryshme të veprimtarive, të sjelljeve dhe të krijimtarisë së tij. Për këtë qëllim, kritika që, për nga vokacioni do të duhej të ishte para së gjithash humaniste, me pasion psikopatik bën “obduksione”, përpiket të masakrojë, nuk heziton as nga trillimi dhe shpifja. Dhe, ndërsa kujton se i njollosoi për turp kundërshtarët e supozuar, e pikturon në të vërtetë me ngjyrat më të zeza dhe në mënyrë të neveritshme qenien e vet morale dhe intelektuale.

Por qëllimi kryesor i pamfletit është të konstitujë R.Qosjen si vlerën kryesore, krijuesin e vërtetë, si “ndërgjegjen e kohës” sonë (!). Ky qëllim përshkon edhe shumë vepra të tjera të R. Qosjes, gati të gjitha veprat e tij, por është leitmotivi i **Iluzioneve**, i **Anatomisë**. Dhe, definitivisht do të duhej të arrihej ky qëllim me “jehonën bombatomike” të **Morfologjisë**. Kujt i duket ky pohim i nxituar, i pabazë, le të lexojë fq. 307: “Duke ndjekur krijuesin, klani objektivisht bëhet denimi...që një shtresë, një mentalitet, një mjedis apo, më në fund, një kohë i shqiptojnë përmes klanit ndërgjegjes së asaj kohe” (!). (Ç’barbare kjo koha jonë, që përmes klanit i bën dënimin, linçimin, i thotë më parë, “ndërgjegjes së kohës”, “krijuesit të vërtetë”, si do të thotë pak rreshta më poshtë R.Q.!).

Sado të jenë skandaloze këto pretendime dhe vetëlavdime, prapë, mund të thuhet se nuk janë të paktë ata që pak a shumë mund të kenë iluzione për veten e tyre, për mundësitë, rezultatet, misionin dhe funksionin e vet. Bile, këto iluzione herë-herë mund të jenë edhe inspirim dhe nxitje për punë krijuese. Më në fund, askujt s’mund t’i ndalohet të ketë iluzione për veten e vet. Por, s’mund të tolerohet, për shkak të pasojave të rënda kulturore dhe shoqërore, brutaliteti me të cilin R. Qosja përpiket t’ia imponojë opinionit, të përligjë e të zyrtarizojë këto iluzione të madhështisë së tij, s’mund të lejohen skandalizimet kur këto iluzione dhe pretendime të tij nuk pranohen, s’mund të mos shihet dëmi kulturor i pseudoproblemeve që po i imponon për këtë shkak R. Qosja që sa vite. Pikërisht këtu qëndron arsyeja kryesore pse shkruaj këtë vështrim për **Morfologjinë**, përkundër sugjerimeve dhe këshillave të shumë shokëve dhe miqve se **Morfologjia** s’është e denjë për përgjigje.

Projeksioni paranoik i fushatës, i linçit, i klanit, trillimi, insinuata, sofizmi, gjysmë të vërtetat e gënjeshttrat si dhe A. Vinca e S. Fetiu – këto janë mjetet e përdorura. Argumentimi është ekskluzivisht

argumentum ad hominem madje i një trajte të vrazhdë, abuzive, sulm kundër individëve, njollosje e tyre. Botimi i pamfletit është një akt i rëndë shpërdorimi të emrit të Institutit Albanologjik dhe të pozitës së drejtorit të Institutit.

Përsëritjet dhe tërë pamfleti prej 342 faqesh duket si një përsëritje – janë stoli e veçantë e **Morfologjisë**. Në shenjë kujdesi ndaj memories së lexuesve apo për të identifikuar përkatësinë e vet në kategoritë e mbërtypësve e të rimbërtypësve, sepse edhe me këtë çështje merret universalisti ynë, R. Qosja mbërtyp dhe mbërtyp sistematikisht e pandërprerë. Dhe, në këtë punë është metodik. Edhe nga tri-katër herë përsërit të njëjtën sharje në një faqe, nuk mungon të kërkojë mbi 27 herë të ndërrohen redaktorët dhe redaksitë e gazetave dhe të botimeve, që nuk i ka për huj, kërkesë kjo e denjë për demokartin e deklaruar.

Një “kontribut” i veçantë i R. Qosjes dhe i pamfletit të tij duhet të theksohet veçmas: Është përpjekje për të sjellë dhe legalizuar në kulturën tonë skandalizimin, brutalitetin, degjenerimin dhe perversitetin – segmente të “begatisë shpirtërore” të akademikut tonë të mendermethënshtëm, që ka “pasur mjaft kohë të mendojë” dhe që ka shkruar “as i befasuar, as i provokuar”, madje “mbas gjashtë vitesh të mendimeve a të shkruaj apo jo” (fq. 14).

S’dua të them se **Morfologjia** s’ka fare segmente të “suksesshme”, madje të “lezeçme”. Cilit lexues mund t’i ketë shpëtuar vargu i denjë për pjekurinë e një akademiku, për shijen e një estetiku dhe moralisti, për veshin e një R. Qosje: “Hokuspokus, rrgadungus, fukarallukus, moralopusus”! Njeriut i vjen keq vetëm që këtë perlë e gjen dikund thellë, në gjysmën e dytë të librit, kurse, po të ishte në fillim, do të mund ta përsëriste dhe ta shënonte në marginë të çdo faqeje.

Morfologjia e nxori në dritë të plotë një iluzion të kahershëm të R. Qosjes, iluzionin se kritiku, d.m.th. R. Q., vlerëson, kualifikon dhe diskualifikon, portreton apo kritikon të tjerët dhe është kjo privilegj dhe monopol i profesionit të tij. Është e çuditshme se çdo akt njohjeje shpreh natyrën e objektit që njihet, por edhe të subjektivit njohës, se kritika, vlerësimi, kualifikimi ose diskualifikimi i një veprë ose autori, në masë të njëjtë vlerëson, kualifikon ose diskualifikon edhe kritikun dhe vlerësuesin dhe se subjektivizmi, arbitrariteti, kaprici në të gjykuar dhe vlerësuar vetëm e diskualifikon kritikun vetë.

Pamfleti ndriçoi fuqishëm dobësitë karakteristike të shkrimtarëve të R.Q., projektimin e dobësive të veta te të tjerët (aq sa në Morfologji,

në çdo dobësi që u atribuohet të tjerëve, shihet dobësia e R. Qosjes vetë), inekuencën dhe palogjikësinë në të konkluduar, konfuzionin dhe mbizotërimin e epsheve, të subjektivizmit, të kapricit dhe të tekave në të gjykuar për të tjerët, diskrepancën në mes të pretendimeve e të fjalës dhe pozës, nga një anë, dhe mundësive e të qëndrimit dhe sjelljes faktike, në anën tjetër, mosnjohjen e shpeshtë të domethënies dhe të peshës së fjalëve dhe të pohimeve.

Se në ç'botë halucinante jeton R. Q. shihet më së miri në kaptinën e fundit të **Morfologjisë**, ku me një obsesion psikopat parashihet me “probabilitet të qindpërqindtë” (!) “jehona bombatomike” e pamfletit dhe përshkruhet gjendja katastrofale që do t'u shkaktojë ai personave që sulmohen. Po ta dinin ata, vazhdon halucionanti ynë, se një vepër e këtillë është shkruar dhe do të botohet “pavarësisht prej jehonës bombatomike që do të ketë”(?) do të ndërmerrnin “ç'mos që ta nxjerrnin prej shtypit” (fq.326-327). Ç'kotësi? Shumë vetë kanë ditur për këtë pamflet, e edhe ata kundër të cilëve u drejtua, madje me muaj para se të dorëzohej në shtyp. Sepse, s'mund të mbetet sekret teksti që shetit dorë më dorë, në Prishtinë e jashtë saj, për të gjetur recensentë e botues. Dhe, Morfologjisë iu desh të kërkojë bukur gjatë recensentët trimosha. Çka ndërmorën ndërkohë kundërshtarët e supozuar? Asgjë! Sepse, ajo që do të dëshironin, ajo që do të ndërmerrnin, së paku disa prej tyre, t'i thoshin R. Qosjes: Pse do të turpërosh veten në këtë mënyrë? – nuk mund të dëgjohet nga veshët ku kishte filluar të ushtojë “jehona bombatomike” e pamfletit. Po ç'mbetet nga “probabiliteti i qindpërqindtë”. Ai mbetet budallallëk, si ishte.

Përkundër vëllimit prej 342 faqeve të **Morfologjisë**, nuk mund të thuhet se iu lehtësua fort puna “historianit të ardhshëm të letërsisë”. Atij, si edhe bashkëkohësit tonë të painformuar i mbeten vërtet shumë enigma ose pohime që duan sqarim. Para së gjithash lidhur me kohën tonë. Çfarë kohe dhe çfarë marrëdhënie klanesh, linçesh qenkan këto, kur i ndjekuri, i persekutuari, i linçuari zgjedhet, rizgjedhet dhe përsëri rizgjedhet drejtor i një institucioni shumë të rëndësishëm shkencor e kulturor, madje edhe përkundër qëndrimeve shoqërore të formuluar qartë mbi udhëheqjen kolektive, mbi ndërrimin e personave në funksionet udhëheqëse si komponentë esenciale e kësaj udhëheqjeje kolektive, mbi nevojën që askush të mos zërë krimba në poste udhëheqëse e funksione drejtorësh? Çfarë monopoli paskan kundërshtarët e tij të supozuar, qofshin pesë apo pesa-gjashtë, kur I Vetmi ka më shumë funksione udhëheqëse e punkte të pushtetit se sa ata të gjithë së bashku, madje edhe si sasi e edhe si cilësi? Dhe, në të

njëjtën kohë, përkundër “monopolizimeve”, për të cilat ai e alarmon opinionin, boton dhe riboton çdo vit nga një libër, madje boton edhe trivialitete si **Morfologjia**? Mbeten edhe shumë enigma, edhe shumë pohime që kërkojnë sqarime plotësuese. E lexuesi i sotëm i pamfletit të quajtur **Morfologji** s’mund të mos ndalet e të mos mendojë për shkakun, motivacionin, qëllimin e vërtetë si dhe për çështjen se kujt i drejtohet, cili është adresimi i lamentacionit të R. Qosjes mbi gjoja ndjekjet politike dhe nacionale që po iu bëkan, ankesë kjo që nga karakteri dhe natyra e vet, për nga implikacionet e saj, për nga theksimi që i bëhet në tërë librin, është në shpërpjesëtim flagrant me argumentimin e mjerë që i bëhet. Dhe s’mund të mos mendojë për hipokrizinë e një metode të konstruksionit dhe trillimit të grupeve e të klaneve, që do t’i mundësonte R. Qosjes që dobësitë eventuale, që i duket t’i ketë gjetur te ndonjëri nga kundërshtarët e supozuar, t’i shumëfishojë, t’i multiplikojë dhe në një mënyrë amorale e të papërgjegjësi t’i shtrijë te të gjithë.

Edhe një pyetje duhet të shtrohet që në fillim: R. Qosja, që me aq pedantizëm e paska përcjellë “fushatën” dhe çdo gjë që shkruhet për të, që madje e periodizon, e ndan në faza, ia përcakton baticat e zbaticat “fushatës” dhe, natyrisht, si çdo egocentrist i kompleksuar i lidh këto “me ngjarje të caktuara në punën time krijuese dhe sidomos organizative në jetën shkencore dhe letrare” (fq. 22). R. Qosja që i paraqet të tjerët sikur jetojnë me ritmet e avancimeve dhe të zgjedhjeve të tij jo drejtor i Institutit Albanologjik, jo kryeredaktor i “Jetës së re”, në Akademi etj. a di të mendojë fare dhe me kategori të tjera, përveç kategorive të suksesit dhe famës personale, të avancimit dhe zgjedhjes e rizgjedhjes, të lirisë që të shkruajë “ashtu siç dëshiroi” dhe të kërcënimit se në të kundërtën do të mendojë “se shpresa, gëzimi, lumturia ime e qershorit të vitit 1966 kishin qenë të kota”(!) (fq.296)? A di të mendojë edhe për pasojat shoqërore dhe kulturore të grindjeve, konfrontimeve dhe përçarjeve që i rifillon “ai as i befusuar, as i provokuar”, për kohën kur i nxit dhe për çështjet se cila do të ishte dobia dhe kush do të mund të përfitonte objektivisht nga këto?

Autori R. Qosja mund të kujtojë të ketë shkruar me jehonë bombatomike, por në të vërtetë na dha një pamflet që është *testimonium paupertatis*, një dëshmi e varfërisë, madje e mjerimit intelektual dhe njerëzor.

KONSIDERIMET ABSURDE DHE KATARZA E MJERË

Për një vështrim të plotë për **Morfologjinë** do të nevojitej një libër i tërë. Jo për problemet që shtron ajo. Sepse, vërtet, po të përjashtohen ekzagjerimet, komplekset e R. Q., trillimet dhe sharjet e bollshme, s'mbetet thuaja gjë tjetër prej saj. Por mbetet të kontestohet gati çdo pohim, të ndriçohen premisat false dhe konkluzionet e gabueshme, të përcaktohen gjysmë të vërtetat dhe të pavërtetat, insinuatat dhe paraqitjet e vlerësimit e rreme me të cilat u mbush një libër.

Në tërë Morfologjinë R. Qosja portreton veten, madje në dy trajta: ashtu si do të donte të shihej dhe si do të donte të shihen kundërshtarët e supozuar. Pretendimet e tij janë të mëdha e komplekse, para së gjithash intelektuale dhe morale. Të analizojmë cilat janë dhe si duken, sa janë me bazë e të qëndrueshme këto pretendime, të shprehura në vështrimet hyrëse të **Morfologjisë**, pra në faqet ku R. Q. merr pozë e kapardiset me tërë madhështinë. Madje, pikërisht ashtu si do të donte të dukej e të shihej prej të tjerëve. Të analizojmë, po themi, e jo të odbuksionojmë, si do të thoshte R. Qosja. Sepse obduksioni, me rrënjë të thella në indin e psiqikës së R. Q. dhe, në pastë gjë të vërtetë në mendimet e Frojdit, si shprehje e instinktit të destruksionit, dëshmon një mendje të errësuar dhe të pushtuar prej pasionesh të errëta dhe, prandaj, sado të kënaqë komplekse e dëshira të marra, nuk arrin të kuptojë mendimin gjithmonë të gjallë e subtilitetin mendor.

Morfologjia fillon me dy prologë e një hyrje. Prologu i parë fton në ndihmë Apologjinë e Sokratit, për t'i dhënë peshë çështjes dhe protagonistit kryesor, në këtë rast autorit të pamfletit, dhe shfrytëzon një letër të Pietro Aretinos për t'i karakterizuar kundërshtarët e supozuar si të gjorë, për t'iu atribuar zilinë dhe për të paralajmëruar që në faqen e parë famën e autorit: "Unë bëhem i famshëm kur të gjithë ata më smirojnë"!

Prologu i dytë është një – "A e dini kush jam"? Në dy faqe shënon R. Q. të dhënat biografiko-bibliografike dhe besimin e tij intelektual e moral, që, ndonëse do të duhej të supozohej se do të dihen nga të interesuarit, ia përsërit edhe një herë lexuesit. Përmenden datëlindja e prindërit, shënohet shkollimi i autorit deri në diplomim në Fakultetin Filozofik në Prishtinë, dhe shtohet: "Ka vijuar (d.m.th. ai, R.Q.) studimet pasuniversitare në Beograd"! Që në faqet e para fillojnë gjysmë të vërtetat. Sepse, këtu, me të njëjtën të drejtë do të

mund të thuhej: “Nuk i ka vijuar studimet pasuniversitare në Beograd”! Si dihet, pas dy-tri provimeve të vitit të parë të studimeve të shkallës së tretë, i pakënaqur fort me rezultatin që kishte arritur, kur erdh te provimi nga gjuha e huaj, vendosi t’i ndërprejë studimet e të kërkojë rrugë tjetër për të paraqitur tezën e doktoratës. A nuk e dinte atëherë këtë **porca miseria**, që me kaq sharm akademik e përdor tani, apo nuk mjaftonte një sharje, qoftë edhe e përsëritur disa herë apo, më në fund, në provim nuk kërkoheshin fare sharjet, por kërkohej njohuri gjuhësore – këtë nuk e di. E di vetëm që R.Q. pat thënë në Institut, se dëshiron t’i ndërprejë studimet sepse një bashkëpunëtor i Institutit (gjoja) po intrigon, po flet me arsimtarët në Beograd që ta rrëzojë në provime R.Q.! (U ndala te ky moment trivial për të përmendur vetëm se edhe insinuatat, edhe frika se dikush punon vazhdimisht kundër tij, nuk janë të reja për R. Qosjen).

Numërohen në vazhdim veprat dhe funksionet e R.Q., shënohet se jeton në Prishtinë dhe shtohet plot mburrje: “Kurrë s’ka qenë i gjykuar, kurrë s’ka qenë dëshmitar në gjyq” (!). Ky pohim, sipas autorit, do të duhej të dëshmonte pastërtinë absolute. Por, ç’kotësi! Gjithkush e di se burgosja, që mund të jetë ndëshkim fizik e fatkeqësi personale, nuk e cenon fare integritetin moral të individit. Diskualifikues mund të jetë shkak i burgosjes, qëndrimi në burg, por jo vetë burgosja. Të mos përmendim revolucionarët, që e kaluan jetën në burg, se R.Q. mund të na akuzojë se po e sulmojmë politikisht, por si do të ndihej Sartri i ndjerë, që aq shpesh merrej në polici, pranë këtij puritanizmi qos, të shpërlarë!

Vijojnë edhe shtatë besimet, konsideratat e autorit, që do të duhej të shprehnin në mënyrë të konsiderueshme, bindjet intelektuale e morale të tij. Por ç’fatkeqësi! Këto qëndrime përkundër shpresës së autorit, dëshmojnë një nivel përgatitjeje teorike dhe aftësi intelektuale që nuk ofron bazë për pretendime të mëdha. T’i analizojmë. Së pari, përcaktimi i artit si “komunikim estetik i individit me njerëzit e tjerë përmes formave të krijuara që flasin për jetën me gjuhën e tyre specifike dhe që jetën në vete e kanë” (fq.8), s’përmban asgjë të re, specifike, në mos qoftë e këtillë gjymtia, papreciziteti si dhe fakti që si definicion, nëse ka pretendime të këtilla, është shembull shkollor i një definimi të dobët, i një definicioni që s’thotë gjë. Përafrsisht, po kjo mund të thuhet edhe për përcaktimin që i bëhet kritikës, si “aktivitet intelektual, që ka për detyrë të tregojë se si, në ç’mënyrë, ekziston estetikisht vepra dhe çka ekziston në atë vepër”.

Duke folur për veten e vet në veten e tretë, R.Q. e vazhdon me një pohim paradoksal, që dëshmon vërtet një nivel të ulët të rezonimit logjik. Ai, pra R.Q., konsideron se “pluralizmi i stileve artistike dhe i metodave kritike, është kusht (!) i lirisë së krijimtarisë” (fq. 8). Pa pasur nevojë fare të ekzagjerojmë, në stilin e R.Q.: “shihni, ju lutem, lexojeni edhe njëherë”, është e qartë se ky pohim dhe kjo bindje është e pakuptim, sepse kusht i lirisë së krijimtarisë nuk mund të jetë pluralizmi i stileve artistike dhe i metodave kritike, liria e krijimtarisë kushtëzohet nga faktorë të tjerë shoqërororë, kurse pluralizmi i përmendur i stileve dhe metodave kritike më së shumti mund të jetë rezultat ose shprehje e lirisë së krijimtarisë. Bindja vijuese e R.Q. është ilustrim i mirë i fjalamanisë boshe dhe i zbrazëtisë mendore: “Reduktimi i krijimtarisë artistike në një stil dhe i kritikës së saj në një aspekt vrojtimi sjell reduksionizmin (!) domethënë dëmton (!) krijimtarinë artistike dhe kritikën e saj” (fq. 8). Si shihet, kjo tezë apo bindje, ky konsiderim, përsërit të përpërmirë mbi pluralizmin dhe lirinë e krijimtarisë. Por, ç’kuptim ka përsëritja kur në shtatë pasuse, në një gjysmë faqe do t’i paraqesësh bindjet tua intelektuale e morale? Mandej, shihe se sa trivial është vetë mendimi: reduktimi sjell reduksionizmin, ky varfëron e varfërimi dëmton krijimtarinë! Dhe, me pohime të këtilla boshe të ngrihet pretendimi mbi “krijuesin e vërtetë” dhe “ndërgjegjen e kohës”?!

Pohimi vijues është edhe më katastrofal. “Vlera e stileve artistike apo e metodave kritike varet jo prej cilësisë së tyre, por prej prirjes së krijuesit” (!). Po, pikërisht kështu thuhet. Pohohet shprehimisht se stilet dhe metodat s’kanë cilësi apo cilësitë e tyre s’kanë vlerë, që do të thotë se stilet artistike dhe metodat kritike të pacilësi apo me cilësi të pavlerë s’janë gjë fare, sepse vlera e stileve artistike apo e metodave kritike nuk varet prej cilësisë së tyre! Çfarë serioziteti dhe rigoroziteti shkencor mund të pritët nga kritika dhe shkencëtari me konsiderime kaq absurde?

Dy pohimet e fundit janë margaritarë të vërtetë të këtij konfuzioni. Ai, d.m.th. R. Q., tani jo më që konsideron, sepse konsiderimet i shterri, por: “është i bindur se: me veprën dhe me jetën mohon çdo formë dogmatizmit; rrjedhimisht: për lirinë, të drejtën dhe të vërtetën lë kokën” (!).

Ai që do të priste një përcaktim të dogmatizmit dhe të formave të tij, që i mohuaka R.Q. me veprën dhe jetën e vet, - sepse dogmatiku sigurisht edhe dogmatizmin e përcakton në mënyrë origjinale (!) – që të mund t’i krahasojë me veprën dhe jetën e autorit, pret kot. Këtu

antidogmatizmi postulohej ose është çështje e bindjes së R. Q. për veten dhe prandaj s'është për diskutim. Pranë kësaj bindjeje të R. Q. zbehet, natyrisht, mendimi i Marksit se “nuk mund të gjykohej për një njeri nga ajo që mendon ai vetë për veten e vet”. Edhe pohimi tjetër për gatishmërinë e R.Q. që të lërë kokën për lirinë, të drejtën dhe të vërtetën, është pohim që duhet ta besojmë dhe s'është çështje e argumentimit. S'ka si të argumentohet, sepse, me sa dihet, deri më tash protagonistin ynë s'e ka lënë ndonjëherë kokën, që do të thotë se ose nuk ka pasur rast ose nuk e ka konsideruar rastin të denjë për kokën e tij. Ndërkohë, si do të shohim, kjo gatishmëri e flijimit të kokës, e lënies së kokës, si do të thoshte ai vetë për të vërtetën, nuk e pengojnë të manipulojë me gjysmë të vërteta ose të gënjejë troç. Objekt diskutimi për ne është mënyra jonormale e lidhjes së këtyre pohimeve, është fjala rrjedhimisht, që do të duhej të shprehte një raport në mes të shkakut dhe efektit, ose në mes të kushteve e të pasojave, në mes të *antecedens* dhe *consequens*. Si mund të ketë këtu raport të tillë?! R. Q. pohon se është antidogmat, dhe rrjedhimisht është gati të lërë kokën! Por, jo, jo, *non sequitur*, çfarë rrjedhimisht?! Dogmatizmi dhe antidogmatizmi dhe gatishmëria apo jo për të lënë kokën janë kategori të ndryshme, s'mund të jenë në lidhje shkakore pa pasur dogmatë të gatshëm të flijohen si antidogmatë që e kanë ruajtur kokën, ose kanë qenë gati vetëm për flijime deklarative. Në fund, - dhe fundi stolis veprën – konkluzë më absurde:

“Mjafton që të bëjnë objekt fushate”! (E shkruar me germa të mëdha). Çka menduaka ai se mjafton që të bëjnë objekt fushate? Të kesh një mendim për artin e kritikën, për pluralizmin e stileve dhe reduksionizmin, për vlerën e stileve dhe dogmatizmin dhe të jesh gati të lësh kokën! Madje edhe kur konsiderimet për artin e kritikën të jenë të çala, kur raporti i pluralizmit të stileve e metodave të krijimtarisë të jetë i pakuptim, kur pohimi për reduktimin e reduksionizmin të jetë një circulus, kur përcaktimi i vlerës së stileve dhe metodave të jetë absurd e kur antidogmatizmi e gatishmëria për t'u flijuar të jenë deklarative! Tepër bile edhe për R. Qosjen!

Parafjala – një lamentacion, një vajtim dhe një arsyetim i mjerë i botimit të pamfletit. Nis me ankesën se është bërë objekt i një fushate që nga viti 1974 e edhe më parë (1972), thotë se në fillim s'ia ka vënë veshin, ndonëse me pedantizëm ka mbledhur çdo dromcë që ka të bëjë me të, dhe vazhdon me konstatimin e raportit 5:1, që “është një përpjesëtim që vetvetiu është në kundërshtim me normat e kulturës” (!) Akademiku në këtë rast nuk arrin të na thotë cilat përpjesëtime nuk

janë sipas normave të kulturës (!) apo cilat përpjesëtime nuk janë vetvetiu në kundërshtim me normat e kulturës, sepse nxiton të akuzojë gazetatat dhe revistat se janë bërë “poligone të këtij aktiviteti”, d.m.th. të fushatës. Pasi jep “shikimin sinoptik” të pjesëmarrësve të fushatës dhe konstaton heterogjenitetin e tyre si dhe faktin që ata kanë të përbashkët vetëm vendosmërinë që ta ndjekin atë, numëron arsyet pse po iu përgjigjet. Thotë R. Q. se ka vendosur të shkruajë sepse fushata “kohët e fundit sikur është bërë institucion legal në jetën tonë kulturore” (!) dhe përpjekjet për ta diskredituar atë “kanë ardhur duke u intensifikuar dhe duke u zgjeruar” (!) (fq.11).

Ç’do të thotë “kohët e fundit” për R. Q. mbetet e paqartë për lexuesin, sepse autori nuk e përcakton këtë, kurse artikulli i fundit, që “obduksionohet” është i para dy vitesh! Mandej vijnë arsyet më vendimtare. Thotë se ka vendosur të shkruajë për të treguar se lirinë e krijimtarisë nuk e cenon vetëm pushtetet, sistemet politike e organet e tyre, por edhe grupet e interesit, klanet e klikat. Me këtë rast, integralisti ynë, që u thotë kundërshtarëve të supozuar se s’do të njohin kurrë idenë e totalitetit (!) dhe antidogmati i deklaruar, grupet e interesit, klanet dhe klikat dhe mundësinë e veprimit të tyre, aq sa të cenon në mënyrë alarmante lirinë e krijimtarisë i sheh të ndara, të palidhura me shoqërinë e marrëdhëniet shoqërore. Ku është këtu konsekuenca shkencore? Për atë që ka njohuri, qoftë edhe modeste, nga teoria shoqërore e marksizmit është e ditur se s’mund të ketë grupe të interesave, klane e klika (të mos flasim për linçe!) që të monopolizojnë shtypin e veprimtarinë botuese, që me veprimin e vet të cenon në mënyrë alarmante lirinë e krijimtarisë e të mos jetë kjo shprehje e marrëdhënieve të caktuara shoqërore ose të paktën deformim i tyre. Por, R. Q. nuk do të nxjerrë konkluzatë tilla. Ai thotë se janë të dhëna pasojat, por jo edhe shkaqet ose kushtet, faktorët që i shkaktojnë. Pse, po a nuk deklaroi se është gati për të vërtetën të lërë kokën? Po deklaroi, por edhe të deklarojë, edhe t’i përmbahet deklaratës i duket shumë. Madje, jo vetëm për të ruajtur kokën, që në shoqërinë tonë nuk ia cenon kush, por R. Q. i ruan me shumë kujdes dhe s’do t’i rrezikojë privilegjet e shumta që i ka, as mundësinë që të zgjidhet për të tretën herë drejtor i Institutit Albanologjik.

Arsyeve “më vendimtare” u shtohet nevoja që t’i lehtësohet puna “historianit të letërsisë”, të cilin e mendon si person që do të merret kryesisht me të. Dhe, arsyeja kryesore “më vendimtare”: katarza nacionale (!) (fq. 16). Kështu rrumbullakësohet argumenti për R.Q. si “ndërgjegjen e kohës” sonë! Kultura jonë u vetëdijësua në

Anatominë, kurse kombi ynë do të përjetojë katarzën, spastrimin, këtë moral kombëtar, në **Morfologjinë**! Kurse lexuesit të **Anatomisë së kulturës** dhe të pamfletit të quajtur **Morfologji** s'i mbetet veçse të mjerorë nivelin intelektual e moral të këtij vetëdijësimi të kulturës e të kësaj katarze morale kombëtare.

Pasi shton se “beson në mënyrën elokuyente” (!) se do të arrihet qëllimi, R. Q. nis të arsyetojë titullin e pamfletit. Mund të quhej kështu apo ashtu, shkruan ai, thuaja se titulli s'ka të bëjë me përmbajtjen. “Mund ta quaja **“Morfologjia e jetës letrare**, por, në fund kam vendosur ta quaj **Morfologjia e një fushate**, respektivisht **Patologjia e një fushate**” (fq. 15). E quajta **Morfologji** sepse është patologji (!) etj. Ç'është ky konfuzion, ç'është kjo renditje si tituj të mundshëm të shprehjeve që dallojnë në thelb, madje edhe si denotacione edhe si konotacione? Ec e dije, vërtet, a është kjo shaka apo seriozitet? Por, jo nuk është këtu vetëm konfuzioni karakteristik i R. Q., as kombinim i shakasë dhe i seriozitetit si dëshiron ta paraqesë punën ai. Përkundrazi, është këtu edhe ndërgjegjja e papastër, që shkakton këtë konfuzion. Sepse, në mbledhjen e Këshillit Shkencor të Institutit Albanologjik, në kuadër të planit botues për vitin 1980 ai e ka paraqitur për botim pamfletin si **Morfologji e jetës letrare** (titull pune). S'ka dyshim se në këtë mënyrë është gënjyer dhe mashtruar një organ profesional-vetëqeverisës, që është delikt i rëndë moral, politik e penal, shkelje e rëndë e normave të vetëqeverisjes. R. Qosja e di se këtë shkelje e ka bërë me qëllim, prandaj përpiqet t'i gjejë një arsyetim gënjeshtër dhe thotë se titulli mund të ishte **Morfologji e jetës letrare**, por ai e quajti **Morfologji e një fushate**, edhe pse secili lexues mund të shohë se këta dy tituj vërtet s'kanë asgjë të përbashkët.

Edhe dy momente do të përmendja nga parafjala. Së pari, mohimin kategorik të autorit se **Morfologjia** s'ka të bëjë me individët. Paradoksale duket, por R. Q., përkundër faktit se tërë pamfleti është një sulm kundër individëve, në parafjalë shkruan se teksti “nuk mund të konsiderohet polemikë me individët: jo, jo, jo!” Dhe, fill pas pikës harrohet mohimi i trefishtë, Së dyti, çështja e korrektesisë, e fer-plejit. “parimi moral, i quajtur fair play, është produkt i kulturës dhe respektin e tij ia kam borxh opinionit aq sa edhe vetëvetes” (!) (fq. 19). Natyrisht, edhe këtë e thotë për Ata që duan të besojnë fjalët, me naivitet, por as kjo deklaratë dhe ky borxh ndaj opinionit dhe vetes së tij nuk i pengon fare të veprojë ndryshe e të japë shembuj drastikë të pakorrektesisë dhe të mungesës së plotë të fair play-it, të këtij “parimi moral” dhe “produktit të kulturës”, si na mëson.

FIKSIONE PSIKOPATE RRETH “LINÇIT INTELEKTUAL”

Ekzagjerimi, stërmadhimi, predimensionimi i çdo gjëje që lidhet ose mund të lidhet në një ose tjetër mënyrë me personin ose punën e tij, aq sa humb çdo masë e përmasë e përpjesëtim real, është një ndër karakteristikat dalluese në shkrimet, qëndrimet e sjelljet e R. Qosjes, dhe zë vend të gjerë në pamfletin e fundit. Kjo duket e natyrshme, sepse çdo gjë lidhur me të duhet të jetë e nivelit, e rangut, e dimensioneve që t’u përgjigjet ideve universale, jetike, vizioneve të gjera, planetare, që t’i përgjigjet mendjes që noton në hapësira interplanetare, ilusioneve që ka ai për personin e vet, për veprën dhe rezultatet e veta. Prandaj, në qoftë se dikush në një mbrëmje diskutimi për kritikën merr qëndrim kritik ndaj disa qëndrimeve të tij, atëherë i tërë tubimi, e tërë mbrëmja s’është tjetër veçse një sulm, një atak, një linç, madje intelektual (!) i përmasave historike! Dhe ky linç do të ketë prapaskenë të thellë, sepse si do të mund të ndodhë të thotë kush mendim negativ për të, madje publikisht, e të mos jetë përgatitur, inskenuar, organizuar kjo nga të gjitha forcat e errëta të sotme e të së kaluarës! Po të ndodhë të botojë kush artikull ku do të shprehte rezerva ose qëndrime kritike ndaj ndonjë pikëpamjeje ose rezultati të tij, atëherë vetë botimi s’mund të mos jetë rezultat i një organizimi, i një agjiliteti të posaçëm qëllimkeq, të redaksisë apo të ndonjë anëtari të saj. Nëse botimi koincidon me ndonjë ngjarje historike ose me prezencën eventuale të mysafirëve të huaj në Krahinë, atëherë lidhur me ngjarjen, shihet i kurdisur dhe i lidhur me ngjarjen si një aferë, komplot, diskreditim, skandal me përmasa ndërkombëtare!

Në përshkrimin e rasteve të tilla, ai i lëshon fre imagjinatës, madje një imagjinate të sëmurë, që për pikënisje ka dyshimin, qëllimkeqësinë e supozuar të kritikut te të tjerët, ngatërron rolin e kritikut e të letrarit, për faktet flet imagjinativisht dhe është insinuativ, zgërdhishëm në të dyja rastet. E në fund, seriozisht (!) do të thotë: pak shaka, pak seriozisht!

Historisë së kulturës sonë do t’i shtojë këtë radhë R. Q. edhe një datë, edhe një ngjarje, por të shënuara me germa të zeza: 23 janarin (1976), mbrëmjen e linçit intelektual! Po, ç’është kjo?

Duke dashur të nxisë krijimtarinë dhe diskutimin kulturor, “Rilindja” pat organizuar një Tribunë, një diskutim publik për tema të ndryshme që mbahej kohëpaskohe në lokalet e Fakultetit Juridik.

Në mbrëmje u diskutua edhe për kritikën dhe disa diskutantë shprehën qëndrime kritike ndaj disa pikëpamjeve të R. Q. Të tjerët i

përkrahën mendimet e tij ose i zunë në gojë, sepse shqyrtuan çështje të tjera. Kjo ishte Tribuna e 23 janarit.

Por, si duket, si përshkruhet, si kualifikohet ajo në pamfletin e R. Q.? Ajo është mbrëmje krimi, madje e njërit ndër krimet më të mëdha në historinë e kulturës, “mbrëmja e linçit intelektual”. Ky “linç” u përgatit, u parapërgatit, u stërpërgatit, me të vetmin qëllim: të diskreditohet R. Q. “Në kronikën e fushatës... mbrëmja e 23 janarit të vitit 1976 do të shkruhet me germa të arta, të zjarra, ndriçuese, vizlluese” (!) (fq. 64). Po, kush e shënon, kush e shkruan këtë kronikë? Kuptohet, R. Q. vetë, sepse vetëm ai merret me trivialitete të këtilla.

Ky “linç” i 23 janarit (!), ky “akt barbar, vandalizëm”, ka edhe tipare të linçeve klasike “çfarë ishin për shembëll, linçi i robërve në arenat e luftës me shtazët... linçi i djegies në turrën e druve në mesjetë... linçet e varjes në sheshin e qytetit, në Perëndimin e egër” (fq. 67), por ka edhe karakteristika të linçeve moderne “sipas metodologjisë bashkëkohore të linçeve intelektuale” (!).

Për imagjinatën e ekzaltuar “linçi” i “23 janarit ka piedestalin – “një amfiteatër të Fakultetit Juridik të shtruar me tepihë ngjyrë të kuqe, që simbolizon përfundimin e heretikut”, ka kohën e caktuar – ishte zgjedhur ora 18 (ora 18 h (!), shkruan R. Q.) “domethënë një kohë e lirë, kur njerëzit nuk dinë ç’të bëjnë me veten dhe, për atë shkak shkojnë në vendet...ku mund të shprazin pasionet e tyre”, ka publikun e mysafirët e nderit, ka “shtabin e grupit (!) që organizonte fushatën” – lokalet e rubrikës kulturore të “Rilindjes”, e të tjera e të ngjashme!

Duke vazhduar të “shprazë pasionet” dhe për të dëshmuar erudicionin dhe kompetencën e vet në çështjet e linçit e të linçimit, në ekstazë, pa dashur të zbresë prej reve, R. Q. vazhdon: “Linçi i kësaj mbrëmjeje ishte një linç specifik, origjinal, i egër, i kurdisur dhe në stilin e linçeve misterioze, perfide të Aleksandar Borxhias, të pallateve të Vatikanit, të kështjellave dhe të dramave të Shekspirit, edhe në stilin e linçeve të Berias dhe të ekzileve të Siberisë” (!) (fq. 72). Ideisti ynë universal, jetik, vizionisti planetar edhe marrëzirat do t’i ketë të dimensioneve historike-botërore! Një mbrëmje diskutimi për kritikën, ku janë shfaqur mendime kritike për disa pikëpamje nga e cila nuk ka pësuar dhe nuk mund të pësonte asnjë të keqe, s’është tjetër veçse – mbrëmje linçi, që përmban tërë perfiditetin dhe të këqiat e linçeve të së kaluarës, por është më i egër se ata!

Dhe, kështu, ndërsa kujton të ketë të thënë gjë të madhe, R. Q. thotë në të vërtetë naivitetin dhe padijeninë më të madhe që mund të thuhej. Sepse, në qoftë se diskutimi për kritikën, edhe po të ishte vetëm një kritikë ekstreme e R. Q., mund të krahasohet, në cilëndo formë, me misteret dhe perfiditetin e Borxhias e të pallateve të Vatikanit, me Berian dhe ekzilet e Siberisë, atëherë ose këto s'paskan qenë gjë ose R. Q. s'di çka flet.

Për të diskredituar ata që e kritikuan dhe për t'u treguar i dijshtëm e bashkëkohës, fjalën e tyre e krahason me “fjalimet nëpër gjyqet ushtarake të ayat-ul-lah-Homeinit...”(!). E mbush shprehjen negativitet dhe e thotë kot! Ç'mund të dijë R. Q. për gjyqet ushtarake të Homeinit? Ato që i servon propaganda e Perëndimit? Kë e gjykojnë këto gjyqe? Gjykojnë satrapët e njërit ndër regjimet më të urryera. Po si mundet kjo “ndërgjegje e kohës” sonë të shprehet kot negativisht për gjyqet që janë organe të një kthese revolucionare të madhe të këtij shekulli, e cila, sado të jetë vështirë vazhdimi i saj mbi baza të ngushta islamike, edhe deri më tash i dha një ndër grushtat më të rëndë imperializmit dhe sistemit të marrëdhënieve të pabarabarta ndërkombëtare? Apo, edhe këtu R. Q. “shpraz emocione” dhe thotë s'di çka thotë?!

I njëjti ekzagjerim, i njëjti dyshim psikopat për skena e prapaskena, për organizime e komplete vërehet kur R. Q. thotë për Ibrahim Rugovën dhe artikullin e tij të botuar në “Përparimi”, 4/78. Botimi i artikullit lidhet me Konferencën shkencore të Lidhjes së Prizrenit ku ai, d.m.th. R. Q., “do të mbajë njërin prej tri referateve kryesore”, lidhet me prezencën e të huajve, shihet dhe paraqitet hiq më pak se një përpjekje e organizuar për diskreditim “ndërkombëtar” të tij! Dhe kjo do të bëhet përmes artikullit i cili do të lexohet “edhe pse ishte vënë në mesin e mesit të revistës, pas pesë dhe para gjashtë artikujve të tjerë”! (fq.229).

Lidhur me këtë artikull, edhe dy fjalë. Në **Morfologji** thuhet: “Nuk ka dyshim se për botimin e këtij artikulli në numrin festiv të Përparimit ishte posaçërisht i interesuar dhe është posaçërisht i merituar Fehmi Agani” (fq. 229). R. Qosja e mbush plot gojën dhe thotë një rrenë!

Natyrisht, në qoftë për përgjegjësi, si anëtar i redaksisë, jam përgjegjës bashkë me të tjerët për çdo gjë që botohet në “Përparimi”. Në qoftë për t'u veçuar, publikisht po them, as për t'u distancuar prej artikullit të botuar dhe as për t'iu arsyetuar kujt, sepse s'më duken të nevojshme as njëra, as tjetra, se artikullin e përmendur si dhe të gjithë

artikujt e atij numri i kam parë vetëm pasi janë botuar. Në të vërtetë angazhimi im në redaksi të “Përparimit” në përgjithësi nuk është as i rregullt, as fort i zellshëm dhe konsiston në angazhimin e bashkëpunëtorëve nga fushat e filozofisë e të sociologjisë dhe në shikimin e punimeve nga këto fusha. Duke mos pasur mundësi për angazhim më të madh, para më se dy vjetësh kam kërkuar të lirohem nga kjo detyrë dhe po pritet një rast i përshtatshëm të më zëvendësojë ndokush tjetër. Gjatë vitit 1978 asnjëherë nuk kam marrë pjesë në mbledhje të redaksisë për programimin e përmbajtjes së numrave të caktuar të revistës. Për artikullin e I. Rugovës nuk kam pasur rast të deklarojem as para botimit, as pas botimit të tij, madje as në redaksi dhe as jashtë saj.

Po pse atëherë gënjen R. Q.? Sepse i duhet të krijojë përshtypjen e fushatës, të klanit, të veprimit të organizuar kundër tij. Ai madje as nuk e sheh se sa kontradiktor është. Vetëm dy faqe më parë ai shkrunte: “Revista shkencore Përparimi... kishte qëndruar gjatë mënjane fushatës... për shkak se një kohë të gjatë në redaksinë e vet nuk kishte pasur anëtarë të interesuar për rrjedhën e saj. Dhe, me zgjerimin e kompletimin e redaksisë me anëtarë të rinj, me anëtarë që ishin të interesuar dukshëm për fushatën... ajo do t’ia dalë në krye ta mbulojë me kompetencë edhe fushatën në fjalë” (fq. 227). Në përbërjen e parë s’kishte të interesuar për fushatë, të interesuarit u shfaqën me zgjerimin e redaksisë. I interesuari kryesor është Fehmi Agani. Por ky ishte anëtar i redaksisë edhe në përbërjen e parë, kur “në redaksi nuk kishte pasur anëtarë të interesuar për rrjedhën” e fushatës, edhe në përbërjen e re! E vërejtja apo jo këtë fakt R.Q.? Apo atij as që i interesojnë faktet, as që i intereson logjika e konsekuenca logjike, kur i ka fiksionet dhe dyshimet, që i mjaftojnë? Më në fund: po recensentët, a nuk guxuan t’i bëjnë as kaq vërejtje, as kaq sugjerime lidhur me faktet elementare? Jo, ata që mund t’i bënin vërejtje e sugjerime, që më në fund kishin respekt ndaj vetes e opinionit, nuk pranuan t’i bëhen recensentë një pamfleti, kurse këta “recensentë” ishin për të nënshkruar, dhe nënshkruan. A nuk është mjaft indikative e dhëna se libri u dorëzua në shtyp në nëntor 1979, kurse Pleqësia e Institutit i caktoi recensentët më 28.XI.1979!

“ILUZIONET” DHE ILUZIONET

Diskualifikimi aprioristik i oponentëve, mënyra e sëmurë e atribuimit të qëllimkeqësisë, të motiveve të dyshimta ose ekstremisht

negative ndaj kundërshtarëve të supozuar, madje argumentuar-paargumentuar, duke injoruar faktet, duke dhunuar arsyen, po e deshti puna, kjo është një ndër karakteristikat më dalluese të “polemikës” së R. Q. e shprehur fuqimisht në pamflet.

Pyetja e parë që mund të shtrohet është pikërisht se për ç’arsye RQ kthehet në ngjarjet e para aq kohëve, të harruara edhe për gjeneratat që i dinin e lëre më për gjeneratat e reja, për të cilat s’kanë rëndësi fare? Mua më duket se ai rikthehet te këto momente për shkak të ndërgjegjjes së papastër! E di se kishte qëndrime të pamira, e bren se këto dihen dhe janë larg pozës burrërore dhe moraliste që don të mbajë dhe përpiqet t’i “racionalizojë” qëndrimet e veta dhe të “dëshmojë” se gjithmonë kishte të drejtë!

Nga fundi i janarit 1974 RQ pat botuar në “Rilindja” artikullin *Krijimtaria dhe jeta jonë krijuese* në të cilin ngritej kundër disa dukurive negative në jetën krijuese dhe angazhohej për forma më të organizuara të jetës kulturore. Edhe pse çështjet e shtrua s’ishin fort të reja, s’ishin që të mos përkraheshin. Por, s’mund të përkrahej edhe mënyra se si kualifikoheshin disa marrëdhënie.

Prandaj, në kuadër të një anketimi që e organizoi “Rilindja” mendova që është mirë të përgjigjem me shkrim. Përkrahsha dënimin e dobësive dhe kërkesën për forma më të organizuara të jetës kulturore, por jo edhe vlerësimin e marrëdhënieve në formë të vrazhdtë e me ngjyra të errëta si e bënte RQ. Ku nuk pajtoheshim? Ai i karakterizonte marrëdhëniet kështu:

“E tillë çfarë është, jeta krijuese është një jetë, le të thuhet, kulturore e provincës, ku njerëzit pjesën më të madhe të kohës e kalojnë duke u marrë, plot gëzim me fatkeqësitë e vogla dhe të mëdha të fqiut dhe duke iu lutur të madhit zot, që t’i digjen vetullat dhe flokët gruas së bukur të fqiut të parë, që t’i bëjë kopilin e bija e fqiut të dytë, që t’i lëshojë burri të bijën e madhe fqiut të tretë, që të ndahet prej të shoqes fqiut i katërt, që t’i bjerë zhuga fqiut të pestë, kurse damlla fqiut të gjashtë, që t’i dhezet shtëpia fqiut të shtatë, e të tjera” (*Anatomia e kulturës, 105*).

Kush mund të pajtohej me një vlerësim të këtillë? S’është fjala për shijen pa shije dhe trivialitet, sepse të këtilla kishte edhe të tjera, por për vlerësimin vetë. Mesi ynë kulturor s’ishte dhe s’është pa dobësi, pa zili e smirë. Mesi ynë kulturor s’ishte i formuar, i pjekur, kritik, duartokiste vend e pa vend, s’mund të ndihmonte krijimtarinë me një qëndrim objektiv vlerësues. Por, entuziazmi dhe dashamirësia ishin karakteristikat kryesore të mesit tonë kulturor, të marrë në

kuptim të gjerë. Duke jetuar edhe unë si e tërë gjenerata në atmosferën e entuziazmit dhe të optimizmit të nxitur fuqimisht me Plenumin e Brionëve, entuziazëm dhe optimizëm që e karakterizojnë, më duket, jetën tonë të përgjithshme të këtyre 15 viteve, s'mund ta perceptoj ndryshe veçse në mënyrë optimiste edhe klimën tonë kulturore e krijuese. Të thuhet se jetojmë prej së keqes dhe për të keqen e tjetrit, më duket akuzë e tmerrshme. Po të thuhej kjo domosdo do të shtrohej pyetja: çfarë qenkan marrëdhëniet tona shoqërore, kur u krijuan marrëdhënie të tilla, që njerëzit të jetojnë nga e keqja e tjetrit? Sepse karakteri dhe natyra e njeriut formohen në tërësinë e marrëdhënieve shoqërore. Por unë e evitoja këtë, sepse më dukej, si më duket edhe sot, se karakterizimi i këtillë i marrëdhënieve dhe i klimës krijuese ishte rezultat i dobësisë së njohur të ekzagjerimit të R. Q. dhe **një kritikë provincialiste e provincializmit**, që e përsëriti ai shpesh deri më sot.

Në reagimin tim thuhej edhe se tema e shtruar shikohej ngushtë, se duhet të shihet më gjerë ndërlidhja e shoqërisë dhe e krijimtarisë, se diskutimi duhej të pasurohej me analiza e orientime vlerore të krijimtarisë sonë, etj. Si e interpreton sot RQ këtë reagim? Para së gjithash e quan interesant “sidomos përkah taktika e kompromisit” (57) dhe mandej kërkon të gjejë arsyen pse u botua fare: “Që të mbronte dobinë e klaneve në jetën tonë krijuese duke mbrojtur ashtu edhe strategjinë e veprimit të tyre? Apo ndoshta që të më sinjalizonte atë që s’jam i prirur kurrë ta kem parasysh: se unë s’mund të shkruaj çka dua, sepse ka kapuç mbi mua!” (58). Antidogmati ynë i deklaruar s’mund të kuptojë se mund të përkrahet damkosja e dobësive, por jo edhe njollosja e mesit dhe e marrëdhënieve, që nuk ka bazë as në realitetin tonë shoqëror as kulturor. Insinuant si është, don të më atribuojë hiç më pak se qëllimin që t’i mbroj klanet, që s’ishin tjetër veçse halucinacione të tij. Dhe, i kompleksuar si është, reagon emocionalisht e rebelohet: Mua të më vejnë kapuç?! Por, ku ka korrektësi, ku mund të ketë diskutim e polemikë, kur nuk vështrohet nëse ka apo jo të të drejtë ai që mendon ndryshe, por në vend të kësaj kërkohen motive të fshehta, obskurante të tjetrit?

Pas pak ditësh R. Q. shkroi *Iluzionet janë të dëmshme*, që ishin të intonura polemikisht që nga titulli, në mënyrë sofistike bënë një spostim, një zëvendësim të subjektit të polemikës. Sepse, ndonëse nga marrëdhëniet dhe klima krijuese varet në një masë të madhe edhe rezultati i krijimtarisë, në plemikën e mëparshme, së paku në reagimin ndaj artikullit të parë të R. Q. s’ishte fjala për rezultatet e krijimtarisë.

Ishte kontestuar vetëm pohimi se në dy vitet e fundit krijimtaria ishte në krizë. R. Q. jo vetëm që bën zëvendësimin sofistifik të temës së diskutimit, por në mënyrë jokorrekte, pa emëruar, u imputon, u atribuon të tjerëve se kanë dhe po përhapin iluzione për rezultatet e krijimtarisë sonë. Dhe, duke qenë se iluzionet rrëzohen shpejt, R. Q. mendon se shpejt do të mund të diskualifikonte edhe oponentët. Por, një gjë s'e llogariste mirë R. Q. Ai s'e shihte se është pikërisht iluzion dhe ikluzore të kujtosh se mjafton t'i imputosh tjetrit iluzione dhe opinionin ta marrë këtë si të gatshme e të vërtetë.

Edhe ndaj këtij artikulli pata reaguar me vështrimin e titulluar: *Për një vlerësim objektiv të krijimtarisë*. Vërejtjet e mia kishin të bënim me mënyrën e diskutimit e të polemikës, me vlerësimin sektar të krijimtarisë, me nisjen nga premisa të pasakta, me konkludimet alogjike, me mënyrën arbitrare – diskualifikuese të vlerësimit dhe me dëmin e saj.

Vërejtjet kishin të bënin me mënyrën e diskutimit, sepse mënyra e diskutimit, e polemikës nuk është formë e jashtme, mirësjellje e korrektësi, fair play, si do të thoshte ky ferjplejist, që kurrësi s'po mund të ngritet te principieliteti marskist, por që është thelbore dhe principiele sa edhe vetë përmbajtja. Mënyra e polemikës së tij ishte aprioristiko-diskualifikuese. Përkundër tri faqeve të gazetës dhe titullit të të tri vazhdimëve me *Iluzionet janë të dëmshme*, s'e shihte fare të nevojshme të thoshte se cilët ishin përhapës të iluzioneve dhe ç'thanë ata që të ishte iluzion, s'e konsideronte fare të nevojshme t'ua shtronte për gjykim lexuesve cilësimin që u atribuonte të tjerëve. Kjo mënyrë e polemikës është e njohur, është mënyra sofistike e postulimit, e supozimit si ditur pikërisht të asaj që do të duhej të vërtetohej. Iluzionet ishin fiksione të R. Q., ishin projeksione të tij, ai postuloi në mënyrë simplifikuese, e quajti të ditur se ata që mund të kenë mendime të ndryshme nga ai për krijimtarinë tonë dhe nivelin e kushtet e saj janë përhapës të iluzioneve, apriori i diskualifikoi për të filluar mandej rrebeshin patetiko-verbal kundër iluzioneve. Kjo mënyrë ishte dialog i RQ me fiskionet e tij. Vërejtjet për mënyrën e polemikës ishin kërkesë për evitimin e dobësive të irrelevancës në polemikë, për evitimin e atakimeve morale e personale të atyre që mendojnë ndryshe, për më shumë konsekuencë në qëndrimet, më shumë besnikëri ndaj qëllimit dhe më pak përgjithësime të pabazë, më pak sulme difuze dhe aluzione të pacaktuara. Sepse, s'mund të ketë diskutim të çështjes nëse vazhdimisht ndërron tema e diskutimit, nëse bëhen pohime të kundërta madje edhe brenda të njëjtit vështrim. Dhe

s'mjafton të deklarojmë se kemi qëllim të mirë, se duam të dënojmë plogështinë e të inkurajojmë krijimtarinë, po qe se lejojmë që, të përfshirë nga emocione të caktuara, të harrojmë rrugës qëllimin dhe të mohojmë edhe ato rezultate që i kemi, duke satisfaksionuar në këtë mënyrë jo punën e rezultatit, por përtacinë e shterpësinë, sepse pikërisht këto të fundit barazohen me të parat. Të gjitha këto dobësi të polemikës në mënyrë shumë më të fuqishme manifestohen në *Morfologji*.

Vërejtjet kishin të bënin edhe me mënyrën sektare të vlerësimit, sepse për rezultatet e krijimtarisë s'mund të gjykohet vetëm sipas fushave albanologjike. Dhe, sado që këto fusha zënë dhe duhet të zënë një vend të veçantë e të gëzojnë një përkrahje të posaçme, as si komb dhe as si punëtorë të kulturës s'mund t'i reduktojmë abicjet e pretendimet dhe as të mohojmë origjinalitetin dhe krijimtarinë në fushat e tjera, qofshin këto shkenca të natyrës apo shkenca shoqërore. S'mund të anulohen p.sh. rezultatet në shekncat e natyrës me një deklaratë të papërcaktuar e të pakuptimtë se aty "s'mund të kemi rezultate për eksportim".

Në vështrim, ndër të tjera, thuhej: "Për një përcaktim dhe vlerësim, relativisht të plotë e të saktë të krijimtarisë sonë dhe të nivelit e të rezultateve të saja, në relacion me kushtet dhe mundësitë, nevojitet para së gjithash përcaktimi relativisht i plotë i vetë kushteve, objektive e subjektive. Kjo u bë vetëm pjesërisht, madje me ca pasaktësi. Të pohohet se kemi kushte objektive të favorshme dhe se s'kemi organizim të punës krijuese, se kemi kushte subjektive, kolektive e individuale, por kemi përtaci e plogështi, madje që nga periudha e sundimit osman, më duket është një kontradiktë". Cilido që do t'i vlerësonte rezultatet tona të përgjithshme të këtyre tri dekadave, do të thoshte medoemos, në një apo tjetër formë, se kemi realizuar transformime të thella edhe ekonomike, edhe shoqërore, edhe kulturore. Këto transformime, transformimi kulturor e arsimor veçmas janë vepër edhe e krijuesve tanë, janë materializim i energjive dhe i mundësive krijuese të tyre. Kjo nuk do të thotë se s'kemi mundësi të bëjmë më tepër, ndoshta shumë më tepër, se duhet të kënaqemi me të arriturat, se s'duhet të përpiqemi për më shumë. Përkundrazi, kjo do të thotë se shumë më tepër duhet të përpiqemi për të përballuar mungesat e shumta, objektive, krahasuar me të tjerët. Kjo nuk do të thotë se s'ka pasur dhe s'ka përtaci, dembeli, papunë. Kjo do të thotë se ka pasur edhe punë, përpjekje, rezultate, përkundër vështirësive objektive dhe

se duhet të vlerësohen më objektivisht pikërisht kjo punë, këto përpjekje, këto rezultate”.

“Po iluzionet? Janë të shumta e të shumëllojta dhe, për të keq, nuk janë të locuara në një vend. Janë të shpërndara dhe të dëmshme kudo që të jenë. Por një “iluzion” timin dëshiroj ta pranoj publikisht. Është iluzion, po deshët, apo bindja që kam se detyra jonë primare është të kërkojmë, të gjejmë dhe të afirmojmë vlerat dhe krijimtarinë që kemi, me ndjenjë mase e përgjegjësie, duke kritikuar të meta e dobësi, por pa shikuar dhe matur nga nivele abstrakte dhe të paqena. Jo për vetëkënaqësi, jo për autarki, por për kënaqësinë normale të shkaktuar nga rezultatet e arritura, kënaqësinë që inspiron dhe inkurajon rezultate më të mëdha, që të mund të hyjmë sa më të plotë e më të begatshëm në komunikim kulturor e krijues me të gjithë. Kjo më duket rruga e vlerësimit objektiv, e nxitjes dhe e inkurajimit të krijimtarisë sonë”.

Redaksia e gazetës e konsideoi të arsyeshme të mos e vazhdojë polemikën dhe nuk e botoi vështirimin tim nga i cili i nxora vetëm dytri mendime. Bëhej kjo për të mos u thelluar konfrontimet dhe për të mos kaluar në grindje personale. Edhe pse nuk më dukej e drejtë, nuk kam dyshuar në këtë motiv. Por R. Q. s’i mjafton kaq. Shkon në redaksi, kërkon t’i lexojë artikujt e pabotuar, fshehurazi del e i kserokson dhe nis t’i shpërdorojë! A mund të mos e dinte R. Q. se artikujt e pabotuar u takojnë vetëm autorëve? Në pamflet shkruan ndryshe. Thotë se donte që artikujve t’u përgjigjej “me kohë”, “menëherë javën tjetër”, prandaj i kseroksoi. Por, edhe po ta lëmë anash faktin që artikujt që kapin gjithsej 21 faqe, s’janë që të mos mund t’u përgjigjet pas një jave ai që për “40 ditë” shkruan një libër, shtrohet pyetja: Ç’është përgjigje “me kohë” për artikujt e pabotuar, përse të jepej përgjigja “menjëherë javën tjetër” dhe përse R. Q. sot e fsheh prej lexuesve faktin që redaksia kishte vendosur të mos i botonte artikujt? “E kisha vënë në dijeni kryeredaktorin”, thotë ai, “se kisha bërë kseroksimin”. Vërtet, mos e pyet se të tregon vetë! Nëse kseroksimi është bërë me leje – dhe vetëm me leje mund të bëhej, ose do të ishte vjedhje e materialeve nga redaksia – pse të vëhet në dije kryeredaktori, lere më që as ky pohim nuk është i vërtetë?!

Këtu më duhet të bëj një digresion dhe të vë në dukje një moment të rëndësishëm, që jo rastësisht RQ e lë anash. Me artikujt e pabotuar, por të kseroksuar ilegalisht R, Qosja, që kujtonte se u kishte bërë nder të madhe redaktorit të atëhershëm dhe dekanit të atëhershëm të Fakultetit Filozofik duke i përmendur në iluzionet e tij si të vetmit

me kontribut albanologjik, insiston të mobilizojë përkrahjen e tyre dhe mbahet mbledhja e Degës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe ku R. Ismajlit, atëherë asistent, për artikull të pabotuar (!) i bëhen kërcënime me dëbim nga Fakulteti! Çështja as që mund të shtrohej para Këshillit të Fakultetit, lere më që marrëdhëniet tona shoqërore s'kanë fare shansë të realizohen me kërcënime të tilla. R. Q., në stil të vet, i pakënaqur, si duket me përkrahjen kur botoi *Anatominë e kulturës*, ku u botuan edhe *Iluzionet*, nuk i shënoi emrat e ish-redaktorit dhe të ish-dekanit, i depersonalizon dhe shkruan: "Me përjashtim të dy-tre vetëve, punonjësit e tjerë shkencorë nuk mund të pohojnë se kontributi i tyre shkencor është me rëndësi të veçantë albanologjike (!) Pas kësaj, njeriu si të mos pyesë: A mund të ketë ende individë aq të kotë e aq të marrë, që ta vënë veten, në çfarëdo forme, në varësi intelektuale apo morale nga vlerësimet subjektiviste, nga arbitrarizmi dhe teket e RQ? Kujt mund t'i duhen ato, qofshin edhe afirmative, lavdëruese? Pyetja imponohet veçmas kur shihet pretencioziteti i R. Q. në *Morfologji*: këtë e citova, atë s'e citova; këtë e përfilla – atë s'e përfilla, e kotësira të ngjashme. Por R. Q. e vazhdon dezinformimin. "Autorët... kishin nxituar mandej t'i tërheqin artikujt me pohimin se ashtu u është cënuar e drejta e sekretit"!

Po ku e gjet R. Q. këtë pohim të marrë? Ai e redukton në absurd trillimin absurd të vetin. Në të vërtetë, pas skandalit në Degën e Gjuhës e të Letërsisë Shqipe, ishte i deplasuar të diskutohej në mënyrën dhe me tonin si ishin shkruar artikujt. Ferplejisti ynë vazhdon: "Kur sot, mbas gjashtë vitesh, mendoj në lidhje me këtë reagim, pranoj se kam gabuar: kam gabuar sepse u kam dhënë alibin autorëve t'i tërheqin artikujt e tyre, sado që do të dëshiroja t'i kishin botuar" (59). Kështu shkruan akademiku ynë, që as fjalës alibi nuk ia di kuptimin dhe përdorimin e drejtë! Dhe vazhdon duke analizuar trillimin e vet: Nuk mund të jetë arsye zbulimi i sekretit, thua se e tha kush këtë, përveç tij!

RQ nuk do të ishte ai që është, po të mos arrinte edhe në këtë orvatje dezinformimi, deri në "prapavijë", po të mos u imputonte motive të errëta oponentëve. "Nuk ka dyshim se autorët tanë i kishin tërhequr artikujt pa arsye se në ndërkohë kishin kuptuar se me ta më qartë zbulonin prapavijën e përgjigjeve të tyre" (!) Natyrisht, depërtimi në "prapavijë" është ikja nga vija e vërtetë e problemeve reale.

Pretendime të mëdha – artikulime konfuze

Iluzionet u botuan në përmbledhjen *Anatomia e kulturës*, librin më pretencioz të R. Q. Kush nuk e ka kuptuar nga *Iluzionet*, sheh qartë në *Anatomi* se qëllimi i autorit nuk është të mohojë rezultatet e krijimtarisë sonë në përgjithësi, ai vetëm mohon rezultatet e të tjerëve, duke u ndarë atyre Jo-në e tij, kurse krijimtarisë sonë dhe nivelit të saj u mjafton të huazojë qoftë edhe një pjesë të mendimit që ka R. Q. për veten dhe krijimtarinë e vet.

Lexuesve të do t'u ketë rënë në sy dhe mund t'u kujtohet kontradikta e qartë në mes të vlerësimit që i bëhen zhvillimit tonë kulturor dhe krijimtarisë në *Parafjalë*, në *Iluzionet* dhe në disa artikuj të tjerë. Parafjala vetë është shumë kontradiktore. Nis me pohimin mbi interesimin e paktë të shoqërisë për kulturën, një e vërtetë të cilën “mjerisht e ka dëshmuar edhe realiteti socialist, e madje, edhe realiteti ynë kosovar”, me pohimin se “interesimi shoqëror për krijimtarinë kulturore nuk ishte në nivelin, në të cilin do të duhej të ishte”, se “një kohë të gjatë krijimtaria jonë kulturore thajse është varur prej vetvetes” dhe se ka pasur “indiferencë” shoqërore ndaj krijimtarisë kulturore (fq. 7). Në faqen vijuese vjen pohimi tjetër se “pavarësisht prej kësaj të vërtete” mbi interesimin e paktë shoqëror, “krijimtaria kulturore në këto hapësira ka shënuar një përparim të madh”, i kemi të gjitha institucionet kulturore, artistike, shkencore, ardhmëria e kulturës sonë “është jashtëzakonisht premtuese” (fq. 8). Pas kësaj, fillon R. Q. të përgatitë shfaqjen e pretendimit të vet kryesor. “Të gjitha analizat e deritashme të kulturës”, thotë RQ, kanë qenë kuantitative, krahasimi i të sotmes me të djeshmen kanë sjellë vetëkënaqësi. Por, - “është harruar ashtu se për krijimtarinë kulturore mund të flitet në radhë të parë në bazë të kriterëve aksiologjike” (!) (fq. 9). Pa ditur dhe pa dashur të dijë për dialektikën e kategorive sasiore e cilësore, vlerore, R. Q. i rezervon vetes monopolin e “kriterëve aksiologjike”, duke i mohuar analizat e deritashme. Dhe vjen kryesorja. Po bëhet e qartë se “një aspekt i tillë i vrojtimit kuantitativ, thuaja pa vlerësim, i të mbërriturave kulturore nuk është më adekuat...” (fq. 9). Duke harruar se pas kësaj Parafjale vijnë artikuj si *Iluzionet*, me pohime të tjera, tani kur i duhet, thotë tjetër gjë: “Praktikisht kultura jonë tani hyn në një periudhë të ngritjes kualitative, kur bëhet e vetëdijshme për domosdonë e vetëdijes së vet, kritikës dhe teorisë, sepse s'mundet pa të. A mund ta konsideroj këtë

vepër shprehje të një vetëdije të tillë? – Pavarësisht se çka do të thotë lexuesi i saj eventual **unë them po**” (!) (fq. 10, nënvizoi F.A.)

Arrogancë më e madhe me artikullin më konfuz, vështirë të gjendet. Analizat e përparshme të krijimtarisë kulturore ishin vetëm sasiore, pa “kritere askiologjike” (!), kurse kultura jonë e sotme kërkon vetëdijen e vet, kritikën dhe teorinë. Kjo vetëdije e kulturës sonë, kjo kritikë dhe teori e kulturës sonë u arrit pikërisht me R. Qosjen dhe *Anatominë* e tij! Lexuesi përjashtohet nga diskutimi, R. Q. i bën pyetje vetes dhe përgjigjet vetë. Por, prapë, në mënyrë të paevitueshme shtrohen shumë pyetje: Si ka mund kultura e djeshme të jetë pa vetëdije të vet, pa kritikë e teori, të cilitdo nivel? Përse? Ç’kuptim ka dhe sa është e vërtetë të pohosh se analizat e përparshme ishin vetëm sasiore? A merret kultura jonë vetëm si kulturë kosovare dhe pse? Ç’do të thotë se kultura jonë po hyn në një shkallë të ngritjes kualitative që e kërkon vetëdijen e vet, kur dihet se në *Iluzionet* thuhet se krijimtaria e viteve të fundit është në gjendje krize? Cilat qenkan karakteristikat e kësaj ngritjeje kualitative të kulturës dhe mos koincidojnë rastësisht me pranimin e R. Q. në Akademi? Më në fund: Ç’kuptim ka, a nuk është substanciale, a nuk është temë pa temë të bisedohet për një autor, për një vepër si për vetëdije e vetëdijësim të kulturës sonë, si për teori e kritikë të saj? A mos është kjo një imitim i gjymtë i pretendimit të Hegelit se në veprën e tij ideja u bë e vetëdijshme për vetveten? Si mund të pretendojë dikush të jetë kritik e teoricien i kulturës e të mos e dijë ose të injorojë faktin se çdo akt krijimtarie kulturore është moment vetëdije e vetëdijësimi dhe se krijimtaria e përparshme s’ishte instinktive, s’kishte si ta priste dhe pse ta priste R. Qosjen për t’u vetëdijësuar?!

Pas këtyre absurditeteve, sikurse në *Morfologji* që i shan që më parë ata që mund t’i përgjigjen, ashtu edhe këtu i diskualifikon që më parë ata që nuk pajtohen: Kush në këtë botë jallane s’e di se kurrë nuk është e lehtë të kesh të drejtë para kohe” (!)

A mund ta bartte *Anatomia* barrën e këtyre pretendimeve? Natyrisht, jo. Përmbledhjen në fjalë e përbëjnë artikujt e shqyrtuar mbi krijimtarinë dhe iluzionet, seria e moralizimeve që e pat botuar edhe në “Rilindje” dhe ndonjë artikull tjetër! Hiç pa i konsideruar të parëndësishme temat e trajtuara, s’mund të mos vërehet se shumica e temave esenciale të kulturës nuk trajtohen fare, temat e trajtuara shikohen nga aspekte sporadike, marginale, në vend të studimit të thelluar autori zgjedh thuaja se reportazhin, eseun që nuk obligon, këto mandej i ngarkon me subjektivizëm e insinucion, me aluzione,

kritikën e bën të kufizuar, provincializmin e kritikon në mënyrë provincialiste, etj. Si mund të dalë njeriu me kaq pretendime e të botojë, që në fillim, një artikull për letërsinë e revolucionin, madje me nëntitull: “çështje teorike”, kur artikulli të jetë për folje e të njohurave, vështirë i dobët e plot gabime. Autori e ndjen të nevojshme të flasë edhe për çështje të strukturës shoqërore, dhe shihni si shkruan: “Pavarësisht pse superstruktura zhvillohet edhe simbas disa ligjësive që janë specifike për të, prapë, siç e kanë konstatuar klasikët e marksizmit, asgjë nuk mund të ngjajë në të, pa ngjarë më përpara në jetën shoqërore (!) (fq. 29). Pohim më absurd s’di se mund të thuhej. Njeriu s’di vetëm ç’dëshën këtu klasikët e marksizmit dhe pse u masakruan në këtë mënyrë. Po ç’është superstruktura në mos qoftë jetë shoqërore! Dhe, kur konstatuan klasikët se asgjë nuk po ndodhka në superstrukturë, “pa ngjarë më përpara në jetën shoqërore”? (!)

R. Q. dëshiron t’ia marrim pretendimet seriozisht, kur zihet në gabime dhe dobësi të këtilla filloriste të akuzon se po zhvillon fushatë kundër tij, bile të projekton rolin në fushatë si rol gjithsesi “filozofik”. Ose, të përmendim eseun që pason: *Gojtaria ose muza e harruar*. Njeriu do të priste të shqyrtohen çështje të rëndësishme dhe aktuale të kulturës së gjuhës. Por, jo. Në vend të kësaj gjejmë erudicion leksikonesh për oratorinë, dhe prapë kapërcime dhe akrobacione logjiko-verbalistike. Pasi përmend oratorë të shumtë të vendeve dhe kohërave të ndryshme, shkruan: “Edhe Rilindja kombëtare shqiptare ka artistët e saj të fjalës së bukur, ndikuese, përvetësuese, të cilët s’kanë pasur mundësi objektive të dalin në tribunat e popullit të vet, por i kanë folur me shkrim” (!) (fq.58). Por, ç’është ky shqelm që e derdh edhe atë që mund të jetë mbledhur më parë? A nuk shihet se të folurit “me shkrim” nuk është gojtari?

Kur mungojnë gjymtyrët kryesore dhe janë dhënë dobët të tjerat, çfarë anatomie është ajo? A mund të jetë anatomi e kokës ajo që reduktohet në anatomi të mykut dhe mjekrës?!

Dobësitë kryesore të stilit dhe të metodës së polemikës e të rezonimit të R. Q. në mënyrë edhe më drastike shprehen në pamfletin e quajtur *Morfologji*. Nga këto do të dallojmë: projektimin e dobësive të veta te të tjerët, dogmatizmin në të menduar, inkonsequencën dhe alogjikësinë në të konkluduar dhe në të argumentuar përgjithësisht.

Projektimi i dobësive personale te të tjerët është karakteristikë e kahershme e R. Q.

Shprehje e kësaj dobësie janë shumë trillime të pamfletit. Linçi? Po a s’ ishte R. Q. që, për një mospajtim të shfaqur, madje të pabotuar,

ndërmori çmos që t'i kërcënohet R. Ismajlit me dëbim nga fakulteti? A s'është R. Q. që me rastin e rizgjedhjes së I. Rugovës si asistent në Institut të ngritet kundër kësaj rizgjedhje? Madje në të njëjtën mbledhje kur një tjetër zgjidhet për një titull më të lartë?! Dhe s'do t'i thotë kush se kjo s'bën. E njëjta gjë ngjet me kategorinë e privatasistentit. Cili u imponon raporte vazale bashkëpunëtorëve të rinj si R. Q.? Më në fund, që të krijosh raporte të tilla duhet të kesh mundësi, të kesh pushtet. A s'është R. Q. ndër kryemonopolistët në kulturën tonë, me më shumë funksione udhëheqëse e monopol faktik se të gjithë ata që i sulmon, edhe të ishin 3-4 herë më shumë? Dhe, a s'e dëshmojnë raportin privatasistent pikërisht recensentët e pamfletit?

Të paditet për monopol një shtëpi botuese edhe redaktorët e saj, duke injoruar këshillin botues, raportet vetëqeverisëse si dhe faktin që kjo shtëpi botuese programin vjetor të botimeve e vë në diskutim publik, nga drejtori i një institucioni që i lejon vetes të mashtrojë këshillin shkencor duke i prezentuar një titull, për të botuar një titull krejt tjetër – kjo është vërtet një impertinencë e padëgjuar.

Antidogmatizmin, me sa mund të gjykohet nga fjalët dhe qëndrimet e tij, R. Q. e kupton si sjellje të pazakonshme. Prandaj mund të deklaroj që në fillim: me jetën dhe veprën mohoj çdo dogmatizëm! Por, jo, dogmatizmi dhe jodogmatizmi nuk janë çështje deklarimi. Dogmatizmi është, në radhë të parë, mënyra e shtangët, e vrazhdë, jodialektike e të menduarit. Si stil, dogmatizmi është oktroim i të vërtetave, është stil i fjalës së fundit, i të vërtetave definitive, absolute, “pavarësisht se çka do të thotë lexuesi”, është, pra, në një masë të madhe pikërisht stil i R. Q. Si të menduar, dogmatizmi është arbitraritet e subjektivizëm, është injorim i fakteve dhe shkelje e arsyes, është përgjithësim pa bazë dhe akrobacion logjik, është “obduksion” në vend të analizës, është verbësi ndaj lidhjeve e ndryshimeve, ndaj përshkrimit të të kundërtave, ndaj subtilitetit mendor dhe nuancave përgjithësisht, është të mos kuptosh relativitetin dhe dinamikën jetësore. R. Q. vërtet na dha shembuj të shumtë të këtij dogmatizmi. Ç'do të thotë të shtrembërosh faktet, të interpretosh një simbol, p.sh. kullën, subjektivisht si simbol të izolimit e të paditësh autorin për izolacionizëm? Ose të konkludosh: Kush s'di të flaës, s'di të shkruajë, kush shkruan kështu prozë s'mund të shkruajë poezi, etj., etj., duke injoruar faktin e shkrimeve, madje shumë të suksesshme, të personit për të cilin flitet. Ose, të rikujtojmë çka quan ai harikiri. R. Q. nuk sheh ose nuk don të shohë, i mundur nga frika se mos po konstituohet edhe ndonjë vlerë tjetër, se deklarata për një tezë të

mbrojtur, që fillon me “nuk e kam lexuar ende” relativizon veten, kurse e nuancuar në formën: “nuk kemi arsye të mos e presim si vepër më të mirë” – shpreh një bindje e një shpresë, nuk pretendon të imponohet. Të sulmosh duke injoruar këto nuanca: si mund të vlerësohet pa u lexuar, është dogmatizëm. Të sulmosh se s’mund të dihet kalibri i intelektit për personin që nuk ka shkruar, do të thotë të mbyllësh sy para shumë mundësive të tjera të përcaktimit të aftësive. Të përsërisësh po këtë sulm, duke injoruar faktin se personi në fjalë ka shkruar, madje me shumë sukses, bile edhe në revistat që boton Instituti, ku R. Q. është drejtor, se përmbledhja e poezive të tij është botuar, bile katër herë, do të thotë të mbyllësh sy para fakteve e të jesh shumë dogmat.

Alogjikësia dhe konkludimet akrobatike të R. Q. janë aq të shpeshta, sa vetëm ato do të kërkonin një vështrim edhe më të gjerë. Të përmendim vetëm një shembull. A. Podrimja paska shkruar diçka për dendësimin e vargut. Me të drejtë ose jo, ka përmendur dy vargje si të pasuksesshme. Ç’bën R. Q.? Ai pyet: Kush e shkroi vargun e parë? Përgjigjet: E. Mekuli. Dhe konkludon: Pra, sipas A. Podrimjes, E. Mekuli s’qenka poet i mirë! Kush e shkroi vargun e dytë? Rr. Dedaj. Pra as ky s’qenka poet i mirë! Por, si mund të bëhen kësi përgjithësime, kësi fluturime nga një varg në tërë poezinë e një autori! R. Q. që na i përmend Dekartin dhe *Traktatin për metodën*, Spinozën dhe *Etikën*, Lajbnicin dhe *Metodologjinë* a s’di se kërkesa themelore e tyre ishte pikërisht rigoroziteti, disiplina e të menduarit? Ntyrisht, do të më përgënjeshtrohte, më duket, vetëm ai që do të më thoshte: s’kishte kohë R. Q. për logjikë, merrej këtu me provokacion.

Shpresa e kotë

“Ndërgjegjja e kohës” sonë s’do të ishte e këtillë po të mos merrej edhe me çështje më të mëdha shoqërore, këtë herë me Plenumin e Brioneve dhe me integrimin e veprimtarisë botuese. Por, ç’subjektivizëm ekstrem, ç’shikim i errësuar?! Fragmentin mbi Plenumin e Brioneve dhe zhgënjimet e tij R. Q. i titullon: shpresa e kotë (!)

Natyrisht, në dialektikën e jetës shoqërore, në kompleksin e faktorëve objektivë, subjektivë dhe të gërshetimit e të ndërhyrjes së tyre, gjithkush mund të ketë batica e zbatice, shpresa e shpresa të kota, gënjime e zhgënjime. Dhe askush s’mund të dalë prej lëkurës së vet ose pakkush mund t’i shohë çështjet pavarësisht nga vendi që zë vetë

në marrëdhënie të caktuara. Por, duhet të jesh vërtet një subjektivist ekstrem ose të jesh R. Qosja e t'i shohësh të gjitha çështjet vetëm sipas vetes! E të mos shohësh domethënien dhe dimensionet historike progresive të kthesës së Brioneve e të zhvillimit të pastajmë, madje pavarësisht nga travajat personale, R. Qosja, më në fund, absolutisht më së paku ka të drejtë të ankohet gjë. A nuk u ngrit ai – në sajë të punës së vet, por edhe në sajë të marrëdhënieve shoqërore të favorshme, të mirëkuptimit e të solidaritetit, e edhe të keqtrajtimit të disa mundësive – pikërisht në këtë periudhë të pas Brioneve, nga përkthyesi në Radio në drejtor të trefishtë të Institutit Albanologjik, në profesor ordinar të Fakultetit, në akademik dhe sekretar seksioni në Akademi? A nuk ishte në këtë ndërkoh edhe kryetar i Degës së Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe, kryetar i studimeve pasuniversitare, kryeredaktor i “Jetës së re”? A nuk botoi në këtë kohë tërë atë mori shkrimesh, me vlerë e edhe pa vlerë, madje edhe nga disa herë? Dhe, pse të mos e themi, a nuk ishte dhe a nuk është edhe sot një ndër më të privilegjuarit në jetën tonë të kulturës? Pse të zhgënjehet, çfarë shpresa të tjera të kota na paska pasur?

Plenumin e Brioneve R. Q. e kupton në mënyrë shumë abstrakte, zhgënjimin e lidh me “fushatën”, me “presionin”. Plenumin e Brioneve, shkruan ai, “e kisha pritur si një kusht (!) të lirisë më të pacënuar (!) (295). “Për më tepër isha i bindur se do të jem qytetar plotësisht i lirë, që domethënë se do të mund të shkruaj lirisht...ashtu siç mendoj, ashtu siç dëshiroj pa u frikësuar...” (!) (294-5). Vizionisti ynë planetar, që mban monopolin e “totalitetit”, nuk do të merret me dialektikën dhe konkretësinë e lirisë, për të cilën “lë kokën”, i mjafton ta trajtojë si papërgjegjësi. Pikërisht si të këtillë e do ai lirinë, si të drejtë “të pacenuar”, që të shkruajë “siç dëshiroj, pa u frikësuar”, si të drejtë që të botojë, duke gënjyer organet përkatëse, një libër sharjesh e trillimesh, libër në të cilin, në kaptinë të veçantë përshkruan vetë sekretin e botimit të panfletit dhe shan që më parë të gjithë ata që do të mund t'i përgjigjen, dhe askush të mos e pyesë “pse shkruan kështu”, askush të mos kërkojë përgjegjësi. Ose, të botojë librin provokativisht në 2000 ekzemplarë, duke shpërndarë disa qindra kopje me përkushtime e gratis, madje edhe jashtë shtetit, në stilin e aksioneve të “revolucioneve kulturore”, për të siguruar eventualisht sa më parë dhe sa më me sensacion botim të dytë, dhe askush të mos i thotë gjë. Përkundrazi, Bashkësia e shkencës t'ia paguajë botimin, duke përfshirë edhe honoraret shumëmilionëshe të autorit, madje edhe për botime të tjera eventuale! Në të kundërtën, do të deklarohet i

zhgënjyer, do të mendojë se “shpresa, gëzimi, lumturia ime e qershorit të vitit 1966 kishin qenë të kota” (!) (296). “Kisha harruar atëherë, se deformimet kolektive mund të shërohen më lehtë se ç’mund të shërohen deformimet individuale”, shkruan R. Q. (295), duke mos na bërë t’i kuptojmë se kur i paska pas ditur këto që i paska harruar. “Dhe kisha harruar...”, vazhdon ai duke na bërë të kuptojmë prapë se për raportin e të përgjithshmes dhe të veçantës, të kolektives dhe të individuale edhe sot më tepër llogotit se sa di gjë.

Për të arsyetuar zhgënjimin, R. Q. hap “faqen e dytë” të fushatës. Faqen e saj të parë e përbënin “artikujt atakues dhe diskreditues”. Sa qenë gjithsej? Rreth dhjetë, duke përfshirë edhe ata që vetëm me ndonjë fusnotë kishin të bënin me të, ose intervistat ku vetëm një pasus mund të duket se ka të bëjë me të. Dhe, këtu u botuan para më së gjashtë vitesh, në një kohë kur R. Q. botoi rreth 6 libra me aq shumë çështje kontestuese! Kjo na qenka fushatë, faqja e parë e saj?! Këtë faqe të parë, që i mbeti bukur zbrazët, R.Q. e mbushi pa fort kriter. Më inkuadron në fushatë edhe mua, ndonëse pas vitit 1974 kur shfaqja, në dy raste, mendime të ndryshme me të tija, nuk pata të bëjë më fare me të. Profesionin nuk më lidh me të, kërshëria intelektuale më çon kah autorë më seriozë.

Faqja e dytë – i njëjti mjerim. R. Q. paraqet publikisht – dhjetë ankesa. Në njërin thotë se një pjesëtar i fushatës paska kërkuar që me rastin e botimit të artikujve të R. Q. në gazetë, emri i tij të mos shtypet me germa të mëdha! Dhe, për këtë të ankoresh publikisht pas gjashtë vitesh?! Ankesa tjetër: Po ai person para katër vitesh, në një ekspozitë në Lublanë, paska protestuar pse janë ekspozuar librat e R. Q. dhe jo “librat e paqenë” të të tjerëve! A u hoqën librat e R. Q.? Jo! Pse e trazojnë librat e paqenë? Ankesa tjetër: I njëjti person i ka shkruar një redaktori të NIN-it një letër me fjalë fyese për R.Q., por jo si reagim publik. Viojnë dy-tri letra anonime, por me datë e vulë, 2-3 kërcënime telefonike me likuidim (të papërcaktuara, moral a fizik, apo moral e fizik njëkohësisht) (!) Kjo është faqja e dytë e fushatës! Dhjetë letra anonime, shqetësime me telefon e presione të tjera përmbi gjashtë vite! Kësaj i thonë fushatë!

Natyrisht, s’është të mos dënohen publikisht letrat anonime, shqetësimet telefonike e turpe të tjera të ngjashme, që mjerisht nuk janë të rralla. Janë këto primitivizma, janë idiotizma të tilla. Por, ç’kuptim ka vajtimi personal publik? Cili pjesëtar i jetës publike është i kursyer nga këto?

Edhe më e pakuptimtë dhe e papërgjegjësi është për letra anonime dhe biseda telefonike (anonime) të dalësh publikisht dhe pa argumentim e të padisëh “pjesëtarët e fushatës”. Unë, në mendjen time, mund të mos e përjashtoj fare R. Q. nga autorësia e ndonjë letre anonime që kam marrë, por të padis publikisht, pa argumentuar, cilindo, do të ishte papërgjegjësi e palejueshme.

S’ka dyshim se, në qoftë se R. Q. e trajton lirinë në këtë mënyrë, si sjellje arbitrare dhe e papërgjegjësi, shpresat e tij lidhur me Plenumin e Brioneve dhe lirinë e “pacënuar” s’mund të jenë vërtet asgjë tjetër veçse shpresa të kota.

Objekt i këtij vështrimi nuk ishte ajo që mund të jetë punë e rezultat me vlerë i R. Q. Objekt shqyrtimi është dështimi dhe pamfletizmi i tij. Dhe dëmi shoqëror e kulturor i skandalizimeve. Qëllimi im ishte të tregoj se për një fikcion kulturor të rëndësishëm nevojitet më shumë dije, më shumë moral, më shumë humanitet. Dhe këto nuk mund t’i zëvendësojë deklarativizmi e kaprici.

Fehmi Agani

KRONIKA 2013

(Aktivitete shkencore, ekspozita, vizita, përvjetorë, ligjërata, përrurime...)

TAKIM SOLEMN ME ANËTARËT E RINJ TË RREGULLT DHE KORRESPONDENTË TË ASHAK-UT

Në mjediset e Akademisë më 10 janar 2013 u mbajt takimi solemn me anëtarët e rinj të zgjedhur në zgjedhjet e fundit, të rregullt (akademikët) dhe korrespondentë të Akademisë. Në takim morën pjesë edhe shumica e anëtarëve të rregullt (akademikëve). Takimin e hapi kryetari i Akademisë akademik Hivzi Islami.

KONCERT SOLEMN NË 5-VJETORIN E PAVARËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, përkatësisht Seksioni i saj i Arteve, kushtuar 5-vjetorit të pavarësisë së Kosovës, organizuan më 15 shkurt 2013, në mjediset e ASHAK-ut koncert solemn, në të cilin morën pjesë akademikë, pedagogë e studentë të artit, personalitete të shquara të muzikës nga Shqipëria si Avni Mula dhe Zhani Ciko si dhe përfaqësues të mediave. Koncertin e shpalli të hapur Kryetari i Akademisë akademik Hivzi Islami. Në vazhdim: Luan Durmishi, tenor, Arta Jashari, soprano, Besa Llugiqi, soprano, Lule Ballata, pikolo flaut, Ardiana Bytyqi, mexosoprano, Astrit Mustafa, (bas) klarinetë, Ergin Brahimi, bariton, Lirika Pula, piano, Pranvera Hoxha, piano, Riad Ymeri, tenor, me dirigjent akademik Zeqirja Ballatën, realizuan programin e paraparë.

LIGJËRATË INAUGURUESE E AKADEMIK KOLEC TOPALLIT ANËTAR I JASHTËM I ASHAK-ut

Me ftesë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Kolec Topalli, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 28 shkurt 2013 ka mbajtur ligjëratën inauguruese me temë: *Disa rezultate në studimin e zhvillimit historik të gjuhës shqipe*.

Në praninë e anëtarëve të Akademisë, profesorëve universitarë, medimeve dhe të interesuarve të tjerë, fjalën e rastit e mbajti kryetari i Akademisë, akademik Hivzi Islami.

AKADEMIK NEXHAT DACI NË KONFERENCËN E AKADEMIVE TË DANUBIT (4 th Danube Conference)

Më 9-10 prill 2013 akademik Nexhat Daci ka përfaqësuar ASHAK-un në Konferencën e organizuar nga Akademia Rumune me titull *Science and European Danube Strategy*. Profesor Daci në Konferencën e lartëpërmendur ka marrë pjesë me punimin *Impacts of Thermo Power Plants Pollution on Human Biochemical Blood Parameters-Kosova Case*.

LIGJËRATË INAUGURUESE E AKADEMIK ALAJDIN ABAZIT ANËTAR I JASHTËM I ASHAK-ut

Me ftesë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Alajdin Abazi, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë dhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 24 prill 2013 ka mbajtur ligjëratën inauguruese me temë: *Konceptet e rrjetave energjetike inteligjente dhe kualiteti i fuqisë*.

Në praninë e anëtarëve të Akademisë, profesorëve universitarë, mediumeve dhe të interesuarve të tjerë, fjalën e rastit e mbajti kryetari i Akademisë, akademik Hivzi Islami.

LIGJËRATË INAUGURUESE E ANËTARIT KORRESPONDENT ARSIM BAJRAMI

Në mjediset e Akademisë, më 15 maj 2013 anëtari korrespondent Arsim Bajrami mbajti ligjëratën inauguruese me temën: Argumentimi kushtetues juridik i pavarësisë së Kosovës dhe vendimi i GJND-së. Fjalën e hapjes më këtë rast e mbajti sekretari i Seksionit të Shkencave Shoqërore akademik Mark Krasniqi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit tha se ligjëratat inauguruese po mbahet me rastin e zgjedhjes së Prof. Bajramit anëtar korrespondent i ASHAK.

PËRUIROHET VEPRA E AKADEMIK ESAT STAVILECIT “TË SHKRUARIT DHE TË MENDUARIT JURIDIK”

Në praninë e anëtarëve të Akademisë, profesorëve universitarë, të interesuarve të tjerë, mediumeve më 20 maj 2013 në mjediset e Akademisë u përurua libri i akademik Esat Stavilecit “Të shkruarit dhe të menduarit juridik”. Fjalën e hapjes me këtë rast e mbajti

sekretari i Seksionit të Shkencave Shoqërore akademik Mark Krasniqi. Më pas fjalë e mori recensenti i librit akademik Pajazit Nushi, pastaj dr. Blerim Reka.

AKADEMIK REXHEP FERRI NDEROHET ME ÇMIMIN “PERSONALITET I SHQUAR (në fushën e artit)”

Akademik Rexhep Ferri, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, është nderuar nga Këshilli i Qarkut Kukës, me titullin “Personalitet i shquar (në fushën e artit)”, me motivacionin: “Për afirmimin e vlerave të Qarkut Kukës, nëpërmjet veprimtarisë së tij artistike dhe akademike në fushën e pikturës dhe krijimtarisë letrare”. Fletdëshmia i është dorëzuar në një ceremoni rasti dhe pritje madheshtore nga Kryetari i Qarkut Kukës zoti Ibsen Elezi, më 8 maj 2013.

LIGJËRATË INAUGURUESE E ANËTARIT KORRESPONDENT RUZHDI PLLANA

Në mjediset e Akademisë, më 4 qershor 2013 anëtari korrespondent Ruzhdi Pllana mbajti ligjëratën inauguruese me temën: „Karakteristikat morfo-hidrologjike të karstit të Kosovës”. Fjalën e hapjes më këtë rast e mbajti sekretari i Seksionit të Shkencave të Natyrës akademik Fejzullah Krasniqi.

MBAHET TRYEZA SHKENCORE ME TEMË: *Letërsia shqipe në shkrimet enciklopedike*

Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës organizoi tryezën shkencore me temë: “Letërsia shqipe në shkrimet enciklopedike”. Tryeza u mbajt më 7 qershor 2013, në mjediset e Akademisë. Në Tryezë morën pjesë: anëtarë të ASHAK-ut, profesorë universitarë, punonjës të Institutit albanologjik, përfaqësues të mediave dhe të interesuar të tjerë. Tryezën e hapi me një fjalë rasti akademik Mehmet Kraja, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Në vazhdim kontributet e tyre i paraqitën: Ali Aliu, Sabri Hamiti, Dhurata Shehri, Ardian Marashi, Fatmir Sylejmani, Floresha Dado, Bashkim Kuçuku, Kujtim M. Shala, Ymer Çiraku, Shaban Sinani, Nehas Sopaj, Persida Asllani, Stefan Çapaliku, Vjollcë Berisha, Nysret Krasniqi, Laura Smaqi, Kastriot Gjika, Salajdin Saliu.

NËNSHKRUHET PROTOKOLLI I RI I BASHKËPUNIMIT MIDIS AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË DHE AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës në zbatim të Marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor-shkencor dhe artistik të vitit 2000, nënshkruan në Tiranë (në mjediset e ASHSH-së) më 13 qershor 2013, Protokollin e bashkëpunimit për vjetët 2013-2015. Protokollin e bashkëpunimit nënshkrua nga Akademik Salvator Bushati, sekretar shkencor i ASHSH-së dhe Akademik Isuf Krasniqi, sekretar i përgjithshëm i ASHAK-ut. Në ceremoninë e nënshkrimit morën pjesë: akademik Gudar Beqiraj, kryetar, akademik Muzafer Korkuti, zëvendëskryetar, akademik Salvator Bushati, sekretar shkencor, akademik Jorgo Bullo, kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike, akademik Dhimitër Haxhimihali kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike dhe akad.asoc. Efigjeni Kongjika, sekretare e Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike, akademik Pajazit Nushi, nënkryetar, akademik Isuf Krasniqi, sekretar i përgjithshëm, znj. Lendita Pula, sekretare e Akademisë .

PËRURUHET VEPRA E DR. ARSIM EJUPIT “LUGINA E PRESHEVËS-STUDIM KOMPLEKS GJEOPHAPSINOR “

Në mjediset e ASHAK më 19 qershor 2013 u përurua vepra e Dr. Arsim Ejupit me titull: *“Lugina e Preshevës- studim kompleks gjeohapsinor”*. Fjalën e hapjes më këtë rast e mbajti anëtari korrespondent Jusuf Bajraktari. Pastaj për vlerat e librit folën: Akademik Pajazit Nushi dhe akademik Hivzi Islami. Në fund autori i veprës dr.Arsim Ejupi falenderoi Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës që ia dha mundësinë e botimit veprës së tij.

KRYETARI I ASHAK-UT VIZITON AKADEMINË BULLGARE TË SHKENCAVE

Në vazhden e vizitave të ndërsjella, të mbështetura në Marrëveshjen për bashkëpunim shkencor dhe artistik midis Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Bullgarisë, nga data 20-21 qershor në Sofie qëndruan Kryetari i ASHAK-ut, akademik Hivzi Islami, akademik Rexhep Ismajli dhe akademik Eqrem Basha. Vizita u realizua me ftesë të Akademisë së Shkencave të Bullgarisë për diskutimin e

bashkëpunimit të mëtejshëm shkencor dhe artistik në vitin që vjen, si dhe për realizimin e pikave të mbetura nga programi i mëhershëm.

MBAHET TRYEZA SHKENCORE ME TEMË: *Depërtimi dhe përshtatja e huazimeve angleze në gjuhën shqipe*.

Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës organizoi tryezën shkencore me temë: “Depërtimi dhe përshtatja e huazimeve angleze në gjuhën shqipe”. Tryeza u mbajt më 27 qershor 2013, në mjediset e Akademisë. Në Tryezë morën pjesë: anëtarë të ASHAK-ut, profesorë universitarë, punonjës të Institutit albanologjik, përfaqësues të medie dhe të interesuar të tjerë. Tryezën e hapë akademik Mehmet Kraja, ndërsa kontributet e tyre i paraqitën: Rexhep Ismajli, Vesel Nuhiu, Jani Thomai, Bardh Rugova, Shykrane Gërmizaj, Jashar Kabashi, Arta Toçi, Valter Memisha, Linditë Sejdiu-Rugova, Agron Duro, Drita Kadriu, Nebi Caka, Irena Pata Kapo, Muhamet Hamiti, Shkumbin Munishi, Albana Ndoja, Dieter Nehring.

PËRURORHET VEPRA E PLOTË E ALI PODRIMJES

Më 5 korrik 2013, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, u bë paraqitja e botimit të *veprës së plotë të poetit dhe akademikut Ali Podrimja*. Me këtë rast folën akademik Mehmet Kraja, Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, akademik Hivzi Islami, Kryetar i ASHAK-ut, akademik Ali Aliut dhe akademik Rexhep Ismajli. Të pranishëm ishin znj. Atifete Jahjaga, Presidente e Republikës së Kosovës, z. Ramë Buja, Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Memli Krasniqi, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, familja e poetit Podrimja, anëtarët e Akademisë dhe shumë të ftuar të tjerë.

KRYETARI I FEDERATËS SË AKADEMIVE EVROPIANE VIZITON ASHAK-un

Kryetari i Federatës së Akademive Evropiane (All European Academies - ALLEA), prof. dr. Günter Stock ka qëndruar për vizitë zyrtare në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 29-30 gusht. ALLEA është federatë e 55 akademive të shkencave dhe të arteve nga pothuaj të gjitha vendet e Evropës, 40 prej tyre anëtare të Këshillit të Evropës. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës është anëtare e ALLEA-s që nga viti 2004. Më 29 dhe 30 gusht,

Kryetari i ALLEA-s është pritur nga Kryetari i ASHAK, akademik Hivzi Islami, me bashkëpunëtorë dhe ka zhvilluar vizita e takime njohëse me anëtarë të tjerë të ASHAK-ut. Z. Islami e ka njoftuar z. Stock me punën dhe veprimtarinë e Akademisë dhe me projekte të veçanta shkencore e hulumtuese që realizohen nga anëtarët dhe bashkëpunëtorët e Akademisë. Akademik Hivzi Islami, Kryetar i ASHAK-ut e njoftoi Kryetarin e ALLEA-s për rrugën e zhvillimit të akademisë dhe për synimet e saj në të ardhmen, për përpjekjet për ta ruajtur autonominë, etj. Dr. Shtok tha se sfidat e sotme nuk dallojnë shumë nga sfidat e djeshme, siç është globalizmi, energjia, ambienti, etj. Akademitë sot duhet të bashkohen për të përballuar këto sfida, theksoi ai. Kryetari i ALLEA-s përkujtoi se në disa vende të Evropës ka pasur përpjekje nga pushteti për të ndikuar në procesin e zgjedhjes së anëtarëve të akademive apo të udhëheqjeve të tyre, apo në imponimin e rregullave të paracaktuara nga pushteti. Ai e ilustroi këtë me rastin e Turqisë, ku po hartohet një ligj i ri për akademinë, i cili, siç tha Dr. Shtok, mund të cenojë pavarësinë e akademisë. "Ne i kemi shkruar presidentit Gyl dhe kemi shprehur shqetësimin tonë. Deri më tash nuk kemi marrë ndonjë përgjigje nga presidenti për shqetësimin tonë, por letra jonë ka hasur në reagime të fuqishme pozitive të institucioneve të shkencës e dijes dhe të shoqërisë civile", tha ai. "Tani e kemi edhe rastin e Akademisë së Rusisë, njërës ndër akademitë më të vjetra të Evropës. Edhe atje presidenti Putin po harton një ligj për akademinë, me të cilin ajo mund të vihet nën kontrollin e politikës dhe të pushtetit. Ne do të shkojmë në Moskë dhe do të përpiqemi të bindim autoritetet ruse se pa autonomi të akademisë nuk ka dije", thekoi Shtok. Kryetari i ALLEA-s, Gynter Shtok, ka folur edhe për një numër aspektesh të rëndësishme për promovimin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe dijes së kosovarëve. Ai ka falenderuar në veçanti Akademik Rexhep Ismajlin për punën e tij në zgjerimin e bashkëpunimit me akademitë evropiane dhe kontributin e tij për realizimin e vizitës së tij në Prishtinë.

TRAJNIMI PËR FJALORIN ENCIKLOPEDIK

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, përkatësisht Redaksia Qendrore e FEK-ut ka organizuar Takim pune për Fjalorin Enciklopedik të Kosovës në Durrës nga 19 - 22 shtator 2013. Në takim kanë marrë pjesë: Bordi i Fjalorit Enciklopedik të Kosovës, Redaksia Qendrore e Fjalorit dhe redaktorët e fushave përkatëse të

FEK-ut, me përjashtim të ndonjë zëvendësimi të tyre nga një anëtar i redaksisë përkatëse.

Takimi është realizuar sipas programit të paraparë.

ASHAK PREZANTON BOTIMET E VETA NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR "FRANKFURTI 2013"

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës është prezantuar më botimet e veta në Panairin Ndërkombëtar "Frankfurti 2013" që është mbajtur nga data 9-13 tetor. Me 11 tetor 2013, gazeta Zëri në portalin e saj (shih artikullin: <http://www.zeri.info/artikulli/17312/kosova-megjithate-dinjitoze-ne-panairin-e-librit-ne-frankfurt>) raporton se paraqitja e botuesve kosovar ka qenë dinjitoze. "Botuesit si ASHAK, Instituti Albanologjik, Instituti i Historisë, Koha, Buzuku, Dukagjini etj. e arsyetojnë pjesëmarrjen dhe të arriturat në fushën e librit në Kosovë, e cila mund të quhet megjithatë e suksesshme dhe dinjitoze!"

PËRURUHET NË TIRANË VEPRA E PLOTË E ALI PODRIMJES

Pas përrurimit në Prishtinë *vepra e plotë e Ali Podrimjes* u përrurura edhe në Tiranë. Përrurimi u organizua nga Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe u mbajt më 10 tetor 2013, ora 18:00 në mjediset e hotelit Tirana International. Solemnitetin e hapi dhe e moderoi shkrimtari Zija Çela, ndërsa për akademik Podrimjen dhe veprën e tij folën ministrja e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Mirela Kumbaro, Bashkim Kuçuku, Visar Zhiti, Ali Aliu dhe Rexhep Ismajli. Në përrurim nga Akademia jonë morën pjesë edhe akademik Mehmet Kraja, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe znj. Lendita Pula, sekretare e Akademisë, si shumë të ftuar të tjerë në mesin e të cilëve akademikë, shkrimtarë të njohur, profesorë universitarë, adhurues të shumtë të poezisë së akademik Podrimjes, si dhe përfaqësues të mediave.

ANËTARJA KORRESPONDENTE E ASHAK EDI SHUKRIU MERR PJESË NË TAKIMIN E I TË KOMITETEVE NACIONALE TË EVROPËS JUGLINDORE TË ICOMOS.

Më 10-13 tetor 2013 anëtare korrspondente Edi Shukriu ka qëndruar në Vjenë për të marrë pjesë në Takimin I të Komiteteve

Nacionale të Evropës Juglindore të ICOMOS, organizatës për trashëgimi kulturore. Tema e takimit ka qenë Bashkëpunimi rajonal-trashëgimi e përbashkët dhe thesar në rajonin e Evropës. Takimi është bazuar në programet e Unionit Evropian për trashëgimi kulturore (Programi kulturor 2014-2020) dhe ICOMOS-Grupit të Evropës (qershor 2011) me të cilat mundësohet bashkëpunimi shkencor i anëtarëve të ICOMOS në rajon. Në takim është pranuar edhe bashkëpunimi me shkencëtarët e Kosovës dhe është rekomanduar themelimi i Komitetit nacional të Kosovës, si në vendet e tjera në rajon dhe në botë.

MSC. ARDIAN GOLA PËRFAQËSON ASHAK-un NË PODGORICË

Më 16-18 tetor 2013, msc. Ardian Golan në emër të ASHAK-ut ka marrë pjesë në Konferencën ndërkombëtare me titull: Young Scientists and Science in the Region. Z. Gola në Konferencë, është paraqitur me temën Research practices in Kosova-Challenges in Humanities and Social Sciences.

PËRUROHET MONOGRAFIA TAHIR EMRA

Në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 23 tetor 2013 u përurua Monografia Tahir Emra, me autor Kujtim Buza, artist i merituar. Për botimin folën: sekretari i Seksionit të Arteve akademik Zeqirja Ballatadhe Kujtim Buza, artist i merituar.

DELEGACIONI I AKADEMISË SË SHKENCAVE TË BULLGARISË VIZITON ASHAK-un

Më 24 tetor 2013 Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës e vizitoi delegacioni i Akademisë së Shkencave të Bullgarisë përkatësisht kryetari i saj akademik Stefan Vodenicharov, D. sc. dhe sekretarja e përgjithshme shkencore prof. Evdokia Pasheva D. sc. Delegacionin në orët e pasditës e priti Kryetari i ASHAK-ut, akademik Hivzi Islami me bashkëpunëtorë. Më 25 tetor 2013, për nder të mysafirëve u mbajt mbledhje solemne e Kyesisë së Akademisë, me çrast anëtarët e saj njoftuan më për së afërmi me punën dhe veprimtarinë e Akademisë së Shkencave të Bullgarisë. Po këtë ditë në Amfiteatrin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,

Kryetari Vodenicharov mbajti një ligjëratë. Të pranishëm me këtë rast ishin edhe ambasadori i Bullgarisë z. Bobi Bobev dhe të ftuar të tjerë.

MBAHET KONFERENCA SHKENCORE *Energjetika dhe mjedisi për zhvillim të qëndrueshëm*

Seksioni i Shkencave të Natyrës i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës organizoi Konferencën shkencore me titull: “Energjetika dhe mjedisi për zhvillim të qëndrueshëm”. Konferenca u mbajt më 30 tetor 2013 në mjediset e ASHAK. Në të morën pjesë: anëtarë të ASHAK-ut, ministri i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë z. Ramë Buja, rektori i Universitetit të Prishtinës z. Ibrahim Gashi, z. Ramush Haradinaj, profesorë universitarë, përfaqësues të mediave dhe të interesuar të tjerë. Konferencën e hapi akademik Fejzullah Krasniqi, e përshëndeti dr. Ramë Buja, Ministër i Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, i cili përshëndeti edhe në emër të Kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi.

ASHAK PREZANTON BOTIMET E VETA NË PANAIRIN E 16 TË LIBRIT TIRANA 2013

Nga data 13 deri 17 nëntor, në Tiranë është mbajtur Panairi i 16-të i librit Tirana 2013. Në mesin e rreth 90 shtëpive botuese, institucioneve shkencore dhe arsimore nga Shqiptaria, Kosova dhe Maqedonia, përfshirë ambasadat e Shteteve të Bashkuara të Amerikë dhe Francës si dhe Përfaqësia e BE-së në Shqipëri, me botimet e veta është paraqitur edhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.

MBAHEN NË PRISHTINË MBLEDHJET E KRYESISË DHE TË KËSHILLIT NDËRAKADEMIK PËR GJUHËN SHQIPE

Më 6 dhjetor 2013 në Prishtinë, në mjediset e Qendrës Leksikografike-Enciklopedike të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u mbajt mbledhja e radhës e Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe. Mbledhja u mbajt nën drejtimin e akademik Rexhep Ismajlit dhe akademik Jani Thomait (bashkë-kryetarë) me pjesëmarrjen e: akademik Besim Bokshit, akademik Ethem Likajt, akademik Gjovalin Shkurtajt, akademik Kolec Topallit, prof. dr. Tomor Osmanit, prof. dr. Seit Mansakut, prof. dr. Imri Badallajt, prof. dr. Enver Hysës, prof. dr. Bardh Rugovës, prof. dr. Shefkije Islamajt, prof. dr. Abdullah Zymberit dhe Isa Bajçincës. Në pamundësi për të marrë pjesë vetë diskutimet lidhur me materialet e

dër-guara paraprakisht i kishin dërguar me shkrim prof. dr. Franko Altimari dhe prof. dr. Mehmet Çeliku. Mbledhja u mbajt sipas rendit të ditës të parashtruar më herët. Pikë qendrore e rendit të ditës ishte diskutimi i materialeve të përgatitura nga komisionet për çështje të morfologjisë në Tiranë dhe në Prishtinë. Komisionet kishin përmbledhur në dy materiale të ndara me detaje dhe lëndë ilustrimi pikat në rregullat ekzistuese të drejtshkrimit për të cilat ka pasur diskutime në opinion ose ato për të cilat anëtarët e Komisioneve e kanë gjykuar të nevojshme të diskutohet. Materialet e paraqitura me shkrim u diskutuan për çdo pikë veç e veç dhe me frymë të theksuar mirë-kuptimi. Pasi u dëgjuan të gjitha diskutimet Këshilli arriti këto përfundime:

1. Pas diskutimeve për format e shumësit të disa emrave të gjinisë mashkullore që mbarojnë me -i të theksuar të sanksionuar si shumës me -nj, u arrit përfundimi të propozohet që këta shumës të përfundojnë me -j. Këtu përfshihen rrjedhojat që në temë kanë një shumës të tillë;

2. U miratua propozimi që te foljet që pësojnë ndryshimin -t/-s të mbetet normative vetëm forma me -s;

3. U miratua propozimi që forma e rasës kallëzore të shquar tek emrat që mbarojnë me -ua: krua, kroi të rrafshohet sipas tipit të përgjithshëm të ndërtimit të këtyre formave të emrave mashkullorë, pra krua-kroi-kroin, ashtu si dhe trajta e kallëzores së shquar të emrave mashkullorë që dalin me -a ose -e të theksuar (again, babain, jubileun, atdheun);

4. U konsideruan si gabime prirjet në përdorim të formave të zhdrejta të përemrave pronorë të gjinisë femërore ime, jonë, jote dhe juaj si vajzës time, vajzës tonë, vajzës tënde, vajzës tuaj dhe kërkohet respektimi i normës ekzistuese, pra vajzës sime, vajzës sate, vajzës sonë, vajzës suaj;

5. Përdorimi i trajtave të lidhore pa formantin të (p.sh. do laj) konsiderohet shkelje e normës; formë e vetme e drejtë konsiderohet forma me të: do të laj;

6. Tek urdhërorja joveprore e foljeve të tipit kruaj, ruaj duhet të mbetet normative forma me -j (ruaju, kruaju), dhe jo me -h (kruhu, ruhu);

7. Rastet e tjera të sistemit emëror dhe foljor, të cilat mund të dalin me zgjidhje të veçanta, mbetet të studiohen dhe të diskutohen në mbledhjen e radhës të Këshillit, bashkë me çështjen e përdorimit të shkronjës së madhe;

8. U arrit përfundimi që të mos mbështetet prirja për respektimin e ambigjinitë tek emrat shumë më -ra (fshatra të elektrizuara, ujëra të ftohta) dhe të konsiderohet si normative vetëm forma e gjinisë mashkullore (fshatra të elektrizuar, ujëra të ftohtë).

9. U vendos që në mbledhjen e radhës të Këshillit të merren në shqyrtim çështjet e mbetura nga kjo mbledhje dhe nga mbledhja e kaluar, e që lidhen me drejtshkrimin dhe me morfologjinë, si dhe ato që do të propozojnë grupet e punës për çështje sintaksore.

ANËTARI KORRESPONDENT SALIH GASHI MERR PJESË NË TAKIMIN VJETOR TË GRUPI PUNUES PËR SHKENCË DHE EDUKIM TË ALLEA-s

Më 19-21 nëntor anëtari korrespondent i ASHAK ka qëndruar në Dublin, me ç'rast ka marrë pjesë në takimin vjetor të grupi punues për shkencë dhe edukim të ALLEA-s. Profesor Gashi ka prezantuar në takim të arriturat dhe projektet që janë zhvilluar dhe janë në zhvillim e sipër në institucionet e Kosovës.

TRYEZA SHKENCORE “PUNËSIMI NË KONTEKSTIN ZHVILLIMOR DHE INTEGRUES TË KOSOVËS”.

Seksioni i Shkencave Shoqërore i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës organizoi tryezën shkencore me temë: “Punësimi në kontekstin zhvillimor dhe integruës të Kosovës”. Tryeza u mbajt më 27 dhjetor 2013, në mjediset e Akademisë. Në Tryezë morën pjesë: anëtarë të ASHAK-ut, profesorë universitarë, përfaqësues të institucioneve të ndryshme, përfaqësues të mediave dhe të interesuar të tjerë. Tryezën e hapi akademik Mark Krasniqi. Në vazhdim kontributet e tyre i paraqitën: Isa Mustafa, Muhamet Mustafa, Lumir Abdixhiku, Premton Hyseni, Venera Demukaj, Dr. Avdullah Hoti, Dr. Besnik A. Krasniqi, Hafiz Leka, Ymer Havolli.

Lendita Juniku – Pula

STUDIME SHOQËRORE

1

2014

Botues:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:

Mr. Shefqet Riza

Redaktor teknik:

ASHAK

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia:

21.12 tabakë shtypi

Tirazhi:

200 copë

Formati:

16x24 cm

U shtyp në shtypshkronjën:

Focus Print

Shkup